

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË

KDU: 94 (05)

K O S O V A

40
2015

**PRISHTINË
2015**

KRYEREDAKTOR

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

SEKRETAR I REDAKSISË

Dr. sc. Gjon BERISHA

REDAKSIA

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

Akademik Beqir META

Prof. dr. Sabile BASHA - KEÇMEZI

Akademik assoc. Marenglen VERLI

Prof. dr. Pëllumb XHUFİ

Prof. dr. Frashër DEMAJ

Prof. dr. Hamit KABA

Dr. sc. Gjon BERISHA

Dr. sc. Bedri MUHADRI

THE INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA

K O S O V A

**40
2015**

**PRISHTINA
2015**

PËRMBAJTJA-CONTENTS

Nermin BASHA

Dëshmi të lashtësisë për dardanët.....	9
Testimony regarding the antiquity of Dardanians.....	23

Arben ARIFI

Nëdmarrjet e mëdha të Justinianit në Dardani dhe sistemi fortifikues.....	25
Justinian's grand undertakings in Dardania and the fortification system.....	36

Teuta SHALA - PELI

Të dhëna për rolin dhe pozitën e gruas në Drisht dhe Shkodër gjatë mesjetës.....	37
Some data regarding the role and position of women in Drisht and Shkodër during the medieval period.....	48

Bedri MUHADRI

Pushtimi i Kosovës nga osmanët në shekullin XV.....	49
The ottoman conquest of Kosova in the 15 th century.....	63

Gjon Berisha

“Arbanaška vera” si komponent i kontinuitetit dhe identitetit shqiptar.....	65
“Arbanaška vera” as a component of the Albanian identity and continuity.....	83

Hasan BELLO

Kontributi i dr. Ibrahim Temos për reformimin e sistemit arsimor osman.....	85
The contribution of dr.Ibrahim Temo in regards to reforming the ottoman educational system.....	96

Fitim RIFATI

Shqiptarët në Lëvizjen Xhonturke (gjysma e dytë e korrikut-gusht 1908)	97
Albanians and The Young Turks Movement (second half of july – august 1908)	114

Xheladin SHALA

Shqipëria në kohën e princ Vedit 1914.....	115
Albania during the reign of Prince Wied 1914.....	171

Muin ÇAMI - Marenglen VERLI

Piruetat greke në Konferencën e Paqes rreth pretendimeve mbi Shqipërinë e jugut në periudhën janar - maj 1919.....	173
The Greek pirouettes at the Paris Peace Conference in relation to their territorial aspirations in southern Albania throughout january- may of 1919.....	191

Jorina VERLI

Shqipëria–prioritet strategjik i politikës italiane në dekadat e para të shek. XX.....	193
Albania–a strategic priority for italian politics in the first decades of the 20th century.....	215

Alban DOBRUNA

Rendi Halveti në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.....	217
The Halveti rite and the National Albanian Movement.....	235

Skender LUTFIU

Arsimi dhe kultura shqiptare në Ferizaj(1918-1941).....	237
Albanian education and culture in Ferizaj(1918-1941).....	249

Eva BABAMETO

SOE në Shqipëri: përpjekje për organizimin e kryengritjes së përgjithshme, 1940-1941.....	251
SOE in Albania: attempts in organizing a general uprising, 1940-1941.....	269

Marenglen KASMI

Divizioni SS “Skanderbeg” dhe kushtet e krijimit të tij në vitin 1944.....	271
The SS “Skanderbeg” Division and circumstances surrounding its formation in 1944.....	284

Mrika LIMANI

Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë.....	285
--	-----

A quantitative analysis of the victims pertaining to the Second World War in Prizren and its vicinity according to the list of war victims published by the Federal Executive Council in Yugoslavia.....	296
--	-----

Sabile KEÇMEZI - BASHA

Lëvizja Ilegale Kombëtare Shqiptare në Kosovë (1945-1999).....	297
The Illegal National Albanian Movement in Kosova (1945-1999).....	314

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hamit Kaba

Aktivitetet e SOE në Shqipëri.....	315
------------------------------------	-----

RECENSIONE

Gjon Berisha, <i>Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV</i> , Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë 2015, f. 675. (Teuta SHALA - PELI).....	305
--	-----

<i>Gjeneral G. F. Phillips dhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, dokumente historike nga Arkivat Britanike 1913-1921, përgatitur nga Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, Tiranë, Londër 2015, f. 483 .</i> (Hakif BAJRAMI).....	335
--	-----

AKTIVITETE

Aktivitetet e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë për periudhën 2014-2015.....	339
--	-----

NERMIN BASHA

DËSHMI TË LASHTËSISË PËR DARDANËT

Artikulli e merr nxitjen nga përmendja e Dardanëve tek autorë të ndryshëm të lashtësisë. Si banorë të një krahine të pasur, që shtrihej nga Danubi deri në kufijtë veriorë të Maqedonisë, dardanët përbënin një nga fiset më të rëndësishme ilire. Trojet dardane kanë qenë gjithmonë lakmi e fqinjëve nga pasuritë e shumta të tokës e nëntokës, nga pozicioni gjeografik etj., duke i bërë ndër shekuj udhëkryq karvanësh dhe ushtrish. Autorë të antikitetit i paraqesin dardanët luftëtarë të zot që mbronin pareshtur tokën e vet. Ashtu si ardianët për det, kështu dardanët i përfaqësuan ilirët për tokë, si fuqi e madhe në zemër të Ballkanit. Të ndarë në shumë fise, ata u bashkuan në një shtet dhe mbret të vetëm, duke u bërë forcë e rëndësishme në një periudhë të caktuar të historisë. Nën sundimin e Romës, dardanët nuk u romanizuan, duke ruajtur individualitetin dhe etnosin e tyre, ndonëse ushtarakisht dhe ekonomikisht u detyruan të nënshtrohen.

Ekzistenca dhe veprimet e dardanëve në po ato troje që gëzojnë edhe sot, ashtu si ilirët në përgjithësi, kanë bërë studiuesit të arrijnë në përfundimin se të parët e popullit shqiptar kanë zënë vend në viset e sotme, të paktën, që në kohë të grekëve e romakëve. Në fillim të përshkrimit të luftërave të romakëve me ilirët, Apiani, mbështetur në një gojëdhënë që si duket qarkullonte në kohën kur ai jetoj ose në shkrime të tjera më të hershme që i përdori si burim të punës së vet, lidhur me prejardhjen dhe emrin e ilirëve, ku përfshinë edhe dardanët, nga pikëpamja etnike (pohim që e gjejmë edhe te Straboni), na paraqet këtë dëshmi: *“Romakët pohojnë se Iliria u quajt nga Iliri, djali i Polifemit. Për këtë, thonë se nga Ciklopi Polifem dhe gruaja e tij Galatea, lindën tre djem: Kelti, Iliri dhe Gali. Këta, duke u nisur nga Sicilia, u bënë zotër të popujve, që më pas i mbiemëruan: keltë, ilirë dhe galë. Këto, mes shumë gjërave të tjera që shkruajnë rreth kësaj pune, unë i kam*

zgjedhur për më të mirat dhe për më të vërtetat. Thonë pastaj që Iliri pati fëmijë meshkuj: Akilin, Autarin, Dardanin, Medin, Taulantin dhe Perrebin. Dhe vajza: Partën, Daortën, Deserën dhe të tjera. Nga këta rrodhën pastaj Taulantët, Perrebejtë, Akilejtë, Autariatët, Dardanët, Parthenët, Dasaretët, Parthenët, Dasaretët dhe Darsët”.¹ Pra, sipas Apianit, Dardani, heroi eponim i dardanëve, ishte i biri i Ilirit.

Në shumë materiale, ilirët përkufizohen si popullsi me origjinë indoevropiane, që mori emrin, sipas traditës mitike, nga Iliri, dhe zuri vend, në kohëra shumë të hershme, në Iliri. Pasi ishin futur në Greqi dhe pasi kishin kontribuar në popullzimin e Italisë, (ku janë njohur si popullsi me origjinë të sigurt ilire, japigët dhe mesapët), nën goditjen e pushtimit kelt, ilirët përfunduan në bregun perëndimor të Gadishullit Ballkanik, dhe të përzierë edhe me elementë trakë, u ndanë në grupe të ndryshme.² Një pjesë e ilirëve doli nëpër Helespont e Propontide në Azinë e Vogël, sepse dardanët e Trojës, të cilët përmenden në Iliadë prej Homerit bashkë me trojanët, janë, si duket, një pjesë e fisit ilir të dardanëve.³ Na duket me shumë vend të paraqesin këtu edhe shkrimin e studiueses Papazoglu në lidhje me këtë. Sipas saj, në favor të vjetërsisë së dardanëve, fisit ilir,⁴ në Gadishullin Ballkanik flet edhe lidhja e tyre me disa fise në Italinë Jugore. Straboni ka shënuar dy fise dardane: Γαλάβρνοι dhe Θουνᾶται. Po sipas saj, të dy këta emra kanë analogjitë e tyre të afërta në Gadishullin e Apenineve: Calabri, nga të cilët ka marrë emrin krahina e Kalabrisë, kanë qenë, siç duket, të afërm me galabrët e Dardanisë, ndërsa Daunii në Pulje, me thunatët e Ballkanit.⁵ Dardanët,

¹ *Tre libri di Appiano Alessandrino delle guerre che i Romani fecero nella Spagna, di quelle che fece Annibale in Italia, e di quelle che i Romani fecero nella Illiria, Venetia: A, Appresso Camillo Francheschini, 1575, 5.*

² Rizzoli Larousse, *Enciclopedia universale*, vëllimi VII, Milano 1968, 728

³ Paul Kretschmer, *Dituria gjuhësore indoevropiane*, Tiranë 1923, 75

⁴ Fanula Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba : Tribali, Autarijati, Dardanci, Skordisci i Mezi*, Centar za balkanološka ispitivanja (Series) ; knj. 1. Djela (Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine), knj. 30, Sarajevo: Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine, 1969, 102-103; Idem, *Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake. 1.Dardanët 2. Sistemi politik, marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike*, Sarajevë 1969, material i përkthyer në gjuhën shqipe në: Arkivi i Institutit të Historisë [më tej: AIH], Tiranë, 69.

⁵ Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, 103; AIH, Tiranë , f. 3. Një mendim të tillë, shumë vite më parë, e ka shprehur edhe P.Kretschmer, *Dituria gjuhësore indogjermane*, 70. Sipas tij, edhe në anën perëndimore të Adriatikut, gjatë brigjeve lindore të Italisë, dolën dy fise ilire, japygët ose japudët. Këta lanë gjurmët e veta në Umbri, u ngulën sidomos në Apuli e Kalabri, emri i së cilës takon me atë të fisit ilir Galabrian.

që banonin në Rrafshin e Kosovës, rreth Nishit e Shkupit, në atë “*trevë, e cila shtrihej pak më në perëndim të qendrës së Gadishullit (Ballkanik), përfshinte krahinën e lumit Aksios (Vardarit) të epër dhe të lumenjve që ushqejnë Moravën e sipërme, duke shkuar gjer te luginat e Ibrit dhe Detit të Zi*”,⁶ përbënin një nga fiset më të mëdha dhe më të rëndësishme ilire të viseve të Ballkanit Qendror. Autorë të antikitetit i konsideronin si nxjerrës dhe punues të arit: “*Madje edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës (rrathë ari), që vinin nga Dardania, dhe prandaj quheshin dardane...*”,⁷ na njofton Plini i Dytë në veprën e tij “*Historia e Natyrës*”. Për ta gjejmë njoftime veçanërisht te Tit Livi sipas të cilit, Prokonsull K. Kurioni i nënshtroi dardanët në Thraki.⁸

Një mbretëri ilire që u formua në shekullin IV p. e. s. dhe që shtrihej në territorin e Kosovës së sotme, të Maqedonisë Veriperëndimore, të Serbisë Jugore dhe në një pjesë të Sanxhakut, qe Mbretëria Dardane. Dardania kufizohet me fiset maqedone dhe paione nga ana e jugut, sikundër edhe me autariatët e dasaretët, të tjerë fise këto, në vise të tjera, që janë kufitare në mes tyre, dhe me autariatët.⁹ Në veprën e tij “*Mbi luftën civile*”, Cezari numëron legjionet që Pompeu kishte mbledhur e formuar me ushtarë të rekrutuar nga të katër anët e botës së atëhershme, nën pushtetin e Romës ose në miqësi me të. Mes të tjerëve, autori përmend edhe dardanët. Në një kaptinë të veprës së tij, Cezari shkruan se: “Përveç këtyre, duke dashur të plotësonte numrin e trupave, kishte shpërndarë nëpër legjione shumë ushtarë nga Tesalia, Beotia, Akaia dhe Epiri. Këtyre trupave, Pompeu u kishte shtuar burra dardanë e besë, pjesërisht mercenarë, pjesërisht të mobilizuar me forcë ose të marrë në bazë miqësie, gjithashtu maqedonas, tesalas dhe nga popullsia të tjera, duke mbërritur kështu tek ai numër që kemi treguar më sipër”.¹⁰ Autori na tregon për trupat që bënin pjesë në ushtrinë e

⁶ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëllimi IV (Nga historia e gjuhës shqipe. Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte), Prishtinë, 1977, 386

⁷ C. Plini Secundi, “*Naturalis Historiae*”, libri XXXIII, kreu 13, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë 1965.

⁸ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, tomus quintus, libri XCV, Bassani MDCCLXXVIII, f. 183 (C. Curio proconsul Dardanos in Thracia domuit.)

⁹ Strabonis, “*Geographica*”, libri VII, kreu 5, pika 6, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë 1965, 155.

¹⁰ Julius Caesar, “*De bello civili*”, liber tertius, Milano 1938, 24 (...*Praeterea magnum numerum ex Thessalia, Boetia, Achaia, Epiroque supplementi nomine in legiones distribuerat... Huc Dardanos, Bessos partim mercennarios, partim imperio aut gratia comparatos, item Macedones, Thesalos ac reliquarum gentium et civitatum adiecerat atque eum, quem supra demonstravimus, numerum expleverat.*)

Pompeut, mbledhur nga e gjithë bota e njohur deri atëherë. Edhe më pas, Cezari vazhdon të numërojë trupat që bënë pjesë në ushtrinë e Pompeut, duke përdorur jo emrin e vendit, por emrin e fisit, si: *dardanë, maqedonas, besë*, etj., ndër të cilët kishte të rekrutuar me forcë, por kishte edhe të marrë me bazë miqësie (...*partim imperio aut gratia comparatos*...). Duke komentuar shprehjen e Cezarit “*Huc Dardanos, Bessos, partim mercennarios, partim imperio aut gratia comparatos*”, Papazoglu kërkon të sqarojë se me farë cilësimi shërbenin dardanët në ushtrinë e Pompeut, nëse *partim mercennarios, partim imperio aut gratia comparatos*, u përket edhe dardanëve apo vetëm besëve.

Gramatikisht duket se është më i drejtë ky i dyti, por edhe interpretimi i parë nuk përjashtohet. Sidoqoftë, teksti i Cezarit nuk na lë pezull. Ndoshta, dardanët kanë qenë të detyruar të japin ushtri, por njëkohësisht, ka mundësi që duke shfrytëzuar çrregullimet e shkaktuara nga luftërat civile, nuk kanë dashur të binden. Prandaj, nuk do të ishte e çuditshme që të jenë inkuadruar edhe ata në ushtrinë romake si mercenarë ose si *gratia comparati* (në bazë miqësie).¹¹ Dardanët jetonin në Dardani,¹² një nga krahinat e mëdha dhe më të rëndësishme të Ilirisë. Ata hyjnë midis fiseve më të vjetra ballkanike që i njohim nga emri; është e vërtetë se për ta nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta nga koha e Homerit, por një sërë rrethanash tregojnë se ata kanë jetuar në Gadishullin Ballkanik para dyndjes trako-frigjiane që daton në shekullin XIII - XII p. e. S.¹³ Sipas nobelistit Mommsen, shtrirja e tyre ishte mjaft

¹¹ Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba – Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 47.

¹² *Historia e Popullit Shqiptar*, I, Tiranë 2002, 143. Në Dardani jetonin një varg fisesh, por, nga burimet e shkruara, mbetën të njohur vetëm fisi i dardanëve, galabrëve, daunëve dhe thunatëve. Rreth shekullit VI-IV para e.s., fisi i dardanëve mori rolin drejtues mbi bashkësinë fisnore, duke i dhënë më pas edhe emrin gjithë mbretërisë. Po në këtë material, f. 144, lidhur me emrin e Dardanisë dhe të fisit dardan, jepet ky shpjegim: etimologjia e emrit dardan, përkatësisht e Dardanisë, lidhet me glosën indoevropiane *dardh-a*, shqip: dardha, dhe do të thotë vendi i dardhave. Edhe qytetet antike dardane e përcjellin zhvillimin fonetik të shqipes, si Naissus-Nish, Scupi-Shkup, apo emrat, apo emrat e maleve dhe të lumenjve në Dardani, si Scardus mons-mali Sharr, Drinus-Drini.

¹³ Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba, - Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 3. Po kjo autore, për përhapjen edhe lashtësinë e dardanëve, shkruan se në pjesën veriore të Azisë së Vogël, në Troade, kanë jetuar në kohën e Homerit dhe më vonë, dardanë. Heroi eponim i tyre *Dardanos* është kënduar në epos si themeluesi i shtëpisë sunduese të Trojës. Në bregun jugor të Helespontit, midis Ilionit dhe Abidit, gjindej qyteti Dardanos dhe, sipas traditës, në kohë të vjetër ka ekzistuar edhe qyteti Dardania, i cili më vonë u zhduk. Krahina ku gjendeshin këto

e madhe: “*Dalluan pastaj në vend të tyre dardanët, në territorin mes kufijve veriorë të Maqedonisë dhe Danubit*”.¹⁴ Për dardanët ka njoftime mjaft të hershme nga autorët e lashtë. Në një pjesë të veprës së tij Polibi na thotë se: “*ndërsa mbreti ishte i zënë akoma me këto punë, një i dërguar nga Maqedonia, erdhi dhe e lajmëroi se dardanët, duke menduar se ai do të nisej për Peloponez, po grumbullonin forca dhe po bënëin përgatitje të mëdha për të hyrë në Maqedoni*”.¹⁵

I përmend Ciceroni në një nga ligjëratat e tij, duke mbajtur qëndrim mjaft të rreptë ndaj drejtuesit romak në vendin e dardanëve ku thotë se: “*(Pizoni) po ua shiste shtrenjtë paqen thrakëve e dardanëve...; kurse durrahasve u kërkonte shuma të mëdha*”.¹⁶ Në kohën e sulmeve gale në krahinat në fjalë, dardanët, ndonëse gjithmonë kishin pasur armiqësi me maqedonët, në rrezikun e përbashkët, ofruan ndihmën e tyre në luftë të bashkuar kundër sulmeve gale. Mirëpo, duke folur për këto ngjarje dhe duke na njoftuar për propozimin e dardanëve, Justini na tregon se: “*vetëm mbreti i Maqedonisë, Ptolemeu, e priti i shkujdesur lajmin e afrimit të galëve... Ai përbuzi propozimin e dardanëve për një ndihmë prej 20 000 luftëtarësh, për më tepër, u përgjigj me fyerje, duke u thënë se kjo ishte punë për Maqedoninë: nëse dikur maqedonët kishin nënshtruar, të vetëm, gjithë Lindjen, tani nuk kishin nevojën e dardanëve për mbrojtjen e kufijve të tyre; se ushtarët maqedonas ishin bijtë e atyre, të cilët, nën shërbimin ushtarak të mbretit Aleksandër, kishin dalë fitimtarë në gjithë rruzullin tokësor. Kur ia thanë këto fjalë mbretit Dardan, ai u përgjigj se, së shpejti, mbretëria e lavdishme maqedone do të binte nga papjekuria e një të riu*”.¹⁷ Fakti që dardanët

qytet quhej Dardani dhe, në bazë të saj, më vonë, ngushticat e morën emrin Dardanele.

¹⁴ Teodor Mommsen, *Storia di Roma antica*, volume secondo, libro 4, capitolo V, Roma- Torino 1908, 144.

¹⁵ Polybii, “*Historiae*”, libri IV, kreu 66, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë 1965, 55.

¹⁶ M. Tulli Ciceronis, “*Oratio pro Sestio*”, kreu XLIII (...*Thracibus ac Dardanis primum pacem maxima pecunia vendidisse...; cogere pecunias maximas a Dyrrachinis*).

¹⁷ M. Juniani Justini, “*Epitoma Historiarum Philippicarum Pompei Trogi*”, liber XXIV, kreu 4: (*Solus rex Macedoniae Ptolemeus adventum Gallorum intrepitus audivit... Dardanorum quoque legationem XX milia armatorum in auxilium offerentem sprexit, addita insuper contumelia, actum de Macedonia dicens, si, cum totum Orientem soli domuerint, nunc in vindictam finium Dardanis egeant; milites se habere filios eorum, qui sub Alexandro rege stipendia toto urbe terrarum victores fecerint. Quae ubi Dardano regi nuntiata sunt, inclitum illud Macedoniae regnum brevi immaturi iuvenis temeritate casurum dixit*).

ofronin një ndihmë jo të vogël, po një forcë prej 20 mijë trupash, tregon për madhësinë dhe fuqinë e Dardanisë në kohën e pushtimit kelt. Dhe ndodhi ashtu si e parashikoi mbreti dardan. Në betejën që u zhvillua pas disa ditëve në Maqedoni, ushtria maqedone u shpartallua dhe mbreti Ptoleme u zu rob nga galët. Këta vazhduan rrugën drejt Greqisë ku grabitën faltoren e Delfit, por në kthim i priste një ndëshkim i paparashikuar.

Që dardanët kanë qenë një nga ata popuj që nuk la pa ia marrë hakun armikut të dërrmuar për viktimat dhe frikën që kishte pësuar pak kohë më parë prej tij, këtë na e njofton Diodori i Sicilisë,¹⁸ i cili shkruan se “... u asgjësuan të gjithë (galët) në tokën e dardanëve, nëpër të cilën donin të kalonin, dhe nuk mbeti as edhe një i vetëm, i cili të mund të shihte përsëri atdheun e vet”.¹⁹ Emri i fisit të dardanëve na paraqitet edhe në veprën e Tit Livit, madje në disa krerë; në njërin prej tyre mësojmë se, “ndërsa (Filipi) po ndante plaçkën dhe robërit - qenë rreth 4 mijë burra dhe 20 mijë krerë bagëti të çdo lloji - erdhi lajmëtari nga Maqedonia dhe njoftoi se një farë Eropi, si kishte korruptuar komandantin e kështjellës dhe të garnizonit, kishte shtënë në dorë qytetin Lyhnid, ishte bërë zot i shumë fshatrave të Dasaretisë dhe mundahej të ngrinte dardanët...”.²⁰ Në një pjesë tjetër Tit Livi thotë se sundimtarët fqinjë me maqedonët, Pleurati, i biri i Skerdilaidit, e Amyndandri, mbreti i atamanëve, dhe prej dardanëve, Batoja, i biri i Longarit, kishin shkuar te kampi romak. Longari kishte luftuar për arsye të vet me Demetrin, babanë e Filipit. Ata u ofronin ndihmën e tyre romakëve;²¹ në kreun 33 Livi përsëri na njofton se ai vetë po grumbullonte forcat tokësore, duke besuar se u kishte shkëputur dy ndihma të mëdha romakëve, nga një anë etolët, kurse nga ana tjetër dardanët, duke u mbyllur gryka e Pelagonisë nga i biri i tij, Perseu.²²

¹⁸ Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba - Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 1.

¹⁹ Diodori, “Excerpta Hoeschel”, 495 - 497, *Ilirët dhe Iiria në autorët antikë*, Tiranë 1965, 146.

²⁰ T. Livii, “*Ab urbe condita*”, libri XXVII, kreu 32 (*Dividenti praedam captivosque - fuere autem quattuor milia hominum, pecorisque omnis generis ad viginti milia - nuntius ex Macedonia venit Aeropum quendam corrupto arcis praesidiiue praefecto Lychnidum cepisse; tenere et Dassaretiorum quosdam vicos et dardanos etiam concire*)

²¹ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, libri XXXI, kreu 28 (...*principes accolae Macedonum in castra Romana veniunt, Pleuratus Scerdilaedi filius et Amynder Athamanum rex et Dardanis Bato Longari filius.*)

²² T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, libri XXXI, kreu 33 (*Ipse terrestres copias*

Sikurse ardianët përfaqësonin ilirët si një popull të fortë për det, ashtu dardanët i përfaqësonin si një fuqi të madhe për tokë, të sunduar nga mbretër të fuqishëm, të cilët luajtën rol të madh në Gadishullin Ballkanik për një kohë të gjatë.²³ Trimërinë e forcën e tyre e mësojmë përsëri edhe nga Tit Livi, i cili na thotë se: *“po ato ditë dhe Atenagora, gjeneral i mbretit (Filipit), duke i mbërritur dardanët në çastin kur këta po futeshin në territoret e veta, fillimisht, pështjelloi praparojën e tyre; pastaj, kur dardanët kthyen flamujt dhe u radhitën përballë armikut, beteja u zhvillua njëlloj si në një luftë e vërtetë. Por, sapo dardanët nisën të ecnin sërish, njerëzit e mbretit i bezdisnin me kalorësinë dhe këmbësorinë e tyre të lehtë, kurse dardanët nuk kishin fuqi ushtarake të këtij lloji dhe ishin ngarkuar me armë të rënda; natyra e vendit i ndihmonte. U vranë pak, të plagosur pati më shumë, asnjë nuk u zu rob, sepse nuk dalin pa arsye nga radhët, por të shtrënguar, të gjithë së bashku, luftojnë ose tërhiqen”*.²⁴ Për disa dekada mbas vërshimit kelt nuk ka asnjë lajm për dardanët, por kur dëgjohet përsëri për ta, shfaqen si populli më i fuqishëm në brendësinë e Gadishullit Ballkanik dhe luajnë rol të rëndësishëm në jetën e jashtme - politike të asaj kohe.²⁵ Historia vetëm përsëritet: mbreti Filipi V i Maqedonisë kishte pushtuar në vitin 211 p. e. s. qytetin dardan Sintia, të cilin dardanët e rimorën në vitin 199 p. e. s., madje duke u futur thellë në Maqedoni. Ngaqë nuk i theu dot vetë dardanët, Filipi V planifikoi të zhdukte popullin e Dardanisë. Këtë qëllim të tij na e përçon Tit Livi, duke na treguar se qëllimi i tij ishte të zhdukte popullin e dardanëve dhe të vendoste në tokat e tyre bastarnët, që jetonin në Bullgarinë e sotme. Ja, ç’kemi trashëguar nga shkrimtari romak: *“Qëllimi i tij ishte të shfaroste dardanët dhe të vendoste bastarnët në territoret e tyre. Dobia për të do të ishte e dyfishtë: nga njëra anë hiqte qafe një popull që kishte qenë gjithmonë armik i Maqedonisë dhe çdoherë ishte përpjekur të nxirrte*

comparabat, magna se duo auxilia Romanis detraxisse credens, ex una parte Aetolos, ex altera parte Dardanos, faucibus ad Pelagoniam a filio Perseo interclusis.)

²³ Karl Patch, *Ilirët*, Tiranë 1923, 41

²⁴ T. Livii, “Ab Urbe condita”, libri XXXI, kreu 43 (*Per eos dies et Athenagoras, regius praefectus, Dardanos recipientes se in fines adeptus, postremum agmen primo turbavit; dein, postquam Dardani conversis signis direxere aciem, aequa pugna iusto proelio erat. Ubi rursus procedere Dardani coepissent, equite et levi armatura regii nullum tale auxilii genus habentes Dardanos oneratosque immobilibus armis vexabant; et loca ipsa adiuvant. Occisi perpauci sunt, plures vulnerati, captus nemo, quia non excedunt temere ordinibus suis, sed confertim et pugnant et cedunt*).

²⁵ Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba - Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 31.

*përfitime nga fatkeqësitë e mbretërve të tyre; nga ana tjetër, bastarnët, si të linin gratë dhe fëmijët në Dardani, të hidheshin në Itali për ta plaçkitur. Përmes skordistëve, mendonte Filipi, dilej në detin Adriatik dhe Itali. Ishte rruga e vetme nga mund të kalonte një ushtri. Skordistët do t'i lejonin bastarnët të kalonin lehtësisht në tokat e tyre, sepse kishin afërsisht të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone; madje, vetë ata, me dëshirë, do t'u bashkoheshin, kur të shihnin se (bastarnët) po shkonin të plaçkitnin një popull aq të pasur. Filipi përfitonte nga çdo plan. Në qoftë se bastarnët asgjësoheshin prej romakëve, prapëseprapë ai do të gjente ngushëllim, sepse hiqte qafe dardanët, shtonte pasurinë nga plaçka e luftës së bastarnëve dhe mbetej zotërues i papenguar i Dardanisë. Në qoftë se bastarnët ia dilnin mbanë, ai përfitonte duke i shmangur romakët të zënë në luftë me bastarnët, për të rishtënë në dorë gjithçka kishte humbur në Greqi. Këto llogari kishte bërë Filipi”.*²⁶

Duke lexuar këto rreshta, a nuk të duket sikur Filipi i 2 000 e ca vjetëve më parë rijetoi te Çubrilloviçi dhe Millosheviçi në mbarim të shekullit XX? Por, dardanët ia dolën në krye dhe kah viti 176 - 175 p. e. s. u çliruan nga rreziku bastarn, duke bërë që plani i Filipit për të shfarosur dardanët me anë të bastarnëve, të dështonte përgjithnjë. Përsëri Tit Livi na e përcjell këtë fakt duke na treguar një nga sakrificat e shumta të dardanëve për të ruajtur trojet atërore historikisht. “Kur (dardanët) panë se bastarnët, jo vetëm nuk po largoheshin nga territoret e tyre, si shpresonin, por ditë për ditë u bënë in keq, mbështetur edhe në ndihmën e trakasve fqinjë, por edhe të skordistëve, dardanët, duke menduar se duhej të ndërmerrnin ndonjë aksion, qoftë edhe pa plan, mblodhën shumë njerëz të armatosur nga të gjitha anët pranë qytetit që ndodhej më afër kampit të bastarnëve. Ishte dimër dhe dardanët kishin zgjedhur bash këtë stinë të vitit, ngaqë thrakasit dhe skordistët shkonin në vatrën e vet. Kështu ishte dhe, kur (dardanët) panë

²⁶ T. Livii, “Ab Urbe condita”, libri XL, kreu 57 (*Dardanorum gentem delere propositum erat inque eorum agro sedes dare Bastarnis. Duplex inde erat commodum futurum, si et Dardani, gens semper infestissima Macedoniae, temporibusque iniquis regum imminens, tolleretur; et Bastarnae, relictis in Dardania conjugibus liberisque, ad populandum Italiam possent mitti. “Per Scordicos iter daturos; nec enim aut lingua aut moribus aequales abhorrere; et ipsos adjuncturos se, quum ad praedam opulentissimae gentis ire vidissent.” Inde in omnem eventum consilia accommodabantur. Sive caesi ab Romanis forent Bastarnae, Dardanos tamen sublatos, praedamque ex reliquiis Bastarnarum, et possessionem liberam Dardaniae, solatio fore: sive prospere gessissent, Romanis aversis in Bastarnarum bellum, recuperaturum se in Graecia, quae amisisset. Haec Philippi consilia fuerant).*

se bastarnët ishin vetëm, i ndanë forcat në dy pjesë: njëra të shkonte nëpër një rrugë të drejtpërdrejtë për t'i sulmuar ballë për ballë; pjesa tjetër, si të bënte një rrethrotullim, të sulmonte nga shpina. Mirëpo, lufta nisi përpara se ata të mund të rrethonin kampin armik; dhe dardanët, të mundur, kthehen në qytetin që ishte rreth 12 mijë hapa larg nga kampi i bastarnëve. Ngadhënjësit rrethojnë menjëherë qytetin, të sigurt se, të nesërmen, ose armiqtë do të dorëzoheshin nga frika e tyre, ose ata do ta pushtonin vendin me forcë. Ndërkaq, pjesa tjetër e dardanëve që kishte bërë rrethrotullimin, duke mos ditur humbjen e të vetëve, futi në dorë, pa asnjë mundim, kampin e bastarnëve, që ishte pa mbrojtje. Bastarnët, të mbetur pa ushqim dhe mjete luftarake që i kishin grumbulluar në kamp, mbasi nuk kishin asnjë mundësi t'i ripërtërinin në mes të krahinës armike dhe në stinën më të pafavorshme të vitit, vendosën të riktheheshin në vendin e vet”.²⁷

Emrin e dardanëve dhe të Dardanisë e gjejmë edhe në shumë autorë të tjerë të vjetër. Dardanët ishin të ndarë në shumë fise, që në fillim të shekullit III p. e. s., ishin bashkuar nën një mbret në një shtet të vetëm të njësishtëm, që u ngrit si një fuqi e rëndësishme, duke u bërë kërcënim për zonat e afërta. Disa nga qytetet e tyre janë: Damastioni, të cilin arkeologët mendojnë se duhet kërkuar në afërsi të Mitrovicës,²⁸ Nishit, Shkupit etj. Ka studiues që pranojnë idenë se nën Perandorinë Romake, dardanët u romanizuan me shpejtësi. Por, ndryshe mendojnë studiues të tjerë. Në kreun e parë të veprës së vet, Papazoglu shkruan se asnjërit prej popujve me të cilët merrem në këtë libër, nuk i përshtatet aq mirë epiteti “ballkanik”, siç u përshtatet dardanëve, jo vetëm nga shkaku

²⁷ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, libri XLI, kreu 19 (*Dardani cum Bastarnas non modo non excedere finibus suis, quod speraverant, sed graviores fieri in dies cernerent, subnixos Thracum accollarum et Scordischorum auxiliis, audendum aliquid vel temere rati, omnes undique armati oppidum, quod proximum castris Bastarnarum erat, conveniunt. Hiems erat, et id anni tempus elegerat, ut Thraces Scordisque in fines suos abirent. Quod ubi ita factum, et solos jam esse Bastarnas audierunt, bifariam dividunt copias: pars, ut recto itinere ad lacessendum ex aperto iret; pars, devio saltu circumducta, ab tergo aggredederetur. Ceterum, priusquam circumire castra hostium possent, pugnatum est; victique Dardani compelluntur in urbem, quae fere duodecim milia ab castris Bastarnarum aberat. Victores confestim circumsidunt urbem, haud dubie postero die aut metu dedituris se hostibus, aut vi expugnaturi. Interim, Dardanorum altera manus, quae circumducta erat, ignara cladis suorum, castra Bastarnarum sine presidio relictas, nullo negotio cepit. Bastarnae, omni et commeatu et apparatu bellico, qui in castris fuerat, exuti, quum eius reparandi facultas ex hostili regione, et infesto tempore anni, nulla esset, patrias sedes repetere statuerunt*).

²⁸ Neritan Ceka, *Udhëtim në kështjellat ilire*, Tiranë 2006, 44

se vendi i tyre gjendej në zemrën e Ballkanit, por edhe nga shkaku se ata shfaqen si elementi më i qëndrueshëm dhe më konservativ në një zonë ku çdo gjë u nënshtrohej ndryshimeve të vazhdueshme dhe nga shkaku se, duke pasur parasysh rrënjët në epokën parahomerike, duke u gjetur në kufirin e botës ilire dhe trake, e ruajtën individualitetin e tyre dhe qenë të vetmit nga të gjitha fiset e asaj zone që mundën të ruajnë etnosin e tyre, edhe atëkohë kur iu nënshtroan ushtarakisht dhe ekonomikisht armëve romake.²⁹ Po cila ishte përkatësia etnike e dardanëve?

Sipas Papazoglusë, tradita sipas së cilës dardanët, ashtu si fqinjët e tyre - autariatët dhe ardianët - kanë qenë ilirë, është ruajtur tek Straboni³⁰ dhe tek Apiani. Ajo duhet të jetë e vjetër, që nga koha kur ka ekzistuar fqinjësia midis këtyre popujve. Tek historianët më të vjetër se Straboni, (Polibi, Tit Livi) dhe historianët që kanë kopjuar burimet e vjetra (Justini, Pompe Trogu), nuk ka asgjë që do të binte në kundërshtim me këtë. Të përmendurit e dardanëve krahas ilirëve tregon vetëm se emri *ilir*, përveç kuptimit më të gjerë etnik, mori shumë shpejt edhe përmbajtje më të ngushtë politike. Kurse, sipas Herodotit, tek i cili emri *ilir* ka mundur të ketë vetëm kuptimin e tij të përgjithshëm, tokat në veri të Maqedonisë, rreth burimit të Moravës Jugore dhe Iberit, kanë qenë të banuara prej ilirëve. Kjo hollësi provon se tradita antike i ka konsideruar dardanët ilirë.³¹ Kësaj analize të burimeve antike, i bashkohet edhe analiza e gjuhëtarëve në glosa dhe emra të viseve dardane. Sipas gjuhëtarit Seit Mansaku, lidhur me Dardaninë duhet shtuar se një pjesë e emrave të kështjellave të ndërtuara e të rindërtuara nga Justiniani që i përmend Prokopi i Cezaresë në veprën e tij “*De Aedificiis*”, libri IV, për këtë krahinë, nga një anë, nuk shpjegohen me anë të greqishtes e të latinishtes, nga ana tjetër, disa prej tyre ose mund të afrohen me anë të leksikut të shqipes ose ruajnë gjurmë të një tradite ilire. Po sipas tij, shumë prej emrave të këtyre kështjellave dhe të krahinave të tjera të Ilirisë, A. Mayer i ka përfshirë në përmbledhjen e

²⁹Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba - Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 1.

³⁰Në veprën e tij “*Geographica*”, libri VII, kreu 5, Straboni shkruan: “*ἐφ’ ἑκάτερα δ’ αὐτῆς, ἐπὶ μὲν τὰ Θράκῃα ἢ Ροδόπῃ, ὁμορον ὑψηλὸν ὄρος μετὰ τὸν Αἴμον, ἐπὶ δὲ θάτερα πρὸς ἄρκτον τὰ Ἰλλυρικά, ἣ τε τῶν Αὐταριατῶν χῶρα καὶ ἡ Δαρδανίη*” - “Në të dy anët e saj janë, në kufi me Trakinë, Rodopi, mal shumë i lartë pas Hemit, dhe, nga ana tjetër, në veri, viset ilire, d.m.th.: vendi i autariatëve dhe ai i dardanëve”.

³¹Papazoglu, *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba - Fiset e Ballkanit të mesëm në epokën perandorake*, AIH, 69.

emrave ilirë. Është me rëndësi të vihet në dukje se një pjesë e këtyre emrave janë emra kështjellash të rindërtuara dhe jo të ndërtuara sërish. Kjo do të thotë se disa prej tyre mund të mos kenë marrë emër të ri, por kanë trashëguar një emër më të lashtë nga tradita ilire. Këto të dhëna gjuhësore ndihmojnë për të argumentuar mendimin e mbrojtur nga shumë dijetarë, historianë e gjuhëtarë, që Dardania jo vetëm nuk u romanizua, por qe pjesë përbërëse e territorit ku u formua populli shqiptar e gjuha shqipe.³²

Për rëndësinë ushtarake të krahinës dhe për shfrytëzimin e minierave, perandorët ndërtuan një rrjet të mirë rrugësh, ngulitën koloni të shumta, themeluan qytete, si Ulpiana.³³ Ushtarë dardanë ishin dendur në korpuse të tjera: në legjione, në kohorta ndihmëse, mes kalorësish të veçantë e pretorianësh.³⁴ Në enciklopedinë Treccani në zërin “*Dardano*” thuhet mes të tjerash se Dardani - i biri i Zeusit, i pari i fisit të Priamit, sipas Iliadës, nuk na jep një pemë të saktë gjenealogjike, veçse një pjesë të vetme. Ajo pemë gjenealogjike e Dardanit [...] nuk na thotë tjetër veç që ai themeloi Dardaninë, përpara se të ekzistonte Troja. Me fjalë të tjera, Dardani, për Homerin, nuk është veç figurë gjenealogjike dhe është e natyrshme që të jetë kështu, nëse ai është eponimi i dardanëve.³⁵ Dardanët jetonin në një krahinë shumë të pasur e pjellore. I përshkuar nga disa lugina lumenjsh, shteti Dardan përbënte një udhëkryq të rrugëkalimeve të rëndësishme ballkanike që çonin drejt Egjeut, Adriatikut dhe Detit të Zi. Pasuritë natyrore tokësore dhe nëntokësore, si: pyjet, kullotat, fushat pjellore, ari, argjendi, hekuri etj., bënë që ky shtet të njihte zhvillim e lulëzim të madh në shek IV - II p. e. s., të cilin, fillimisht, e lakmoi Maqedonia për të forcuar kufijtë veriorë të saj. Mbretëria e Dardanëve përmendet si fuqi e rëndësishme në brendi të Ballkanit,³⁶ të cilën, sundimtarët e Maqedonisë, pas përpjekjesh të pafrytshme, u përpoqën ta shkatërronin dhe ta shkretonin me anë të bastarnëve, që banonin në krahinën e Danubit.³⁷ Polibi na njofton për

³² Seit Mansaku, “Në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë”, *Studime filologjike* 3 - 4, Tiranë 1982, 106.

³³ Procopius Caesariensis, “De aedificiis”, libri IV, kreu I (ἤν δέ τις ἐν Δαρδάνοις ἐκ παλαιοῦ πόλις, ἥπερ Οὐλπιὰνα φνόμαστο - ka pasur në Dardani, që prej kohëve të lashta, një qytet që quhej Ulpiana).

³⁴ Treccani, “voce Dardano”, *Enciclopedia italiana di scienze, lettere ed arti*, volume XII, Milano 1931, 379.

³⁵ Ibid.

³⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, I, 149.

³⁷ Ibid., 148.

pretimet e mbretit Filip, i cili gjatë kësaj kohe zuri Bylazorën, qytetin më të madh të Paionisë, që ishte kyç për dyndjet që vinin nga Dardania në Maqedoni. Ky pushtim e çliroi pothuaj nga e gjithë frika që kishte nga dardanët.³⁸ Më vonë, përsëri për këto ngjarje, Tit Livi shkruan se (Filipi), mbasi kishte shkretuar zonat pranë kufijve të Ilirisë, me të njëjtën shpejtësi ishte drejtuar në Pelagoni; prej këtej (Pelagonisë), pushtoi qytetin e dardanëve, Sintia, nëpërmjet të cilit dardanët hynin në Maqedoni.³⁹

Dardanët përbënin kërcënim serioz për Maqedoninë dhe zotëronin fuqi të mëdha ushtarake. Ata u futën në koalicionin antimaqedon dhe duke bashkëpunuar me ushtrinë romake për të arritur qëllimet e veta, morën pjesë në luftën e dytë mes Romës dhe Maqedonisë. Dardanët nuk patën ndonjë përfitim nga ndihma që dhanë, gjë që shkaktoi marrëdhënie jo të mira pas luftës. Pikërisht këtë çast shfrytëzuan maqedonët, që i sulmuan dardanët dhe thyen ushtrinë e tyre. Megjithatë, dardanët mbetën gjithmonë kundërshtarë të fortë të sundimtarëve maqedonas dhe nuk e ndërprejnë luftën kundër tyre, duke mos u pajtuar me politikën e Filipit dhe të pasardhësve të tij. Pas pushtimit të Maqedonisë dhe Paionisë, për dardanët u bënë të qarta qëllimet e romakëve për nënshtrimin e plotë të shteteve ilire. Kështu, dardanët ndërmorën veprime të përbashkëta me fqinjët e tyre kundër romakëve dhe për disa dhjetëvjeçarë, e penguan depërtimin romak në viset e tyre, e për më tepër, duke sulmuar edhe provincën romake të Maqedonisë, ata arritën deri në Delf, duke kundërshtuar pa ndërprerë politikën e Romës ndaj tyre. Luftërat e gjata të shtetit ilir dhe maqedon qenë bërë pengesë e fuqishme kundër romakëve. Por, me thyerjen e këtyre dy fuqive, Romës iu hap rruga për të vazhduar shtrirjen e saj edhe më tej në Lindje dhe objekti i synimeve të saj qe Mbretëria Dardane, të cilën, pas shumë përpjekjesh e me shumë legjione, ajo e futi nën varësinë e saj rreth vitit 76 p. e. s.

Emri antik i Kosovës ishte *Dardania*, që si thotë Çabej, për sa i përket burimit dhe kuptimit të këtij emri, sidomos emrat e disa trevave dhe popujve të lashtësisë, shumë herë mbeten të errëta. Megjithatë, po sipas tij, meriton të përmendet në radhë të parë që, së pari, J. G. von Hahn, duke folur për ata emra gjeografikë të vjetër, që dalin si apelativa

³⁸ Polybii, "Historiae", libri V, kreu 97, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, 58.

³⁹ T. Livii, "Ab Urbe condita", libri XXVI, kreu 25 (*Vastatis proximis Illyrici, in Pelagoniam eadem celeritate vertit iter; inde Dardanorum urbem Sintiam, in Macedoniam transitum Dardanis facturam, cepit*).

në shqipen e sotme, e lidhi emrin e *dardanëve* me shq. *dardhë*, duke shënuar në atë mes që në Shqipëri janë të shpeshta emrat e viseve të formuara nga emra drurësh...⁴⁰ Mendimi i Hahnit ka pasur edhe ndjekës të tjerë, të cilët kanë vërtetuar e argumentuar drejtësinë e interpretimit të emrit *Dardan*. Këtyre emrave u bashkohet edhe F. Nopcsa, i cili mendon se emri i fisit ilir të pirustëve përmban përkthimin latinisht të emrit të dardanëve (lat. Pirus - shq. *dardhë*).⁴¹ Në veprën “*De bello Gallico*” (Mbi luftën në Gali), Jul Cezari përmend fisin e pirustëve.⁴²

Sipas studiuesit H. Ceka, Cezari është autori i parë që i përmend pirustët; në vitin 54 p. e. s., si lexohet në kreun e parë të librit të pestë të veprës së sipërpërmendur, Cezari niset me ngut nga Galia, kur merr vesh për sa po ndodhte në Illyricum, të cilin e administronte vetë. Studiuesi ngre pyetjen: cilët ishin dhe ku banonin këta pirustë, të cilëve nuk paskan qenë në gjendje t’u bënëin ballë forcat romake, sigurisht jo të pakta, që ndodheshin në Ilirik, dhe e detyruan Cezarin të largohej vrik nga Galia, ende e pashtuar? Duke pasur parasysh kufizimet e provincës nga të gjitha anët, kërcënimi i rrezikshëm pirust, për të cilin flet Cezari, vinte veçse nga lindja. Si banorë të kësaj pjese të Ilirisë përmenden dardanët, si në burimet e lashta, ashtu edhe në ato të vona historike; këta shquheshin për organizim të fuqishëm ushtarak e shtetëror. Sipas Cekës, pirustët e Cezarit, nuk janë veçse dardanët.⁴³ Në luftën ilirike të vitit 6 - 9 të e. s., pirustët qenë kundërshtarë të ashpër të romakëve, si e pohon edhe Vellej Paterkoli. Për përvojën e tyre në miniera, në fillim të shekullit II të e. s., pjesërisht qenë transferuar nga Trajani në Daki për të punuar në minierat e atjeshme të arit.⁴⁴

⁴⁰ Çabej, *Studime gjuhësore IV* (Nga historia e gjuhës shqipe), Prishtinë 1977, 389. Po këtu, Çabej përmend edhe konstatimin e A. Baldaçit, që kjo trevë është shumë e pasur me pemët e egra *Pirus amygdaliformis*. Më Edith Durham, e cila ka udhëtuar për shumë vjet nëpër Shqipërinë e Veriut, tërheq vëmendjen mbi faktin që, emrat e vendeve me burim nga emra bimësh, janë shumë të shpeshta në trevën shqiptare. Në Shqipëri, Dardhë, si emër visesh, është shumë i shpeshtë dhe i përhapur në të gjitha anët e vendit.

⁴¹ Ibid., 390.

⁴² Julius Caesar, “*De bello Gallico*”, libri V, kreu I (*Ipse conventibus Galliae citerioris peractis in Illyricum proficiscitur, quod a Pirustis finitimam partem provinciae incursionibus vastari audiebat*. - Vetë Cezari, si përfundoi kuvendet në Galinë e këtej Alpeve, niset për Ilirik, ngaqë ishte njoftuar se Pirustët plaçkitnin me çetime pjesën e poshtme të provincës së afërme me ta.)

⁴³ Hasan Ceka, *Në kërkim të historisë ilire*, Tiranë 1998, 192.

⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, I, 166.

Gjeografia, madje edhe gjeologjia, shpjegojnë thelbin përse Kosova pati rëndësi të vazhdueshme historike. Pasuria minerale e Kosovës e kishte bërë këtë territor cak të posaçëm të ushtrive pushtuese që nga koha e romakëve. Mirëpo, nga të gjitha pasuritë minerale të Kosovës, më e rëndësishme gjatë historisë së hershme të saj, ishte begatia e argjendit. Që në kohët pararomake ka pasur miniera, si të argjendit, ashtu edhe të plumbit (dhe, sipas të gjitha gjasave), edhe të një sasive të arit; këto miniera u shfrytëzuan gjerësisht gjatë periudhës romake. Edhe gjeografia shpjegon pse zotërimi i këtij territori ka qenë gjithmonë i rëndësishëm për arsye strategjike. Me gjithë rrethin e vargmaleve, Kosova ka qenë udhëkryq, si i karvanëve tregtarë, ashtu edhe i ushtrive.⁴⁵ Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të të tjerëve, me mundimet e sakrificat e pashoq të fiseve dardane që nga shekujt e errët të lashtësisë deri sot, ndonëse me kufij të rrudhur, ata ruajtën zemrën e truallit të tyre.

⁴⁵ Noel Malcolm, *Kosova: një histori e shkurtër*, Tiranë 2001, 5.

Nermin BASHA

SUMMARY

TESTIMONY REGARDING THE ANTIQUITY OF DARDANIANS

The paper is based on various sources compiled by authors of antiquity who in their texts mention the Dardanians. As the inhabitants of a rich area that extended from the Danube up the northern borders of Macedonia, the Dardanians represented one of the most important Illyrian tribes. Because of its favorable geographic position and the abundance of natural resources, the Dardanian territory was subjected to continuous attacks from the neighboring people, who aimed to gain access on a land that was the crossroads of caravans and armies throughout the centuries. The authors of antiquity describe the Dardanians as skilled fighters who defended their lands with endless determination. Similar to the Ardian tribe who were skilled on the sea, the Dardanians represented the Illyrians on land as a significant power in the heart of the Balkans. Divided into many tribes, they were united under one king, thus becoming an important power during certain periods in history. Under the Roman rule, the Dardanians resisted the process of *romanisation*, but preserved their *ethnos* and individuality, although they were subdued economically and militarily. The existence and activity of the Dardanians, as the other Illyrian tribes in general, in the same territory continuously, has lead to the conclusion that the first of the Albanian people have settled in the territory where modern day Albanians reside, at least since the times of the Greeks and Romans.

Arben ARIFI

NDËRMARRJET E MËDHA TË JUSTINIANIT NË DARDANI DHE SISTEMI FORTIFIKUES

Justiniani ishte një ndër perandorët më të mëdhenj të Perandorisë Bizantine, i cili veçohet si perandor i suksesshëm në organizimin dhe harmonizimin e të gjithë mekanizmave shtetëror, shumë prej të cilëve i krijoi vetë. Por, rrethanat në të cilat veproi ishin ndër më të vështirat: kur po përmysej në njërën anë Perandoria Romake e perëndimit dhe në anën tjetër po formohej një e re, ajo e lindjes, ku padyshim, Justiniani ishte gurë themeltar i kësaj që po krijohej. *Koha e Justinianit* njihet me të drejtë për vepra të tilla si: Kishën e Shën Sofisë (ose Urtësisë së Shenjtë), mozaikun e Ravenës, për kodifikimin dhe renovimin e së drejtës romake, etj. Mbretërimi i Justinianit, nga viti 527 deri 565, përfaqëson kulminacionin e “*shekullit të gjatë të gjashtë*” të antikitetit të vonë romak (ose të hershëm bizantin) të Perandorisë.¹

Ai njihet edhe si kodifikator i madh, ku edhe sot, ligjet e *Corpus Iuris Civilis* shërbejnë si model për ligjet bashkëkohore; pastaj, si perandor i cili me sukses kreu reforma fetare; arriti të mbrojë kufijtë e Perandorisë dhe po ashtu, la vepra të pavdekshme arkitekturale. Për të mbrojtur Perandorinë në rrethana të shek. VI, iu deshtë një punë kolosale dhe një strategji e menduar mirë. Në këtë drejtim, ndërtimet dhe rindërtimet e Justinianit dhe një sistem fortifikimi i paparë deri në atë kohë, ishin bazë e fortë që i mundësonin atij mbrojtjen e Perandorisë pa të cilin vështirë se do ia kishte dalë. Ndërmarrjet e mëdha në Dardani me Justiniana Primen, të cilën e ndërtoi nga fillimi (e ngriti në

¹ Peter N. Bell, *Social Conflict in the Age of Justinian: Its Nature, Management, and Mediation*, Oxford 2013, 4.

seli të krishterimit), pastaj Justiniana Secunden² dhe Justinopolin, së bashku me sistemin e fortifikimit, merren si një ndër hapat më vendimtarë për Dardaninë në antikitetin e vonë. Sulmet barbare nuk filluan në kohën e Justinianit, por ato u shpeshtuan dhe u bënë shumë të fuqishme pas kalimit të ostrogotëve në perëndim (488). Pas sulmit të ostrogotëve e kemi njëfarë pauze përreth dy dekadave kur tanimë vërshojnë sulmet e pareshtura në Perandorinë Bizantine dhe sidomos në vetë Dardaninë në dhjetëvjeçarët e parë të shek. VI, kur në kufijtë veriorë u shfaqën popuj të rinj: bullgarët, avarët, antët, gepidët, e mbi të gjitha sllavët. Këto inkursione u intensifikuan në kohën e sundimit të perandorit Justinian. Që të mbrojnë kufijtë e Perandorisë, atij iu deshtë që të ndërmerre ndërmarrjen më të madhe fortifikuese në mbrojtje të kufijve të Perandorisë.

Sistemi i fortifikimit ishte ndalesa e parë e drejtpërdrejtë e këtyre sulmeve e cila filloi nga *limesi* i Danubit për të ardhur valë-valë duke zbritur në drejtim të Jugut. Luftërat e shumta në Afrikë e në Itali kishin thithur energjinë e nevojshme për mbrojtjen e Ballkanit,³ për shkak të mungesës së kapaciteteve ushtarake. Edhe pse në këtë anë të vijës së fortifikuar mbi Danub ishte ndërtuar një tjetër brez i fuqishëm mbrojtës më i tërhequr, kjo nuk bëri punë. Problemi ishte te kapaciteti i vogël i ushtareve ku edhe fortifikatat më të pathyeshme nuk mund të bënin ballë kur mungonin trupat e nevojshme.⁴ Këtu qëndron edhe arsyeja, përkatësisht domosdoshmëria e ndërtimit të fortifikatave, sepse ato ishin aktualisht i vetmi mjet shpëtimi për të ndaluar sulmet barbare, meqë rrugë tjera nuk kishte. Ushtarakisht ishte e pamundur që t'i përgjigjeshin sulmeve të pareshtura barbare, të cilat numerikisht ishin shumë herë më të mëdha. Territori i gjerë i Bizantit që vështirë administrohej, dhe së fundmi një perandori që kishte trashëguar një emër të madh nga Roma, tashmë ishte bërë pikësynim i të gjithë popujve barbarë, të cilët donin të përfitonin nga rasti. Situatë e tillë e palakmueshme ishte edhe në provincën e Dardanisë.⁵ Ndërtimet e bëra nga vetë Justiniani në territorin e Dardanisë të cilat na i numëron Prokopi nuk janë edhe aq të plota sa i përket territorit të Dardanisë. Një pjesë e tyre, të cilat nuk figurojnë në listat e Prokopit, na janë të njohura përmes rezultateve

² Qyteti antik i Ulpianës pas tërmetit të vitit 518 rindërtohet dhe emërohet për nder të emrit të tij, Justiniana Secunda. Pra, Justiniani përveç Justiniana Primes e rindërtoi edhe Justiniana Secunden si dhe një qytet të tretë Justinopolin.

³ G. Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë 1997, 44.

⁴ Ibid., 44.

⁵ Procopius, *De Aedificiis*, IV, 4.

arkeologjike që na dalin nga terreni. Disa prej tyre mund t'i kenë ikur njoftimit të Prokopit ose mund të kenë qenë te shënuara në burimet tjera që ai nuk i përdori, ndërsa të tjerat mund të kenë qenë ndërtuar pasi vepra *De aedificiis* ishte përfunduar, ose pasi që Prokopi kishte përfunduar së punuari në këtë trakt.⁶ Kështu, nga të dhënat e terrenit në territorin e Dardanisë mund të këtë edhe më shumë nga ato që janë të paraqitura në traktin e tij.⁷

Nga lista e ndërtimeve të Prokopit mund të vërejmë se numri më i madh i kështjellave ishte i koncentruar në Illyricum. Kjo nuk ishte vetëm si reflektim i pozitës strategjike që kishte Iliriku, por ndikoi edhe prejardhja e perandorit pararendës, Justin, si dhe e vetë Justinianit që vinin nga territori i Dardanisë. Gjithnjë, sipas Prokopit një politikë ushtarake e bërë nga ai (Justiniani), konstruktimi dhe restaurimi i rreth 460 fortifikatave në *Illyricum* për të kompensuar rrjetin e dobësuar të fortifikimit, Justiniani na përkujton se ai po vijonte përpjekjet e Anastasit dhe Justin. ⁸ Justiniani jo vetëm që e kishte koncentruar numrin më të madh të fortifikatave në territoret ilire, por në radhët dhe në krye të ushtrisë së tij, po ashtu kishte edhe shumë gjeneralë ilirë. Në lidhje me vendlindjen e perandorit, autori antik Agathia, duke folur për hunët *kutrigur* në vitin 559 dhe për mbrojtjen e Hersones, të cilën e kishte organizuar Germani, i biri Doroteut, gjeneral i shkëlqyer i Justinianit ndër të tjera thotë: “atdheu i tij ka qenë qyteti ilir, i cili që prej kohërash është quajtur Bederiana e më vonë emri iu ndërrua në Justiniana Prima, për të cilin thonë se ka qenë vend i panjohur të cilin e ka zbuluar me ndërtesa madhështore”.⁹ Edhe për Justinin, ungjin e Justinianit thuhej se vinte nga Dardania. Gjoni i Antiokisë thotë që vendlindja e perandorit Justin gjendej në afërsi të qytetit ilir të Nishit:

⁶ Glanville Downey, “Justinian as a Builder”, *The Art Bulletin*, Vol. 32, No. 4 (Dec., 1950), 262-266. Për më shumë për veprën *De aedificiis*, dhe datat kur Prokopi ishte duke punuar në këtë trakt shih: G. Downey, *The Composition of Procopius, “De aedificiis”*, Transactions of the American Philological Association, LXXVIII, Philadelphia, 1947, 171-183.

⁷ Nga hulumtimet që ka kryer autori i këtij studimi gjatë punimit të temës së masterit si dhe gjatë përgatitjes së studimeve të doktoraturës, ka hasur në një numër të madh të fortifikatave vetëm në territorin e Kosovë, pa llogaritur ato jashtë territorit të saj të cilat e kalojnë shifrën e Prokopit.

⁸ Gilbert Dagron, “Les Villes dans L’Illyricum Protobyzantin”, *Actes du colloque organisé par l’École française de Rome* (Rome, 12-14 mai 1982), 1984, 6.

⁹ Zef Mirdita, *Studime Dardane*, Prishtinë, 1979, 133; Agathia, His. V, 21, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë 2002, 458.

“...*Justini nga Bederiana kashteli i cili i afrohet Nishit ilir*”.¹⁰ Përveç sulmeve barbare sllave, Dardaninë e goditi një fatkeqësi e madhe - tërmeti. Pra, Justinianit iu desh që të përballej edhe me katastrofa natyrore. Në vitin 518 e goditen një varg tërmetesh të fuqishme, të cilat i rrënuan dhe i zhdukën shumë vendbanime. Këtë na e përshkruan hollësisht *Marcelinus Comes (Marcelin Komesi)*, i cili thotë se: “*për një moment në Dardani janë zhdukur 24 kështjella. Dy nga këto i gëlltiti dheu me të gjithë banorët e tyre: 4 prej tyre u shkatërruan dhe e humben gjysmën e shtëpive dhe të banorëve. Kështu ndodhi edhe me të tjerat. Shumë qytete dhe kështjella u lanë shkretë për shkak të frikës së madhe. U rrënuan krejtësisht edhe kryeqyteti Scupi, edhe pse banorët shpëtuan, sepse ishin larguar nga qyteti duke ikur nga armiku. Krejt krahina pësoi rëndë. Në një gjatësi prej 30 miljeve dheu kishte pëlcitur dhe ishte krijuar një plasaritje e gjerë 12 hapa, në të cilën ranë shumë banorë të frikësuar, nga frika e armikut i cili i ndiqte vazhdimisht. Ndërsa, në afërsi të qytetit Sarnonta, nga dheu shpërtheu uji i nxehtë, i cili rridhte pandërprere...*”.¹¹

Tërmeti i shkallës kaq të lartë duhet të këtë goditur tërë territorin e Dardanisë, në anën tjetër përmenden 24 kështjella të shkatërruara nga tërmeti që po ashtu nuk mund të kenë qenë në një rajon të ngushtë. Autori na bënë me dije se krejt krahina pësoi dëme. Nuk mund të thuhet se çfarë ka nënkuptuar me nocionin krahinë, por duhet ta ketë përfshi Dardaninë në tërësi. Mirëpo jeta vazhdon edhe pas kësaj katastrofe natyrore, dhe perandori Justinian ishte ai i cili ripërtëriu jetën edhe në vendlindjen e vet. Kështu, ai përveç ndërmarrjeve ushtarake dhe civile bëri atë që ishte maksimumi i tij të bënte për vendlindjen e tij Dardaninë. Por, situata ishte shumë komplekse sepse të dy polet¹² e tërhiqnin në sferën e interesit të vetë Ilirikun, respektivisht Dardaninë. Kjo gjendje ishte e pranishme edhe para ardhjes në pushtet të Justinianit të Madh. Si shembull mund ta marrim skizmën e Akacit e cila shpërtheu

¹⁰ Mirdita, *Studime Dardane*, 133.

¹¹ D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, vol. VIII, Venetis 1819; Jacques-Paul Migne, *Patrologiae cursus completus: sive bibliotheca universalis, integra uniformis, commoda, oeconomica, omnium SS. Patrum, doctorum scriptorumque ecclesiasticorum qui ab aevo apostolico ad usque Innocentii III tempora floruerunt ...* [Series Latina, in qua prodeunt Patres, doctores scriptoresque Ecclesiae Latinae, a Tertulliano ad Innocentium III], Volume 51, 1986, 925.

¹² Me krijimin e dy qendrave të Perandorisë: Romës dhe Kostandinopojës filloi edhe rivaliteti në mes tyre, kështu të dyja qendrat synonin që ta fusnin nën ndikimin e vetë sidomos provincën e Ilirikut.

rreth Akaciusit të Kostandinopojës, e që zgjati tridhjetepesë vjet (484 - 519), e cila solli probleme të reja. Vikarët Apostolik të Selanikut sërish morën anën e peshkopëve të kryeqytetit, edhe pse ato nuk zbatoheshin gjithmonë nga sufraganet e tyre. Një sjellje e tillë i bëri ata të humbasin titullin e tyre dhe kompetencat e tyre të veçanta. Megjithatë, patriarku bizantin duket se ka ushtruar juridiksion efektiv mbi krahinat e Ilirisë Lindore. Bashkimi me Romën u bë e modës nga ndërprerja e skizmës akaciane (519). Papët ruanin autoritetin e tyre të plotë mbi rajonin, dhe nuk i kthenin menjëherë titujt e tyre të privilegjeve të peshkopit të Selanikut. Në vitin 519, titullari Dorotheu, kishte bërë kompromis në trazirat gjatë të cilave u rrahën legatët papal dhe ai erdhi për të festuar pajtimin.¹³

Justiniana Prima u ngrit në një qendër të re administrative. Kjo veçanërisht u bë për të bartur selinë e prefekturës nga Thesaloniku (Selaniku). Për këtë qëllim, më 14 prill 535 Justiniani e shpalli Novelen XI, e cila konsiderohej si statut i institucionit, pasi me këtë themelohej ekzarkati, përkatësisht vikariati për këtë pjesë të Perandorisë. Nën ekzarkatin e ri do të jenë këto provinca: Dacia Mediteranea, Dacia Ripensis, Mesia e Parë, Dardania, Prevaliatana, Maqedonia e Dytë dhe një pjesë e Panonisë së Dytë, e cila ishte në krahinën e qytetit Baciensi.¹⁴ Kjo Novelë shpallë themelimin e një arqipeshkvie në qytetin e sapokrijuar të Justiniana Primes, dhe i referohet lëvizjes së prefekturës ilire nga Selaniku në këtë qytet, me sa duket në fillim të vitit 530.¹⁵ Me këtë akt, ai i dha ingerenca kishtare Justiniana Primes dhe e promovoi atë jo vetëm si Ipeshkvi të thjeshtë, por si qendër metropolitane, me autoritet të plotë mbi ipeshkvijtë sufragane në pavarësi ndaj Selanikut. Për ta pranuar këtë risi në hierarkinë kishtare, Justiniani nuk iu adresua Kostandinopojës, por Romës. Marrëveshja, megjithatë, nuk u bë menjëherë, por dhjetë vite më vonë edhe pse papa Agapetus kishte ardhur në kryeqytetin bizantin menjëherë pas miratimit të ligjit. Bisedimet kulmuan më në fund me papën Vigilius, më 18 mars të vitit 545. Titullari i Justiniana Prima duhet të jetë përfaqësues i Selisë Apostolike të Romës në zonën e tij, siç ishte ajo e Selanikut në Novela XI dhe CXXXI.¹⁶ Me fjalë tjera, del se Justiniana Prima i mori nën

¹³ R. Janin, "Constantinople, Anexion d'Illyricum", *Dictionnaire d'histoire et de géographie ecclésiastiques* vol.13, Paris 1956, 648-650.

¹⁴ G. Gjini, *Ipeshkia Shkup - Prizren nëpër shekuj*, Drita Ferizaj 1992, 44.

¹⁵ "De privilegiis Archiepiscopi Primae Iustinianae", *Corpus Iuris Civilis: Novellae*, ed. and trans. R. Schoell and G. Kroll, Berlin, 1954, 94.

¹⁶ Janin, "Constantinople, Anexion d'Illyricum", 648-650; Gjini, *Ipeshkia*, 44-45.

kujdesin e vetë provincat të cilat sot i përgjigjen territorit të Serbisë së ngushtë, të Sremit Lindor, të Bullgarisë Perëndimore, të Maqedonisë Veriore, të Kosovës dhe të Malit të Zi.¹⁷

Sipas perandorit, provinca e re kishtare do të ketë karakter të provincës së pavarur, sepse ai dëshironte që t'ia rriste edhe më shumë autoritetin dhe nderin vendlindjes së tij.¹⁸ Ipeshkvi i Justinianes së Parë e mbante titullin e mitropolitit, pra të instancës më të lartë kishtare, pasi që autoritetit të tij do t'i nënshtrohen disa krahina. Argjipeshkvit të ri do t'i përkas *“Summus honor, summa dignitas, summus sacerdotium, summum fastigium”*. Tani e tutje, as ai e as ipeshkvijtë, të cilët i nënshtrohen atij, për asnjë gjë nuk do të varen nga ipeshkvi i Thesalonikut (Selanikut).¹⁹ Kështu, Justiniana Prima bëhet metropol, jo vetëm një argjipeshkvi që futet në rangun e tretë (pas Romes dhe Konstantinopolit), por edhe të tërë Ilirisë, njëra ndër tri dioqezat apo prefekturat perandorake, për të cilat Justiniani flet edhe në Kodin e tij.²⁰ Si duket, Justiniani përveç arsyeve të tjera të shumta, ka bërë dy vija mbrojtëse fortifikuese, njërën në luginën e lumit Danub dhe Sava në veri për të ndalur hovin e sulmeve barbare me disa valëzime dhe vijën e dytë në territorin e Dardanisë edhe për të mbrojtur selinë e kishës që e kishte vendosur në qytetin e tij të emëruar sipas emrit të tij, të cilën e ngriti në rang të mitropolisë dhe argjipeshkvisë, e cila i merr të gjitha ingerencat e Ipeshkvisë së Shkupit *“...multis et varis modis nostram patriam augere... ut Prima Justinianae nostram patriam”*.²¹

Pra, në kuadrin e ndërtimeve dhe rindërtimeve të mëdha që i bënë Justiniani sipas njoftimeve që na jep Prokopi, një ndër arsyet duhet të jetë edhe mbrojtja e selisë së Ipeshkvisë pasi që tanimë me mbrojtjen e kësaj qendre mbrohet edhe nderi i vetë perandorit, sepse për mos gjë tjetër ky qytet e barte emrin e perandorit. Fortifikimet në Dardani shtriheshin në qendrat e mëdha të banimit dhe nëpër zonat tjera përreth, pranë rrugëve të komunikacionit, në luginat e lumenjve pranë kanjoneve, grykave, si dhe në brendësi të vendit në zonat e thella malore në kushte të përshtatshme ku vetë pozita natyrore ofronte mbrojtje natyrale. Këtë argument mund ta forcojnë dëshmitë se gati në çdo kala,

¹⁷ Gjini, *Ipeshkvia*, 44.

¹⁸ Lj., Maksimovic, “L’Illyricum Septentrional au VI siècle”, *Zbornik Radova Vizantoloskog Instituta*, XIX, Beograd 1980, 56

¹⁹ Gjini, *Ipeshkvia*, 45.

²⁰ *Anekdotia ou Histoire Secrète de Justinien*, M. Isambert, Paris 1856, 618.

²¹ *Codex Justinianus*, éd. P.Krueger, Corpus Iuris Civilis, Novellae XI, t.II, Berlin 1914, CXXXI, c.3.

në muret fortifikuese kemi përdorimin e ledheve natyrore duke bërë plotësime me mure gurësh. Arsyeja se pse janë përdorur ledhet natyrale është edhe nevoja imediate e ndërtimit të kalave, pra koha e shkurtë e ndërtimit që lidhet edhe me vetë madhësinë e kalave, ku në të gjitha rastet kalatë janë relativisht të vogla. Në shumicën e rasteve kalatë janë të koncentruara në afërsi të rrugëve aq sa ua lejonte pozita, nga ku kontrolloheshin rrugët si dhe karvanët tregtarë. Me një fjalë, kalatë që ishin buzë rrugëve ishin më shumë si pika doganore.

Një rendësi të veçantë mori në këtë periudhë ruajtja dhe mbikëqyrja e rrugëve të rëndësishme tradicionale të komunikacionit dhe të pikave strategjike të trasesë së njohur Lissus - Naissus, e cila shfrytëzonte luginën e lumit Drin për të depërtuar në hapësirën e Dardanisë dhe nëpërmjet luginës së Koçanices dhe Toplicës arrinte deri në luginën e Moravës dhe Vardarit. Kjo rrugë kanalizonte jo vetëm qarkullimin e bregdetit nga Lisi dhe Shkodra, por edhe atë nga Tivari në Durrës.²² Ky aks rrugor lidhte edhe Adriatikun me brendësinë e kontinentit. Këtu lidheshin edhe itineraret e Bosnjës dhe rrugët tjera që kalonin drejt jugut në drejtim të Egjeut. Këtu rendësi kanë edhe arteriet ndihmese të rrugëve Egnatia dhe Lissus - Naissus që përbënin një rrjet të dendur rrugor. Në të njëjtën kohë vërejmë se veprimtaria fortifikuese u shtri edhe në akset rrugore të dorës së dytë. Në këto raste nuk kemi të bëjmë me ngritjen e kështjellave të mëdha, por me rrethime të thjeshta që zotëronin pikat mbizotëruese të luginave dhe komunikonin mjaft mirë njëra me tjetrën.²³ Dendësia e këtyre fortifikimeve me një sipërfaqe relativisht të reduktuar është si pasojë e organizimit ushtarak. Ai pasqyron prezencën e një sistemi mbrojtës të programuar dhe mjaft efikas, i cili vërehet edhe në rajone tjera me rendësi strategjike. Me fillimin e trazirave historike në Ballkan e më gjerë, të njohura si dyndje barbare apo më vonë ato sllave, fortifikimet ndërtohen në terrene të ngritura malore, me një mbrojtje të konsiderueshme natyrore. Kjo bëhej për shkak se në terrene të rrafshëta as nuk kishin kohë e as kapacitete njerëzore për t'u mbrojtur. Rinovimet e mëvonshme Justiniane bëheshin më tepër për një qëndrueshmëri në situata ushtarake, sesa për ta restauruar një prosperitet ekonomik.²⁴ Kalatë janë ndërtuar sipas

²² L. Perzhita, G. Hoxha, *Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimorë*, Tiranë 2003, 121.

²³ Ibid., 121.

²⁴ "Ville et peuplement dans l'Illyricum protobyzantin", Gilbert Dagron, *Les Villes dans L'Illyricum Protobyzantin (Pannonie, Mésie I, Dacie et Dardanie)*, Actes du Colloque organisé par l'Ecole Française de Rome, 12 – 14 mai 1982), 286.

skemave të ndryshme që i përgjigjen nevojave mbrojtëse dhe formave topografike të terrenit. Për ndërtimin e kështjellave si duket janë marrë parasysh këshillat e teoricienit bizantin anonim të shek. VI, i cili tregon rregullat fikse kryesore për ndërtimin e një kështjelle, e që duhet të jenë: një lartësi me pjerrtësi shumë të madhe, eventualisht e mbrojtur nga një lum, me planimetri konform terrenit si dhe me komunikim direkt me kalatë tjera. Pra, të gjitha kalatë në përpikëri ju kanë përmbajtur këtyre rregullave.²⁵ Një element tjetër determinues për përcaktimin e vendit të ndërtimit të kalave nëpër kodra është edhe prania e minierave, ku në të shumtën e rasteve kalatë ose janë shumë afër minierave ose në largësi të afërt. Përveç kësaj shikoheshin edhe burimet e ujit dhe të materialit për ndërtim.

Lidhur me ndërtimet, Justiniani ndërmori tri lloje ndërhyrjesh themelore:

- 1) Qytetet tradicionale *poleis*, të cilat ruanin ose fituan një status të posaçëm, të cilat Justiniani i krijoi, i përtëriu ose i zhvendosi si: Ulpiana në Justiniana Sekunda. Formoi qytetin Justiniana Prima. Adrianopolisi i Epirit u ripagëzua në Justinianopolis etj. Këtu ishin të vendosura selitë kryesore të administratës, kishës, ushtrisë, punishtet etj.
- 2) *Poliacnion*, qytetet me rëndësi dytësore, qyteza ndërmjetëse. Qytete me rëndësi dytësore me fuqi mesatare të dobët mbrojtëse dhe me garnizone ushtarake.
- 3) Fshatrat e fortifikuara, të cilat përgjithësisht mbesin fshatra, ato janë quajtur *frouria* për arsye të mureve dhe muraleve që i mbronin ato. Zhvillimi arkitektonik ato i transformon nga një kullë e thjeshtë mbrojtëse me një kullë në një bark ose bashkësi të katër kullave të këndit. Sikurse në Taurision, *tertapyrigia* me një popullatë të përhershme brenda fortifikatave.²⁶
- 4) Termi *frourio* mund të ketë lidhje edhe me veprat defanzive të destinuara për të shërbyer si strehimore për një popullatë rurale të shkapërderdhur, duke shërbyer si roje fshatare dhe që janë pajisur me një garnizon të rregullt të cilat janë shndërruar në kështjella me popullatë ushtarake sipas traditës së vjetër romake.²⁷

²⁵ L. Perzhita, G. Hoxha, *Fortifikime*, 121

²⁶ Për herë të parë kemi rastin e Tauresiumit me fortikatë me 4 kulla *tetrapyrgia* e më pas ato i vërejmë edhe në vende tjera, si në Kalanë e Radacit në Pejë etj.

²⁷ "Ville et peuplement dans l'Illyricum protobyzantin", 8.

Te qytetet tradicionale të tipit *Poleis* ndryshon edhe tipologjia, sepse tani i vërejmë tentativat me tipare dalluese në arkitekturën e hershme bizantine me disa ndryshime të vogla nga ajo romake e perëndimit. Edhe gjatë periudhës së hershme bizantine, stili arkitekturor perandorak vazhdon të përdoret në rajon, siç shihet në fillim të shekullit të VI, fortifikimet e Justiniana Primes dalloheshin me ekspozimin e karakteristikave të *ideosinkretitetit* rajonal, arkitektura zyrtare këtu pasqyron praktikat standarde të ndërtimit të perandorisë lindore romake.²⁸ Në grupin e dytë qytetet me rëndësi dytësore, qyteza ndërmjetëse janë ato qytete ku më parë kanë qenë municipiume, si p.sh. Municipium D. D, Municipiumi i Dersnikut ku afër tyre kanë pasur fortifikata, si p.sh. Municipiumi i Dersnikut i kishte dy fortifikata shumë afër, si Kalanë e Pogradjes në Klinë dhe fortifikatën e Dollcit.

Në grupin e III në Dardani futen kalatë më të mëdha, siç janë: Kalaja e Pogradjes, e Harilaqit, Kastercit, Vuçakut, Vrellës, Miradisë së Ulët, Novosellës së Madhe, Grabocit etj.²⁹ Shpeshherë në to kemi edhe kisha brenda strukturës murale të cilat kanë mundur ta strehojnë një numër të konsiderueshëm të popullatës. Në grupin e fundit, futën fortifikatat më të vogla, siç janë: Dollci, Lubavec, Kopiliq i Ulët dhe i Epërm, Qubrel, Çikatovë e Vjetër, Poklek i Vjetër, Fushticë e Epërme, Bajskë, Novalan i Epërm, Shtitaricë, Shalcë etj. Këto fortifikata në raste të luftës e kanë marrë rolin mbrojtës dhe janë shndërruar në qendra të rezistencës. Kryesisht na paraqiten si kështjella malore të ngritura në vende të mbrojtura mirë në mënyrë natyrore. Kështu, ndërtimet sipas Prokopit nisen me gjeografinë administrative të zakonshme një rrugëtim më të komplikuar nga Dardania duke kaluar në Daki kontinentale, Epir dhe Greqi meridionale për t'u ngjitur në Thesali dhe Maqedoni deri tek *Limesat* danubiane.³⁰ *Frouriat* për të cilat Prokopi paksa e drejton listën janë shpërndarë së pari sipas provincave pastaj lidhen drejtpërdrejt me qendrat urbane të rëndësishme. Kështu qendrat e marrin formën përfundimtare të një organizimi territorial.³¹ Me një fjalë shoqëria ishte e organizuar mbi bazën e trinomit armata, fshatarësia dhe kisha nëpër

²⁸ Michael R. Werner, "The imperial style in late roman architecture in the Balkans" (The Eighty-Fourth General Meeting of the Archaeological Institute of America), *American Journal of Archaeology*, Vol. 87, No. 2 (New York 1983), 268.

²⁹ *Harta Arkeologjike e Kosovës II*, Prishtinë: Instituti Arkeologjik i Kosovës 2012, 28.

³⁰ V. Besevliev, *Zur Bedeutung der Kastellnamen in Prokops Werk De Aedificies*, Amsterdam 1970, 63-69.

³¹ "Ville et peuplement dans l'Illyricum protobyzantin", 9.

këto grupime në të cilat Justiniani kishte kontroll të plotë. Kjo gjë bëri të mundur që të grumbulloi edhe shuma kolosale për realizimin e ndërmarrjeve të tij shumë të kushtueshme të cilat do të ndalin hovin e zhvillimit të Bizantit më vonë. Dhe me të drejtë, të gjithë jetëshkruesit dhe historianët e periudhës së sundimit të Justinianit pajtohen që së bashku me “luftërat”, “ligjvëniet” dhe “ndërtimet”, përbëjnë trekëndëshin e sukseseve më të spikatura të tij.³²

Me këto, Justiniani hyri në histori si një ndër perandorët më të mëdhenj që njeh historia. Në lidhje me këtë, po përmbyll me një mendim të Ostrogorskit se me këto veprime, politika e Justinianit i imponoi popullatës taksa gjithnjë e më të larta të cilat erdhën duke u shtuar për shkak të ndërmarrjeve të mëdha ushtarake dhe të shpenzimeve për ndërtimin e monumenteve të kërkuara nga perandori. Çmimi i pushtimeve të Justinianit ishte shterimi i plotë financiar i të gjithë vendit.³³ Justiniani nuk arriti ta rinovojë Perandorinë: mundi vetëm për pakë kohë t'i shtrijë kufijtë e saj, pa qenë në gjendje të kryejë rigjenerimin e brendshëm të shtetit të vjetër romak. Restaurimit territorial i mungonin bazat e shëndosha e pikërisht për këtë arsye rrjedhojat e dështimit të papritur të restaurimit të Justinianit qenë dy herë katastrofike. Pas gjithë atyre sukseseve madhështore Justiniani i la pasardhësve të vetë një perandori krejt të shterur me ekonomi dhe financa të rrënuara.³⁴ Si përfundim mund të shtojmë se Justiniani nga të gjithë perandorët romakë më origjinë dardane ndihmoi më së shumti Dardaninë, por rrjedhat historike bënë që pas tij Bizanti të këtë rënie nga sulmet e pareshtura barbare të cilat e shkatërruan në masë të madhe atë dhe e cila nuk mundi të rimëkëmbej për një kohë të gjatë. Edhe vendosja përfundimtare e sllaveve në Dardani në shek VIII bëri që ajo të këtë ngecje të mëdha. Sot rrjeti i fortifikimit të Justinianit në Dardani është parë në disa kala, si në: Harilaq, Kalanë e Pogragjes, Vrellë, Banjicë, Trubohoc, Dragolec, Izbicë, Miradi e Ulët, Lipjan, Reçak etj. Pjesa tjetër pret gjeneratat e reja për të bërë kërkime dhe gjurmime për të nxjerr në sipërfaqe strukturën dhe përbërjen e tij pasi që i tëri gjendet i mbuluar në nëntokë. Kurse sa i përket qyteteve që i ndërtoi Justiniani, si Justiniana Prima (disa studiues e lokalizojnë me Caricin Gradin), Justiniana Secunda tanimë është mirë e dëshmuar që identifikohet me Ulpianën, por Justinopoli ende nuk është zbuluar. Me një fjalë mund të

³² Qazim Lleshi, *Perandorët dhe Dinjitarët Ilirë II (518-578)*, Tiranë 1999, 85.

³³ Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, 44.

³⁴ Ibid., 48.

themi që ndërmarrja më e madhe e Justinianit në Dardani ishte krijimi i dy epiqendrave Justiniana Prima dhe Justiniana Secunda i shoqëruar me rrjetin e sistemit të fortifikimit në Dardani në vendlindjen e tij.

Arben ARIFI

SUMMARY

JUSTINIAN'S GRAND UNDERTAKINGS IN DARDANIA AND THE FORTIFICATION SYSTEM

Emperor Justinian is considered the greatest Byzantine Emperor. He was born in Dardania, Tauresium, which was a city close to Bederiana as we are informed by the most renowned chronologist of the time, Procopius. The latter served in the Royal Court of Justinian, and is the most trusted source in regards to Dardania. Thanks to his sources pertaining to the late antiquity and early medieval times, we are capable to reconstruct the history of ancient Dardania.

Procopius informs us regarding the construction of a new city named Justiniana Prima, which became a center for Christianity, and thereafter the construction of another city named Justiniana Secunda which was identified as an ancient settlement in the vicinity of the city of Ulpiana. We are also informed on the existence of another city named Justinopol, the whereabouts of which remain unidentified. We are also informed about the fortification system in Dardania which together with the 3 cities is considered one of the grandest undertakings of Justinian in his birthplace, ancient Dardania. Procopius informs us that only in Dardania Justinian had rebuilt 61 castles as well as constructed 8 new ones, and that he invested in construction in Dardania because it was his birthplace.

Teuta SHALA - PELI

**TË DHËNA PËR ROLIN DHE POZITËN E GRUAS NË DRISHT
DHE SHKODËR GJATË MESJETËS**

Për rolin dhe rëndësinë e gruas në shoqërinë mesjetare informacionet na ofrojnë një sërë dokumentesh që iu referohen ngjarjeve dhe problemeve qoftë politike, ekonomike, kulturore e më gjerë, nga periudha në fjalë. Krahas të dhënave dokumentare për pozitën dhe rolin e gruas në shoqërinë mesjetare të dhëna më rëndësi na ofrojnë edhe statutet, përkatësisht ai i Drishtit dhe i Shkodrës. Përveç rolit dhe rëndësisë së gruas në shumë çështje politike dhe ekonomike, për më tepër nga dokumentet e kohës vërejmë se gjatë mesjetës femrat kishin të drejtë edhe në hartimin e testamenteve, të merrnin pjesë në trashëgimi, si dhe t'ju linin të tjerëve pjesë nga pasuria e tyre. Për ta elaboruar këtë problem në bazë të burimeve dhe literaturës që disponojmë për pozitën e gruas në Drisht dhe Shkodër gjatë mesjetës, e kemi ndarë në tri grupe. Në grupin e parë do të prezantojmë kontributin e saj në çështjet politike dhe ekonomike, në grupin e dytë do të përfshihet e drejta e saj në trashëgimi dhe çështje të tjera që i referohen këtij problemi, dhe në grupin e tretë do të vëmë në dukje se sa hapësirë iu është dhënë përfshirjes së femrës në statutet e Shkodrës dhe të Drishtit.

Roli politik dhe ekonomik

Një numër i konsiderueshëm dokumentesh që iu referohen çështjeve të ndryshme që karakterizuan qytetin e Drishtit dhe të Shkodrës gjatë mesjetës flasin për rolin dhe rëndësinë e gruas në shumë çështje politike dhe ekonomike, siç e kemi rastin me Helena Balshën, ku

shumë dokumente të karakterit ekonomik dhe politik që iu referohen problemeve të qytetit të Drishtit dhe Shkodrës i drejtoheshin drejtpërdrejt asaj. Roli politik i Helena Balshës doli në pah sidomos në kohën kur Principata e Balshajve drejtohej nga djali i saj Balsha III, i cili po bënte përpjekje për çlirimin e Drishtit, Shkodrës e viseve tjera nga sundimi venedikas. Gjatë asaj kohe shumica e dokumenteve të ardhura nga Venediku apo Ragusa i drejtoheshin Helena Balshës, duke dëshmuar rolin, rëndësinë dhe ndikimin e saj në shumë procese politike të rëndësishme të asaj kohe.

Është më rëndësi që të vëmë në dukje se duke u mbështetur në dokumentet të cilat iu referohen ngjarjeve të viteve 1400 - 1410, vihet në pah roli i Helena Balshës në çështjet e përmendura më lartë, të cilat do t'i paraqesim në vazhdim. Nga dokumentet që i disponojmë, del se Helenës i drejtoheshin jo vetëm për çështje të karakterit politik, por edhe ekonomik. Kësisoj në qershor të vitit 1404, senati i Venedikut u jep përgjigjeje gjashtë kapitujve të paraqitur në senatin e Venedikut nga ambasadorët e Helenës, ku ndër të tjera thuhet: “... i lejohet Helenës që nga viset tona të Shkodrës, dhe të anëve të atyshme, veç kripës që i jepet asaj nga rektorët tanë të vendeve të thëna për përdorim të saj, d.m.th. 100 mode për Ulqinin dhe po aq për Tivarin, të mund të ketë e të marrë prej viseve të lartpërmendura dy barka me kripë, që të zënë 250 mode secila prej tyre, ne po përgjigjemi, dhe po kështu do t'u japim urdhër rektorëve tanë të atyshëm që, sipas zakoni të vjetër, për çështjen e kripës së sipërthënë, d.m.th për ato dy barkat, sipas kërkesës së saj, rektorët në falë duhet të veprojnë po në këtë mënyrë...”¹

Në fillim të vitit 1405, me sa del nga dokument që flasin për ngjarjet e atij viti, raportet në mes të Balshajve dhe Venedikut fillojnë që të ashpërsohen. Me sa duket Balshajt kishin kërkuar ndihmë nga Ragusa, por Bashkia e Raguzës i shmanget plotësimi të kërkesave të Balshajve, në mënyrë që të mos armiqësohet me Venedikun. Në një dokument i cili mban datën 11 janar 1405, thuhet se: “...Bashkia e Raguzës i shkruan zonjës Helenë dhe zotit Balshë se e ka marrë letrën e tyre të dërguar me anën e shërbëtorit Dhimitër, “Ato që kërkon aty (në atë letër) zotërimi juaj si gjëra të nevojshme për ju, i lutemi që të mos e kërkojë prej nesh, sepse zotërimi juaj e di se ne jemi shërbëtorët dhe miqtë tuaj si dhe miq të zotërimit venedikas...”² Ndërsa, dokumenti

¹ Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, vëllimi I, përgatitur nga Injac Zamputi, Luan Malltezi, Tiranë, 1987, dok. 444.

² Ibid., dok. 484.

tjetër i cili mban datën 12 janar 1405, flet për masat që ndërmerr Venediku për të ripushtuar Shkodrën. Në mesin e masave që Venediku i sheh si të domosdoshme për ripushtimin e Shkodrës, merr vendim që të caktohen dy përfaqësues për t'u dërguar te Helena Strazimiri.³ Po ashtu edhe një dokument i vitit 1405, i referohet Helenës, fjala është për dokumentin e 7 majit 1405, me anë të të cilit senati i Venedikut urdhëron kapedanin e Gjirit që të shkojë me flotën në Lezhë apo gjetkë për të marrë vesh si shkojnë punët me Helena Strazimirin për çështjen e Shkodrës dhe të Drishtit. Ndër të tjera në atë dokument thuhet: “... nëse nuk arrihet një marrëveshje me Helena Strazimirin, ai kapedani i Gjirit urdhërohet që të kalojë në Ulqin, Tivar dhe Budue, vende që janë të Helena Strazimirit, dhe secilit prej këtyre vendeve duhet t'i shkaktoni, dhe të urdhëroni t'i shkaktohet, çdo dëm e çdo dhunë që do të keni mundësi...”, më tej vazhdon dokumenti, “...dhe në rast se nuk mund t'i pushtoni, duhet që atyre, po ashtu edhe cilësdo anije e cilitdo shtetas të zonjës në fjalë e djalit të saj, t'i shkaktoni e të urdhëroni t'u shkaktohet çdo dëm që do të kemi mundësi, si vende e shtetas të armiqve tanë, në mënyrë që ajo zonjë të jetë e detyruar të na i kthejë vendet tona të lartpërmendura...”.⁴

Me interes është edhe një dokument tjetër i cili po ashtu mban datën 7 maj 1405, që i drejtohet Helena Balshës, për zgjidhjen e konfliktit me Republikën e Venedikut. Fjala është për një propozim i cili bëhet në senatin e Venedikut për zgjidhjen e konfliktit me Helena Balshën e të birin, por me sa duket propozimi nuk pranohet në senatin e Venedikut. Në dokumentin në fjalë propozohet që ambasadorët venedikas të bëjnë një sërë premtimesh për rregullimin e çështjes dhe nëse nuk ia dalin, t'i dorëzohet Helenës fortesa e Shkodrës me disa kushte për shpenzimet e bëra, për dëmshpërblimin e tregtarëve venedikas dhe t'u sigurohet tregu i drithit venedikasve.⁵

³ Ibid., dok. 485.

⁴ Ibid., dok. 518.

⁵ Ibid., dok. 524: “Po ju japim urdhër që edhe një herë duhet paraqiteni në praninë e zonjës Helena Strazimiri dhe birit të saj, dhe t'u parashtoni që, pasi kemi lexuar letrat tuaja të sipërthëna, me të cilat na keni shkruar se si madhëria e saj nuk pranon të na i kthejë vendet tona të Shkodrës e të Drishtit, meqë pohon se i ka marrë si gjë të veten. Po ashtu vazhdon dokumenti, nëse na premtim zonja në fjalë dhe biri i saj që, në çdo kohë, do t'i lejojnë qytetarët dhe tregtarët tanë të shkojnë, të qëndrojnë, të tregtojnë në ato viset dhe vendet e thëna të saj, dhe të largohen që andej shëndosh e të sigurt, me mallrat e pasuritë e veta, dhe të blejnë në qytetet, vendet e territoret e saj drithëra, sido që të gjenden aty, dhe ti nxjerrin ato nga territoret e saj dhe t'i shpien në Venedik pa asnjë kundërshtim, dhe që asnjë njeri tjetër, cili do qoftë, të mos mund

Me sa mund të kuptojmë nga dokumentet që i referohen ngjarjeve të vitit 1405, vërejmë se Venediku dhe Balshajt ishin vazhdimisht në konflikt në mes vete. Gjatë atij viti në senatin e Venedikut bëhen propozime dhe udhëzime për të zgjidhur këtë konflikt, në të gjitha ato raste Republika e Venedikut i porosit dhe udhëzon përfaqësuesit e saj që t'i adresohen Helena Strazimirit. Kështu u veprua edhe pas ripushtimit të Shkodrës, ku në një dokument të 17 korrikut 1405, senati i Venedikut pas ripushtimit të Shkodrës, jep udhëzime si duhet vepruar për marrjen e Ulqinit dhe të vendeve të tjera. Urdhëron edhe të bëhen meremetimet e nevojshme për fortifikim, shpenzime për nozullim dhe një sternë në kështjellën e Shkodrës.⁶ Edhe në dokumentin e 22 korrikut 1405, Senati i Venedikut i jep udhëzime kapedanit të Gjirit si duhet të veprojë për të mos e lëshuar Ulqinin dhe për të detyruar Helenën me të birin që të lëshojnë Drishtin e vendet e tjera që ia kanë hequr zotërimit të venedikasve.⁷ Ndërsa, në një dokument që mban datën 18 maj 1406, Venediku nuk pranon kërkesën e ambasadorëve të despotit Stefan që t'u kthejë Balshajve vendet e pushtuara ashtu edhe

të blejë në qytetet e vendet e saj as të nxjerrë drithërat e sipërthënë, përveç tregtarëve tanë, që për hatër të zotit, do të jenë krejt të mjaftueshëm për t'i blerë të gjitha drithërat e saj”.

⁶ Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV,I, dok. 538. Gjithashtu në këtë dokument thuhet: “...duam që ju të bëjnë çfarë të jetë e mundur me zonjën Helena Strazimiri, me ato mënyra të shkathëta e me ato fjalë të dobishme që mençuria juaj do t'i shohë me vend, që t'u jepet fund siç duhet grindjeve të lartpërmendura .Por nëse zonja Helena ngul këmbë në qëndrimin e vet të parë, duke mos dashur t'na i kthejë vendet tona të lartpërmendura që i ka shtënë në dorë ajo zonjë, atëherë, me çdo mënyrë të mundur, do të përpiqeni t'i rimerrni vendet e sipërthëna”.

⁷ Ibid., dok. 541. “Duhet të përpiqeni dhe të kërkonit të bini në marrëveshje me zonjën Helen Strazimiri dhe birin e saj, d.m.th. që të duan të na kthejnë qetë e pa ngatërresa Drishtin dhe të gjitha vendkalimet e vendet e tjera që ne posedonim dhe mbanim para se zonja Helena dhe biri i saj t'i kapnin vendet në fjalë. Kurse ju nga ana tjetër, duhet t'u ktheni atyre të gjitha vendet që në çfarëdo mënyre t'i keni shtënë në dorë tani së fundi, me përjashtim të Ulqinit, nëse e keni marrë, siç u tha më lartë, se ne duam që ai vend të ruhet për nderin tonë. Por nëse zonja e thënë nuk do të kënaqej me kaq dhe do të thoshte se do atë provizion vjetor që i jepnim asaj para trazirës së tanishme, (provizionin) që është një mijë dukatesh në vit, qëllimi ynë është që, së bashku me përfaqësuesit tanë, që gjenden në ato vise, duhet të pranoni të bini në këtë ujdise me zonjën e sipërthënë, d.m.th. se zotërimi ynë do të pranojë ta sjellë zonjën në fjalë e birin e saj në atë gjendje e kusht siç ishin para trazirës së tanishme, me përjashtim të provizionit që kishin, të cilin aspak nuk duam t'ua japim, duke pasur parasysh ato që aq marrëzisht kanë vepruar kundër nesh. Dhe në lidhje me këtë, duhet të përpiqeni, me ato mënyra të mira që mençuria juaj do t'i shohë me vend, që të mund ta arrijmë qëllimin tonë”.

kërkesa të tjera të tyre. Në këtë dokument thuhet se “...ne jemi gati të harrojmë fyerjet që na janë bërë dhe ta pranojmë në hirin tonë atë zonjë Helenën dhe zotin Balshë, birin e saj, dhe t’i kemi dashamirës dhe miq tanët, nëse ata do të duan të sillen siç duhet të veprojnë ata që duan të janë miq dhe dashamirës ndaj të tjerëve. Dhe në rast se ata duan të vijnë për të banuar në qytetin tonë të Venedikut apo në ndonjë nga vendet e tjera tonat, në vise të tjera, por jo në vendet e Shqipërisë, ne do të mendojmë për ta që të mund ta çojnë me nder jetën e tyre...”⁸

Në dhjetor të vitit 1406 Republika e Venedikut vendos t’u jep fund bisedimeve me ambasadorët e Balshajve. Në dokumentin i cili mban datën 30 dhjetor 1406, thuhet se: “...megënëse i duhet dhënë fund punës me përfaqësuesit e zonjës Helena Strazimiri dhe të Balshës, birit të saj, të cilët gjenden këtu prej shumë ditësh dhe kërkojnë me të madhe tu kryhet puna, dhe duke pasur parasysh se ato që kanë qenë ngarkuar për t’i dëgjuar shpeshherë janë takuar me ta dhe e kanë marrë vesh qëllimin e tyre që do të ishte ky: që zotërimi ynë të denjojë t’i ndiejë ata (Helenën dhe Blshën) dhe t’i pranojë në hirin e tij duke marrë masat që për cak të tyre të kenë si një nder të veçantë, vendin e Drishtit dhe të Budues ashtu edhe disa fshatra që gjenden nën Ulqinin...”⁹ Pra, edhe pse principata e Balashajve drejtohej nga Balsha III, megjithatë duke u mbështetur në dokumentet e lartpërmendura, shohim se Helena Balsha kishte mjaft ndikim në principatën e Balshajve e cila udhëhiqej nga djali i saj. E themi këtë për faktin se shumë dokumente gjatë kohës sa ishte në pushtet Balsha III, i referohen drejtpërdrejt nënës së tij Helena Balshës.

E drejta në trashëgimi - testamentet

Përmendja e femrave në testeamente si hartuese apo përfituese të tyre, na lë të kuptojmë se gjatë mesjetës femrat kishin të drejtë jo vetëm të hartojnë, por edhe të përfitojnë nga testeamentet, qoftë nga prindërit, bashkëshortët apo fëmijët e tyre. Për privilegjin që gëzonin femrat në hartimin e testeamenteve vlen t’i përmendim disa raste ku disa drishtasë përmenden si dëshmitarë dhe përfitues të atyre testeamenteve. Kështu në testamentin e Stavës gruas së Jakobit, hartuar në Raguzë më 8 prill

⁸ Archivio di Stato di Venezia, Deliberation Miste Senato, III/22v-23 (më tej: A.S.V., Del.Secr. Sen.), sipas përkthimeve që ndodhen në Arkivin e Institutit të Historisë - Tiranë, A.III./563, dok.49 (më tej: AIH).

⁹ A.S.V., Del. Secr. Sen. III/51; AIH, A.III./563, dok. 94.

1400, është edhe Dom Pjetri nga Drishti, dëshmitar.¹⁰ Ndërsa, në testamentin e Visinës, gruas së Millat Gojanoviqit, i cili mban datën 8 maj 1400, hartuar në Raguzë, një nga dy dëshmitarët është edhe prifti Pjetër Spani. Në testament gruaja që bënë testamentin thotë nga fundi po i lë dom Pjetër Spanit 7 groshë.¹¹ Ndërkaq në testamentin e Aniçes gruas së Radin Visiniqit, hartuar në Raguzë më 21 maj 1400, thuhet ndër të tjera: *“Unë Aniça e çobanit Klupia..., dua që vreshti im që është në Ulqin, jashtë qytetit dhe shtëpia të shiten edhe kopshti im që gjendet pranë kishës së Shën Pjetrit në Ulqin gjithashtu të shitet dhe me të hollat të bëhen lëmosha etj.”* Ndër epitropë është edhe dom Pjetri nga Drishti.¹²

Po ashtu, në një testament të hartuar më 20 mars 1401 në Raguzë, dy klerikë shqiptarë me banim në Raguzë marrin një vresht, njëri nga këta klerikë është Pjetër Spani nga Drishti. Në testament thuhet: *“... po u japim dhe u lëshojmë priftit Anton Skamandra nga Durrësi dhe priftit Pjetër Spani nga Drishti, banorë të Raguzës, që janë të pranishëm dhe marrin në dorëzim, sa të jenë gjallë, vreshtin që ishte i së ndjerës Serge dhe i të ndjerit Engjëll, babait të saj, që ta mbajnë, ta posedojnë dhe t’ia gëzojnë frytet, për shpirtin e së ndjerës Serge në fjalë...”*, me tej në testament thuhet: *“dhe për të gjitha ato që u thanë prifti Anton dhe prifti Pjetër pranuan dhe u detyruan të meshojnë dhe ta mbajnë në rregull vreshtin, me mënyrat dhe kushtet e sipërshtuara...”*¹³ Ndërsa në testamentin e dom Benkut nga Drishti, e bërë me anën e Nikollë Karosit dhe të shokëve epitropë, hartuar më 2 prill 1401 në Raguzë, përmenden, ndër të tjerë, edhe dom Dhimitri nga Drishti që mori 5 perperë për vete. Ai mori edhe 1 perperë e 7 groshë, pasi Gjudoslava, vajza e Draksit, e ka caktuar atë si prokurator të saj.¹⁴ Edhe gruaja e Nikollë Spanit bën aktin e dhurimit të pasurive të veta që ka në Shqipëri, në favor të të birit dom Pjetër Spanit, testamenti mban datën 4 gusht 1402, Raguzë.¹⁵

¹⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, I, dok. 26.

¹¹ *Ibid.*, dok. 31.

¹² *Ibid.*, dok. 39.

¹³ *Ibid.*, dok. 98.

¹⁴ *Ibid.*, dok. 99.

¹⁵ *Ibid.*, dok. 239. “Unë Vlasna, e bija e të ndjerit Andre Skapudarit nga Drishti, që gjendem personalisht në Raguzë, duke marrë parasysh se im bir, dom Pjetër Spani, pas vdekjes së Nikollë Spanit, të sipërthënit baba të tij dhe burrit tim, me pasuritë e tij në të holla dhe pasuritë e tundshme, që i ka fituar me veprën e vet, martoi dy motra e veta, bijat e mia dhe të të thënit Nikollë, duke u dhënë atyre prikën e përshtatshme siç

Në disa testamente femrat i hasim edhe si përfituese qoftë nga prindërit, fëmijët apo bashkëshortët e tyre. Në këtë aspekt në testamentin e hartuar më 6 - 9 shtator 1400 në Raguzë nga Pjetër Suma nga Drishti, kapelan i Shën Vlashit të Raguzës, thuhet: *“Unë dom Pjetër Suma nga Drishti, duke qenë i sëmure fizikisht po bëj testamentin tim të fundit me mendje të shëndoshë, gjithashtu po i lë nënës sime 20 perperë. Gjithashtu Domenikës, mbesës së dom Andreas, veshje për 7 dukate”*.¹⁶ Nga testamenti i dom Pjetër Sumës përfiton edhe Domenika një grua nga Shkodra, të cilës dom Pjetër Spani i kishte lënë për veshje shtatë dukat ar.¹⁷ Më 17 mars 1404 në Raguzë, vërtetohet testamenti i Pjetër Leporës nga Drishti, ndër të tjera thuhet se *“po i lë tridhjetë perperë mbesës sime Konina”*.¹⁸

E drejta sipas statuteve

Statutet e Shkodrës të cilat i referohen pozitës së gruas në jetën shoqërore, dëshmojnë qartë për rolin dhe rëndësinë e saj në shoqëri. Në statutet e Shkodrës ishin të rregulluara shumë çështje të cilat i referohen pozitës, rolit dhe të drejtës së gruas në shoqëri, duke filluar nga e drejta e saj për trashëgimi si dhe për hartimin e testamenteve. Sa i përket të drejtës për trashëgimi, sipas kapitujve të cilët i kushtohen kësaj çështjeje shohim se jo vetëm djemtë, por edhe vajzat kishin të drejtë të

ra në marrëveshje, me burrat e tyre, në çdo mënyrë që ta lejojë e drejta, në çdo rrugë e formë që kam mundësi më mirë, me dijenitë time të saktë dhe me vullnetin tim, jo gabimisht, por lirisht dhe pasi u mendova, po i jap, po i kaloj dhe po i fal me titull donacioni midis të gjallëve, që për asnjë mosmirënjohje apo fyerje kurrë nuk do të mund të revokohej, dom Pjetër Spanit, birit tim, që është i pranishëm dhe që po merr, të gjitha pasuritë e mia, si të tundshme ashtu edhe të patundshme, kudo që të gjenden, ashtu edhe të gjitha të drejtat e mia, që më përkasin apo që për çdo arsye e shkak do të mund të më përkasin të ardhmen, qoftë me të drejtë tjetër çfarëdo qoftë dhe cilado qoftë. Kështu që i thëni dom Pjetri, biri im, si gjatë jetës sime ashtu edhe pas vdekjes sime, të mbetet posedues i patrazuar i të gjitha pasurive të mia të tundshme e të patundshme. Megjithatë nga këto pasuri do të hiqet një arë tokë që gjenden në vendin në fjalë, edhe një vresht që gjendet në Kruçe poshtë një vreshti më të madh në vendin e thënë të Kruçes. Këtë arë e këtë vresht i mbaj për t'i përdorur sipas vullnetit tim të plotë, qoftë gjatë jetës sime, qoftë në vdekjen time, ashtu siç do të më pëlqejë. Kurse të gjitha pasuritë e të drejtat e tjera të mia, siç u tha, të jenë të dom Pjetrit në fjalë, dhe ai vet si më pasuritë e veta. Zoti Stefan de Lukaris, gjykatës dhe Rusku i mjeshtër Kristoforit dëshmitarë etj”.

¹⁶ Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV, I, dok.64.

¹⁷ Ibid., dok. 374.

¹⁸ Ibid., dok. 420.

trashëgonin pasuri nga prindërit e tyre. Kjo çështje ishte e rregulluar në kapitullin e 160, sipas të cilit: *“Vajzat e mbetura pa baba e pa nënë, kanë pjesë të barabartë në ndarjen e pasurisë dhe të drejtën të marrin prikën e virgjërisë. Nëse mbeten jetimë, vëllai me një apo më shumë motra, vëllai apo vëllezërit kanë për detyrë të martojnë motrën apo motrat, me atë ç’kanë trashëguar ato nga babai e nga nëna. Pjesa që tepron, u takon të vëllezërve ose vëllait, nëse është vetëm një”*.¹⁹ Sa i përket të drejtës së hartimit të testamentit, sipas kreut 186, shihet se si djemtë ashtu edhe vajzat kishin të drejtë që të hartonin testamentin. Në kreun 186 sa i përket të drejtës së hartimit të testamentit nga femrat thuhet: *“Vajza dhe femra në përgjithësi ka të drejtë të përpilojë testament duke filluar nga mosha 12 vjeç e lartë. Nëse nuk e ka mbushur këtë moshë, testamenti i hartuar prej saj konsiderohet i pavlerë. Nëse vajza vdes e pamartuar dhe nuk ka bërë testament, pasuria e saj i mbetet njeriut më të afërt”*.²⁰ Gjithashtu gratë kishin të drejtë të hartonin testament, ku nga prika e tyre kishin të drejtë që të lënin një pjesë për lutjet për shpirtin e tyre. Sa i përket kësaj çështjeje: *“Gruaja që ka fëmijë ka të drejtë të bëjë testament dhe të lërë mënjanë për lutje të shpirtit të saj, një të pestën e prikës, nëse këtë prikë nuk ia ka kaluar vajzës së saj. Përndryshe, të caktojë për përsheptjen e saj, pjesën e mbetur, pasi t’u ketë shpërndarë djemve pjesën që u takon”*.²¹

Një çështje tjetër me rëndësi për pozitën e gruas në jetën shoqërore të asaj kohe ishte edhe trajtimi njerëzor i saj, ku mund të veçojmë kreun *“Mbi dëbimin e gruas”*, sipas të cilit, burri nuk mund ta dëbonte gruan në rast se ajo nuk mbante prikë në shtëpi, në rast se e dëbonte gruan ishte e paraparë që burri të dënohej. *“Burri që ka futur një grua në shtëpi nuk mund ta dëbojë kurrë, për shkak se ajo nuk mban prikë në shtëpi. Prika duhet kërkuar me arsye. Ai që dëbon gruan dënohet me një gjobë prej 8 hyperperësh, që ndahen barabar mes Kontit dhe paditësit”*.²² Në kuadrin e kapitujve që i referohen gruas po veçojmë edhe ata që i referohen dhunës ndaj gruas ku përfshihen dhunimet dhe rrahjet. *“Nëse një grua e martuar qoftë dhe me një burrë me emër të keq, ankohet ndaj një kleriku për përdhunim, rrahje ose vjedhje, asaj i duhet besuar edhe pa dëshmitarë, ndërsa kleriku duhet të*

¹⁹ Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469, Onufri: Tiranë 2010, kreu: 160.

²⁰ Statutet e Shkodrës, kreu:186.

²¹ Ibid., kreu: 196.

²² Ibid., kreu: 265.

paguajë si dënim një gjobë prej 50 hyperperësh Sklavonie. Gjysma e shumës i kalon peshkopit, një e katërta Kontit dhe pjesa e mbetur, një e katërta, gruas që paraqet ankesën. Nëse peshkopi heq dorë nga pjesa e tij, ajo i kalon Komunës”.²³ Po ashtu: “Nëse një burrë përdhunon një grua të ndershme të pamartuar dhe nëse burri është i pamartuar, ai detyrohet të bashkohet me të në martesë të ligjshme. Por nëse gruaja është e martuar, po ashtu edhe burri që përdori dhunën, atëherë ky i fundit detyrohet të paguajë një gjobë prej 50 hyperperësh, që ndahen përgjysmë mes Kontit dhe gruas së dhunuar. Por për këtë fakt, gruaja duhet të japë prova bindëse”.²⁴

Statutet e Shkodrës dhe masa ndëshkuese gjithashtu parashihnin edhe për ata persona që ushtronin dhunë ndaj shërbyeseve. “Nëse dikush përdhunon shërbyesen e një burri a të një gruaje dhe shërbyesja vdes gjatë lindjes, dhunuesi detyrohet t’i japë padronit të viktimës një tjetër shërbyese. Djali apo vajza e lindur e shërbyeses, do të jetë shërbyese e padronit të nënës së tyre”.²⁵ Gjithashtu masa ndëshkimore parashihej edhe për personat që ushtronin dhunë fizike ndaj grave. “Nëse provohet që një laik prek me dorë, rreh një grua apo dhunon banesën e saj, dënohet me një gjobë prej 8 hyperperësh. Nëse dhunon një tjetër grua në të njëjtën mënyrë, të gjobitet me 8 hyperperë, gjysmën Kontit dhe gjysmën tjetër paditësit”.²⁶ Një çështje tjetër e cila ishte e rregulluar në statutet e Shkodrës sa i përket pozitës së gruas në shoqëri ishte edhe martesë, ku disa nga kapitujt e statuteve në fjalë i kushtohen kësaj çështjeje. Në kapitujt që flasin për këtë çështje thuhet se: “Prindërit që kanë djem e vajza për të martuar duhet të kenë parasysh se përpara martohen vajzat e më pas djemtë. Nëse një djalë dëshiron të martohet përpara se motrat të kenë dalë nga shtëpia, pa miratimin e prindërve, atëherë babai dhe nëna kanë të drejtë ta dëbojnë atë nga shtëpia”.²⁷ Po ashtu, statutet e Shkodrës e rregullonin edhe çështjen se sa pasuri i takon vajzë së martuar. Sipas tyre: “Kur një baba apo një nënë kanë vajza të martuara si dhe djem a djem të djemve, ata nuk duhet t’u japin gjë tjetër vajzave, veç prikës. Gjithë sa mbetet pas sigurimit të prikës së vajzave, i takon djalit apo djemve të djemve. Nëse nuk ka djem, vajzat duhet t’i ndajnë këto pasuri mes tyre, në mënyrë të

²³ Ibid., kreu: 200.

²⁴ Ibid., kreu: 201.

²⁵ Ibid., kreu: 202.

²⁶ Ibid., kreu: 256.

²⁷ Statutet e Shkodrës, kreu: 161.

barabartë, që asnjëra të mos marrë më shumë se tjetra nga pjesa e mbetur e pasurisë, pas dhënies së prikave”.²⁸ Paja e gruas konsiderohej si diçka tepër e rëndësishme dhe shpërdorimi i saj shërbente si një pengesë serioze për ata meshkuj që kërkonin të martoheshin për herë të dytë.²⁹ Këto parashiheshin në kreun “Mbi ata që martohen për së dyti”, ku thuhej: “Kur një burrë e humbë gruan e parë dhe dëshiron të martohet sërish, nëse nuk ka fëmijë me të parën, duhet fillimisht, ta dorëzojë prikën e gruas së parë tek njerëzit e saj. Në rast se nuk vepron kështu, nuk mund të marrë një grua të dytë”³⁰, dhe në kreun “Mbi fëmijët e gruas së parë”: “Nëse fëmijët e gruas së parë nuk e kanë marrë prikën e nënës, meqë babai është gjallë, edhe kur ky martohet me një grua tjetër dhe bën fëmijë të tjerë me të, në radhë të parë babai duhet të heqë mënjatë prikën e fëmijëve që ka me gruan e parë, pra më nënën e fëmijëve...”³¹

Statutet e Shkodrës na ofrojnë të dhëna me interes edhe për jetën martesore nga të cilat mund të veçojmë kreun “Mbi çiftet që jetojnë pa prindër”, ku parashihej se: “Nëse një burrë dhe një grua martohen dhe jetojnë më vete, pa prindërit, çdo gjë që ata fitojnë së bashku konsiderohet e barabartë, pra gjysma i takon burrit dhe gjysma tjetër gruas. Kjo vlen edhe për dëmet”.³² Gjithashtu Statutet e Shkodrës e kishin të rregulluar edhe çështjen nëse nusja dhe dhëndri pas martesës jetonin së bashku me familjen. Kjo çështje ishte e përfshirë në kreun “Mbi dhëndrin e nusen”, ku thuhej se: “Nëse pas martesës dhëndri dhe nusja jetojnë bashkë me vjehrrin dhe vjehrrën, me kunetërit e me kunatat dhe nëse më vonë çifti i martuar vendos të ndahet prej tyre, duhet të marrë me vete aq sa kishte sjellë në martesë. Kurse të ardhurat e siguruara nga gjithë familja vitin që dhëndri dhe nusja vendosin të largohen nga shtëpia, duhet të ndahen në fillim të vitit më pas”.³³ Për çiftet që nuk kishin fëmijë, ekzistonte e drejta e birësimit ose e adoptimit.³⁴ Kjo e drejtë ishte e rregulluar në kreun “Mbi fëmijët e adaptuar”.³⁵ Për dallim nga Statutet e Shkodrës, në Statutet e kishës

²⁸ Ibid., kreu:162.

²⁹ Ermal Baze, *Një qytet me statute, Shkodra në gjysmën e parë të shekullit XIV*, Muzgu: Tiranë 2013, 168.

³⁰ Statutet e Shkodrës, kreu:172.

³¹ Ibid., kreu:173.

³² Ibid., kreu:166.

³³ Ibid., kreu:167.

³⁴ E. Baze, *Një qytet me statute*, 169.

³⁵ Statutet e Shkodrës, kreu:174: “Nëse një burrë i martuar me një grua të ligjshme nuk

katedrale të Drishtit, vetëm në një kapitull përmenden femrat përkatësisht iu ndalohet vajzave që të mos shkojnë në kanonikë.³⁶

Fare në fund mund të themi se të dhënat e përmendura në këtë punim për pozitën dhe rolin e gruas në Drisht e Shkodër gjatë mesjetës, janë një tregues i mirë se sa çmohej roli i gruas në shoqërinë mesjetare. E këtë më së miri e dëshmojnë të dhënat dokumentare, statutet (Drishtit dhe Shkodrës) si dhe testamentet, të cilat i kemi përdorur për të elaboruar këtë problem.

ka fëmijë prej saj dhe nëse burri dhe gruaja bien dakort të bënë një birësim, mund të veprojnë kështu duke adaptuar fillimisht një fëmijë të vëllait; nëse ky nuk ka fëmijë, mund të marrin fëmijën e një të afërmi që e pranon birësimin, duke u paraqitur para gjykatësve, duke sjellë dëshmitarë dhe akt noteri për birësim në fjalë. Si burri që ka grua, ashtu dhe ai që nuk ka, apo si gruaja që ka burrë dhe ai që nuk ka, kanë të drejtë t'ua kalojnë fëmijëve të birësuar të gjithë pasurinë e tyre”.

³⁶ Statutet dhe urdhëresat e kapitullit të kishës katedrale të Drishtit, përgatitur nga Musa Ahmeti & Etleva Lala, Tiranë 2009, dok. XXXVIII, f. 162. “Kur mbliidhemi për drekë askush të mos guxojë të sjellë me vete ndonjë vajzë. Dënimi: dëbim prej shtatë ditësh për çdo herë. Nuk është e ndershme që të vijnë vajza në të tillë vende, edhe pse mund të jenë mbesa dhe faretis”.

Teuta SHALA-PELI

SUMMARY

SOME DATA REGARDING THE ROLE AND POSITION OF WOMEN IN DRISHT AND SHKODËR DURING THE MEDIEVAL PERIOD

A series of documents exist which refer to the role of women in Medieval society, in particular regarding political, economical, and cultural issues. Regarding the role and position of women in medieval society of particular importance are the statutes of Drisht and Shkodër. The documents pertaining to the Medieval period argue that women maintained important roles in political and economical issues. Additionally, the documents prove that women also had rights in formulating testimonies, the right to inherit family properties, as well to delegate their inheritance to another individual.

To further elaborate on the issue regarding the role of women in Drisht and Shkodër during the Medieval period, based on literary and primary source at hand, we have divided the treatise in three parts:

- The first part consists of information regarding the women's contribution in political and economical issues,
- The second part treats women's right in inheritance and other issues related to this topic,
- The third part treats the role of women as included in the statutes of Shkodër and Drisht, which stand as a testimony to women's importance in Medieval society.

The previously mentioned information treated in this paper regarding the role of women in Drisht and Shkodër during the Medieval period is an excellent indicator of the importance that women had in medieval society.

Bedri MUHADRI

PUSHTIMI I KOSOVËS NGA OSMANËT NË SHEKULLIN XV

Fitorja e shteti osman në Betejën e Kosovës të viti 1389 dhe konsolidimi i pushteti osman në fund të shekullit XIV, lehtësuan pushtimet e mëtejshme osmane në Shqipëri dhe në Kosovë. Me marrjen e Shkupit (1392) nga osmanët, pozicioni shumë i favorshëm gjeografik ku kryqëzoheshin rrugët më të shkurtra që lidhnin Perandorinë Osmane me të gjitha tokat shqiptare dhe me rajonet e tjera të Ballkanit, e shndërruan qytetin e Shkupit në bazë ushtarake shumë të fuqishme, duke e shpallur *pashasanxhak* apo vend rezidencë e bejlerbeut të Rumelisë, që ishte komandanti i përgjithshëm i ushtrive osmane për pjesën evropiane të saj.¹ Më 1393 osmanët e morën Zveçanin dhe kështu osmanët përforcuan prezencën e tyre në Kosovë. Një pjesë e territorit të Kosovës gjegjësisht Rrafshi i Dukagjinit me territoret e saja në: Pejë, Istog, Klinë, Gjakovë, Prizren dhe Suharekë, ndodheshin nën administrimin e Dukagjinasve. Dinastia feudale arbërore e Dukagjinasve krijoi raporte vasaliteti me shtetin osman. Për krijimin e këtyre raporteve dëshmon letra e fisnikëve të Dukagjinasve e vitit 1387, me të cilën njoftojnë autoritetet e Raguzës se mund të kalojnë lirisht nëpër tokat e tyre sepse kanë lidhur marrëveshje me osmanët.² Kjo

¹ *Historia e Popullit Shqiptar I : Ilirët Mesjeta Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XIV - vitet 20 të shek. XIX*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë 2002, 378.

² Letra e Lekë Dukagjinit dërguar Raguzës, më 30 dhjetor 1387, ka këtë përmbajtje: “*Fisnikë të qytetit të nderuar të Dubrovnikut, ju shkruaj me besën time dhe të vëllait tim: ejani lirisht në tokën time, mos keni frikë për asgjë*”. Për sa i përket tagrit doganor, paguani taksën doganore ligjore që u keni paguar më parë fisnikëve të tjerë, që kanë qenë më parë në këto vende. Dhe mos keni frikë për asgjë, sepse kam paqe me turqit. *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë Vëllimi II, Shek. VIII - XV*, Tiranë, 1962, 190.

dëshmon se nën autoritetin qeverisës të Dukagjinasve ishin territoret përgjatë rrugës Lezhë-Prizren, si dhe daljen në bregdet.³ Në këtë kohë në gjysmën e dytë të shek. XIV kryezotërinjtë arbërorë Balshajt, formuan shtetin e tyre që shtrihej në pjesën veriore të trevës arbërore. Territori mbi të cilën shtrihej pushteti i Balshjave në fillim të viteve '60 të shek. XIV quhej Zetë.⁴

Në fillim ata qeverisnin me qytetin Budua (Budva), Tivarin, Ulqinin dhe Shkodrën, të cilën e bënë edhe seli të tyre.⁵ Balshajt në vitet 1371 - 1385 e shtrinë pushtetin mbi qytetin e Pejës, Prizrenit dhe rrethinën e Novobërdës. Që këto territore ishin nën zotërimin e shtetit të Balshjave dëshmon dokumenti apo marrëveshja politike-tregtare ndërmjet Gjergjit II Balsha dhe Raguzës, lëshuar më 20 nëntor 1379. Me këtë dokument shteti i Balshjave përmes sundimtarit të vet Balsha II i konfirmon qytetit të Raguzës privilegjet e vjetra që kishin të bënë me tregti, por edhe duheshin të paguanin taksën doganore nëpër territorin e shteti të Balshjave ku thuhet; “... *Të kalojnë lirshëm tregtarët e Dubrovnikut (ish Raguzës) nëpër tokën time..., dhe në Danjën (vendi doganor) dhe në Kriva Rekë (vendi doganor afër Novobërdës) të paguanin taksën doganore aq sa kanë paguar kur ka qenë gjallë vëllai im, zoti Gjergji (Gjergji I Balsha, B. M.).*⁶

Kurse pjesa e Rrafshit të Kosovës me qytetet si Prishtina e Vuçitërna ishte nën sundimin e despotit serb Stefan Llazareviqit. Në këtë kohë formacioni shtetëror serb i trashëguar nga Stefani Llazareviqi ishte shumë i dobët. Për t'u përballuar hungarezëve të cilët ishin mjaft aktiv dhe paraqisnin rrezik të drejtpërdrejtë, iu drejtua për ndihmë Raguzës, por pa sukses. Ndihmë kërkuan edhe nga sulltani osman Bajaziti. Sulltan Bajaziti i ofroi pozitën vasale Stefan Llazareviqit e cila u pranuan nga serbët. Me këtë marrëveshje Serbia hyn në raporte vasaliteti në kuadër të Perandorisë Osmane, duke i premtuar serbëve mbrojtje nga pushtimi hungarez. Marrëveshja u realizua më 1389.⁷ Kjo u mbështet edhe nga Kuvendi i Kishës Ortodokse Serbe dhe patriku i saj

³ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII: administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë: Rilindja 1982, 29.

⁴ G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshjave*, Tiranë, 2009, 18.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar I*, 301.

⁶ *Burime të zgjedhura*, 186.

⁷ M. Tërnavë, *Diskursi shkurtër nga toponimia, Beteja e Kosovës gjatë shekujve XIV - XV dhe vendosja e atëhershme e pushtetit turk në Dardani-Kosovën e shekullit XV*, Prishtinë, 2007, 70.

Spiridoni.⁸ Marrëveshja e vasalitetit mes Bajazitit dhe Stefan Llazareviqit ishte hartuar në këtë mënyrë; Serbia që ka pranuar vasalitetin osman është e obliguar që vetë personalisht bashkë me ushtrinë e vetë të merrte pjesë në të gjitha luftërat. Ndërkaq për shkak të xeheroreve të argjendit (gumus madenler dolayisile), që gjendeshin në Serbi, princi serb duhej t'i paguante haraç shtetit osmanli. Veç kësaj, ai (Stefan Llazareviqi) ishte obliguar që motrën e vetë Oliverën, (13 vjeçare) t'i jepte për grua Bajaziti.⁹ Milica (gruaja e Lllazarit) në emër të birin të vet Stefan Llazareviq, i cili ishte i mitur, pranoi vasalitetin osman që nënkuptonte pagesën e kontributit vjetor si dhe pajisjen me trupa në numër të caktuar për ekspeditat ushtarake osmane, sa herë që kërkonte sundimtari osman. Djemtë e Lllazarit Stefani dhe Vuku kishin për detyrim të paraqiteshin dy herë në vit te Bajaziti. Menjëherë pasoi udhëtimi i Stefan Llazareviqit me patriarkun ortodoks për në Adrianopojë për të shfaqur nënshtrimin e tyre.¹⁰

Raporti i vasalitetit serb me turqit, u manifestua me rastin e betejës së Angolës (Ankarasë) më 1402 ndërmjet turqve dhe prijësit të famshëm të Azisë Qendrore Timur Lengu, i cili kishte pushtuar Iranin, Irakun, Sirinë etj. Në këtë betejë, në anën e osmanëve morën reparte të shumta ushtarake nga Serbia dhe Kosova nën udhëheqjen e Stefan Llazareviqit, dhe Gjergj Brankoviqit.¹¹ Mirëpo, forcat ushtarake të prijësit mongol Timur Lengut, kishin epërsi si nga numri i forcave ushtarake, ashtu edhe nga shkathtësia luftarake. Kështu ai e fitoi betejën, duke u shkaktuar humbje të mëdha osmanëve. Kjo disfatë lëkundti në themel shtetin osman, sepse që nga viti 1403 e gjerë në vitin 1413 filloi lufta për fronin osman ndërmjet bijve të sulltan Bajazitit. Kjo situatë brenda shtetit osman i mundësoi që të shpallet despotati serb dhe despot i saj Stefan Llazareviqi. Disfata e Ankarasë kishte pasur për pasojë një shturje të pushtetit në të gjitha territoret e sunduara më parë nga osmanët. Në shtetin osman për më se dhjetë vjet do të kemi luftëra civile për pushtet ndërmjet bijve të sulltan Bajazitit.¹² Po ashtu, kemi luftëra civile ndërmjet Stefan Llazareviqit dhe Gjergj Brankoviqit. Në nëntorin e viti 1402 u përleshën në Graçanicë trupat e Stefan Llazareviqit me forcat e Brankoviqit të ndihmuara edhe nga ushtria

⁸ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë 2002, 84.

⁹ Tërnavë, *Diskursi shkurtër nga toponimia*, 71.

¹⁰ Malcolm, *Kosova*, 84.

¹¹ Ibid., 86.

¹² Ibid., 87.

turke. Stefan Llazareviqi, pati suksese duke e mundur Brankoviqin. Despot Stefan Llazareviqi hyri në konflikt më vëllait e tij për pushtet. Në këtë situatë Stefani, kërkoi ndihmë nga mbreti i Hungarisë, duke u bërë vasal i tij.¹³ Po njëkohësisht ai ruajti raportet vasalitetit edhe me osmanët me Sylejmanin birin e Bajazitit. Në këtë situatë, kur shteti osmane ishte në luftë civile ndërmjet djemve të Bajazitit (Muratit dhe Mehmetit), një krah i Perandorisë turke përkrahnin forcat e vëllait të Stefanit. Një ushtri e udhëhequr nga Sulejmani i biri i perandorit osman Bajazit, i shkoi në ndihmë vëllait të Stefanit. Lufta shpërtheu në mbarë territorin e Kosovës.

Në pranverën e vitit 1409, në kohën e konflikteve ndërmjet vëllezërve Llazareviq, qytetet në Kosovë si Novobërda dhe Prishtina u përfshinë nga sulmet shkatërruese. Nga mbreti i Hungarisë Sigismundi, despoti Stefan pati në ndihmë një repart ushtarak i cili u vendosë në Novobërdë, prej nga ata bënë bastisje dhe plaçkitje në hapësirën përreth, dhe në një nga ato depërtime pushtuese Prishtina ishte shkatërruar. Nën presion e osmanëve, despoti Llazar ia mori Vukut pjesën jugore të vendit duke përfshirë edhe Novobërdën.¹⁴ Në betejën e vitit 1410 në Prishtinë, vëllai i Stefanit bashkë me ushtrinë turke që e përkrahu pësuan humbje.¹⁵ Në fillim të vitit 1412 depërtoi sulltan Musa në territorin e Uglleshës dhe iu afrua Novobërdës, por nuk arriti ta marrë. Pozicioni shumë strategjik dhe i përshtatshëm për mbrojtje, muret e gjata dhe kullat e larta, u mundësojë që me sukses të mbrohen, edhe ndaj forcave më të mëdha ushtarake. Me të dëgjuar që despot Stefani po vjen me ushtrinë e tij, sulltan Musa u tërhoq nga rrethimi i Novobërdës. Stefan Llazareviqi u vendos në Novobërdë, kurse sulltan Musa iku për në Shqipëri.¹⁶ Raguzanët të cilët kishin marrë pjesë në mbrojtje të Novobërdës, u falënderuan nga despoti Stefan në letrën dërguar atyre në të cilën thuhet: Ata ishin popull trim, të cilët treguan besnikëri duke mos u frikësuar nga shpata e osmanëve.¹⁷ Në vitin 1425 despot Stefan Llazareviq do të pajtohet me Gjergj Brankoviqin, dhe trashëgimtar i despotit Stefan u zgjodh vetë Gjergj Brankoviqi, pasi Stefan Llazareviqi

¹³ Ibid.

¹⁴ В. С. Јовановић, “Ново Брдо средњовековни град - Novo brdo Mediaeval Fortress”, *Ново Брдо*, Београд 2004, 58.

¹⁵ Në këtë betejë, u zu rob dhe u mbytë vëllai i Stefanit. Po ashtu edhe udhëheqësi turk Sylejmani u zu rob. Ai u mbyt në burg nga urdhri i vëllait Musai, që ishte në konflikt me të. Malcolm, *Kosova*, 87.

¹⁶ Јовановић, “Ново Брдо средњовековни град”, 58.

¹⁷ Ibid., 59.

nuk kishte trashëgimtarë. Pasi mori pushtetin Gjergj Brankoviçi do të vazhdojë të sundonte pjesën më të madhe të territorit të Kosovës, gjithë këtë, në sajë të kushteve të vasalitetit me osmanët. Me vdekjen e despotit Stefan Llazareviçi (1427) shtrirja e sundimit të Gjergj Brankoviçi do të zgjerohet dukshëm. Në vitet 1427 - 1428 forcat osmane depërtuan thellë në territorin e Kosovës, duke pushtuar qytetet kryesore të saj, me përjashtim të Novobërdës.¹⁸ Gjatë vitit 1427 turqit do të rrethojnë Novobërdën. Rezistenca në Novobërde që e madhe, e cila i bëri ballë rrethimit të madh osman. Rrethimi i Novobërdës do të përfundojë me një marrëveshje të re në mes të Gjergjit dhe sulltanit osman. Sipas të drejtës osmane, tokat e sundimtarëve, në rastin konkret të Stefan Llazarit pasi që kishte vdekur, nuk mund t'i trashëgonte Gjergj Brankoviçi. Duke ditur këtë rrezik Gjergj Brankoviçi hyri në marrëveshje të re vasaliteti ndaj osmanëve. Drejtpërsëdrejti ai pranoi pushtetin qendror osman duke paguar edhe kontributin vjetor atyre në shumën prej 50 000, 00 dukatë (Stefan Llazareviçi u paguante atyre 40 000, 00 dukatë) duke ofruar edhe trupa ushtarake prej 2 000 kalorës nën komandën e djemve të sulltanit ose ushtarakëve të sulltanit. Me këtë marrëveshje edhe përfundon faza e parë e pushtimeve osmane në Kosovë 1389 - 1427.

Pushtimi osman në Kosovë në vitet 1427 - 1453

Gjergj Brankoviçi që ishte sundues i pjesës së madhe të territorit të Kosovës, tentoi të bashkëpunonte me hungarezët. Ky veprim bëri që të jetë edhe shkas për ofensiva pushtuese nga ana e osmanëve. Në vitin 1432, Gjergj Brankoviçi për të bërë zotimin para sulltan Muratit II dhe për të mbetur vasal besnik i tij, ai e martoi të bijën e tij Marën me sulltan Muratin II. Por, këto përpjekje të tij që të ruante pozitat e veta në bashkëpunim me hungarezët dhe me osmanët nuk dhanë rezultat. Më 6 gusht 1439, ushtria osmane nën udhëheqjen e Beut Arzanoviçi, arriti të pushtonte disa territore në afërsi të Novobërdës, si vendbanimet Makresh, Tripolj etj., por, qyteti i Novobërdës nuk u pushtua.¹⁹ Në qershor të vitit 1439, qeveria e Raguzës i këshillonte qytetarët e vet që jetonin në Novobërdë, që në rast të ndonjë sulmi të mundshëm nga ana e osmanëve, të qëndrojnë fuqishëm, ashtu siç kishin vepruar më parë dhe

¹⁸ Malcolm, *Kosova*, 90.

¹⁹ Јовановић, “Ново Брдо средњовековни град”, 59.

të tregojnë respekt për udhëheqësit e Novobërdës.²⁰ Pushtimi i parë i Novobërdës nga osmanët erdhi në vitin 1441, dhe së pari u pushtua varoshi përreth Novobërdës, ndërsa qyteti ishte i pamposhtur. Pas një rrethimi të fuqishëm, më 27 korrik 1441, qytetin e pushtoi bejlerbeu i Rumelisë (Ballkanit) Shehabedin.²¹

Sulltan Murati, për më tepër duke dyshuar se familja e Brankoviqëve po bënte një komplot kundër tij, i verboi të dy djemtë e Gjergj Brankoviqit kurse vetë ai kishte ikur për në Hungari.²² Gjatë kësaj kohe territori i Kosovës disa vite do të jetë nën pushtetin e plotë osman. Në vitin 1443, mbreti i Polonisë Vlladisllavi, i cili këso kohe e merr edhe titullin e mbretit të Hungarisë, përgatitë një ekspeditë ushtarake shumëkombëshe kundër turqve me synim që t'i dëbojë turqit nga Evropa. Në ushtrinë e koalicionit përveç polakëve dhe hungarezeve, merrnin pjesë edhe ushtarët gjermanë, boshnjakë, kroatë dhe ushtarë të Gjergj Brankoviqit.²³ Kështu nën komandën e mbretit Vlladisllav dhe Janosh Huniadit, forcat aleate hynë në Serbi, korrën fitore afër Nishit ndaj ushtrisë osmane (vjeshtë 1443) duke depërtuar deri në Sofje të Bullgarisë. Gjatë përparimit të forcave osmane, këto forca kishin pushtuar edhe një pjesë të territorit të Kosovës deri në Novobërdë, duke i larguar osmanët.

Përafërsisht dy vjet më vonë Novobërda përsëri u morë nga Brankoviqi. Kjo erdhi si rezultat i depërtimeve të suksesshme të ushtrisë hungareze në vitin 1443 në rrugën Nish-Sofje deri në Zlaticë. Nuk dihet se a pati nga ana e popullatës kryengritje apo osmanët u larguan nga rreziku i sukseseve të ushtrisë hungareze në Ballkan, apo despoti Gjergj i ka dërguar ndonjë njësi që ta merr qytetin. Por, pas disfatës së rëndë të ushtrisë hungareze në Varnë më 1444, Novobërda u gjend përballë sulmeve osmane. Daut beu nga Sitnica ndërmori sulme të rënda pushtuese në Novobërdë. Në sajë të një marrëveshje me udhëheqësit e Novobërdës, Daut beu u largu nga Novobërda.²⁴ Në pranverë të vitit 1444, Murati II kishte dërguar një emisar te Gjergj Brankoviqi (dihet se për këtë kishte ndërmjetësuar sulltaneshja Mara, e bija e Gjergj Brankoviqit) për ta informuar atë se, në qoftë se tërhiqet nga ekspedita ushtarake (hungareze), atij do t'i kthente pushtetin në territoret që i

²⁰ М. Динћ, *Са исторњу рударству средновековној Србији и Бони*, II, Београд 1962, 59.

²¹ Ibid., 60.

²² Malcolm, *Kosova*, 90.

²³ Ibid., 91.

²⁴ Јовановић, “Ново Брдо средњовековни град”, 61.

kishte pasur. Thuhet se Gjergji u pajtua menjëherë, kështu që periudha fillestare e sundimit të drejtpërdrejtë të Turqisë mbi Serbinë 1439 - 1444 mori fund. Kështu Gjergj Brankoviçi prapë u bë sundimtar i saj nën vasalitetin osman.²⁵ Meqë Gjergj Brankoviçi u bë vasal i osmanëve, tani ai, nuk lejoi ushtrinë hungareze nën komandën e J. Huniadit të kalonte nëpër territoret e tij dhe Huniadit, iu dështë të kalonte Danubin nëpër Bullgari për të marshuar për në Varnë. Në Varnë në nëntorin e vitit 1444 ushtria e Huniadit shpartallohet tërësisht nga forcat turke, ndërsa Huniadi arriti të shpëtonte, kurse mbreti polako-hungarez u vra.²⁶ Këtej mund të themi se në bazë të të dhënave, sunduesit serbë sundonin në një pjesë të territorit të Kosovës, me përqendrim të tyre konstant në qytetin e Novobërdës. Por, edhe ky sundim ishte marrë në raporte vasaliteti me turqit dhe se nuk ndodhi asnjë luftë siç pretendohet nga historiografia serbe kundër pushtimeve osmane gjatë tërë kësaj kohe, për ta rimarrë Kosovën. Luftërat e sundimtarëve serbë të theksuara kishin karakter të brendshëm, ndërmjet sunduesve të Rashës, të cilët luftuan ndërmjet tyre për pushtetin ekonomik dhe territorial. Nga ky vështrim del se mbretërimi i Stefan Llazareviçit s'ka qenë gjë tjetër veçse një vorbull ekspeditash ushtarake, betejash dhe rrethimesh – pa ndonjë pushtet të qëndrueshëm në trevat e Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore.

Edhe në kohën kur kemi të instaluar sundim serb në Kosovë, në këtë kohë është sundim i dyfishtë, apo mund të themi se ishin transmetues të pushteti osman, pasi që në tërësi sundimtarët serbë ishin në raporte vasaliteti, që do të thotë sa ata në këtë kohë nuk kishin mundësi që të pavarur ta sundonin Kosovën. Aq më tepër ata ishin edhe të shtyrë të përqendronin ato forca që kishin në territorin e Kosovës, pasi që viset veriore të Serbisë bashkë me qytetin si Nishin që ishte në afërsi të tyre dhe qyteti i Beogradit mbahej nën sundimin hungarez. Krejt në fund në periudhën 1389 - 1444 edhe territoret e despotatit serb, ashtu edhe territori i Kosovës, ishte nën ndikimin e rrethanave politike të asaj kohe, që në tërësi manifestohen me pushtime të shumta, nga ana e osmanëve nga jugu, dhe nga veriu nga ana e hungarezëve. Despotati serb në këtë kohë në krahasim me ta ishte shumë i dobët, dhe pa fuqi të madhe që të ndikonte në rrjedhat e kohës. Mund të thuhet se despotati serb i përballoi kohës së nënshtrimit të plotë nga osmanët deri në vitin 1455, vetëm në saxe të një largësie të dukshme gjeografike, që në

²⁵ J. Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Zagreb: Misioni katolik Shqiptar në Kroaci 2008, 379-384.

²⁶ Ibid.

krahasim me viset arbërore, të cilat u gjendën përballë sulmeve dhe qëllimeve osmane në atë kohë.

Pushtimi përfundimtar i Kosovës nga Perandoria Osmane

Me pushtimin e Kostandinopojës më 1453, nga ana e sulltan Mehmetit II (i njohur në historinë osmane si Mehmet Fatihu, Mehmet Pushtuesi), ndryshoi edhe qasja e politikës së jashtme të Perandorisë Osmane. Perandoria osmane, tani nuk zbatoi qasjen e tërthortë të sundimit përmes raporteve të vasalitetit të vendeve që i pushtonte, por kërkonte qasje të drejtpërdrejtë të pushtimit dhe administrimit. Në vitin 1445 u bë ripërtëritja e despotatit serb, që shtrihej edhe në territorin e Kosovës. Por, edhe në këtë kohë ekziston pushteti i autoriteteve osmane në qendrat e Kosovës, krahas atij serb. Sundimi i dyfishtë në Kosovë, ka përfunduar në vitin 1455, kur sulltan Mehmeti II (1451 - 1481), pasi që kishte pushtuar Kostandinopojën (1453), vendosi që në mënyrë definitive të pushtonte edhe Kosovën. Novobërda ishte shpeshherë kryeqytet i sundimtarëve vendas. Aty sundimtarët kishin pallatet e tyre. Udhëheqësit më të lartë të Novobërdës mbanin titullin vojvodë. Në cilësi të vojvodës së Novobërdës ishte, më 1434, Hrënko-ja. E në vitin 1454, vojvodë i Novobërdës ishte Llesh Spani.²⁷

Më 1454, Mehmeti II dërgoi forca të mëdha ushtarake kundër Gjergj Brankoviqit. Aty kah fundi i vitit osmanët arritën të pushtonin pjesën më të madhe të Serbisë Jugore dhe Serbisë së Mesme. Në këtë situatë të rëndë lufte në rrethinën e Novobërdës kundër forcave ushtarake osmane, popullata vendase përpiqej që në çdo mënyrë të kërkonte zgjidhje në ruajtjen e pasurive të tyre. Kështu udhëheqësi dhe mbrojtësi i Novobërdës, arbërori Llesh Spani më 27 dhjetor 1454 dërgoi në bankën e Raguzë depozitën prej 390 dukatë (me obligim që pas 20 vitesh ai do t'i tërheq këto para).²⁸ Familja Spani ishte familje e njohur arbërore e mesjetës. Pjetër Spani krahas familjeve tjera të Muzakajve dhe Dukagjinasve, përfaqësonte territorin e Arbërisë mesjetare në Kuvendin mbarë arbëror në Lezhë nën udhëheqjen e Skënderbeut 1444. Pjetër Spani me të bijtë, Lleshin, Bozhidarin, Uroshin dhe Mirkon, zotërues në luginën e Kirit pranë Drivastos (Drishtit). Spanët mbanin lidhje të ngushta me Kosovën, dhe Llesh Spani për një kohë administroi

²⁷ S. Rizaj, "Novobërda gjatë shekujve XV dhe XVI", *Vjetari XX*, (Prishtinë 1985), 115.

²⁸ Динћ, *Са историју рударству*, 64.

qytetin e Novobërdës.²⁹ Sigurisht, si rezultat i krizës së rendë të shfaqur nga sulmet osmane, shumë qytetarë të Novobërdës, tregtarë, zanatlinj dhe ipeshkëv katolikë lëshuan qytetin dhe kërkuar strehim në vende të tjera, ku një pjesë e qytetarëve është vendosur në Raguzë.

Sulmi i fuqishëm osmanë për ta pushtuar qytetin e Novobërdës erdhi në pranverën e vitit 1455, ku sulltan Mehmeti II grumbulloi në Edrene ushtrinë e Rumelisë dhe të Anadollit, dhe u drejtua për në Rumeli në Kratovë ku u prit nga bejlerbeu i saj, Isak Begu. Ai kërkoi nga udhëheqësi i Novobërdës që ta dorëzonte qytetin pa luftë. Sulmet e mëdha vazhdojnë dhe me ardhjen e sulltan Mehmetit II me forca ushtarake në Novobërdë, që sipas Kritobulit, osmanët kishin sjellë me vete edhe shumë këshilltarë profesionistë për ta realizuar me suksese rrethimin e Novobërdës. Ushtria osmane numëronte më se 50 000 ushtarë (kalorës dhe këmbësor), sipas Kritobulit.³⁰ Nuk dihet saktësisht se sa zgjati rrethimi. Sipas Kritobulit, qyteti u pushtua pas 40 ditësh të luftës, dhe sipas Ashik Pashazades, pushtimi i Novobërdës erdhi në ditën e 17 të arritjes së sulltan Mehmetit II në Novobërdë.³¹ Sidoqoftë, rrethimi zgjati disa ditë, ndoshta afërsisht 40 ditë.³²

Më në fund, më 1 qershor 1455, u bë një marrëveshje për dorëzim. Në këtë kohë ndodhej edhe vetë Mehmeti II në Novobërdë, dhe në saje të marrëveshjes, ai u premtoi banorëve se do t'u lejonte që t'i ruanin pasuritë e tyre, dhe se gratë dhe fëmijët nuk do të shndërroheshin në robër.³³ Mirëpo, sulltan Mehmeti II, nuk mbajti premtimin e dhënë. Sipas dëshmimeve, të një dëshmitari qytetar i Novobërdës, posa u dorëzua qyteti, turqit u sollën në mënyrë të vrazhdë. Sipas tij, 74 gra u rrëmbyen nga turqit, ndërsa 320 fëmijë u morën për t'u bërë jeniçerë në Anadoli. Despotati i Serbisë zgjati edhe katër vite. Më 1456 një rrethim i madh osman i Beogradit dështoi, në saje të një mbrojtje jashtëzakonisht të fuqishme të kështjellës nga Huniadi. Mirëpo, ai vdiq pak më pas nga murtaja. Nga fundi i viti 1455 vdiq edhe Gjergj Brankoviqi. Bijtë e tij u grindën për trashëgiminë e tyre. Kështu u krijua situatë e favorshme për osmanët dhe me shumë lehtësi pushtuan edhe ato pak vende që i takonin dikur despotatit të Serbisë. Qyteti i Beogradit do të mbetet në duar të hungarezëve edhe për 60 vite të tjera, kurse

²⁹ O. J Schmit, *Skënderbeu*, Tiranë 2008, 76.

³⁰ Јовановић, "Ново Брдо средњовековни град", 61.

³¹ Динћ, *Са историју рударству*, 65.

³² Јовановић, "Ново Брдо средњовековни град", 63.

³³ Malcolm, *Kosova*, 95.

Smedereva, fortessa e fundit në veri në duart e serbëve, iu dorëzua Mehmetit II pa luftë më 1459. Kjo ishte shuarja definitive e shtetit mesjetar serb.³⁴

Sipas historianëve bizantinë, Kritobulit, sulltan Mehmeti II bëri sulmin për ta pushtuar Kosovën, në vitin 1455, për shkak se despoti serb Gergj Brankoviqi nuk i paguante me rregull haraçin vjetor, si dhe për shkak se mbante lidhje të fshehta me Hungarinë. Ndërkaq, sipas, Dukës, sulltani bëri këtë sulm për arsye se dëshironte të bënte zvogëlimin e shtetit serb (despotatit serb), në mënyrë që mbretit serb t'i mbetej një territor sa ishte ai i të atit të Gjergjit, Vuk Brankoviqit.³⁵ Sipas kronistit bizantin Dukës, Novobërda është pushtuar më 1 qershor 1455 në ditën e pestë të sulmit pushtues osman. Në të osmanët kanë gjetur një sasi të madhe të arit. Pastaj osmanët kanë vazhduar me pushtimin e kështjellës së Trepçës (Tirebce). Kështjella rezistoi një ditë. Nga kështjella kanë marruar sasi të mëdha ari. Kështu osmanët pushtuan një pjesë të territorit të Kosovës (pa Rrafshin e Dukagjinit) që njëhej edhe si Vilajeti i Vëlkut. Ky pushtim ka ndodhur më 1455.³⁶

Sipas njoftimeve të historianëve osmanë si të Neshriut dhe Ibën Kemalit dhe studimeve të arritura, osmanët për pushtimin e Novobërdës ishin nisur nga Shkupi, duke kaluar nëpër Malin e Zi të Shkupit. Faktet që sjellin kronistët osmanë është se qyteti i Novobërdës është pushtuar pas ditës së pestë të rezistencës, apo edhe të shtatë të rezistencës, pas një bombardimi të madh. Nga kjo shihet se turqit, gjatë pushtimit të shumicës së qendrave të Kosovës në vitin 1455, kanë përdorur edhe armët e zjarrit, në mesin e të cilave vend kryesor kanë zënë topat.³⁷ Pushtimin e Novobërdës nga ana e osmanëve e përshkruan edhe Konstantin Mihaloviqi, nga Ostrovica.³⁸ Të dhënat që i ofron Ibni Kemali mbi pushtimin e Novobërdës, mësojmë se kjo qendër xehtare ka rënë në duart e osmanëve pas një rezistence e cila ka zgjatur pesë ditë, gjegjësisht fortifikata (kështjella) është dorëzuar në ditën e pestë të rezistencës. Kronisti tjetër osman Ashik Pasha Zadeja, bën të njohur se pushtimi i Novobërdës ka ndodhur pas shtatë dite rezistence.

³⁴ Ibid.

³⁵ Tërnav, *Diskursi shkurtër nga toponimia*, 76.

³⁶ Ibid., 81.

³⁷ Ibid., 84.

³⁸ Ky ishte bashkëkohës i ngjarjeve dhe kishte përshkruar pushtimin e Novobërdës. Ai shkruan “Edhe unë (Konstantin Mihaloviqi) që po shkruaj këtë, kam qenë në atë vend dhe bashkë me vëllezërit e mi kam qenë i marruar si jeniçerë në mesin e atyre djelmohave”, Ibid., 83.

Kronisti bizantin, Kritobuli, pohon se osmanët e kanë pushtuar Novobërdën pas një bombardimi mjaft të madh, i cili ka zgjatë katërdhjetë ditë.³⁹ Sulltan Mehmeti II, pas pushtimit të Novobërdës, më 1 qershor të viti 1455, vazhdoi të pushtonte pjesën e Kosovës. “*Gjatë disa ditëve osmanët, pushtuan pjesën jugperëndimore, Lipjanin në Kosovë, Prizrenin e vjetër më 21 qershor, Bihorin në luginën e Limës*”.⁴⁰ Megjithatë, kur dhe si ishte pushtuar Kosova nga ana e osmanëve, paraqet një problem, për shkak të kundërshtive të dhënave të burimeve osmane. Kështu, nga të dhënat e Ibni Kemalit dhe të Neshrisë mësojmë se sulltan Mehmeti II më parë ka pushtuar Novobërdën (1 qershor), mandej Trepçën, Zapllaninën, Plavën, Bërvenikun etj. Pas kësaj (sipas Neshriut dhe Ibin Kemalit) sulltani nuk kishte qëndruar më gjatë në Kosovë, pasi më vonë ishte kthyer nëpër Selanik në Jedrene. Prandaj, nëse është e saktë data e rënies së Prizrenit nën sundimin turk (21 qershor) ekziston mundësia që sulltan Mehmeti II të mos ketë marrë pjesë në atë fushatë pushtuese kundër Prizrenit. Duhet cekur se kronistët turq Neshriu dhe Ibni Kemali nuk përmendin fare pushtimin e Prizrenit, të xeheroreve dhe të vendbanimeve xehetarë. Më parë ka pushtuar Novobërdën, Trepçën, Zapllaninën, Plavën, Bërvenikun etj., ndërsa më vonë vendet tjera, ndonëse nuk e përmend pushtimin e Bellasicës.⁴¹

Rënia e Novobërdës në vitin 1455 shënon edhe fundin e kohës së famës së këtij qyteti. Në vitin 1456 u shfaq një murtajë, dhe në vitin 1459 ndodhi tërmeti i fuqishëm (apo ka mendime edhe për eksplodim të gazit të xeherores), për të mbaruar me ekzilin e popullatës. Nga ky qytet, morën rrugën e mërgimit një numër i madh novobërdasë, si në: Raguzë, Venedik, Veronë, Kotorr etj.⁴² Nga Novobërda, pos arit dhe argjendit nxirrej plumbi, zingu dhe hekuri. Nga xeheroret e Novobërdës nxirrej, përveç argjendit të bardhë (argento bianco) dhe argjendi i verdhë, me përzierje me ari i quajtur “*argjendi galam*” (argento de glama), i cili ishte shumë i kërkuar në Evropë.⁴³ Aty ku ishin xeheroret e metaleve të çmueshme gjendeshin edhe punishtet ku preheshin monedhat (zeccha). Këto monedha farkoheshin me anë të kallapëve të hekurit. Kjo prerje e monedhave kryhej nën administrimin dhe mbikëqyrjen e vojvodës së vendit dhe të doganierëve latinë-katolikë

³⁹ Ibid., 83.

⁴⁰ Ibid., 84.

⁴¹ Ibid., 85.

⁴² R. Panxha, *Novobërda gjatë shekullit XIV - XV*, (punim në dorëshkrim për Master), Prishtinë, 2010, 95.

⁴³ К. Костић, *Наши нови градови на југу*, Београд: СКЗ, 1922, 175.

(gabelloti). Prerja bëhej nga ana e artarëve (aurificës, ital, orresi), dubrovnikasë, kotorrasë dhe të novobërdasëve. Monedha e prerë në Novobërdë në shekullin XIV mbante këtë mbishkrimin “*Nouomonte monetar argentea*”.⁴⁴

Sipas shënimeve të regjistrave osmanë të vitit 1488 në qytetin e Novobërdës dhe rrethinë pas rënies së qytetit nën sundimin osman, numri i popullatës ishte afërsisht 40 000 banorë. Vetë qyteti në hapësirën e fortifikatës së qytetit të Novobërdës kishte më se 5 000 banorë, dhe popullata e saj përreth në varosh ishte afërsisht prej 35 000 banorë.⁴⁵ Filloi periudha e rënies shkallë-shkallë të këtij metropoli të kohës. Në institucionet e qytetit osmanët larguan ish- administratorët e mëparshëm qeverisës të qyteti, duke i zëvendësuar me autoritete të tjera të zgjedhur nga osmanët. Administratori kryesor ishte Subashi, dhe i pari që u zgjodh ishte Kasum Beu.⁴⁶ Me kështjellën merrej dizdari, kurse kontestet gjyqësore i trajtonte kadiu.⁴⁷ Nga shtjellimi i gjertanishëm shihet se në vitin 1455, ushtria turke e udhëhequr nga sulltan Mehmeti II, sulmoi dhe pushtoi territorin lindor të Kosovës me qytetet: Novobërdën dhe Trepçën. Është më se e besueshme se në këtë kohë kur pushtohen këto dy qendra, është pushtuar edhe Prishtina, Janjeva, Vuçitërna dhe Lipjani. Ndërkaq, Rrafshi i Dukagjinit në këtë kohë të pushtimit të pjesës lindore të Kosovës më 1455, nuk pushtohet nga turqit. Asnjë burim me të cilat disponojmë nuk dëshmon se Peja është pushtuar në vitin 1455, kur është pushtuar Novobërda, Prishtina dhe Trepça. As në defterin e viti 1451 - 1452, që përmendë pushtimin e rrethinës së Gjakovës, nuk përmendë Prizreni.⁴⁸ Dukagjinasi me synim që të ruanin dhe të forconin pozitat e tyre më 1452 hynë në marrëveshje vasaliteti me osmanët. Dukagjinasi në këtë kohë kontrollonin rrugët tregtare që sillnin të ardhura të mëdha nga qarkullimi i mallrave ndërmjet rajoneve bregdetare dhe fushave verilindore (të Rrafshit të Dukagjinit e të Fushë-Dardanisë), që ishin vazhdimisht nën kontrollin e tyre, derisa më 1455 filloi ripushtimi i rajoneve verilindore e veriore të viseve shqiptare nga osmanët.

⁴⁴ К. Лиречек, Зборник К. Лиречека I, Београд: САНУ 1959, 260-261.

⁴⁵ Rizaj, *Kosova gjatë shekujve*, 222. Skënder Rizaj konkludon se pas vendosjes së sundimit osman menjëherë nuk ka ra numri i banorëve në Novobërdë. Por, është zvogëluar në një masë, ngase një numër i konsiderueshëm janë larguar nga Novobërda.

⁴⁶ Јовановић, “Ново Брдо средњовековни град”, 63.

⁴⁷ Panxha, *Novobërda gjatë shekullit XIV-XV*, 16.

⁴⁸ Tërnavë, *Diskursi shkurtër nga toponimia*, 86.

Skënderbeu me rezistencën e famshme në mbrojtje të Krujës në vitin 1450 kundër osmanëve, arriti të ketë suksese të mëdha ndaj tendencave separatiste të disa udhëheqësve të shquar shqiptarë, si me Arianitin etj. Më e vështirë qe rruga e përfshirjes së zotërimeve të Dukagjinasve në shtetin e Skënderbeut. Deri më 1455, ku sulltan Mehmeti II filloi veprimet intensive për pushtimin e Fushë-Dardanisë e të Rrafshit të Dukagjinit, zotërimet e Dukagjinasve nuk i kishin pësuar edhe aq pasojat shkatërrimtare të sulmeve osmane, sepse ende kufizoheshin me viset e pushtuara dhe lidheshin me to me rrugët tregtare që sillnin të ardhura të rëndësishme doganore. Prandaj, Dukagjinasit veçanërisht gjatë viteve 1450 - 1455, ndoqën një politikë deri diku të ndarë nga Besëlidhja e Lezhës, dhe shtetit të Skënderbeut, duke u ofruar me osmanët për shkak të interesave ekonomike e tregtare. Skënderbeu përdori mjete të ndryshme që t'i largonte ata nga osmanët, duke kërkuar edhe ndërmjetës të shteteve të huaja, si të Papatit etj. Në vitin 1452 me angazhimin e Papa Piut II, Skënderbeu nënshkroi një akt bashkëpunimi me Pal e Nikollë Dukagjinin.⁴⁹

Sulltan Mehmeti II duke lënë Pejën të pa pushtuar u nisë kah Serbia dhe pushtoi territorin e Kopaonikut, kurse më vonë edhe Smederevën (1459). Për këtë arsye ekziston mundësia që në atë kohë Peja t'i ketë takuar domenit të Dukagjinasve, por nën vasalitetin osman.⁵⁰ Nga këto fakte dhe rrethana Rrafshi i Dukagjinit nuk ishte pushtuar në këtë kohë nga osmanët. Turqit kanë lejuar që Peja të mbetej nën pushtetin e Dukagjinasve, të cilët ishin vasal të turqve. Edhe qyteti i Prizreni ishte pushtuar gjatë vitit 1459, ndërsa Gjakova dhe 80 fshatra të rrethinës së gjerë dhe të ngushtë të saj, ishin të pushtuara dhe të regjistruara gjatë viteve 1451 - 1452. Historiani Hazimi Shabanovi, pushtimin turk të Pejës e kërkon në distancën kohore në mes të viteve 1456 - 1467, kurse Skënder Rizaj, në vitin 1462 - 1463. Konstatimi i S. Rizës konsiderohet në historiografi si mendim i qëndrueshëm.⁵¹ Me pushtimin prej turqve të Fushë-Dardanisë dhe të një pjese të Rrafshit të Dukagjinit gjatë viteve 1455 - 1462 edhe zotërimet e Dukagjinasve u dëmtuan rëndë dhe iu ekspozuan tërësisht të njëjtit rrezik. Në këto kushte Dukagjinasve i ndërprente lidhjet me osmanët dhe në fund të viteve '50 të shek. XV ata dalin të lidhur plotësisht me pushtetin qendror të Skënderbeut.

⁴⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, 428.

⁵⁰ Tërnavë, *Diskursi shkurtër nga toponimia*, 86.

⁵¹ *Ibid*, 87

Nga kjo që u tha më sipër rezulton se turqit në vitin 1455 kanë pushtuar: Novobërdën, Trepçën, Prishtinën, Janjevën, e me siguri edhe Vuçitërnën dhe Lipjanin. Mbas pushtimit të Novobërdës ishte pushtuar edhe Bellasica dhe Klina. Kurse Prizrenin njëherë e kanë pushtuar në vitin 1455, dhe nëse qe organizuar një kryengritje kundër pushtetit turk, pushtimi i tij në mënyrë definitive u bë në vitin 1459. Pushtimi i Pejës dhe të një pjese të Rrafshit të Dukagjinit në Kosovë nga turqit u arrit në vitin 1462. Kështu, treva e Kosovës ra nën sundimin turk dhe nga kjo kohë filloi perioda e pushtetit turk, që zgjati deri në vitin 1912.⁵² Gjatë pushtimit osman, qytetet e Kosovës kanë pësuar relativisht dëme të mëdha. Me rastin e pushtimit turk kanë pësuar dëme të gjitha qendrat e njohura të Kosovës, por dëmet më të mëdha i kanë përfshirë qendrat e mëdha xehetare. Me rastin e atij pushtimi, shkatërrim dhe dobësim të dukshëm kanë përjetuar edhe Trepça dhe Janjeva, kurse nga qendrat e tjera edhe Prizreni, Prishtina dhe Bellasica.

⁵² Ibid.

Bedri MUHADRI

SUMMARY

THE OTTOMAN CONQUEST OF KOSOVA IN THE 15th CENTURY

After the death of King Dusan which resulted with the fall of Raska, the economically advanced cities in Kosova: Novobërda, Trepça, Prishtina, Prizreni, Peja etc., remained partially under the Slavic reign of Stefan Lazar and Gjergj Brankoviq, whereas the western cities remained under the reign of Albanian aristocratic families such as Balshaj and Dukagjini. After the successful campaigns of Ottomans in 1427-1428 and 1441, the territory of Kosova was conquered by the Ottomans. The successful Hungarian and Polish campaigns against the Ottomans in the Battle of Nish in 1443, managed to overthrow the Ottomans from the Balkans. However, after the Battle of Varna in November of 1444, the Ottomans regained reign on the territory of Kosova. Seeing that Gjergj Brankoviq resurfaced as an Ottoman ally during this time, the Ottomans acknowledged him the right to reign over a large part of the Kosovar territory, as a vassal.

After the fall of Constantinople on the 19th of May 1453, Sultan Mehmet II in the spring of 1455 initiated a strong military operation, and managed to ultimately include a large part of the Balkans, including Kosova, under the Ottoman reign. In 1455 the Ottomans conquered: Novobërda, Trepça, Prishtina, Janjeva, Vuçitërna and Lipjan. After the conquest of Novobërda, Bellasica and Klina were conquered as well. Prizren was initially conquered in 1455, but thereafter an insurgency against the Turkish conquest erupted and as a result the Ottomans only managed to ultimately conquer it in 1459. The Turkish conquest of Peja as well as a large part of Dukagjini Plain occurred in 1462. After these events, Kosova fell under the Turkish reign which lasted until 1912.

Gjon BERISHA

“ARBANAŠKA VERA” SI KOMPONENT I KONTINUITETIT DHE IDENTITETIT SHQIPTAR

Tipari identifikues i identitetit për të gjithë shqiptarët - *gjuha shqipe* si tipar konstruktiv i qëndrueshëm dhe i pranishëm në kohë dhe hapësirë, i tillë nuk ka qenë i vetëm gjatë gjithë mesjetës, së paku jo deri në shek. XVIII. Deri në këtë shekull, statusin e tiparit identifikues për *arbërin-shqiptarin*, e gëzonte edhe *besimi*, përkatësisht riti roman-katolik. Edhe titulli i këtij punimi “*Arbanaška vera*” (feja shqiptare), ku ritin katolik të huajt (sidomos nga sllavët e jugut) e identifikonin me të qenurit *arbëror-shqiptar*, është shkëputur nga parathënia e veprës së Pjetër Bogdanit “*Cvnevs Prophetarum*”.¹ Kjo frazë e huazuar nga Bogdani, prekë, jo vetëm njërën prej temave të rëndësishme të problemit fetar, por edhe rrugën e megjullt nëpër të cilin ka kaluar emri i shqiptarëve: etnonimin *arbër/arbëresh* dhe transformimin e tij në *shqiptar*. Kjo, ka shtruar para studiuesve pyetjen nëse ndryshimi gjuhësor i këtij etnonimi ruan në përmbajtjen e vet edhe gjurmën e ndikimit të përbërëseve të tjerë të identitetit kombëtar, sidomos të ndikimit të besimeve dhe qytetërimeve të mëdha perandorake me të cilat bota shqiptare ka pasur prekje historike dhe fqinjësore.

¹ P. Bogdani, *Cvnevs Prophetarum de Christo Salvatore Mvndi, et eivs Evangelica Veritate; italice, et epirotice contexta; Et in duas Partes divisa a Petro Bogdano macedone ...*, Pars prima, Patavii MDCLXXXV, në hyrje [Te primate perpara letterarit, f.[IV].

Besimi si tipar identifikues për arbërin/shqiptarin

Në lidhje me përbërësit themelorë të etnosit shqiptar gjatë mesjetës, njëri ndër ta, ishte sigurisht, siç theksohet nga Ismajli, Myderrizi e të tjerë - *besimi fetar*, i cili te popujt ballkanikë merret si njëri ndër shënjesit bazë të identitetit etnik-kulturor përkatës: serb, malazez, bullgar = ortodoks; kroat e slloven = katolik; boshnjak = mysliman etj. Këtë funksion, para depërtimit osman dhe islamit, e dëshmon edhe shënjesi etnik mbi bazën *arbën/r* në letërsinë fetare - katolike të arealit kulturor të veriut.² Kjo bazë dëshmohet edhe në gojën e popujve fqinjë gjatë kësaj periudhe.³ Elementin katolik në shënjimin e etnisë e theksojnë edhe Jirečeku, Shufflay e Thalloczy. Sipas tyre, derisa shkruajnë për zonën e Raguzës, theksojnë se prej formës latine ose romane u formua emri sllav i kohës së mesjetës *arbanasi* (1230), duke shtuar se kjo fjalë (*arbanasi*) deri në kohët e vona, në qarkun e Raguzës e në Mal të Zi, shënon shqiptarin katolik.⁴

Kur flasim për komponentin fetar në identitetin e shqiptarëve, le të mos harrojmë pra ata qindra mijëra arbërorë që arritën të shpëtojnë gjallë dhe morën në krahë drejt Italisë jo plaçkë, por vetëm gjuhën dhe besimin e tyre. Dhe aq i fortë qe ky besim, sa pasardhësit e shkodranëve të mërguar arritën ta mbjellin kultin e Zonjës së Shkodrës deri në Genazzano, ndërsa ata të Moresë dhe Shqipërisë së Jugut ta mbajnë ritin kishtar të pandryshuar, mes një mjedisi shpeshherë armiqësor, deri në ditët tona. Lidhur më këtë, po e marrim edhe një shembull të arbëreshëve të Italisë ku riti fetar është një atribut i identitetit nacional. Binomi “*greko-arbëresh*” apo “*greko-shqiptar*” i përdorur nga N. Keta, si dhe sot e kësaj dite në Sicili, do të thotë “*shqiptar-arbëresh i ritit*

² O. Myderrizi, “Emri i vjetër kombëtar i Shqipërisë në tekstete e vjetra shqip me alfabet latin dhe arab”, *Studime historike*, 1 (1965), 164.

³ Sipas Nikollë Ketës, “... abitanti dell’Albania nostra da’ turchi vengono detti *arbanosj arnautlari gaùri*, in singolare *arbanòs arnaut gaùr*, quali in turchesco vagliano epirota cristiano = ... banorët e Shqipërisë sonë thirreshin nga turqit me emrat: *arbanosj arnautlari gaùri*, në njëjës, *arbanòs arnaut gaur*, që në turqisht do me thënë arbër/epirot i krishterë”, N. Chetta, *Tesoro di notizie su de’ Macedoni* (Palermo 1777 dorëshkrim); botues Mandalà, M. & Fucarino.Gi.), Contessa Entellina 2002, 171, cit. nga: B. Demiraj, *Shqiptar dhe shqa : histori popujsh përmes dy emrave entikë (triptik etnolinguistik)*, Tiranë: Naimi 2014, 116-118.

⁴ L. Thalloczy, K. Jireček, “Zweit Urkunden aus Nordalbanien”, *Illyrisch-albanische Forschungen*, Munchen, Leipzig, Duncker & Humblot, I, 1916, 125-126; M. Šufflay, *Historia e shqiptarëve të veriut: serbët dhe shqiptarët*, përktheu Z.Cana, Prishtinë: Rilindja, 1968, 109.

bizantin”. Në këtë rast, riti “*bizantin*”, që përdoret në kishën e tyre, është një atribut thelbësor për t’u quajtur *arbëresh*.⁵ Gjithsesi se ky atribut vjen e forcohet kur i shtojmë gjuhën, doket e zakonet e ruajtura prej shekujsh, të cilat i veçojnë nga vendasit italian.

Në kushte të tilla, kompleksi etnonimik *arbën/r* e thellon dashur pa dashur funksionin e tij si shënjesë i shtresës së besimtarëve, përgjithësisht të krishterë (ritit roman dhe bizantin) brenda etnosit shqiptar. Në kohën e ekspansionit të pushtetit dhe të kishës ortodokse sllave, ky shënjesë del më i theksuar te riti katolik dhe, sipas të gjitha gjasave, identifikohet (madje jo rrallë stigmatizohet) si i tillë edhe nga popujt fqinjë. Si i tillë ai hyri në kundërvënje direkte vetëm me shënjesët etnikë të popujve fqinjë, të cilët njëherësh identifikonin brenda etnosit shqiptar shtresat sociale me përkatësi tjetër fetare. Një shembull të tillë të identifikimit të etnisë nga arbërit katolikë, dhe përmes saj të diferencimit nga ortodoksia sllave, edhe pse me konotacion negativ apo me përbuzje, e gjejmë në gojën e sllavëve ortodoksë, të cilët, siç na pohon që në hyrje të kryeveprës së Bogdani, se: “*fesë katolike për antonomazi i thonë feja shqiptare*”.⁶ Në këtë rast, “*Arbanaška vera*” duke u përdorur si mbiemër, nuk e përjashton mundësinë që në dokumentet sllave shqiptarët të quhen edhe *latinë*, siç edhe ka ndodhur shpesh gjatë mesjetës, dhe mund të konstatohet edhe në një dokument (krisobulë) të manastirit të Shën Gjergjit afër Shkupit, më 1300.⁷ Ky diferencim mbi baza fetare (të ritit), gjatë mesjetës, ishte mjaft karakteristik edhe në Kosovë. Dokumentacioni mesjetar i lëshuar nga zyrat e mbretërisë mesjetare serbe dhe nga institucionet kishtare ortodokse sllave, që i referohen Rrafshit të Dukagjinit dhe atij të Kosovës, japin një pamje të kufizuar nga pikëpamja gjeografike dhe demografike për shkak të vetë synimeve zyrtare për të cilat ato ishin hartuar, duke i paraqitur vetëm disa fshatra që ishin pronë e disa

⁵ Xh. Skiro, “Arbri mesjetar i Epirit në burimet bizantine. Traktati etnologjik arbëror i Nikollë Ketës (1791-1803)”, *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së tij (Tiranë, 2-5 korrik 1982)*, Tiranë: ASHRPS Shqipërisë 1988, 119.

⁶ “...vece jù lufce te me fctampohej Libri, afctu chi cur te kçegne prej çeut fine te Kefce gni Chirij ndeeune ndore, per te ndrittune ate te vobek çee t’ Arbenit, e te Scerbijfse, i ffilli, e maçe pjeffe flet Arbenifct, tue kjanune dalune çeut fe Arbenit, e mbille Scenjtene Fee nde çee te Despotit: praftu Schiete per antonomaffi Feesse Cattoliche i ççone arbanaška vera”, P. Bogdani, *Cvnevs Prophetarum*, f.[IV].

⁷ “bilo da je Grk ili Bugarin, ili Srbin, Latin, Arbanasin, ... treba da daje carinu po zakonu, kao u Htetovu i u Gračanici i po svim drugim crkvama”, Ст. Новаковић, *Законски споменици српских држава средњег века*, Београд 1912, 620.

institucioneve kishtare ortodokse (si *arbanas*, *arbanaški jezik* ose *arbanaška vera*, Gj.B.). Konsiderohet se banorët e regjistruar të këtyre fshatrave janë shënuar si *arbanas* vetëm shqiptarët e ritit katolik. Shqiptari i këtushëm i ritit ortodoks, duke bërë pjesë në të njëjtin komunitet fetar dhe politik me serbët, është konsideruar dhe regjistruar, zakonisht nga zyrtarët mesjetarë si “serb = *ortodoks*” në veri, ose “grekë = *ortodoks*” në jug, ashtu siç do të ndodhë më vonë me shqiptarët myslimanë, të cilët zakonisht do të konsiderohen dhe do të quhen “*turq*”.⁸

Konteksti historik dhe kohor

Momente të tilla ku komponenti fetar doli në sipërfaqe me një rol të spikatur historik, kishte gjatë gjithë periudhës së mesjetës dhe më vonë. Varësisht prej kushteve dhe kohës kur u përdor ky rol, krishterimi (më vonë si katolicizëm) në disa raste tek iliro-arbërorët luajti rolin e mbrojtjes së identitetit të tyre nacional.

Rasti i parë në këtë drejtim ishte mesjeta e hershme, ku krishterimi i dha mundësinë arbërorëve, ashtu si edhe grekëve, të mos shuheshin nga dyndjet barbare dhe ato të sllavëve paganë.⁹ Në këtë drejtim, si tipare të reja etnike e më të rëndësishme, të formuara gjatë kësaj periudhe, krahas emrit nacional dhe deri diku si pararendës të tij ishte edhe përhapja e krishterimit, e cila u bë një fe e përbashkët për të gjithë arbërorët, viset e të cilëve njohën organizimin kishtar që herët, në shek. IV. Në periudhën e dyndjeve të popullsive sllave në Ballkan, pikërisht në një kohë kur u kërcënua seriozisht zbrëthimi i etnogjenezës shqiptare, krishterimi i iliro-arbërorëve na paraqitet si një proces i përfunduar, ndërsa vetë përkatësia fetare e krishterë u shndërrua - krahas identifikuesit gjuhësorë - në një ndër faktorët identifikues kryesorë në kulturën e tyre etnike. Kështu, tipari identifikues besimi mëton po ashtu statusin e komponentit konstitutiv, ky sidomos të paktën deri në gjysmën e dytë të shek. IX, kur sllavët e jugut, ndryshe nga arbërorët, nuk kishin përqafuar ende krishterimin. Në këto rrethana, përballë sllavëve “*paganë*” në kuptimin “*jo i krishterë*”, të cilët për një kohë të gjatë i rezistuan procesit të kristianizimit dhe kulturës greke dhe

⁸ S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek.XV-XVI (studime dhe dokumente)*, Tiranë 1983, 18.

⁹ M. Spinka, *A history of christianity in the Balkans: a study in the spread of bizantine kulture among the slavs*, Hamden, Connecticut: Archon books 1968, 10.

latine, ekzistenca e iliro-arbërorëve të krishterë, me qendra të mirë organizuara kishtare, ishte një element i qartë identifikues dhe diferencues në mes vendasve të krishterë dhe të ardhurve paganë.¹⁰ Kur themi se krishterimi i iliro-arbërorëve na paraqitet si një proces i përfunduar, nuk përjashton në asnjë mënyrë mundësinë që gjatë kësaj periudhe kohore edhe në mesin e iliro-arbërorëve të ketë patur paganë.

Rasti i dytë, lidhet me Bizantin dhe daljen në burimet e shkruar të emrit *albanoi* dhe *arbanitai*. Sikurse në perandoritë tjera të mëvonshme edhe në Perandorinë Bizantine, dallimet gjuhësore, etnografike, historike dhe antropologjike të popullsisë të ndryshme që jetonin në të njëjtin komunitet fetar e politik nuk çonin peshë. Pikërisht, arsyeja pse *albanët* janë të përmendur për herë të parë më 1043 dhe jo më herët duhet të kërkohen kryesisht në praktikën e shkrimtarëve bizantinë dhe kancelarëve, të identifikimit të njerëzve në bazë të përkatësisë fetare. Sipas tyre të gjithë banorët që iu nënshtruan pushtetit perandorak të Bizantit mbuloreshin me një emërtim politiko-ideologjik të përbashkët “*romaios*”. E njëjta praktikë është përdorur edhe me shtetasit e Perandorisë Bullgare me emërtimin “*bulgaroi*”, duke mos pasur një komunitet politik apo fetar të veçantë.¹¹ Procesi i “*shthurjes*” së Perandorisë Bizantine solli në dritë, sidomos përmes dijetarëve bizantinë, shenjat e para të një koncepti të ri të identitetit “*kombëtar*” e “*fetar*” të cilat nuk ishin më të përcaktuara nga bashkësia politike dhe fetare, por nga lidhjet gjuhësore dhe fetare.¹² Shqiptarët e mesjetës për herë të parë përmenden si të tillë (Αλβανοί) nga historiani bizantin Ataliati, i cili ndër të tjera, në një pasazh të veprës së tij, shprehë habinë për faktin se *arbërit* dhe *latinët* (Αλβανοί καὶ Λατῖνοι), të cilët deri atëherë kishin qenë qytetarë të barabartë të perandorisë (ἰσοπολιτείας), kishin të përbashkët me bizantinët edhe besimin fetar (θρησκείας), por që në mënyrën më të çuditshme u bënë armiq të tyre.¹³ Të paktën ky

¹⁰ Ibid., 11; Gj.Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shek.XI-XV*, Prishtinë: Instituti i Historisë 2015, 85-86.

¹¹ K. Frashëri, “Trojet e shqiptarëve në shek.XV”, *Studime për epokën e Skënderbeut I*, Tiranë: ASHRPS Shqipërisë, Instituti i Historisë 1989, 8.

¹² V. Tapkova - Zaimova, “L’idée byzantine de l’unité du monde et l’Etat Bulgare”, *Résumés des Communications-ler Congrès International d’Études du Sud-Est Européen*, Sofia, 1966, 228.

¹³ Sipas Ataliatit, bizantinët i konsideronin deri atëherë arbëreshët, si pjesëmarrës në sundim me të drejta të barabarta: 9 “...καὶ οἱ ποτε σύμμαχοι καὶ τῆς ἰσοπολιτείας ἡμῶν συμμετέχοντες, ὡς καὶ αὐτῆς τῆς θρησκείας, Ἀλβανοὶ καὶ Λατῖνοι ὅσοι μετὰ τὴν ἐσπερίαν Πρώμην τοῖς Ἰταλικοῖς πλησιάζουσι μέρεσι...”, 18 “...ὁ προμνημονευθεὶς Γεώργιος, ὃς Μανιάκης ἐπώνυμον, ἐκ τῆς Ἰταλικῆς ἀρχῆς ἐπαναστάς μετὰ τῶν ἐκείσε

tekst tregon se arbërorët, tani më ishin shkëputur nga bashkësia fetare e Bizantit (ritit bizantin) ose ky veprim (kalimi në ritin perëndimor) ishte në proces e sipër.¹⁴ Duke mos qenë as shtetas bizantinë, as ndjekës të ortodoksisë (kjo nuk mund të vlejë në mënyrë absolute për të gjithë banorët e Arbanonit, Gj.B.), kështu asnjë nga këto dy komponentë të kombësisë të përcaktuara nga shkrimtarët dhe kancelarët e mesjetës, sipas studiuesit K. Frashëri, *albanitët, arbanitët*, banorët e krahinës Albanon, Arbanon, si të tillë nuk ishin romej.¹⁵

Duke shfrytëzuar krizën e thellë politike që kishte kapluar Bizantin, po në këtë kohë dioqezat kishtare të Shqipërisë Veriperëndimore kishin filluar të lidheshin njëra pas tjetrës me Kishën e Romës,¹⁶ kurse feudalët e Arbanonit ishin shkëputur nga sundimi bizantin dhe nga Kisha Lindore para vitit 1043, duke mëkëmbur, sikurse feudalët e Dioklesë fqinje, një formacion shtetëror më vite. Kishin formuar pra të paktën një komunitet politik, në mos një komunitet fetar të veçantë. Si rrjedhim, për ta nevojitej një emër i veçantë etnik. Kështu, doli apelativi *albanoi* me karakter historik, nga emri i stërgjyshërve të lashtë dhe apelativi *arbanitai* me karakter etnografik, nga emri i krahinës ku banonin. Ky apelativ iu vesh vetëm pjesëtarëve të komunitetit politik e fetar që u krijua rreth e rrotull krahinës Arbanon, e cila ishte njëkohësisht një dioqezë kishtare, por mbante emrin e kryeqendrës së saj - Ipeshkvia e Krujës, e cila sipas traditës u krijua në fillim të shek. VIII, kur këto vise kaluan nga ana kishtare në varësi të Romës dhe të tre ipeshkvijtë fqinje u shkrinë në një dioqezë të vetme

συνόντων στρατιωτῶν Ῥωμαίων καὶ Ἀλβανῶν, διὰ παρόρασιν τοῦ βασιλέως ἀνιαθεῖς καὶ προηγησαμένης ἔχθρας μετ' αὐτοῦ δεδιώς,...", 297 "...εἶχε γὰρ καὶ Ῥωμαίων πολλῶν στρατιωτικόν, Βουλγάρων τε καὶ Ἀρβανιτῶν, καὶ οἰκείους ὑπάσπιστάς οὐκ ὀλίγους,...". Cfr.: M. Attaleiotae, *Historia*, recognavit Immanuel Bekkerus, ed Bonnae 1853, lib.9, 18, 297; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë II, shek.VIII-XV* (red. Kristo Frashëri), Tiranë 1962, 32.

¹⁴ A. Ducellier, "L'Arbanon et les Albanais au XIe siècle", *L'Albanie entre Byzance et Venise, Xème-XVème siècles*, London 1987, (kap.IV), 357 dhe shën.22; Xhufi, "La "debizantinizzazione" dell' Arbanon", *The Medieval Albanians*, Athena 1998, 60; Idem, "Ndarja e Shqipërisë nga Bizanti", *Studime historike*, 1-2/1999, Tiranë 1999, 24.

¹⁵ Frashëri, "Trojet shqiptare", 10-11.

¹⁶ Një lidhje të tillë të ipeshkvive arbërore me Kishën Katolike, vërehet më të madhe sidomos pas ngritjes së Tivarit në rangun e kishës metropolitane, shih: M. Šufflay "Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme", *Illyrisch - Albanische Forschungen I*, München und Leipzig 1916, 199 - 208.

katolike me emrin dioqeza e Arbanonit (dioceseos arbanensis).¹⁷ Më 1166, Arbanoni kishte një *prior* (Andreas prior Arbanensis) dhe një *ipeshkëv* (Lazarus episcopus Arbanensis).¹⁸ Edhe në këtë rast, lidhja me Kishën Perëndimore ishte një komponentë e rëndësishme, por jo e vetme, për tu dalluar nga emërimi i përbashkët për qytetarët e Bizantit – *romaios*, dhe krijimit të një identiteti të veçantë nga Perandoria Bizantine.

Rasti i tretë, ka të bëjë me krijimin e formacionit “*Regnum Albaniae*” dhe identitetin e saj. Ky fenomen vihet re gjatë gjysmës së dytë të shek. XIII, kur Karl I Anzhu i grumbulloi territoret e pushtuara në Shqipërinë mesjetare në një formacion të vetëm politik në “*Mbretërinë e Albërisë*” (*Regnum Albaniae*) me kufij më të gjerë nga ç’kishte Principata e Arbërit në kohën e arkondit të madh Dhimitër. Të lidhur më Papatin anzhuinët i favorizuan dioqezat kishtarë të territoreve të pushtuara të lidheshin me Romën dhe Kishën Katolike. Pavarësisht se “*Regnum Albaniae*” ishte krijuar nga feudalët anzhuin, për shkrimtarët dhe kancelarët e shek. XIII ajo formonte një komunitet politik e fetar më vete. Dhe duke u nisur nga ky mentalitet mesjetar, banorët katolikë të këtij komuniteti politik u konsideruan anëtarë të kombësisë *arbanite*, *albanite*, kurse, banorët jokatolikë të kësaj mbretërie, nuk u përfshinë në gjirin e kombësisë *arbanite*, *albanite*. Pavarësisht nga gjuha amtare, banori arbëror i ritit ortodoks-bizantin konsiderohej, për shkak të traditës shumëshekullore, si “*romaios*” për bizantinin, “*graecus*”, për latinin apo anzhuinin. Kur Karli I Anzhu shkruante: “*armiqtë tanë grekë*”,¹⁹ sipas prof. Frashërit, e kishte fjalën për bizantinët. Por, kur më 9 nëntor 1274 shkruante se Durrësin e kishin rrethuar kryengritësit “*albanitë dhe grekë*” (*albanenses et greci*),²⁰ ai nënkuptonte me këta dy apelativë shqiptarët katolikë dhe ortodoksë, mbasi ekzistenca e fshatarëve të gjuhës greke në zonën e Durrësit nuk vërtetohet historikisht.²¹

Rasti i katërt, ku komponenti fetar - katolicizmi ishte pjesë identifikuese e elementit kulturor-etnikë për arbërorët, ishte periudha e sundimit të dinastëve nemanjid.

¹⁷ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, college Tholloczy, L.-Jiriček, C. -Sufflay, E., vol.I, Vindobonae 1913, 116; Frashëri, “Trojet shqiptare”, 11.

¹⁸ *Acta Albaniae* I, 43 dhe 93.

¹⁹ *Acta Albaniae* I, 349.

²⁰ Ibid., 330, 332, 334; Frashëri, “Trojet shqiptare”, 12.

²¹ Ibid., 11-12.

Gjatë shekujve të mesjetës, kur sllavët përqaftuan krishterimin ortodoks të Lindjes, dhe sidomos pas pavarësimit të kishës serbe në vitin 1219, krahas antroponimisë me formë të dalluar nacionale, në trevat shqiptare dhe sidomos në zonat periferike, ku ushtruan veprimtarinë e tyre klerikët sllavë përmes kishës së tyre ortodokse-sllave, u përhap te shqiptarët edhe antroponimia sllave. Në këto rrethana, përhapja dhe fuqizimi i katolicizmit në një pjesë të shqiptarëve, përbërja arbërore e klerit katolik, i dhanë besimit katolik tiparet e një feje nacionale identifikuese që ndikoi shumë në rritjen e vetëdijes nacionale të shqiptarëve të mesjetës. Në rrethanat e një rreziku të tillë për elementin katolik në territoret shqiptare, që vinte nga sllavët ortodoksë të bashkuar me perandorët bizantinë, Papati ishte i interesuar të forconte identitetin dhe karakterin lokalo-vendor të *Regnum Albaniae*, si mbretëri e bazuar në fenë katolike.²² Futja e komponentit fetar në tërësinë e faktorëve themelorë të asaj qëndrese, që ishin ata me përmbajtje politike - shoqërore dhe etnokulturore, ndihmoi së tepërmi për shkrirjen e saj në frontin e përbashkët antiserb të fuqive katolike të Evropës.²³

Por jo vetëm kaq, për më tepër ajo bëri që Arbëria të kthehej në një bazë operacionale të Perëndimit katolik kundër ekspansionit të shtetit mesjetar serb.²⁴ S'ka dyshim që lëvizjet dhe ballafaqimet *fetare* në brezin e kontakteve shqiptaro-sllave pasqyronin, në një masë apo në një tjetër, edhe raportet e atyshme etnike. Këmbëngulja e katolikëve dhe e ortodoksëve arbërorë të ritit bizantin për të ruajtur identitetin e vet fetar, për të cilin flitet edhe në Kodin e Dushanit, ishte në radhë të parë këmbëngulja e një popullsie joserbe për të ruajtur identitetin e vet etnokulturor. Njoftimet historike të kësaj kohe hedhin dritë mbi atë konflikt të ashpër që u zhvillua në hapësirën e gjerë prej Kotorrit, në veri, e deri në Durrës, në jug, që në kuptim të caktuar përfaqësonin dy komunitete të ndryshme *fetare*, përkatësisht, komunitetin katolik dhe ortodoks. Në shërbim të zhdukjes së këtij elementi identifikues për arbërorin u vunë mbretërit e fundit të dinastisë nemanjide, veçanërisht Stefan Uroshi II - Millutini (1282 - 1321) e Stefan Dushanit (1331 - 1355). Kjo politikë e mbretërve serb, arriti kulmin e saj me Kodin e Dushanit (1349), i cili katolicizmit në perandorinë e tij i shpalli luftë të

²² *Acta Albaniae* I, 561 - 569.

²³ Jireček, *Geschichte der Serben*, Band I, Gotha 1911, 279.

²⁴ Šufflay, "Kirchenzustände", 208; P. Xhufi, "Shqipëria dhe bota mesdhetare në mesjetë (shek.XI-XV)", *Studime historike* 2, Tiranë 1990, 184.

hapur, të institucionalizuar edhe përmes Kodit të tij, ku ritin katolik e kategorizonte si “*herezi latine*”. Në nenet e veçanta të Kodit, del qartë shqetësimi i shtetit dhe i kishës serbe ndaj banorëve vendas të ritit katolik, të cilët sipas Kodit ishin të përhapur gjithandej nëpër qytete e fshatra, dhe që në këtë kohë po paraqiteshin si rrezik për pushtetin serb, meqë këta (katolikët) po ripërtëriheshin duke bërë edhe *proselitë* (të sapo konvertuar) të rinj midis popullsisë vendase. Duke i diferencuar banorët në kuadër të Mbretërisë mesjetare Serbe, në: “*besimtarë të vërtetë*”, ku sipas tyre konsideroheshin vetëm banorët e ritit ortodoks pravosllav (serbët); në “*mosbesimtar*” dhe “*heretik latin*”,²⁵ për të krishterët vendas të ritit katolik nën pushtetin serb, etj., dhe kur këto dispozita nuk vlenin për banorët e huaj (sasët, kottorrasit dhe raguzanët), vetvetiu del se *target* i tyre ishin banorët katolikë arbërorë, sidomos ata të viseve të Kosovës, Zetës dhe Maqedonisë Perëndimore.²⁶

Viset shqiptare të Zetës, Kosovës, Maqedonisë dhe ato të Shqipërisë së sotme të Veriut, që në kohë të ndryshme hynë nën pushtimin serb, përfaqësonin në fakt brezin që sipas një letre të Papa Benediktit XI, drejtuar argjipeshkvit të Tivarit, Marinut “*ushtrohej feja katolike dhe ku ruhej riti i kishës së Romës*”.²⁷ Pikërisht në këtë brez, burimet përmendin ekzistencën e vazhdueshme të ipeshkvijve dhe famullive katolike në Bëreskovë, Rogoznë, Trepçë, Janjevë, Graçanicë, Prizren, Novobërd, Patkovë (afër Gjakovës), Prishtinë, Shkup etj.²⁸ Në këto vise të kontakteve me arbërorë-sllavë, të qenurit katolik, përkonte pothuajse tërësisht me të qenurit arbëror (shqiptar). Fakti i të qenurit kisha e vetme e besimit roman në Ballkan, nëse përjashtojmë zonat e largëta të Kroacisë dhe Dalmacisë, ajo konsiderohej si një pengesë për asimilimin e tyre. Studiuesi serb, Bogdanoviq me të drejtë pohonte se elementi katolik në këtë brez ishte parë si pengesë për përfshirjen më të

²⁵ Cfr.: nenet 6, 7, 8, 9, 10, 77, 82, te Ст. Новаковић, *Законик Стефана Душана Цара Српског 1349. и 1354* (Издање задужбини Илије М. Коларца, 91.), Београд: Штампано у Државној штампарији 1898, 11, 174, 176-177, 153-155, 192, 195.

²⁶ Berisha, *Arbërorët*, 428-434.

²⁷ “*ubi fides catholica colitur et ritus Romane ecclesie observatur*”, *Acta Albaniae* I, 552; Xhufi, “Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe”, 101.

²⁸ A. Theiner, *Vetera monumenta Historica Hungariam sacram illustrantia. Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis*. Tom.I (1216-1352), Romae: Typis Vaticanis 1859, dok.649, 1061; Idem., *Vetera monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia* (Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis), Tom. I, (1198-1549), Romae 1863, dok.45; *Acta Albaniae* I, 489, 552; II, 20; Д. Ковачевић-Којић, “Приштина у средњем веку”, *Историјски часопис* XXII, (1975), 46; Xhufi, “Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe”, 101.

gjerë të arbërorëve në shtetin e “*vërtetë*” serb. Sipas tij, në brezin e kontakteve arbërore-sllave, si p.sh. të Zetës, katoliku identifikohet me arbërorin (shqiptarin).²⁹ Megjithatë, kur Bogdanoviq, gabon kur në mënyrë absolute e identifikon ortodoksin vetëm me serbin, duke mos llogaritur së një pjesë e qytetarëve vendas arbëror i takonin edhe ritit ortodoks bizantin.

Rasti i pestë, përkon me titullin e punimit dhe i takon periudhës së sundimin osman, përkatësisht luftës së Pjetër Bogdanit dhe bashkëkohësve të tij në dy kahje: kundër përpjekjeve të Perandorisë Osmane dhe Patrikanës së Pejës për asimilimin kulturor-etnik të shqiptarëve. Qysh më 8 nëntor 1677, kur konçistori i papës e transferoi Bogdanin prej Ipeshkvisë së Shkodrës te kisha metropolitane e Shkupit (argjipeshkëv i Shkupit dhe administrator i gjithë Serbisë), ai u ndesh me probleme dhe pengesa të vazhdueshme që i vinin, përveç tjerash, nga kleri dhe kisha ortodokse serbe. Posa arriti në Shkup, Bogdani u detyrua të përballohej më një armik, patrikun e Pejës, i cili haptas doli si kundër Bogdanit ashtu edhe kundër katolikëve në përgjithësi. Në fakt, lufta e ortodoksisë serbe kundër shqiptarëve është e lidhur me ripërtëritjen e kësaj Patrikane në vitin 1557, e cila u krye përmes një fermi të lëshuar nga sulltan Sulejmani II, në sajë të përpjekjeve të vezirit të madh Mehmet Pashë Sokoloviqit.³⁰ Bazuar në traditën e Serbisë mesjetare, Patrikana e Pejës është perceptuar gjerësisht, veçanërisht nga serbët e krishterë ortodoksë në Kosovë, si një vazhdim strukturor i Serbisë mesjetare; duke qenë bazë e funksioneve financiare dhe gjyqësore u bë instrument me funksion politik, fetar dhe etnik për serbët në njërin anë, kurse në anën tjetër, një mekanizëm në shtypjen dhe asimilimin e popujve të tjerë jo serb. Katolicizmi i shqiptarëve, sipas Bogdanoviqit, nga Selia e Shenjtë në Romë shihej si shtyllë e rëndësishme, dhe si të tillë, katolikët shqiptarë konsideroheshin, pikërisht fije që lidhin veprimtarinë e Kongregatës në Ballkanin Qendror. Si qendra të forta të katolicizmit, të cilat konsideroheshin të dëmshme për serbët, ishin qytetet shqiptare të Prizrenit, Gjakovës dhe Shkupit.³¹ Duke e konsideruar katolicizmin si element të rrezikshëm për kishën dhe popullin serb, Patrikana e Pejës mori detyrën e konvertimit

²⁹ “Срби и Албанци су тада у тој области још увек хришћани, први - православни, други – католици”, Д. Богдановић, *Књига о Косову*, Београд: Књижевне новине 1990 72-73.

³⁰ A. Hüdal, *Die serbische-kirchen Nationalkirche*, Graz und Leipzig: Verlag 1922, 28.

³¹ Богдановић, *Књига о Косову*, 106.

dhe asimilimit të tyre. Kështu, qendër e propagandës ortodokse ndër shqiptarë në viset e Kosovës së sotme por edhe më gjerë, ishte Patrikana e Pejës.

Siç u përmend më sipër, Pjetër Bogdani na njofton se sllavët e dinin shumë mirë se në ato vise të ishe katolik do të thoshte të ishe etnikisht shqiptar. Në fakt, në mesin e shek. XVIII, feja katolike në viset nën juridiksionin e Patrikanës së Pejës, ishte strehuar vetëm në popullsinë shqiptare. Pikërisht, këtu e ka burimin pohimi që bënë Pjetër Bogdani në parathënien e veprës së tij se sllavët me konotacion negativ, fesë katolike i thonë *fe e shqiptarëve*.³² Se katolikët e Kosovës ishin shqiptarë, e pohojnë edhe relatorët e Papatit gjatë shek. XVII. Gjergj Bardhi gjatë vizitave që bënte këtyre trevave gjatë viteve 1637 - 1638, disa herë e përsëritë pohimin se: “*të gjithë katolikët e Kosovës janë shqiptarë dhe flasin po në atë gjuhë*”.³³ Pas një viti të rivendosjes së Patrikanës së Pejës (1557), patriku i ri, Makarie, kishte siguruar një *firman* (dekret) perandorak sipas të cilit të gjithë të krishterët në territorin e tij duhej të paguanin taksa kishtare.³⁴ Në vitin 1662 priftërinjtë katolikë i janë drejtuar papës përmes misionarit Cezar Roza duk i bërë me dije se patriku i Pejës “*il Patriarca di Pech scismatico*” ka marrë nga sulltani autorizime me të cilat të gjithë katolikët e Turqisë vihehin nën pushtetin e tij. Shqiptarëve katolikë u ishte ndaluar që t’i drejtoheshin për ndihmë Romës, duke i kërcënuar se nëse e bëjnë një gjë të tillë, do të dënoheshin ashpër.³⁵ Në këto kushte, s’është për t’u

³² Bogdani, *Cvnevs Prophetarum*, [f.IV].

³³ “*tutti questi luoghi sopra nominati sono Albanesi e parlano le istessa lingua*”, Arch.Prop. Fide, Vis. Coll. vl.16, fl. 241v-242 (AIH, A-III-222, dok.21-22); I. Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëll.II (1963-1965), Tiranë 1965, dok.27, f. 100.

³⁴ “*...Jo gionsi poi in Scopia, dove uno sacerdote Raguseo, vicario del Reverendo Arcivescovo d'Antivari mi venne a trovar et disse, ch'uno Patriarcha di Servia, Greco, nuovamente creato per favor d'uno suo barba, che e bassa, havea ottenuto dal Signor Turco un commandamento, che tutti li christiani..., per l'uso delli sacramenti, che da anime 4 m., che sono li sudditi del Signor, che vivono alla romana, potria importar 1500 cechini all'anno, pero ch'essendo questa cosa novissima et principio di far sottomettere tutti questi poveri catholici a poco alla Chiesa greca, che volesse io a Constantinopoli procurare per l'amor de Dio la revocatione di questo commandamento....*”, V. Lamansky [ed.], *Secrets d'Etat de Venise: documents, extraits, notices et études servant à éclaircir les rapports de la Seigneurie avec les Grecs, les Slaves et la Porte ottomane à la fin du XV^e et au XVI^e siècle*, Saint Petersburg 1884, dok.5, shtojca f.064.

³⁵ J. Радонић, *Римска курија, Римска курија и јужнословенске земље: од XVI до XIX века* (САН. Посебна издања књ. 155), Београд, 1950, passim

befasuar kur hasim në shumë shprehje të armiqësisë së hapur ndërmjet hierarkisë së Kishës Ortodokse dhe Kishës Katolike - sidomos nga priftërinjtë katolikë, të cilët herë pas here ankoheshin se ata ishin më të shtypur nga ortodoksët sesa nga myslimanët.

Nga kjo periudhë ka mbetur edhe një letër e Andrea Bogdanit e dërguar më 1 nëntor 1664 nga Janjeva, Kongregatës në Romë, në të cilën ai ankohej shumë për këtë çështje duke pohuar se “*ortodoksët janë armiq të tërbuar të katolikëve njësoj si turqit*”.³⁶ Ndonëse këto konsiderata të Andrea Bogdanit për ortodoksinë përcjellin një dozë fanatizmi fetar, gjë që nuk i gjejmë të shprehura në këtë masë te nipi i tij Pjetri e të shumë klerikë të tjerë katolikë, ato mund të jenë shkaktuar nga presioni i Patrikanës në fjalë, e cila në njërën anë bënte presion mbi klerin dhe banorët e ritit katolikë, dhe në anën tjetër pretendonte të mbante primatin mbi të gjithë ortodoksët e trevave të pushtuara, pa marrë parasysh etninë e tyre. Prandaj, ky pohim i përgjithësuar i Andreas, nuk na mundëson të jemi të sigurt nëse i përfshinë të gjithë ndjekësit e ortodoksisë duke përfshirë edhe shqiptarët e këtij riti. Më tej, për Janjevën thoshte se patriku serb i Pejës (*risiede il patriarcha di Pechina*), i cili e kishte selinë në manastirin e afërt të Graçanicës, vetëm një milje larg Janjevës, përpiquej t’i zhdukte katolikët. Patriku i detyronte katolikët që t’i paguanin tributin prej njëqind *talirash* dhe i konsideronte ortodoksët - të cilët, shtonte ai, ishin të mbrojtur nga turqit, si armiq të më të egër të katolikëve.³⁷ Pothuajse e njëjta ankesë, përsëritet nga argjipeshkvi shqiptar i Shkupit Andrea Bogdani më 10 gusht 1670 po nga Janjeva, ku bëhej me dije se banorët katolikë detyroheshin që t’i paguanin çdo vit patrikut një taksë të caktuar “*una certa tassa di denari*”, që të mos i detyronte ata me anë të pushtetit turk që të konvertoheshin në skizëm, “*essendo potentissimo nelle ricchezze a sono delle quali i Turchi ballano per tutti li tasti*”. Prandaj, në kohën kur katolikët gjendeshin të kërcënuar nga patriku serb, prania e

³⁶ “*Non hà la Religione Cattolica inimici più Capitali in queste parti, et à pari con Turchi, quanto i Scismatici, delli quali abonda questo Regno per esser stato de loro Despoti, avanti, che fosse soggiogato dal Turco, il quale per esser della descendaza di Marilla figlia di Giorgio Despote data ad Amurate Rè de Turchi per moglie molto li protegge*”, J. Marlekaj, Marlekaj, Pjetër Bogdani e Shqipnia e kohës së tij: me riprodhim fotografik të njëqind e tridhjetedy dokumentave, Shkodër: Botime Françekane 2008, 142.

³⁷ Ibid., 342.

argjipeshkvit katolik, Bogdanit në Janjevë, konsiderohej e dobishme “*per stara al fronte al patriarca greco con li suoi vescovi e preti*”.³⁸

Kështu, për shkak të qëndrimit të tij armiqësor ndaj katolikëve shqiptarë, argjipeshkvi Bogdani e konsideronte despotin serb, si: “*inimicissimo della Sede Apostolica*”.³⁹ Për më tepër, marrëdhëniet me kishën serbe po acaroheshin në një kohë kur presioni i administratës osmane kundrejt shqiptarëve po shtrëngohej në kulm.⁴⁰ Kjo formë e presionit ndaj shqiptarëve katolikë nga kisha ortodokse serbe, vazhdoi edhe në vitet në vijim. Më 1678, patriku i Pejës, për të cilin thuhej se banonte në Janjevë, u kishte shpallur luftë klerikëve dhe popullsisë katolike të Shkupit dhe të tërë Kosovës, duke u marrë taksa të larta vjetore. Sipas Pjetër Bogdanit, patriku serb, me ndihmën e autoriteteve turke, përshkonte vendin për të mbledhur grurin, duke u sjellë si një tiran faraonik “*sua faraonitica tirania*”. “*Ai kishte urdhëruar mbylljen e kishave të ritit katolik dhe kishte penguar zhvillimin e kremtimeve fetare*”.⁴¹

Koha dhe arsyet e ndërrimit të emrit etnik *arbën/r* në atë *shqiptar*

Meqë emri *shqiptar* është më i ri se ai *arbën/r*, para studiuesve ka shtruar problemin e faktorëve dhe motivin që ndikuan në futjen në përdorim të emërtimit të ri (shqiptar). Duk mos u marrë shumë me aspektin e përcaktimit gjuhësor (meqë është fushë e ngushtë e gjuhëtarëve) të vetë emërtimit *shqiptar*, sikurse në aspektin leksikorë, ashtu edhe në atë morfologjik e semantik, në rastin tonë, do të mundohemi t’i trajtojmë rrethanat historike që ndikuan në ndërrimin e emrit. Problem mbetet gjithsesi, se cila dukuri sociale ka nxitur e dhënë shtysën kryesore procesit të ndërrimit të emrit etnik. Në mënyrë të veçantë më këtë problematikë janë marrë studiuesit, Osman Myderrizi,⁴²

³⁸ Ibid, 347; M. Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime: studime etnografike*, Tiranë 1982, 332.

³⁹ Радонић, *Римска курија*, 347.

⁴⁰ Më 3 janar 1669, në vitin e fundit të luftës veneto - osmane të Candies, Pjetër Bogdani, i cili qëndronte më tepër në male se në Shkodër, i shkruante Kongregatës se këtë radhë jeta e tij ishte me të vërtetë në rrezik “*ma io che sto in un posto pericolosissimo della mia vita ho paura che questa volta actum sit de me*”, Радонић, *Римска курија*, 389.

⁴¹ Marlekaj, *Pjetër Bogdani e Shqipnia e kohës së tij*, 141.

⁴² O. Myderrizi, “Emni i Shqipnis në kohën e mesme”, *Hylli i Dritës*, 4 - 5, 6 - 8 (1943), 122-136, 231-239; Idem, “Emri i vjetër kombëtar”, *Studime historike*, 1 (1965).

thelluar më pas nga Kristo Frashëri,⁴³ Eqrem Çabej,⁴⁴ Rexhep Ismajli,⁴⁵ Engjëll Sedaj⁴⁶ dhe vazhduar së fundmi nga Bardhyl B. Demiraj⁴⁷ e ndonjë tjetër, të cilët përcaktojnë si një nga shënjesit kryesorë të identitetit etnik *besimin fetar* për periudhën e parë të formimit të etnosit shqiptar si dhe për ruajtjen e tij gjatë gjithë mesjetës.

Përgjithësisht, autorët që janë marrë me këtë problematikë: me procesin e zëvendësimit të emrit etnikë *arbën/r* në atë *shqiptar*, këtë proces e lidhin me ndryshimin e rrethanave socialo-politike mbas pushtimeve osmane dhe depërtimit të islamit në vend dhe në kushtet e shumësisë së besimeve fetare, sipas autorëve, përkatësia fetare erdhi duke e humbur rëndësinë si përbërës themelor i identitetit etnik-kulturor. Në lidhje me këtë proces, do të mjaftohemi me vijëzimin e mendimeve të disa prej studiuesve. Përkitazi me çështjen e faktorëve dhe motiveve kryesore të ndërrimit të etnonimit, Çabej shprehet se: “*zhdukja e zëvendësimi*” i emrit *arbën* me *shqiptar* ka të bëjë “*me zbërthimet etnike që u kryen me ardhjen e osmanëve...*”,⁴⁸ por duke mos e shtjelluar gjerësisht këtë mendim se si është imponuar ndërrimi në proceset historike-shoqërore. Albanologu R. Ismajli, këtë problem e shqyrton, kryesisht në kombinimin e një vargu ndryshimesh - sigurisht të brendshme - sociale, politike, ekonomike dhe kulturore që përjetoi populli shqiptar në periudhën e krijimit të vetëdijes kombëtare, sidomos gjatë procesit të krijimit të kombit. Sipas tij, shek. XVIII kishte sjellë një varg ndryshimesh socialo-politike, si rezultat i kontakteve tregtare me Perëndimin, posaçërisht me vendet bregdetare. Këto kontakte ndikuan në ngritjen e vetëdijes se këta njerëz, që besojnë në tri besime, e prandaj kanë edhe ndryshime të tjera, kanë diçka të përbashkët më të rëndësishme: flasin të njëjtën gjuhë dhe kanë zakone të përbashkëta. Gjithnjë, sipas tij, kësaj i ndihmoi shumë vetëdija e imponuar nga turqit se *arbën/r* lidhet me diçka që ka qenë në të kaluarën dhe që lidhet me të sotmen vetëm me shqiptarët e krishterë.⁴⁹ Studiuesi O. Myderrizi, i cili

⁴³ Frashëri, “Trojet e shqiptarëve”, 7-21.

⁴⁴ E. Çabej, *Sudime etimologjike në fushën e shqipes II*, Tiranë 1976.

⁴⁵ R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit (1706): studime mbi grafinë, fonetikën-fonologjinë dhe tekstin e Kuvendit*, Prishtinë: Rilindja 1985.

⁴⁶ E. Sedaj, *Etnonimi arbëresh shqiptar: (kontribut për autoktoninë e shqiptarëve)*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1996.

⁴⁷ B. Demiraj, *Albanian - Shqiptar*, Tiranë: Naimi, 2010; Idem, *Shqiptar dhe shqa*, 105 - 129.

⁴⁸ Çabej, *Studime etimologjike II*, 65.

⁴⁹ Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit*, 229 - 230.

është marrë me arsyet dhe motivin e ndërrimit të emrit, këtë proces e lidhë me procesin e ndërrimit të besimit fetar ndër shqiptarë, duke i mbetur gjithnjë besnik mendimit, se: *“Emri i vjetër [arbën/r, Gj.B.] nuk tregonte vetëm kombësinë, por edhe besimin. Me ndërrimin e besimit u ndje nevoja edhe e ndërrimit të emrit nacional. Emri i ri shqiptar, që u adoptua si emër kombëtar, bazohej në gjuhën, në një nga elementët kryesorë të kombësisë”*.⁵⁰

Me disa ndryshime të vogla, përgjithësisht, mund të vihet në përfundim se ky proces u krye me ndryshimin e rrethanave politike e sociale, të cilat erdhën si pasojë e pushtimeve osmane dhe procesit të islamizimit të popullsisë. Me kalimin në fenë islame, ishte humbur një pjesë e komponentit të identitetit nga mozaiku etnik *arbën/r* - besimi, i cili deri në atë kohë, së bashku me gjuhën ishte element identifikues. Në kushte të tilla, emri etnik i përbashkët *arbën/r*, nuk përfshinte të gjithë shqipfolësit. Aq më tepër kur shqiptari i këtushëm i besimit islam, duke bërë pjesë në të njëjtin komunitet fetar dhe politik me turko-osmanët, është konsideruar, zakonisht nga zyrtarët por edhe nga kancelaritë perëndimore si *“turk”*.⁵¹ Edhe Z. Shkodra do të shprehet se *“meqenëse islamizimi nuk e dallonte fenë nga kombësia, përpiquej që muhamedanët shqiptarë t’i konsideronte si turq”*.⁵²

Këtij “argumenti” i kishte trumbetuar edhe vetë Perandoria Osmane me konceptin që ajo kishte mbi kombësinë dhe identitetin kombëtar të një populli. Perandoria Osmane si shtet teokratik islamik vazhdonte ta llogariste fenë si përbërës të identitetit etnik, madje, si përbërësin kryesor, për më tepër, si përbërësin absolut të identitetit të një populli. Ajo vazhdonte të mbronte me çdo kusht konceptin anakronik mesjetar mbi kombin, ndonëse historia kishte vulosur dështimin e plotë të tij. Në Perandorinë Osmane vazhdonte të mbisundonte koncepti sipas të cilit, të gjithë myslimanët që bënë pjesë brenda kufijve të saj, pavarësisht nga gjuha, nga traditat, nga historia e tyre, po të kishin përqafuar fenë islame, duhej ta konsideronin veten pjesëtarë të kombësisë osmane (osmanli millet). Për analogji, nga rrethi i “kombësisë osmane” përjashtoheshin vetëm të krishterët dhe çifutët. Të krishterët që banonin brenda kufijve të Perandorisë ndaheshin sipas saj, në dy kombësi: ortodoksët, duke përfshirë edhe shqiptarët, në bazë të

⁵⁰ Myderrizi, “Emri i vjetër kombëtar”, 164.

⁵¹ Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, 18.

⁵² Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare: shekujt XV - XX*, Tiranë: ASHRSH, Instituti i Historisë 1973, 51.

marrëveshjes së lidhur në vitin 1454, midis sulltan Fatihut dhe Patrikut të Kostandinopojës, konsideroheshin *rumë* (rum millet), në vështtrimin e kombësisë bizantine, me nënkuptimin e kombësisë greke. Katolikët, përfshirë edhe shqiptarët, përkundrazi trajtoheshin si pjesëtarë të kombësisë latine (latin millet), në vështtrimin e banorëve evropianë të varur fetarisht nga Roma. Pikërisht, ky diferencim që zbatonte Porta e Lartë ndaj popullsisë së saj peshoi rëndë mbi perceptimin që formuan disa të huaj mbi identitetin kombëtar shqiptar.

Nëse i referohemi disa prej dokumenteve perëndimore dhe një pjesë të historiografisë së huaj ku shqiptarët myslimanë i emërojnë me fjalën “*turk*”, duke u nisur nga përcaktimet fetare, për një lexues të huaj që nuk i njeh mirë rrethanat historike shqiptare është e vështirë të kuptohet nëse këtu është fjala për kategori etnike, politike apo thjeshtë fetare. Fjala “*turk*” si emërues për shqiptarin mysliman, jo rrallë herë është keqpërdorur e manipuluar nga studiues të ndryshëm duke luajtur me shifra të popullsisë. Megjithatë, autorët shqiptarë të shek. XVI - XVIII, për dallim nga të huajt, e kishin shumë të qartë këtë fjalë dhe dinin të bënin dallim në mes “*turqve etnikë*” (Turchi nazionali) dhe “*turqve shqiptarë*” (Turchi Albanesi). Kështu, në vitin 1623, Pjetër Mazreku i raportonte Romës se prej 12 000 “*turqve*”, që jetonin në atë kohë në Prizren, “*thuajse të gjithë janë shqiptarë*”. Edhe Pjetër Bogdani, i quante myslimanët shqiptarë “*bashkëkombas*” (conazionali), duke mos harruar të kujtojë edhe dashurinë që ekzistonte mes tyre e të krishterëve dhe që shpesh rridhte e përforcohej nga lidhjet familjare që ekzistonin mes njeri-tjetrit.⁵³ F. Bardhi (1635), duke shkruar për themeluesin e “*qytetit të ri ose Dukagjinit nga një turk*”, thekson në mënyrë të veçantë emrin e themeluesit, Bulolit si *shqiptar* (Epirota nomine Buloli),⁵⁴ duke ia njohur vlerën e tij nacionale, ndonëse deklarohej “*turk*”. Në këtë pikëpamje, ilustrues është edhe ajo që shkruan P. Budi se “*qesh lutur shumë herë nga disa të mëdhenj të atyre popujve të Shqipërisë dhe veçanërisht nga dy turq* (da doi Turchi

⁵³ I. Zamputi, *Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të mesme në shek. XVII*, vëll. I (1610 - 1634), Tiranë: USHT-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1963, 336; P. Xhufi, “Turq që luftojnë kundër turqve”, *Studime historike* 3 - 4 (2014), 32 - 33.

⁵⁴ Franciscvs Blanchvs [F. Bardhi], *Dictionarivm Latino-Epiroticvm*, Romae: Typis Sac.Congr.de Propag. Fide. 1635, 197 (Ciuitas noua, siuè Ducagina aedificata his nostris temporibus in arduis, asperisque Albania montibus à Turca quodam Epirota nomine **Buloli**, Ducaginarum Pæfecto, velit Turicico more dicamus, Sanzacho, Città noua, ò Ducagini, Gytetia e ree, oò Ducagin.)

Principali) *farefis të mi shumë të ngushtë*”,⁵⁵ duke treguar afrinë nacionale edhe për ata që ishin larguar në mënyrën e jetesës duke praktikuar zakonet e turqve.

Meqë ndryshimet politike e ideologjike që pasuan pushtimin osman i sollën dëme unitetit psikiko-kulturor të etnosit shqiptar,⁵⁶ u bë e domosdoshme dhe jetike që besimi fetar duhej t’i linte vendin gjuhës amtare, e cila - krahas hapësirës jetike kompakte dhe traditave jetësore - u shndërrua në përcaktuesin thelbësor brenda bërthamës së kulturës etnike mbarëshqiptare. Nga *gjuha shqipe* si zgjedhje pragmatike mbijetese u krijua emërtimi gjithëpërfshirës etnik *shqiptar*. Megjithatë, ruajtja e gjuhës dhe unitetit etnik të territorit shqiptar që ishin faktorë konvergjent nga më të rëndësishmit, shërbyen për të përballur me sukses kërcënimin e shpërbërjes së tij.⁵⁷ Emërtimi *shqiptar* ishte i vonë, pra pas pushtimeve osmane dhe përhapjes së islamizmit, dhe disi i huaj për të gjitha shtresat e popullsisë, e nuk njihej jo vetëm në përdorimin e jashtëm, por as në gjuhën letrare për një kohë të gjatë.

Në aspektin kohor, emrin “*shqiptar*”, e ndeshim në fjalorin e Francesco Maria da Lecces (1702) “*...oh shqipetâr i dashun, e shkrova jo per zotin tande...*”, dhe materialet e Kuvendit të Arbenit të vitit 1703 “*a dine mire gjuhën e shqiparëvet*”, kurse në formë ndajfolje prej Buzukut (1555) e këndej, duke kaluar një rrugë krejtësisht tjetër nga rruga që ecte emërtimi *arbën* apo *arbënesh*.⁵⁸ Buzuku, Budi e Bogdani nuk e njohin etnonimin në variantin *shqiptar*, por vetëm ndajfoljen *shqip*, të cilën L. Matranga nuk e njeh fare.⁵⁹ Se etnonimi *shqiptar* është i ri, rasti më i dukshëm është me shqiptarët e Italisë të cilët jo vetëm nga vetë ata, por edhe shqiptarët tjerë i quajnë *arbëreshë*.⁶⁰ Arbëreshët e Greqisë, që ishin më numerikë dhe kufizoheshin me shqiptarët brenda kufijve të Shqipërisë, e nuk e njohin emërtimin *shqiptar* dhe *Shqipëri*, do të jenë dëshmi edhe më e bindshme se ndërrimi i etnonimit është bërë pas shpërnguljes së tyre. Madje edhe ata të Zarës, të shpërngulur e

⁵⁵ *Dokumente të shek. XVI - XVII për historinë e Shqipërisë* III (përg. I. Zamputi), Tiranë: ASHRPSH, Instituti i Historisë 1989, 378.

⁵⁶ S. Naçi, “Faktorët konvergjentë dhe divergjentë në zhvillimin e popullit shqiptar në shek. XVI - XVIII”, *Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar*, 159.

⁵⁷ Ibid.

⁵⁸ Demiraj, *Shqiptar dhe shqa*, 107 - 108.

⁵⁹ Sedaj, *Etnonimi arbëresh - shqiptar*, 99.

⁶⁰ Dora d'Istria, *Fylétia e Arbenoré prëj Kanekate Laoshima*, enkethyeme ne shkjipte perej Dimitri Camarda, Livurne: P. Vannini, 1867; Sedaj, *Etnonimi arbëresh shqiptar*, 96.

të ikur nga turqit shumë vonë dhe të vendosur në Arbanasi afër Zarës (në atë kohë *Borgo Erizzo*) në vitin 1726 dhe më herët,⁶¹ quhen me të njëjtin emër, sikurse edhe arbëreshët e Bullgarisë, të Sremit (Kelmendasit), etj. Ky qëndrim përputhet edhe me zhvillimin historiko-gjuhësor dhe me kohën e aktivizimit të këtij emërtimi, kështu që *Arbneshi* i Zarës, për shkak të kohës më të vonshme të shpërnguljes, është në një mënyrë, edhe më ilustrativ se arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë.

⁶¹ Për arbëreshët e Zarës, shih: T. Erber, *La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara*, Dubrovnik, 1883; M. Ćurković, *Povijest Arbanasa kod Zadra*, Šibenik, 1922; K. Krstić, *Doseljenje Arbanasa u Zadar*, Zadar, 1988; N. Karuc, *O zadarskim Arbanasima*, Zadar, 1985; A. Stipčević, *Kultura tradizionale e Arbanasëve te Zarës*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës 2012.

Gjon BERISHA

SUMMARY

“ARBANAŠKA VERA” AS A COMPONENT OF THE ALBANIAN IDENTITY AND CONTINUITY

The study treats the historical and social circumstances of the religious element (Christianity) which served as one of the main identifying elements for the Albanians during medieval times, alongside the Albanian language. Until the 18th century, the main identifier for the medieval Albanians (*arbër-shqiptar*) was their religious denomination, namely the Roman-Catholic rite. The title of this paper “*Arbanaška vera*” (The Albanian Religion), has been adopted from the preface of Pjetër Bogdani’s “*Cvnevs Prophetarum*”, which depicts the name with which the Southern Slavs referred to the Albanians according to the latter’s adherence to the Roman-Catholic Church. As such, this component played an important part in preserving the Albanian identity and ensuring its ethnical continuity from the Illyrian-Arbëror to the Albanians during medieval times. Christianity among Albanians served as a differentiating element from the foreign ethnicities starting from early medieval times, where Christianity served initially as a differing element from the pagan Slavs; during Byzantine period, in particular from the 11th century, when it differed from *arbëror* of the western rite, which helped them secede from the Orthodox Byzantine Empire.

The religious element was closely related to the variation of the ethnonym *arbën/r* and the emergence of the name Albanian (18th century), a process which resulted from the Ottoman conquest and the introduction to a new religion, Islam. In the circumstances where there were Albanians pertaining to three religions, the religious component in light of existential troubles, paved the way for the Albanian language to become the unique cultural-ethnic identifying element for Albanians. Thereafter, the name Albanians served to distinguish from those who had migrated after the Ottoman conquests, whereas the foreigners preserved the former Albanian ethnonyms such as *arbëresh*, *arbën*, *arbëror*, *Albanian* etc.

Hasan BELLO

**KONTRIBUTI I DR. IBRAHIM TEMOS PËR REFORMIMIN E
SISTEMIT ARSIMOR OSMAN**

Një personalitet me origjinë shqiptare, që ka lënë gjurmë në historinë politike dhe në mendimin pedagogjik osman është edhe dr. Ibrahim Temo. Ai u lind më 21 mars të vitit 1865 në qytetin e Strugës, në lagjen “Murat Çelebi”.¹ Pasi mori arsimin fillor në qytetin e lindjes, në vitin 1884 ai shkoi në Stamboll ku u regjistrua për të vazhduar studimet në Fakultetin Ushtarak të Mjekësisë (*Askeri Tıbbiye-i Şahane*). Gjatë viteve të studimit, ai ra në kontakt me figura të njohura të kohës, disa prej të cilëve, bashkëstudentë me të, dhe në prill të 1889 themeluan organizatën politike “İttihad ve Terakki” (“Bashkim dhe Përparim”).² Kjo organizatë, shumë shpejt u kthye në një lëvizje opozitare, e cila e frymëzuar nga parimet e Revolucionit Borgjez Francez (1789) synonte mbledhjen e Parlamentit dhe kthimin e Perandorisë Osmane në monarki kushtetuese. Për arsye politike, i ndjekur nga sulltani dhe qeveria osmane, pjesën dërrmuese të jetës ai e kaloi në Rumani. Megjithatë, gjatë gjithë kohës dr. I. Temo luajti një rol aktiv. Ai ruajti lidhje me figura të njohura të lëvizjes xhonturke në emigracion, shkroi artikuj në gazeta e revista të njohura të kohës, shqiptare e të huaja, hartoi

¹ Kristaq Prifti, *Doktor Ibrahim Temo - Jeta dhe Vepra 1865-1945*, Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, 1996, f. 13.

² Për më gjerë lidhur me rolin e dr. Ibrahim Temos në lëvizjen xhonturke shih: Sina Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, Ankara: IMGE kitabevi, 2014; Ahmet Bedevi Kuran, *Osmanlı İmparatorluğunda İnkılâp Hareketleri Millî Mücadele*, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2012; M.Şükrü Hanioğlu, *Bir siyasal örgüt olarak Osmanlı İttihad ve Terakki Cemiyeti ve Jon Türklük* (1889-1902), İstanbul: İletişim yayınları, 1987.

memorandume drejtuar sulltanit, qeverisë osmane dhe personaliteteve më të njohura të Evropës, në të cilat ngriti probleme të ndryshme mbi reformat që duheshin realizuar në Perandorinë Osmane.

Një vend të rëndësishëm në kujtimet³ artikujt, memorandumet dhe epistolarin⁴ e dr. I. Temos zë edhe çështja shqiptare. Për vetë peshën dhe vendin që zë kjo figurë në historinë e Perandorisë Osmane dhe Rilindjen Kombëtare Shqiptare, shqyrtimi i pikëpamjeve që ai ka dhënë mbi reformimin e sistemit arsimor osman dhe shkollat e huaja në trojet shqiptare është një obligim shkencor. Në një memorandum që dr. I. Temo dhe atdhetarët e kolonisë shqiptare të Bukureshtit i dërguan qeverisë osmane në korrik të 1896, protestohej ashpër kundër propagandës së Greqisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, të cilat, duke shtuar vazhdimisht shkollat dhe kishat e tyre në viset shqiptare synonin të asimilonin popullsinë vendase. Kisha dhe shkolla, që në Shqipërinë e Poshtme (në Toskëri) funksiononin në greqisht, kurse në Maqedoninë e Sipërme dhe në Gegëri në sllavisht - shkruhej në memorandum - u shërbenin interesave të huaja politike, Greqisë dhe shteteve sllave, që synonin të errësonin shpirtin e shqiptarëve dhe t'i bënin ata për vete, t'i asimilonin e t'i shkombëtarizonin. Për të penguar këtë politikë antikombëtare, shqiptarët e Bukureshtit i kishin parashtruar Patrikanës protesta të njëpasnjëshme, ku i kërkonin që kisha të mos përdorej si mjet për helenizimin e shqiptarëve ortodoksë, që nuk kishin asnjë lidhje me grekët as nga gjaku as nga kombësia. Për t'i dhënë fund dhunës dhe arbitraritetit politik në Shqipëri dhe veprimtarisë antishqiptare të shteteve ballkanike, e cila sipas patriotëve shqiptarë lejohej edhe nga vetë sulltani, ata kërkonin që:

a) qeveria osmane të lironte të gjithë shqiptarët e burgosur dhe të internuar për arsye politike;

b) të njëhej kombësia shqiptare dhe përkatësia fetare të mos përziheshin me atë kombëtare dhe;

c) me qëllim për të penguar propagandat e huaja kishtaroshkollore dhe për të mos u dhënë mundësi shteteve fqinjë t'i përdorin kishat dhe shkollat si vegla të tyre politike, ishte e nevojshme që, në viset me popullsi shqiptare, shërbimi fetar të bëhej në shqip. Gjithashtu,

³ Ibrahim Temo `nun *Ittihad ve Terakki Anıları*, Istanbul: Arba yayınları, 2000.

⁴ Epistolari dhe dokumentacioni personal i dr. Ibrahim Temos që nga viti 1960 ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Ai iu dhurua shtetit shqiptar nga familja dhe bashkëshortja e tij Nafije Temo, sipas porosisë së bashkëshortit.

kërkohej që në këto vende të hapeshin shkolla kombëtare, ku mësimi të zhvillohej në gjuhën shqipe.⁵

Një nga bashkëhartuesit e Memorandumit të mësipërm, dr. I. Temo, në thirrjen “Bashkatdhetarë shqiptarë” të hartuar në vitin 1897, pasi përshkruante gjendjen e mjerueshme të popullsisë shqiptare në Perandorinë Osmane, si shkaktar kryesor për situatën e krijuar ai akuzonte regjimin e Abdyl Hamitit II, valinjtë dhe funksionarët osmanë. Sipas tij, projektet për reforma që ata i kishin dërguar qeverisë osmane, kishin shkuar kot dhe nuk kishin marrë asnjë përgjigje. Padishahut - shkruante ai - as që i shkonte ndërmend të plotësonte dëshirat e shqiptarëve për zhvillimin e arsimit dhe të ekonomisë së vendit. Ndërkohë që vazhdonte t’u bënte lëshime serbëve, malazezëve, bullgarëve dhe grekëve, të cilët, duke patur mbështetjen e Rusisë po ndërhnin hapur në Vilajetin e Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës, duke punuar për të helmuar ndërgjegjen e shqiptarëve dhe për t’i përçarë ata. Ky ishte edhe “shpërblimi” për shërbimet që shqiptarët i kishin bërë Perandorisë Osmane, duke derdhur gjakun në shkretëtirat e Arabisë dhe Afrikës.⁶

Dr. I. Temo ishte nga të parët intelektualë shqiptarë që ngriti zërin dhe vuri në spikamë rrezikun që i kanosej vendit nga shkollat e huaja. Në një artikull që botoi në revistën *Albania* të Faik Konicës me titull “La Bulgarisation de l’Abanien” (“Bullgarizimi i Shqipërisë”), ai fliste hapur mbi zgjerimin e ndërhyrjes së Bullgarisë dhe të shteteve të tjera ballkanike. Sipas tij, këto shtete, në saje të lëshimeve që u kishte bërë Porta e Lartë kishin krijuar kishat dhe shkollat e tyre në një pjesë të madhe të Shqipërisë. Më tej, ai e vinte theksin në rrezikun e madh që përbënin këto shkolla në drejtim të shkombëtarizimit dhe të sllavizimit të territoreve dhe popullsisë shqiptare. Përpyekjet e këtyre shteteve për të rikrijuar “Bullgarinë e madhe” apo perandoritë e tjera mesjetare greke e serbe, ai i quante qesharake dhe pjellë të një fantazie të shfrenuar. Megjithatë, dr. I. Temo, nuk harronte të paralajmëronte qarqet shoviniste ballkanike se veprimtaria e tyre propagandistike në fushën e arsimit do të çonte, pa e kuptuar edhe ata vetë, në shpërthimin e

⁵ Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F) 19, Dosja (më tej: D).18, fl. 1. Memorandum i Ibrahim Temos dhe i patriotëve të Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit drejtuar sulltanit, korrik 1896.

⁶ AQSH, Fondi 19, dos. 21, fl. 36. Pamfleti “Bashkatdhetarë shqiptarë”, 1897.

ndjenjave nacionale shqiptare, në një aksion të dhunshëm dhe në një revansch të tmerrshëm kundër tyre.⁷

Përpjekjet e bëra nga sulltan Abdyl Hamiti II për ta rikthyer në Stamboll, ai i shfrytëzoi për t'i parashtruar kërkesa në favor të çështjes shqiptare. Në shtator të vitit 1899, dr. I. Temon i dorëzoi funksionarit të lartë osman gjeneral Ahmet Xhelaledin Pashës një Promemorie prej 8 faqesh. Kjo Promemorie përmbante kërkesa me karakter arsimor dhe kulturor, të cilat do ta ndihmonin popullin shqiptar për ta afirmuar identitetin e tij kombëtar dhe për të parandaluar politikën asimiluese të shteteve fqinje.⁸ Sipas dr. I. Temos, shqiptarët myslimanë që përbënin edhe shumicën e popullsisë ishin të bashkuar me këto kërkesa me vëllezërit e tyre të krishterë dhe po mbronin kombësinë, moralin dhe nderin e tyre kundrejt rrezikut të sllavizimit, greqizimit dhe latinizimit. Ai kritikonte funksionarët osmanë, nga qeveritarët më të lartë e deri tek drejtorët e arsimit në vilajete, për shkak se ata i shikonin me indiferentizëm propagandat e huaja dhe nuk shqetësoheshin aspak ndaj rrezikut të shkombëtarizimit që u kanosej shqiptarëve. Mungesa e shkollave shqipe nga njëra anë dhe përhapja e shkollave e kishave sllave e greke në Vilajetin e Kosovës, Manastirit dhe Janinës, nga ana tjetër, kishin krijuar sipas dr. I. Temos një gjendje të rëndë për popullsinë shqiptare. Për ta ilustruar këtë situatë, ai sillte si shembull pozitën e një njeriu, të cilit i kishin vendosur shkelmin në bark dhe po i zinin frymën. Dr. I. Temo i bënte thirrje sulltan Abdyl Hamitit II dhe qeverisë së Stambollit se dobësimi i lidhjeve midis shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane kishte ndodhur pikërisht për shkak të kësaj politike. Prandaj, në qoftë se qeveria osmane do të hapte në çdo anë të Shqipërisë shkolla shqipe, jo vetëm që do t'u pritej rruga propagandave të huaja, por do të forcoheshin njëherazi edhe lidhjet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Ai kundërshtonte me forcë të gjithë ata funksionarë konservatorë osmanë, të cilët, duke njohur rolin e shkollave në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, kishin frikë se hapja e tyre do të çonte në shkaputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Shqiptarët, sipas dr. I. Temos, e kishin pasur gjithmonë të zhvilluar ndërgjegjen kombëtare. Për ta vërtetuar këtë, ai i sugjeronte funksionarëve osmanë që të pyesnin ndonjë shqiptar për kombësinë e tij. Me bindje të plotë, ai shkruante se nga nëpunësi më i lartë e deri tek shqiptari më i thjeshtë,

⁷ Ibrahim Temo, "La Bulgarisation de l'Abanien", *Albania*, nr. 4, 15-31.7.1898, f. 63-64.

⁸ K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 162.

qoftë ky mysliman ose i krishterë, do t'u thoshte se "Lavdi Zotit, jam shqiptar", duke u lavdëruar me kombësinë e tij. Dr. I. Temo i bënte thirrje sulltanit se për të forcuar lidhjen e shqiptarëve me Perandorinë Osmane, Stambolli duhet të zbatonte një politikë tolerante dhe më të drejtë ndaj shqiptarëve, sidomos në drejtim të hapjes së shkollave dhe lëvrimin të gjuhës shqipe. Kjo do të ndihmonte në forcimin e unitetit jo vetëm mes shqiptarëve myslimanë dhe Perandorisë Osmane, por edhe me shqiptarët ortodoksë. Si shembull ai sillte qëndrimin e tyre në Luftën Greko-Turke (1897), të cilët nuk kishin rënë në kurthin e propagandës dhe shoqërive greke që vepronin në Shqipërinë e Jugut, por përkundrazi bashkërisht me forcat osmane u ishin kundërvënë ushtrisë pushtuese greke kur ajo kishte sulmuar Vilajetin e Janinës.

Në Promemorien e dr. I. Temos paraqitet edhe një projekt reformash që Perandoria Osmane duhet të zbatonte në vilajetet shqiptare. Me interes për studimin tonë është sidomos pika tre, ku ai shkruan se të huajt, duke shfrytëzuar doktrinën fetare, i kishin kthyer shkollat dhe kishat në vegla të tyre. Ata, emëronin në to mësues dhe priftërinj grekë në Toskëri dhe bullgarë e serbë në Gegëri. Për t'u dhënë fund ndërhyrjeve të tilla, ai sugjeronte se duheshin plotësuar dy kërkesa të popullit shqiptar: së pari, të krishterëve shqiptar t'u lejohej që në liturgjinë kishtare të fusnin gjuhën shqipe dhe që Patrikana greke të mos i persekutonte priftërinjtë shqiptarë; së dyti, qeveria osmane të hapte në viset shqiptare shkolla shqipe, ku nxënësit shqiptarë të mësonin edhe gjuhën turke. Dr. I. Temo në këtë promemorie deklaronte haptazi se me bashkimin e shkollave shqiptaro-osmane të katër vilajeteve shqiptare do t'u jepej fund propagandave greko-sllave, si dhe pretendimeve të tyre territoriale në Shqipëri e Maqedoni. Për ta paralizuar krejtësisht ndikimin e shteteve ballkanike, ai ishte i mendimit që qeveria osmane duhet të hapte shkolla edhe për kombësitë e tjera joshqiptare. Kjo strategji do të kishte efekt pozitiv dhe do të bënte që kombësitë në fjalë t'i ndërprisnin lidhjet e tyre me Athinën, Beogradin, Sofjen, Bukureshtin dhe Moskën.⁹ Në tetor 1902-prill 1903 dr. I. Temo pasi dha dorëheqjen si mjek nga një spital i Rumanisë shkoi në Paris për të vijuar specializimin në fushën e okulistikës. Atje, ai vendosi kontakte me miq dhe bashkëpunëtorë, personalitete të njohura të lëvizjes xhonturke. Gjatë kësaj kohe, me kërkesë të dr. I. Temos, u mbajt një mbledhje në

⁹ AQSH, Fondi 19, dos.31, fl .97 - 99. Promemorie e Ibrahim Temos paraqitur Ahmet Xhelaledin Pashës, shtator 1899.

shtëpinë e Ahmet Rizait¹⁰ ku morën pjesë drejtuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje. Në kujtimet e tij, ai shkruan se në mbledhje kishte parashtruar nevojën e hartimit të një programi, mbi bazën e të cilit duhet të punonin të gjitha degët e partisë “Bashkim dhe Përparim”. Ky program do të shërbente si një platformë për qeverisjen e vendit, kur kjo parti të vinte në fuqi. Dr. I. Temo i tërhoqi vëmendjen drejtuesve të lëvizjes se ata nuk duhet të kufizoheshin vetëm me kritika drejtuar regjimit të sulltan Abdyl Hamitit II, sepse po të vazhdohej kështu, kur të merrnin frenat e shtetit në dorë, nuk do të ishin në gjendje për ta drejtuar atë.

Duke marrë në konsideratë këto propozime, pjesëmarrësit ranë dakord për të përpiluar një program të hollësishëm, për të gjitha degët. Dr. I. Temo mori përsipër që të hartonte pjesën mbi politikën arsimore dhe reformat që partia “Bashkim dhe Përparim” do të ndërmernte kur të vinte në pushtet. Ai e vlerësonte arsimimin e popullit si treguesin themelor të qytetërimit të një kombi. Vendi që zinte një shtet në botën e qytetëruar, sipas tij, përcaktohej nga pesha numerike e numrit të banorëve që dinin të shkruanin e lexonin në raport me popullsinë e përgjithshme. Prandaj, reformimin e sistemit arsimor në Perandorinë Osmane ai e quante si diçka të domosdoshme. Programin arsimor që dr. I. Temo e paraqiti në mbledhjen e radhës përbëhej nga këto pika:

- 1) Vendosja e arsimit fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë shtetasit e Perandorisë Osmane;
- 2) Programet e këtyre shkollave do të përgatiteshin nga shteti dhe do të kontrolloheshin prej tij;
- 3) Nxënësit që nuk do të vazhdonin studimet e mesme do të mësonin, pas mbarimit të shkollës fillore edhe dy vite të tjera, gjatë të cilave do të merrnin njohuri për profesione të ndryshme që nevojiteshin për jetën;
- 4) Në katundet ose lagjet ku përveç turqve kishte edhe popullsi të kombësive të tjera, kur mblidheshin më tepër se 40 nxënës, do të organizoheshin çdo pasdite dy orë mësimi kushtuar gjuhës amtare. Mësuesit e tyre do të paguheshin nga komunitetet përkatëse ose nga shteti osman;
- 5) Të mos lejohej hapja e shkollave të huaja dhe krerët e komuniteteve fetare të mos ndërhyjnë në çështjet e arsimit.

¹⁰ Ibrahim Temo`nun Ittihad ve Terakki..., s.157.

Ata kishin të drejtë që t'i rekomandonin Ministrisë së Arsimit vetëm programet e lëndëve fetare;

- 6) Alfabeti arab ishte i papërshtatshëm për natyrën e gjuhës turke. Prandaj, rekomandohej që në shkolla të futej alfabeti latin, i cili do të lehtësonte mësimin e gjuhës osmane dhe kulturën turke do ta bënte të njohur në Evropë.¹¹

Për shkak të kërkesës së fundit, e cila duhet theksuar se ishte një kërkesë e guximshme për kohën, ai filloi të thirrej nga bashkëpunëtorët xhonturq me nofkën “Latinisti”.¹² Në të vërtetë programi i hartuar nga dr. I. Temo në pjesën më të madhe të tij ishte aplikuar nga vetë administrata e sulltan Abdyl Hamitit II,¹³ çka tregon se ai për shkak të viteve që kishte kaluar në emigracion, ishte shkëputur disi nga realiteti. Gjatë polemikës që zhvilloi me Ahmet Rizain, kur paraqiti programin për organizimin e sistemit arsimor në Perandorinë Osmane, ai e vuri theksin tek nevoja e mbrojtjes së fëmijëve të krishterë, që ishin po aq atdhetarë sa ata myslimanë, nga rreziku i shkombëtarizimit. Ndalimin e shkollave të huaja dhe futjen e mësimin të gjuhës amtare për fëmijët e kombësive joturke, ai e konsideronte si një masë që do t'i priste rrugën procesit të asimilimit të të rinjve të krishterë shqiptarë. Ky program i dr. I. Temos lidhur me organizimin e arsimit nuk u miratua, për shkak se asnjë koleg i partisë “Bashkim dhe Përparim” nuk e kishte hartuar pjesën e vet.¹⁴ Gjithsesi, tashmë ai ka hyrë në analet e historisë së arsimit dhe mendimit pedagogjik osman si programi arsimor i partisë “Bashkim dhe Përparim”, i hartuar nga dr. I. Temo. Në një Promemorie tjetër të shkruar në vitin 1904 dhe që zyrtarisht Perandorisë Osmane i është dërguar në emër të një Komiteti të kombësive të ndryshme,¹⁵ dr. I. Temo si autorë i saj parashtron si zgjidhje më të përshtatshme për çështjen kombëtare shqiptare dy alternativa:

- a) ose vilajetet me popullsi shqiptare të bashkoheshin në një vilajet më vete, duke u veçuar nga territoret e tjera dhe mbi këtë bazë të zbatoheshin edhe reformat;

¹¹ *Po aty*, s.158-159.

¹² *Po aty*, s.159.

¹³ Për këtë shih: Bayram Kodaman, *Abdülhamid devri eğitim sistemi*, Ankara: Turk Tarih Kurumu, 1991; Yahya Akyüz, *Türk Eğitim Tarihi (Başlangıçtan 2001'e)*, İstanbul: ALFA, 2001, s.206-240; Hasan Ali Koçer, *Türkiye de Modern Eğitimin Doğuşu ve Gelişimi: 1773-1923*. İstanbul: M.E.B. Yayınları, 1991.

¹⁴ *Ibrahim Temo'nun İttihad ve Terakki...*, s.160.

¹⁵ K.Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f.193-194.

b) ose të pengoheshin ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha në tërësi dhe nga qeveria osmane të zbatoheshin reforma të përgjithshme për të gjithë Turqinë Evropiane.

Krahas këtyre alternativave propozoheshin edhe disa masa me karakter administrativ, ku me interes për objektin tonë të studimit është pika katër, sipas së cilës nga qeveria osmane kërkohej që shkollat e huaja të hiqeshin nga duart e klerit dhe të vendoseshin nën kontrollin e shtetit, sepse, ato ishin bërë burim përçarje midis popujve të ndryshëm të Perandorisë. Kjo masë sugjerohej edhe për grekët e bullgarët, të cilët financonin dhe kishin nën kontroll një pjesë të madhe të këtyre shkollave.¹⁶

Të njëjtin problem ai e shtroi edhe në një letër që i dërgoi ministrit të Brendshëm, Ebu Mukbil Kemal beut, e cila faktikisht kishte trajtën e një promemorie dhe që indirekt i drejtohej vetë sulltanit. Në letër ai shkruante se Madhëria e Tij ishte në dijeni se në gjykimin e Evropës, Perandoria Osmane, kishte mbetur prapa dhe për të mos prishur harmoninë e qytetërimit evropian turqit duheshin dëbuar sa më parë nga Evropa. Këto projekte drejtoheshin kundër turqve si myslimanë dhe ishin mbeturinë e kohës së kryqëzatave. Por, edhe periudha e zbatimit të këtyre mendimeve, sipas tij, nuk do të ishte e largët. Në këtë parashtrësë ai ndalet edhe në politikën e Bullgarisë ndaj Turqisë Evropiane. Bullgaria, sipas dr. I. Temos, po tregohej shumë aktive dhe rrezikonte më shumë se çdo shtet ballkanik popujt e saj. Bullgarët ishin duke punuar me anë të shkollave dhe të kishave, që vetë qeveria osmane i kishte lejuar zyrtarisht, për të përgatitur truallin për pushtimin e vilajeteve shqiptare dhe maqedonase. Ata ishin duke pritur shkatërrimin përfundimtar të Perandorisë Osmane, me qëllim për të realizuar projektet e tyre. Por, sipas tij, që tani ende pa ndodhur kjo ata po përpiqeshin që me “butësi” të shkëpusnin diçka.¹⁷ Në një shkrim të titulluar “Mbi intrigat e fqinjëve në Shqipëri dhe në Maqedoni”, i cili sipas studiuesit Kristaq Prifti i takon fundit të vitit 1904, dr. I. Temo denoncon botërisht përpjekjet që qarqet politike të Athinës, Beogradit dhe Sofjes ishin duke bërë për të shkombëtarizuar popullsinë shqiptare e veçanërisht brezin e ri, me anë të shkollave dhe kishës. Ai e trajtonte veprimtarinë e tyre si një prelud të copëtimit të Shqipërisë dhe

¹⁶ AQSH, F. 19, D. 18, fl. 91-93. Promemorie e hartuar nga Ibrahim Temo drejtuar Portës së Lartë, 1904.

¹⁷ AQSH, F. 19, D. 31, fl. 75-79. Promemorie e hartuar nga Ibrahim Temo drejtuar ministrit të Brendshëm të Perandorisë Osmane, 1904.

njëkohësisht bënte thirrje se nëse shqiptarët nuk ngriheshin qysh tani, fqinjët ballkanikë do të rrëmbenin pjesët më të mira të atdheut. Dr. I. Temo i ftonte shqiptarët që të shfrytëzonin situatën dhe të përfitonin nga ashpërsimi i kontradiktave midis Fuqive të Mëdha për shkak të çështjes së Lindjes dhe Luftës Ruso-Japoneze të 1904-1905.¹⁸

Pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908 ashtu si tek të gjithë shqiptarët edhe tek dr. I. Temo u ngjallën shpresa të mëdha për të ardhmen e Perandorisë e të popullit shqiptar. Pikëpamja e partisë “Bashkim dhe Përparim” (“İttihat ve Terakki”), lidhur me çështjen e përdorimit të gjuhës ishte: në shkollat fillore shtetërore mësimi përveç se në turqisht do të zhvillohej edhe në gjuhën që flitej nëpër vilajete; në shkollat e ndërmjetme zhvillimi i mësimi në gjuhën turke ishte i detyrueshëm, ndërsa gjuha lokale do të lihej me zgjedhje; hapja e shkollave private do të ishte e lirë, me kusht që ato të ishin nën kontrollin e shtetit.¹⁹ Ndërsa, në Kushtetutë këto të drejta sanksionoheshin në nenin 15 ku thuhet: “Mësimet janë të lira. Çdo qytetar osman ka të drejtë, brenda kufijve të ligjit, të hapë shkolla publike apo private”. Ndërsa sipas nenit 16: “Të gjitha shkollat janë nën kontrollin e shtetit”; “Turqishtja është gjuhë shtetërore; nëpunësi i shtetit është i detyruar të dijë turqisht” (neni 18). Kjo politikë që në fillim hasi në kundërshtimin e plotë të popujve myslimanë (arabët, shqiptarët, kurdët, etj.) dhe jomyslimanë (grekët, armenët, bullgarët, rumunët, etj.). Ajo u perceptua dhe konsiderua si një politikë nacionaliste, e cila synonte haptazi turqizimin e kombësive joturke.²⁰ Situata u acarua sidomos pas vendosjes së detyrueshme të gjuhës osmane në shkollat e ciklit të ndërmjetëm. Ky akt, nga etnitë e ndryshme u perceptua si faza e parë e procesit të turqizimit dhe shkaktoi një valë të madhe zemërimi.²¹ Pavarësisht shenjave jo të mira që kishin filluar të shfaqeshin, në kuadër të ndryshimeve që ishin duke ndodhur pas Revolucionit, dr. I. Temo hartoi një Projektligj mbi reformimin e

¹⁸ K.Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f.199.

¹⁹ Julius Richter, *A History of Protestant missions in the near East*, Edinburgh: Oliphant, Anderson & Ferrier, 1910, p.180; Tarık Zafer Tunaya, *Türkiye’de Siyasal Partiler*, c.I, İstanbul: İletişim Yayınları, 1998, s.34-35; E.Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi...*, s.129.

²⁰ İlay İleri, “Batı Gözüyle Meşrutiyet Döneminde Osmanlı Hükümetlerinin Dil ve Eğitim Politikalarına Karşı Tepkiler”, *OTAM* (Ankara Üniversitesi, Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi), sayı: 18, 2005, s.214.

²¹ Mustafa Ergün, *II. Meşrutiyet Devrinde Eğitim Hareketleri, 1908-1914*, Ankara: Ocak Yayınları, 1996, s. 483-484.

sistemit arsimor osman, të cilin do t'ia paraqiste për miratim Parlamentit. Dorëshkrimi i këtij Projektligji nuk ka datë, por ne i përbahemi mendimit të studiuesit Kristaq Prifti, i cili shkruan se ai mund të jetë hartuar në verën e vitit 1909, pas ngjarjeve kundërrevolucionare të prillit të atij viti.²² Në hyrje të tij, ai shkruan me nota vlerësuese për sistemin arsimor austro-hungarez dhe duke marrë parasysh që edhe Perandoria Osmane ishte një shtet multietnik ashtu si Austro-Hungaria e paraqiste atë si shembull që mund të ndiqej edhe për organizimin e sistemit arsimor osman.²³ Projektligji i hartuar nga dr. I. Temo përmbante këto pika:

- 1) Arsimi fillor të ishte i detyrueshëm dhe i përgjithshëm, pa përjashtime dhe dallime kombëtare;
- 2) Mësimi në shkollat fillore të zhvillohej në bazë të programeve të hartuara nga Ministria e Arsimit;
- 3) Mësimet të bëheshin në gjuhën amtare, ndërsa gjuha osmane që ishte gjuhë zyrtare, të zhvillohej në një masë prej 7 orësh në javë;
- 4) Lëndë të tilla si historia, gjeografia, etj., të zhvilloheshin gjithashtu në bazë të programeve, të miratuara nga Ministria e Arsimit, por gjithnjë në gjuhën që do të dëshironin nxënësit;
- 5) Shkolla e përgjithshme fillore, pavarësisht se kujt kombësie i përkiste do të ishte nën kontrollin dhe inspektimin e Ministrisë së Arsimit;
- 6) Shpenzimet për shkollat fillore do të përballoheshin nga buxheti i shtetit;
- 7) Në qoftë se në fshatrat ose komunat, ku kishte më shumë se 40 fëmijë të hapeshin shkolla fillore, qoftë edhe në ndërtesa të gjetura nga vetë banorët, Ministria e Arsimit ishte e detyruar të dërgonte mësues për gjuhën osmane dhe për gjuhën lokale të vendit dhe t'i paguante ata nga buxheti i shtetit.

²² K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 254.

²³ AQSH, F. 19, D. 24, fl. 23-28. Projektligj mbi reformimin e sistemit arsimor osman i hartuar nga Ibrahim Temo, 1909; K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 254.

- 8) Të gjitha shkollat që do të pranonin programet dhe kontrollin e Ministrisë së Arsimit do të njiheshin si shkolla zyrtare, shtetërore.²⁴

Me këtë Projektligj, dr. I. Temo, mendonte se do të arriheshin dy objektiva kryesore: përparimi me hapa të shpejtë i Perandorisë Osmane dhe zhdukja e mosmarrëveshjeve ndërmjet popujve të ndryshëm të saj. Futja e gjuhës amtare në shkollat osmane, sipas tij, ishte një kusht i domosdoshëm për zbutjen e konfliktit ndërnacional në vend, ndërsa po të veprimej ndryshe shteti osman do të futej në kaos dhe do ta përfshinte një fatkeqësi e përgjithshme.²⁵

²⁴ *Po aty.*

²⁵ *Po aty.*

Hasan BELLO

SUMMARY

THE CONTRIBUTION OF DR. IBRAHIM TEMO IN REGARDS TO REFORMING THE OTTOMAN EDUCATIONAL SYSTEM

Throughout the 19th century the Ottoman Empire undertook several reforms in the administrative area, particularly in the educational system. In this regard, Ibrahim Temo gave a contribution of importance. However, his views were subjected to criticism because he accentuated the dire and neglected situation in which the Ottoman educational system was in at the time. In this regard, the study analyzes the personality of Ibrahim Temo and his lifetime contribution. Through various memorandums, published articles and political activity, Ibrahim Temo systematically displayed his stance in relation to the Ottoman educational system. He was particularly vocal in regards to the foreign schools opening throughout Albanian Vilayets, arguing that such acts are dangerous for the Albanian people and the Empire itself.

Fitim RIFATI

**SHQIPTARËT NË LËVIZJEN XHONTURKE
(gjysma e dytë e korrikut-gusht 1908)***

Fillimi i aktiviteteve të armatosura në vilajetin e Kosovës, të Manastirit e të Selanikut ndodhi për arsye të ndërthurjes dhe acarimit të kontradiktave të brendshme politike, ekonomike, kombëtare dhe nga rreziku i pretendimeve të jashtme. Pikërisht, në Kuvendin e Ferizajt u gërshetuan të gjitha këto elemente dhe u kërkua të ndërmerreshin hapa konkret që çonin në përmirësimin e kushteve të brendshme dhe forcimin e pozitës së Perandorisë Osmane krahas mbretërive ballkanike dhe Fuqive të Mëdha. Në kohën kur Kuvendi i Ferizajt po zhvillonte punimet e tij, kur të dërguarit xhonturq po përpiqeshin që rrjedhat e tij t'i kthenin në suaza të realizimit të objektivave të tyre dhe kur Nijazi Beu po avanconte me njësitin e tij, lëkundjet në kuadër të Armatës III po merrnin një karakter zhvillimi saqë kjo situatë e tensionuar e detyroi sulltan Abdyl Hamitin II të vepronte për të shuar këto trazira. Kështu, marshall Shemsi Pasha, komandant në divizionin e Mitrovicës të Vilajetit të Kosovës, me urdhër të sulltanit shkoi në Manastir për të shuar lëvizjen e Nijazi Beut dhe njësitet të tij. Dy batalione që mori me vete, të përbëra nga ushtarë shqiptarë të garnizoneve të Mitrovicës, Shkupit dhe Gjevgjelisë, nuk pranorin të marshonin për në Resnjë dhe të përballeshin me këtë situatë.¹ Mirëpo, veprimtaria e Komitetit “Bashkim e Përparim” kishte depërtuar edhe në mesin e oficerëve dhe të

* Vazhdim i punimit nga numri i mëparshëm (39) me titull “Shqiptarët në Lëvizjen Xhonturke (1907 - gjysma e korrikut 1908)”, Kosova 39, Instituti i Historisë - Prishtinë, 2014.

¹ Gazmend Shpuza, *Në vazhden e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare (Përmbledhje shënimesh historike dhe historiografike)*, Tiranë: “Toena”, 1997, f. 148.

ushtrisë në Armatën III. Kundër Shemsi Pashës u organizua një atentat. Derisa po përgatitej për të udhëhequr ekspeditën ndëshkimore së bashku me dy oficerë të tjerë, atë e qëllloi për vdekje Atif Beu,² para ndërtesës së postës dhe telegrafit. Me këtë rast u plagosën edhe disa kalimtarë të tjerë.³ Një raport diplomatik anglez e përshkruan në këtë mënyrë aktin e vrasjes së tij: *“Shemsi Pasha komandant i divizionit 18 në Mitrovicë, me tren special, nga Mitrovica arriti në Manastir në mbrëmje të 6 korrikut. Me vete kishte dy batalione ushtarësh nga shqiptarët dhe ¾ e regjimentit 69 të Prizrenit. Ishte i stërlodhur nga udhëtimi gjithëditor. Në mëngjes të 7 korrikut disa herë i telegrafoi pallatit të sulltanit. Të njëjtën ditë, rreth orës 3 pasdite, shkoi përsëri në postë për t’i raportuar sulltanit mbi situatën në vend. Mu në momentin kur ishte duke hipur në karrocë të vete, me të cilën do të udhëtonte për në Resnjë, tre plumba pistoleje e shtruan për dhe”*.⁴

Vrasja e Shemsi Pashës u konsiderua si një akt që privoi nga jeta armikun më të madh të shqiptarëve, i cili kishte përdorur masa të dhunshme në Vilajetin e Kosovës, ndërkaq kjo ngjarje në Ferizaj ndikoi fuqishëm në bindjen e të tubuarve shqiptarë se rruga e realizimit të kërkesave dhe e suksesit do të ishte më e afërt. Mirëpo, vrasja e Shemsi Pashës u cilësua si një humbje për minoritetin serb në Vilajetin e Kosovës, për Mbretërinë e Serbisë dhe njëkohësisht si një humbje edhe për interesat strategjike të Austro-Hungarisë, ndërsa Komiteti “Bashkim e Përparim”, duke shfrytëzuar jehonën e këtij akti, i bëri thirrje shqiptarëve t’i bashkoheshin Revolucionit.⁵ Në një kushttrim që Turqit e Rinj lëshuan “Nga qendra e Shqipërisë” drejtuar popullit shqiptar, thuhej: *“O shqiptarë trima, bashkatdhetarë të mi, që jeni të rrethuar nga të gjitha anët, nga jashtë e nga brenda, me shtete armiqësore, një lajm i gëzueshëm - zgjedha po thyhet, po thyhet zgjedha e pushtetit despotik, i cili si helm tokësor po i helmon shqiptarët tanë, jetën tonë*

² Ai i përkiste Armatës së III të Maqedonisë. Ibrahim Temo e quajti hero të revolucionit. Shih: Kristaq Prifti, *Doktor Ibrahim Temo Temo – Jeta dhe vepra 1865-1945*, Prishtinë: “Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës”, 1996, f. 223.

³ Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë (në tekstin e mëtejshëm: AIHT), fondi: Arkivi i Vjenës, Vj-18-8-896, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri dërguar MPJ në Vjenë, 8 korrik 1908; Vj-18-11-1126, Raport i konsullit austro-hungarez nga Prizreni dërguar MPJ në Vjenë, 11 korrik 1908.

⁴ Skënder Rizaj, “Roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, Kosova, nr. 3, Prishtinë: “Instituti i Historisë – Prishtinë”, 1974, f. 169.

⁵ AIHT, Vj, 18-11-1139, Telegram konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 9 korrik 1908; Ramiz Abdyl, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë: “Instituti i Historisë – Prishtinë”, 2004, R. Abdyl, f. 27.

*dhe vendin tonë. Myslimanë dhe të krishterë tani filloni të bashkoheni në Anadoll dhe në Rumeli. Në emër të popullit tonë po kërkojmë parlament. Në mënyrë që të marrë fund regjimi i sotëm tiranik, i cili po i djeg shtëpitë tona, po i shuan vatrat tona dhe po i detyron fëmijët tanë të qajnë me lot të përgjakur, po kërkojmë kushtetutë”.*⁶

Vrasja e Shemsi Pashës tashmë dha një pasqyrë të qartë se sabotimi dhe mosrespektimi i urdhrave nga ana e ushtrisë ishte bërë praktikë mjaft e përhapur në mesin e saj, saqë njësitet e Armatës II dhe III nisën të mos zbatonin direktivat e Portës së Lartë për të luftuar kundër njësitit të Nijazi Beut e kryengritësve të tjerë, gjë e cila u provua edhe atëherë kur dy batalione ushtarake në Manastir refuzuan urdhrin.⁷ Dezertimet e ushtarëve për të mos kryer shërbimin në ushtri, tashmë ishin bërë mjaft të dendura. Nga 26 batalione që zbarkuan në Selanik, vetëm 6 nga to arritën në Manastir, madje edhe këto nuk pranuan të luftojnë kundër njësitit të Nijazi Beut, duke filluar kështu t’i bashkoheshin çetave shqiptare.⁸ Në këtë mënyrë Manastiri u bë ndër qendrat kryesore ku oficerët dhe nëpunësit civilë të ushtrisë po afroheshin me Lëvizjen Xhonturke, ku numri i ushtarëve dhe oficerëve në fillim të korrikut kishte arritur shifrën rreth 30 000, që sipas Hysen Hilmi Pashës, inspektor i përgjithshëm i Rumelisë në Selanik, vetëm ai kishte ngelur pa iu bashkuar kryengritësve.⁹ Propaganda e lëvizjes së armatosur u zgjerua veçanërisht tek shqiptarët dhe oficerët shqiptarë të cilët përkrahin operacionet e bashkatdhetarëve të tyre.¹⁰ Raste të tilla u paraqitën edhe në pjesë të tjera të Shqipërisë, siç ishte ai i popullsisë së Krujës, e cila ishte e pakënaqur me administrimin e kajmekamit (nënprefektit) që në shenjë revolte kuvendi lokal për tre muaj të tërë nuk kishte arritur të mblidhej. Popullsia shprehu zemërimin e saj në atë formë sa qëlloi me armë banesën e kajmekamit dhe dy nëpunësve të tjerë, të cilët nuk kishin pranuar të largoheshin nga Kruja. Pas këtij sulmi, kajmekami shkoi në Lezhë, ndërsa njëri nga nëpunësit iku në Tiranë dhe tjetri në Durrës. Për të hetuar këtë rast, prefekti i Durrësit

⁶ S. Riza, “Roli...”, f. 167.

⁷ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 27.

⁸ *AIHT*, Vj-18-8-896, Raport i konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 8 korrik 1908; Vj-18-4-478, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 9 korrik 1908.

⁹ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 28.

¹⁰ Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, përktheu: Nestor Nepravishta, Tiranë: “Dituria”, 2006, f. 190.

kishte marrë urdhër të shkonte në Krujë, por ai kishte refuzuar atë me arsyetimin se ishte i sëmurë.¹¹

Në kushte të vështira financiare, autoritetet osmane nuk kishin me se t'i paguanin ushtarët që shërbenin në ushtri, megjithëse morën të holla nga borxhi shtetëror. Të ndodhur në një gjendje të rëndë politike dhe financiare, divizione rezervistësh iu bashkuan Lëvizjes Xhonturke, duke brohoritur për lirinë (hyrietin).¹² Ndikimi i Komitetit “Bashkim e Përparim” u reflektua edhe në kuadrin e xhandarmërisë, ku pjesëtarë të saj filluan të dezertonin dhe arratiseshin së bashku me pajisjet luftarake dhe i bashkoheshin forcave kryengritëse revolucionare, ku kjo dukuri veçmas theksohet në vilajetet e Manastirit dhe të Janinës. Në këtë drejtim nuk mungoi edhe inkuadrimi në kuadër të kësaj lëvizje edhe nga ana e çetave të Pollogut të përbëra nga 300 luftëtarë dhe të udhëhequra nga Veli Beu i Gostivarit. Ato e kishin nën kontroll krahinën në fjalë. Përsheptimi i suksesit nga ana e kryengritësve tashmë shkaktonte shqetësim të madh në qarqet qeveritare, ku pozita e Perandorisë Osmane në Rumeli keqësohej si pasojë e veprimit të Lëvizjeve Kombëtare, mosrespektimit të urdhrave nga ana e oficerëve osmanë dhe ndikimit të Lëvizjes Xhonturke.¹³ Metoda më e përhapur nga ana e Komitetit “Bashkim e Përparim” ishte ajo e organizimit të atentateve ndaj personaliteteve osmane që ishin shquar për besnikëri të plotë ndaj vijës politike të sulltan Abdyl Hamitit II. Fatin e Shemsi Pashës e kishin përjetuar edhe disa personalitete të spikatura prosulltaniste në Dibër, Selanik e Serez.¹⁴ Në këtë kontekst, theksojmë vrasjen nga një shqiptar të gjeneral-kolonel Sadik Pashës në momentin kur po kthehej nga Selaniku për në Stamboll me anijen “Sidon”, vrasjen e një myftiu (agjent i sulltanit) duke hipur në tren nga Selaniku për në Stamboll, akt që u krye po ashtu nga një shqiptar.¹⁵ Nuk mungoi as vrasja e një oficeri në Manastir, atentati kundër kolonel Naim Beut në Selanik, vrasja e prefektit të Dibrës, Hysen Beu, dhe komandantit të artilerisë në Serez.¹⁶ Më 16 korrik të vitit 1908 kryengritësit shqiptarë nga sanxhaqet e Prizrenit, Prishtinës dhe të Pejës, së bashku me krerët e tyre organizuan një tubim në Doganaj afër Ferizajt. Me këtë rast ishte lidhur besa që deri

¹¹ G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 155.

¹² S. Riza, “Roli...”, f. 188.

¹³ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 28.

¹⁴ *AIHT*, Vj-9-17, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri dërguar MPJ në Vjenë, 22 korrik 1908.

¹⁵ S. Riza, “Roli...”, f. 169.

¹⁶ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 29.

në shëmitër të atij viti të ndaloheshin hasmëritë, vëllavrasjet si dhe veprime të tjera të dhunshme.¹⁷ Të dhënat provojnë se Turqit e Rinj i bënë për vete shqiptarët vetëm atëherë kur u zotuan se do të realizonin kërkesat e tyre.

Ata prematuan se do të nderonin privilegjet e vjetra lidhur me taksat, i siguruan shqiptarët se do t'i lejonin të mbanin armët e tyre dhe se do të kishin të drejtë të hapnin shkolla në gjuhën shqipe.¹⁸ Sipas të dhënave, deri më 18 korrik Kuvendi i Ferizajt nuk arriti të krijonte masën e nevojshme për aprovimin e programit të Komitetit “Bashkim e Përparim”, për shkak të pengesave që dilnin nga tabori prosulltanist në krye me Mehmet pashë Dërrallën. Në anën tjetër, në kuadër të ecurisë së punimeve në Kuvend u inkadruan edhe përfaqësues të komunitetit shqiptarë katolikë, gjë e cila ndikoi në përmirësimin e kompaktësisë kombëtare, pasi që kohët e fundit ishin ftohur raportet ndërfitare si pasojë e disa incidenteve të shfaqura ndërmjet dy besimeve.¹⁹ Besa që ishte lidhur mes shqiptarëve në këtë rast, kishte të bënte me ndalimin e hakmarrjeve për gjashtë muajt e ardhshëm, duke fuqizuar kështu qëllimin për interesat e tyre të përbashkëta.²⁰ Që nga kjo periudhë, Kuvendi i Ferizajt u shndërrua në një shprehje të programit xhonturk, por akoma në mungesë të shumicës së delegatëve për ta miratuar atë.²¹ Me rastin e diskutimit të çështjes për rivendosjen e kushtetutës kishte pasur kundërthënie në mes pjesëtarëve të Kuvendit të Ferizajt. Shqiptarët e Shkupit, Tetovës, Gjilanit, Preshevës e të Kumanovës ishin deklaruar për hapjen e një regjimi kushtetues dhe parlamentar, ndërsa delegatët e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Pejës ishin kundër rishpalljes së kushtetutës, ndërsa delegatët e Prishtinës, Gjakovës dhe Pazarit të Ri ishin të lëkundshëm. Qytetet e papërfaqësuara si Sjenica, Plevlie, Biellopolje, Berana dhe Tërgovishta do të pyeteshin telegrafisht për qëndrimin e tyre. Si vendimtar për aprovimin e qëndrimit për rishpalljen

¹⁷ Po aty, f. 25.

¹⁸ Stavro Skendi, *Zgjidhje kombëtare shqiptare 1878 – 1912*, përkthyer nga: Skënder Luarasi dhe Nestor Nepravishta, Tiranë: “Phoeniks”, 2000, f. 312-313;

¹⁹ S. Rizaj, “Roli...”, f. 174; Ismet Dërmaku, “Kuvendi i Ferizajt (1908) dhe Revolucionin i Xhonturqve”, Buletin i Muzeut të Kosovës XV-XVI (1987-1988) – SEPARAT – Prishtinë, 1988, f. 98; Qamil Gexha, *Shtypi i Malit të Zi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1873 - 1912*, Gjakovë, 2003, f. 148.

²⁰ Shaban Hashani, “Isa Boletini dhe rezistenca shqiptare kundër pushtuesve turq në Ferizaj dhe rrethinë më 1908-1910”, Instituti i Historisë – Prishtinë, *Isa Boletini dhe koha e tij*, Prishtinë, 1998, f. 66.

²¹ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 26.

e kushtetutës konsideroheshin përfaqësuesit e Prishtinës.²² Është me rëndësi të theksohet se gjatë këtyre ditëve në Preshevë, Kumanovë dhe Gjilan ishin tubuar rreth 20 000 kryengritës shqiptarë, të cilët ishin të gatshëm për të pushtuar Shkupin, vetëm se po prisnin sinjalin nga Kuvendi i Ferizajt.²³

Njësitë e Nijazi Beut kishte shpeshuar ndërmarrjet e sulmeve ndaj autoriteteve osmane. Ai mori urdhër nga Komiteti “Bashkim e Përparim” i Ohrit që të rrëmbente marshallin Osman Pasha, tashmë zëvendësues i Shemsi Pashës. Numri i pjesëtarëve vullnetarë të këtij aksioni kishte arritur shifrën prej 2 000 vetash nga rrethet e Ohrit dhe të Strugës, 800 vullnetarë nga Prespa dhe 200 të tjerë nga Pogradeci.²⁴ Me këtë rast, mbi 3 000 kryengritës u nisën drejt Manastirit për të përfunduar aksionin e paraparë, i cili u realizua me sukses natën midis 22-23 korrikut të vitit 1908.²⁵ Në Kuvendin e Ferizajt ishin shfaqur tri grupe që kishin qëndrime të ndryshme me njëri-tjetrin. Grupi i parë përbëhej nga austrofilët që e përkrahnin ndërtimin e hekurudhës Uvac-Mitrovicë, grupi i dytë përbëhej nga xhonturqit që ishin për reforma në Perandorinë Osmane (vendosjen e sistemit shtetëror kushtetues) dhe grupi i tretë përbëhej nga shqiptarë të cilët kërkonin autonominë e Shqipërisë. Rryma xhonturke kishte mbizotëruar në Kuvendin e Ferizajt, prandaj e vetmja pikë që i bashkoi këto grupe ishte kërkesa për rivënien e Kushtetutës së vitit 1876.²⁶ Me ardhjen e delegacionit të krerëve të Shkupit prej 24 anëtarëve dhe të Dibrës prej dy anëtarëve, në seancën e 19 korrikut Kuvendi deklaronte me shumicë votash betimin për besnikëri ndaj programit të Komitetit “Bashkim e Përparim”.²⁷ Kjo ndikoi që me këtë rast të shprehej edhe besnikëria ndaj Perandorisë Osmane, e cila bëri që të hiqej parakushti për realizimin e programit kombëtar për bashkëpunim me Turqit e Rinj. Edhe pse në mbledhjen e 19 korrikut trojet shqiptare juglindore të Vilajetit të Kosovës (Shkupi,

²² *AIHT*, Vj-18-12-1273, Raport i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1908.

²³ Shukri Rahimi, “Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1909 - 1912”, *Kosova*, nr. 1, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1972, f. 17-18.

²⁴ *AIHT*, Vj-18-12-1237, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri dërguar MPJ në Vjenë, 23 korrik 1908.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ I. Dërmaku, “Kuvendi...”, f. 104-105; Emin Pllana, *Kosova dhe reformat në Turqi (1839-1912)*, Prishtinë: “Enti i Historisë së Kosovës”, 1978, f. 237.

²⁷ *AIHT*, Vj-18-4-492, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 23 korrik 1908; I. Dërmaku, “Kuvendi...”, f. 104.

Tetova, Gjilani, Presheva dhe Kumanova) ishin shprehur për të hapur një parlament kombëtar.²⁸

Në seancën e 20 korrikut, Kuvendi i Ferizajt paraqiti Rregulloren e betimit (Itifaknamenë), e cila përbëhej prej 8 pikave, që në thelb kishin kërkesën e rivendosjes së Kushtetutës së vitit 1876. Kjo rregullore përmbante këto nene:

1. Lutja dhe betimi për besnikëri ndaj sulltanit, pacenueshmëria dhe papërmbysshmëria e të cilit është e garantuar.
2. Qëndrimi i papërkulur në zbatimin e serishëm të Kushtetutës së vitit 1876, për të cilën të gjithë të pranishmit pajtohen në mënyrë solidare.
3. Kushdo që i kundërvihet nenit 2, nëse është fjala për individ, do të dënohet me vdekje. Nëse vjen reagimi i qyteteve ose rretheve të tëra, do të bëhet djegia dhe shkatërrimi i tyre.
4. Vendoset lidhja për kushtetutë. Ajo garanton pronësinë dhe shprehjen e lirë të mendimit. Në ligjet ekzistuese nuk do të ndryshohet asgjë deri në mbledhjen e parlamentit. Asnjë rreth nuk guxon pa pëlqimin e tërësisë të punon me kokë të vet. Nëpunësit që do t'i ndjekin njerëzit liberal ose idetë liberale do të vriten. Patriotët nuk kanë përse të frikësohen.
5. Kuvendi si i tillë, si dhe çdo individ do të kujdeset në marrëveshje me ushtrinë e të ndihmon depërtimin e ideve liridashëse.
6. Askush nuk guxon të shlyej nenet e mëparshme, t'i paraqet në mënyrë të shtrembëruar etj. Dënohet sipas nenit 3.
7. I vetmi qëllim i Lidhjes së paraqitur këtu është të realizohet kushtetuta dhe zbatimi i saj i lirë; nuk veprohet për kurrfarë qëllime tjera publike ose sekrete.
8. Thirret bekimi i Zotit që të arrihet marrëveshja.²⁹

²⁸ *AIHT*, Vj-18-13-1821, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 28 korrik 1908.

²⁹ *AIHT*, Vj-18-11-1149, Raport i konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 30 korrik 1908; Živko Avramovski, "Izvještaji austrougarskih konzula u Kosovskoj Mitrovici, Prizrenu i Skoplju o odborskoj Skupštini u Ferizoviću 5-23. Jul 1908. godine", *Vjetar*, nr. II-III, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1970, f. 332-333.

Me rastin e kësaj mbledhje iu dërgua një telegram sulltan Abdyl Hamitit II, i cili u nënshkrua nga 1 200³⁰ personalitete më me influencë në Vilajetin e Kosovës. Ky telegram përmbante kërkesat e njëjta me ato të itifaknamesë. Meqë nuk morën për dy ditë asnjë përgjigje nga ana e sulltanit, delegatët kërcënuan se nëse kërkesat e tyre nuk merren parasysh, 50 000 kryengritës do të nisen drejt Stambollit.³¹ Në rrethana të tilla, më 21 korrik në Shkup ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme, ndërsa Nexhip Draga kishte dhënë urdhër të ndërpritet puna e gjyqeve dhe ishte nisur për në Ferizaj, aty ku ishte e përqendruar masa revolucionare e kryengritësve.³² Shqiptarët tashmë kishin përqafuar idenë e vendosjes së regjimit kushtetues dhe i kërkonin sulltan Abdyl Hamitit II që të mos vononte në këtë aspekt.³³ Kuvendi i Ferizajt kishte dhënë vendimin e tij që kërkesën për rivendosjen e kushtetutës së vitit 1876 sulltani ta realizojë sa më shpejtë. Në këtë kontekst, sa më tepër që zvarritej përgjigja e sulltanit aq më shumë shtohet gatishmëria për të marshuar drejt Stambollit. Kështu, me thirrjen e delegatëve të Kuvendit, kryengritësit shqiptarë tashmë ishin bërë gati të nisin marshimin të ndarë në tre grupe; njëri në drejtim të Karadakut, tjetri në drejtim të

³⁰ Sipas historianit Gazmend Shpuza, numri i delegatëve që nënshkruan telegramin ishte 180 (që mbështetet tek Sylejman Kylçe) personalitete shqiptare nga Vilajeti i Kosovës të ardhur nga Prishtina, Kaçaniku, Prizreni, Gjakova, Peja, Vushtrria, Mitrovica, Pazari i Ri dhe Shkupi, ku në mesin e të nënshkruarve ishte edhe Isa Boletini, që sipas Sylejman Kylçes, përkundër besnikërisë së tij ndaj Abdyl Hamitit II, ishte bashkuar me programin kushtetues pa pëlqimin e tij. Ndikim në kthimin e Isa Boletinit në anën e programit të Turqve të Rinj kishte luajtur edhe Galip Beu dhe agjitorë të tjerë xhonturq. Në anën tjetër, këtë pohim të S. Kylçes dhe të tjerëve e demanton historiania Fatmira Musaj, e cila duke u mbështetur në kujtimet e kryesekretarit të pallatit, Tahsim Pasha, burimeve të tjera e rrethanave të kohës, nënvizon se “*Isa Boletini vendosi revolucionin e turqve të rinj, duke shpresuar se me shpalljen e kushtetutës së vitit 1876 do të krijoheshin mundësitë për fitoren e autonomisë së Shqipërisë*”. Shih: Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Instituti i Historisë), Tiranë, 1987, f. 53-54; G. Shpuza, *Në vazhden...*, f. 164; Adem Murati, “Kuvendi i Ferizajt dhe Revolucioni Xhonturk më 1908”, *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike), nr. 26-1996, Prishtinë: “Instituti Albanologjik i Prishtinës”, 1997, f. 103.

³¹ *AIHT*, Vj-18-9-971 dhe Vj-18-11-1149, Raporte të konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 22 dhe 30 korrik 1908; Vj-8-9-967, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 22 korrik 1908; Vj-18-4-491, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1908.

³² I. Dërmaku, “Kuvendi...”, f. 106.

³³ *AIHT*, Vj-18-9-969, Rezervat i atasheut ushtarak të Austro-Hungarisë nga Shkupi dërguar Ministrisë së Luftës së Perandorisë në Vjenë, 22 korrik 1908.

Grykës së Kaçanikut, që kishte arritur me tren në afërsi të Shkupit dhe grupi i tretë në drejtim të Tetovës. Të gjitha këto grupe ishin vendosur nëpër fshatrat shqiptare dhe për çdo moment po prisnin përgjigjen e sulltanit.³⁴

Telegrame në adresë të sulltanit tashmë vinin nga të gjitha pjesët evropiane të Perandorisë. Ndonëse të mbledhur në Preshevë, kryengritësit përmes një telegrami të dërguar më 20 korrik 1908, kërcënuan sulltan Abdyl Hamitin II se në rast mosrealizimi të kërkesës së tyre për rijetësimin e kushtetutës, ata do të futnin nën kontroll Shkupin dhe rrethinën e tij, deri në atë moment kur të plotësohej thirrja e tyre.³⁵ Po ashtu, telegrame të kësaj përmbajtje iu dërguan sulltanit edhe nga qytetet e Gostivarit, Tetovës³⁶ dhe të Dibrës. Më 22 korrik iu dërgua edhe një telegram sulltanit nga Ferizaj prej Sudi efendiut (xhonturk), kryetar i Prishtinës, ku në emër të të gjithë krerëve të Vilajetit të Kosovës, ulemave, kryeministrit e rezidencës, shkruante: *“Nuk është e mundur të qetësohet gjendja. Populli po zbret nga malet i armatosur. Luteni që të jepni (nxirrni) dhe të njoftoni përgjigje pozitive. Po të mos vij përgjigje e pëlqyeshme e të refuzohet (kërkesa) rreziku është i sigurt”*.³⁷ Kërkesat për rishpalljen e kushtetutës i dhanë një motiv më të madh shqiptarëve që të nxiteshin për revolta të armatosura. Kështu, doli në mal edhe çeta e Ohrit nën komandën e Ejup Sabriut, ndërsa më 21 a 22 korrik doli në mal edhe çeta e Kosturit (prej 30 ushtarësh), që komandohej nga Beqir Grebeneja, të cilës më pas iu bashkuan rreth 1 000 pjesëtarë nga popullsia e këtij rrethi. Në këtë mënyrë, njësi të Nijazi Resnjës e çeta e Ohrit, u masivizuan aq sa morën tiparet e një “batalioni popullor”. Mirëpo, duhet theksuar se këto çeta dirigjoheshin nga Komiteti “Bashkim e Përparim” dhe se luftonin për rishpalljen e kushtetutës dhe jo për kërkesat kombëtare shqiptare, siç ishte autonomia e Shqipërisë.³⁸ Në rrethana të tilla, Komiteti “Bashkim e Përparim” në Manastir dhe Selanik, për të sfiduar sulltan Abdyl Hamitin II, më 23 korrik shpalli Kushtetutën e vitit 1876, ngjarje kjo që u përcoll me të shtëna topash. Njëkohësisht iu kërkuar edhe sulltanit të bënte të njëjtin akt, sepse në të kundërtën pasojat do të ishin tragjike për

³⁴ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 32.

³⁵ Po aty.

³⁶ *AIHT*, Vj-18-9-964, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 25 korrik 1908.

³⁷ G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 168-169.

³⁸ Po aty, f. 165; S. Rizaj, “Roli...”, f. 166.

shtetin osman.³⁹ Po të njëjtën ditë, në Manastir, Preshevë dhe Qyprrly (Veles), u shpall kushtetuta.⁴⁰ Ndonëse shpallja e kushtetutës bëhej nëpër qendra të ndryshme të viseve evropiane të Perandorisë Osmane, peshën kryesore dhe formën e prerë do ta merrte atëherë kur riaktivizimi i saj do të bëhej nga ana e sulltanit. Më datën 22 korrik të vitit 1908 oficerët e garnizonit të Shkupit i kërkuan valiut të Kosovës të bashkëpunonte me ta, mirëpo ai nuk e pranoi kërkesën e tyre. Ata e arrestuan dhe e dërguan me tren në Selanik.⁴¹

Në ndërkohë personaliteti i Ismail Qemalit ishte shumë i rëndësishëm, si për sulltan Abdyl Hamitin II, po ashtu edhe për interesat e Turqve të Rinj. Çastet më kritike për pozitën e tij, sulltani kishte kërkuar opinion nga Ismail Qemali lidhur me kërkesat që shqiptarët po i bënin atij për të rijetësuar kushtetutën. Ismail Qemali vlerësonte se Kuvendi i Ferizajt qe faktori kryesor në vendimin e sulltanit. Ndërkaq në përgjigjen e tij dhënë sulltanit, ai e këshillonte atë *“të mos vonohej asnjë minutë, por të shpallte Kushtetutën, sepse kjo ishte e vetmja masë e dobishme dhe e vetmja garanci, që popujt e Perandorisë të ishin bashkë rreth fronit të tij”*.⁴² Sulltani nuk kishte besim tek njerëzit e tij. Ai, duke parë që masa demonstruese e popullit nuk po pushonte dhe se indinjata publike po rritej më tej, nisi të largonte nga detyra ministrat e padëshirueshëm dhe zyrtarë të qeverisë, duke i zëvendësuar ata me njerëz të tjerë.⁴³ Meqë po ballafaqohej me një situatë mjaft të pafavorshme për pozitën e tij, ai thirri Këshillin e Ministrave në një mbledhje e cila kishte vazhduar gjatë gjithë ditës së 23 korrikut deri në mesnatë. Pas diskutimeve që u bënë, u arrit zgjidhja e dëshirueshme në mes të 23-24 korrikut 1908, ku sulltani shpalli iraden (dekretin, urdhëresën) që riaktivizonte Kushtetutën e vitit 1876, të shfuqizuar prej tri dekadash.⁴⁴ Në kujtimet e tij, ai fajëson politikën angleze për ndikimin e saj në masat popullore që kërkonin rishpalljen e kushtetutës. Për të penguar ndikimin anglez, rishpallja e kushtetutës, sipas tij, kishte

³⁹ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 33.

⁴⁰ G. Shpuza, *Në vazhdën...*, f. 169.

⁴¹ AIHT, Vj-18-4-495 dhe Vj-18-9-965, Telegram dhe raport i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar MPJ në Vjenë, 23 dhe 24 korrik 1908.

⁴² Ismail Qemali, *Kujtime*, Përktheu nga anglishtja: Abdurrahim Myftiu, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 359.

⁴³ “The New York Times”, *Sultan outs favorites*, 30 july 1908; Tachar Ramavarma Ravindranathan, *The Young Turk Revolution - July 1908 to April 1909*, Utah State University, 1965, f. 77.

⁴⁴ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 33; T. R. Ravindranathan, *The Young...*, f. 81.

“mbetur e vetmja zgjidhje”.⁴⁵

Njoftimi zyrtar nga ana e pallatit të sulltanit thoshte: “Sekretariati i përgjithshëm i oborrit perandorak. Në zbatim të urdhrit të Madhërisë së tij Sulltanit, sekretariati i oborrit perandorak ka nderin të kumtojë me këtë qarkore lajmin e mëposhtëm dhe lutet të veprohet në përputhje me udhëzimet e tij: Kushtetuta e Perandorisë, siç dihet, përfaqëson një rend të ri, të dhuruar popullit nga shpirtmadhësia e Madhërisë së tij dhe parasheh krahas qeverisë, ndër shumë masa të tjera të bekuara, edhe përfaqësimin popullor, që i siguron dhe i rregullon asaj të drejtën e funksionimit. Duke qenë se rithirrja e këtij përfaqësimi dëshirohet nga Madhëria e tij dhe se nga ne është shpallur dekreti përkatës (Irade), urdhëron të gjitha zyrat shtetërore në qendër, në vilajete dhe në sanxhaqe, të ndërmarrin hapat e nevojshëm, në mënyrë që, duke u mbështetur në rregullat ligjore të parashikuara për këtë qëllim, populli të zhvillojë zgjedhjet sa më parë dhe të dërgojë përfaqësuesit e tij në parlamentin që do të hapet në kryeqytetin perandorak”.⁴⁶ Vlerësimet që janë dhënë nga studiues shqiptarë dhe të huaj lidhur me këtë ngjarje të rëndësishme (rishpalljes së Kushtetutës së vitit 1876) për historinë e popullit shqiptar dhe ndryshimet në Perandorinë Osmane, i japin rolin kryesor lëvizjes kryengritëse të shqiptarëve dhe Kuvendit të Ferizajt/⁴⁷ madje edhe vetë sulltan Abdyl

⁴⁵ Sulltan Abdylhamiti, *Kujtimet e mia nga politika*, Shkup: “Logos”, 2010, f. 114; Norman Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914*, Tiranë: “Toena”, 2006, f. 345.

⁴⁶ Eqrem bej Vlora, *Kujtime*, Vëllimi i parë (1885-1912), Përktheu nga origjinali gjermanisht: Afrim Koçi, Tiranë: “Shtëpia e Librit & Komunikimit”, 2001, f. 231.

⁴⁷ AIHT, Vj-18-11-1149, Raport i konsullit austro-hungarez nga Mitrovica dërguar MPJ në Vjenë, 30 korrik 1908; Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ASHASH), fondi: Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë - Shtypi dhe periodiku, gazeta “Kombi”, nr. 98, 21 gusht 1908, mikrofilm nr. 0598; Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar II (Rilindja Kombëtare Shqiptare – vitet 30` të shek. XIX-1912)*, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 377; E. Vlora, *Kujtime...*, f. 232; Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897 - 1912)*, Prishtinë: “Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës”, 1978, f. 141; Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës në 1878-1912*, Prishtinë: “Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës”, 1969, f. 124; S. Rizaj, “Roli...”, f. 176; Miranda Vickers, *Shqiptarët – një histori moderne*, Përktheu: Xhevdet Shehu, Tiranë: “Bota shqiptare”, 2008, f. 90; Kristaq Prifti, “Kontributi i shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)”, *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike), nr. 31-32/2001-2002, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2002, f. 229; K. Prifti, *Doktor...*, f. 223; Sulejman Kylçe, *Shqipëria në historinë osmane*, nga origjinali turqisht: përkthyer dhe pajisur me vërejtje nga Zyber Hasan Bakiu, në vitin 1972,

Hamiti II kishte pohuar se një faktor i rëndësishëm në ngjarjet e fundit kishin qenë edhe shqiptarët.⁴⁸

Sipas M. M. Patriok, në veprën e saj “Ndodhina në Bosfor” për ngjarjet e vitit 1908 në kuadër të Perandorisë Osmane, vlerësohet se populli shqiptar kishte qenë fare aktiv në arritjen e ndryshimit të fundit juridik shtetëror osman, duke e cilësuar atë si një ndryshim të madh historik, që më së shumti efekte u reflektuan në Shqipëri.⁴⁹ Ndërkaq, duke konsideruar këtë akt si një nga faktorët që u pasqyruan në ngadhënjimin e Revolucionit të Turqve të Rinj, J. H. Bajur ka shkruar: “Fakti që shqiptarët kërkuar Kushtetutën edhe që një turmë e madhe shqiptarësh mund të zbriste nga rajonet malore në Shkup, Selanik dhe ndoshta edhe më tej, i shkaktoi veçanërisht preokupacion sultanit”.⁵⁰ Po ashtu, edhe historiani Noel Malkolm vë në pah se në rrugën e fitores së Turqve të Rinj shqiptarët luajtën “rolin vendimtar për instalimin e

Tiranë: “Globus R”, 2004, f. 172-173; S. Skendi, *Zgjimi...*, f. 313; Edwin Jasques, *Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: “Kartë e Pendë”, 1996, f. 295; P. Bartl, *Myslimanët...*, f. 194; Robert Mantrani, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: “Dituria”, 2004, f. 534; Georges Castellan, *Historia e Ballkanit (shekulli XVI-XX)*, Tiranë: “Çabej”, 1991, f. 385 - 386; Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane (Osmanli Yönetiminde Arnavutluk ve Arnavut)*, përktheu nga origjinali në turqisht: Dritan Egro, Tiranë: “Dituria”, 2002, f. 248; Grup autorësh, *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*, Vol. 1., Tiranë: “Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam”, 2009, f. 133-134; Isa Bicaç, “Revolucioni Xhonturk, shqiptarët dhe Mali i Zi”, *Kosova*, nr. 20/21, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1998/1999, f. 71; Sadullah Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit – Islam Pira (1861-1931)*, Prishtinë: “Instituti Albanologjik i Prishtinës”, 2008, f. 47; Shaban Hashani, *Ferizaj dhe rrethina 1873-1941 - (Vështruar nga pikëpamja historike)*, Ferizaj, 1998, f. 135; Aliriza Selmani, *Gjilani me rrethinë 1908 - 1912*, Prishtinë: “Lidhja e Historianëve Shqiptarë “Ali Hadri”, 1998, f. 84; Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875 - 1913*, Prishtinë: “Instituti i Historisë-Prishtinë”, f. 177 - 181; Tefik Raka, “Kuvendi i Ferizajt më 1908 në dritën e dokumenteve austro-hungareze”, *Gjurmime albanologjike - seria e shkencave historike*, nr. 25-1995, Prishtinë: “Instituti Albanologjik i Prishtinës”, 1997, f. 107; A. Murati, “Kuvendi...”, f. 110-112; Sylë Ukshini, “Kuvendi i Ferizajt në burimet e proveniencës austro-hungareze”, *Vjetar*, nr. 41-42, Prishtinë: “Arkivi Shtetëror i Kosovës”, 2009, f. 292-300; Universiteti i Tiranës (Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë), *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi)*, Vëllimi II (1908 - 1910), Tiranë, 1976. f. 122, “Kombi”, Boston, nr. 94, 24 korrik 1908.

⁴⁸ R. Abdyl, *Lëvizja...*, f. 34.

⁴⁹ Skënder Luarasi, *Isa Boletini (Jetëshkrim i shkurtër)*, Prishtinë: “Rilindja”, 1972, f. 68-69.

⁵⁰ K. Prifti, “Kontributi...”, f. 229.

tyre në pushtet”.⁵¹ Ndërkaq, Dervish Hima, më 5 gusht të vitit 1908 i shkruante kështu Ibrahim Temos nga Brukseli: “Në sajë të veprimtarisë së atdhetarëve tanë, Abdyl Hamiti u dorëzua. Shpallja e kushtetutës është një fakt real”.⁵² Gazeta Kombi që botohej në Boston, vlerësonte se rishpallja e Kushtetutës u bë si rrjedhojë e vendosmërisë dhe kërkesave të shqiptarëve. Në artikullin e saj me titull “Vigjëloni”, ajo shkruante: “Sulltani dha konstitucie! Rroftë Sulltani. Jo! S’e dha Sulltani, po e shtrënguan gjon turqit! Rrofshin gjonturqit. Jo! S’e dhanë gjonturqit, po shqiptarët e Ysqypit.* Rrofshin shqiptarët e Ysqypit!”.⁵³

Kjo është një vepër “më tepër e shqiptarëve sesa e çdo kombësie tjetër”.⁵⁴ Një rol dhe kontribut të veçantë në ngadhënjimin e Revolucionit Xhonturk kishin dhënë edhe gratë shqiptare. Sipas artikullit “Revolucioni në Turqi” të gazetës serbe “Politika”, thuhet se një rol të posaçëm në Revolucionin Xhonturk kishin dhënë edhe gratë turke (ku përfshihen edhe gratë shqiptare myslimane, F. R.). Në Selanik ato kishin Këshillin Revolucionar të Grave, i cili e ka ndihmuar Komitetin “Bashkim e Përparim”. Kryetare e këtij Këshilli ishte zonja Emine Semiu. Po në këtë artikull thuhet se zonja Xhylistane, e bija e Asim Beut, i vrarë gjatë Revolucionit, kishte njohur gjuhën angleze dhe gjuhën franceze, ku njëkohësisht kishte bashkëpunuar me shtypin e huaj, duke botuar artikuj për Revolucionin Xhonturk.⁵⁵ Pra, shqiptarët me qëndrimin kategorik dhe kërkesat në formë ultimatumit që nxorën nga Kuvendi i Ferizajt, luajtën një rol vendimtar dhe kontribuan në vënien e themeleve për ngadhënjimin e Revolucionit Xhonturk më 24 korrik të vitit 1908, gjeneza e të cilit fillonte që nga paraqitja e Lëvizjes Otomane, e sidomos nga viti 1889 kur u formua shoqëria “Bashkim e Përparim”, në të cilën shqiptarët ishin pjesë aktive dhe e pandashme. Në këtë proces ata dhanë ndihmesën e tyre si nga fuqia fizike e materiale, po ashtu edhe nga ajo intelektuale. Shqiptarët e konsideruan rishpalljen e Kushtetutës nga sulltani si një akt që do t’i jepte lirinë dhe të drejtat kombëtare të shumëkërkua sidomos nga koha e Lidhjes Shqiptare të

⁵¹ Noel Malcolm, *Kosova – një histori e shkurtër*, Përktheu nga anglishtja: Dr. Abdullah Karjagdiu, botim i dytë, Prishtinë-Tiranë: “Koha & Shtëpia e Librit”, 2001, f. 246.

⁵² Kristaq Prifti, *Dervish Hima 1872-1928*, Tiranë: “Elena Gjika”, Tiranë, 1993, f. 191.
* Shkupit.

⁵³ ASHASH, gazeta “Kombi”, nr. 98, 21 gusht 1908, mikrofilm nr. 0611.

⁵⁴ Po aty, *Konstitutsia Ottomane dhe Shqiptaret*, nr. 95, 31 korrik 1908, mikrofilm nr. 0599.

⁵⁵ “Политика”, Београд, nr. 1620, 22 ЈУЛА 1908.

Prizrenit. Kjo ngjarje kishte ngjallur një entuziazëm të madh tek masat e gjera popullore të Perandorisë, duke përfshirë edhe shqiptarët, me ç'rast do të kremtohej me përshtypjen se Kushtetuta do të realizonte aspiratat kombëtare të të gjithë popujve të shtypur nën Perandorinë Osmane. Manifestimet popullore treguan se pushteti autokratik i sulltanit kishte qenë aq i padurueshëm për ta. Kushtetuta në gjithë Shqipërinë ishte përshëndetur me hare të jashtëzakonshme përmes demonstratave e mitingjeve popullore.

Me këtë rast nisën edhe festat sidomos në pjesën evropiane të Perandorisë (vilajetet e Kosovës, Manastirit, Selanikut dhe gjithë Shqipërinë), ku u përfshinë oficerët, nëpunësit dhe i gjithë populli. Kjo ngjarje kishte shërbyer edhe në përforcimin e bashkimit të shqiptarëve, duke përfshirë myslimanë e të krishterë.⁵⁶ Një tablo realiste të festimeve të shqiptarëve e paraqet edhe publicistja angleze Miss Edith Durham, e cila shkruan: *“Ndodhesha në male kur na erdhi lajmi habitës i revolucionit turk. Ishte e pabesueshme. Shpejtova në Shkodër. Asnjë konsullatë s’kish marrë ndonjë lajm tjetër veç proklamimit të kushtetutës. Shkodra qe ndezur flakë... Ngjarja dukej si e pamundur. Vetëm të dielën, më 2 të gushtit filluan proklamatat zyrtare dhe festimet. Atëherë gjithë Shqipëria u çmend nga gëzimi. Të krishterë e myslimanë u bashkuan menjëherë. Besohej se Evropa kishte hyrë në mes dhe sundimi i Turqisë kishte mbaruar. Malësorët zbritën poshtë me rrobat e tyre më të bukura. Në qytet gostiteshin duke bërë titur “Rroftë Kushtetuta” dhe duke zbrazur pushkë gjersa s’mbeti më asnjë fishek në qytet. Megjithëse gjendeshin mbi dy mijë njerëz të armatosur në qytet për dy ditë e netë dhe s’kish as forca policie të mjaftueshme për të shtypur një lëvizje, as ngjarja më e vogël nuk u dëgjua. Secili ishte mjaft i lumtur, që t’i shkonte mendja për keq dhe dëfreheshin me gjithë zemër”.*⁵⁷ Për manifestimet me rastin e rishpalljes së kushtetutës, ato ditë shkruante edhe gazeta *“Kombi”*, e cila konsideronte që gëzimi i saj u ndje në gjithë territorin e Perandorisë, duke filluar nga lumenjtë Tigër dhe Eufrat e deri në Shqipëri, duke u kremtuar në gjuhë të ndryshme, nëpër xhami, kisha e sinagoga. Kudo dëgjoheshin brohoritjet *“Rroftë konstitucia!”*.⁵⁸ Kështu, në Manastir, një gëzim i madh kishte kapluar

⁵⁶ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 34.

⁵⁷ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë: “Argeta-LMG”, 2001, f. 201; Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet (Traditë, ngjarje, njerëz...)*, Vëllimi II, Shkodër: “Idromeno”, 1999, f. 355-357.

⁵⁸ *ASHASH*, gazeta “Kombi”, *Konstitutsia Ottomane dhe Shqiptarët*, nr. 95, 31 korrik 1908, mikrofilm nr. 0599.

gjithë popullin, i cili kishte zgjatur për tri ditë e tri net, gjë që ishte festuar në atë mënyrë, saqë nuk kishte nevojë as për forca të ruajtjes së rendit, gjë e cila ishte për t'u lakmuar.⁵⁹ Më 25 korrik aty kishin ardhur edhe Nijazi Beu e Çerçiz Topulli, së bashku me trima të tjerë shqiptarë për të cilët ishte organizuar një pritje imponante.⁶⁰

Një përshtypje të madhe kishte lënë edhe manifestimi në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, ku delegatët që kishin marrë pjesë në Kuvendin e Ferizajt, më 24 korrik i kishin hipur trenit dhe ishin nisur për në Shkup. Atyre iu kishin bashkëngjitur edhe 60 përfaqësues të Kuvendit të Ferizajt, të cilët ishin pritur në mënyrë madhështore nga autoritetet dhe qytetarët, ku nën përcjelljen e nderimeve me muzikë ushtarake e 20 breshëri topash,⁶¹ ishte ngritur flamuri dhe valiu kishte pranuar urimet.⁶² Në këtë ngjarje ishin nisur rreth 4 000 shqiptarë të armatosur, të cilët kërkonin autonominë e Shqipërisë me qendër në Shkup, mirëpo, me ndërhyrjen e Komitetit Xhonturk u pengua hyrja e tyre në qytet, duke lejuar që aty të merrnin pjesë vetëm një grup i vogël delegatësh të shoqëruar nga disa krerë, në mesin e të cilëve ishte Bajram Curri dhe myftiu i Prishtinës. Xhonturqit i bënë të ditur atyre se ishte bërë ndalimi i ndërtimit të hekurudhës Uvac-Mitrovicë dhe për këtë gjë do të vendoste parlamenti. Shqiptarët morën premtimin se do të largoheshin oficerët joshqiptarë nga trevat e tyre dhe do t'u lejohej pjesëmarrja në administrimin e vendit.⁶³ Manifestime të ngjashme u shënuan edhe në qytete të tjera të Vilajetit të Kosovës, si në Pejë, Gjakovë e Prizren, të cilat ndiqeshin nga breshëri topash e të shtëna armësh nga masa popullore.⁶⁴ Në Prizren ishte organizuar një manifestim me rastin e kthimit të Sherif Efendiut dhe Jahja Agës, dy delegatë pjesëmarrës në kremtimin e Shkupit, të cilëve iu organizua një pritje imponante në hyrje të qytetit nga ana e klerit, nxënësve të shkollave dhe nga gjithë kori i oficerëve në krye me Sali Pashën, të cilëve i dhuruan tufa lulesh. Pjesëmarrësit brohoritnin me

⁵⁹ *AIHT*, Vj-18-12-1236, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri dërguar MPJ në Vjenë, 26 korrik 1908.

⁶⁰ S. Kylçe, *Shqiptarët...*, f. 174.

⁶¹ *AIHT*, Vj-18-4-497, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Manastiri dërguar MPJ në Vjenë, 25 korrik 1908.

⁶² S. Riza, "Roli...", f. 176.

⁶³ Shfaqet Pllana, "Kuvendi i Ferizajt më 1908 sipas disa bashkëkohësve", *Gjurmime Albanologjike* (Seria e shkencave historike), nr. 26-1996, Prishtinë: "Instituti Albanologjik i Prishtinës", 1997, f. 111.

⁶⁴ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 36.

parullat “rroftë kombi”, “rroftë liria”, ndërsa në kala të qytetit u shkrepën 24 plutona topash.⁶⁵ Me këtë rast u shpall amnistia në Vilajetin e Kosovës, u liruan të burgosurit që ndodheshin në qytete, madje edhe në Vilajetin e Manastirit⁶⁶ e më gjerë.⁶⁷

Edhe qytete të tjera në vise të Shqipërisë, si në: Gjirokastrë, Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan e Vlorë, e kremtuan aktin e rishpalljes së Kushtetutës, e cila konsiderohej në popull si shpallje e hyrietit (lirisë). Në Korçë kjo ngjarje ishte kremtuar për tri ditë me radhë. Populli bënte betimin për besnikëri mbi aktin e shpalljes së hyrietit. Myslimanët vinin dorën mbi Kuran, ndërsa të krishterët mbi Ungjill. Manifestimi përcillej me këngë e me valle, me përqaftime, vizita e urime nëpër shtëpi. Njerëzit i grisnin festet e kuqe dhe në vend të tyre vinin në kokë qylafë të bardhë dhe kapele evropiane. Në qytet ishte ngritur edhe një tribunë nga ku mbaheshin fjalime të zjarra në shqip, turqisht, greqisht e frëngjisht.⁶⁸ Në Elbasan populli kishte kremtuar me gosti, këngë e valle kombëtare. Burrat përqafoheshin me njëri-tjetrin dhe thërrisnin “Rroftë hyrrieti! Rroftë gjuha shqipe!”.⁶⁹ Ndërsa, në Vlorë ishin mbajtur mbledhje e parakalime festive, ishin afishuar shpallje në gjuhën shqipe e në gjuhën turke, në të cilat shkruhej: “*Të bashkuar dhe me forca të përbashkëta ne, si kombet e tjera, do të punojmë për të mirën dhe përparimin e atdheut*”. Ndërkaq, në Tuz, ku ndodhej një garnizon i rëndësishëm i përbërë nga ushtarë turq dhe shqiptarë, rishpallja e Kushtetutës kishte ndikuar në vëllazërimin ndërmjet ushtarëve mysli-manë dhe popullsisë katolike të vendit.⁷⁰ Shqiptarët e konsideruan ngjarjen e rishpalljes së Kushtetutës si një manifest të plotësimit të idealeve kombëtare. Në sheshin Olympus të Selanikut, u mbajt haptas fjalimi i parë në gjuhën shqipe. Aty u tha: “... tani është dita edhe për ne të themi lirisht se jemi shqiptarë. Gjer më sot nuk mundnim ta thoshim këtë, sepse na pritej gjuha, hidheshim në burg. Porse tani do ta themi me vetëdijen tonë, me gëzim dhe shpresë në zemrat tona”. Ndërsa për të provuar patriotizmin e tyre, ata i

⁶⁵ Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX*, Prishtinë: “Instituti i Historisë i Kosovës”, 1998, f. 311.

⁶⁶ R. Abdyli, *Lëvizja...*, f. 36.

⁶⁷ R. Mantrani, *Historia...*, f. 536.

⁶⁸ *Kujtime veteranësh për Luftën Çlirimtare Kombëtare në vitet 1878-1912*, “Rilindja” (Fejton), Prishtinë, 28.IV.1970.

⁶⁹ Po aty, 29.IV.1970.

⁷⁰ P. Bartl, *Myslimanët...*, f. 195.

përfundonin fjalimet me sloganin: “*Rroftë Liria! Rroftë Shqipëria*”.⁷¹ Pra, shqiptarët nga të gjitha viset e Shqipërisë, përmes festimeve të ndryshme që zgjatën ditë të tëra me rastin e rishpalljes së Kushtetutës së Mit’had Pashës (1876), provuan se përfshirja e tyre në Lëvizjen Xhonturke dhe ngadhënjimin e saj, pasqyrohej në lirinë dhe barazinë për të gjithë popujt e Perandorisë dhe në të njëjtën kohë për realizimin e të drejtave dhe aspiratave kombëtare të tyre.

⁷¹ S. Skendi, *Zgjidhimi...*, f. 313-314.

Fitim RIFATI

SUMMARY

ALBANIANS AND THE YOUNG TURKS MOVEMENT (SECOND HALF OF JULY – AUGUST 1908)

Sultan Abdul Hamid II was initially hesitant and maintained a passive stance in relation to the events that took place in the summer of 1908 in the Vilayet of Kosova, Manastir and Thessaloniki. He was of the opinion that he could manage the situation by simply replacing the Viziers in the respective Vilayets, which he believed would consequently mitigate the political situation within the Empire. However, this did not occur, he lost his faith in the people who were in power and as such he was left without options in relation to the requests presented by the insurgents gathered in Ferizaj and elsewhere throughout the Empire. The longer he ignored the requests presented by the Albanian insurgents, the more sullen the latter became. There were many disputes between the Albanians at the Convention of Ferizaj in regards to what measures were to be taken further. Ultimately, it was agreed that they would offer their support to the Young Turks, and all participants agreed in favor of the Constitution approved in 1876.

The decisiveness with which the Albanians from the Convention of Ferizaj confronted the Sultan, made the latter agree in regards to mandating the Constitution of 1876 once again. This action was followed by various festivities and euphoria throughout the Ottoman Empire, but among Albanians as well, because the constitution by itself guaranteed freedom and protection of property to all citizens equally. Therefore, it is argued that Albanians played an important and decisive role with their contribution in establishing the foundations for the Young Turks' Revolution on the 24th of July 1908, whose revolution originated from the Ottoman Movement, in particular since 1899 when the society 'Unity and Prosperity' was founded, part of which were many Albanians.

Xheladin SHALA

SHQIPËRIA NË KOHËN E PRINC VIDIT 1914

Caktimi i Princ Vidit në fronin e Shqipërisë

Pra, ndërhyrjet e shteteve fqinje dhe të fuqive evropiane ndaj pavarësisë së shpallur më 28 nëntor të vitit 1912, nuk pushuan. Ato ishin të llojllojshme dhe kulmi i tyre arriti më 12 tetor 1913 me “Shpalljen e pleqësisë” së Durrësit nga ana e Esat Pashës, që ishte një vepër antikombëtare, e kurdisur dhe e stimuluar nga jashtë, por e përqafuar edhe prej mbeturinave të ndryshme të vendit. Derisa asokohe bëhej një propagandë në favor të një princi mysliman (ishte koha e një marrëveshjeje turko-bullgaro-shqiptare), fuqitë evropiane vendosën përfundimisht në nëntor të vitit 1913 që për princ të Shqipërisë të ishte gjermani Vilhelm Von Vid, i propozuar nga Austro-Hungaria dhe Italia, gjë që situata u bë edhe më polarizuese për disa segmente të shoqërisë fanatike shqiptare. Një pjesë ishte kundër, por rrethet atdhedashëse u bashkuan me vendimin e Fuqive të Mëdha. Mirëpo, duhet theksuar se në Shqipëri në fund të vitit 1913 dhe në fillim të vitit 1914 u bë një pështjellim i madh, duke u krijuar një situatë kaotike. Madje, pat tentime për organizimin e një kryengritjeje të armatosur në favor të kandidimit të princit mysliman, ku ishte përfshirë Beqir Grebeneja, e që konsiderohej si një “komplot” i xhonturqve. Ai ishte oficer turk me origjinë shqiptare që i kishte vënë vetes si qëllim të rivendos integritetin e tokave shqiptare, kuptohet që aty të rikthehej Kosova dhe Çamëria.¹ Mirëpo, më 8 nëntor me propozimin e Austro-Hungarisë e të Italisë dhe në marrëveshje midis gjashtë Fuqive të Mëdha u caktua Vilhelm Vidi -

¹ Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretarijata Inostranih Poslova - Allbanski Odsek - 1914, fasc. I, dos. IV, br. 68; Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 111.

Princ i Shqipërisë.² Në realitet, në fund të vitit 1913 dhe në fillim të vitit 1914, shteti shqiptar i njohur në Konferencën e Londrës në pikëpamje politike ishte me të vërtetë në një pozitë të mjeruar. Pushteti i qeverisë së Vlorës ishte ngushtuar vetëm në Vlorë. Në Durrës vepronte “Pleqësia” e Esat Pashës, në Orosh të Mirditës qeveriste Prenk Bib Doda; në Fier e Muzeqe-Aziz pashë Vrioni, në Lezhë-Dedë Coku, në Shëngjin-Vat Marashi; në Shkodër një detashment i ushtrive ndërkombëtare nën kryesinë e kolonelit anglez Filips, ndërsa në Himarë sundonte agjenti grek, Spiro Milo. Në jug të Shqipërisë ishte qeveria kukull e Athinës e ashtuquajtur “Vorio Epiri”, nën udhëheqjen e ish-ministrit grek, Kristaq Zografos. Në Mat sundonte Ahmet Myftari dhe shumë grupe mercenarësh që vepronin përgjatë kufijve verilindor të caktuar në Londër, si: Arif Hiqmeti, Jusuf Beu, Dervish Beu etj.³ Pra, shtetin e ri shqiptar e kishte përfshirë një ndarje dhe konflikt krahinor, të cilët ishin të nxitur e stimuluar nga qeveritë e shteteve fqinje.

Pranimi për ardhjen e Princ Vidit

Kështu, pas krijimit të një vargu të gjatë të pushteteve lokale, qeveria e Vlorës dhe udhëheqësi i saj dhanë pëlqimin për ardhjen e Princ Vidit në Shqipëri. Andaj, më 22 janar 1914 Ismail Qemali dhe kabineti i tij dhanë dorëheqje, duke ia dorëzuar prerogativat e pushtetit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të ardhur në tetor të vitit 1913. Gjithashtu, Esat Pasha me “Pleqësinë” e tij dhanë dorëheqje më 12 shkurt 1914. Edhe “qeveritë tjera lokale” në Shqipëri, njëra pas tjetrës, u detyruan ta njohin Princ Vidin si të vetmin sundimtar të Shqipërisë. Për disa ditë duhej kryer disa “obligime” rreth huas për të cilin ishin zotuar Fuqitë e Mëdha për të filluar puna në organet shtetërore të Shqipërisë.⁴ Në të vërtetë, Princ Vidi kërkoi t’i jepej një avancë prej 10 milionë frangash mbi huan prej 75 milionësh të garantuara nga gjashtë Fuqitë e Mëdha.⁵ Për atë kohë thuhej se qarqet politike atdhetare në ato momente kritike nuk u orientuan drejt. Mirëpo, duke mos pasur kurrfarë rrugëdalje, ato të gjitha shpresat i mbështetën

² Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 206.

³ Kristo Frashëri, Kryengritja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme (1914-1915), Buletin për shkencat shoqërore, nr. 1, Tiranë 1954, 23; DASSIP-AO-1914, fasc. II, dos. VII, br. 325.

⁴ DASSIP-AO-1914, fasc. I, dos. V, br. 12.

⁵ Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 206.

te mbreti, cilido që të ishte e sido që të quhej,⁶ me qëllim që të formohej një qeveri e vetme për Shqipëri dhe t'i jepej fund përçarjes dhe anarkisë që e kishte kapluar shtetin e ri shqiptar, pasi që një varg faktorësh destabilizues vepruan brenda vendit. Pra, çështja shqiptare, pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër, jo që nuk avancoi, përkundrazi degradoi.⁷

Princ Vilhelm Vidi arriti në Durrës më 7 mars 1914 në orën 15:00. Ndërkaq, 10 ditë më vonë, më 17 mars, në Durrës u krijua qeveria, e cila përbëhej nga 8 anëtarë: Turhan Pasha-kryeministër dhe ministër i Jashtëm, Esat Pasha-ministër i Luftës dhe i Punëve të Brendshme, Myfit Libohova-ministër i Drejtësisë, dr. Adamidhi-ministër i Financave, Prenk Bib Doda-për Punët Botërore, Aziz pashë Vrioni-ministër i Bujqësisë dhe Tregtisë, Hasan Prishtina-ministër i PTT dhe dr. Turtulli-ministër i Arsimit dhe Shëndetësisë⁸. Thuhej se kryeministrin e sugjeruar me këmbëngulje nga dy fuqitë evropiane (Rusia dhe Franca) e lidhte me shqiptarët dhe Shqipërinë vetëm një origjinë e largët. Turhan Pasha kishte qenë së fundi ambasador i sulltanit pranë Carit të Rusisë në Peterburg (1908-1913) dhe kishte më se gjysmë shekulli që nuk kishte shkelur në vendin, ku ai vinte ta kryesonte qeverinë.⁹ Vetvetiu kuptohet se Fuqitë e Mëdha e të dyja blloqeve bënë kompromis: Austro-Hungaria, Italia dhe Gjermania propozuan Princ Vidin, kurse Rusia dhe Franca - Turhan Pashën. Ndërkaq, dy pozitat kyçe të Esat Pashës ishin si lëshime ndaj shteteve fqinje ballkanike, me të cilat ai ishte i lidhur më së shumti. Pra, Princ Vidin e njohën Fuqitë e Mëdha, e pas tyre edhe shtetet ballkanike. Thuhej se pranimin e qeverisë së Vidit të parët e njohën më 24 mars 1914 qeveritë e Rumanisë, të Austro-Hungarisë dhe të Italisë.¹⁰ Konkluzioni mbi njohjen e qeverisë së Vidit edhe nga ana e të gjashtë Fuqive të Mëdha, janë rrjedhë e vetë logjikës së gjërave. Mirëpo,

⁶ Piro Tako, Luigj Gurakuqi, Tiranë 1980, 220; Ismail Qemali, Kujtime, Tiranë 1997, 323.

⁷ Emine Arifi - Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë 2011, 217.

⁸ Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912 - 1914, Tiranë 1978, 580-581; Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 119; Ismail Qemali, Kujtime, Tiranë 1997, 323.

⁹ Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912 - 1914, Tiranë 1978, 581; Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 119; Turhan Pasha nuk e fliste mirë shqipen dhe ishte mik personal i Carit rus.

¹⁰ DASSIP-AO-1914, fasc. II, dos. V, br. 614.

marrëdhëniet diplomatike me të nuk vendosën të gjitha Fuqitë e Mëdha, por vetëm katër prej tyre: Austro-Hungaria, Italia, Franca dhe Gjermania. Anglia dhe Rusia nuk akredituan pranë qeverisë së Vidit përfaqësues të tyre diplomatikë, ndonëse rezultoi që çështja të jetë marrë në shqyrtim në dikasteret përkatëse që në muajin prill 1914.¹¹

Problemët e qeverisjes së Princ Vidit

Mirëpo, që në ditët e para të qeverisjes së Vidit u vërejt paaftësia e tij që ta bashkojë vendin e proklamuar në Konferencën e Londrës. Kokëçarje më të mëdha Princit i nxorën ushtritë pushtuese fqinje në jug, ato të Greqisë dhe në veri e verilindje ato serbo-malazeze, të cilat vazhdonin t'i mbanin të pushtuara tokat shqiptare në ato pjesë. Pastaj, ato qarqe i përkrahnin elementët antikombëtar si: Arif Hikmetin, Jusuf Beun, Spiro Milon, Marka Gjonin, Zografon etj. Po ashtu, që në fillim u vërejt mosangazhimi dhe paaftësia e ministrave bejlerë e pashallarë për t'u rrekur me problemet e ngutshme në zbutjen e gjendjes së mjeruar të popullsisë. Si probleme të theksuara paraqiten shqiptarët e shpërngulur nga gjysma tjetër e Shqipërisë së robëruar, që ajo pjesë luftonte për jetë a vdekje. Pra, qeveria e Vidit nuk mori masa në fillim në brendi të Shqipërisë dhe se ajo ishte ngujuar në Durrës.

Kështu, formimi i qeverisë, të përbërë nga katër pashallarë dhe nga katër bejlerë, ishte deziluzioni i parë që pësuan elementët përparimtarë shqiptarë pas ardhjes së Princit.¹² Asokohe, në gjysmën e dhjetëditëshit të tretë të muajit mars 1914 në rrethinën e Malishevës, Therandës dhe Rahavecit, më konkretisht në: Banjë, Karvasari, Bellanicë dhe në fshatra përreth u organizua një kryengritje, e cila u quajt Kryengritja në Kosovë në muajt mars-prill 1914. Kryengritësit shqiptarë luftuan për liri dhe të drejta kombëtare kundër pushtetit të Serbisë, i cili ishte bërë i padurueshëm. Kryengritja kishte për qëllim ta vë në lëvizje tërë popullin shqiptar, me qëllim çlirimin e kësaj gjysme tjetër të Shqipërisë së robëruar. Mirëpo, pushtetmbajtësit serbë nga frika e zgjerimit të kryengritjes morën masa të menjëhershme, duke e rrethuar me ushtri dhe polici nga të gjitha anët. Ajo kryengritje zgjati nga java e fundit të marsit deri në javën e parë të muajit prill 1914. Kundër kryengritësve u morën masa të ashpra, për çka qeveria e Vidit mori

¹¹ Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912 - 1914, Tiranë 1978, 591-592.

¹² Gazmend Shpuza, Kryengritja e Haxhi Qamilit, Tiranë 1979, 34.

informata shqetësuese. Rëndësia e kryengritjes në Kosovë e zhvilluar në muajt mars-prill 1914 qëndron në atë se, për herë të parë shpërtheu në brendi të Kosovës kundër okupimit serbo-malazez më 1912. Duhet theksuar se një barrë e rëndë vazhdonte të qëndronte edhe më tej çështja e “Vorio Epirit”, për të cilën ishte angazhuar majori holandez Tomson, që edhe ajo pjesë e atdheut përjetonte masakra të papara, e cila duhej t’i bashkohej amës së vet.¹³ Anëtarët e “Vorio Epirit” ishin kukulla të qeverisë së Athinës, kurse vetë udhëheqësi i saj Zografo, ishte agjent i saj.

Komploti i Esat Pashës

Mirëpo, shthurjet dhe turbullirat nga ndërhyrjet e shteteve fqinje në verilindje dhe në jug të Shqipërisë së proklamuar në Londër më 1913, nuk iu konvenonin disa fuqive evropiane, sidomos Austro-Hungarisë dhe Italisë, qëllimi i të cilëve ishte që të mos e lejojnë asnjë shtet tjetër ta rrezikojnë bregdetin shqiptar, i cili sipas politikave të tyre ishte një “baraspeshë” në Adriatik.¹⁴ Ndërkohë, Esat Pasha si ministër i Brendshëm dhe i Luftës qysh në fillim u shpërnda armë mercenarëve të vet “kinse për t’iu bërë ballë shteteve fqinje”, fshehtas propagandonte nëpërmjet pasuesve të vetë kundër Vedit, duke i këshilluar “me kërkua një mbret prej Stambollit, me qëllim që këto pështjellime e trazime t’i sillnin fitim për ta shtie në dorë pushtetin”.¹⁵ Me kohë dihej se Esat Pasha ishte një antividist i përbetuar. Megjithëse iu dhanë dy poste më të rëndësishme, ai nuk u kënaq as me to, por e dëshironte mandatin për formimin e qeverisë. Pastaj, nervozën e shprehu edhe kur nuk iu besuan forcat për të intervenuar në Shqipërinë Jugore - në të ashtuquajtur “Vorio Epir”. Por, tensioni tek ai u rrit kur u bënë disa ndërrime në qeveri, të cilat, gjithsesi nuk shkonin në favor të tij. Për ta organizuar komplotin, mercenarët e Esatit dhe të Arif Hiqmetit përhapnin fjalë se Vilhelm Vidi do t’iu heqë fenë islame dhe se “mbaroi myslimanizmi” (e kjo shkaktonte huti te masa e pashkolluar, fanatike), andaj sipas tyre kërkohesh të largohej sa më parë. Kurse, refugjatëve të dëbuar nga Dibra, Gostivari, Struga etj., të cilët ishin larguar nga masat e ushtrisë serbe pas Kryengritjes së Shtatorit 1913, iu jepnin premtime boshe se po ta heqin qafe Vilhelm Vidin, serbët do t’ua dorëzojnë përsëri tokat e

¹³ DASSIP-AO-1914, fasc. I, dos. V, br. 571.

¹⁴ AS-MID-PO-1914, fasc. VII, dos. IV/14, br. 76.

¹⁵ Gaspër Mikeli, Njoftime historike mbi Shqypni, Shkodër 1932, 55 - 56.

rrëmbyera.¹⁶ Publicisti dhe atdhetari i njohur Nikollë Ivanaj, me një rast shkruan: “Bib Doda si tue u tallë, i patë thanë Princ Vidit në Durrës; pa m’vra mue, Esat Pashanë dhe Ismail Qemalin, nuk bahet Shqipnija”.¹⁷

Pra, me gjithë ardhjen e V. Vidit, pozita e popullit shqiptar nuk u përmirësua, përkundrazi gjendja vazhdonte të ishte e rëndë. Kështu, kundërthëniet e brendshme dhe ato të jashtme gërshetoheshin në ashpërsimin e tyre. Kjo kuptohet, ishte edhe si rezultat i mbrapshtive të Esat Pashës, si ministër i dy portofolave më të rëndësishme, por që e detyroi V. Vidin më 19 maj pas një aksioni të shpejtë dhe energjik ta bllokojë në Durrës. Mirëpo, Esatin e mori në mbrojtje Italia. Pra, vet Esati u largua i pari nga Shqipëria, sepse donte të tregohej më “mbret” se mbreti me intriga të shumta. Dëbimi i kryepersonazhit, mercenar i shteteve ballkanike, i revoltoi qeveritë e tyre, duke parë në të si humbje të madhe për shërbim të interesave megalomane ndaj Shqipërisë. Mbizotëronte mendimi se Esat Pasha ishte “prishësi kryesor i unitetit shqiptar”.¹⁸ Për ngjarjet e asaj kohe shtypi shqiptar shkruante: “Na duket se bijtë e Shqipërisë e kanë për detyrë t’i tregojnë botës se kanë të drejtë që të rrojnë dhe lypset ta provojnë duke shpëtuar Shqipërinë nga feudalët, intrigantët e tradhtarët”.¹⁹ Pos tjerëve, në këto turbullira kishte kontribuar shumë edhe Arif Hiqmeti, i cili ishte vënë në shërbim të Serbisë. Dihej se qëllimi ishte që “Shqipëria të trazohet, të derdhet gjaku dhe Evropa të bindet se çrregullimet nuk do të ndërpriten derisa Vidi nuk largohet nga Shqipëria dhe të mos bëhet ndarja e re e Shqipërisë”.²⁰ Ajo ishte motoja e Arif Hiqmetit dhe nxitësve e pasuesve të tij të verbër. Me rastin e zbulimit më 19 maj të komplotit të Esat Pashës, më 20 maj të gjithë ministrat japin dorëheqje, por me sugjerimin e V. Vidit duhej t’i kryenin për disa ditë obligimet.²¹ Pra, Esati në pozitat e dy ministrive kyçe qëndroi më tepër se dy muaj, derisa u zbulua komploti i tij. Asokohe flitej se në organizimin e atij komploti

¹⁶ M. Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë 1944, 262; Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh (1888 - 1919), përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë 2002, 411.

¹⁷ Nikollë Ivanaj, Historia e Shqypëniës së Re - Vujejtjet e veprimet e mija, Pjesa e parë, Tiranë 1943, 68.

¹⁸ Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 196.

¹⁹ Populli, 8-VII-1914, Vlorë.

²⁰ Shukri Rahimi, Marrëveshjet e qeverisë serbe me Esat pashë Toptanin gjatë viteve 1914 - 1915, Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike, nr. 6 - 1976, Prishtinë 1977, 119.

²¹ DASSIP-AO-1914, fasc. II, dos. I, br. 1044.

nëpërmjet mercenarëve të vet që i kishte në Durrës ishte futur edhe Rusia cariste. Thuhej se Esat Pashën e vizitonte nga dy-tri herë në ditë një rus, por që u vërtetua se ai ishte një agjent serb.²² Në të vërtetë, me rastin e zbulimit të komplotit aty u zunë edhe dy agjentë italianë.²³

Pas largimit të Esatit, më 29 maj 1914 u bënë disa ndryshime në qeverinë e V. Vidit: Turhan Pasha-kryeministër, Prenk Bib Doda-ministër i Punëve të Jashtme, ndërsa ministër i Punëve të Brendshme-Aqif pashë Elbasani, i Financave-F. Noga, i Drejtësisë-Myfit Libohova, i Arsimit-dr. Turtulli, i Bujqësisë-Abdi Toptani dhe ministër i Ndërtimitarisë-Mit'hat Frashëri. Ndërkaq, Hasan Prishtinës i është ofruar Ministria e Postë-Telegrafës për të dytën herë, që si duket e ka refuzuar. Mirëpo, theksohej se një zgjedhje e tillë e anëtarëve të qeverisë nuk do të zgjidhë asnjë problem. Asokohe thuhej se Isa Boletini i ofron qeverisë së re shqiptarët e Kosovës.²⁴ Në të vërtetë, situata në Shqipëri ishte elektrizuar edhe nga paaftësia e V. Vidit që të bëjë ndonjë hap të guximshëm. Ai interesohej dhe kërkonte ruajtjen e qeverisë të ngjuar në Durrës. Më 24 qershor Princ Vidi priti shqiptarët e Kosovës, si: Isa Boletinin, Bedri Pejantin, Rexhep Mitrovicën, Mehmet Dërrallën dhe Hajdin Dragën. Gjithashtu, kah fundi i qershorit 1914 edhe Ahmet Zogu me 1 000 matjanë shprehu gatishmërinë t'i shërbejë V. Vedit. Në ndihmë shkuan edhe Aziz pashë Vrioni, Prenk Bib Doda, Bektash Cakrani etj.²⁵

Ndërhyrjet dhe kryengritja antividiste

Asokohe, si mbështetëse më e madhe e qeverisjes providist ishte Austro-Hungaria. Ndërkohë, veç kishte filluar një kryengritje fshatare në Shqipëri të Mesme, e cila ishte një lëvizje anakronike e kohës. Mbizotëronte mendimi se atë lëvizje e ushqenin Turqia dhe Bullgaria. Gjithashtu, nga qarqe të ndryshme akuzohej edhe Serbia se gjoja ajo ishte “shpirti i lëvizjes fshatare”, e cila në mënyrë të shkathtë ishte drejtuar kundër V. Vidit, me qëllim të qartë për t'i bindur Fuqitë e Mëdha se Shqipëria nuk mund të qëndrojë si shtet.²⁶ Atëbotë u shfaq

²² Populli, 30-V-1914, Vlorë.

²³ M. Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë 1944, 264; Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 215.

²⁴ DASSIP-AO-1914, fasc. I, dos. VI, br. 1146; Populli, 19-VI-1914, Vlorë.

²⁵ Populli, 26-VI-1914, Vlorë; Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 119.

²⁶ AS-MID-PO-1914, fasc. II, dos. III/15, br. 98.

frika se ngjarjet në Shqipëri do të shkaktojnë ndërlikime në Ballkan dhe më gjerë, ngase në Kosovë dhe Maqedoni organet policore dhe ushtarake serbe silleshin shumë vrazhdë ndaj popullit shqiptar dhe atij maqedonas. Serbët dhe malazezët po djegin, po vrasin, po presin e po masakrojnë. Gjithçka ka marrë pamjen e një kasaphane.²⁷

Ishte mesi i vitit 1914, kur shthurjet dhe ndërhyrjet e të huajve në punët e brendshme të Shqipërisë ishin në rritje e sipër. Mbretëresha Sofia, në një letër drejtuar mbretëreshës së Rumanisë në qershor të vitit 1914, e përshkroi situatën e çiftit mbretëror në këtë mënyrë: “Pa ushtri, pa para, pa ditur gjuhën, të rrethuar prej miqve pjesërisht të dyshimtë dhe prej influencave të dyshimta nga jashtë, gjendja jonë është shumë e vështirë”.²⁸ Kurse, gazeta *Populli* shkruante: “Për fat të keq Shqipëria është e rrethuar me armiq, dhe armiq të fortë, që nuk lënë gjë pa folur kundër nesh. Po edhe Evropa nuk mendon për shqiptarët ndryshe. Të gjitha të ligat janë shprazur mbi shqiptarët”.²⁹ Për fat të keq, me apo pa vetëdije, asaj gjendje i kontribuonin edhe lëvizjet e kryengritjet e dyshimta të shqiptarëve. Njëra ndër to ishte edhe Kryengritja fshatare (që udhëhiqej nga Musa Qazimi, Mustafa Ndroqi, Haxhi Qamili, Haxhi Aliu etj.) që shpërtheu në Shqipëri të Mesme si shprehje e pakënaqësisë së kinse myslimanëve, por që kishte karakter religjioz.³⁰ Shpërthimi i Kryengritjes në Shqipëri të Mesme u cilësua si antikombëtare, meqë kishin dorë oficerët ushtarakë të shteteve fqinje.³¹ Dhe, me të drejtë u quajt Lëvizje Rebele në Shqipërinë e Mesme gjatë viteve 1914-1915, që pat efekt tejet negativ për çështjen shqiptare.³² Në të vërtetë, Kryengritja fshatare dhe ngjarjet e ndryshme në Shqipëri ishin si rezultat i koniunkturave politike të fuqive evropiane dhe shteteve satelite ballkanike në përgatitjen e fazës së re të konfrontimit midis blloqeve. Prandaj, “Kryengritja fshatare është edhe një re e zezë që i është bashkangjitur hapësirës politike të Evropës. Ajo ndoshta do të shpejtojë atë fatkeqësi, që po përgatitet dhe që po i kërcënohet Evropës. Çështja shqiptare nuk do të vendoset tani për tani, e as më vonë, kjo

²⁷ AS-MID-PO-1914, fasc. II, dos. III/15, br. 239; Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh (188 - 1919), përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë 2002, 379.

²⁸ Karl Buhberger, Vjetët e mija në Shqipëri, Studime historike, nr. 4, Tiranë 1972, 172.

²⁹ Populli, 4-VIII-1914, Vlorë.

³⁰ AS-MID-PO-1914, fasc. II, dos. X, br. III/15.

³¹ Emine Arifi - Bakalli, Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare, Prishtinë 2011, 234.

³² Po aty, 209.

është pjesë përbërëse e asaj çështjeje të madhe që do të vendoset në konfliktin e madh evropian”. Me të vërtetë ishte koha kur Ballkani kundërmonte erë lufte të re, që do të shndërrohej në konflikt të përgjithshëm botëror.³³ Gjithashtu, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit vazhdoi të ishte arenë e ndeshjes së interesave të kundërta të gjashtë Fuqive. Një gjendje e tillë nuk mund të mos reflektohej në pozitën e qeverisë së Vidit, e cila praktikisht u paralizua në veprimtarinë e saj. Kështu, diplomacia e Fuqive të Mëdha dalëngadalë i dha fund krijesës së saj, meqë u reflektua vazhdimi i antagonizmave të gjashtë fuqive evropiane.³⁴ Ndërkaq, anëtarët e KNK ishin: 1. Dr. Vinkel i Gjermanisë, 2. Petroviq i Austro-Hungarisë, 3. Krajevski i Francës, 4. Lemb i Anglisë, 5. Leoni i Italisë dhe 6. Petrajev i Rusisë.³⁵

Kështu, pas ngjarjeve të stuhishme në maj-qershor dhe fillim të korrikut 1914, në shtypin e huaj shkruhej kundër shqiptarëve, duke parashikuar se në Ballkan po përgatitet përsëri stuhia për ta ndezur tërë siujdhesën. Disa shkruajnë se “shqiptarët nuk janë komb për qytetërim” dhe se Konferenca e Londrës “bëri gabim duke krijuar një shtet, i cili nuk mund të ekzistoj në Ballkan” dhe se “ka për të mbetur një brengë përgjithmonë” për diplomacinë e Evropës. Ato ishin gazetët e Rusisë, të Francës, të Serbisë, të Greqisë dhe të Turqisë, duke kërkuar copëtimin e Shqipërisë midis shteteve fqinje.³⁶ Ndërkaq, sa i përket shqiptarëve të Kosovës të vendosur në Shqipëri së bashku me krerët e vetë udhëheqës, që nga dorëheqja e I. Qemalit një kohë mbetën anash, duke pritur se si po zhvillohen ngjarjet e njëpasnjëshme aspak të këndshme për popullin tonë. Duke luftuar me shekuj kundër Perandorisë Osmane, në shpirtin e tyre ende i ndjenin thellë ekspeditat ndëshkuese, andaj ata nuk mund të “bindeshin” për karakterin “kombëtar” të kryengritësve fshatarë, pas kërkesave të para për princin e flamurin turk dhe një varg kërkesash me karakter religjioz. Asokohe, shqiptarët nga Kosova pas Shkodrës, Vlorës gjetën vendosje më të sigurt në Durrës. Fundja, Durrësi ishte zyrtarisht kryeqytet i Shqipërisë. Pastaj, ata shihnin në personalitetin e Vilhelm Vedit si mbrojtësin më të sigurt të pacenueshmërisë territoriale të 1913, prej Fuqive të Mëdha, sidomos nga rreziku i grabitqarëve të shteteve fqinje, që vazhdimisht prisnin momentin të shkëputnin edhe

³³ AS-MID-PO-1914, fasc. VII, dos. VII, br. IV/2; Zekeria Cana, Dimitrije Tucoviqi, Prishtinë 1983, 105.

³⁴ Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 210-211.

³⁵ Ismail Qemali, Permbledhje dokumentesh (1888 - 1919), përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë 2002, 365.

³⁶ Populli, 13-VI-1914, Vlorë; Trgovinski Glasnik, 25-V dhe 7-VI-1914, Beograd.

ndonjë copë të territorit shqiptar. Në fund, duhej kuptuar se lidhjet territoriale të Shqipërisë me Turqinë ishin shkëputur përgjithmonë dhe se Turqia në këto territore nuk mund të kthehej më.

Shtypi shqiptar kërkonte zgjuarsi

Ishte një fakt i pamohueshëm se shtetet ballkanike e dëshironin shumë më tepër të ngritej flamuri turk, se sa të valohej flamuri kombëtar shqiptar, meqë në ato rrethana i kishin duart më të lira për të vepruar kundër popullit shqiptar. Vërtet, ishte një kohë e pështjellimit të madh, moment shumë i vështirë për atdhedashësit, meqë parullat e taborëve të ndryshme negative përputheshin deri-diku. Kokat e njerëzve të helmuar dëshironin ta ngatërronin dhe ta helmonin tërë vendin. Prandaj, duhej këmbëngulur në çdo mënyrë “të mbahej flamuri me ngjyrë kombëtare, pa të cilin vendi do të humbte simbolin e vetëm të pavarësisë së tij dhe do të bëhej menjëherë pre e fqinjëve”.³⁷ Ndërkaq, shtypi përparimtar shqiptar kërkonte me ngulm që “mos t’u besojnë krerëve se ata po iu mbrojnë fenë, kur ata vetë nuk kanë as fe, as din, as iman, s’kanë tjetër ndjenjë pos xhepit” dhe vazhdonte - “O popull hapi sytë e shih gropën që po ta hapin krerët, hapi sytë se të shitën e ke për të mbetur i mjerë për tërë jetën: hapi sytë se po vritesh e po digjesh për të mbushur xhepat e atyre tradhtarëve që s’kanë as ndjenja, as njerëzi, asgjë prej gjëje”.³⁸

Në fund të qershorit nga burime të sigurta ishte kuptuar për “fyerjen e Fuqive të Mëdha” që nuk do të mund të qëndroj më në fron V. Vidi, të cilit iu kishte ngushtuar rrethi dhe dita-ditës pritej të pushtohet edhe Durrësi nga kryengritësit fshatarë. Flitej se në pushtet duhej të vinte KNK.³⁹ Gjithashtu, kuptohej se për pushtetin e Princ Vidit, i cili qëndronte në këmbë nën hijen e topave e luftanijeve austro-hungareze dhe italiane, që ishin angazhuar sipas udhëzimeve të qeverive të tyre, të ndërhynin për sigurimin e Princit Vidit.⁴⁰ Pos tyre ishin të angazhuar edhe oficerët holandezë, që kishin ardhur për organizimin e xhandarmërisë shqiptare, e që morën pjesë në “çështjen e Vorio Epirit” kundër grekëve, në dëbimin e Esat Pashës, në komplotin grek në Korçë dhe në zbulimin e “komplotit” të Beqir Grebenesë, i cili ishte dënuar në

³⁷ Ismail Qemal Vlora, Kujtime, Tiranë 1997, 371.

³⁸ Populli, 27-VI-1914, Vlorë.

³⁹ AS-MID-PO-1914, fasc. III, dos. X, br. III/15.

⁴⁰ Gazmend Shpuza, Kryengritja fshatare e Haxhi Qamilit, Tiranë 1979, 104.

burg të përjetshëm, por që nga V. Vidi u lirua bashkë me shokë në gusht të vitit 1914.⁴¹

Thellimi i pështjellimeve në Shqipëri

Ishte koha e plasjes së luftës austro-serbe pas atentatit të njohur të Sarajevës në korrik të vitit 1914. Në ato rrethana përcillej çdo hap i lëvizjes fshatare në Shqipëri dhe sidomos qëndrimi i shqiptarëve të Kosovës të vendosur atje.⁴² U përhap lajmi se Austro-Hungaria nga V. Vidi ka kërkuar që në Kosovë të organizojë kryengritje nëpërmjet shqiptarëve kryengritës të vendosur në Durrës dhe me forcat e veta (V. Vidi) të depërtojë në Kosovë dhe ta çlirojnë këtë pjesë shqiptare. Mirëpo, Princ Vidi një kërkesë të tillë thuhej se nuk ka mundur ta pranojë, meqë e kishte punën ngushtë dhe nuk kishte forca të mjaftueshme. Gjithashtu, e dinte edhe faktin se Shqipëria nuk mund ta shkelte neutralitetin, që ia “garantonin” gjashtë Fuqitë e Mëdha.⁴³ Vërtet, Vjena kërkoi nga V. Vidi që edhe ky t’i shpallte luftë Serbisë.

Në fillim të gushtit 1914 ministri i Jashtëm, Berhtoldi, e ftoi haptas Princ Vidin që “të vihej në krye të shqiptarëve dhe të marshonte kundër Serbisë”. Vjena kishte shpresë së lufta kundër Serbisë do të ishte katalizatori i unitetit shqiptar, se shqiptarët do t’i lënë grindjet me një anë, ku ndër të tjera Berhtoldi theksonte: “dëshira e fortë për të rimarrë Kosovën” do t’i shtynte shqiptarët të rreshtohen nën komandën e Princit kundër armikut tradicional. Mirëpo, Vidi faktikisht nuk kishte kurrfarë pushteti real. Ai i qëndroi besnik neutralitetit të Shqipërisë. Por, kjo ishte fatale për Vidin. Ai më nuk ishte i vlefshëm nga pikëpamja e politikës së Austro-Hungarisë.⁴⁴ Në fillim të korrikut shtypi shqiptar shkruante: “Gjendja e sotme është kritike, meqë s’ka një qeveri që të ketë hapur rrugë të mbarë e të drejtë. Situata është e mjeruar pasi që në krye të punës ka njerëz pa ideal e pa energji. Andaj, fatkeqësia më e madhe që po rrinë si rrufe mbi kokë - vazhdonte shtypi i kohës - është përbërja e një kabineti të tillë, i cili është formuar prej disa njerëzve që s’kanë një mendje, një karakter, një patriotizëm, e të gjithë së bashku

⁴¹ Populli, 18-VIII-1914, Vlorë; Ismail Qemal Vlora, Kujtime, Tiranë 1997, 365: Beqir Grebeneja ishte arrestuar më 7 janar 1914.

⁴² DASSIP-AO-1914, fasc. I, dos. VII, br. 1296.

⁴³ Millovan Sekuliq, Kosovo od 1912 do 1918 godine (tezë doktorature), Prishtinë 1980, 442.

⁴⁴ Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 218 - 219; Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 154.

asnjë influencë”.⁴⁵ Edhe armiqtë e popullit shqiptar atë gjendje me padurim e prisnin që ashtu të rrjedhin ngjarjet e të komplikohet situata sa më shumë në Shqipëri dhe vetëm atëherë do të bindet Evropa se ka bërë vepër të keqe me rastin e formimit të shtetit shqiptar. Është një fakt se të gjitha shtetet fqinje ishin kundër Princ Vidit. Mirëpo, edhe situata në Evropë nuk ishte aspak e qetë. Pas atentatit të Sarajevës, ku u vra trashëgimtari i fronit të Austro-Hungarisë, Franc Ferdinandi, situata politike evropiane arriti kulmin e acarimit. Gjatë muajit korrik bëheshin përgatitje të ethshme të Austro-Hungarisë, në njërën anë, dhe të Serbisë në anën tjetër. Këto shtete i takonin blloqeve kundërshtarë. E para i takonte bllokut Qendror, ndërsa e dyta i takonte bllokut të Antantës. Pritej vetëm fillimi i luftës. Serbia frikësohej edhe nga ngjarjet në Jug për shkak të lëvizjeve në shtetin shqiptar.

Shenjat e falimentimit të qeverisjes së Vidit

Asokohe anijet angleze, franceze dhe ruse u larguan nga Durrësi,⁴⁶ për shkak të vendosmërisë së Austro-Hungarisë që ta sulmojë Serbinë pas skadimit të afatit të ultimatumit. Prandaj, eksperimenti i Princ Vidit ishte një falimentim i plotë. Qeveria e tij dështoi brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet me jashtë. Vërtet, nuk e kishte as personalitetin dhe as vullnetin e domosdoshëm për të përballuar një situatë kaq të rëndë.⁴⁷ Mirëpo, dihej se edhe caktimi i Vidit si Princ i Shqipërisë, ishte rezultat i një kompromisi që kishte për qëllim të shtynte për njëfarë kohe rivalitetet midis Fuqive të Mëdha në Ballkan, përderisa ato nuk qenë përgatitur plotësisht për luftë të armatosur për ndarjen e kolonive.⁴⁸ Në muajin gusht pozitat e kryengritësve fshatarë me ato të qeverisë së V. Vidit mbetën të njëjta si në muajin korrik, dhe ishin nën hijen e fillimit të luftës evropiane që e përgatitën të dy blloqet kundërshtarë për qërimin e hesapeve të tyre. Edhe në atë kohë krize para fillimit të furtunës së luftës botërore, Shqipëria mbet edhe më tej lëmë e propagandave të huaja. Shtypi shqiptar shkruante: “Siguria e nderit, e mallit dhe siguria e shpirtit arrihet vetëm me bashkësi dhe pas asaj vije fuqia, e cila përgatit bashkimin dhe kjo vetvetiu sjellë besën

⁴⁵ Populli, 8-VII-1914, Vlorë.

⁴⁶ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. I, br. 14.

⁴⁷ Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë 2003, 208.

⁴⁸ Gazmend Shpuza, Kërkesat kombëtare dhe agrare të kryengritësve fshatarë në fillim të shtatorit 1914, Studime historike, nr. 3, Tiranë 1981, 130.

dhe dashurinë”.⁴⁹ Mirëpo, si të arrihej në një vend kur sundonin të huajt, ku thuhet: “Or vëlla, qysh Shqipëria shtet më vete, po të them: në kontroll të huaj, me organizatë të huaj, nën influencë të huaj, me gjuhë të huaj, me emër të huaj. Atëherë të ruhet indipendenca! E ke dëgjuar”.⁵⁰ Kështu, pos Princit që ishte me gjak i huaj, në krye të shtetit të ri shqiptar dhe të disa anëtarëve të qeverisë së tij, që luanin me karta të huaja, në fakt rol me rëndësi vazhdonte të luante Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Kompetencat dhe veprimtaria e tij ishin praktikisht një mohim i pavarësisë së Shqipërisë. Ai, duke dalë jashtë caqeve të kontrollit dhe duke hyrë drejtpërdrejt në sferën e qeverisjes e të pushtetit, u shndërrua në mjaft raste në një organ bashkësundimi të Fuqive të Mëdha.⁵¹

Kështu, përfaqësuesi serb në Durrës, Panta Gavrilloviq, së bashku me Petrajevin e Rusisë, në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit intervenojnë, duke e kërcënuar Turhan Pashën dhe Aqif Pashën, me qëllim që të ndërmarrin çdo gjë për t'i ndaluar shqiptarët nga një ekspeditë marshimi në drejtim të Kosovës. Turhan Pasha, menjëherë i ofroi postin e ministrit Hasan Prishtinës, me qëllim për ta ndalë në Durrës, por ai nuk pranon. Mirëpo, Turhani frikësohet edhe nga numri i madh i shqiptarëve nga Kosova në Durrës, që ishin në gjendje në çdo moment ta kundërshtonin dhe rrezikonin qeverinë e Durrësit.⁵² Po ashtu, Austro-Hungaria si fuqia më e interesuar për të mbajtur V. Vidin në fronin shqiptar, me fillimin e luftës në verë të vitit 1914, filloi ta lidhte drejtpërsëdrejti përkrahjen e saj me interesat e veta imediate në luftë kundër Serbisë. Me këtë, siç ka pohuar edhe vet Vidi, Vjena e lidhte dhënien e kësteve të paradhënies së huas. Kështu, sipas ministrit të Jashtëm austro-hungarez Berhtoldit, ky qëndrim kinse mund ta kthente tërë situatën brenda vendit në favor të Princit. Megjithatë, Vjena arriti në përfundim që V. Vidi duhej të largohej nga Shqipëria, pasi që nuk diti në asnjë mënyrë të imponohej, për çka u krijua një përçarje e madhe e shqiptarëve, e cila në situatën e luftës e bënte të pamundshme shfrytëzimin e popullit shqiptar edhe për interesat austro-hungareze. Në të vërtetë, shkaku vendimtar që përcaktoi fundin e regjimit të V. Vidit në Shqipëri qe padyshim Kryengritja fshatare në Shqipërinë e Mesme. Ndërkaq, goditjen e fundit në plan të jashtëm ia

⁴⁹ Populli, 27-VII-1914, Vlorë.

⁵⁰ Ylber Skendi, Sali Nivica, Tiranë 1980, 52.

⁵¹ Gazmend Shpuza, Kryengritja fshatare e Haxhi Qamilit, Tiranë 1979, 31.

⁵² DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. I, br. 71.

dha ndërprerja e pagesave të kësteve prej 10 milionë frangash, nga gjithsej 75 milionë që i qenë premtuar atij nga Fuqitë e Mëdha.⁵³ Kështu, shtetet e jashtme kurdisnin planet e veta minuese, për t'i mbrojtur më mirë interesat në këtë pjesë të Ballkanit, nëpërmjet mercenarëve e tradhtarëve vendas dhe agjentëve të ndryshëm, me subvencione të mëdha financiare. Atëbotë thuhej: "Njëri turk e njëri grek; tjetri sllav...! Shqipëria për kend me qenë. A s'duhet një zot për këtë! Si kishte me iu gjetë dermani kësaj pune".⁵⁴

Largimi i Princ Vedit nga Shqipëria

Kah fundi i gushtit, pas shthurjeve disamujore të pushtetit të Vedit flitej haptazi për largimin e tij brenda një kohe të shkurtër, meqenëse gjendja në Shqipëri gjithnjë e më tepër vinte duke u përkeqësuar. Vetëm pritej që kryeministri Turhan Pasha të kthehet nga turneu nëpër Evropë dhe të tërhiqet qeveria nga Durrësi së bashku me V. Vidin.⁵⁵ Edith Durham mendonte se ndoshta arsyeja e vërtetë për zgjedhjen e njëzëshme të V. Vedit është se Fuqitë e Mëdha, që përgatitnin shkatërrimin e Shqipërisë, e njihnin për njeri të paaftë, me qëllim që me të t'i qëronin hesapet më lehtë. Rusia, Greqia, Serbia dhe Franca qenë lidhur ta rrëzojnë, qysh kur e pranuan zgjedhjen e tij.⁵⁶ Mendohej se çdo pikënisje që nuk i ka rrënjët në faktorët efektiv vendas, por mbështetet në kombinacionet e diplomacisë, është e destinuar doemos të mbaronte keq, si në tërësi, ashtu edhe në çdo pjesë të veçantë.⁵⁷ Fundi i gushtit dhe fillimi i shtatorit V. Vedit dhe qeverinë, e gjeti të falimentuar, sidomos në pikëpamje financiare. Gjithashtu, vazhdimi i kryengritjes fshatare (kërcënimet e tyre) dhe plasja e Luftës së Parë Botërore e lëkundën nga themeli pushtetin e V. Vedit. Pas 181 ditësh pushteti nuk pati sukses. Princ Vilhelm Vidi u detyrua të largohej nga Shqipëria më 3 shtator 1914.⁵⁸ Princ Vidi dhe suita e tij e lëshojnë

⁵³ Gazmend Shpuza, Kërkesat kombëtare dhe agrare të kryengritësve fshatarë në fillim të shtatorit 1914, Studime historike, nr. 3, Tiranë 1981, 130.

⁵⁴ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. II, br. 139; Ylber Skendi, Sali Nivica, Tiranë 1980, 140.

⁵⁵ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. I, br. 75.

⁵⁶ Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë 1944, 257.

⁵⁷ Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë 1978, 569.

⁵⁸ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. II, br. 90; Piro Tako, Luigj Gurakuqi, Tiranë 1980, 223.

Durrësin në ora 8 të mëngjesit, ku hipën në anijen italiane të luftës “Mizurati” në drejtim të Venedikut dhe pastaj drejtohen për Rumani. Së bashku me të u nisën edhe ministrat e qeverisë dhe anëtarët e tjerë të Oborrit mbretëror. Pushtetin ia dorëzoi KNK që e përbënin vetëm tre vetë: ai italian, francez dhe austriak, meqë anëtarët e tjerë, ai anglez dhe rus, e kishin lëshuar Durrësin një muaj më parë, kurse përfaqësuesi gjerman ishte larguar edhe më herët.⁵⁹

Në një libër të shkruar nga vetë, Vilhelm Vidi, do të ankohet se intrigat italiane, ruse e franceze, si dhe dredhitë e mbrojtësve të tyre, imuniteti që gëzonte Greqia për të gjitha makinacionet e veta, por edhe “asnjanësia” e Gjermanisë dhe e Anglisë, e bënë të pamundur kryerjen e detyrës nga ana e tij dhe shënuan fatin e atij mbretërimi aq të shkurtër.⁶⁰ Pas largimit të V. Vedit dhe bashkëpunëtorëve të tij, nga Durrësi pas dy dite largohen edhe mbi 500 shqiptarë nga Kosova që kishin qenë pranë Princ Vedit dhe qeverisë në Durrës. Ata i udhëhiqnin Isa Boletini dhe Bajram Curri, të cilët ishin kryesisht nga Malësia e Gjakovës dhe rrethi i Mitrovicës.⁶¹ Nga Durrësi shqiptarët e Kosovës me krerët e tyre udhëtojnë nëpërmjet detit në Shëngjin dhe me veti kishin marrë armë dhe municion. Mendohej se qëllimi i tyre ishte sulmi në verilindje të Shqipërisë.⁶² Udhëheqësit e njohur shqiptarë nga Kosova si: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Mehmet Dërralla, Bajram Curri etj., me gjithë rezervën në fillim të ardhjes së Vilhelm Vedit, pas një kohe i vihen në dispozicion mbretit, me qëllim për ta ruajtur prestigjin si popull dhe besën tradicionale. Ata angazhohen kryesisht në mbrojtjen e kryeqytetit, me qëllim ruajtjen dhe nderin para opinionit ndërkombëtar. Megjithëse, ata së bashku me atdhetarët e tjerë, ushqyen iluzione dhe shpresuan se Princ Vidi do t’i zgjidhë pothuaj të gjitha problemet e grumbulluara. Ata menduan se një princ nga “dera e madhe” evropiane do ta bënte më aktuale çështjen shqiptare në përgjithësi dhe pacenueshmërinë territoriale të Shqipërisë, në veçanti. Mirëpo, duhet theksuar se për mendimin dhe përcaktimin e patriotëve shqiptarë ndikoi edhe fakti se shtetet ballkanike, si: Greqia, Rumania dhe Bullgaria kishin pasur dhe kishin mbretër me origjinë të huaj që kishin arritur konsolidimin me mjaftë sukses të shteteve të tyre. Prandaj, nuk kishte përse, sipas tyre, të mos ndodhte kështu edhe për popullin dhe shtetin shqiptar, aq me tepër

⁵⁹ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. II, br. 96.

⁶⁰ Bajram Xhafa, Historia e Shqipërisë, Shkodër 2009, 155.

⁶¹ DASSIP-AO-1914, fasc. IV, dos. II, br. 85.

⁶² AVII, kut. 50, fasc. 85, br. 5/4.

që Princ Vidi ishte protestant, pra as mysliman sunit apo shiit, as i krishterë ortodoks apo katolik.⁶³

Kështu, pas presionit të pandërprerë të kryengritësve fshatarë, në krye me Haxhi Qamilin, mbreti Vilhelm Von Vidi së bashku me suitën e tij e lëshoi përfundimisht Shqipërinë më 3 shtator 1914. Pas dy dite, më 5 shtator në Durrës hyjnë kryengritësit fshatarë, ku e hoqën flamurin kombëtar shqiptar dhe vunë flamurin turk. Me atë edhe përfundon periudha antividiste e kësaj lëvizjeje anakronike religjioze, nga muaji maj deri në shtator 1914. Princ Vidi formalisht ia dorëzoi pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, por flitej haptas për kthimin e Esat Pashës, pasi që qarqet megalomane serbe i kishin ra në gjurmë “gjahut të tyre të çmueshëm”. Ai sorollatej dhe “konsultohet” në vijën Selanik-Nish. Andaj, u vunë në plan të ditës sërish ambiciet antikombëtare të Esat Pashës.

⁶³ Koli Xoxi, Ismail Qemali, Tiranë 1983, 287.

Xheladin SHALA

SUMMARY

ALBANIA DURING THE REIGN OF PRINCE WIED 1914

As soon as the idea came about to insert a prince as a head of Albania, a list of potential princes was immediately generated. In the various European centers, there were numerous discussions in regards to who should be appointed in the new position, both with a Christian and Muslim background. On the 8th of November 1913, as propositioned by Austria-Hungary and Italy, and as agreed upon by the Great Powers, Prince Wilhelm Wied was appointed Prince of Albania. Immediately after he took position, his incompetence and lack of leadership skills became apparent particularly so in regards to unifying the country. Great trouble was caused to him by the Greek armies in the south and the Serbian and Montenegrin in the north and north-east, which maintained the Albanian territories under invasion. The same political actors supported anti-nationalist figures such as: Arif Hiqmeti, Shani Llausha, Jusuf Beu, Spiro Milo, Marka Gjonin, Zografos etc.

As a result of Esat Pasha's doings, Prince Wied was forced to block the former in Durrës. Regardless, Esat was taken under Italy's protection. It was believed that he was the 'main agitator of Albanian unity'. Unfortunately, the situation became worse through the dubious activities of some Albanians. Among them was also the Peasant Uprising (under the leadership of Musa Qazimi, Mustafa Ndroqi, Haxhi Qamili etc), which erupted in Central Albania as a result of discontent among the Muslim population, which had an immense negative impact on the Albanian cause. The ultimate action which led to the resignation of Wied, was the suspension of installments of about 10 million francs from 75 million in total which were promised to him by the Great Powers. The continuation of the Peasant Uprising and the beginning of the First World War shook the foundations of Wied's power, who after 181 days of rule was forced to abdicate the throne on the 3rd of September 1914.

KDU: 94(496.51-13)"1919"
32(495:496.51-13)
"1919"

Muin ÇAMI - Marenglen VERLI

**PIRUETAT GREKE NË KONFERENCËN E PAQES RRETH
PRETENDIMEVE MBI SHQIPËRINË E JUGUT NË
PERIUDHËN JANAR - MAJ 1919**

Konferenca e Paqes u organizua në Paris nga të pesë fuqitë kryesore fituese: Britania e Madhe, Franca, Italia, SHBA dhe Japonia, për t'i dhënë fund gjendjes së luftës dhe për t'u diktuar shteteve të mundura: Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Perandorisë Osmane dhe Bullgarisë traktatet e paqes. Ajo filloi zyrtarisht punimet më 18 janar 1919 në ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës. Hapjen e bëri presidenti i Republikës, Raimond Puankare (Raymond Poincaré). Gjuha frënge dhe drejtimi nga kryeministri i vendit pritës Zhorzh Klemanso (George Clemenceau), tregonin peshën e Francës në këtë forum ndërkombëtar.¹ Shqipëria nuk bënte pjesë as midis vendeve fituese, përfaqësuesit e të cilave u ulën në tryezën e Konferencës në ditën e hapjes së saj plenare, as midis të mundurve.² Megjithatë pozita e

¹ M. Macmillan, *Paris, 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: Plejad, 2006, f. 91; Owen Pearson, *Albania and King Zog*, vol.I, London-New York, 2004, f. 117.

² *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States - The Paris Peace Conference 1919*, United States, Washington, Volume III, 1942, f. 172-175; Shih edhe A. Hadri, *Presidenti Uillson dhe çështja shqiptare - Politika e SHBA në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920*, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, 1912, f. 72-73. Sipas rregullave të Konferencës, Pika 1 dhe 2, SHBA, Perandoria Britanike, Franca, Italia dhe Japonia do të merrnin pjesë në të gjitha komisionet dhe do të përfaqësoheshin me nga pesë delegatë. Belgjika, Brazili, Kina, Greqia, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Siami, Hixhazi, Çekosllovakia dhe shtetet e Amerikës Latine (Bolivia, Ekuadori, Peruja, Uruguaji) do të merrnin pjesë në sesionet ku do të diskutoheshin çështjet lidhur me to ose për të cilat kishin interes. Shtetet evropiane dhe aziatike nga ky grup do të përfaqësoheshin nga tre delegatë, përveç Polonisë dhe

saj “anormale e konfuze”, sikurse është shprehur diplomati britanik Harold Nikolson,³ synimet e fqinjëve fitues dhe ekzistenca e Traktatit të Londrës, 26 prill 1915, përcaktuan që trajtimi i saj në Konferencë të ishte më i keq se i atyre që do t’u jepnin llogari fitimtarëve. Çështja shqiptare u diskutua si pjesë e pretendimeve që shtruan qeveritë e vendeve fqinje fitues dhe jo si një çështje e veçantë, që kërkonte një zgjidhje më vete, në bazë të parimit të kombësisë dhe të vetëvendosjes së popujve. Të drejtat kombëtare të popullit shqiptar nuk u morën pra parasysh; kërkesat e delegacionit shqiptar nuk u përfillën. Duke pasur parasysh këtë situatë historiane M. Makmilan, mbesa e kryeministrit britanik të asaj kohe, D. Ll. Xhorxhit, vitet e fundit ka shkruar: “E mjera Shqipëri, me kaq shumë armiq të fuqishëm dhe kaq pak miq”.⁴

Si një vend që nuk ishte përzier në konfliktin botëror, Shqipëria juridikisht duhej të renditej në kategorinë e atyre shteteve neutrale e në formim e sipër, përfaqësuesit e të cilëve, sipas procedurës së vendosur nga fuqitë kryesore fituese, mund të komunikonin me Konferencën me disa kushte. Ato mund t’i paraqitnin asaj jo vetëm kërkesa me shkrim, porse mund të dëgjoheshin gojarisht nga forumet e Konferencës, atëherë kur të shqyrtoheshin çështje, që u interesonin atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Dëgjimi mund të bëhej me kërkesën e të gjitha Fuqive të Mëdha fituese të interesuara, ose me kërkesën e njërës prej tyre. Në rastin e Shqipërisë një fuqi e tillë ishte Italia, e cila kishte lejuar të mbahej Kongresi i Durrësit dhe kishte pranuar më në fund formimin e qeverisë së dalë prej tij. Mirëpo, diplomacia e Romës ndiqte synimet e veta. Ajo donte që delegacioni shqiptar në Konferencë të ishte një shtojcë e delegacionit italian për t’iu kundërvënë vetëm pretendimeve të dy fuqive ballkanike ndaj Shqipërisë dhe të mos prekte ato të Italisë.

*

* *

Çekosllovakisë, të porsaformuara si shtete, që do të kishin nga dy delegatë. Shtetet e Amerikës Latine dhe të Afrikës që nuk kishin marrë pjesë efektivisht në luftë ose kishin pasur një diplomaci të ngrirë, si: Guatemala, Haiti, Hondurasi, Kuba, Liberia, Nikaragua, Kosta Rika dhe Panamaja, Bolivia, Ekuadori, Peruja, Uruguaji do të përfaqësoheshin me nga një delegat. Shtetet në proces formimi dhe ato neutrale, përgjithësisht do të thirreshin në interpelancë me shkrim ose me gojë nga Fuqitë e Mëdha “me interesa të përgjithshme” në sesionet që shqyrtonin çështjet për të cilat ishin të interesuara.

³ H. Nikolson, *Peacemaking 1919*, The Universal Library, Grosset&Dulap, New York, 1965, p. 174.

⁴ M. Macmillan, *Paris, 1919...*, f. 417.

Tema që trajtohet në këtë artikull është e njohur. Me të janë marrë mjaft autorë vendas e të huaj,⁵ por luhatjet në qëndrimin e Greqisë, në trajtimin e çështjes shqiptare, përkatësisht të paraqitjes së pretendimeve për Shqipërinë e Jugut, nuk janë parë e argumentuar në mënyrë të detajuar e shteruese. Për të kontribuar në këtë drejtim u ndërmor ky studim i shkurtër duke shfrytëzuar materiale relevante bibliografike e arkivore. Në Konferencën e Paqes çështja shqiptare u lidhë më parë me pretendimet greke mbi Shqipërinë e Jugut për faktin se nga të tre shtetet fqinj, Greqia ishte e para që i parashtroi Konferencës pretendimet e veta territoriale dhe që për shqyrtimin e tyre u krijua një organizëm i posaçëm. Qarqet drejtuese të Athinës, nën udhëheqjen e një diplomati karizmatik e me shumë përvojë si E. Venizelosi, kishin synime tepër ambicioze. Ato dëshironin t'i zgjerimin sa më shumë kufijtë e shtetit grek, duke ëndërruar territoret që kish pasur Perandoria Bizantine mesjetare, trashëgimtare të së cilës e ndjenin veten. Këto synime i kanë vënë në dukje shumë historianë të huaj, midis tyre edhe autorë grekë. Në qoftë se në mbarim të Luftërave Ballkanike, më 1913, territori i Greqisë u dyfishua, më 1918-1919 kryetari i delegacionit grek E. Venizellos kërkonte që ky territor të dyfishohej përsëri. Në këtë zgjerim Greqia mendonte të shfrytëzonte pozitën e vet si vend fitues, ndonëse nuk kishte dhënë ndonjë kontribut të dukshëm për fitoren. Ajo kishte hyrë në luftë tepër vonë, por diplomacia greke kishte shpresa në mbështetjen që gjente për pretendimet e saj te Franca dhe te Britania e Madhe. Investimet e kapitalit francez dhe britanik në Greqi ishin të mëdha.⁶ Nga ana tjetër Parisi dhe Londra kishin interesa gjeostrategjike për të përkrahur forcimin e Greqisë, veçanërisht të partisë venizeliste, që ishte e gatshme të aktivizohej, për përputhje interesash, qoftë për asgjësimin përfundimtar të Perandorisë Osmane në Lindje, qoftë për të bllokuar në Perëndim ekspansionin italian në Ballkan. “Greqia në Kongres të Paqes kishte dy miq të mëdhenj, Klemansonë dhe Llojd Xhorxhin”,⁷ kanë shkruar përfaqësuesit

⁵ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Vëll. I, Tiranë: Toena, 2013; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009; Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, Shkodër: Camaj-Pipa, Shkodër, 2007; Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë*, Tiranë: Pegi, 2012; Owen Pearson, *Albania and King Zog*, vol.I, London-New York, 2004, etj.

⁶ D. Kitsikis, *Propagande et pressions en politique internationale* (La Grèce et ses revendications a la Conférence de la Paix 1919-1920), Paris, 1963, f. 20-21.

⁷ G. Frangoudis, *L'hellénisme en lutte contre l'Orient et l'Occident*, Athènes, 1925, f. 225.

venizelistë të qarqeve politike greke. Prania e Italisë në Shqipëri, me pretendimet e saj, i shërbente Greqisë si nxitje për të kërkuar pjesën që “i takonte” nga ndarja e Shqipërisë, duke shfrytëzuar në favor të saj kontradiktat e fuqive fituese.

Në fillim kërkesat territoriale të Athinës u pasqyruan në memorandumit e 30 dhjetorit 1918. Kryeministri i Greqisë dhe njëherësh kryetari i delegacionit grek në Paris, E. Venizelos, shpejtoi t’ua paraqiste atë përfaqësuesve të fuqive kryesore fituese përpara se Konferenca e Paqes të hapej zyrtarisht. Sipas këtij memorandumit në kufijtë politikë të shtetit grek kërkohej të hynin dy trevat e Shqipërisë së Jugut, Korça me Gjirokastrën, bregdeti bullgar i Egjeut, (Thraka Perëndimore), Turqia Evropiane bashkë me Stambollin (Thraka Lindore), Azia e Vogël Perëndimore dhe ishujt e Dodekanezit.⁸ Pretendimet greke shtriheshin kështu jo vetëm mbi territore të dy vendeve të mundura, të Bullgarisë dhe të Turqisë (duke përjashtuar këtu ishujt e Dodekanezit të pushtuar nga Italia gjatë Luftës Italo-Turke të 1911), por edhe mbi territore të Shqipërisë neutrale. Mirëpo Shqipëria e Jugut, që propaganda greke kishte filluar ta quante “Epiri i Veriut”, në shumicë dërmuese banohej prej popullsisë me kombësi shqiptare. Ekzistonte edhe një minoritet grek, që kishte mbetur brenda kufijve politikë të 1913. Ai jetonte në trevën e Gjirokastrës, përkatësisht në Dropull, në Vurgun e Delvinës dhe në Pogon. Por, në krahasim me popullsinë shqiptare të të dy trevave të Jugut, minoriteti grek përbënte një pakicë. Ai zinte aty afro 13.7 për qind të popullsisë. Në qoftë se më 1913, popullsia e Korçës dhe e Gjirokastrës arrinte, sipas shumë të dhënave statistikore të shqyrtuara, në rreth 235 mijë banorë, minoriteti grek nuk i arrinte të 30 mijët.⁹ Për rrjedhim, rrethet qeveritare greke kërkesën për të rishikuar në interes të tyre kufirin shtetëror shqiptarogrek të vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve (dhe të përcaktuar me Protokollin e Firences të 17 dhjetorit 1913), nuk mund ta mbështesnin në parimin e kombësisë. Përbërja etnike shqiptare e popullsisë ishte pengesa më serioze që duhej të kapërcenin përfaqësuesit e qeverisë së Athinës, për të zgjeruar kufijtë e shtetit grek në dëm të atij

⁸ E. Venizelos, *La Grèce devant le Congrès de la Paix*, Paris, 1918.

⁹ *Fletorja zyrtare*, nr. 65, 20.11.1923, f.2-3; Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë, 1928, f. 496; Jacques Bourcart, *Les confins albanais administrés par la France (1916-1920)*, Paris, 1922, f. 273; Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej : AQSH, Fondi MPJ, dosja 101 (1922), f. 43-51; Shih po ashtu G. Papadopolu, *E ethnike ellenike meionotes eis ten Albanian kai to sohalikon aytes zetema*. Istorikon archeion 1921-1979, Joaninna, 1981, f. 44-47.

shqiptar. Pengesën tjetër e përbënte, qëndrimi i Italisë, rivalet kryesore për ndarjen e Shqipërisë së Jugut. Prandaj në këto dy probleme: në mënjanimin e kundërshtimit të Italisë dhe veçanërisht, në falsifikimin e përbërjes etnike të popullsisë së kësaj pjese të vendit, u përqendrua më shumë memorandum i grek i 30 dhjetorit 1918 dhe të gjitha materialet tjera të palës greke. Duke qenë se pjesa dërrmuese e popullsisë së Shqipërisë së Jugut me kombësi ishte shqiptare, por e ndarë në dy fe të ndryshme, në myslimane dhe në ortodokse, hartuesit e memorandumit të 30 dhjetorit u kapën pas versionit me karakter propagandistik e tanimë të vjetruar, atij që i mohonte popullit shqiptar formimin e tij si komb dhe që e zhvishte nga ndërgjegjja e tij kombëtare. Ky version e identifikonte fenë me kombësinë, shqiptarët myslimanë i paraqiste si turq, ata katolikë si latinë, kurse ortodoksët si grekë.

Të nisur nga kjo bazë artificiale e ndarjes së popullit shqiptar sipas fesë, e mohimit të bashkimit të tij kombëtar dhe e mbivlerësimit të dasive fetare, hartuesit e memorandumit të 30 dhjetorit 1918 pohonin se popullsia e dy krahinave të pretenduara të Shqipërisë së Jugut (të Korçës dhe Gjirokastrës) përbëhej nga 230 mijë vetë, prej të cilëve, sipas tyre, shumica ishin grekë: 120 mijë kundrejt 110 shqiptarëve.¹⁰ Si grekë paraqiteshin kështu të tërë ortodoksët, pa bërë asnjë dallim midis shqiptarëve dhe minoritarëve grekë, kurse si shqiptarë vetëm myslimanët. Në polemikën e zhvilluar në atë kohë është vënë në diskutim nëse myslimanët e të dy trevave të Jugut si numër ishin më pak se të krishterët, sikundër pohonte kryeministri grek, ose më shumë, sikundër shkruanin kundërshtarët e tij.¹¹ Megjithatë kjo nuk përbënte asgjë me rëndësi përpara përbërjes etnike të popullsisë. Ndërkaq, në ndarjen e popullsisë shqiptare sipas feve, Venizelloja shkoi edhe më tej. Në memorandumin e tij të 30 dhjetorit ai propozoi ngushtimin e kufijve të “Epirit të Veriut” që pretendonte, duke lënë jashtë këtyre kufijve disa krahina të banuara nga shqiptarë myslimanë. Këto krahina do të ishin Kurveleshi, pjesë të kazave të Tepelenës dhe të Përmetit, që ndodheshin në veri të Vjosës, si edhe kazaja e Starovës (Pogradecit). Sipas Venizellos këto krahina mund të shkëputeshin prej “Epirit të Veriut” dhe t’i bashkoheshin Shqipërisë, meqë banoreshin pothuajse krejtësisht

¹⁰ E. Venizelos, *La Grèce devant la Congres de la Paix*, Paris 1918, f. 3-4.

¹¹ Shih p.sh.: *Refutations des arguments de M. Venizelos pour établir les droits de l'hellénisme en Epire du Nord*, Paris, 1919; *La Paix de Versailles*, Questions territoriales, Paris, 1939, f. 19; *The Manchester Guardian*, 13.7.1919; T. Dilo “Çështja e “Epirit të Veriut”, në: *Bota e Re*, nr. 4, viti 1945, f. 36.

prej myslimanësh.¹² Në kufijtë e Shqipërisë do të përfshiheshin: 52 fshatra - (3 në Himarë, 4 në rrethin e Gjirokastrës, 24 në atë të Përmetit dhe 21 në rrethin e Pogradecit) me një popullsi prej 29 673 frymësh, nga të cilët 28 516 ishin myslimanë.¹³ Në këtë rast, sipas memorandumit, myslimanët shqiptarë, që do të aneksonte Greqia, do të zbrisnin në 80 mijë, të cilët ishin aq të pleksur me të krishterët sa ishte e pamundur t'i ndaje këta me një kufi gjeografik, në mënyrë të tillë, "që besimtarët e Krishtit t'i kalonin Greqisë ortodokse, ata të Muhamedit "shtetit mysliman shqiptar".¹⁴

Pasi bënë qëllimisht këtë ndarje të popullsisë sipas besimit fetar, hartuesit e memorandumit grek kalonin në një çështje tjetër, që tregon edhe një herë për pikëpamjet e tyre rreth së ardhmes politike të Shqipërisë. Ata deklarorin se kjo popullsi e përzier e krishterë e myslimane, duhej t'i bashkohej Greqisë "pasi do të ishte në kundërshtim me çdo të drejtë që një shumicë (të 120 mijë të krishterët) më e qytetëruar t'i nënshtrohej një pakice (të 80 mijë myslimanëve) me një qytetërim më të pakët". Përveç kësaj, duke qenë se, sipas Venizellos, Shqipëria nuk mund të rronte "si një shtet i pavarur, pa një tutelë të huaj", nuk kishte arsye që kjo popullsi e përzier nga pikëpamja fetare të përfshihej në një shtet shqiptar, që nuk ishte i zoti të kishte një qeveri krejt autonome "dhe jo në shtetin grek, që kishte tanimë një jetë politike të pavarur".¹⁵ Pretendimi i qarqeve sunduese të Greqisë, se shteti shqiptar kishte nevojë për një tutelë të huaj, tani shpinte ujë kryesisht në mullirin e propagandës së qeveritarëve italianë. Këtë pretendim Roma e përdorte si një pretekst për të përligjur protektoratin italian mbi shtetin e ardhshëm shqiptar. Nga ana tjetër, lënia e Kurveleshit dhe Tepelenës jashtë pretendimeve greke përbënte po ashtu një "tërheqje" përpara synimeve të Romës. Kurveleshi dhe Tepelena përfshiheshin në hinterlandin e Vlorës, të cilin Italia synonte ta aneksonte. Kështu e shtroi çështjen në fillim kryeministri grek. Ai nuk kërkoi respektimin e vendimeve të 1913 mbi Shqipërinë, por shkëljen e tyre në favor të Italisë, pavarësisht se qëndrimi i Italisë në Shqipëri përbënte një rrezik potencial për vetë Greqinë. Këtë rrezik nuk mund të mos e kuptonte një diplomat i tillë me përvojë si Venizeloja. Për një rrezik të tillë ai iu

¹² E. Venizellos, *La Grece...*, f. 3-4.

¹³ *Archivs du Ministère des Affaires Etrangères. Archives Diplomatiques* (më tej: AMAE, Paix 1914-1920, Grèce, vol 311, f. 79-82).

¹⁴ E. Venizellos, *La Grece...*, f. 3-4.

¹⁵ *Po aty*.

kishte folur përfaqësuesve të Anglisë dhe të Francës në Athinë, në qershor 1918. Vendosja e Shqipërisë në dorën e cilësdo nga Fuqitë e Mëdha “do t’ua bënte jetën të pamundur fqinjëve të saj”, u kishte deklaruar ai përfaqësuesve të Britanisë së Madhe dhe të Francës.¹⁶ Një pohim të ngjashëm dhe më të qartë kryetari i delegacionit grek do ta bënte në fillim të prillit 1919. Në intervistën që i jepte gazetës *Messenger d’Athenes* Venizelloja botërisht u tërhiqte vëmendjen qeveritarëve italianë që të mos shtriheshin deri në liqenin e Ohrit, mbasi do të ishin “dy herë më të rrezikshëm dhe më shqetësues nga ç’ishin austriakët në Sanxhakun e Novi-Pazarit”.¹⁷

Për Venizellon, zgjidhja më e mirë për problemin shqiptar natyrisht do të ishte ajo e ngritjes së një shteti të pavarur shqiptar, sikundër i kishte deklaruar Llojd Xhorxhit në tetor 1918,¹⁸ por jo në kufijtë e vitit 1913, si dhe vendosja e tij nën tutelën e një komisioni ndërkombëtar.¹⁹ Ai do ta pranonte këtë zgjidhje pasi të kishte aneksuar mundësisht të dy krahinat jugore të Shqipërisë, Korçën dhe Gjirokastrën. Në fillim të prillit 1919 Venizellos do të deklaronte madje se, nëse Shqipëria “mund të ngrihej në një shtet të pavarur, qoftë me forcat e saj, qoftë me ndihmën e një fuqie që nuk do të kishte interesa në Gadishullin Ballkanik, unë do të isha i gatshëm të mos kërkoja popullsinë e “Epirit të Veriut”.²⁰ Por, në kushtet e asaj kohe, kur pretendimet e Italisë ishin pranuar nga të gjithë fuqitë dhe pjesa më e madhe e vendit ishte pushtuar nga forcat italiane, mënjanimi në rrugë diplomatike i protektoratit italian dhe i zotërimit të Vlorës prej Italisë, dukeshin krejt të parealizueshme. Kurse organizimi i një qëndrese nga ana e popullit shqiptar për t’iu kundërvënë planeve të Italisë nuk parashikohej atëherë nga politikanët dhe ushtarakët e huaj. Aq më pak në atë shkallë sa të bëhej faktor për rifitimin e pavarësisë dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar, siç do të ndodhte më 1920. Në fillim të vitit 1919, vëmendja e përfaqësuesve të qeverisë së Athinës u përqendrua kështu në copëtimin e Shqipërisë, duke aneksuar Shqipërinë e Jugut. Për këtë qëllim u përdorën dy rrugët e sipërpërmendura. Së pari, sajimi i sa më shumë “argumenteve” në favor

¹⁶ N. Petsalis - Diomidis, *Greece at the Paris. Peace Conference 1919*, Thessaloniki, 1978, f. 62-63.

¹⁷ Citohet sipas *Refutations des arguments...*, f. 14-15.

¹⁸ N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris...*, f. 72.

¹⁹ *Po aty*, f. 62-63; *Refutations des arguments...*, f. 14-15.

²⁰ Citohet sipas *Refutations des arguments...*, f. 15. Shih edhe H. Nicols, *Peacemaking 1919...*, f. 278.

të pretendimeve greke, duke theksuar veçanërisht mungesën e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Së dyti, u ndoq rruga e arritjes së një marrëveshjeje me qeverinë e Romës, rivalen e madhe, për ndarjen e Shqipërisë së Jugut.

Në kuadrin e sajimit të “argumenteve” për të aneksuar territore shqiptare, përkatësisht në vijim të identifikimit të fesë me kombësinë, bëjnë pjesë edhe përpjekjet e delegacionit grek për të dhënë pikëpamjet e veta për kombësinë. Në këtë mënyrë ai synonte të vinte në dyshim vendimet e 1913, nëse në përcaktimin e kufirit greko-shqiptar ato ishin bazuar në parimin etnik dhe në atë të vetëvendosjes. Me përjashtim të minoritetit të vogël grek, popullsia e Korçës dhe e Gjirokastrës fliste shqip, pavarësisht nga besimi fetar i saj. Nga ky aspekt i rëndësishëm i kombësisë, pra i gjuhës amtare (përveç bashkësisë së territorit etj.), ishte udhëhequr Konferenca e Ambasadorëve dhe pastaj Komisioni i Kufijve Jugorë, i cili në dhjetor 1913, me Protokollin e Firences, kishte caktuar kufijtë shtetërorë midis Greqisë dhe Shqipërisë. Duke pasur parasysh këta faktorë, hartuesit e memorandumit të 30 dhjetorit shkruanin se kombësinë nuk e përcaktonte as origjina, as gjuha por “ndërgjegjja”. Në këtë linjë kryeministri grek më 3 shkurt pohoi përpara Këshillit të të Dhjetëve se: “... as raca, as gjuha, as forma e kafkës nuk mund të merreshin si të vetmit elementë për të përcaktuar kombësinë, vetëm ndërgjegjja kombëtare duhej të vendoste”.²¹ Sipas kësaj pikëpamjeje, ortodoksët e Shqipërisë, ndonëse ishin shqiptarë, për nga kombësia, nuk donin të bënin pjesë në një shtet të përbashkët me bashkatdhetarët e tyre myslimanë, sepse e ndjenin veten si grekë. Në mbështetjen e kësaj teze, e përqendroi vëmendjen kryetari i delegacionit të Athinës. E vërteta është se një pjesë e popullsisë shqiptare me besim ortodoks, kryesisht shtresat e larta të piramidës sociale dhe klerikët e lartë anonin nga Greqia e shfaqnin një qëndrim politik grekoman. Kjo pjesë numerikisht e vogël qëndronte në pozita atdhemohuese, siç shkruhej në atë kohë në shtypin shqiptar, apo e ndjente veten si greke, sikundër shkruante Venizelloja. Mirëpo, qëndrimin e kësaj pjese, Venizelloja ia vishte qëllimisht tërë popullsisë shqiptare ortodokse. Ai donte të mohonte luftën e gjatë me pushkë dhe me penë, që kishte bërë kjo pjesë e popullsisë, që nga fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si kundër pushtuesit osman ashtu edhe kundër shovinizmit e shovinistëve grekë ose tjetërsoj. Pjesa dërmuese e popullsisë shqiptare ortodokse luftonte për një shtet shqiptar të pavarur e demokratik, në një front të përbashkët

²¹ E. Venizelos, *La Grece...*, f. 4; *FR of the USA, PPC*, vol. III, f.860.

me pjesën myslimane e katolike të kombit shqiptar. Ajo kishte kontribuar e dhënë dëshmorë të shumtë, që nga Naum Veqilharxhi, rilindësi i parë i fillimit të shekullit të kaluar e deri te Themistokli Gërmenji, at Stathi Melanit etj., që i përkisnin viteve të fundit 1917 - 1918. Ishte njësoj sikur të mohojë patriotizmin e pjesës myslimane të popullsisë shqiptare, vetëm sepse nënshtresa të veçanta të saj, kishin ekzistuar elementë turkomanë, që nuk kishin dashur shpëtimin e tyre nga Perandoria Osmane.²² Venizelloja donte të merreshin si kriter dukurit politike të kësaj natyre, që janë vënë re pak a shumë edhe ndër shtresa të popujve të tjerë të perandorive shumëkombëshe e që kanë pasur madje të njëjtin besim fetar.

Përpjekjet e Athinës për t'i mohuar popullit shqiptar ndjenjën e tij kombëtare, ose për ta paraqitur këtë si ndërgjegje të fituar shumë vonë, shprehen fare qartë në deklaratën e Venizellosit të 3 shkurtit 1919, përpara Këshillit të të Dhjetëve. Ai theksoi në atë rast se: "... që nga koha e Shpalljes së Pavarësisë së Greqisë, të krishterët shqiptarë e kishin konsideruar veten gjithnjë grekë dhe lëvizja shqiptare kishte filluar vetëm përpara dy ose tre vjetësh", se "myslimanët shqiptarë deri në këto dy ose tre vjetët e fundit nuk kishin ushqyer kurrë asnjë ndjenjë kombëtare, ata gjithnjë e kishin konsideruar veten turq".²³ Për të mohuar ndjenjën kombëtare të shqiptarëve, kryeministri grek arriti deri atje sa të vinte shenjën e barazimit midis pjesës ortodokse të popullsisë shqiptare dhe diasporës së Greqisë, arvanitëve. Edhe në jug të Greqisë kishte 300 mijë banorë me origjinë shqiptare, të cilët "ishin helenizuar, si në zakone, ashtu edhe në veshje; megjithëse ruanin gjuhën shqipe", deklaronte Venizelloja. Dha edhe ilustrime. Vetë zëvendëskryeministri i atëhershëm i Greqisë, M. Repulis, komandanti i ushtrisë, gjenerali Danglia dhe komandanti i forcave ushtarake detare, admirali Kunduriotis, pohonte ai "për gjuhë amtare kanë shqipen".²⁴ Kjo ishte, natyrisht, lidhje artificiale. Arvanitët e Greqisë i kishin shpëtimin prej shekujsh lidhjet e tyre territoriale me atdheun mëmë; madje përpara pushtimit osman, kur ishin në shkallën e formimit të kombësisë. Megjithatë edhe ata kishin ruajtur vetëdijen e përkatësisë etnike. Pati arvanitë që ishin ngritur madje me forcë të madhe për të mbrojtur të

²² *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëll.III, Tiranë: Toena, 2007, f. 30-33, 60-72; Tafil Boletini, *Kujtime*, Botimimpex, Tiranë, 2011, f. 150-170; Marenglen Verli, *Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës*, Tiranë: Klean, 2008, vëll.I, f. 28-64; etj.

²³ PR to the FR of USA, PPC, vol III, f. 860-861.

²⁴ Po aty, f. 860. E. Venizelos, *La Grece...*, f. 4.

drejtat kombëtare të vëllezërve të tyre në Shqipëri, duke kritikuar çdo dallim fetar midis tyre.

Ndër ta ishte shquar Anastas Kullurioti, që punoi me shumë guxim në Athinë. "... feja s'mund të quhet në asnjë mënyrë provë e kombësisë greke për ortodoksët e Shqipërisë së Jugut", kishte shkruar gazeta e tij *I foni tis Allvanias* më 1879. Dhe më poshtë: "Të thuash se të krishterët janë shqiptarë grekë, vetëm pse ata besojnë doktrinën e kishës ortodokse, kjo ... është sikur të përcaktohet si parim kombësie feja dhe të zëvendësohet raca, fisi, gjuha, zakonet me dogmën fetare, atdheu me fenë, atdheu me sektin, gjë që është e papranueshme...".²⁵ Megjithatë pretendimet greke në mungesë të argumenteve të tjera, vijonin të ngriheshin mbi të njëjtat baza të dasive fetare e të mohimit të ndërgjegjes kombëtare. Është rasti të bëhet gjithashtu një paralele me atë që propagandohej në Itali asokohe për rolin e arbëreshëve, diasporës shqiptare atje. Siç u bënë përpjekje nga ana e qeveritarëve grekë për t'i përdorur arvanitët si një mbështetje e synimeve të tyre aneksioniste në Shqipërinë e Jugut, pati edhe orvatje për t'i përdorur arbëreshët e Italisë së Jugut si një mbështetje për vendosjen e protektoratit italian mbi të tërë Shqipërinë. Këto orvatje publikohen në mbarim të Luftës së Parë Botërore si në shtypin italian edhe në atë evropian e ballkanik.²⁶ Sa pak i qëndron kritikës njëra pikëpamje, aq i qëndron edhe tjetra, sepse mbi të njëjtat baza ekspansioniste qëndronin si synimi italian për protektoratin mbi Shqipërinë, ashtu edhe ai grek për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Nga arbëreshët e Italisë doli kryeministri italian i fundit të shek. XIX, Francesco Krispi, që ndoqi një politikë ekspansioniste, por shumë arbëreshë të tjerë, ndër të cilët Jeronim De Rada, luftuan për të drejtat kombëtare të atdheut mëmë.

²⁵ Z. Reso, *Anastas Kullurioti dhe gazeta "Zëri i Shqipërisë" 1879-1880*, Tiranë, 1981, f. 93.

²⁶ "Që Italia kërkon protektoratin mbi Shqipërinë, kjo mund të justifikohet plotësisht. Në qoftë se ka shumë pak italianë në Shqipëri, ka shumë shqiptarë në Itali, dhe pasi Shqipëria për një kohë të gjatë do të ketë nevojë për mbrojtjen e një shteti tjetër, ky shtet është shënuar të jetë Italia". Kështu shkruante në fillim të dhjetorit 1918 gazeta zvicerane *La gazetta de Lausanne*, kurse gazeta bullgare *Mir*, në nëntor 1918, duke bërë fjalë për "rregullimin" e Ballkanit pas luftës shkruante: "Adriatiku një det italian. Shqipëria një protektorat italian dhe sipas çdo mundësie një penetrim italian në Lindje. Kjo do të jetë e lehtë për këtë fuqi të re ballkanike, pasi ajo ka mjetet e nevojshme për ta kryer. Për të kuptuar se Shqipëria do të ndërrojë shpejt pamjen e saj të tanishme mjafton të përmendim të 400 mijë shqiptarët e vendosur në Sicili dhe Kalabri, pionierë dhe organizatorë italianë të natyrshëm..." Citohet sipas *L'Echo de Bulgarie*, Sofie, 14.11.1918; Shih dhe *The New Europe*, 19.12.1918, f. 227-231.

Animin politik progrek të popullsisë shqiptare me besim ortodoks dhe mohimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare të saj E. Venizellos u përpoq ta argumentonte më tej me shpërthimin e lëvizjes “vorio-epirote” më 1913-1914. Gjithashtu, ai nënvizonte përhapjen e shkollës e të kulturës greke në Shqipëri. Kjo propagandë është bërë objekt i një kritike të fortë e të drejtë qysh atëherë.²⁷ Është e tepërt të flitet më gjatë këtu për këtë. Duhet vënë në dukje vetëm fakti se në memorandumit e tij të 30 dhjetorit 1918, Venizelloja ndalej në mënyrë të veçantë në krahinën e Korçës. Ai tregonte përhapjen e gjerë në këtë trevë, në kohën e pushtimit osman, të shkollave në gjuhën greke dhe luftën që kishte bërë elementi filogrek me kishën në krye, për të penguar përhapjen e shkollës e të mësimin në gjuhën amtare shqipe. Me këto Venizelloja përpiquej të dëshmonte për “karakterin grek të Korçës.”²⁸ Kjo përpjekje e veçantë nuk ishte e rastit. Në tërë trevën e Korçës nuk kishte asnjë fshat grek. Korça kishte qenë mandej “qendër e patriotizmit” dhe “djepi i iluminizmit shqiptar”, gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Këtë fakt kryeministri grek ishte detyruar ta pranonte në bisedime me diplomatë britanikë.²⁹ Përveç kësaj ai nuk mund të mos kishte parasysh suksesin e madh që kishte arritur lëvizja kombëtare në Korçë në dhjetor 1916, kur masivisht, qytetarë e fshatarë, të bashkuar pa dallim fetar dhe të udhëhequr nga atdhetarë të njohur si Themistokli Gërmenji e Sali Butka, kishin treguar jo vetëm ndjenjë të lartë kombëtare shqiptare, por i kishin detyruar pushtuesit francezë të pranonin kërkesat e tyre politike, siç ishte, edhe largimi prej andej i administratës greke venizeliste. Venizelloja duket se donte të ndikonte mbi përfaqësuesit e Britanisë së Madhe dhe sidomos mbi ata të SHBA, të cilët, kishin rezerva për sa i përket kalimit të krahinës së Korçës në kufijtë e shtetit grek. Në përpjekjet e tyre për mohimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe për ta luftuar lëvizjen e tij kombëtare, përfaqësuesit të “Idesë së Madhe” shkuan akoma më tutje. Një rol të veçantë në këtë drejtim kishte marrë përsipër të kryente ish-ministri i Punëve të Jashtme në “qeverinë” e “Epirit të Veriut” të 1914, A. Karapanos. Më vonë në kabinetin grek të Kallogjeropullos (Nikolas Kalogeropoulos), të formuar në tetor 1916, kishte qenë për disa javë (16 shtator-9 tetor 1916)

²⁷ Shih: *Refutations des arguments...*, f. 6-10.

²⁸ E. Venizellos, *La Grece...*, f. 4-5.

²⁹ *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, edited by Rohan Butler, J.P.T.Bury, M.E.Lambert, First Series, Vëll.XII, London Her Majesty, Stationery Office 1962, dok.318 dhe aneksi.

ministër i Punëve të Jashtme i shtetit helen.³⁰ Karapanos u paraqit në Paris në krye të një përfaqësie të “epirotëve” të përbërë nga grekomanë të tillë, si: Spiro Spiromilo, Josif Adhamidhi e Kristo Koska.³¹ Në memorandumin që i paraqiti Konferencës së Paqes në fund të janarit 1919, ai u ndal në disa çështje të paprekura nga Venizelloja. Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Shqipërinë e Jugut gjatë Luftës së Parë Botërore, A. Karapanos ose e mohoi ose e paraqiti nga një këndvështrim që përputhej me synimet e tij. Këtë lëvizje, që kishte synuar të shfrytëzonte në interes të çështjes shqiptare, kontradiktat ndërkombëtare, siç ishin ato italo-greke, ai e paraqiti gjoja si “pjellë” të pushtuesve italianë dhe të atyre francezë. Kurse një udhëheqësi të shquar të kësaj lëvizjeje, Themistokli Gërmenjit, A. Karapanos i vishte petkun e “aventurierit politik”.³²

Kështu, regjimin e pushtimit të vendosur në Shqipërinë e Jugut nga forcat e armatosura franceze, dhe veçanërisht, nga ato italiane, Karapanos e jepte me një dritë fare të njëanshme e të shtrembër. E paraqiste si shtypës vetëm ndaj atyre pak forcave që ishin për bashkimin me Greqinë, ndërsa ndaj forcave kundërshtarë si “përkrahës”.³³ Lëvizjen çlirimtare shqiptare në Jug, që zhvillohej nën flamurin e unitetit kombëtar dhe jo të dasisë fetare, ai e injoronte dhe e luftonte, sikundër e kishte luftuar më parë, më 1912-1916. Nga ky parashtrim i pretendimeve të rretheve ekspansioniste greke mbi Shqipërinë e Jugut del qartë sesa larg qëndronin ato nga respektimi i parimit të kombësisë. Me gjithë mungesën e argumenteve të qëndrueshëm, propaganda e diplomacisë greke, por edhe pozicionime të natyrës politike, kanë ndikuar që disa autorë, për mosnjohje të mirë të fakteve, ose për pozicionim të paracaktuar, në mos qëndrim në shërbim të politikës, u bëjnë jehonë, në një formë ose në një tjetër, pretendimeve greke në Shqipëri.³⁴ Të ndikuar nga materialet e përfaqësuesve të Athinës në Konferencën e Paqes, ose të ndikuar nga autorë të ndryshëm grekë, të djeshëm dhe të sotëm, ka autorë që mbështesin edhe sot pretendimet greke të kohës së E. Venizellos dhe A. Karapanos mbi Shqipërinë e

³⁰ E. Driault et M. L’Heritier, *Histoire diplomatique de la Grèce de 1821 a nos jours*, Paris, 1926, vol. V, f. 258.

³¹ D. Kitsikis, *Propagande...*, f. 362, shën. 4.

³² A. Carapanos, *Mémorandum sur l’Epire du Nord, 1919*, f. 12.

³³ *Po aty*, f. 7-12.

³⁴ Shih Petsalis-Diomidis, N., *Greece at the Paris...*, f. 64; Ph. Philon - *The question of Northern Epirus its historical and diplomatic background* Washington: Grek Government Office of Information, 1945, etj.

Jugut. Një botim i viteve të fundit, p.sh. vlerëson se memorandum i A. Karapanos “argumentet greke i shtjellonte me mjeshtëri të madhe e me frymë të moderuar”,³⁵ ndërkohë që në të vërtetë aty s’kishte asgjë të kësaj natyre. Memorandumin e përshkonte fund e krye një frymë e egër nacionalizmi që luftonte e përbuzte çdo gjë të mirë që kishte arritur e përpiquej të arrinte fqinji i Veriut.

Për A. Karapanon çdo shqiptar ortodoks kudo që ishte, në Shqipërinë e Jugut ose në Shqipërinë e Mesme, duhet të quhej si grek,³⁶ shteti shqiptar i 1913 duhej të konsiderohej si “krijesë artificiale e diplomacisë austro-italiane”,³⁷ kurse vetë populli shqiptar si “pjellë” e pushtuesve osmanë³⁸. Përmbajtja e memorandumit të tij, ashtu si ai i Venizellos, në thelb drejtoheshin kundër popullit shqiptar, ndërgjegjes së tij kombëtare dhe lëvizjes së tij politike dhe jo kundër pushtuesve italianë në Shqipëri, armiqve të përbashkët të popujve dhe vendeve fqinje ballkanike.³⁹ Në të njëjtën linjë propagandonte synimet e Athinës edhe dr. J. Gasopulos (J. Gascopulos), kryetar i Unionit “panepirot”. Në një letër dërguar Klemansoit më 13 maj 1919, ai shprehej se nuk duhej lejuar që popullsia e Epirit të mbetej nën terrorin e bandave “turko-shqiptare” që ishin “hordhi gjysmë të egra”.⁴⁰ Një qëndrim i tillë ia mbyllte rrugën afrimit shqiptaro-grek që ishte i nevojshëm për luftën kundër ekspansionit italian në Shqipëri e në Ballkan. Këtë derë e

³⁵ N.Petsalis - Diomidis, *Greece at the Paris ...*, f. 143.

³⁶ Përveç të krishterëve të Korçës dhe të Gjirokastrës, shkruante A. Karapanos në memorandum, në kufijtë e shtetit shqiptar të 1913 ishin përfshirë edhe shumë të krishterë të tjerë, sikundër “... janë banorët e krahinës në veri të Vlorës, të Beratit etj., numri i të cilëve, vetëm në rajonin që ndodhet në afërsi të kufirit të Epirit i kalon të 45 mijë, pa përmendur shumë të krishterë, gjithashtu grekë, që ndodhen më në veri”. (A. Carapanos, *Memorandum...*, f. 13.

³⁷ “Sot nuk është më fjala të ngrihet një ndërtesë e mbështetur mbi nevojat politike të shteteve të mëdha, por “njësi kombëtare të afta për të jetuar”. (*Po aty*, f. 13-14).

³⁸ “Në rastin e Shqipërisë, ne gjendemi përpara një problemi racial të veçantë, që ka lindur në gjirin e Turqisë, xhelatë individësh, por dikur krijuese kombësish për t’i vënë njëri kundër tjetrës. A donë ndokush të pretendojë që shqiptari mysliman, krijesë pothuajse në tërësi e pushtimit (turk) ka të drejtë për një regjim të veçantë që t’i sigurojë epërsinë mbi fqinjin e tij të krishterë... (f. 13-14).

³⁹ Lavdosh Ahmetaj, “Shqipëria dhe qëndrimi i shteteve ballkanike në Konferencën e Paqes, Paris 1919-1920”, në botimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, *Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë*, Tetovë - Shkup 23-28 shtator 2009, f. 329-332.

⁴⁰ *Po aty*, f. 331; *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AMPJ), viti 1919, dosja 4, f. 43, Gassopoulos; Shih edhe Lavdosh Ahmetaj, *Shqipëria në Konferencën e Paqes në Paris dhe delegacionet shqiptare 1919-1920* (Tezë doktore, Tiranë, 2009, f. 78).

mbyllnin gjithashtu mitingjet e shumtë që mbaheshin në qendrat në anën tjetër të kufirit. Një miting i tillë u organizua në Janinë më 2 shkurt, d.m.th. një ditë më parë se Venizeloja të dëgjohej përpara Këshillit të të Dhjetëve. Në këto mitingje kërkohej zëvendësimi i pushtimit italian e francez të Gjirokastrës e të Korçës me atë grek, si edhe aneksimi i Shqipërisë së Jugut nga Greqia.

Këto kërkesa në muajt e parë të vitit 1919 zinin një vend të dukshëm edhe në faqet e shtypit proqeveritar ballkanik.⁴¹ Të gjitha këto nuk mund të mos ushtronin ndikimin e tyre politik ndër shqiptarët. Ato ndikonin në ndarjen midis dy popujve fqinj, dhe jo në afrimin e tyre. Kërkesa e pretendime të tilla në fakt i bënë jehonë ku më shumë e ku më pak, edhe propagandës së qeverisë italiane, që përpiqej të theksonte rrezikun që përbënin monarkitë ballkanike fqinje për Shqipërinë dhe që paraqitej përpara shqiptarëve si “mbrojtësja” e Shqipërisë nga ky rrezik. Bile Roma i frynte shumë kësaj ane për të fshehur kështu sadopak planet e saj koloniale ndaj Shqipërisë. Nga ana tjetër vetë kryeministri grek ishte i prirur për afrimin me Italinë, për arritjen me të, të një marrëveshjeje në ndarjen e Shqipërisë. Ky ishte drejtimi tjetër ku u përqendrua vëmendja e Venizellos. Prirje të tilla afrimi, ishin shfaqur më herët, sidomos qysh nga koha e luftërave ballkanike, mandej edhe më 1917, pas hyrjes së Greqisë venizeliste në luftë në anën e Fuqive të Antantës.⁴² Në maj të vitit 1918, E. Venizeloja i kish propozuar përfaqësuesit diplomatik italian në Athinë, A. De Bosdarit, të ktheheshin në “marrëveshjen fatlume, e cila... u arrit më 1914, midis Italisë e Greqisë nën kujdesin e Anglisë”.⁴³ D.m.th. të ripërtërinin atë ujdë të pashkruar, kur Italia pranoi pushtimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia, meqenëse asokohe donte të pushtonte Vlorën. Në mbarim të konfliktit botëror këto përpjekje nga ana greke u bënë më të shpeshta. Venizelloja dëshironte “gjallërisht që midis të dy qeverive të arrihet mundësisht një ujdë përpara fillimit të bisedimeve të paqes”,⁴⁴ i

⁴¹ *Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: DDI), Ser. VI, vol.II, dok. 136, 287, 373, 660, 832; AMAE-Europe 1918-1929, Albanie, vol.28, fl. 189, 196-197; R. Woodall, *The Albanian Problem during the Peace making 1919-1920*, Ph. D. Thesis, Memphis state University, 1978, p. 72.

⁴² S.Sonino, *Carteggio 1916-1922*. A cura di Pietro Pastorelli, Roma-Bari, 1975, dok. 245.

⁴³ A.de Bosdari, *Delle guerre Balcaniche, dello grande guerra e d'alcuni fatti precedenti ad esse*, Milano, 1931, f. 211-213.

⁴⁴ DDI, Ser.VI, vol.I, dok. 403.

telegrafonte Romës në dhjetor 1918 ambasadori i saj në Paris, Bonin Longare, pas takimit me kryeministrin grek.

Këto prirje të qeverisë greke nxiteshin në këtë kohë për qëllime të caktuara edhe nga fuqitë e tjera fituese të luftës, sidomos nga Britania e Madhe dhe Franca.⁴⁵ Këto donin që Roma me Athinën t'i zgjidhnin mundësisht vetë divergjencat që kishin midis tyre, të cilat nuk ishin të pakta. Ato kishin të bënin me Shqipërinë e Jugut, me Dodekanezin, me brigjet e Azisë së Vogël, mbi të cilat Italia kishte siguruar gjatë luftës pozita të rëndësishme për aspiratat e saj ekspansioniste në dëm të atyre greke. Në Shqipërinë e Jugut dhe në Dodekanez pozitat e siguruar nga Italia ishin të dyfishta, të brendshme dhe të jashtme. Një pjesë e madhe e Shqipërisë së Jugut ndodhej nën pushtimin e ushtrisë italiane, sidomos pjesa që lidhej me Kanalin e Korfuzit e që i interesonte më shumë Italisë. Po ashtu, në dorën e ushtrisë italiane ishin të gjithë ishujt e Dodekanezit. Me Traktatin e Londrës, Italia kishte siguruar sovranitetin mbi këta ishuj grekë (që arriti t'i mbante deri në vitin 1943), kurse në Shqipërinë e Jugut kishte siguruar një pozitë të veçantë. Në këto kushte përpjekjet e Athinës për zgjidhjen e kontradiktave me rrugë bisedimesh dypalëshe me Romën, e për t'u paraqitur pastaj përpara Konferencës së Paqes me një gjuhë të përbashkët ishin të mëdha. Bisedimet greko-italiane të filluara në dhjetor 1918, vijuan, ndonëse pa ndonjë rezultat konkret, edhe në janar 1919.⁴⁶ Periudha e “muajve të mjalitit” midis Romës dhe Athinës, ajo e fillimit të Luftës së Parë Botërore (kur Italia pranoi pushtimin zyrtar të Shqipërisë së Jugut nga Greqia, meqë vetë kishte nevojë të pushtonte Vlorën), tashmë kishte marrë fund. Udhëheqësi i diplomacisë italiane e quante tani të pamjaftueshme “ofertën bujare” të partnerit grek të tij, sikundër e quan një historian i huaj gatishmërinë e Venizelos për të hequr dorë nga aneksimi i një pjese të Kurveleshit dhe të Tepelenës, nga ato vise që Italia i konsideronte si pjesë e hinterlandit të Vlorës.⁴⁷ Ministri i Jashtëm i Italisë donte dhe propozonte ta ndante Shqipërinë e Jugut përgjysmë me Greqinë e të ndahej kështu përgjysmë edhe zotërimi i Kanalit të Korfuzit. Në këtë vështrim, Sonino i kërkonte Venizelos të hiqte dorë nga pretendimi i tij mbi krahinat bregdetare, d.m.th. mbi ato të Gjirokastrës dhe të mjaftohej

⁴⁵ DDI, Ser.VI, vol.II, dok.836, shënimi 1, f. 637; N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris ...*, f. 75.

⁴⁶ DDI, Ser.VI, vol.II, dok. 95; S. Sonino, *Diario 1916-1922*, Bari, 1972, f. 316, 326, 331-332.

⁴⁷ N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris ...*, f. 142.

me aneksimin e pjesës tjetër të Shqipërisë së Jugut, me Korçën, duke përfshirë Kolonjën dhe Leskovikun. Me këtë pjesë Greqia do të siguronte vijën e rëndësishme të komunikacionit që lidhte Epirin Jugor me Maqedoninë, d.m.th. vijën Prevezë-Janinë-Korçë-Manastir-Selanik. Nga të dyja palët u shkëmbyen bile edhe hartat për “ofertat” përkatëse.⁴⁸ Por, Venizeloja i donte të dy pjesët edhe Korçën edhe Gjirokastrën dhe priste përkrahjen e fuqive të tjera, veçanërisht atë të Francës dhe të Britanisë së Madhe për t’i siguruar të dyja. Gjithsesi, kryeministrit grek nuk i mungonte përvoja. Ai e dinte se përballë Italisë duhet të tregohej i matur. Sipas materialeve greke, ai ishte i gatshëm, megjithëse me keqardhje, ta pranonte më në fund ndarjen e propozuar prej Soninos: të merrte krahinën e Korçës e të “sakrifikonte” atë të Gjirokastrës.⁴⁹ Bisedimet vazhduan edhe në shkurt, por gjërat nuk ecën më tej.

Një ujdj italo-greke, për ministrin italian të Punëve të Jashtme, ishte e padobishme.⁵⁰ Si përfaqësues i një fuqie të madhe fituese, S. Sonino priste nga aleatët dhe nga fuqia shoqe, të shqyrtoheshin më parë kërkesat e Italisë në Konferencë, dhe të shtyhej sa më shumë dëgjimi i delegacionit grek nga Këshilli i të Dhjetëve. Në fillim të 1919, diplomacia italiane në bisedime me atë greke bënte vetëm sondazhe, pa hyrë në veprime angazhuese.⁵¹ Roma donte gjithashtu t’i mbante pozitat e fituara tanimë në Shqipërinë e Jugut. Madje synoi të shtinte në dorë edhe pjesën e pushtuar nga Franca. Në fund të dhjetorit 1918 dhe fillim të janarit 1919, kur u përhapën fjalë se francezët mund të tërhiqeshin nga Korça, qeveria e Romës urdhëroi ushtrinë e saj të përgatitej për t’u zënë kështu vendin trupave franceze. Kjo duhej bërë, pohonte ajo, për të evituar “përparimin e mundshëm në tokën shqiptare të trupave dhe bandave greke”.⁵² Roma nuk e pranoi edhe një kërkesë të qeverisë helenike, paraqitur nëpërmjet ambasadorit francez në Romë, K. Barrere, në mes të janarit 1919, që një divizion grek, të përdorte rrugën Follorinë-Korçë-Leskovik për të kaluar prej Follorinë në Janinë. Qeveria italiane kishte frikë se pas kësaj mund të fshihej ndonjë plan i Greqisë për të pushtuar Korçën. Kontradiktat greko-italiane si dhe dëshira për zgjidhjen e tyre, gjetën pasqyrim si në memorandumin e delegacionit grek të 30 dhjetorit 1918, ashtu edhe në pretendimet që ky

⁴⁸ DDI, Ser.VI, vol.II, dok. 95, 124; S.Sonino, *Diario*, f. 326, 331-332.

⁴⁹ N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris ...*, f. 135-138.

⁵⁰ V. E. Orlando, *Memorie (1915-1919). A cura di Rodolfo Mosca*, Milano, 1960, f. 386-387.

⁵¹ DDI, Ser, VI, vol. I, dok. 777, 778.

⁵² DDI, Ser, VI, vol. I, dok. 664, si dhe dok. 614, 666, 775; *Po aty*, vol.II, dok. 18.

delegacion parashtroi përpara Këshillit të të Dhjetëve. Marrëveshja e fundit të vitit 1914, kur Italia pushtoi Vlorën dhe Greqia Shqipërinë e Jugut, linte të kuptohej, theksonte Venizeloja në memorandum, që në qoftë se “në kohën e paqes pushtimi i Vlorës nga Italia do të konfirmohej, pushtimi i Epirit të Veriut nga Greqia do të ishte gjithashtu definitiv”. Më poshtë në memorandumin e qeverisë greke pohohej se: “Në Traktatin e fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915, Fuqitë e Antantës, duke i njohur Italisë të drejtën e pushtimit të Vlorës, vendosën që kufijtë e këtij pushtimi nuk duhej të kalonin në jug të atyre të “Epirit të Veriut”.⁵³

Kështu pretendimet e tij në Shqipëri, Venizeloja i lidhi së fundi me ato të Italisë në Shqipëri, në kuptimin që realizimi i këtyre pretendimeve nuk mund të ishte i njëanshëm, por i barabartë për të dyja palët. Këtu, në këtë ndarje të Shqipërisë midis Greqisë dhe Italisë, mendojmë se qëndroi thelbi i pretendimeve greke mbi Shqipërinë e Jugut. Kryetari i delegacionit grek kërkesat e qeverisë së tij ia paraqiti më në fund, më 3-4 shkurt, Këshillit të të Dhjetëve. Në këtë paraqitje të re, kërkesave të memorandumit të 30 dhjetorit, Venizeloja u bëri vetëm një ndryshim në renditje. Më 3 shkurt renditja ndiqte kriterin politik dhe jo atë gjeografik të memorandumit.⁵⁴ Pas pretendimeve mbi Shqipërinë e Jugut, ai vendosi menjëherë kërkesat mbi ishujt e Dodekanezit. Këtë renditje Venizeloja e bëri pasi Italia, pohonte ai, “ishte shumë e interesuar në sistemimin e këtyre çështjeve”.⁵⁵ Në këtë mënyrë kryetari i qeverisë së Athinës po e lidhte çështjen e drejtë të çlirimit të ishujve grekë të Dodekanezit, me një çështje të padrejtë, me aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia nën petkun e “çlirimit” të ortodoksëve të kësaj pjese të vendit. Ishte një lidhje e bërë me qëllim, për të ndikuar sadopak në përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha fituese, të mbledhur në Këshillin e të Dhjetëve. Kryeministri grek i vuri gjithashtu në dukje këtij Këshilli se midis Italisë dhe Greqisë ishin zhvilluar bisedime, të cilat kishin për qëllim, pohonte ai “të arrihej në një marrëveshje dhe të përgatitej rruga për një zgjidhje pa impenjuar Konferencën”.⁵⁶ Më 4 shkurt, E. Venizeloja e arriti atë që priste. Për të shqyrtuar kërkesat territoriale të Greqisë, duke përfshirë edhe ato në Shqipërinë e Jugut,

⁵³ E. Venizelos, *La Grece...*, f.5.

⁵⁴ Në memorandum, pas pretendimeve mbi Shqipërinë e Jugut vinin me radhë kërkesat mbi Thrakën Perëndimore e atë Lindore, që pasoheshin nga ato në Azinë e Vogël Perëndimore e ishujt e Dodekanezit.

⁵⁵ *PR to the FR. Of the USA, PPC*, vëll. III, f. 859.

⁵⁶ *Po aty*, vëll.III, f. 859; *DDI*, Ser.VI, vol.III, dok. 226.

Këshilli i të Dhjetëve ngriti një komision të posaçëm, i cili do të fillonte nga puna pas disa ditësh. Këtij Komisioni, Këshilli i të Dhjetëve i ngarkoi shqyrtimin e çështjes shqiptare, pas dëgjimit më 24 shkurt të delegacionit shqiptar.⁵⁷

Sipas materialeve të delegacionit italian (që informonte Romën më 24 shkurt), u veprua kështu “për kursim personeli dhe për shkak të së njëjtës brendi të çështjes” (connessita argomento).⁵⁸ Në të vërtetë problemi nuk qëndronte tërësisht ashtu. Në qoftë se për shqyrtimin e kufirit shqiptaro-grek çështja mund të themi se ishte e njëjtë, nuk ishte e tillë për kufirin shqiptaro-jugosllav. Por dhe për shqyrtimin e këtij kufiri, çështja kishte marrë pothuajse fund një javë më parë. Pas dëgjimit më 18 shkurt të delegacionit jugosllav, Këshilli i të Dhjetëve çështjen e kufijve shqiptaro-jugosllavë e kishte lidhur në fakt me “çështjen e Adriatikut”,⁵⁹ d.m.th. me divergjencat italo-jugosllave për ndarjen e trashëgimisë austro-hungareze gjatë Adriatikut Verior e Lindor, ashtu sikundër ishte lidhur me Traktatin e fshehtë të Londrës çështja e Adriatikut Jugor dhe Jonit. Kjo lidhje çoi në atë që jo vetëm kërkesat territoriale të delegacionit shqiptar të liheshin mënjanë, por edhe pavarësia e Shqipërisë dhe territoret e shtetit shqiptar të shndërroheshin në “plaçkë tregu” në duart e përfaqësuesve të fuqive kryesore fituese.

⁵⁷ *FR of the USA, PPC*, vol.IV, f. 104; H. Nicolson, *Peacemaking...*, f. 268-269.

⁵⁸ *DDI*, Ser. VI, vol.II, dok. 475, datë 24.2.1919.

⁵⁹ *PR to the FR of USA, PPC*, vol. IV, f. 362; D.H. Miller, *My Diary*, vol. XI, f. 328.

Muin ÇAMI –Marenglen VERLI

SUMMARY

THE GREEK PIROUETTES AT THE PARIS PEACE CONFERENCE IN RELATION TO THEIR TERRITORIAL ASPIRATIONS IN SOUTHERN ALBANIA THROUGHOUT JANUARY-MAY OF 1919

At the Peace Conference in Paris (1919-1920), the discussions on the Albanian case were immediately subdued to the Greek territorial aspirations in Southern Albania, similarly to the other neighboring countries who also had expansive territorial aspirations in Albanian lands. The governing circles in Athens, led by a charismatic and experienced diplomat, E. Venizelos, had quite ambitious goals. They wanted to expand the Greek borders hoping that they could annex the territories that were once under medieval Byzantine, an Empire they considered to be their historical predecessor. Paris and London had geo-strategical interests in cooperating with Greece, especially so with the Party of Venizelos, mostly because the latter was on guard to help eliminate the Ottoman Empire in the East as well as to block the Italian expansion in the Balkans. The Italian presence in Albania served Greece as an excuse to ask for the part that they believed 'belonged to them', thus putting into use the reigning contradictions between the winning powers. Initially, the requests presented by Athens were reviewed on the 30th of December 1918, and were later hurriedly presented by E. Venizelos to the main powers preceding the official opening of the Paris Peace Conference. According to the memorandum, the Greeks aimed to take control over Korçë and Gjirokastër as well. The ethnic composition consisting of Albanians remained the most serious obstacle for the Greek government. The other obstacle was the Italian presence in Albania, the former being the main rival to the Greeks in regards to their territorial aspirations in Albania.

KDU: 327(496.5:450) "19"
94(496.5).086/.087
(093.2)

Jorina VERLI

**SHQIPËRIA – PRIORITET STRATEGJIK I POLITIKËS
ITALIANE NË DEKADAT E PARA TË SHEK. XX**

Shumë shpejt pas krijimit, në gjysmën e dytë të shek. XIX, nën kurorën e dinastisë së Piemontit, Italia përcaktoi prioritetet e politikës së vet të jashtme. Në procesin e rritjes ekonomike dhe konsolidimit politiko-administrativ, ajo i ktheu në krahun lindor të Adriatikut. Përballë shteteve të fuqishme të Francës në veriperëndim dhe Austro-Hungarisë në veri e verilindje, për qarqet drejtuese të Romës, në kontinentin evropian, i vetmi krah i depërtimit ekonomik e politik mbetej Ballkani Perëndimor, përkatësisht ndonjë shtet i parëndësishëm si Mali i Zi, ku gjithsesi kishte edhe lob rus të rëndësishëm, apo territoret shqiptare të Perandorisë Osmane, ku duhej konkurruar me Austro-Hungarinë. Orientimi i Italisë për ekspansion në drejtimin e përmendur, që do të vijonte edhe në shek. XX, është një temë e trajtuar në historiografinë shqiptare. Gjithsesi në këtë trajtesë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme bibliografike e arkivore të dala në dritë kohët e fundit, do të përpiqemi t'i qasemi temës nga një këndvështrim i veçantë, për një periudhë 8-vjeçare, kur ngjarje të bujshme në rajon, nxorën në pah thelbin e politikës italiane në Shqipëri.

**Konferenca e Londrës. Italia, interesat mbi Shqipërinë dhe roli i
veçantë i kujdestarisë mbi shtetin shqiptar të porsakrijuar**

Nga fundi i shek. XIX dhe në dekadat e para të shek. XX, interesat e dukshme të Italisë në Shqipëri, në të gjithë sferat,

(posaçërisht në angazhimin politik, ekonomik dhe në arsim-kulturë,) e detyruan Perandorinë e fuqishme Austro-Hungareze, t'i njohë pjesën e tij, shtetit të ri dhe madje agresiv përtej mundësive reale. Marrëveshje të veçanta konfirmuan ortakërinë strategjike që, nga njëra anë, ruante një farë baraspeshe midis dy rivalëve dhe nga ana tjetër, siguronte aleancën konsensuale, e cila kishte për qëllim të pengonte synimet e shteteve të vogla të Ballkanit, satelite në orbitat e Rusisë (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria) dhe Britanisë së Madhe.¹

Aleanca midis Italisë dhe Austro-Hungarisë, për çështjen shqiptare, spikati veçanërisht në vitet 1912-1913. Pavarësisht nga nuancat e ndryshme, për aspekte të ndryshme të qëndrimeve politike, të dy shtetet që zotëronin brigjet e Adriatikut, mbajtën qëndrim thelbësisht të njëjtë, kur ishte fjala për muajt e zhvillimit të Luftës së Parë Ballkanike dhe më pas në Konferencën e Londrës.² Sa kohë ishte në luftë me Perandorinë Osmane, në vitet 1911-1912, Italia prirej të nxiste turbullira në Ballkan, e në këtë kontekst, t'i frynte zjarrit kryengritës në Shqipëri, qëndrim ky i ndryshëm nga ai i Austro-Hungarisë. Por në tetor-nëntor, kur ushtritë e Portës së Lartë ishin shpartalluar dhe synimet e fitimtarëve të Luftës Ballkanike kishin dalë hapur në pah, qëndrimet e të dy shteteve ishin akorduar plotësisht. Italia iu bashkua këmbënguljes së ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, kontit energjik Bertold (Leopold Berchtold), për të mos lejuar në asnjë rrethanë, e duke mënjeluar me çdo kusht, daljen e Serbisë në Adriatik, madje nëse lindte nevoja edhe duke u angazhuar në një luftë rajonale.³ Projekti serb, në të gjitha variantet, qoftë për aneksimin e territoreve shqiptare, qoftë për sigurimin e një korridori simbolik, u kundërshtua nga të dy zotëruesit e

¹*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, (Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX – 1912), Botimet TOENA, Tiranë 2002, f. 29; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Përmbledhje dokumentash me një vështrim historik*, Vëllimi II, (1912-1918), Tiranë 1987, f. 25; shih edhe *British Documents on the Origins of the War, 1898-1914*, London 1927-1938; *Documenti Diplomatici Italiani*, Roma 1952.

²*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, (Periudha e Pavarësisë – 28 Nëntor 1912 – 7 Prill 1939), Botimet TOENA, Tiranë 2007, f. 19, 21, 27; shih edhe *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, Vëllimi VII, Tiranë 2014; Muhamet Shatri, *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi II, Botimet TOENA, Tiranë 2012; Muhamet Shatri, *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, Botimet TOENA, Tiranë 2012.

³*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, Vëllimi II, Raporte dhe deklarata rreth bisedave e qëndrimeve austro-hungareze e italiane në tetor-nëntor 1912.

pellgut të Adriatikut, sepse dalja portuale e Serbisë në bregdet, do të thoshte jo vetëm dalje në Mesdhe e Perandorisë Ruse, por edhe sepse depërtimi tokësor serb e përjashtonte krijimin e një shteti shqiptar të qëndrueshëm, që supozohej të ndalte dyndjet sllave drejt Perëndimit. Kryeministri italian San Xhuliano (Antonio Petero Costello, marchese di San Giuliano) vlerësoi realiste politikën kundërshtuese të Vjenës, duke konkluduar se dalja e Serbisë në Adriatik, do të sillte jo vetëm asfiksi për Vjenën, por edhe paqëndrueshmëri për Romën dhe asgjësim të synimeve të kësaj të fundit për ekspansion drejt Lindjes, e konkretisht drejt Ballkanit, në të ardhmen.⁴

Në Konferencën e Ambasadorëve, që filloi punimet më 17 Dhjetor 1912 në Londër, organizuar nga Fuqitë e Mëdha (Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Austro-Hungari, Rusi dhe Itali), praktikisht ambasadorët përfaqësues të Austro-Hungarisë dhe Italisë, të përkrahur pa ndonjë pasion, për shkak të mungesës së interesit të drejtpërdrejtë edhe nga Gjermania, mbajtën të njëjtën linjë që shtetet e tyre kishin ndjekur gjatë muajve të fundit (tetor-dhjetor 1912). Si pasojë, interesat e tyre të posaçme në rajon, u detyruan t'i merrnin në konsideratë edhe fuqitë e tjera. Në këtë mënyrë, u shmang dalja e Serbisë në Adriatik, duke marrë territore bregdetare shqiptare (fillimisht iu njoh një dalje ekonomiko-tregtare, përmes një skele shqiptare “të lirë dhe asnjëanëse”, që do të shfrytëzohej përmes një hekurudhe ndërkombëtare dhe do të mbikëqyrej, po ashtu, nga një forcë ndërkombëtare). U miratua krijimi i një shteti shqiptar, fillimisht autonom nën varësinë e Turqisë, por që më 29 korrik 1913, u përcaktua se ky shtet do të ishte i pavarur.⁵ U debatua

⁴Arkivi i Institutit të Historisë (më tej AIH), Fondi (më tej: F.) Arkiv i Vjenës, shih: Dokumente të muajve nëntor-dhjetor 1912. Dokumentet e sipërpërmendura janë botuar në *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimet V, VI, Tiranë 2012, Vëllimi VII, Tiranë 2014; M. Shatri, *Dokumente britanike...*, Qëndrimi i përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha më 17 dhjetor 1912-29 korrik 1913.

⁵*Po aty*, Sipas vendimit të 29 korrikut 1913, Shqipëria shpallej principatë autonome, sovranë dhe e trashëgueshme (Neni 1); çdo lidhje sovraniteti me Turqinë përjashtohet (Neni 2); Shqipëria bëhet shtet asnjëanës nën garancinë e Fuqive të Mëdha (Neni 3). Por, nga ana tjetër shteti shqiptar vihet nën kontrollin e tyre, që nënkuptonte kontroll mbi administratën civile dhe mbi financat e Shqipërisë. Mbikëqyrja do të ushtrohej me anën e një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë nga delegatët e Gjashtë Fuqive të Mëdha dhe nga një deputet i Shqipërisë... KNK do t'i vazhdonte funksionet e kontrollit për 10 vjet, që në rast nevojë do të përsëriteshin (nenet 4,5,6). Në krye të Shqipërisë vendosej një princ, i cili do të caktohej nga Fuqitë e Mëdha, brenda jo më shumë se 6 muajve (Neni 7). Qetësia dhe rendi publik do të siguroheshin nga xhandarmëria, organizimi dhe drejtimi i së cilës do t'u besohej oficerëve të huaj (Neni

gjatë për kufijtë, që më në fund, më 22 mars 1913 dhe 11 gusht 1913, u përcaktuan, me lëshimet dy-palëshe të Austro-Hungarisë dhe Rusisë mbi projektet e tyre fillestare. Si përfundim, brenda kufijve të shtetit shqiptar u përfshinë rreth 28 000 km², pra vetëm gjysma e sipërfaqes tokësore dhe gjysma e numrit të popullsisë. Përcaktimet territoriale nuk mund të ndryshonin pa një ligj, i cili do të kërkonte paraprakisht aprovimin e gjashtë Fuqive të Mëdha. Megjithatë, ato e njohën Shqipërinë si shtet *de jure*, e për pasojë si të tillë e njohën edhe Rumania, Bullgaria, Serbia dhe Greqia.⁶

Pikërisht, Konferenca e Londrës (17.12.1912-12.08.1913), që në seancën e parë të 17 dhjetorit, në kohën që ishte vendosur krijimi i “Shqipërisë autonome e asnjëanëse, nën garancinë dhe kontrollin ekskluziv të Fuqive të Mëdha”, ngarkoi Austro-Hungarinë dhe Italinë me “detyrën” e hartimit dhe paraqitjes së një projekti të hollësishëm për organizimin e shtetit të ri autonom, duke njohur kështu “interesat e tyre të posaçme” mbi trevat shqiptare. Pra, ndonëse nuk iu dha zgjidhje asnjërit prej aspekteve të rëndësishëm për çështjen shqiptare, Italia u bë njëri nga dy shtetet që siguroi miratimin ndërkombëtar për përgatitjen e projektit për organizimin e shtetit shqiptar.⁷ Likuidimi i Austro-Hungarisë pas Luftës së Parë Botërore, do ta bënte Italinë protektorin e vetëm të Shqipërisë në periudhën midis dy luftërave.

Nga Traktati i Fshehtë i Londrës, në Konferencën e Paqes dhe në Luftën e Vlorës

Menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, Qeveria e parë shqiptare e Ismail Qemalit ndërmori hapa që tregonin se donte të dilte nga kornizat ala-osmane në fushën ligjore dhe të shkonte drejt Evropës së qytetëruar. Mund të konsiderohet këtu një përpjekje “Kanuni i Përtashëm (i përkohshëm) i administratës civile” të Shqipërisë, i cili u shpall më 22 nëntor 1913. Në të, përcaktoheshin parimet e centralizimit të pushtetit, të organizimit administrativ të vendit në prefektura, nënprefektura dhe krahina, të pjesëmarrjes së popullit në organet përfaqësuese, krijohej Këshilli i Përgjithshëm si instanca më e lartë etj.

8), që do të vinin nga radhët e ushtrisë suedeze (Neni 9).

⁶Amedeo Giannini, *L'Albania dall' indipendenza all' unione con l'Italia 1913-1939*, 4^a Edizione, Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, Milano 1940, p. 16, 17.

⁷*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III..., f. 20; Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë, (Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare)*, Botimet PEGI, Tiranë 2012, f. 55.

Të gjitha këto së bashku, ishin një hap për organizimin e administratës shqiptare dhe për bashkimin e të gjithë vendit nën pushtetin e Qeverisë së Vlorës. Në Kanun gjenin shprehje parimet e shqyrtimit të buxhetit, trajtimit të çështjeve ekonomiko-financiare, parashikohej ndërtimi i rrugëve, skelave, hekurudhave, bonifikimi i kënetave, zhvillimi i tregtisë, minierave, industrisë etj.⁸

Këto synime e të tjera, nuk mundën të realizohen për shkak të jetës së shkurtër dhe koniunkturave të disfavorshme të brendshme dhe ndërkombëtare. Megjithatë, Qeveria e Vlorës gjatë vitit 1913, kreu shtetëzimin dhe konfiskimin e 175 çifligjeve (në total 56 287 ha tokë) të Sulltanit dhe Portës së Lartë, nxori ligjin për kontrollimin e dokumenteve të pronësisë së tokës, përcaktoi detyrat dhe kompetencat e administratës civile, vendosi kontrollin mbi doganat dhe monopolet osmane të duhanit, kripës, peshkimit në dajlanë, etj.⁹

Vlen të përmendet, veçanërisht përpjekja për të hedhur bazat e sistemit monetar e të kreditit kombëtar, duke tërhequr oferta për dhënie koncesionesh ndaj kapitalit austro-hungarez dhe italian, dy fuqive objektivisht të interesuara në atë kohë për ekzistencën e shtetit shqiptar. Dihet se më 4 tetor 1913, u lidhë marrëveshja mjaft e favorshme, me afat 60-vjeçar, për krijimin e Bankës Shqiptare, me “Wiener Bank Berein” (Vjenë) dhe me “Banca Commerciale Italiana” (Milano), marrëveshje e cila u vlerësua nga Ismail Qemali, si “një i dytë fitim, pas lirisë”.¹⁰ Banka nuk pati kohë, as kushte, që të dimensiononte punën e vetë dhe e mbylli veprimtarinë me çështje të kufizuara, që kishin lidhje me administratën shqiptare e me disa persona privatë.¹¹ Gjithsesi, preferenca për t’ua bërë përpjekjen sa më të lehtë, investimeve të kapitalit austro-hungarez dhe italian, tregonte se këtyre fuqive, si në plan ndërkombëtar, ashtu edhe në plan të brendshëm, të lidhur me faktorin politik shqiptar, u ishin njohur pozitat preferenciale. Periudha 22 janar 1913–3 shtator 1913, e cila ka brenda 6 javë qeverisjeje të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe 6 muaj qeverisjeje të Princit gjerman Vilhelm Vid (William of Wied ose në gjermanisht, Wilhelm Friedrich Heinrich von Wied), së bashku me KNK-në, dëshmojnë ndikimin parësor të Vjenës dhe Romës në Shqipëri, njëherësh edhe

⁸Banka Kombëtare e Shqipërisë, Vlorë 1914.

⁹Historia e Shqipërisë, Vëllimi III, 1912-1944, Botim i Institutit të Historisë së Akademisë së Shkencave, Tiranë 1984, f. 68.

¹⁰Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë 1913, Nr. 23.

¹¹Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, Tiranë 1935, f. 779-780.

politikën e konkurrencës dhe rivalitetit që ato rifilluan të zbatonin midis tyre.¹² Është koha kur Roma vlerësoi forcën e Esat pashë Toptanit, si shumë të rëndësishme dhe të vlefshme për të minuar pozitat e Vjenës në Shqipëri. Investimi i saj shumëplanësh i dokumentuar në aspektin financiar me sponsorizimin e jashtëzakonshëm të pashait toptanas, është i njohur e faktuar historikisht.¹³

Kur Vidi ishte larguar dhe, qoftë rebelimi në Shqipërinë e Mesme, qoftë “lëvizja vorio-epirote”, e kishin zhytur vendin në anarshi, Roma ende asnjëanëse në konfliktin botëror, duke u kapur pas “rrezikut” të pushtimit të Vlorës nga forcat “vorio-epirote” dhe duke propaganduar qëllime “humanitare” dhe respektimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, lëshoi ultimatumin “kush e prek Vlorën, prek Italinë”.¹⁴ Sikurse nënvizonte Sër Xhorxh Klark (Sir George Clark), atëherë funksionar i lartë në Forin Ofis (Foreign Office), edhe pse çështja shqiptare kishte kaluar në plan dytësor në marrëdhëniet ndërkombëtare evropiane, “Vlora mund të përbënte shkas për fillimin e një luftë midis Italisë dhe Austrisë”.¹⁵ Athina, ndërkohë, miratoi vendosjen e përkohshme të Italisë në Vlorë, e bindur se pa pranuar interesat italiane në Shqipëri, nuk do të mund të realizonte synimet e saj lidhur me Jugun e vendit. Këtë e miratuan edhe Fuqitë e tjera të Mëdha, pjesëmarrëse në të dy blloqet, që po përpiqeshin të joshnin Italinë drejt anës së tyre. Më 29 tetor 1914, Italia zbarkoi fillimisht në Vlorë me një “mision sanitar”, (për të ndihmuar refugjatët e grumbulluar në ullishtat e Vlorës); më 30 tetor, pushtoi ishullin e Sazanit (prej nga grekët ishin larguar qysh në qershor); kurse më 25 dhjetor 1914, zbarkoi forca të marinës ushtarake në skelën e qytetit. Tri ditë më pas, pasoi zbarkimi në Vlorë i forcave tokësore.¹⁶ Në linjën e akordit të paracaktuar, “qeveria” e Esat Toptanit, përkatësisht Këshilli i Senatit të Durrësit, i parapriu zbarkimit italian me një dokument të datës 20 dhjetor, që u lejonte trupave italiane të zbarkonin lirisht “në çdo pikë të Shqipërisë” për të ndihmuar në zhdukjen e anarkisë. Reagimi lokal, që erdhi nga prefekti i Vlorës, Osman Haxhiu dhe zv. kryetari i Bashkisë, Ali Asllani, duke i

¹²N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 82.

¹³Gazeta “*Shqiptarja.com*”, Tiranë, 4 shtator 2012, Dokumente të viteve 1914-1915, të Arkivit të Ministrisë së Jashtme të Italisë, të publikuara nga Ledia Dushku; *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 65.

¹⁴*Po aty*, f. 76.

¹⁵Rodd për Grey, 27/9/1914, FO371/2171/53584, dokument i cituar nga N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 128.

¹⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 77.

dorëzuar një notë proteste me shkrim konsullit italian, ose ndonjë protestë tjetër nga disa koloni shqiptare jashtë Shqipërisë,¹⁷ kishin vetëm efekt protokollar.

Ndërkohë, në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore, Italia peshoi interesat e shanset dhe zgjodhi krahun e Antantës, për të likuiduar si rivale Austro-Hungarinë. Në Traktatin e Fshehtë të Londrës (29 prill 1915), ajo do të siguronte protektoratin mbi Shqipërinë Qendrore, (që do të duhej të përcaktohej, pas një vlerësimi të mëvonshëm nga ana e Antantës, në veri e në jug për të shpërblyer përkatësisht Serbinë e Greqinë,) si dhe ishullin e Sazanit, Vlorën dhe krahinën përreth, si territore që do të kishte të drejtë t'i aneksonte.¹⁸ Italia tashmë e larguar nga aleatët e dikurshëm (Austro-Hungari dhe Gjermani) dhe e rreshtuar përkrah Britanisë së Madhe, Francës dhe Ruisë, nënshkroi Traktatin e Fshehtë të Londrës (26 prill 1915) duke i dhënë fund asnjëanësisë së vitit 1914-1915. Pikërisht në dhjetor 1915, trupat e saj zbarkuan në Vlorë dhe më pas u përhapën edhe në vise të tjera të Shqipërisë së Jugut.¹⁹ Marsi i vitit 1915, kishte qenë muaj veprimesh intensive nga diplomacia e Romës, me Austro-Hungarinë nga njëra anë dhe qeveritë e Antantës nga ana tjetër. Nga cili bllok anoi Italia dhe arsyet se përse veproi në atë mënyrë, janë çështje të njohura tashmë.

Në pikat 5, 6 dhe 7, ndër 16 pikat e Traktatit, trajtoheshin pretendimet ndaj Shqipërisë, të Italisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë asnjëanëse, e cila ishte gjithashtu në fazën e joshjes. Në pikën 6, Vlorë, ishulli i Sazanit dhe një territor toke mjaft i gjerë në lindje të Vlorës, do të kalonin nën sovranitetin e plotë të Italisë. Territori në fjalë në veri dhe në lindje do të kishte si kufi lumin Vjosa. Kufiri jugor do të niste nga Tepelena për të dalë në Himarë, nëpërmjet Kurveleshit. Pjesëtimin e Shqipërisë me fqinjët ballkanas, Roma e pranoi me kusht që kjo të ndodhte pasi ajo të merrte krahinën e Vlorës dhe tokat e pretenduara dhe të premtuara në veri të bregdetit Adriatik. Kusht tjetër i Romës ishte që shteti shqiptar i cunguar, autonom e neutral, që do të formohej në Shqipërinë e Mesme, të mos kishte marrëdhënie diplomatike të pavarura, por të përfaqësohej nga Italia. Kjo do të thoshte, që ai të vihej nën protektoratin italian.

¹⁷Po aty, f. 78.

¹⁸Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë, nga zanafilla deri në ditët tona*, Botimet SHLK (Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit), Tiranë 2000, f. 133.

¹⁹Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005, Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93 vjeçare të tij*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2006, f. 64.

Traktati i Londrës i 26 prillit 1915, me fuqi veprimi pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, zhvlerësonte vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), të marra me konsensusin e 6 Fuqive të Mëdha. Traktati i realizuar prej katër fuqive (Britani e Madhe, Francë, Rusi dhe Itali), parashikonte likuidimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimin e plotë të saj.²⁰ Në fund të vitit 1916, frontet e luftës në Ballkan ndryshuan dukshëm. Trupat austro-hungareze dhe bullgare shpartalluan ushtrinë serbe dhe malazeze, kurse anglo-francezët rritën territoret nën kontrollin e tyre në frontin e Selanikut. Në viset shqiptare, kufiri i zonave austro-hungareze dhe italiane të pushtimit u fiksua në Vjosë. Bullgarët kishin pushtuar një pjesë të Kosovës dhe Maqedoninë Perëndimore, përkatësisht trevat shqiptare lindore, që iu shkëputën shtetit shqiptar me vendimet e Konferencës së Londrës (1913).

Francezët zotëruan Korçën dhe Pogradecin, prej nga dëbuan forcat greke të mbretit Kostandin, i cili anonte nga Blloku Qendror. Italianët mbajtën Tepelenën, Gjirokastrën dhe Përmetin.²¹ Ndryshe nga zona franceze e pushtimit, ajo italiane, përgjithësisht, është anashkaluar nga historiografia shqiptare. Të dhëna të përgjithshme për situatën në këtë zonë, për qëndrimin e forcave italiane ndaj popullsisë, për organizimin e administratës, veprimtarive publike, aktet politike etj.; i gjejmë në vëllimin III të Historisë së Popullit Shqiptar, në një monografi e disa artikuj të profesorëve Muin Çami, Arben Puto, e ndonjë autori tjetër, por detajet e hollësishme të kësaj periudhe disa vjeçare janë të rralla.²² Për të mësuar rreth tyre, shërbejnë disa vëllime me dokumente të botuara, ku përsëri prof. M. Çami spikat ndër studiuesit shqiptarë, dhe Spiro Kosova ndër autorët e memoaristikës, që kanë qenë të pranishëm në ato vise në vitet e Luftës së Parë Botërore.²³ Nga burimet që kemi konsultuar, mund të nxjerrim përfundime lidhur me qëndrimin që ka mbajtur Italia, si pjesë e Antantës, në organizimin e pushtetit ushtarak në territorin e pushtuar, në sjelljet e saj ndaj problemeve të kohës në

²⁰N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 145.

²¹*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 83.

²²Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Botimet TOENA, Tiranë 2009; Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Botim i Akademisë së Shkencave të RPSH të Shqipërisë, Tiranë 1987; etj.

²³*Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentesh)*, red.përgj. Muin Çami, vëllimi I, II, Tiranë, 1975-1976; Marenglen Verli, *Historia e Shqipërisë në kujtimet e Spiro Kosovës*, Botimet KLEAN, Vëllimi I, Tiranë 2008.

trevat shqiptare, që lidheshin me mbajtjen e rendit dhe sigurimin e burimeve njerëzore e materiale vendase në shërbim të luftës, në mënyrën e organizimit dhe shpërblimit të forcave të rregullta ose të parregullta të armatosura vendase, në prononcimet politike në raste të domosdoshme, si proklamata e gjeneralit Ferrero (Giacinto Ferrero), kryekomandantit të trupave italiane në Shqipëri, e datës 3 qershor 1917, etj.²⁴ Vihet re përpjekja për të mos krijuar probleme me shqiptarët, për të fituar mundësisht simpatinë e tyre dhe për të përgatitur situatën për zotërimin me çdo kusht, të paktën të Vlorës, pas Luftës.

Gjithsesi, shqiptarët e zonës italiane të pushtimit patën rast gjatë viteve 1915-1918 e më pas, krahas privimeve e sakrificave që impononte situata e luftës dhe kërkesave të okupatorit për zbatimin e politikës së vet, të shikonin si ky shtet evropian organizonte e stërviste ushtrinë, si qeveriste, si përzgjidhte e kultivonte administratën, me çfarë legjislacioni vepronte, si ndërtonte, si nxiste prodhimin e tregtinë, etj.²⁵ Ishte kjo, një përvojë tjetër, për ata që kishin rast të udhëtonin, të kujtonin e të krahasonin, e ngjashme me rastet franceze e austro-hungareze në Korçë apo në veri të lumit Vjosa, por mjaft e ndryshme nga përvoja pararendëse e njohur e qeverisjes osmane.²⁶

Në gusht 1916, nisur nga Vlora, ushtria italiane zbriti drejt jugut, pushtoi Tepelenën dhe gjithë trevën që i njihte Traktati i Fshehtë i Londrës. Në këtë kohë ndodhi edhe ndalimi i ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar, i cili prej gati dy vjetësh shoqëronte paralelisht flamurin italian. Gjithsesi, veprimi francez në Korçë, në 10 dhjetor 1916, për të fituar përkrahjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke sfiduar për hir të politikës së ditës, jo vetëm esadistët dhe venizelistët, por edhe qëndrimin italian, e detyruan Romën të lejonte autoritetet e veta civile e ushtarake në Shqipëri të vepronin në mënyrë të ngjashme në trevën e Gjirokastrës. Ndryshe nga veprimi që ndërmorën në Vlorë,

²⁴ A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 180; Lef Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbyer historisë sonë kombëtare*, Botim i dytë, Tiranë 2007, f. 276.

²⁵ *Archivio Storico Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri d'Italia* (më tej ASDMAEI), Fondo (më tej F.) Serie Politica 1919-1930, Albania, Anno (më tej A.) 1930, Pacco (më tej P.) 695, Xhandarmëria dhe policia 1920, Milicia shqiptare, e organizuar nga italianët, numëronte rreth 4000 vetë, ndër të cilët 300 italianë. Shumica e 480 shqiptarëve të graduar ishin nënoficerë e kapterë; shih edhe raportin e G. Vitalit, komandant i Legjionit shqiptar (Gjirokastrë më, 4 shtator 1919).

²⁶ Marenglen Verli, *Elemente të integritetit në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e Evropës Perëndimore deri në vitin 1944, Shqipëria dhe Kosova, Historia e një aspirote*, Vëllimi II, BOTIMPEX, Tiranë 2007.

më 1 janar 1917, komanda italiane shpalli se për Gjirokastrën do të përdorej emërtimi “Shqipëri e Jugut” e jo “Vorio-Epir”, dhe se aty lejohej të ngrihej flamuri kombëtar shqiptar. Njëkohësisht, u organizua një Këshill Administrativ prej 6 anëtarësh, gjysma myslimanë e gjysma të krishterë, u larguan nga administrata elementët grekofilë, u hapën shkollat shqipe, në të cilat u angazhuan shumë mësime italiane, etj.²⁷ Deklarimi më 23 janar 1917, i austro-hungarezëve për të ardhmen e Shqipërisë (nga Komandanti i përgjithshëm Trollman në Shkodër), i dha të kuptojë Romës se kishte mbetur pas të tjerëve “për të fituar zemrat” e shqiptarëve.

Duke dashur t’ua kalonte aleatëve francezë dhe armiqve austro-hungarezë në premtime, më 10 maj 1917, gjenerali Ferrero, komandanti i Korpusit XVI të pushtimit, u rekomandoi eprorëve të shpallej një “proklamantë” ku të njihej “në mënyrë solemne... pavarësia shqiptare”, çka edhe u bë më 3 qershor 1917, me rastin e përvjetorit të kushtetutës italiane. Solemnisht, shoqëruar me 21 të shtëna artilerie, Ferrero lexoi në kalanë e Gjirokastrës, proklamantën që u drejtohej gjithë shqiptarëve dhe shpallte “unitetin dhe pavarësinë e gjithë Shqipërisë”, ndonëse “nën hijen dhe nën mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë”.²⁸ Me sa duket, veprimin italian e kushtëzoi edhe avantazhi që krijuan venizelistët në konfliktin politik në Greqi, dhe futja e tyre në luftë përkrah Antantës.²⁹ Në këtë kohë, italianët i shtynë trupat e tyre edhe më në jug, duke zbritur deri në lumin Kalamas, e duke vënë në zotërim Janinën dhe gjithë Epirin. Ky veprim duket se kishte vetëm synim diversiv të dyfishtë. Të sigurt se pas futjes së Greqisë në luftë përkrah Antantës, Britania e Madhe dhe Franca, do të përkrahnin edhe aspiratat e saj në periudhën e pasluftës; italianët, nga njëra anë u jepnin grekëve leksionin e fuqisë së madhe, që duhej respektuar, ndërsa nga ana tjetër fitonin simpati të shqiptarët, posaçërisht të popullsia çame e keqtrajtuar prej disa vitesh, çka ishte investim për politikën e ardhme italiane në Ballkan.

²⁷Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Vëllimi I, (1912-1939), Botimet TOENA, Tiranë 2013, f. 279; shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 93.

²⁸L. Nosi, *Dokumente historike...*; Joseph Swire, *Shqipëria, Ngritja e një mbretërie*, Shtëpia Botuese DITURIA, Tiranë 2005, f. 224, 225; M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare...*, f. 298; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 81, 82; etj.

²⁹J. Swire, *Shqipëria...*, f. 223.

Në Romë llogaritej përjashtimi i zbatimit të Traktatit të Londrës në favor të Greqisë, në Shqipërinë e Jugut. Në historiografi është paraqitur pikëpamja se, proklamata italiane e 3 qershorit ishte një reagim edhe ndaj deklaratës së presidentit të SHBA-ve, U. Uillson (Woodrow Wilson), pas hyrjes në luftë të këtij vendi të përtej Atlantikut, në prill 1917, se bashkimi i armëve me Antantën bëhej “për vendosjen e një paqeje të drejtë, dhe se nuk do të njiheshin traktatet e fshehta”,³⁰ deklaratë kjo, që fitoi simpati sidomos në radhët e emigrantëve shqiptarë në Amerikë. Kur po atë muaj, ministri i Marinës i SHBA-ve, i bëri thirrje Federatës Panshqiptare “Vatra”, që të dërgonte marinarë shqiptarë në flotën e Shteteve të Bashkuara në brigjet e Adriatikut, mbi 60 000 shqiptarë që jetonin në SHBA, nëpërmjet një telegrami dërguar presidentit Uillson, iu përgjigjën pozitivisht kësaj thirrjeje. Mbi 3 000 prej tyre e bënë këtë premtim realitet.³¹

Por, proklamata italiane solli pasoja të kundërta nga ato që synonte Roma. Vet burimet italiane pohojnë se proklamata, jo vetëm që nuk ngjalli ndonjë interesim tek popullsia, por përkundrazi i shtoi antipatitë ndaj Italisë.³² Dyshimet dhe reagimet kundërshtuese nga shqiptarët u forcuan veçanërisht pas nëntorit 1917, kur qeveria sovjetike botoi traktatet e fshehta të Rusisë me Fuqitë e tjera të Mëdha për ndarjen e botës, e midis tyre u publikua edhe Traktati i Fshehtë i Londrës i 26 prillit 1915.³³ Në të njëjtin moment, në fundvitin 1917, Austro-Hungaria, gjithashtu shpërndau në të gjithë Shqipërinë tekstin e përkthyer të Traktatit të Fshehtë të Londrës, pa pjesën ku flitej për copëtimin e Shqipërisë. Një përlllogaritje dinake kjo, për të kompromentuar qarqet drejtuese kundërshtare të Italisë dhe Francës.³⁴ Në Itali ndjehej se Shqipëria ishte një terren i rrëshqitshëm, prandaj në fund të vitit 1918, kur ushtarakisht kontrollohej shumica e territorit të vendit (kufijtë e vitit 1913), Roma u përpoq të ndikonte përmes lobit të vetë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, për të forcuar pozitën. Në Kongresin e organizuar nga shqiptarët në Durrës, më 25 dhjetor 1918, ajo arriti diçka, por raportet me shqiptarët nuk ishin raporte besimi ose

³⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 94.

³¹ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare Vatra*, Shtëpia Botuese GLOBUS R, Tiranë 2002, f. 139.

³² Massimo Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)*, Franco Angeli Edizioni, Milano 2007, p. 37.

³³ N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, fq. 174.

³⁴ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shek. XX*, Botimet IDEART, Tiranë 2004, f. 89.

bindjeje, pesha në arenën ndërkombëtare nuk ishte e padiskutueshme dhe situata sociale e politike në Itali, kishte krijuar destabilitet frenues për synimet ekspansioniste të qeverisë së Romës.³⁵

Gjithsesi, Konferenca e Paqes e mbledhur më 18 janar 1919 në Paris, nga 5 Fuqitë e Mëdha fituese, (Britani e Madhe, Francë, Itali, SHBA dhe Japoni,) duket se ishte një përplasje midis: filozofisë së vjetër të diktatit të fortë të fituesve mbi të mundurit (Austro-Hungari, Gjermani, Turqi, Bullgari), pa respektuar as interesat e tyre jetike, ndërkohë që respektoheshin të gjitha traktatet e lidhura midis fituesve, (përfshi Traktatin e Fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915) nga njëra anë; dhe përpjekjeve të SHBA-ve, që shfaqeshin pa sigurinë e duhur apo me hezitimin e të angazhuarit rishtas në Evropë, për të diktuar rregulla të reja loje. Idetë e presidentit Udrou Uillson, të sintetizuara në 14 pikat e njohura, të shpalosura në janar 1918, që premtonin për një pozicion të paanshëm dhe veprime “sipas traditës amerikane të drejtësisë dhe zemërgjerësisë”³⁶, ngjallën shpresa edhe te populli shqiptar. Pika kryesore e programit të tij ishte goditja e diplomacisë së fshehtë. Në Konferencën e Paqes së Parisit (1919), ai denoncoi ashpër Traktatin e Fshehtë të Londrës (prill 1915). Në pikën 9 të programit të tij, Uillsoni, duke iu referuar pretendimeve të Italisë, për “korrigjime kufijsh”, ripohoi parimin e përcaktimit të kufijve sipas kombësisë.³⁷ Por çështja nuk ishte e thjeshtë. Dy memorandumet e paraqitura nga delegacioni shqiptar, në Konferencën e Paqes në Paris, nuk gjetën mirëkuptim. Ato e trajtonin çështje të mbyllur pavarësinë e Shqipërisë, të fituar e të njohur ndërkombëtarisht qysh më 1913; dhe mbronin idenë se shtetit shqiptar duhej t’i ktheheshin territoret e copëtuara nga vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) dhe të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913).³⁸ Por, shqiptarët nuk u respektuan dhe nuk u morën seriozisht. Pa u ndalur në evoluimin e kërkesave e të situatës në Konferencë, duhet theksuar qysh në fillim se kërkesat e shqiptarëve u hodhën poshtë, ndërkohë që u morën në shqyrtim pretendimet greke mbi Korçën dhe Gjirokastrën, gjithashtu kërkesa që të respektohej

³⁵ Marenglen Verli, Kongresi i Lushnjës akt kulmor në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Kosova, *sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, BOTIMPEX, Tiranë 2007, f. 86, 89.

³⁶ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 129.

³⁷ N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 233; shih edhe M. Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar në vitet 1918-1920*, Tiranë 1969.

³⁸ P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, (1912-1939), f. 380; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 91, 92.

Traktati i Londrës (1915), çështje këto të paraqitura përmes kryeministrit Venizelos.³⁹

Qëndrimi i dyzuar i delegacionit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllave), në dukje i favorshëm për Shqipërinë, sepse nuk paraqiti drejtpërdrejt kërkesa për territore, u përcaktua nga rivaliteti i ashpër italo-jugosllav në Adriatik dhe në Shqipëri.⁴⁰ Në Beograd, shpresonin të diktonin lojën tek fqinji i vogël jugperëndimor, përmes Esat Toptanit, që ishte riorientuar politikisht gjatë kohës së bashkëpunimit me serbët e francezët në frontin e Selanikut (1916-1918), por kryesorja ishin gati për “lëshime”, që mund të zmbrapsnin matanë Otrantos Italinë e rrezikshme.⁴¹ Roma, nga ana e saj kishte synime të palëkundura drejt Vlorës, që e konsideronte prej kohësh si pikë të rëndësishme strategjike në Adriatikon Jugor dhe përpiquej të ngulte rrënjë të thella në Ballkan përmes protektoratit mbi “shtetin autonom shqiptar”, i cili do të krijohej në Shqipërinë e Mesme “myslimane”, sipas Traktatit të Fshehtë të vitit 1915, por që Italia e kërkonte me shtrirje në kufijtë e vitit 1913.⁴²

Në morinë e kontradiktave midis të vegjëlvë, por edhe midis Fuqive të Mëdha, Italia që kishte siguruar qysh më 1915, premtimin për pjesën e luanit, ndoqi taktikën e veprimit jo të nxituar, duke studiuar situatat. Pikëpamja e Londrës dhe Parisit, sipas së cilës pavarësia e Shqipërisë dhe tërësia territoriale e saj duheshin sakrifikuar për interesat e vendeve fqinje, aleate të tyre e fituese të Luftës, me kohë u pranua edhe nga SHBA-të, që duhet thënë se nuk kishin njohuritë e duhura për Ballkanin, dhe as peshën për të zbatuar drejtësinë e premtuar me 14 pikat e Uillsonit.⁴³

³⁹Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, KRISTALINA-KH, Tiranë 2013, f. 248-257; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ALBIN, Tiranë 2003, f. 286-291; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, (1912-1939), f. 378.

⁴⁰Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Shtëpia Botuese ENCIKLOPEDIKE, Tiranë 1992, f. 85-93.

⁴¹P. Milo, *Po aty*, f. 67-84; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 94, 95, 104, 105; Muin Çami, Kompromisi i Nittit i janarit 1920 dhe qëndrimi i Jugosllavisë ndaj problemit shqiptar, *Studime historike*, Nr. 1-4, 1992, Tiranë 1995; M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare...*, f. 187.

⁴²M. Verli, Vështrim për raportet e shqiptarëve me fqinjët e tyre dhe me Europën në periudhën midis dy luftërave botërore, *Kosova, sfida shqiptare...*, f. 102.

⁴³A. Puto, *Historia diplomatike...*, f. 310; N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 221.

Duke e konsideruar të parakohshme, pavarësinë e njohur të Shqipërisë më 1913, të tre Fuqitë e Mëdha, (ndoshta edhe nën efektin e një propagande të shfrenuar të fqinjëve, që i paraqisnin shqiptarët si të organizuar në fise, të pacivilizuar, pa kohezion, pa aftësi shtetformuese,) e përfshinë atë në sistemin e mandateve, ndërkohë që në këtë sistem futeshin vetëm vende e popuj, të cilët nuk e kishin fituar ende pavarësinë, përkatësisht ish-territore të Perandorisë Osmane, ose koloni të Gjermanisë së mundur.⁴⁴ Ishte sërish rasti për Italinë të kërkonte e të përfitonte. Të mëdhenjtë e tjerë, që në mars 1919, u treguan të gatshëm për t'i dhënë asaj mandatin mbi Shqipërinë, duke plotësuar kështu edhe kërkesën për protektorat, që Italia kishte paraqitur qysh gjatë Luftës. Kjo gatishmëri u përsërit në shtator 1919, pas kërkesës zyrtare që paraqiti në fund të gushtit në forumet e Konferencës, ministri i ri i Jashtëm i Italisë, Tomazo Titoni (Tommaso Titoni).⁴⁵

Miratimi për mandatin në fjalë u parashtrua në memorandumin e 9 dhjetorit 1919, të firmosur nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, Francës dhe SHBA-ve. Në përkujtesën bashkëngjitur memorandumit thuhej se tri fuqive nuk u mungonte dëshira për të njohur pavarësinë e shtetit shqiptar, por se “ky shtet do të ketë nevojë për këshillat dhe për ndihmën administrative të ndonjëres prej Fuqive të Mëdha. Nga pozita e saj gjeografike dhe nga kapaciteti ekonomik, Italia është shteti më i përshtatshëm për të përmbushur këtë detyrë”.⁴⁶ Dispozitat konkrete të mandatit dhe Statuti themeltar i shtetit shqiptar do të përgatiteshin nga një komision i përbërë nga tre autorë, prej të cilëve njëri do të ishte përfaqësues i Qeverisë italiane, tjetri përfaqësues i Lidhjes së Kombeve dhe i treti përfaqësues i shtetit shqiptar. Megjithatë, ky i fundit do të zgjidhej dhe caktohej nga Fuqitë e Mëdha. Dispozitat e sipërpërmendura do të miratoheshin nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, organizatë e njohur e krijuar në mbarim të Luftës së Parë Botërore për të ruajtur paqen në botë. Projektet për vendosjen e Shqipërisë nën mandatin e Italisë, jo vetëm shkelnin pavarësinë dhe sovranitetin që ajo kishte fituar disa vjet më parë, por nuk respektonin as procedurën e parashikuar nga Karta e Lidhjes së Kombeve për vënien nën mandat. Shqiptarët nuk u pyetën për të dhënë miratimin e tyre lidhur me shtetin të cilit do t'i

⁴⁴J. Swire, *Shqipëria...*, f. 250, 252.

⁴⁵*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 132; Muin Çami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes*, Monografi në proces botimi, f. 134.

⁴⁶Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore*, Vëllimi III, Tiranë 2001, f. 42.

ngarkohej mandati, sikurse parashikohej në nenin 22 të Kartës. Të tre Fuqitë e Mëdha u dakorduan edhe për ngushtimin territorial të shtetit shqiptar. Ata miratuan vënien e Vlorës nën sovranitetin e Italisë dhe aneksimin e Gjirokastrës nga Greqia. Ndërkohë historia e kontradiktave italo-jugosllave në Konferencën e Paqes, e njohur në historiografi me togfjalëshin “Çështja e Adriatikut”, ripozicionoi disa herë qëndrimet e Fuqive të Mëdha për fatin e Shqipërisë.⁴⁷

SHBA-të përgjithësisht toleronin vetëm copëtimin e krahinës së Gjirokastrës, në favor të Greqisë. Me disa rezerva, mund të pranonin edhe vënien e Vlorës nën sovranitetin italian dhe mandatin mbi Shqipërinë e paprekur, në kufijtë e tjerë. Ky qëndrim që favorizonte politikën italiane, ndër të tjera, ndoshta ishte edhe një tentativë për të frenuar sadopak fuqinë e padiskutueshme të Britanisë së Madhe në Mesdhe, por edhe kontrollimin e forcës kontinentale të Francës, që pas gjunjëzimit të Gjermanisë dhe krijimit të shtetit serbo-kroato-sllloven, ishte fuqia e parë në Evropë, dhe jo më dashamirëse dhe përkrahëse e SHBA-ve, si në kohën e Revolucionit Amerikan të shek. XVIII.⁴⁸ Memorandumi i 9 dhjetorit 1919 nuk kënaqi as Italinë, për shkak të zgjidhjes që i jepte çështjes së Fiumes në veri të Adriatikut, as Greqinë që nuk siguronte Korçën, e aq më pak Jugosllavinë, që nuk përfitonte asgjë në Shqipëri. Kryeministri serb, Nikolla Pashiç (Nikola P. Pašić), u kundërpërgjigj më 8 Janar 1920, duke përsëritur kërkesën e shkurtit 1919, me të cilën kërkonte një shtet shqiptar të pavarur, në kufijtë e vitit 1913, ose aneksimin e territoreve veriore shqiptare, deri në lumin Drin. Në një kompromis të 13 janarit 1920, në mungesë të përfaqësuesit të SHBA-ve, kryeministrat e Britanisë së Madhe (David Lloyd George), Francës (Georges Clemenceau) dhe Italisë (Francesco Saverio Nitti), vendosën që Shqipëria të copëtohej midis tri fuqive fqinje, gati sikurse parashikohej në Traktatin e Fshehtë të Londrës (prill 1915). Kundërshtimi i SHBA-ve, për të miratuar një dokument në hartimin e të cilit nuk kishin marrë pjesë, u dha kohë shqiptarëve të organizonin një qëndresë të brendshme, themelet e së cilës u hodhën në Kongresin e Lushnjës, më 21 janar (28-31 janar 1920).⁴⁹

⁴⁷ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 73, 74.

⁴⁸ Margareth MacMillan, *Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Botimet PLEJAD, Tiranë 2006, f. 154, 155.

⁴⁹ *Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës*, Tiranë 1974, f. 43, 51; Francesco Jacomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2005, f. 9.

Italia i kishte konsumuar energjitë duke synuar shumë dhe kishte fituar jo pak. Duke u treguar e paskrupullt, ajo kishte fituar antipatinë e shqiptarëve dhe të Jugosllavisë, por me sa duket, edhe të Francës e sidomos të Britanisë së Madhe.⁵⁰ Shqiptarët e shfrytëzuan këtë rast. Pas Kongresit të Lushnjës, lobi proballkanas dhe qeveria e Sulejman Delvinës u orientuan në veprime konstruktive, që garantuan prapavijat kufitare, morën nën kontroll situatën, nxitën e mbështetën kryengritjen çlirimtare në Vlorë (5 qershor 1920–2 gusht 1920), dhe më në fund duke larguar Italinë, konfirmuan e garantuan përgjithësisht arritjet e vitit 1913.⁵¹ Shqipëria e pasluftës së Parë Botërore, humbi disa territore në kufijtë juglindorë e verilindorë, i mbeti Italia në hyrje të gjirit të Vlorës, në ishullin e Sazanit, por ishte përsëri një shtet i pavarur. Gjithashtu mundi të vinte nën kontroll gjithë territorin, çka nuk e kishte arritur në vitet 1913-1914; dhe në 17 dhjetor 1920 me përkrahjen e britanikëve, ishte pranuar anëtare e Lidhjes së Kombeve.⁵²

Anëtarësimi në Lidhjen e Kombeve kishte rëndësi të trefishtë për Shqipërinë. Së pari, me këtë veprim ripohohej njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar. Së dyti, realizohej akti i njohjes kolektive të qeverisë së Tiranës. Së treti, krijoheshin mundësi për të shqyrtuar nga ky forum ndërkombëtar çështjet e mbetura pezull me shtetet fqinje. Megjithatë, çështjet e diskutueshme kufitare me fqinjët, me këmbënguljen dhe argumentin e tyre se vendimet e Konferencës së Londrës për kufijtë nuk ishin më në fuqi, i kaluan Konferencës së Ambasadorëve në Paris, vëzhguese kjo e Konferencës së Paqes.⁵³ Për të kaluar diskutimin e çështjeve të mbetura nga ky organizëm, u prononcua edhe qeveria e Romës. Ajo nuk kishte çështje territoriale për të diskutuar, por synonte të siguronte me çdo kusht një pozitë “të veçantë” në Shqipëri, krahasuar me fuqitë e tjera. Tërheqjen nga aneksimi i Vlorës dhe nga marrja e mandatit mbi Shqipërinë, Roma e shihte si veprim që duhej të kompensohej nga Fuqitë e Mëdha, për t’i njohur asaj të drejtën e ndërhyrjes për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe sovranitetin e Shqipërisë, në rast se këto kërcënoheshin.⁵⁴

⁵⁰ ASDMAEI, F. Serie Politica 1919-1930, Albania, A. 1920, P. 695, Xhandarmëria dhe policia, Raport rezervat i komisar Penneta-s, dërguar nga Vlora më 25 nëntor 1920.

⁵¹ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 151, 165.

⁵² *Po aty*, f. 167, 171; Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë 1996, Botimet ÇABEJ, f. 36.

⁵³ A. Puto, *Historia diplomatike...*, f. 348.

⁵⁴ A. Biagini, *Historia e Shqipërisë...*, f. 147; *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 173.

Kështu, kërkesat e qeverisë shqiptare të 29 prillit dhe 21 qershorit 1921, drejtuar Lidhjes së Kombeve, për rinjohjen e kufijve të vitit 1913 dhe për tërheqjen e forcave jugosllave e greke tej këtij kufiri, Këshilli i Lidhjes së Kombeve, me vendimin e 26 qershorit 1921, ia kaloi për diskutim Konferencës së Ambasadorëve. Kjo konferencë në përfundimet që shpalli më 9 nëntor 1921^{*}, rikonfirmoi nga njëra anë kufijtë e vitit 1913, (caktuar nga Protokolli i Firences i 17 dhjetorit 1913) me disa ndryshime në favor të Jugosllavisë; dhe nga ana tjetër sanksionoi ruajtjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Shqipërisë, por duke i njohur Italisë një pozitë të veçantë. U pranua kështu teza italiane se, dhunimi i kufijve dhe i pavarësisë së Shqipërisë, “mund të përbënte një kërcënim për sigurimin strategjik të Italisë”.⁵⁵

Konferenca vendosi, që nëse Shqipëria nuk do të ruante dot vetë tërësinë tokësore, qeveria shqiptare mund t’i drejtohej për ndihmë Lidhjes së Kombeve. Në këtë rast Britania e Madhe, Franca dhe Japonia do t’i rekomandonin Këshillit të Lidhjes, që t’ia besonte Italisë rivendosjen e kufijve shqiptarë. Po kështu, do të vepronin këto fuqi edhe në rast se do të kërcënohej “pavarësia ekonomike e Shqipërisë”.⁵⁶ Gjithsesi, qeveritë shqiptare asnjëherë nuk e njohën këtë vendim. Por edhe qeveritë italiane nuk iu referuan ndonjëherë kësaj formule. U mbyll kështu, në vitin 1921, një etapë e rëndësishme historike, që u kurorëzua me rifitimin e pavarësisë kombëtare dhe ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar.⁵⁷

Këmbëngulja e Italisë për të shmangur konkurrentët në Shqipëri në vitet 1921-1924

Ndonëse me pozita të tronditura në Shqipëri nga humbja e Vlorës dhe e mandatit mbi shtetin shqiptar, Roma nuk hoqi dorë nga përpjekjet për të realizuar synimet e saj. Në situatën e turbullt politike të viteve 1921-1924, kur forca e grupime të ndryshme politike u

* Vendimi i 9 dhjetorit u shoqërua me vendosjen, më 10-12 nëntor 1920, të marrëdhënieve diplomatike të tri Fuqive të Mëdha, nënshkruese të këtij vendimi, (të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë) me Shqipërinë.

⁵⁵M. Verli, Vështrim për raportet e shqiptarëve..., *Kosova, sfida shqiptare...*, f. 104, 105; Vuk Vinaver, Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore, *Gjurmime Albanologjike*, Nr. 1, Prishtinë 1968; shih edhe Haris Silajdžić, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë 1999.

⁵⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 174.

⁵⁷*Po aty*, f. 174.

ballafaquan ashpër, deri edhe me armë në Shqipëri, ajo do të angazhohej thelbësisht për të siguruar një qeveri proitaliane në Tiranë. Diplomati i Britanisë së Madhe në Shqipëri, Aires* (Sir Harry Eyres), njëherësh kuadër i Intelligence Service, u angazhua përkrah forcave qeveritare dhe për shtypjen e lëvizjes së marsit 1922,⁵⁸ duke vlerësuar se fitorja e kryengritësve do të sillte forcim të ndikimit të Romës në dëm të atij të Londrës, duke kërcënuar edhe sigurinë e shoqërive britanike të koncesioneve të shfrytëzimit të naftës në Shqipëri. Një kryengritje e re, në janar 1923, në prefekturën e Kosovës e nxitur nga Bajram Curri, Hasan Prishtina e Hysni Curri, gjithashtu nuk pati rezultat.⁵⁹ Por, Roma ishte konsekuente në politikën e saj drejt Shqipërisë.

Qysh në 1921, për të kompensuar humbjen e Vlorës, ajo këmbënguli në Konferencën e Ambasadorëve që t'i njihej një pozitë e veçantë politike dhe ekonomike në Shqipëri. Britania e Madhe dhe Franca e toleruan vetëm në fushën politike. Ndonëse njohja e Shqipërisë në vitin 1922 nga një varg shtetesh (13 të tilla, përfshi SHBA-të) dhe lidhja e marrëdhënieve diplomatike midis tyre dhe Shqipërisë, i lanë të kuptojë Romës se do të duhej kohë për të arritur ambiciet e veta. Megjithatë, ajo e shfrytëzoi përparësinë që iu dha. Në janar 1923, në krye të Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, u caktua gjenerali italian Enriko Telini (Enrico Tellini). Ky komision me përfaqësues të tri fuqive të Mëdha, ishte caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve me vendimin e 9 nëntorit 1921, për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë me fqinjët.⁶⁰ Të gjitha protokollat e KNK-së duhet t'i u paraqiteshin për miratim shteteve të fuqishme kryesore.⁶¹ Më 27 gusht 1923, gjeneral Telini, përfaqësuesi i Italisë dhe kryetari i Komisionit, u sulmua ndërsa udhëtonte në makinën e tij, nga persona të panjohur dhe u vra, së bashku me përkthyesin e tij dhe tre italianë të tjerë. Që krimi ishte rezultat i një komploti të organizuar nga autoritetet greke, kjo nuk u vu asnjëherë në dyshim.⁶² Qeveria e Benito Musolinit iu kundërpërgjigj

* Më 24 janar 1922, pas njohjes së qeverisë shqiptare nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia (në nëntor 1921), H. Eyres do të ishte përfaqësuesi i parë diplomatik britanik në Shqipëri.

⁵⁸Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy, 1908-1939*, Volume One, The Centre For Albanian Studies in association with I B TAURIS Publishers, New York 2004, p. 190.

⁵⁹*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 186.

⁶⁰B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar...*, f. 62-65.

⁶¹N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 288.

⁶²J. Swire, *Shqipëria...*, f. 333; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 572.

këtij akti me pushtimin e përkohshëm të ishullit të Korfuzit. Vdekja e gjeneralit, me sa duket, u shfrytëzua nga Italia për të shkaktuar tension të dyfishtë në Ballkan. Ajo u tregoi si shqiptarëve, ashtu edhe fqinjëve të tyre dhe Fuqive të tjera evropiane, se e kishte marrë seriozisht “kujdestarinë” mbi Shqipërinë.⁶³

Në vijim, edhe pse nga Konferenca e Ambasadorëve, nuk iu njoh ndonjë përparësi në depërtimin ekonomik në Shqipëri, Italia u përpoq ta arrinte vetë këtë, duke akaparuar sa më shumë koncesione në ekonominë shqiptare. Deri në fundin e vitit 1924, edhe pse koncesionet që u miratuan nga Këshilli Kombëtar (Parlamenti) ishin të kufizuara, Italia mbajti minierën e Serës në Selenicë të Vlorës (“Societa Italiana Miniere di Selenizza”), të cilën e kishte blerë nga një firmë franceze, qysh më 1920*. Ajo rriti gjithashtu investimet në shfrytëzimin e pyjeve të Mamurrasit (Shoqëria Italiane e Pyjeve në Shqipëri - SIFA), koncesionin e të cilave e gëzonte që prej vitit 1920. Italia fitoi për disa dekada**, të drejtën e shfrytëzimit të çifligjeve të shtetit nga Shkumbini deri në Vjosë (grupi italian “Adriatico”), por nuk arriti të futet në rrethin e parë të lojës, përkrah anglezëve dhe amerikanëve, për të siguruar naftën shqiptare, me gjithë përpjekjet e lobistëve të saj, midis të cilëve mesa duket bënë pjesë edhe figura potenciale të politikës shqiptare, si Luigj Gurakuqi.⁶⁴

Pas disa përpjekjeve, Italia arriti në mars 1924, të siguronte nga Lidhja e Kombeve, të drejtën që së bashku me qeverinë shqiptare, të themelonin Bankën e Shqipërisë, për të dirigjuar sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri, ku fitimi konsiderohej i sigurt e pa risk.⁶⁵ Gjithsesi, lufta e konkurrencës midis koncesionarëve të mëdhenj, ku u përzje edhe politika shtetërore, nuk i rreshti presionet mbi palën shqiptare. Në një kohë kur Italisë nuk i ishte njohur përparësia mbi ekonominë mbi Shqipërinë, këto presione, sollën disbalancime që ndikuan në lënien pezull të miratimit të shumë projekteve koncesionare.

⁶³ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 207.

* marrëveshja midis shoqërisë italiane dhe qeverisë shqiptare u nënshkrua në qershor 1922.

** sipas *Historisë së Popullit Shqiptar...*, f. 211, për 25 vjet, gjithsesi marrëveshja nuk u finalizua.

⁶⁴ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 212; ASDMAEI, F. Serie Politica 1919-1930, Albania, A. 1920, P. 695, Xhandarmëria dhe policia, Raport për pasuritë e naftës në Shqipëri, 16 qershor 1919.

⁶⁵ Iljaz Fishta, Veniamin Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë 1983, f. 39,40.

Në këtë proces ndikoi edhe debati në elitën politike shqiptare, ku personalitete të ndryshëm mbrojtën pikëpamjet që koncesionet të mos jepeshin në kushte monopoli, që të rritej përqindja e përfitimit në dobi të shtetit shqiptar, që fushat naftëmbajtëse të mos jepeshin njëherësh në koncesion, që koncesionarët të jepnin garanci për seriozitetin e tyre, që marrëveshjet të formuloheshin të studiuara dhe me kushte të përcaktuara qartë, që prodhimi ose kapitali vendas të ruhej e të nxitej me një politikë të kujdesshme proteksioniste etj.⁶⁶

Në periudhën qershor-dhjetor 1924, Italia u shfaq favorizuese për opozitën e ardhur në pushtet.⁶⁷ Nisur nga llogaritjet e interesave ekonomike dhe të kontradiktave të Italisë me Britaninë e Madhe dhe Mbretërinë SKS-së (Jugosllavinë), si dhe nga prania e një lobi të konsiderueshëm proitalian në radhët e opozitës kryengritëse, komiteti administrativ i formuar në Vlorë në fillim të kryengritjes, më 26 maj 1924 i kërkon Romës, t'u tërhiqte vëmendjen shteteve fqinje për Shqipërinë, që të mos ndërhyjnë në punët e saj të brendshme. "Na pëlqen të besojmë, shkruan Noli me shokë, se në rradhët e opozitës së tanishme, Italia ka miq të zjarrtë, sinqeriteti i të cilëve nuk mund të vihet në dyshim..."⁶⁸ Roma, nga ana e saj, më 9 qershor, një ditë para se të hynin në Tiranë forcat kryengritëse, i imponoi Beogradit publikimin e një deklarate të përbashkët ku theksohej se dy qeveritë nuk do të ndërmerren "asgjë që të ndalojë ose të pengojë zhvillimin e Shqipërisë së pavarur" dhe se "ata i konsiderojnë trazirat në Shqipëri, punë të brendshme të saj".⁶⁹ Këto sinjale të para dhanë shpresë se qeveria e Benito Musolinit do t'i njihte forcat kryengritëse pas marrjes së pushtetit. Këto shpresa ushqeheshin sidomos nga disa anëtarë të qeverisë Noli, që kishin prirje të pranonin firmat koncesionare italiane në Shqipëri, ndërkohë që Ahmet Zogu kishte preferuar projektet e shoqërive britanike. Strehimi i A. Zogut në Jugosllavi, rivalja më e madhe kjo e Italisë në Shqipëri, ishte një arsye tjetër, me rëndësi politike, që ushqente shpresat e kabinetit Noli ndaj sigurimit të mbështetjes së Romës. Diplomacia italiane, në fakt, bëri edhe një hap tjetër. Ajo kontaktoi me Londrën, Parisin, Uashingtonin dhe vendet e Ballkanit, që të merreshin vesh për vendosjen e marrëdhënieve

⁶⁶ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942 (Kujtime dhe vlerësime historike)*, Botim i dytë i plotësuar me foto, Shtëpia Botuese NERAIDA, Tiranë 2000, f. 7.

⁶⁷ A. Biagini, *Historia e Shqipërisë...*, f. 152.

⁶⁸ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 233.

⁶⁹ *Po aty*, f. 233.

diplomatike me qeverinë e re shqiptare. Por, kur këto përçapje dolën të pasuksesshme, Roma zgjodhi të ecte në një hap me qeveritë e vendeve të tjera.⁷⁰ Ende nuk kishte ardhur koha e saj, dhe në diplomacinë e lartë italiane, me sa duket, u kristalizua ideja se kjo nuk mund të bëhej me Nolin e kundërshtuar fort nga Britania. Por duhej investuar te A. Zogu, për të mos e lënë atë plotësisht në duar të Jugosllavisë. Pasi dështoi në ditët e para të tetorit, në bisedimet direkte me Nolin dhe L. Gurakuqin, kur këta në kthimin nga Gjeneva, ku kishin marrë pjesë në sesionin e Lidhjes së Kombeve, qëndruan disa ditë në Romë, që t'u impononte miratimin e një pakti politik që e vinte Shqipërinë nën një lloj kujdestarie, Musolini e braktisi krejtësisht qeverinë shqiptare të qershorit.

Aq më tepër se përmes emisarëve të fshehtë, mori nga A. Zogu premtimin se po të kthehej në pushtet, do ta orientonte Shqipërinë drejt Italisë.⁷¹ Misioni i togerit italian, Alessandro Lessona dhe veprimtaria e vëllezërve tregtarë, Aldo dhe Gildo Pugni, të cilët furnizuan me armë e municione luftëtarë e “legalitetit”,⁷² janë dëshmi e lojës së re të Italisë në kuadrin e konfliktit politik në Shqipëri. Roma nuk ishte tashmë e interesuar për qeverinë e Fan Nolit, e cila në tetor 1924, refuzoi të pranonte platformën e saj për të marrë nën “tutelë”, apo për të “mbrojtur” Shqipërinë nga çdo ndërhyrje e jashtme.⁷³ Ditën e fillimit të sulmit të forcave të A. Zogut nga Jugosllavia, më 10 dhjetor 1924, B. Musolini i shkruante përfaqësuesit italian në Shqipëri “që Shqipëria do të arrinte një ditë në një gjendje kritike, kjo duhej pritur, përderisa ky shtet, për hir të ndjeshmërisë së tepruar (për ruajtjen e pavarësisë), deshi të sakrifikonte mbështetjen efektive që, në një situatë të veçantë si kjo, do të ishte në gjendje t'i jepte Italia”. Disa ditë më pas, më 20 dhjetor, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, S. Contarini, i deklaroi të ngarkuarit me punë apo kryediplomatit shqiptar në Romë, Tefik Mborjes: “Duke na dëbuar nga Vlora (më 1920), ju na hoqët mundësinë për t'ju ndihmuar në mënyrë efikase. Në situatën e tanishme ne nuk mund të bëjmë asgjë për ju...”.⁷⁴

⁷⁰A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 365; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 608.

⁷¹Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit, Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924*, Botimet ALBIN, Tiranë 2000, f. 179.

⁷²Marenglen Verli, Rreth një marrëveshjeje të A. Zogut të vitit 1924, *Studime Historike*, Nr. 3, Tiranë 1986; Marenglen Verli, Ndërhyrja jugosllave për përmbysjen e qeverisë së Nolit, *Kosova në fokusin e historisë*, BOTIMPEX, Tiranë 2002, f. 206.

⁷³P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 629.

⁷⁴Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej AMPJ), Viti (më tej V.) 1924, Dosja

Beogradi kishte marrë kështu miratimim e heshtur për të ndihmuar A. Zogun të rimerrte pushtetin. Deklarata e 13 dhjetorit 1924, Musolini-Ninçiq, për “mosndërrhyrjen” e të dy vendeve në punët e brendshme të Shqipërisë, një përsëritje kjo e deklaratës italo-jugosllave të 9 qershorit, kur në elitën politike shqiptare ndodhte konflikti i radhës për pushtet, ishte formaliteti i radhës i fqinjëve, që kishte të bënte me ruajtjen e ekuilibrit midis tyre.⁷⁵ Afërsisht në këtë kohë (në mesin e dhjetorit), qeveria e Romës refuzoi kërkesën e qeverisë shqiptare për të blerë municione, ndërkohë që forcat zogiste furnizoheshin me gjithçka nga Jugosllavia.⁷⁶

(më tej D.) 225. Telegram i Tefik Mborjes nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 20 dhjetor 1924.

⁷⁵*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 242; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 661.

⁷⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 243.

Jorina VERLI

SUMMARY

ALBANIA – A STRATEGIC PRIORITY FOR ITALIAN POLITICS IN THE FIRST DECADES OF THE 20TH CENTURY

Italy's political interest in Albania increased noticeably since the 19th century as a pathway to establish dominance in the Western Balkans. This interest was particularly noticeable in the first decades of the 20th century, and the most evident after the First World War. The Conference of London in 1912-1913 acknowledged the "special interests" of Italy in regards to Albania. The liquidation of Austro-Hungary after the First World War resulted in Italy becoming the only protector of Albania during the period between the two World Wars, a role which Italy ensured itself since the Secret Treaty of London (29th of April 1915).

The three Great Powers, Great Britain, France and the USA, at the Peace Conference in Paris (1919-1920) agreed to defy Albania's sovereignty and to shrink its territorial borders. They approved for Italy to rule over Vlorë and to become a protectorate to the now sundered Albania. Nonetheless, after the Congress of Lushnje and the War of Vlorë (1920), Italy was forced to withdraw. The year 1920 represents Italy's end of reign, a period of quite significance for Albanians. National independence was regained and Albania's territorial integrity remained intact. However, Rome did not give up on its quest to achieve its political goals. During the years 1921-1924, the Italians engaged actively in hopes of installing a pro-Italian government in Tiranë. The period of June-December of 1924 marks a time when Rome chose to align itself with the politics headed by London, Paris and Washington. At the highest ranking Italian diplomacy sprouted the idea that A. Zogu was to be supported. A. Zogu promised Mussolini that if the former were to come to power, he would orient Albania towards Italy. Until 1939 Italy gradually eliminated its rivals in Albania.

Alban DOBRUNA

RENDI HALVETI NË LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

Halveti është emërtim i rendit të dervishëve që u themelua në territoret e Kaukazit të sotëm në shekullin XIV. Si rendi ashtu edhe pjesëtarët e tij u quajtën ndryshe nga tarikatet e tjera. Halveti e ka marrë emrin nga shërbimi dhe jo nga udhëheqësi shpirtëror, për shkak se e zbatoi më së shumti sistemin mistik të halvetit (vetizolim) apo të izolimit dhe shkëputjes nga të gjitha gjërat që kanë lidhje me botën në dhoma apo kthinat e veçanta të teqeve (zakonisht dyzet ditore).¹ Halvetizmi paraqet njërin prej dymbëdhjetë tarikateve aleviane i cili në gjirin e vet përmban shumë degë (kolle), të cilat asnjëherë nuk hoqën dorë nga baza e përbashkët doktrinare e halvetizmit. Prandaj, halvetinjtë e praktikojnë tërheqjen në vetvete, por brenda për brenda bashkësisë, e jo jashtë saj. Në Perandorin Osmane nga zanafilla e tij rendi halveti gëzonte përkrahjen e pushtetit osman dhe të autoriteteve më të larta shtetërore (p. sh. të sulltan Bajazitit II, sulltan Sulejmanit I Kanunit etj.), duke u bërë kështu aleatë të pushtetit politik osman në ruajtjen dhe konsolidimin e islamit suni në vendet e sunduara dhe në luftërat e tij.²

¹ Ekrem Murtezai, *Fjalor i feve*, Rilindja, Prishtinë, 2000, f. 119; Baba Rexhebi, *Misticizma Islame dhe Bektashizmi*, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Tiranë, 2006, f. 115; Tahir N. Dizdari, *Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, f. 338; Robert Elsie, *Fjalori Historik i Shqipërisë*, Uegen, Tiranë, 2011, f. 247; Shejh Muhamed Shehu, *Shejh Shefqeti dhe Teqja e Madhe në shërbim të Zotit, në shërbim të popullit*, ARB dengui, Gjakovë, 1418/1998, f. 59.

² *Historia e Popullit Shqiptar I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Instituti i Historisë, Toena, Tiranë, 2002, f. 596.

Rendi halveti u përhap në: Bullgari, Bosnje, Maqedoni, Greqi, Shqipëri etj. Veprimtaria e tyre u zgjerua me forcimin e pushtetit otoman në këtë pjesë të Ballkanit. Faktorët kryesorë historiko-shoqërorë që çuan në paraqitjen dhe zhvillimin e rendit halveti tek shqiptarët, kanë qenë raportet shoqërore-historike që mbretëruan në kushtet dhe rrethanat e reja të rritjes, të forcimit dhe të organizimit të shtetit osman. Këto rrethana islamin e sollën drejtpërdrejt me popuj që kishin tradita të hershme kulturore dhe fetare, pjesëtarë të cilëve pranuan fenë islame, por që nuk ishin të gatshëm të shkundeshin plotësisht nga botëkuptimet e tyre të mëparshme, nëpërmjet këtij tarikati në shumë vise të Ballkanit, e si pjesë e tij edhe në trojet shqiptare është prezantuar botëkuptimi sufik i fesë islame.³

Peter Bartl është një ndër hulumtuesit që ka bërë studime rreth historisë së islamit tek shqiptarët, ai e përforcoi mendimin për dervishët se ata në vendet ballkanike ua shpjeguan islamin vendasve në formën më të kuptueshme dhe më të lehtë për t'u praktikuar, gjë që është në përputhje me islamin tradicional.⁴ Ka mjaft argumente që dëshmojnë se islami në trojet shqiptare fillimisht ka depërtuar me anë të misionarëve sufi (dervishëve). Ata marshonin së bashku me ushtarë dhe në përhapjen e islamit në trevat e Ballkanit ku luajtën rol të rëndësishëm, duke u quajtur ushtarë shpirtërorë,⁵ këta ishin misionarë të përkushtuar që rrezatuan mirësinë e tyre në shoqëri, duke tërhequr zemrat e njerëzve. Të dhënat të shumta rrëfejnë përkushtimin e këtyre njerëzve që arritën të krijojnë bulëzat e një tradite, që më vonë do të masivizoheshin në këtë vend,⁶ p.sh. kur sulltan Sulejmani është nisur në ekspedita luftarake, ai me vete ka marrë shehlerë të caktuar që ta ngrenë moralin e ushtrisë së tij, si në pushtimin e Beogradit, Sigetvarit etj.⁷ Ishte mendësia liberale dhe filozofike e dervishëve që gjeti një përkrahje dhe mbështetje të gjerë edhe ndër shqiptarët. Rendi halveti si dimension

³ Metin Izeti, *Kllapia e Tesavvufit*, BFI FSHI, Shkup, 2004, f. 136.

⁴ Peter Bartl, *Milli Bagimsizlik Hareketi Esmasinda Arnavutluk Muslumanlari 1878-1912*, trc. Ali Taner, Istanbul, 1998, f. 49 - 50.

⁵ Qarkullojnë nëpër Ballkan tregime e legjenda për misionar sufi si Sari Salltuku, personalitet sa historik, aq edhe legjendar, puna misionare e të cilit paraqet një periudë shumë të rëndësishme në përhapjen e islamit në Ballkan; Hasan Kaleshi, *Legjenda shqiptare për Sari Salltukun*, Përparimi, Prishtinë, 1967, f. 86; Baki Dollma, *Historiku i Sarisalltek Babait e Teqesë Bektashiane të Dollmes*, Krujë, 2004, f. 36 - 39.

⁶ Mehdi Gurra, *Nuk ka Tarikat pa Sheriat*, Lumturia, Viti III, Nr. 9, Korrik 2012, Botuesi: Shoqata Kulturore "Kur'ani"-Kosova, Prizren, f. 43.

⁷ Metin Izeti, *Kllapia...*, f. 140.

shpirtëror në islam, është fenomen i rëndësishë së veçantë. Ai në realitet, është fryt i porosisë shpirtërore të Profetit, përpjekje që me angazhimin personal të ringjallen modalitetet e saj me anë të kundërimit të brendshëm të përmbajtjes së Shpalljes Kur'anore. Sufizmi halvetian është kundërshti evidente, dëshmi e pafalshme e islamit shpirtëror⁸ dhe kundër çdo lloj përpjekjesh që islami të reduktohet në religjion legjislativ dhe literalist. Mund të themi se rryma ezoterike, pra e brendshme e islamit, i ka rrënjët thellë në fushën e hapur nga Kur'ani dhe sufizmi halveti, ku përfaqëson aspektin e brendshëm të islamit. Doktrina e sufizmit në thelb, nuk është asgjë tjetër përveçse interpretim ezoterik i Kur'anit, por që në itinerarin e vet nuk përjashton kursesi anën e jashtme të synetit (tradita profetike) apo rregullave të islamit.

Duke u nisur nga fakti, se në: Shkodër, Berat, Korçë, Elbasan dhe në Vlorë në fund të shek. XVI dëshmohej të jenë themeluar teqe halveti,⁹ përhapja gjeografike e këtij tarikati ishte zgjeruar jo pak. Zhvillimi i këtij procesi shpejtohet edhe më shumë gjatë shek. XVIII, shekull gjatë të cilit tarikati halveti shton praninë e vet edhe në Kosovë dhe në trevat shqiptare në Maqedoninë Perëndimore. Kjo shihet në rrjetin e teqeve halveti që themelohen gjatë kësaj kohe në këto treva, si në: Prizren, Shkup, Gjakovë, Rahovec, Ohër, Strugë, Gostivar, Kërçovë etj., u bënë qendra kryesore të rendit halveti.¹⁰ Me zhvillimin, funksionimin dhe rolin e dervishëve dhe teqeve të tyre në trevat shqiptare ka pasur shehlerë dhe dervishë të cilët janë dëshmuar në veprimtarinë shoqërore, historike dhe kulturore.

⁸ Shejh Xhafer Shehu-Halveti, *Hyrje në Tesawufin Islamik*, Buletin "HU", Prizren, 1979, f. 6; Ali M. Basha, *Nëpër gjurmët e Islamit*, Tiranë, 2005, f. 452.

⁹ *Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë* (më tej: *AIHT*, Fondi: Filozofi, Ekonomi, Etnografi, Kultura-Arti, dos. G-I-24, Nr. 1782, f. 9; Emin Riza, *Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë shek. XV-mesi i shek. XIX*, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1991, f. 57; Kadri Halimi, *Trajtime dhe studime etnologjike*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Prishtinë, 2011, f. 90; Gjergj Frashëri, *Teqeja e Halvetinjtë (Berati)*, Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Kristal-Kh, Tiranë, 2009, f. 2682; Ferit Duka, *Berati në kohë osmane shek. XVI-XVIII*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë; Instituti i Historisë, Toena, 2001, f. 194.

¹⁰ *Arkivi i Teqesë së Saraqhanes-Prizren*, (më tej: *ATSP*) më 4. III. 2011; Vefa Qemal Karahoda, *Një Histori e shkurtër e tetë teqeve dhe tarikateve 1455-2003*, Prizren, f. 43; Haxhi Shejh Xhemali Shehu-Rufai, *Teqeja e rendit dervish "SINANI"-Prizren*, Buletini "HU" Nr.1, Prizren, 1980, f. 3; *Arkivi i Teqesë së Shejh Litës-Gjakovë*, (më tej: *ATSHLGJ*); më 30 gusht 2009; Shif Hilafetnamen e përbotshme të Shejh Halitit I; *Arkivi i Teqesë së Shejh Bedrushit Mulliqit-Gjakovë*, (më tej: *ATSHBGJ*), më 20 gusht 2009.

Si rezultat i zhvillimit ekonomik, familje të mëdha feudale shqiptare filluan të fuqizoheshin dhe të shkëputeshin politikisht nga shteti osman. Pushteti qendror ishte i detyruar që përfaqësuesit e këtyre familjeve t'i njihte si nëpunës të lartë. Në vitin 1757, Porta e Lartë (Perandoria Osmane) e njohu Mehmet Bushatin si qeveritar të Sanxhakut të Shkodrës dhe i dha gradën Pashë. Ai vendosi qetësinë e rregullin në sanxhak, dhe zbatoi politikën e tolerancës fetare për katolikët, duke marrë nën mbrojtje klerin. Ai përkrahu tregtarët dhe nxiti zhvillimin e prodhimit zejtar. Krahinave malore u njohu privilegjet e vetëqeverisjes dhe mori në shërbimin ushtarak dhe shumë malësorë. Për qeverisjen e sanxhakut vuri në shërbim të tij njerëz të ditur me përvojë dhe me emër të mirë. Në mesin e tyre kishte edhe shehlerë të rendit halveti, si: Shejh Tahiri i fshati Çajë, Shejh Hyseni i Shtiqnit, Shejh Aliu i Fshatit etj.¹¹

Shejh Tahiri i cili vinte nga një familje e ndershme dhe e respektuar me tradita të shehlerëve, ishte i lidhur miqësisht me Bushatllinjë e Shkodrës duke qenë mbështetje kryesore e tyre në Lumë dhe nyje lidhëse për ata edhe në: Tetovë, Gostivar e Dibër. Sipas të dhënave të historikut të kësaj teqeje (gjysma e dytë e shek. XVIII), Shejh Tahiri ia kishte ndërprerë rrugën oficerit osman Tahir Pashës, i cili ishte nisur në krye të një ushtrie nga Kroi i Bardhë për të shkuar në Kala të Dodës, dhe nuk kishte respektuar institucionin e teqesë dhe zakonet e vendit¹². Të dhënat flasin për ndihma të konsiderueshme që këta vezirë u jepnin atyre, për lidhje mes Sanxhakut të Shkodrës dhe teqeve në zonat tepër malore dhe të izoluara, sikurse ishte trekëndëshi Kala e Dodës-Gjakovë-Shkodër, ku përfshiheshin Luma, Hasi, Malësia e Gjakovës, Puka dhe Mirëdita. Respektin e kultit fetar islam dhe shërbimin që u bënin vezirët bushatas të Shkodrës që nga Karamahmut Pasha e deri tek i fundit, veziri i kësaj dere i dërgonte çdo vit teqesë së Shejh Tahirit një barrë kafe, një barrë sheqer dhe një barrë oriz (një barrë barazi me 100 okë ose 128 kg.).¹³

¹¹ Nazif Dokle, *Rreth veprimtarisë patriotike të teqeve të Kuksit*, E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike (9), Kumtesë, portrete dhe vështrime shkencore nga Sesioni i IX shkencor i mbajtur më 11 nëntor 2010 në Kukës me temën "Luma dhe trevat e tjera shqiptare në luftë për çlirim dhe bashkim kombëtar 1878 - 1990, Prizren - Kukës, 2010, f. 176.

¹² Nazif Dokle, *Teqeja e At Aliut Fshat-Kuk*, Tiranë, 2009, f. 112.

¹³ Këto të dhëna janë ruajtur në kujtimet e Teqesë në vitet '30 nga pleqtë Ismail Osmani 120 vjeçar nga Puka dhe Selim Zeqa me mbi 100 vjeçar nga fshati Fleti (Pukë); Nazif Dokle, *Rreth veprimtarisë patriotike të teqeve të Kukësit*, E djathta

Situata para dhe pas Kongresit të Berlinit (1878) ishte shumë e vështirë, edhe pse shqiptarët ishin në mes të Perandorisë Osmane, shtetet ballkanike dëshironin t'i vinin nën zgjedhje të re. Në një situatë të tillë tejet të vështirë, në prill të vitit 1878, filluan bisedimet e personaliteteve të shquara shqiptare nga të gjitha trevat shqiptare. Atëherë mbajtën një varg mbledhjesh nga të gjitha anët, ku më të rëndësishmet ishin ato të cilat u mbajtën në Gjakovë e në Shkodër.¹⁴ Në mbledhjen e dytë në Gjakovë, u vendos që të mbahet Kuvendi në Prizren dhe aty të merret vendim kundër Kongresit të Berlinit i cili cenon interesat e popullit shqiptar. Njëkohësisht në të u morë vendim që të formohet një organizatë politike e cila do të udhëhiqte rezistencën gjithë popullorë shqiptare.

Këshilli qendror i Lidhjes i ftoi të gjitha krahinat të dërgonin delegatët e tyre në Prizren që të merrnin pjesë në mbledhjen e përgjithshme të saj. Në këtë mbledhje të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit morri pjesë shehu i rendit halveti Shejh Maksuti II. Lidhja Shqiptare ishte ngritur mbi përkatësinë fetare dhe krahinore të cilat përmbliidhen në përpjekjet për të ndalur ndarjen e zonave kufitare të Shqipërisë, sipas një raporti të konsulli anglez Kirby Green dërguar ministrit të Jashtëm anglez Markesi Salisbury të datës 11 nëntor 1878, ku ndër të tjera thotë: "Më thonë se Lidhja përfaqëson vendimin e prerë, që të kundërshtojnë çdo agresion të njërit ose të tjetrit prej anës së elementëve të shumtë armiqësore që rrethojnë Shqipërinë. Shprehja "nacionale" nuk duhet të kuptohet aspak si një dëshirë për ndarje nga sundimi i Sulltanit. Lidhja e ka kuptuar në ç'mënyrë kanë vepruar dëshirat e popullit në politikë kohët e fundit. Lidhja s'ka për qëllim të bëjë luftë kundër Malit të Zi, Austrisë, Serbisë, Bullgarisë, Rusisë dhe Greqisë, veç se i ka bërë të ditur botës që Shqipëria nuk mund të nxjerrë në pazar as një pëllëmbë toke prej saj pa pyetur edhe për dëshirën e trashëgimtarëve të saj, që janë shqiptarët".¹⁵ Në vitin 1878, kajmekam në Preshevë ishte Hasan Kudretullah Efendia, i cili në fillim ishte kundër qëndrimeve të degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Preshevë. Mirëpo, Shejh Maksuti II i

shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike (9), Kumtesë, portrete dhe vështirime shkencore nga Sesioni i IX shkencor i mbajtur më 11 nëntor 2010 në Kukës me temën "Luma dhe trevat e tjera shqiptare në luftë për çlirim dhe bashkim kombëtar 1878-1990, Prizren-Kukës, 2010, f. 176.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *AIHT, Fondi: Dokumente të zgjedhura të periudhës 1864-1913 burime të ndryshme, viti: 1878, dos. A-IV-31. f. 12. Raporti i konsullit anglez në Shkodër Kirby Green dërguar ministrit të Jashtëm Markezit Salisbury më 11 nëntor 1878.*

dërgoi kajmekamit të Preshevës një këshillë prej tre pleqve: Rexhep Agën, Mehmet Efendinë dhe Naip Efendinë, me qëllim që ta njoftojnë se çdo qëndrim kundër kërkesave shqiptare do ta paguajë me kokë. Takimi i parë ishte i pasuksesshëm, duke i dhënë besë 24 orë në mënyrë që të mendojë mirë. Pas këtij afati, pleqnarët për të dytën herë i hynë në zyrë kajmekamit të Preshevës. Meqë në vitin 1887, Mëhalla e Shehëve ishte më e madhja dhe numëronte gjithsej 20 shtëpi, nga presioni i krerëve të Degës së Lidhjes së Prizrenit në Preshevë dhe nga frika e familjes së Shejh Maksutit II, kajmekami i Preshevës Hasan Kudretullahu pranoi se në postin që kishte do të ishte vetëm si kukull dhe do të respektojë çdo kërkesë të Lidhjes Shqiptare.¹⁶ Për Shejh Maksutin II janë ruajtur disa vargje të këngëve popullore në të cilat flitet për dërgimin e luftëtarëve të tij në mbrojtjen e popullsisë shqiptare të rrethinës së Vrajës që në atë periudhë sulmoheshin nga forcat serbe me qëllim të shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve dhe spastrimit etnik të tokave të tyre. Rezistenca në fjalë u zhvillua në Grykën e Gërdelicës ku u bë një luftë heroike për ruajtjen e tokave shqiptare të trashëguara me shekuj nga paraardhësit tanë.

Gjatë viteve 1877-1878, shqiptarët e Vrajës heroikisht luftuan kundër forcave serbe si në Grykën e Gërdelicës ashtu edhe në rrethinën e Vrajës, sepse nga dhuna dhe presionet e padurueshme serbe ata nuk kishin shtegdalje tjetër. Megjithatë të përballur me një forcë shumëfish më të madhe ata u detyruan që të shpërngulen nga vatrat e tyre dhe t'i lënë ato përgjithmonë. Një gjë të tillë e vërteton edhe fakti se në vitin 1878 në Preshevë erdhën një numër i madh muhaxhirësh nga Vraja, Leskoci etj. Në këtë kontekst, shqiptarët, sado që qenë vendosmërisht kundër çdo pushtuesi të ri, e në mënyrë të veçantë kundër Serbisë, ata nuk mundën t'i përballonin forcave të mëdha ushtarake të Serbisë të cila ia arritën që të shpërngulin me dhunë më tepër se 100 000 shqiptarë.¹⁷ Situata ndërkombëtare në fillim të vitit 1881 vazhdimisht po acarohet, kurse forca dhe autoriteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit gjithnjë e më shumë po rritej, pasi për një kohë të shkurtër administrata shqiptare u shtri në tërë Vilajetin e Kosovës, si në: Prishtinë, Kumanovë, Preshevë etj. Lidhja u forcua organizativisht dhe fitoi një përkrahje më të madhe në mbarë vendin. Sipas planeve osmane, Lidhja Shqiptare e Prizrenit duhej të shtypej gjatë muajit prill të vitit 1881. Në këtë kohë pushteti i

¹⁶ Rexhep Selimi, *Në Grykën e Gërdelicës u bë një luftë heroike për ruajtjen e tokave shqiptare*, Zëri i Kosovës, e enjte, 24 shtator 1998, f. 14.

¹⁷ *Po aty*.

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte përqendruar kryesisht në viset e Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Preshevës, Gjakovës, Dibrës, por edhe në vende të tjera. Ndërkaq, dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Preshevë u shtyp pasi arriti në pragun e realizimit të programit madhor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Por edhe pse u shtyp, ajo pati një varg rezultatesh me rëndësi të madhe historike.

Pas shuarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në vitin 1881 u shua edhe Dega e Lidhjes në Preshevë, kurse Shejh Maksuti II u arrestua së bashku me dy bashkëluftëtarë të tij dhe u internua në Stamboll. Në vitin 1885 pas internimi u kthye në Preshevë. I lodhur dhe i sëmurë rëndë nga pasojat e vuajtjeve në internim jetoi vetëm pak vite pas kthimit në vendlindje. Vdiq në vitin 1887 në Preshevë, ku u varros me nderime të mëdha në tyrbe pranë varrit të birit, ngase pas vetit nuk la trashëgimtar.¹⁸ Në momente më të vështira të luftërave dhe kthesave historike, teqetë si institucion fetar kanë qenë në anën e të shtypurve dhe të papërfillurve. Kur flasim për veprimtarinë patriotike që kryenin teqetë halveti, duhet të ndalemi te fryma humane që përshkon përmbajtja e veprimtarisë së tyre, si Shejh Salihu i teqesë së fshatit Çajë të rrethit të Kuksit përveç veprimtarisë fetare, aktivizohet edhe në çështjen kombëtare. Ai u ka bërë bekimin vendimeve të Kuvendit të Lidhjes së Pejës më 1899 që drejtoi atdhetari i shquar Haxhi Zeka. Në mbledhjen historike të Verrat e Llukës afër Deçanit (1910), Shejh Salihu ishte njëri nga përfaqësuesit e Lumës. Në fund të mbledhjes, e më kërkesën e drejtuesve të saj, Shejh Salihu bënë duanë (lutjen) sipas zakonit fetar. Teqetë, në përgjithësi, u bënë vatra të lëvizjes patriotike për çlirim kombëtar. Në mbledhjet fetare që bëheshin në to, shqyrtoheshin edhe çështje politike, e në radhë të parë marrëdhëniet shqiptaro-osmane.¹⁹ Shpallja e Pavarësisë ishte një akt me rëndësi jetike për popullin shqiptar. Kuvendi i Vlorës e shpalli Pavarësinë në emër të të gjithë shqiptarëve, të të gjitha trevave shqiptare që dërguan përfaqësuesit e tyre në të. Ai trajtoi Shqipërinë një e të pandarë. Edhe qeveria shqiptare

¹⁸ Në epitaf mbi varrin e tij shkruhet në osmanishten e vjetër: Nuk ka zot, përveç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Allahut. U shpërngul kësaj bote kaluese. Në botën e përhershme (në botën amshueshme) Haxhi Shejh Maksut Efendi, djali i Shejh Omer Efendiut. Për shpirtat e tyre El-Fatiha. Në mes shkruan viti 1230/1815. Varrin e Shejh Maksutit II e punoi Shejh Alisahiti, po atë vit që kishte vdekur por nuk dihet kush e shkroi epitafin dhe kush e skaliti varrin. Tyrbja e Preshevës është nën mbrojtjen e Entit për Mbrojtjen e Monumeteve Kulturore Historike.

¹⁹ K. Buchberger, "Vjetët e mija në Shqipëri", *Studime historike*, nr. 4, Tiranë, 1972, f. 145.

e Ismail Qemalit doli në rrafshin ndërkombëtar si përfaqësuese e gjithë popullsisë shqiptare dhe e gjitha tokave shqiptare.²⁰ Është e qartë që edhe kleri mysliman ka dhënë kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes, në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do vëmë re se prania e klerikëve myslimanë është kudo e pashmangshme, si p. sh: Shejh Ahmed Pazari, një atdhetar i shquar që punoi dhe shkriu gjithçka që kishte për idealin kombëtar.

Si kryetar i rendit halveti, ishte i njohur në të gjitha trojet shqiptare, faktin që bekoi dhe e ngriti bashkë me atdhetarë tjerë flamurin kombëtar në Tiranë më 26 nëntor 1912,²¹ në ditën e “madhnueshme” siç e quante ai, Shejh Ahmed Pazari ishte një nga organizatorët dhe oratorët e mitingut që u organizua për këtë qëllim, bekoi flamurin dhe nga goja e tij dolën fjalët plot gëzim e shpresë “Rrnoft Shqiperia”. Por, ai ishte dhe një veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare, njëkohësisht shquhej për idealizmin e pikëpamjeve të tija në funksion të lirisë, kombit dhe atdheut. Shejh Ahmet Pazari ishte një qytetar i moderuar, ai luftonte fanatizmin, përbuzte ata që pengonin dijen. Për këtë fanatikët dhe turkomanët e thërrisnin me epitelin e Sheh Kaurrie. Ky idealizëm e patriotizëm i tij që e manifestonte dhe e shpaloste çdo ditë u lind dhe u zhvillua mbi bazën e patriotizmit të familjes së tij dhe kontakteve që ai kishte me rilindësit në Stamboll, si: vëllezërit Frashri, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja etj. Me gjithë kërkesën e qeverisë së Vlorës, as Fuqitë e Mëdha dhe as shtetet fqinjë ballkanike në fillim nuk e njohën Pavarësinë e Shqipërisë. Sidoqoftë, problemi i shtetit të ri shqiptar dhe shtrirja territoriale e tij ishte në qendër të vëmendjes për shtete ballkanike dhe evropiane. Për shkak të interesave të këtyre shteteve të ndryshme ai përbënte një problem të rëndësishëm. Serbia kishte sulmuar disa herë Shqipërinë dhe në vitin 1912, gjeti rastin, kur ushtria osmane largohej, trupat serbe ishin të përqendruar nga Shkodra deri në Krujë.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, f. 512.

²¹ *Gazeta Liria*, e premte, 27 nëntor 1992, f. 3; Shejh Muhamer Pazari, *Rruga e Azizave të Tiranës*, Tiranë, 2007, f. 41; Ibrahim Rr. Gashi, *Xhemal Pazari atdhetar i shquar tiranas*, Instituti i Integritimit të Kulturës Shqiptare (IIKSH), Tiranë, 2009, f. 68.

Me zemër prej atdhetari së bashku me Fuad Toptanin, Xhelal Toptanin dhe Nikolla Nishkun kishin dërguar një notë proteste para komandës serbe duke kërkuar që të mos marshojnë drejt Tiranës së Pavarur.²² Protesta drejtuar komandantit serb, konsiston në: "Ne jemi popull shqiptar dhe jo turk". Për këtë kemi ngritur flamurin tonë dhe kemi shpallur independencën. "Komisioni, që do të nisej protestën, formohet nga gjashtë persona. Për të mbajtur një barazi në mes feve, në kuptimin njerëzor, Sheh Ahmet Pazari bëri një shembull tolerant dhe të barabartë. Në komisionin e protestës ndaj serbëve, ai si kryetar, propozoi tre myslimanë dhe tre të krishterë për të njoftuar komandantin serb në Krujë, rreth vendimeve të komisionit për pavarësi. Kryetar i Komisioni zgjedhet Shejh Ahmet Pazari, ndërsa anëtarë të tij janë: Myslym Agë Beshiri, Myslym Myderrizi, Fan Koja, Nikoll Nishku, Spiro Politoqi.²³

Komisioni arriti në Krujë pa rënë dielli dhe i paraqiti komandantit serb protestën. Komandanti iu përgjigj, se një punë e tillë duhej bërë me kohë. Shejh Ahmet Pazari, aty për aty i përgjigjet, se: "Populli shqiptar dhe Kosova ka shumë kohë me kryengritje e pushkë, që kërkon këtë pavarësi. Ne kemi rënë dakord me kufijtë. Ku t'i thonë bukës "bukë", na përket neve dhe ata që bukës i thonë "hljeb", iu përket juve. Ndërkohe ne kemi lajmëruar dhe shtetet e tjera evropiane dhe presim përgjigje prej tyre". Komandanti serb merret vesh me Beogradin dhe përgjigja e tyre ishte që përfaqësuesit e këtij komisioni të kryesuar nga Shejh Ahmet Pazari të mos vriteshin, por të mbaheshin në survejim. Të nesërmen, pa lindur dielli, u lanë të lirë nga serbët për t'u kthyer në Tiranë. Populli i Tiranës priti gjithë natën në sheshin pranë Teatrit të Kukullave. Me arritjen e tyre u bë një atmosferë e gëzuar, e përzier me lot. Atë ditë Ismail Qemali zbriti në Durrës dhe gjeti flamurin të ngritur. Mësoi se Sheh Ahmet Pazari, pasi ngriti flamurin në Tiranë, punoi dhe për ngritjen e flamurit në Durrës. Ismail Qemali, që e njihte mirë mikun e tij atdhetar, i dërgon një telegram nga Durrësi: "Sheh Ahmet Pazarit-Tiranë, Ju përgëzoj për ngritjen e flamurit në Shqipërinë e Mesme,

²² Këtë veprim të guximshëm të Shejh Ahmed Pazarit dhe shokëve të tij, gazeta *Gazeta Shqiptare* që botohej në Bari të Italisë e përmbledhte me këto fjalë: "Kur sulmonte e jepte flake vendi, fuqia e tmerrshme serbe iu afrua Tiranës, Shejh Ahmedi bashkë me shokët që pat bekuar dhe ngrehur flamurin kombëtar në qytetin e tij Tiranë. Në atë dhe i komunikoi komandantit të ushtrisë sulmuese se vendi i tij është Shqipëria..."

²³ Arkivi i Teqesë Shejh Ali Pazarit në Tiranë; Sinan Tafaj, *Në kuadrin 75-vjetorit të Pavarësisë, atdhetarit që ngriti flamurin në Tiranë*, f. 4.

Kandilat e Shqipërisë që keni ndezur, nuk do t'i leje të shuhen".²⁴ Ushtria serbe më 27 nëntor 1912, në mbrëmje, zaptën Tiranën. Arrestin e parë e bëjnë me Shejh Ahmet Pazarin. E çojnë në burgun e Kavajas, ishte dimër i ftohte. Shejh Ahmeti, është si të burgosurit e tjerë, flinte në çimento, pa shtrojë, e i torturuar shumë.²⁵ Shejh Ahmet Pazarin nuk pranoi asnjë ofiq në atë kohë, ndonëse i ofruan poste me rëndësi të cilat i refuzoi në mënyrë kategorike. Që njeri i thjeshtë dhe i drejtë e për çështjet e atdheut nuk kurseu asgjë. Netët e 27-29 nëntorit ishin një torturë e vërtetë për plakun atdhetar, që punonte për pavarësinë e vendit të tij. Shejh Ahmetin e akuzojnë, se njerëzit që ndihmuan Ismail Qemalin për të kaluar në Vlorë, ishin njerëzit e tij, e kjo akuzë do t'i kushtonte më vdekje në litar dhe trekëndëshi ishte gati. Leonidha Mineu, N/Prefekti i Kavajas, hyri garant për pafajësinë e patriotit.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe aneksimit të Kosovës nga ana e ushtrisë serbe lidhjet shpirtërore në mes teqeve halveti jo vetëm nuk u shkëputen, por ato kaluan edhe në planin kombëtar, siç shkruan Shejh Muhamer Pazarin: "Kjo çerdhe patriotësh, mbledhte dhe priste patriotë edhe nga Kosova. Nëpërmjet fesë ata bënë dhe bisedime rreth vendit të tyre, flisnin për pavarësinë, të cilën e kishin ëndërruar prej kohësh të parët e tyre".²⁶ Me anë të këtyre komunikimeve teqetë përpiqeshin të ndihmonin në mbajtjen gjallë të ndjenjave kombëtare e të dilnin në mbrojtje dhe strehim të shqiptarëve të Kosovës, edhe pse pushteti serb mori masa represive ndaj Shejh Aliut nga Mitrovica dhe vëllait të tij Shejh Ahmedit, Shejh Litës nga Gjakova etj. Pas fitores së Pavarësisë, Shqipëria hyri në hullitë e zhvillimeve të reja sociale, politike e kulturore. Me gjithë prapambetjen e madhe të vendit, shenjat e progresit dukeshin në çdo sferë. Përparim pati edhe në kulturën islame shqiptare. Tek rendi halveti nuk ekzistonte dualizmi konfliktual ndërmjet ndërgjegjes për funksionim fetar me ndërgjegjen kombëtare. Përkundrazi ato ishin mbështetje të njëra-tjetrës, në shërbim të drejtpërdrejtë të prosperitetit gjithëkombëtar. Në këtë periudhë u hodhën themelet për një zhvillim të pavarur të kulturës islame si dhe të çdo veprimtarie tjetër brenda kuadrit të shtetit kombëtar. Në këtë periudhë patriotët myslimanë shqiptarë e panë të domosdoshme të bëjnë ndryshime me rëndësi në kulturë dhe në organizimin si dhe të realizojnë binomin Fe dhe Atdhe. Mendjet e kthjellëta të prijësve fetarë myslimanë

²⁴ Gazeta *Liria* ..., f. 3.

²⁵ Gazeta *Besa*, "Kronika e vendit", e mërkurë, 9 shtatuer, 1931, f. 4.

²⁶ Sheh Muahmer Pazarin, *Rruga Historike* ..., 35.

shqiptarë filluan të zbatojnë reformën në kulturën islame. Kështu gjatë viteve '20 dhe '30 të shek. XX u zhvilluan tre kongrese aleviane (shehlerëve), i pari u mbajt në Tiranë në vitin 1921,²⁷ i dyti u mbajt në Berat më 1930²⁸ dhe i treti përsëri në Tiranë më 1936.²⁹ Duke pasur parasysh në kushtet dhe rrethanat në fillim të viteve '20 dilte si detyrë e parë stabilizimi politik i Shqipërisë, për ta futur atë në rrugën e zhvillimit e të përparimit, kontrasti shpirtëror kishte ndikuar jo pak edhe në fetë e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri, institucionet e të cilave i kishin qendrat e tyre jashtë Shqipërisë. Organizmi i rendit halveti dhe bashkimi i tyre nuk kishte për qëllim vetëm forcimin e anës fetare, por rritjen e dashurisë e të unitetit kombëtar shqiptar siç thuhet edhe në statutin e nxjerr nga Kongresi I: "Qëllimi themelor i kësaj lidhje asht: Naltësimi i popullit në pikëpamje morale e kombëtare; në plotësim të këtij qëllimi "LIDHJA" ka me i ndihmue edhe qeverisë shqiptare me çdo mjet të pëlqyeshëm".³⁰

Shteti i ri shqiptar kishte nevojë të reformohej dhe të përtërinte organizmin shtetëror, Shqipëria kishte gjithashtu nevojë për demokratizimin e jetës së vendit në rrafshin politik, legjislativ, ekonomik, shoqëror etj. Forcat politike shqiptare mbajtën qëndrime të ndryshme si për nevojën e zgjidhjes së këtyre detyrave, ashtu edhe për rrugët që duheshin ndjekur për t'i zgjidhur ato. Në këto procese të brendshëm të jetës politike-shoqërore mori pjesë shehu i rendit halveti Shejh Salihu. Si një intelektual, ishte për ndryshimet e reja që t'i sigurojë vendit përparim dhe drejtësi. Për këtë, ai renditet krah atyre që inspironin e punonin për lëvizjen politike demokratike të viteve 1920-1924, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hoxha Kadriu, Rexhep Mitrovica etj. Shejh Jahaj si zgjedhës i dytë në Lumë jep një ndihmesë të frytshme në zgjedhjet parlamentare të vitit 1923 ku Luma bënte pjesë në prefekturën e Kosovës, aktivisht angazhohet në fushatën elektorale dhe propagandon për grupin e deputetëve të opozitës. Në atë fushatë elektorale fitoi grupi i opozitës. Për këtë Shejh Jahja është falënderuar nga deputetët Hoxha Kadri Prishtina dhe Rexhep Mitrovica me telegram të veçantë. Shejh Jahja mbante lidhje dhe korrespondencë me shumë emigrantë nga Kosova, herë pas here shkonte edhe vetë në Kosovë. Ai

²⁷ Sheh Muhamer Pazari, *Rilindja e besimit Halvetian*, Tiranë, 2006, f. 59.

²⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: AQSH) F. 149, V. 1933, D. VI-458, fl. 10; Delegatet në Kongres. Berat 20. VI. 1930.; *Gazeta Vullneti i Arbërisë*, Tiranë, Nr. 13, e mërkure, 25 qershor 1930, f. 4.

²⁹ AQSH, Fondi i kryeministrit, Nr. 149, D.VI-636, viti 1937, fl. 4.

³⁰ *Statuti i Kongresit të Shehlerëve*, Tiranë, Shtypshkronja "Elbasani", 1921.

qe pjesëmarrës në ngjarjet e qershorit të vitit 1924 dhe pikërisht për këtë pati edhe pasoja të mëvonshme, por prestigji i tij fetar e popullor qenë mbrojtje e tij kryesore. Varfëria e popullit dhe mjerimi ekonomik i vendit ishte shqetësimi kryesor që e preokuponte. Pikërisht për këtë më 1933 bashkë me kushëririn e tij Ahmet Halil Qashifin i kërkon takim mbretit Zog. Nga ky takim nuk doli ndonjë rezultat. Pak më vonë Ahmet Qashifi dënohet me 2 muaj burg dhe internohet në qytetin e Korçës, ndërsa Shejh Jahja në mbarim të pranverës së 1934 do të vritet nga mercenarët e forcave konservatore. Varrimi i Shejh Jahjasë u bë në Grykën e Çajës (Kukës) u krye me madhështi dhe e pamja zgjati 40 ditë me nderime nga e gjithë krahina e Lumës dhe viset e tjera të Veriut.

Nga fundi i viteve '30, Italia po e konsideronte seriozisht mundësinë e aneksimit të Shqipërisë. Në prill të vitit 1939 Italia e okupoi Shqipërinë. Okupimi ishte rezultat i ultimatumit me të cilin Shqipërisë iu imponua bashkimi me Italinë, pas së cilës fshihej qëllimi i bashkëngjitjes së Shqipërisë me Italinë. Pas kapitullimit të mbretërisë jugosllave në prill të vitit 1941, forcat fashiste filluan t'i copëtojnë vendet e okupuara. Edhe pse bashkimi u bë nën kapelën fashiste, megjithatë për popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore kishte rëndësi të madhe historike. Gjuha shqipe u shpallë si gjuhë zyrtare bashkë me atë italiane. Për herë të parë u hapën shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, u legalizua përdorimi i simboleve kombëtare dhe u realizua bashkimi i administratës së fesë islame. Në këtë kuadër, teqetë halveti u lidhën me kryeqendrën e re në Tiranë, lidhjet e vjetra të teqeve të Shqipërisë dhe Kosovës u intensifikuan duke marrë një organizim të sekteve aleviane; në bazë të një dokumenti të vitit 1942 që gjendet në Arkivin Qendror Shtetëror të Shqipërisë, është një listë e shehlerëve të teqeve halveti nga Prizreni, Gjakova, Rahoveci, Peja, Kërçova dhe Gostivari që ishin përfshirë në Kryesinë e Sekteve Aleviane të Shqipërisë.³¹ Pas përfundim të Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë gjatë viteve 1945-1948, popullata shqiptare është trajtuar mbi bazën e elaboratit të V. Qubrilloviqit në vitet 1937 të

³¹ AQSH, F. 482, V. 1942, D. 18, fl. 1; Lista që përmban emrat e fetarëve në tokat e çliruara të Shqipërisë. Tiranë. Më data 21. X. 1942; Lista që përmban emrat e shehlerëve halveti në tokat e çliruara të Shqipërisë: 1. Shejh Hasani, Prizren, 2. Shejh Rexhep, Prizren, 3. Shejh Ferati, Prizren, 4. Shejh Hyseni, Prizren, 5. Shejh Ramadan, Gjakovë, 6. Shejh Ahmet, Gjakovë, 7. Shejh Halit, Gjakovë, 8. Shejh Osmani, Gjakovë, 9. Shejh Halit, Rahovec, 10. Shejh Myhedini, Rahovec, 11. Shejh Tahiri Pejë, 12. Shejh Jakup Gjakovë, 13. Shejh Rexhep Marina Gjakovë, 14. Shejh Ismaili, Kërçovë, 15. Shejh Ismaili, Gostivar.

ripërtërirë në vitet 1944. Mos respektimi i vullnetit të popullit për vetëvendosje, provokoi Luftën e Gjilanit e të Drenicës (1944-1945), gjatë së cilës u shkatërruan e u rrënuan fshatra të tëra shqiptare.

Masakrat do të vazhdojnë në të gjitha anët ku ndodheshin shqiptarët (Prizren, Gjilan, Tetovë, Shkup, Kumanovë, Preshevë etj.), duke pasur parasysh rrethanat dhe gjendjen tejet të rëndë nëpër të cilën po kalonin shqiptarët e Kosovës. Një grup atdhetarësh u angazhuan me konsekuencë për përmirësimin e gjendjes dhe pozitën e shqiptarëve të Kosovës, duke formuar organizatën Lëvizjen Nacionale Demokratike Shqiptare (LNDSH) në krye me Halim Spahia. Në këtë grup bënë pjesë edhe shehu i rendit halveti në Rahovec Shejh Mihedini. Që të krijohet një klimë e përgjithshme paniku dhe tensioni nga ushtria dhe policia jugosllave ndërmarrin aksione të përmasave të mëdha duke organizuar arrestime dhe dënime në shkallë të gjerë. Në gazetën *Rilindja*,³² botohet njoftimi se “Gjyqi i Naltë i Serbisë aprovon Vendimin e Gjyqit Populluer Krahinuer të Prizrenit, me të cilin dënohen me vdekje dhe me konfiskimin e të gjithë pasurisë: Halim Spahija, Tahir Deda, Rifat Krasniqi, Kajtaž Ramadani, Sefedin Ahmeti e Rexhep Kabashi.”³³ Ky grup ishte kundër vendimeve të pushtetit të atëhershëm serbo-jugosllav. Për ndalimin e aktiviteteve të këtij grupi për herë të parë në Prizren mbahet gjykimi në shtëpinë e “Sokolov Dom”,³⁴ ku prokurori Ali Shukriu kishte ngritë akuzë kundër grupit. Shejh Mihedini dënohet me 4 vjet burg në burgun famëkeq të Nishit, ndërsa gjashtë anëtarët e tjerë u pushkatuan në Prishtinë. Pas daljes nga burgu, ai nuk e la aktivitetin e tij politik. Shehu doli hapur kundër politikës serbomadhe dhe kështu ai u bë një faktor me ndikim për shqiptarët. Në një mbledhje në Xhaminë e Kadirive, po në qytetin e Rahovecit, servilët serbë organizojnë dhe marrin vendim që në Rahovec të mos flitet gjuha shqipe. Arsyeja e saj ishte sepse shumica e këtij qyteti nuk e flasin edhe sot e kësaj dite gjuhën shqipe. Pas situatës së krijuar Babës Shejh i jepet edhe më shumë kurajo për të luftuar kundër padrejtësive, dhe përmes elitës intelektuale të asaj kohe merr iniciativë për mobilizim të përgjithshëm, për mos sllavizmin e popullsisë së kësaj komune. Vëllai i Babës Shejh, Zylfi Shehu, në një tubim deklarohet se gjuha shqipe në këtë komunë nuk mund dhe nuk do të ndryshojë dhe se gjuhë zyrtare do të jetë gjuha

³² Gazeta *Rilindja*, datë 23.01.1946, Prishtinë, f. 2.

³³ Mehmet Rukiqi, *Me rastin e 60-vjetorit të rënies së Rifat Berishës në altarin e lirisë*, f. 5.

³⁴ *Po aty*.

e nënës, e ajo është gjuha shqipe. Kështu që në atë kohë në këtë komunë shkollën në gjuhën serbe e ndiqnin vetëm 10 apo 15 familje.

Në vitin 1955 për Shejh Mihidinin ishte viti më i vështirë i jetës së tij. Çdo ditë plaçkitez teqeja e tij nga bandat e ndryshme serbe, për çdo ditë mbusheshin burgjet përplot me shqiptarë, ku shumica e tyre ishin dervishë apo myhybë të shehut. Kjo karakterizon edhe vitin e mbledhjes së armeve apo siç e njohin si “Aksioni i mbledhjes së armëve”, ku ka qenë i theksuar posaçërisht në Rrafshin e Dukagjinit.³⁵ Ai ishte i involvuar në politikën e asaj kohe gjatë viteve 1968, 1974, 1981, 1990 dhe 1991,³⁶ e deri në vdekjen e tij në korrik 1998, ku edhe vritet në oborrin e Tyrbes së tij.³⁷ Në vitin 1966, në plenumin e Brioneve, duke goditur, klanin serbomadhi të Aleksander Rankoviçit, Titoja, u përpoq t’ia hidhte atij fajet për çdo masakër që ishte bërë mbi shqiptarët. Pas vitit 1966 fillon një fazë e re për shqiptarët në Jugosllavi në përgjithësi dhe për ata të Kosovës në veçanti. Atëbotë, posaçërisht pas vitit 1974, shqiptarëve të krahinës së Kosovës ju mundësua realizimi i një autonomie me një pavarësi më të madhe administrative-juridike dhe politike. E në fakt, edhe pse formalisht Kosova si krahinë me më shumë autonomi politike, ajo tërthorazi juridikisht dhe faktikisht ende ishte nën përbërjen dhe ndikimin e Serbisë. Në këtë periudhë, shqiptarët si popullsi shumicë që jetonin në KSA të Kosovës, gradualisht filluan t’i realizojnë disa të drejta të veta politike dhe ekonomike, si: e drejta e mbajtjes së flamurit kombëtar, universiteti, themelimi i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, media të pavarura, filloi të ndërtohet infrastruktura e prapambetur dhe të zhvillohet ekonomia etj. Gjatë kësaj periudhe rendet e dervishëve kanë funksionuar në gjysmë ilegalitet. Njëra ndër masat e organeve Federative të Jugosllavisë kundër Bashkësisë së Fesë Islame ishte përçarja e brendshme. Me nxitjen e organeve shtetërore, individë të

³⁵ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha dhe shtëpia e Librit, Prishtinë, Tiranë 2001, f. 334.

³⁶ Të gjitha këto vite janë të rëndësishme për popullin shqiptar të Kosovës. Për tri vitet e para nuk do të ndalem në detale, por dua të ndalem në vitin e fundit ku është bërë tek ne shqiptarët pajtimi i gjaqeve. Ka shkuar nëpër vende të ndryshme, si: në Has, në Rekë, në Deçan e vende të ndryshme. Por rëndësia më e madhe e tij ka qenë pajtimi i gjaqeve me Shejh Nexhatin në Rogovë të Hasit më datë 14 maj 1998. Këtu ka pasur disa familje të vrara. Për më shumë jam dëshmitar edhe vetë (G.K.).

³⁷ Për jetën dhe veprimtarinë e Baba Shejh Mihedini jep sqarime djali i tij Ylvi Shehu - zëdhënës i tyrbes, njëherit kryesues për informim pranë kësaj teqeje. Intervistë, shtator 2010.

caktuar në funksione të larta në Bosnje dhe Hercegovinë gjatë viteve 1951,³⁸ me vendimin e Kuvendit Vakufnor, e ndalojnë punë e tarikateve (de facto tarikatet veprimtarinë e tyre fetare prej vitit 1945 e kanë zhvilluar në ilegalitet të plotë), kurse me vendimin e Kryesisë Supreme të Bashkësisë së Fesë Islame të vitit 1962, tarikatet ndalohen edhe në Kosovë dhe në Maqedoni.³⁹

Qëndrimi lojal i këtillë i disa udhëheqësve, në Sarajevë, u ka mundësuar organeve shtetërore fraksionizmin e islamit në Jugosllavi dhe njëkohësisht u lehtësoi organeve shtetërore shtypjen dhe terrorin ndaj shqiptarëve, pasi që shqiptarët për shkak të presionit, kanë qenë në pozitë të konfliktit me pushtetin. Numri më i madh i pasuesve të tarikateve ka qenë në radhën e popullatës shqiptare.⁴⁰ Në vitin 1974 me iniciativën e Shejh Xhemailit të rendit rufai nga Prizreni, Shejh Hakiut i rendit kaderi nga Gjakova, Shejh Fejzulla Haxhibariqi nga Sarajeva si dhe të Shejh Xhaferit i rendit halveti nga Juniku, vendosen të formonin “Lidhjen e Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” për Republikën Federative të Jugosllavisë në kuadër të Bashkësisë Islame për Jugosllavi me resorë të ndarë për tarikate.⁴¹ Iniciativa në fillim u prit mirë nga reis ul-ulema i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Haxhi Sulejman Efendi Kemura, por pas kërkesës me shkrim u refuzua me arsyetimin se Këshilli Suprem i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë ka marrë vendim që t’i mbyll të gjitha teqetë në Jugosllavi. Kësaj iniciative ju përgjigj edhe Kryetari i Bashkësisë Islame për Republikën e Serbisë Ismail Hakiu. Këshilli iniciues për formimin e “Lidhjes së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” bëri një kërkesë në Ministrinë Federative për Religjione për lejimin si një organizatë e pavarur, me sugjerimin e sekretarit të Ministrisë për Religjione që edhe njëherë të aplikon në Bashkësinë Islame që të pranohen në kuadër të saj. Këshilli iniciues për formimin e “Lidhjes së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” bëri edhe një kërkesë, ku morri të njëjtën përgjigje negative. Atëherë me nismën e

³⁸ Shih: Zapisnik sa zajedanja Vakufskog sabora u Sarajevu održanog 16 novembra 1952 godina u saborskoj sali Vakufske direkcije u Sarjavu (Shih: Proqesverbalin e mbledhjes të Këshullit Vakfit Sarajev të mbajtur më 16 nëntor 1952, në sallën e tubimeve të drejtorisë së Vakfit në Sarajev), “Glasnik VIS-a”, (1962), nr. 8-10, f. 323.

³⁹ Shih: Izvestaj o radu Vrhavnog isamskog u Sarajevu (Shih: Raportin e punës të Këshillit Suprem Islam Sarajev), “Glasni VIS-a”, (1962), nr. 4 - 5, f. 187.

⁴⁰ Menduh Bamja, *Pozita Kushtetuese-Juridike dhe Faktike e Bashkësive Fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame*, Shoqata Kulturorë “Kur’ani”-Kosovë, Prizren, 2009, f. 378.

⁴¹ Deklaratë e Shejh Xhaferit Shehut - Junik më 11. VI. 2011.

këshillit organizues në vitin 1974 u mbajt kuvendi themelues për formimin e “Lidhjes së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” në Teqenë e Shejh Xhemailut-rufai në Prizren. Në mbledhjen themeluese morën pjesë shehlerë nga të gjitha tarikatet me ç’rast u zgjodh edhe kryetari Shejh Xhemaili, shehu nga tarikati rufai.

Pas formimit dhe konsolidimit të kuvendit themelues u bë aplikimi në organet kompetente, ku njëherit u pranua edhe statuti i organizatës me 68 nene i cili u miratua më 12 nëntor 1974, me përjashtimin e vetëm që mos të quhet “Lidhjen e Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee”, por “Bashkësia e Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” në Jugosllavi me arsyetimin se në një Lidhje duhet me qenë shumë bashkësi.⁴² “Bashkësia e Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” i zgjeroi rrjetin e aktivitetit të vet ku u formuan degët e saj në Republikën e Serbisë, Bosnjës e Hercegovinës, Maqedonisë dhe të Kroacisë, ku në secilën republikë u caktuan kryesuesit e degëve. Nën ombrellën e kësaj bashkësie me dymbëdhjetë rende të mëdha të pranura të dervishëve siç janë: raderi, rufai, saadi, bedevi, desuki, shahzeli, halveti, mevlevi, nakshibendi, bektashi, bajrami, sinani dhe kësaj bashkësie mund t’i bashkohen edhe rende të tjera të dervishëve.⁴³ Organizata në fjalë për herë të parë bëri legalizimin e të gjitha teqeve në Jugosllavi që ishin të anatemuara nga Bashkësia Islame dhe kualifikimin e njerëzve adekuat për udhëheqje të teqesë. Filluan të nxirrnin edhe revistën e tyre të quajtur *Buletini HU* që botohej në vitet ‘70 dhe vitet ‘80 në qytetin e Prizrenit.⁴⁴ Botimi i *Buletinit HU* ishte me karakter arsimor dhe kulturor për dervishët dhe dashamirët e jetës së dervishëve në islam, si dhe me përhapjen dhe afirmimin e principeve dhe rregullave të sufizmit (mistikes islame). Më 23 dhjetor të vitit 1984 me rastin e dhjetëvjetorit të formimit të “Bashkësisë së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee” u formua shoqata e shehlerëve “Meshajiheve” për Republikën e Serbisë - KSA të Kosovës me seli në Prizren në teqenë e rendit halveti të Shejh Nexhatit. Kryesia e punës së Kuvendit themelues të shoqatës e përbërë

⁴² Arkivi Teqeja e Madhe Amë e Tarikatit Aliee - Halveti në Junik më 11. VI. 2011; Nga mbledhja e përbashkët e BRDIA në RSFJ dhe Shoqatës së Meshajihve për RSS KSAK, Buletini “HU”, Bashkësia e Radhëve të Dervishëve Alije, Prizren, 1988-89, f. 11; Fjalimi i Shejh-UI Meshajihit, Haxhi Shejh Xhemali Shehu, me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të BRDIA në RSFJ dhe me rastin e themelimit të shoqatës Meshajihëve (Shehlerëve) të RS të Serbisë - KSA të Kosovës, Revista *Dervishi*, Prizren, korrik 1987, f. 11.

⁴³ Neni 3 i Statutit të Bashkësisë së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee, 12. IX. 1974.

⁴⁴ Biblioteka e Teqesë së Shejh Hakiut në Gjakovë.

nga: Haxhi Shejh Hamdi Tabaku-kaderi nga Peja, Shejh Nexhat Shehu-halveti nga Prizreni, Shejh Xhafer Shehu nga Juniku, Shejh Mehmed Ali Isniqi-nakshibendi nga Gjakova dhe Shejh Ajat Shabani-saadi nga Bujanoci. Me propozimin e kësaj, kryesia e zgjodhi për kryetar Shejh Xhafer Shehu nga Juniku, ndërsa për nënkryetar Haxhi Shejh Hamdi Tabaku-kaderi nga Peja si dhe Shejh Muhamed-halveti nga Mitrovica, sekretar Adri Hysejn Shehu-rufai nga Prizreni, ndërsa arkëtar Shejh Avdyl Kader Horosani-kaderi nga Prizreni.⁴⁵ Shoqata formuloi statusin e vetë dhe bëri kërkesë për regjistrim në organet kompetente, me ç'rast u pranua shoqatat dhe statusi i saj. Prej vitit 1984 shoqata "Meshajihëve" në kuadrin e "Bashkësisë së Radhëve të Dervishëve Islamë Aliee". Shoqata filloi të nxjerr revistën e vetë të quajtur *Dervishi*.⁴⁶

Në vitin 1987 kryetari i shoqatës "Meshajihëve" Shejh Xhafer mori iniciativën për herë të parë në Kosovë për aplikimin e kontratave për sigurime pensionale dhe invalidorë të nëpunësve fetarë të shoqatës së "Meshajihëve".⁴⁷ Tipari dallues i këtyre teqeve, të cilat ndodhen në Kosovë, është shumëllojshmëria e tarikateve, pjesë e së cilave janë. Veçanërisht teqetë në Gjakovë dhe Prizren, që u përkasin tarikateve të ndryshme, përbëjnë një të dhënë të rëndësishme për ta transmetuar, një pasuri sa i përket islamizimit të tyre. Tarikati halveti është ndër tarikatet më të rëndësishme, teqetë e së cilit tarikat ndodhen në Kosovë. Prej themelimit të teqeve e deri në ditët e sotme, si rajon i Dukagjinit po ashtu edhe Rrafshi i Kosovës me rrethinë luajnë një ndikim shumë të madh. Por, ndikimi i saj qëndron edhe sot e kësaj dite tek popullata e kësaj ane. Në Kosovë kanë qenë të ndërtuara monumente të ndryshme të karakterit të tillë. Ato diku më shumë e diku më pak, luajnë një ndikim shumë të fuqishëm. Ndërsa më vonë, në disa qytete kanë filluar të shkatërrohen duke mos thënë që nuk ekzistojnë fare. Si rezymim i krejt kësaj dhe konstatim përmbyllës, mund të thuhet se rendi halveti u proklamua në popull si krah i rezistencës kombëtare shqiptare, u

⁴⁵ Fjalimi i zotëri Shejh Xhafer Shehut-halveti, me rastin e zgjedhjes së tij si kryetar i shoqatës së Meshejihëve (Shehlerëve) për Republikën e Socialiste të Serbisë dhe Krahinën Socialiste autonome të Kosovës, Revista *Dervishi*, Prizren, korrik 1987, f. 17.

⁴⁶ Shejh Mehmed Ali Isniçi - nakshibendi, *Themelimi i Shoqatës së Meshajihëve (Shehlerëve) për RSS-KSAK*, Revista *Dervishi*, Prizren, korrik 1987, f. 19.

⁴⁷ Arkivi Teqeja e Madhe Amë e Tarikatit Aliee-Halveti në Junik; Buletini, Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të sigurimit pensional invalidorë të Kosovës, Nr:3-4, viti 1987, Prishtinë.

angazhua në format e ndryshme si: ushtarake, politike dhe kulturore për bashkimin etnik shqiptar, duke dhënë kontribut të vogël, por shumë të çmueshëm më shumë domethënie

Alban DOBRUNA

SUMMARY

THE HALVETI RITE AND THE NATIONAL ALBANIAN MOVEMENT

Halveti is the name given to the rite of Dervish which was founded on the territories of modern day Caucasus in the 14th century. The rite, as well as its followers, were called differently from the other Tariqat followers, because the rite of Halveti was more focused on the mystical system (self-isolation), or more specifically on the isolation and disconnectedness from all things related to the spiritual world within the confines of the Teqqe. The Halveti rite was initially spread in Bulgaria, Bosnia, Macedonia, Greece, Albania and elsewhere. Its activity gradually advanced with the strengthening of the Ottoman rule in this region of the Balkans. The main historical and social factor which led to the emergence and progression of the Halveti rite among Albanians is related to the establishment of Ottoman rule.

Considering that at the end of the 14th century numerous Halveti Teqqe were constructed in Shkodër, Berat, Korçë, Elbasan and Vlorë, we can argue that the followers of this rite had considerably increased in numbers. The evolution of this process was catalyzed more so during the 18th century, a century during which the Halveti Tariqat established congregations in other Albanian territories as well, such as: Prizren, Shkup, Gjakovë, Rahovec, Ohër, Strugë, Gostivar, Kërçovë etc. Throughout the development of the Dervish and Teqqe in Albanian lands, there were numerous Qutbs and Dervish who proved themselves influential in the cultural, historical and societal spheres. The Teqqe in general became a cradle of patriotic movements for national liberation. Some political issues in regards to the Albanian-Ottoman relations were also discussed in the religious meetings that took place there. The Halveti rite supported the national Albanian resistance and it engaged through various means in the fight for this cause, including through military initiatives, through political and cultural influence, giving thus a small but an important contribution for the cause.

KDU: 37(496.51-21)"1918/1941"
94(496.51-21)"1918/1941"

Skender LUTFIU

ARSIMI DHE KULTURA SHQIPTARE NË FERIZAJ(1918-1941)

Rrethanat politike në Kosovë ndërmjet dy luftërave ishin të pafavorshme për shqiptarët, ngase Mbretëria SKS-së e sapo formuar, ndiqte një diskurs politik që shkonte në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar, i cili më 1913 u copëtua padrejtësisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, ndërsa më 1918 territoret e shkëputura nga trugu i saj u futën në kuadër të kësaj mbretërie, e cila ndiqte interesat e popujve serb, kroat dhe slloven, në dëm të popujve të tjerë, konkretisht në dëm të atij shqiptar. Kështu, nga fundi i muajit shtator, në Kosovë hyri së pari ushtria franceze si aleate, për t'ia hapur rrugën ripushtimit të Kosovës nga forcat serbe, të cilat menjëherë synonin të organizonin pushtetin policorë dhe administratën. Për më tepër, qeveria serbe kishte për qëllim që krahas depërtimit të ushtrisë franceze të organizohet pushteti serb në qendrat më të mëdha administrative, në mënyrë që kur të arrijë ushtria serbe, pushteti vetëm të jetë i vendosur. Nga një raport të datës 14 tetor 1918 nga i deleguari i MPB-së së Qeverisë së Serbisë në Selanik kuptojmë se më 30 apo 31 tetor në Ferizaj u emërua përkohësisht nënprefekt i rrethit të Nerodimes, Marko Despotoviq.¹ Situata politike ishte mjaftë e rëndë për popullsinë shqiptare që mbeti jashtë Shqipërisë politike të vitit 1913, madje gjithnjë rëndohej në dëm të saj. Kështu, përveç organeve të ndryshme shtetërore, në vitin 1920 edhe organet ushtarake duhej të ndërmerrnin aksione jo vetëm kundër

¹ Limon Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Prishtinë: "Instituti i Historisë së Kosovës", 1981, f. 24.

Lëvizjes Kaçake, që ishte njëherit e vetmja forcë që e kundërshtonte me armë, regjimin e Mbretërisë së SKS-së², por edhe kundër popullit në përgjithësi. Këto veprime bëheshin në mënyrë që të realizohej dëbimi i shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore dhe të vendosen kolonët sllavë të cilët do të ndryshonin rrënjësisht strukturën e popullsisë.³

Shqiptarët, me gjithë pozicionin e tyre të pafavorshëm, në një masë të vogël u bënë pjesë e institucioneve shtetërore, ngase donin të përfaqësonin interesat e tyre kombëtare, sado që mundësit ishin fare minimale. Këtu do të japim të dhëna që përshkruajnë zgjedhjet parlamentare të vitit 1920, në qarkun e Kosovës, konkretisht në rrethin e Ferizajt. Kështu, në këto zgjedhje kanë kandiduar tri subjekte politike, si: Partia Demokratike, Partia Radikale dhe Partia Komuniste. Nga dymbëdhjetë vendvotime, dy në qytet dhe dhjetë të tjera në fshatrat e Ferizajt ku kanë votuar 3 609 votues. Nga këto zgjedhje në rrethin e Ferizajt fitues ka dalë Partia Demokratike me 1 972 vota, e cila pasohet nga Partia Radikale me 1 361 vota, ndërsa Partia Komuniste renditej e treta me vetëm 276 vota.⁴ Gjithashtu, duhet shtuar se në territorin e rrethit të Ferizajt numri i përgjithshëm i votuesve ishte 5 610, ndërsa në zgjedhjet parlamentare kanë dalë 3 609 votues, në përqindje i bie mbi 50%. Ndërsa, sa i përket përkrahjes së partive politike del se partia më e votuar, siç e theksuam më lartë në këtë territor ishte Partia Demokratike, e cila ndiqej nga Partia Radikale, ndërsa Partia Komuniste ishte dukshëm më pak e votuar. Për më tepër kjo parti në Ferizaj është themeluar që në maj të 1919, mirëpo pas presionit për ndërprerje të veprimtarisë së komunistëve nga pushteti borgjez ajo pushoi së vepruari, deri në shtator të vitit 1920, kur u mbajt Konferenca Themeluese në kafenenë “Beograd”, në qendër të Ferizajt.⁵ Por, këto subjekte politike, jo vetëm që nuk përfaqësonin interesat legjitime të popullit shqiptar, por ato punonin në dëm të çështjes së tyre. Vlen të theksohet se nuk kemi të dhëna sa i përket numrit të votuesve sipas përkatësisë etnike, fakt që ndikon në mungesën e të dhënave për pjesëmarrjen e shqiptarëve në këto zgjedhje. Mirëpo, kemi të dhëna për

² Në rrethin e Ferizajt ishin krijuar grupet e kaçakëve, të cilat udhëheqshin nga Ymer Devetaku, Rexhep Berisha, Bislim Tahiri etj.

³ L. Rushiti, *Lëvizja...*, f. 58.

⁴ Limon Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrative i Kosovës 1878-1941*, Prishtinë: “Instituti i Historisë”, 2004, f. 180-181.

⁵ Shaban Hashani, “PKJ në Ferizaj dhe rrethinë më 1919-1945”, *Vjetar*, nr. XXIV, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1988, f. 69-71.

emrat e shqiptarëve që u zgjodhën për deputetë popullorë. Kështu, për qarkun e Kosovës, ku hynë edhe rrethi i Ferizajt, deputetë shqiptarë u zgjodhën Ramush Osmani, bujk nga Gjilani, që përfaqësonte Partin Radikale dhe Bejtullah Rexhepi, bujk nga Sllatina e Epërme (komuna e Vitisë), nga Partia Demokratike.⁶

Pas këtyre zgjedhjeve, partitë politike borgjeze, për shkak të rivalitetit të tyre, ato në të shumtën e rasteve emëronin për kryetarë të komunave shqiptarët të cilët kishin autoritet në popull, në mënyrë që të përfitojnë votat e shumicës shqiptare. Kështu, në harkun kohor 1920-1936 për kryetarë të komunave në rrethin e Ferizajt (Nerodimes), janë zgjedhur këta shqiptarë: Ramë Bajraktari (komuna e Kosinës), Ahmet Sylejmani, Bajrush Sylejmani dhe Smajl Gorani (komuna e Shtimes), Sefë Llugaxhia (komuna e Babushit), Mulla Agushi (komuna e Gaçkës) dhe Tahir Sojeva (komuna e Talinovcit).⁷ Në zgjedhjet parlamentare të 18 marsit 192, njëra ndër subjektet që pati suksesin më të madh ishte Xhemjeti, me kandidatët e saj Mahmut Isaku dhe Tahir Hasani. Ky subjekt politik i vetmi që përfaqësonte interesat e shqiptarëve. Vlen të theksohet se nga 5 059 votuesve fitoi 2 980 vota, ose në përqindje 85.9%. Në zgjedhjet e 11 dhjetorit të vitit 1938, një kandidat tjetër shqiptar e hasim në listën e Bashkësisë Radikale Jugosllave. Ai ishte Iljaz Agushi, ish-anëtar i Xhemijetit, që në këto zgjedhje fitoi 3 509 vota. Ndërsa, Sejdi Ismajli u paraqitë në listën nga Partia Popullore Jugosllave, i cili fitoi vetëm 8 vota.⁸ Në anën tjetër në Ferizaj rinia komuniste ishte mjaftë aktive dhe veçohej ajo e cila ndiqte mësimet në Medresenë e Madhe të Shkupit. Këtë grup të rinjsh shqiptarë nga rrethi i Ferizajt e përbëjnë: Halit Ibishi, Fazli Obrazhda, Shaban Kajtazi, Idriz Ajeti-Gashi, Jakup Ramadani, Shefki Beqiri, Xhemajl Avdiu etj.⁹ Megjithatë, për shqiptarët, partia e cila i përfaqësonte më së miri ishte Xhemijet, e cila pushoi së vepruari si subjekt politik, ngase atë e shkatërroi qeveria më 1924, ndërsa kryetarin e saj Ferat Draga, e burgosi. Mirëpo, paria shqiptare në Kosovë dhe në territoret shqiptare në Maqedoni, edhe nën petkun e partive në pushtet, pra të Partisë

⁶ L. Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi...*, f. 192.

⁷ Shaban Hashani, *Ferizaj dhe rrethina 1873-1941 (Vështruar nga pikëpamja historike)*, Ferizaj: 1998, f. 274.

⁸ *Po aty*, f. 275-276.

⁹ Shaban Hashani, "Bashkimi i rinisë komuniste të Jugosllavisë (BRKJ) në Ferizaj dhe rrethinë 1919-1945", *Kosova*, nr. 8, Enti i Historisë së Kosovës - Prishtinë, Prishtinë, 1979, f. 202.

Radikale dhe asaj Demokratike, përfaqësonin interesat e bashkëkombëseve të tyre.

Rrethanat ekonomike në Ferizaj dhe rrethinë, ndërmjet dy luftërave botërore

Duhet të theksohet se në lindjen dhe zhvillimin e të gjitha fazave të qytetit të Ferizajt dhe rrethinës së tij, padyshim që rolin kryesor e ka luajtur ndërtimi i hekurudhës Mitrovicë-Shkup, e cila u lëshua më 1874, një vit pas datës së themelimit të Ferizajt. Kjo hekurudhë përmirësoi dukshëm infrastrukturën në tërë Kosovën, e në veçanti në rajonin e Ferizajt, nëpër të cilin kalon duke përfshirë shumë fshatra dhe vet qytetin që sot e “ndanë”, në dy pjesë thuajse të barabarta. Po ashtu, tregtia filloi të lulëzojë pas vënies në qarkullim të kësaj linje hekurudhore, që lidhte Kosovën me portin e rëndësishëm të Selanikut. Tani eksport-importi i Kosovës u fokusua kryesisht në relacionin veri-jug, pra drejt Selanikut, për dallim nga më parë kur tregtia bëhej kryesisht në relacionin lindje-perëndim drejt qytetit të Shkodrës.¹⁰ Duke qenë në një pozitë strategjike, Ferizaj dhe rrethina e tij, brenda një kohe të shkurtër u shndërrua në një pikë të rëndësishme tregtare.

Kështu, në këtë periudhë Ferizaj me gjithë vështirësitë nëpër të cilën po kalonte populli shqiptar në kuadër të Mbretërisë së SKS-së, pati një zhvillim të hovshëm. Këtë mund ta themi po të krahasojmë me vendbanimet e tjera të Kosovës. Në këtë periudhë Ferizaj shpallet qytet, dhe merr edhe emrin Uroshevac, sipas perandorit Urosh Nemanjiqit.¹¹ Mirëpo, vlen të theksohet se këtë toponim serb, shqiptarët nuk e pranuan asnjëherë. Për sa i përket zhvillimit të qytetit gjatë kësaj periudhe, vërehet një tendencë për zhvillimin e tij me plan urbanistik. Madje që në vitin 1924 qyteti fitoi planin e parë të rregullimit. Në harkun kohorë 1918-1941 në Ferizaj janë ndërtuar këto objekte publike: Shtëpia e Sokolave (tani ndërtesa e Teatrit Profesional “Adriana Abdullahu”), ndërtesa e Shkollës Filllore “Tefik Çanga”, ndërtesa e vjetër e postës më 1927, ndërtesa e Arkivit Ndërkomunal më 1928, ndërtesa e Shkollës Qytetare (Gjimnazi i vjetër), 1928-1930, ndërtesa e Konviktit të nxënësve më 1934, ndërtesa e Shtëpisë së Oficerëve, në të cilën sot është vendosur Qendra e Kulturës, ndërtesa e Kishës Katolike

¹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar III, Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 prill 1939*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 448.

¹¹ Këtë emër Ferizajt ia vendosi pushteti borgjezë serbë më 1914.

më 1929, Kisha Ortodokse Serbe “Car Uroshi” me kambanore më 1931 etj.¹² Po ashtu, në Ferizaj kanë ekzistuar katër hane të cilët kanë punuar deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Këta janë: Hani i Ferizit, Hani i Safetit, Hani i Ibrahim Boshnjakut dhe Hani i Sali Agës. Përveç tyre në Ferizaj ka pasur edhe hotele siç ishin hoteli “Kosova”, pastaj përball tij u vendos hoteli në ndërtesën më të lartë që kishte qyteti deri në atë kohë, e cila quhej “Kulla e Todorit”. Kjo kullë ka qenë në vendin ku sot ndodhet hoteli “Lybeten”, që lirishtë mund të themi se është simbol i qytetit të Ferizajt.¹³ Ndërmjet dy luftërave botërore, Ferizaj përjetoi një zhvillim ekonomik, ngase u hapën dyqane tregtare, zejtare etj. Vlen të përmendet se në Ferizaj ekzistonin 112 punishte zejesh.¹⁴ Po ashtu, Ferizaj kishte një central elektrik që ndriçonte qytetin.¹⁵ Prej objekteve industriale në Ferizaj ishin fabrika e tjegullave dhe e tullave e Ivan Videkut në fshatin Talinovc (1935), dhe ajo “Luboten” e Nikolla Gj. Nikoliqit, pastaj mulliri motorik i Sava Çiçkariqit, mulliri “Kosovo” i J. Popoviqit, centrali elektrik dhe xeherorja e kromit “Jezerina”.¹⁶ Kjo xeherore për nga rezervat e veta llogaritej si xeherorja e tretë e kromit në Jugosllavi. Banka e parë në Ferizaj u themelua pas luftërave ballkanike, kur nga fondi i kishës së Shën Uroshit u themelua Banka e Ferizajt, ndërsa më 1924 u themelua Banka Ekonomike e Ferizajt.¹⁷

Zhvillimi i arsimit shqip në Ferizaj dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave

Menjëherë pas ripushtimit të Kosovës dhe viseve të tjera më 1918, shqiptarët jo vetëm që bënë rezistencë dhe nuk u pajtua me faktin se ata do të bëhen pjesë e mbretërisë së sapoformuara, por ata kërkuar hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, kërkesa që parashtruan në mënyrë

¹² Ibrahim Hyseni (Goga), *Ferizaj 1873-19 (Që nga themelimi e deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore)*, Ferizaj, 2014, f. 16.

¹³ *Po aty*, f. 94.

¹⁴ Punishtet më të njohura të zejeve në Ferizaj ishin poçarët, bukëpjekësit, këpucëtarët, bojaxhinjtë, nallbanët-mbathtarët, terzinjtë, kasapët-mishtoret, berberët, zdrukthëtarët, plisaxhinjtë, etj.

¹⁵ Qemal Ratkoceri, Ruzhdi Marevci, *Shkollat në Komunën e Ferizajt*, Monografi, Ferizaj: “Shoqata Regjionale e Veteranëve të Arsimit “Zekeria Rexha”- Ferizaj”, 2007, f. 18.

¹⁶ Shaban Hashani, “Rrethanat ekonomike, kulturore dhe arsimore në Ferizaj dhe rrethinë (1918-1945)”, *Kosova*, nr. 12, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1983, f. 274.

¹⁷ *Po aty*, f. 278.

të organizuar nga ana e organizatës “Bashkimi” (Xhemjeti) si dhe nga Komiteti i Kosovës, drejtuar Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.

Për më tepër kjo mbretëri kishte marrë edhe detyrime ligjore, ngase megjithëse pa vullnetin e saj ajo nënshkroi më 1919 Traktatin për Mbrotjen e Pakicave. Pas nënshkrimit të këtij traktati, Jugosllavia u zotua që të siguronte shkollimin fillor në gjuhët vendëse në të gjitha rajonet, ku një përqindje e lartë e popullsisë kishte një gjuhë tjetër që dallohej nga gjuha serbo-kroate e cila ishte gjuhë zyrtare. Madje pakicat, sipas këtij traktati, kishin të drejtë që me shpenzimet e tyre “*të hapnin shkolla dhe institucione të tjera arsimore me të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre dhe për të gëzuar lirinë e të drejtës fetare*”.¹⁸ Nga kjo del se shqiptarët asgjë më shumë nga sa u zotua nga Mbretëria SKS-së nuk kërkuan, mirëpo këto kërkesa hasën në kundërshtim me qëllimet që kishte kjo mbretëri ndaj shqiptarëve, andaj ajo justifikonte veprimet e saj kundrejt kërkesave për hapjen e shkollave shqipe. Kështu, u hartua një urdhëresë prej 15 pikave të cilat duhet të plotësoheshin për të fituar të drejtën e hapjes së shkollës, e cila u nënshkrua nga Svetozar Pribiqeviqi. Madje një “arsye” kundër hapjes së shkollave private ishte se këto janë të panevojshme kur kishte shkolla shtetërore, edhe pse në to mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën serbo-kroate. Në fakt, parimisht pushteti aktual ishte kundër shkollave shqipe, mirëpo këto manovrime i bënte vetëm sa për të identifikuar se cilët shqiptarë angazhoheshin për emancipimin e tyre kombëtar që pastaj të kishte më të lehtë arrestimin dhe likuidimin e tyre.¹⁹

Arsye rreth mungesës së shkollave shqipe ishin të natyrave të ndryshme, sa thuhej se nëse një pakicë paraqet një kërkesë për hapjen e një klase, prej 25-30 nxënës, pushteti menjëherë merr vendim për hapjen e asaj klase me mësim në gjuhën e pakicës që e paraqet kërkesën. Për më tepër pushteti serb shprehej se mungesa e klasave ose shkollave shqipe ishte si rezultat që ata ende nuk kishin as doracak shkollor, as kuadër të personelit mësimor etj., andaj ata asnjëherë nuk kanë kërkuar hapjen e klasave në gjuhën shqipe. Por, kjo ishte një politikë diskriminuese ndaj shqiptarëve, sepse ishin pikërisht borgjezia serbe që mbylli të gjitha shkollat shqipe më 1919, pastaj arrestonte,

¹⁸ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: “Koha”, 2011, f. 345.

¹⁹ Hakif Bajrami, “Qëndrimi i Jugosllavisë Monarkiste ndaj Arsimit dhe Kulturës së Shqiptarëve në Kosovë (1918-1941)”, *Kosova*, Nr. 12, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1983, f. 199.

burgoste dhe keqtrajtonte çdo person që synonte të hapte një shkollë apo klasë shqipe.²⁰

Për gjendjen e vështirë të arsimit shqip Ferat Draga, kryetari i “Bashkimit” në një reagim në parlamentin e Mbretërisë së SKS-së, më datë 11 tetor 1923, për gjendjen e mjerueshme të shqiptarëve, në veçanti në fushën e arsimit nderë të tjera tha: *“Unë nuk jam turk, zotëri, unë jam për nga feja musliman, për nga kombësia jam shqiptar më i lashtë se ju në Ballkan [...], Ne shkolla nuk kemi edhe pse këtë Kushtetuta e garanton, ne nuk mund të hapim shkolla në gjuhën shqipe, për kundër asaj që Ligji na lejon...”*.²¹ Vlen të theksohet se në fillim kanë ekzistuar shkolla të posaçme për fëmijët shqiptarë, por ky lloj shkollash u suprimua gjatë viteve të 1920.²² Pra, si në gjithë Kosovën edhe në Ferizaj dhe rrethinë, gjendja e arsimit shqip ishte e mjerueshme. Kështu, objekti i parë shkollor është ndërtuar në vitin 1923, ku pas Luftës së Dytë Botërore mësimet i ka zhvilluar Shkolla Fillore “Ismajl Qemali” (Tefik Çanga).²³

Ndërsa, në vitin shkollor 1924/25 në Ferizaj u themelua Gjimnazi jo i plotë, që vazhdoi punën deri në vitin shkollor 1928/29, kur me Ligjin mbi shkollat e mesme më 1929 pushoi veprimtaria e tij. Në këtë shkollë i ndoqën mësimet gjithsej 594 nxënës, prej të cilëve vetëm 34 nxënës shqiptarë. Po ashtu, në vitet 1928-1930 në Ferizaj është ndërtuar objekti ku u hap shkolla e mesme që quhej Shkolla Qytetare, e që sot këtë objekt e shfrytëzon Shkolla e Mesme Ekonomike “Faik Konica”.²⁴ Mirëpo, si rezultat i masave të ashpra ndaj përpjekjeve për hapjen e shkollave shqipe gjatë gjithë periudhës në shqyrtim, kemi një përqindje tepër të lartë të analfabetizmit, jo vetëm në Ferizaj, por në tërë Kosovën. Kështu kjo përqindje në Ferizaj arrinte deri në 99%.²⁵ Pas vitit 1926 Ministria e Arsimit e Mbretërisë së SKS-së, për t’u hequr para ndërkombëtarëve si vend demokratik dhe kinse i trajton të barabartë të gjithë qytetarët e saj, hapi disa shkolla në Ferizaj dhe rrethinë, si në: Mirash, Slivovë etj. Mirëpo, mësimi në këto shkolla zhvillohej në gjuhën serbe nga mësimdhënësit serbë. Madje për të kryer katër klasat e ulëta, nxënësit shqiptarë duhet të shkonin në shkollë pesë vjet, pasi që

²⁰ Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), Koleksioni i Hakif Bajramit, Inventari 145 /LLF/, f. 2.

²¹ H. Bajrami, “Qëndrimi i Jugosllavisë Monarkiste...”, f. 202.

²² Sh. Hashani, *Ferizaj dhe rrethina...*, f. 297.

²³ I. Hyseni, *Ferizaj...*, f. 106.

²⁴ *Po aty*, f. 108.

²⁵ H. Bajrami, “Qëndrimi i Jugosllavisë Monarkiste...”, f. 213.

në vitin e parë e mësonin gjuhën serbe. Për më tepër, kalueshmëria e nxënësve shqiptarë ishte nën 50%, ndërsa edhe ata të cilët mbaronin katër klasat e fillores, ishin të rrallë që vazhdonin shkollimin e mëtutjeshëm për dy arsye kryesore, së pari ngase kushtonte shumë dhe se përzgjedhja ishte tejet rigoroze për shqiptarët.²⁶ Në harkun kohor 1920-1930, në rrethin e Nerodimes kishte 23 shkolla katërklasëshe, në të cilat mësimet i ndiqnin 3 063 nxënës.²⁷

Në këtë periudhë, përveç shkollave shtetërore, në të cilat mësimi jepej vetëm në gjuhën serbo-kroate, u hapën edhe shkollat fetare islamike, ku mësimi zhvillohej në gjuhën turke dhe shqipe, ndërsa shkollat jofetare të bashkësive të tjera gjuhësore përveç serbo-kroatishes, u ndaluan. Arsyeja pse pushteti në këtë periudhë mbështeste shkollat fetare myslimane ishte tendenca për ta fuqizuar identitetin religjioz, në dëm të ndikimit të ideve kombëtare shqiptare.²⁸ Për më tepër, me Ligjin e miratuar më 1936, mbi komunitetin islam në Jugosllavi favorizohej sistemi shkollor fetar, me çka shqiptarët myslimanë në fushën e arsimit fetar arritën një autonomi faktike. Kështu, sa i përket numrit të përgjithshëm të mejtepeve dhe të mualimëve në rrethin e Ferizajt mund të themi se ekzistonin 24 të tilla, 20 prej të cilave ishin dyvjeçare, ndërsa vetëm 4 prej tyre ishin njëvjeçare. Për më tepër numri i mualimëve ishte 20, ndërsa numri i përgjithshëm i fëmijëve ishte 1 112.²⁹ Në rrethin e Ferizajt mësuesi më i njohur i fesë ka qenë mulla Vesel Guta, i cili diplomoi në Medresenë e Mehmet Pashës në Prizren, ndërsa u punësua si mësues në mejtepin e fshatit Vojnovc të Shtimes,³⁰ pastaj mulla Azem Efenia, mulla Sylejman Idrizi, hafëz Shaban Vata etj. Në dokumentet e kohës ndër të tjera theksohet se: *“Te myslimanët (shqiptarët), ka qenë zakonë që fëmijët në moshën e hershme rinore t’i dërgojnë në sibian mejtepe [...]. Fëmija pasi ta kryente me sukses këtë, mund të regjistrohej në shkollë fillore shtetërore”*.³¹ Në trojet shqiptare përveç mejtepeve ekzistonin edhe

²⁶ Q. Ratkoceri, R. Marevci, *Shkollat...*, f. 10.

²⁷ Gani Rekaj, *Pellgu dardan i Nerodimes*, Ferizaj: “StarGraf”, 2013, f. 73.

²⁸ Oliver Jens Schmitt, Kosova, *Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë: “Koha”, 2012, f. 159.

²⁹ Haki Kasumi, “Shkollat Fetare Islame në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore”, *Gjurmime Albanologjike*, (Seria e shkencave historike), nr. XII – 1982, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1983, f. 163.

³⁰ Rrahim Hetemi, Januz Mustafi, *Historiku i Xhamive të Ferizajt me rrethinë (imamët dhe roli i tyre)*, Ferizaj: “DinoGraf”, 1434 - 2013, f. 36.

³¹ *Po aty*, f. 22-23.

medresetë, të cilat korrespondonin me arsimin e mesëm. Kështu, deri më 1931 numri i përgjithshëm i medreseve në territorin e Kosovës ishte tetë³², ndërsa në Ferizaj punonte vetëm një. Medreseja e Ferizajt punoi deri më 1939, kur planifikohej që në kuadër të reformimit të këtyre medreseve të krijohen vetëm 5 të tilla në qendrat ku kishte më shumë banorë myslimanë.³³ Në këtë medrese për vitin shkollor 1931/32 ishin të regjistruar gjithsej 51 nxënës, ndërsa sa i përket kuadrit vlen të theksohet se këtu ligjëroi për një kohë myderrizi Hasan Efendi Nahi. Për më tepër ai ligjëronte në gjuhën shqipe me gjithë kërcënimet dhe vështirësitë që iu paraqiteshin nga pushteti borgjez serb.³⁴

Përveç shkollave myslimane, ndërmjet dy luftërave në Kosovë kemi edhe shkolla katolike. Në vitin 1920, ekzistonin dhjetë shkolla të tilla, ku njëra prej tyre ishte në Ferizaj.³⁵ Për shqiptarët e krishterë (ortodoksë dhe katolikë), nuk mund të përdorej gjuha shqipe në mësimet e fesë që i merrnin kryesisht në kisha.³⁶ Me gjithë masat e ndërmarra nga Mbretëria jugosllave dhe vështirësitë nëpër të cilat po kalonte populli shqiptar, në Ferizaj dhe në rrethinë janë hapur shkolla pjesa dërmuese e të cilave ishin shkolla fillore katërklasëshe. Në harkun kohor 1919-1937 në rrethin e Ferizajt u hapën disa shkolla, të cilat do t'i paraqesim në mënyrë tabelore:

Në Ferizaj	1. Një Shkollë e Ulët Qytetëse, 2. Gjimnazi i Ulët Privat, 3. Një shkollë fillore, 4. Medrese.
Në komunën e Talinovcit	Janë hapur tri shkolla në fshatrat: Starosellë, Talinovc dhe Pojatishtë.
Në Komunën e Kosinës	Janë hapur dy shkolla, në: Slivovë dhe Kosinë.
Në Komunën e Nerodimes	Janë hapur tri shkolla, në: Nerodime, Pleshinë dhe Zaskok.
Në komunën e Shtimes	Janë hapur dy shkolla, në: Shtime

³² Numri i medreseve në Kosovë ishte dhjetë. Për më tepër rreth medreseve shih: Rr. Hetemi, J. Mustafi, *vep.cit.*

³³ Haki Kasumi, "Shkollat Fetare Islame në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore", *Gjurmime Albanologjike*, (Seria e shkencave historike), nr. XII – 1982, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1983, f. 164-165.

³⁴ Sh. Hashani, *Ferizaji dh rrethina...*, f. 300.

³⁵ *Historia e Popullit Shqiptar III...*, f. 490.

³⁶ ASHAK, Koleksioni i H. Bajramit, *Situata e pakicave...*, f. 12.

	dhe Muzeqinë.
Në komunën e Babushit	Janë hapur katër shkolla, në: Babushin Serb, në Gadime, Llugaxhi dhe Mirash.
Në komunën e Gaçkës	Ishte hapur një shkollë në Gaçkë. ³⁷

Në tabelën e mëposhtme do të paraqesim të dhëna rreth numrit të nxënësve në përgjithësi dhe të shqiptarëve në Gjimnazin e Ulët Privat në Ferizaj që funksionoi gjatë viteve 1924-1928.

Viti shkollor	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Numri i nxënësve shqiptarë
1924/25	60 nxënës	Një shqiptar
1925/26	170 nxënës	Pesë shqiptarë
1926/27	182 nxënës	Katërmëdhjetë shqiptarë
1927/28	182 nxënës	Katërmëdhjetë shqiptarë ³⁸

Sa i përket përqindjes së shqiptarëve në vijimin e mësimave në shkollat serbe, mund të konstatojmë që ishte fare i vogël, ngase ai kapte shifrën 6.5% të numrit të përgjithshëm, ndërsa numri i femrave shqiptare ishte tejet më i vogël, pra vetëm 0.5%.³⁹

Zhvillimi i kulturës shqiptare në Ferizaj dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave

Në harkun kohor 1918-1941 si në tërë Kosovën edhe në Ferizaj dhe rrethinë, me gjithë gjendjen e vështirë nëpër të cilën po kalonte populli shqiptar në kuadër të Mbretërisë së SKS-së, pati përpjekje që të zhvillohej edhe kultura, krahas zhvillimeve të përgjithshme. Shoqëritë e para amatore që u themeluan në Ferizaj luajtën rol të rëndësishëm në

³⁷ Sh. Hashani, "Rrethanat ekonomike...", f. 282.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ Lush Culaj, "Nën sundimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë (1912-1941)", *Kosova, Vështrim monografik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, f. 371.

zhvillimin e kulturës në këtë trevë. Por, mungesa e shqiptarëve në këto shoqëri dhe në përgjithësi në fushën e kulturës, dëshmon se kultura në rrethin e Ferizajt nuk pati zhvillim të madh në periudhën ndërmjet dy luftërave, për faktin se shqiptarët edhe pse ishin popullsi shumicë nuk merrnin pjesë në zhvillimin e saj. Andaj me të drejtë konstatojmë se vetëm elementi sllavë që ishte pakicë për nga numri nuk mund të zhvillonte kulturën në përgjithësi në një shkallë të kënaqshme, ndërsa për zhvillimin e kulturës shqiptare as që mund të bëhej fjalë.

Pra, në rrethin e Ferizajt shoqëria e parë korale ishte “Millosh Obiliqi” e themeluar më 1914, në gjirin e së cilës ishin 25 anëtarë. Më 1927 u themelua shoqëria e amatorëve serbë të dramës, ndërsa më 1932 u themelua kori i qytetit “Sveti Urosh” (Uroshi i Shenjtë).⁴⁰ Po ashtu, më 1937 në Ferizaj u themelua edhe shoqëria kulturo-artistike “Sharr”, e cila ishte shumë aktive dhe e cila ishte e vetmja në gjirin e së cilës kishte shqiptarë⁴¹. Në trevën e Ferizajt ishte e pranishme edhe veprimtaria e Organizatës së Rinisë Përparimtare Shqiptare “Drita”, anëtarë i së cilës nga rrethina e Ferizajt ishte hafëz Ymer Shemsu, imam i fshatrave Talinocv i Muhaxherëve dhe Sazli.⁴² Në Ferizaj ndërmjet dy luftërave botërore kanë vepruar edhe dy shoqata të femrave: Shoqata “Knjeginja Lubica” dhe “Kolo Srpskih Sestara”, si dhe Shoqata e Myslimanëve “Gajret”⁴³. Ndërsa sa i përket filmit, kemi të dhëna që shfaqja e parë filmike në Ferizaj u dha në vitin 1928, ndërsa duke filluar nga viti 1937 ato filluan të shfaqen rregullisht. Shfaqja e filmave bëhej në “Shtëpinë e Sokolave”, (tani Teatri Profesional “Adriana Abdullahu” S. L.).

Krijimi i institucioneve fetare në Ferizaj

Pas Luftës së Parë Botërore dhe formimit të Mbretërisë së SKS-së, si institucionet e tjera, po ashtu u bë edhe konstituimi i bashkësive fetare, në mesin e të cilave edhe Bashkësia Fetare Islame. Si rezultat gjatë vitit 1920 në Kosovë i gjejmë të formuara tri myftini të qarqeve (Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë) dhe 11 të rretheve. Në mesin e myftinjve të rrethit bënte pjesë edhe Myftinia e Nerodimes-Ferizajt, në krye të së cilës ishte myftiu Bajram Ademi.⁴⁴

⁴⁰ Sulltane Kojçini-Ukaj, “Rrethanat kulturo-arsimore në Kosovë 1937-1945”, Kosova, nr. 16, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1987, f. 160.

⁴¹ Sh. Hashani, “Rrethanat ekonomike...”, f. 283.

⁴² Sh. Hashani, *Ferizaj dhe rrethina...*, f. 301.

⁴³ *Po aty*, f. 302.

⁴⁴ Haki Kasumi, “Bashkësia Fetare Islame në Kosovë më 1918-1929”, *Vjetar*, nr. XII-

Po ashtu, nga viti 1933, në kuadër të Gjykatës Supreme të sheriatit me qendër në Shkup, hynte edhe gjykata e sheriatit e rrethit të Ferizajt, ku numri i gjykatësve ishte vetëm një dhe ai ishte Hajdar Ludviu.⁴⁵ Në Ferizaj përveç institucioneve fetare islame, që në fazën e parë të zhvillimit të tij janë ndërtuar edhe institucione fetare të krishtera, si kisha katolike dhe pas pushtimit të Kosovës respektivisht të Ferizajt nga forcat serbo-malazeze më 1912, edhe kisha ortodokse. Kështu, kisha katolike në Ferizaj është ndërtuar në vitin 1929, edhe pse në kohën e Perandorisë Osmane këtu ka funksionuar kisha e mëparshme katolike. Për më tepër, nga dokumentet që ruhen në këtë kishë del se që nga viti 1889 kisha ka kryer pagëzimin dh regjistrimin e fëmijëve të porsalindur. Ndër priftërinjtë më të njohur që kanë vepruar në Ferizaj janë: imzot Pashk Troshki, pastaj prifti apo famullitari i parë në Ferizaj Don Bartalome Fratelli dhe Don Tadej Ivani, si ndihmës i tij, më pas Nikollë Mazreku, Don Luigj Kurti, Don Shtjefën Kurti, Don Gaspër Gjini etj.⁴⁶ Ndërsa, sa i përket kishave ortodokse në Ferizaj dhe rrethinë, ndërmjet dy luftërave botërore, mund të përmendim vetëm kishën ortodokse serbe, e cila është ndërtuar në vitet 1928-1931, në pjesën e oborrit të Xhamisë së Madhe, të cilës iu konfiskua prona nga regjimi i atëhershëm serb.⁴⁷

XIII, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1981, f. 255.

⁴⁵ Haki Kasumi, "Bashkësia Fetare Islame në Kosovë (1929-1941)", *Vjetar*, nr. XVI-XVII, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1983, f. 100.

⁴⁶ I. Hyseni, *Ferizaj...*, f. 197.

⁴⁷ *Po aty*, f. 200.

Skender LUTFIU

SUMMARY

ALBANIAN EDUCATION AND CULTURE IN FERIZAJ (1918-1941)

The paper treats a complex problematic within its content. The paper includes a long historical period (1918-1941) regarding the history of Ferizaj and its vicinity, including the political, educational and cultural developments. The period between the two world wars in Kosova, particularly in Ferizaj and its vicinity, was a difficult time for the Albanian population. This came to be as a result of the political circumstances of the time which were in general disadvantageous towards Albanians. According to a political discourse as directed by the Serbian bourgeois, many problems resulted pertaining to the economical, cultural and educational nature, which prevented Kosova from developing similarly to the other regions of the Serb-Croatian-Slovenian Kingdom. Despite the hardships through which the Albanians went through, there were numerous tendencies that hinted towards general developments. It is of importance to stress the economical development of Ferizaj, although in a slow and incomparable rhythm in relation to the other regions of the SKS Kingdom. Such attempts in development were also noticeable in the realm of education and culture, which resulted with minimal success, but which nonetheless proved the decisiveness of the Albanian population to make ceaseless attempts to develop their country.

Eva BABAMETO

SOE NË SHQIPËRI: PËRPJEKJE PËR ORGANIZIMIN E KRYENGRITJES SË PËRGJITHSHME, 1940-1941

Me pushtimin e 7 prillit 1939, Shqipëria u bë një ndër viktimat e para të agresionit fashist. Është një fakt i njohur tashmë se Britania e Madhe e cila ishte qendra kryesore e lojës diplomatike gjatë Luftës së Dytë Botërore në shkallë botërore,¹ mbajti qëndrim tolerant dhe indiferent ndaj këtij pushtimi. Duke iu përmbajtur politikës së “paqëtimit” (appeasement policy) me fuqitë fashiste, ministri i Jashtëm, Lordi Halifax, në një raport të veçantë të mbajtur mbi ngjarjet në Shqipëri më 8 prill u shpreh se Shqipëria nuk duhet bërë një *casus belly*, një shkak për të shpërthyer luftën në Evropë,² duke synuar kështu që të evitohej përhapja e tensionit në arenën ndërkombëtare. Ndërkohë, edhe pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia, për një periudhë të konsiderueshme shqetësimi i Britanisë vijonte të mbetej përpjekja për mospërfshirjen e Italisë në luftë. Madje edhe nëse ka pasur konsiderata për nxitjen e rezistencës në Shqipëri, këto kanë qenë vetëm në funksion të politikës Britanike në rastin e mundshëm të hyrjes së Italisë në luftë. Kështu, kur në fillim të tetorit (1939) Kabineti i Luftës së Britanisë së Madhe diskutonte politikën e saj në Evropën Juglindore dhe u ngritën pyetje nëse do të kishte plane për të nxitur pakënaqësi në Shqipëri “në rast se Italia hynte në luftë si kundërshtarë” nuk pati reagime për një angazhim të tillë.³ Për më tepër, më 31 tetor 1939, Britania njohu *de*

¹Arben Puto, *Nëpër analet e diplomacisë Angleze: Politika e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore*; Tiranë: Albin, 2001, f. 12.

² Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), dokumente britanike PRO-FO 371, *Albania 1939*, procesverbal i mbledhjes së posaçme të qeverisë britanike mbi qëndrimin e saj kundër “aksionit italian” në Shqipëri.

³Elisabeth Barker, *British Policy in South East Europe in the Second World War*;

facto “statusin e ri” të Shqipërisë si territor i pushtuar nga Italia, përmes emërimit të Laurence Grafftey Smith si konsull i përgjithshëm në Durrës.⁴

Planet britanike dhe Shqipëria: 1940-1941

Pikërisht, në pranverën e vitit 1940 kur po bëhej e qartë se Italia do të hynte në luftë, britanikët vendosën të përdornin rezistencën shqiptare si objektin e eksperimentit të tyre të parë të inkurajimit të luftës guerile në EJT.⁵ Interesimi i Britanisë në këtë periudhë vjen jo nga Foreign Office (Ministria e Jashtme) por nga War Office (Ministria e Luftës) ku degët e organizatave të saj që vepronin në këtë kohë në territoret e Jugosllavisë dhe Greqisë, i kthyen sytë edhe nga Shqipëria,⁶ e cila përveç problemeve të saj të brendshme, do t’i duhej të përballej edhe me pretendime territoriale të shteteve fqinje - Greqia dhe Jugosllavia - të cilat për më tepër kishin më shumë peshë e rëndësi për politikën Britanike. Me shqyrtimin dhe hartimin e një plani bashkëpunimi për të inkurajuar shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë që t’i rezistonin pushtimit italian në këtë periudhë në Londër u morën Jo Holland, drejtuesi i MI(R) (dega e shërbimit të zbulimit ushtarak) dhe George Taylor, drejtuesi i zyrës së Ballkanit të seksionit D të SIS (shërbimit inteligjent).⁷ Agjentët kryesorë që u përfshinë në përgatitjen dhe organizimin e rezistencës në Shqipëri ishin: kolonel Walter Francis Stirling në Stamboll, nënkolonel Dayrell Oakley-Hill dhe kapiten Julian Amery në Beograd, major R.T. Cripps në Kajro dhe Margaret Hasluck në Athinë.⁸ Qendra e planifikimit për Shqipërinë u zhvendos nga Londra në Beograd, ku kishte një komunitet të mërguarish shqiptarë, me të cilët mund të mbaheshin kontakte. Përfaqësuesi kryesor i seksionit D në Beograd ishte Julius Hanou, pseudonimi i të cilit ishte “Cezar”.⁹ Po si funksiononte ky seksion dhe çfarë roli do të luante për Shqipërinë?

London: 1976, f. 47-48

⁴Po aty.

⁵Bernd Fischer, *Resistance in Albania during the SWW: partisans, nationalists and the SOE*, East European Quarterly, XXV - No. 1, March 1991, f. 22.

⁶Arben Puto, *Nëpër analet ...*, vepër e përmendur, f. 31.

⁷Owen Pearson, *Albania in Occupation and War: from fascism to communism: 1940 - 1945*, London; New York: Centre for Albanian Studies; I.B Tauris: 2005, f. 5.

⁸Po aty.

⁹Julian Amery, *Bijtë e Shqipes: studim i luftës guerile*, London: Macmillan Co, 1948, f. 45.

Në Ditarin e Luftës të SOE sqarohet se seksioni D ishte “në thelb një armë e mësymjes”. Pra, qëllimi i tij ishte “tërësisht afatshkurtër dhe oportunist”. Veprimet merreshin kur dhe ku të ishte e mundur, ndërsa politika e qeverisë së madhërisë së tij dhe e përfaqësuesve të tij nuk merreshin gjithmonë në konsideratë. Foreign Office ishte pjesërisht përgjegjëse pasi puna e seksionit D duhej të mbahej tërësisht e veçuar nga misionet diplomatike.¹⁰

Ky seksion u ngarkua me studimin e gjendjes në Shqipëri, kushtet e përgjithshme që mbretëronin aty, grupazhet e ndryshme dhe udhëheqësit kryesorë të tyre, si dhe me përgatitjen e planeve të ardhshme operacionale. Agjentët e caktuar në Beograd studiuan mënyrat dhe mjetet për të kontaktuar me përkrahës të fuqishëm në Shqipëri. Pikërisht për këtë veprim delikat, ata u këshillua me Jovan Gjonoviçin, që ishte njëkohësisht edhe mik i madh i aleatëve. “Ai kishte dijeni të plotë për të traditën zakonore - shprehet kapiten Amery - dhe prej tij mësova për kushtet e përgjithshme që mbretëronin në Shqipëri, diçka mbi grupazhet e ndryshme dhe udhëheqësit më kryesorë”.¹¹ Sipas kapiten Amery, faza e parë e misionit u plotësua me ngritjen e një sistemi të efektshëm korrierësh prej Shqipërisë nga Shkupi, Selaniku dhe Athina, të cilët sillnin informata për gjendjen e brendshme. Brenda 6 javëve filluan të merrnin raporte të rregullta nga të gjitha anët e Shqipërisë, të cilat tregonin se populli nuk duronte dot qeverisjen e huaj dhe ushqente ndjenja miqësore ndaj aleatëve, megjithëse ende nuk ishte i sigurt në fitoren e tyre.¹² Bazuar në këto raporte u konkludua se perspektiva ishte e mirë për incidente dhe për një kryengritje të përgjithshme në lindje të Shqipërisë, veçanërisht në territorin e fiseve të Mirditës.¹³ Grupi që do të operonte në këtë zonë ishte planifikuar të përpiqej për ndërmarrjen e sabotazheve dhe ndonjë aksioni të vogël. “Kur të piquej situata dhe rrethanat të ishin të përshtatshme - kujton Hill - do të punonim për një kryengritje të përgjithshme të mbështetur nga një Jugosllavi neutrale”.¹⁴

¹⁰ Roderick Bailey, *“The Wildest Province: SOE in the Land of Eagle”*, Vintage Books, f. 17 - 23.

¹¹ Julian Amery, *Bijtë e Shqipes ...* f. 48.

¹² Elisabeth Barker, *British Policy ...* f. 48.

¹³ *Po aty*.

¹⁴ Dayrell Oakley-Hill, *Një Anglez në Shqipëri: Kujtime të një oficeri Britanik: 1929 - 45*, Tiranë, Koci: 2006, f. 138 - 141.

Në këtë periudhë ndodh një ngjarje me rëndësi politike: më 10 qershor 1940, Italia u deklaroi luftë aleatëve.¹⁵ Ajo që ishte ndjerë prej kohësh tashmë u bë fakt i kryer. Brenda muajit, qeveria e Britanisë bëri një deklaratë në Dhomën e Komuneve, me anë të së cilës, ajo “rezervonte të drejtën për liri të plotë veprimi kundrejt çdo lloj angazhimi që ajo kish marrë më parë ndaj qeverisë italiane lidhur me zonat e Mesdheut, Afrikës Veriore e Lindore dhe Lindjen e Mesme”.¹⁶ Por, FO bënte të ditur se kjo nuk përfshinte njohjen e pavarësisë së Shqipërisë.¹⁷ Me angazhimin e hapur të Italisë në luftë, në mënyrë të natyrshme, Britania reagoi menjëherë duke ndryshuar qëndrimin e saj; por a ndikoi kjo situatë në pozicionimin e Britanisë ndaj Shqipërisë? Duhet thënë se megjithëse Italia kishte hyrë në luftë, strategjitë e britanikëve mbetën të fokusuara në mbajtjen sa më gjatë të luftës jashtë Ballkanit.¹⁸ Gjithashtu, Anglia nuk e ndryshoi qëndrimin e saj as ndaj aneksimit të Shqipërisë. Po kjo situatë vazhdoi edhe kur Zogu mbërriti në Angli dhe për rrjedhojë duhej përcaktuar qëndrimi ndaj tij; Zogut me këtë rast, iu komunikua se nuk mund të zhvillonte asnjë aktivitet politik në territorin e Britanisë së Madhe.¹⁹ Që nga kjo periudhë ndërmjet ekspertëve të ndryshëm pati diskutime të zjarra lidhur me përdorimin ose jo të figurës së Zogut për stimulimin e rezistencës shqiptare. Mbreti Zog u lejua të qëndronte në Angli, por me kusht që të konsiderohej si person privat duke mos i njohur statusin zyrtar të monarkut të ligjshëm. Arsyet e këtij qëndrimi janë kërkuar tek imazhi i dobët i figurës së Mbretit Zog dhe i qeverisjes së tij në Shqipëri, tek mungesa e interesave britanike për çështjen shqiptare në raport me vendet fqinje të saj, Greqinë e Jugosllavinë, si dhe tek mungesa e unitetit të faktorit shqiptar.²⁰ Në fakt siç e treguan edhe ngjarjet e mëvonshme Zogu nuk u trajtua thjesht si person privat në Angli; vlen të përmendim këtu rastet kur vetë Foreign Office e konsideronte në momente të caktuara

¹⁵ Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar: 1939 - 1949*, Tiranë: Globus R., 2007, f. 39.

¹⁶ Arben Puto, *Nëpër analet ...* vepër e përmendur, 2001, f. 30; Kjo frazë kishte për qëllim të tërhiqte njohjen e pushtimit të Shqipërisë që qeveria britanike i kishte dhënë Italisë pak muaj më parë. Prej kësaj kohe, deri në fund të 1942, diplomacia angleze do të bëjë mjaft projekte e plane lidhur me Shqipërinë, por pa angazhuar veten për pavarësinë e saj pas lufte.

¹⁷ Elisabeth Barker, *British Policy ...* f. 49.

¹⁸ Roderick Bailey, “*The Wildest Province ...*” f. 22.

¹⁹ Arben Puto, *Shqipëria Politike: 1912 - 1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 678.

²⁰ Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: Klean, 2015, f. 16.

përfshirjen e tij në planet dhe projektet politike lidhur me Shqipërinë në rast keqësimi të gjendjes në frontin grek a po të mundësisë së një ndërhyrjeje gjermane në Ballkan.

Me gjithë këto zhvillime, pas përpjekjeve të bëra, në fund të qershorit 1940 seksioni D shpresoi se do të nxiste revoltën nga Jugosllavia dhe për këtë qëllim kërkoi para për të blerë 5 000 pushkë të vjetra.²¹ Por, kryekomandanti për Lindjen e Mesme, gjenerali Archibald Wavell tha se “nuk donte aspak që të nxitej një kryengritje në Shqipëri në atë moment”.²² Thelbi i pikëpamjeve të Wavell sipas njerëzve të SOE në Kajro ishte se një revoltë e përgjithshme do të kërkonte ndihmë substanciale të cilën ai nuk mund ta ofronte meqenëse sipas tij, prioritet u duhej dhënë grekëve.²³ Në diskutimet e 2 korrikut 1940 në Foreign Office u vendos që propaganda për Shqipërinë të fillonte, por ajo “do të ndiqte një vijë relativisht të mesme” me qëllim që të mos shqetësonte qeveritë jugosllave dhe greke.²⁴ Në këto rrethana, më 5 korrik 1940 seksioni D i SIS mori udhëzime në zyrën e tij në Beograd se akoma nuk duhej të bënin asgjë që të shkaktonte shqetësime kundër italianëve në Shqipëri, por të mbanin lidhjet e tyre me nacionalistët shqiptarë dhe të vazhdonin t’i subvenciononin ato.²⁵ Duke pasur parasysh se Britania nuk e konsideronte Shqipërinë si një vend me rëndësi për politikën e saj, nuk donte të angazhohej për pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë, ishte më e ndjeshme ndaj interesave dhe pretendimeve të shteteve fqinje të Shqipërisë, madje të mos shqetësonte italianët pushtues në Shqipëri, rezultati aktual i përpjekjeve të bëra për një kryengritje të përgjithshme nisur nga Jugosllavia ishte i pritshëm. Në përputhje me programin e reformave²⁶ të politikës britanike për nxitjen dhe zhvillimin e veprimeve minuese në Ballkan, në korrik 1940, Churchill i propozoi Ministrit të Luftës Ekonomike, lordit Dalton, të krijonte një forcë të re që do të përfshinte disa seksione dhe në veçanti seksionin e luftës jokonvencionale e cila do të përfshinte spiunazhin, sabotimin dhe ndihmën për popullsinë lokale në krijimin e një lufte guerile ndaj ushtrisë së rregullt gjermane.²⁷ Në zbatim të kësaj porosie, Daltoni

²¹ Elisabeth Barker, *British Policy ...* f. 49.

²² Reginald Hibbert, *Lufta nacionalçlirimtare shqiptare: Fitorja e hidhur*, London, New York, Pinter: 1991, f. 75.

²³ Roderick Bailey, “*The Wildest Province ..*” f. 29.

²⁴ Beqir Meta, *Tensioni*,... vepër e përmendur, f. 329.

²⁵ Owen Pearson, *Albania in Occupation ...* f. 12 - 13.

²⁶ Kim Philby, *Lufta ime e heshtur*, Onufri, Tiranë: 2004, f. 25.

²⁷ Gazeta Shqiptare, nr. 4709, 1 Tetor 2009, f. 24 - 25.

formoi organizatën e quajtur SOE (Special Operation Executive-Drejtoria e Operacioneve të Posaçme). Fillimisht, ajo u nda në tri degë: SO-1, për “propagandën e zezë”, SO-2 për sabotazh e diversion, dhe SO-3 për planizim. SO-1 më vonë u quajt Drejtoria e Luftës Politike, kurse SO-2 mori emrin që mbante në fillim e gjithë organizata, SOE. SO-3 mbeti në letër dhe mbylli ekzistencën e saj pa lavdi.²⁸ Pra, seksioni që do të drejtonte veprime të fshehta në Ballkan, veçanërisht sabotime dhe diversione ishte SO-2 apo siç u quajt më vonë SOE. Ajo u vendos nën kontrollin e ministrit të Luftës Ekonomike, Hugh Dalton. Por, SOE kishte gjithashtu autonomi dhe fuqi të konsiderueshme. Ekzistenca e saj ishte shumë sekrete, emrat e saj ishin të panjohur dhe vepronte jashtë kontrollit parlamentar si dhe financohej nga fonde sekrete.²⁹

Si e tillë, kolonel Stirling mendonte se SOE ishte “mjete ideal” për të inkurajuar rezistencën në Shqipëri: duke mos qenë organ ushtarak, SOE nuk kishte skrupuj, dhe nëse është e nevojshme, operacionet e saj mund të mohoheshin me një betim. Por, SOE nuk kishte autoritetin të shfrytëzonte Zogun në planet e saj ose të garantonte Pavarësinë e Shqipërisë.³⁰ Ndërkohë Musolini po i zbulonte aleatit të vetë, Hitlerit, planet e tij ofensive në Ballkan. Duke iu referuar “Documents on German Foreign Policy” Jacomoni shkruan se në një bisedë që Musolini ka patur me Hitlerin më 7 korrik 1940, ishte shprehur se Italia e quante të nevojshme të niste pushtimin e ishujve grekë të detit Jon dhe se sipas tij, mendonte se çështja jugosllave do të merrte fund brenda një muaji. Hitleri e shikonte shtrembër nismën luftarake kundër Jugosllavisë, por i jepte dorë të lirë Italisë për një veprim kundër Greqisë.³¹ Musolini nxitonte të përmbushte synimet e tij ekspansioniste në Greqi e Jugosllavi edhe si kundërpeshë ndaj aleatit të tij “Gjermanisë”, me qëllim që ky i fundit të mos jetë në pozitë parësore në ndarjen e zonave të influencës pas fitores së mundshme të Boshtit. Në funksion të kësaj politike, Italia nxitoi me hapa të tjerë për përgatitjen e terrenit. Konkretisht, më 28 korrik 1940 qarkullonte një hartë italiane e vendosur në dyqane dhe kafene ku tregonte pjesë të mëdha të Greqisë dhe Jugosllavisë të përfshira në “Shqipërinë e

²⁸ Kim Philby, *Lufta ime ...* f. 25, Qëllimi i SOE sipas fjalëve të Churchill ishte ndezja e zjarrit në Europë.

²⁹ Roderick Bailey, “*The Wildest Province ...* f. 17-23

³⁰ *Po aty*, f. 24.

³¹ Francesko Jacomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri, (Mëkëmbës i Viktor Emanuelit III në Shqipëri)*, shtëpia botuese “55”, Tiranë 2005, f. 228

Madhe”.³² Më pas, më 25 gusht 1940, me pretekstin se po mbronin minoritetin e shtypur shqiptar në Greqi, Italia filloi të shtonte numrin e ushtarëve në Shqipëri. Nga 70 000 trupa në kufirin greko-shqiptar në periudhën e verës tashmë deklaroheshin 130 000 të tillë dhe pritej që ky numër të arrinte në 150 000 vetë.³³

Në dritën e këtyre zhvillimeve, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zinte Greqia në sferën e saj të interesave natyrshëm pritej që edhe Britania të rriste “vëmendjen” e saj dhe të ripozicionohej. Nga fundi i gushtit kryekomandantit për Lindjen e Mesme iu paraqit një program për veprimet lidhur me Shqipërinë dhe këtë herë ai e miratoi atë (programi lidhej me studimin e mundësisë për të rekrutuar agjentë që mund të fusnin lëndët shpërthyes brenda në Shqipëri, për t’i pasur të gatshëm që të përdroreshin kundër italianëve në rast të një sulmi italian të Greqisë).³⁴ Ky program do të kontrollohej nga përfaqësuesi në Stamboll, kolonel Stirling,³⁵ i cili gjithashtu parashikonte që luftimet aktuale të bëheshin nga malësorët e pjesës verilindore dhe qendrore të organizuar rreth Gani Kryeziut. Nisur nga këto zhvillime edhe Foreign Office, e shqetësuar nga kërcënimi i Italisë kundër Greqisë, në gusht 1940 nisi të interesohet për mundësinë që t’u shkaktonte trazira italianëve në Shqipëri.³⁶ Seksioni D tashmë u shndërrua në SO-2 i SOE dhe Dayrell Oakley Hill u caktua drejtuesi i qendrës në Beograd.³⁷ Thelbi i misionit të kësaj organizate në Shqipëri në këtë periudhë ilustruhet më së mirë në fjalët e thëna nga vetë drejtuesi i organizatës. “Ne nuk kishim urdhra formale apo të detajuara - thekson Hill - përveç një letre të përgjithshme për të punuar që të frynte sa më shumë erë, të ishte e mundur kundër italianëve anembanë Veriut”.³⁸ Në funksion të kësaj politike, shërben memorandum i datës 15 shtator 1940 i quajtur “Shqipëria”, ku Dixon, sekretar i Jashtëm i FO, deklaroi se pas bisedimeve të fundit me SOE u vendos një politikë më e avancuar në Shqipëri, në lidhje me shkaktimin e trazirave kundër italianëve. Aktet subversive përfshirë edhe formimin e komiteteve të fshehta shqiptare ... të cilat do të ishin në duart e SOE.³⁹ Megjithatë nuk të çudit fakti se

³² Owen Pearson, *Albania in Occupation* ... f. 15

³³ *Po aty*, f. 38.

³⁴ Reginald Hibbert, *Fitorja*... f. 75.

³⁵ Elisabeth Barker, *British Policy* ... f. 49.

³⁶ Reginald Hibbert, *Fitorja*... f.76.

³⁷ Owen Pearson, *Albania in Occupation* ... f. 15.

³⁸ Dayrell Oakley-Hill, *Një Anglez* ... f. 138 - 141.

³⁹ Owen Pearson, *Albania in Occupation* ... f. 38.

ende në këtë fazë zhvillimesh, në një protokoll të 18 shtatorit 1940, Dixon ka shënuar se derisa kishte mbështetur miratimin e FO që të ecej përpara me përgatitjen e planeve për veprime subversive në Shqipëri, “italianëve nuk u duhej dhënë një pretekst për të sulmuar Greqinë”.⁴⁰

Për pasojë, ndërkohë që shprehte hapur ndjeshmërinë ndaj Greqisë dhe interesave të saj në këtë periudhë, Foreign Office vazhdonte të kundërshtonte çdo rol të Zogut në planet e rezistencës. Po në shtator, FO i telegrafoi Kairos ku motivonte qëndrimin e saj duke shënuar se, për shkak të armiqve të shumtë të Zogut dhe faktit që besnikët e tij ishin diskretituar, nuk kishte të ngjarë që ai të luante ndonjë rol të dukshëm. Gjithashtu, Foreign Office refuzoi sugjerimin e seksionit D, që Zogu të dërgonte një letër ku t’i jepte pëlqimin e tij për një komitet shqiptar që do të formohej në Stamboll.⁴¹ Arsyet e këtij qëndrimi janë të qarta: Foreign Office këmbëngulte kundër Zogut sepse nuk donte të angazhohej në rivendosjen e pavarësisë në Shqipëri dhe gjithashtu të mos “ngacmonte” ndjeshmërinë e grekëve për këtë çështje. Një moment tjetër me rëndësi të madhe në zhvillimet politike të Luftës së Dytë Botërore dhe njëherësh pikë kthese dhe akt tronditës botëror shënoi Pakti Trepalësh Gjermani, Itali dhe Japoni më 27 shtator 1940.⁴² Rrjedhimisht, kjo situatë ndikoi, ndërmjet të tjerash, që politikanët britanikë të rishqyrtonin edhe përdorimin e figurës së Zogut në teatrin e luftës. Pikërisht në këtë periudhë, në disa takime midis përfaqësuesve të Foreign Office dhe War Office u arrit në konkluzionin që Zogu mund të shërbente si “pikë bashkimi” (*rallying point*) e gjithë forcave të rezistencës brenda dhe jashtë Shqipërisë.⁴³ Ky ndryshim në qëndrimin ndaj Zogut duket se ishte në përputhje me situatën aktuale politike që po kalonte Britania e Madhe në një shkallë më të gjerë në atë periudhë. Vetë britanikët në vjeshtën e vitit 1940 po ndienin një nevojë psikologjike dhe strategjike për aleatë në Evropën Juglindore. Që prej qershorit të 1940, ato ishin lënë jashtë Evropës pas disa humbjes pak a shumë poshtëruese dhe kthimi i tyre në kontinent apo edhe angazhimi i ushtrisë gjermane në tokë dukej i largët. Thirrja e grekëve për t’i rezistuar Italisë dhe më pas Gjermanisë - shprehet Barker më tej - ishte pikërisht ajo çka Britanikët po kërkonin në atë periudhë.⁴⁴ Ndërkaq, më

⁴⁰ Reginald Hibbert, *Fitorja...* f. 76.

⁴¹ Elisabeth Barker, *British Policy ...* f. 49.

⁴² Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare*, VI, Geer: 2005, f. 280.

⁴³ Arben Puto, *Nëpër analet ...* f. 31,

⁴⁴ Elisabeth Barker, *British Policy ...* f. 99, Që prej Tetorit 1940, kërcënimi i pushtimit po binte. Britanikët po luftonin italianët në Afrikën e Veriut por jo ushtrinë gjermane.

15 tetor 1940 paradite në zyrën e Duçes në Palazzo, Venecia u bë mbledhja historike në të cilën zyrtarët më të lartë fashistë diskutuan planin përfundimtar të sulmit kundër Greqisë.⁴⁵

Në diskutimet e bëra u shprehë frika se mos Britania mund të ndihmonte grekët. Por, Musolini i bindur për mospërfshirjen e britanikëve i kundërshtoi këto zëra. “Jam absolutisht i sigurt - thekson ai - që ata nuk do të dërgojnë trupa”.⁴⁶ Optimist për fitoren e tij në këtë sulm, siç do të dëshmohej së shpejti, duket se Musolini nuk i kishte bërë llogaritë mirë. Nga ana tjetër, ai nuk vuri në dijeni për përgatitjet që po bëheshin as aleatin e vet Gjermaninë. “Hitleri më vë gjithmonë përpara faktit të kryer, i thoshte me mllef Musolini Kontit Ciano vetëm pak ditë para sulmit, por këtë herë, unë do t’ia shpërblej me të njëjtën monedhë: do ta mësojë nga gazeta që pushtova Greqinë”.⁴⁷ Madje edhe kur Musolini vendos që të njoftojë Hitlerin për aksionin e afërt, përsëri ai është i vendosur të mos saktësojë as forcën e as datën - “druhet se i vjen edhe një herë alt”, shkruan Ciano më 22 tetor.⁴⁸ Duhet thënë se në agresionin italian kundër Greqisë, ndihmoi në mënyrë të fuqishme edhe ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë me qendër në Romë e cila financoi këtë sulm të Italisë në dëm të popullit shqiptar. Ajo vuri në dispozicion të fuqive të armatosura italiane bankënota shqiptare për t’u përdorur në Greqi.⁴⁹ Më 28 tetor, italianët pa provokim sulmuan Greqinë.⁵⁰ Në mënyrë të natyrshme, ndryshe nga ç’kishte ndodhur me Shqipërinë,

⁴⁵ Ilir Ikonimi, *Faik Konica: Jeta në Washington*, Onufri, Tiranë, 2011, f. 271 - 272.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë Shekullit XX*, shtëpia botuese “ideart”, Tiranë: 2004, f. 215.

⁴⁸ Gaetano Ciano, *Ditari i Kontit Ciano, Shqipëria*, shtëpia botuese “albin form”, Tiranë: 1994, f. 65.

⁴⁹ *AMPJ*, v. 1941, dos. 179, f. 100, Masa të njëllajta si me financimin e agresionit italian kundër Greqisë u morën dhe për financimin e agresionit kundër Jugosllavisë. Përveç këtyre, pas okupacionit të një pjesë të Jugosllavisë më 1941, Banka hapi degët e saj për të forcuar okupacionin dhe për të armiqësuar popullin shqiptar me popullin jugosllav. Ndryshimi i faktit të luftës nuk i la rast ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë të vërë në zbatim projektet e saj.

⁵⁰ Peace and War United States Foreign Policy, 1931 - 1941, Documents, Department of State Bulletin, vol. IV, p. 85 *Statement by the Secretary of State Before the Committee on Foreign Affairs, House of Representatives, January 15, 1941*, Government Printing Office, 1943, fq 612-614,

Site: <http://ibiblio.org/hyperwar/Dip/PaW/index.html>, Në këtë deklaratë sekretari i Shtetit tha se Italia u bashkua në luftë në anën e Gjermanisë me qëllimin e hapur për të marrë pjesë në rimodelimin e “rendit të ri” të krijuar me përdorimin e pakufishëm të forcës së armatosur.

reagimi i Britanisë në mbështetje të Greqisë ishte i menjëhershëm dhe i pritshëm. Nga Londra u transmetua një mesazh i mbretit George VI për mbretin e Greqisë ku thuhej: “jemi me ju në këtë luftë, kauza juaj është kauza jonë”. Dhe të njëjtën ditë Churchill i dërgoi një mesazh Metaksait: “ne do t’ju japim të gjithë ndihmën tonë”.⁵¹

Britania po përfshihej në teatrin e Evropës Juglindore. Dhe ishte pikërisht sulmi i Musolinit në Greqi, që solli perspektivën e ndërhyrjes Britanike në Evropën Juglindore.⁵² Në këtë periudhë aeroplanët e RAF (Royal Air Force-Forca Ajrore Mbretërore) u dukën në Greqi dhe lajmet e një ekspedite forcash britanike, çuan në Ballkan në nismat e aksioneve. Sulmi i parë u zmbrops me humbje të mëdha dhe Grekët kundërsulmuan menjëherë. Grekët përparuan në pjesën veriore të Shqipërisë dhe më 22 nëntor 1940 morën Korçën. Nga fundi i vitit ofensiva e tyre i kishte detyruar italianët të tërhiqeshin rreth 30 milje gjatë gjithë kufirit shqiptar. Për disa muaj, 27 divizione italiane u mbërthyen në Shqipëri duke pasur përballë 16 divizione greke.⁵³ Sulmi italian dështoi. Këto zhvillime ndikuan pa dyshim edhe tek shqiptarët. Humbja e italianëve dhe angazhimi i trupave britanike në mbështetje të Greqisë, ndezën shpresa në mes tyre. Ata besuan se kishte ardhur ora e çlirimit të vendit të tyre.⁵⁴ Megjithatë shpejt kjo shpresë do të shuhej tek shqiptarët. Në sulmin italian kundër Greqisë, dezertimet masive të ushtarëve shqiptarë nga fronti u bënë të shpeshta. Shembullin e dha batalioni shqiptar “Tomorri”. Trupat italiane që ndodheshin në prapavijë në Shqipëri sulmoheshin në rrugë dhe në kazerma. Në qytet organizoheshin demonstrata masive me kërkesën për ta ndërprerë këtë luftë të çmendur që dëmtonte Shqipërinë,⁵⁵ gjë që ishte në mospërputhje të plotë me atë çka deklaroi Jacomoni në mbledhjen e 15 tetorit.

⁵¹ Elisabeth Barker, *British Policy...*, vepër e përmendur, f. 100.

⁵² Winston Churchill, *The Second World War*, Volume III, The Grand Alliance, Houghton Miffling Company Boston, 1950, f. 147.

⁵³ Winston Churchill, *The Second ...*, Volume II, Their Finest Hour, f. 486.

⁵⁴ Julian Amery, *Bijtë e Shqipes ...* f. 61.

⁵⁵ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë...* f. 217-218, E vërteta është se në fund të dhjetorit të vitit 1940, të gjithë robërit shqiptarë të luftës që ishin të gatshëm të hynin në ushtrinë greke liroheshin nga kampet dhe dërgoheshin në front. Në atë kohë, u fol se kjo kishte ndodhur me këmbënguljen e anglezëve. Por shpejt, një praktikë e tillë u ndërpre ngaqë qeveritarët grekë e kuptuan rrezikun se lufta mund të merrte ose karakter anti-fashist ose ngjyrim kombëtar shqiptar. Ata parapëlqyen variantin e pushtimit të Shqipërisë Jugore dhe bashkimin e saj me Mbretërinë greke.

Mirëpo, dështimi italian në pushtimin e Greqisë e detyroi Hitlerin të kthejë vëmendjen drejt frontit ballkanik.⁵⁶ Gjithashtu, në këtë periudhë Hitleri duhej të siguronte prapavijën e tij në Ballkan me qëllim që të përjashtonte mundësinë e zbarkimit të aleatëve. Atij i duhej të dërgonte në Ballkan një ushtri që e kishte planifikuar për ta dërguar në Rusi.⁵⁷ Kjo situatë na lejon të themi se nëse sulmi italian në Greqi shënoi tërheqjen e Britanisë në Ballkan, ishte pikërisht dështimi i këtij sulmi që do të tërhiqte Gjermaninë në këtë rajon.

Kryengritja e dështuar

Sulmi italian kundër Greqisë në vjeshtën e vitit 1940 nga territori shqiptar e rriti vëmendjen e politikëbërësve britanikë dhe ushtarakë në nxitjen e rezistencës guerile në Shqipëri, veçanërisht nga fundi i vitit '40 duke synuar krijimin e një Fronti të Bashkuar të rezistencës Shqiptare kundër Italisë. Kjo situatë e re vuri në lëvizje edhe Zogun, i cili propozoi në Londër që së bashku me 14 000 shqiptarë në Stamboll të organizonte një forcë që do të zbarkonte në Selanik me pëlqimin e qeverisë greke dhe kështu të krijonte një front lufte.⁵⁸ Qëndrimi i Zogut ndaj Greqisë ishte i qartë dhe miqësor. Ai premtoi se së bashku me patriotët e tjerë shqiptarë do të përkrahnin Aleatët kundër fuqive të boshtit.⁵⁹ FO e pëlqeu këtë propozim por nuk vendoste pa marrë pëlqimin e qeverisë greke. Rrjedhimisht FO ia përcolli propozimin Athinës për të mësuar nëse qeveria greke ishte dakord. Ky propozim nuk u pranua nga kryeministri grek Metaxas, me argumentin se po të përkrahnin Zogun, “kjo i angazhonte për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë pas lufte”,⁶⁰ dhe për rrjedhojë, ky plan për zbarkimin e Zogut u braktis. Po kështu, Foreign Office kërkoi mendimin e qeverisë greke për zbarkimin e Zogut në Shqipërinë Veriore për të drejtuar operacionin aty, por duke parë qëndrimin e prerë të kryeministrit grek Metaxas, FO vendosi që të braktisë edhe këtë alternativë; në vend të këtij plani, Foreign Office dhe SOE ranë dakord që të nxisnin prijësit shqiptarë t’i rezistonin italianëve.⁶¹

⁵⁶ Abaz Lleshi, *Gjeopolitika dhe probleme të sigurisë në Ballkan*, Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë: 2009, f. 86

⁵⁷ Ruth Mitchell, *The Serbs Choose War*, Garden City, New York: 1943, f. 6

⁵⁸ Elisabeth Barker, *British Policy...*, f. 50-51

⁵⁹ Beqir Meta, *Tensioni ...* f. 40

⁶⁰ Arben Puto, “*Në për analet ...* vepër e përmendur, f. 37

⁶¹ Elisabeth Barker, *British Policy...*, f. 50 - 51.

Lidhur me këtë qëndrim të qeverisë greke për përdorimin e Zogut si pikë bashkimi për kryengritjen në Shqipëri, Dixon do të bënte të qartë arsyet e refuzimit të cilat tashmë ishin të njohura: “Grekët gjithmonë kanë lakmuar Shqipërinë.... Ata do të kërkojnë korrigjimin e kufirit jugor”. Sipas tij, kjo ishte arsyeja që grekët kundërshtonin Zogun.⁶² Madje, ai shkoi më tej sa të shprehej: “...pas lufte, mund të ishte e përshtatshme që grekët të lejoreshin të mbanin ndonjë pjesë të Shqipërisë,⁶³ duke rikonfirmuar kështu qëndrimin e politikës britanike në pajtim me interesat greke. Nga ana tjetër, edhe në War Office ishin të bindur se një kryengritje e përgjithshme shqiptare në prapavijat e ushtrisë italiane do të ishte një ndihmë e madhe për grekët.⁶⁴ Megjithatë SOE konsideronte si më të mundshëm një variant tjetër, organizimin e një kryengritjeje në pjesën veriore të Shqipërisë nën drejtimin e Gani Kryeziut, nëpërmjet kontakteve të tyre në Jugosllavi. Në të vërtetë, ishte një pikëpamje për të gjithë ata që kishin jetuar e punuar në Shqipërinë e para luftës së mbretit Zog se fati politik i Shqipërisë përcaktohej më tepër nga malësorët e veriut, gegë, sesa nga toskët e Jugut.⁶⁵ Për pasojë, çelësi për një kryengritje kundër italianëve në Shqipëri më 1941, mendohej se ishte në Veri, ndër krerët dhe fiset gege të nxitura nga Jugosllavia. Sipas SOE, përmes kryengritjes së drejtuar nga Gani Kryeziu, do pushtohej Kukësi dhe do shpallej qeveria kombëtare shqiptare. Përveç vëllezërve Kryeziu të cilët u vunë në qendër të planeve britanike, në listë u përfshinë edhe Mustafa Gjinishi, komunist që jetonte në mërgim në Jugosllavi. “Lëvizja jonë - thekson kapiten Amery - mund të cilësohej me të vërtetë një front i bashkuar i rezistencës shqiptare kundër Italisë”.⁶⁶ Gjithashtu u përfshi edhe Abaz Kupi i cili aktualisht ndodhej në Stamboll dhe ishte besnik i Mbretit Zog.⁶⁷ Vlen të theksohet se megjithëse familja e Kryezinjve nuk kishin miqësi me Zogun, ata konsideruan si parësore çështjen kombëtare duke dëshmuar kështu vlerat e tyre pozitive.

⁶² *Po aty*.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ Beqir Meta, “Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në fillimet e Luftës së Dytë Botërore (1939 - 1941)”, vepër e përmendur, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2004, f. 152.

⁶⁵ Reginald Hibbert, *Fitorja...* f. 57.

⁶⁶ Julian Amery, *Bijtë e Shqipes ...* f. 56, Meqenëse në Shqipëri fashizmi ishte besimi i sunduesit të huaj, ata në përpjekjet e tyre për të gjetur një besim dhe një disiplinë u drejtuan kështu ndaj komunizmit.

⁶⁷ Roderick Bailey, “*The Wildest Province ...* f. 21.

Sipas planit, agjentët britanikë së bashku me vëllezërit Kryeziu, organizuan një sërë takimesh me shumë nga prijësit e Shqipërisë verilindore ku ndikimi i Ganiut ishte i konsiderueshëm si figura udhëheqëse shqiptare në Kosovë.⁶⁸ Si e tillë, Kosova do të ishte si pikënisja natyrore për revoltën pasi ishte shtrirja natyrore e Shqipërisë brenda kufijve politikë jugosllavë. Në këtë mënyrë, Kosova shërbente si një pikë shumë e favorshme për të gjitha operacionet, qoftë për dërgimin e armëve, lëvizjen e agjentëve, qoftë për përhapjen e propagandës së duhur në Shqipëri. Në këto rrethana, përkrahja e kosovarëve për realizimin me sukses të planeve të kryengritjes, merrte rëndësi të veçantë, por ekzistonte problemi se kishte nga ata udhëheqës kosovarë të cilët ishin gënjyer nga fuqitë e Boshtit me premtimin se do të bashkonin krahinën e tyre me Shqipërinë. Ndërkaq ky plan fillimisht u pranua nga Foreign Office. Ajo u tregua më e zbutur duke ofruar disa variante të tilla si: përdorimi i Zogut për t'i dërguar një mesazh mbështetjeje Gani Kryeziut, miratimi për kryengritje shoqëruar me furnizimin e ndihmave në ushqime e materiale nga ajri, dhe më e rëndësishmja, propozimi i një deklarate britanike në mbështetje të një qeverie Shqiptare me premtimin për ndihmë britanike në çlirimin e Shqipërisë, por me pëlqimin e qeverisë greke. Në këtë pikë, është e rëndësishme të thuhet se propozimi për krijimin e një qeverie shqiptare me mbështetjen britanike përbën përpjekjen e parë, e njëkohësisht bazuar në dokumentet e Foreign Office, të vetmen tentativë për krijimin e një qeverie shqiptare që mban qartë markën angleze gjatë të gjithë Luftës së Dytë Botërore.⁶⁹ Por, qëndrimi i Athinës kundër këtyre propozimeve, siç rezultoi shumë shpejt, ishte i prerë dhe kategorik, e po kështu ndryshoi dhe qëndrimi i FO. Lidhur me variantet e mësipërme, më 18 dhjetor, përfaqësuesi i SOE në Beograd, Alexandër Glen u takua në Athinë me drejtuesin e Misionit Ushtarak Britanik, major gjeneral T. G. Heywood, dhe diskutuan planin me Metaxan.⁷⁰ Projekti që ishte përgatitur në Foreign Office ishte ky: “Qeveria e Madhërisë së Tij e përshëndet nxehtësisht lajmin që sapo erdhi se në veri të Shqipërisë, patriotët shqiptarë janë hedhur në kryengritje kundër shtypësve italianë. Nga ana tjetër, qeveria e madhërisë së tij është gati të bëjë ç’është e

⁶⁸ Dayrell Oakley-Hill, *Një Anglez ...* f. 133 - 134.

⁶⁹ Arben Puto, *Nëpër analet ...* f. 62.

⁷⁰ Elisabeth Barker, *British Policy...*, f. 52.

mundur për ta përkrahur këtë lëvizje, me qëllim që të ndihmojë kështu për çlirimin e Shqipërisë”.⁷¹

Mirëpo, Athina ishte kundër çdo deklarate. Qeveria greke nuk mund të jepte pëlqimin për një kryengritje në shkallë të tillë sikurse e parashikonte skema e SOE. Rezultati i bisedimeve ishte që në rrethanat aktuale, interesi anglo-grek kërkonte që veprimet në Shqipëri të koordinoheshin nëpërmjet grupeve të vogla, jo të rregullta,⁷² gjë për të cilën palët e përfshira në bisedime ranë dakord. Ndërkohë, sipas Oklay-Hillit, plani i SOE në Beograd parashikonte një marshim të shpejtë në Kukës, ku Ganiu dhe njerëzit e tij, do të siguronin pajisjet “thelbësore” të hedhura nga RAF: 40 mijë paund në flori, plus armë, pistoleta, municione, granda, automatikë... veshje luftarake... misër dhe grurë.⁷³ Të nesërmen (19 dhjetor), SOE në Beograd u njoftua se armët nuk do të jepeshin të paktën për tre javë dhe RAF nuk mund të ofronte asnjë ndihmë për momentin, e për rrjedhojë operacioni do të varej nga përpjekjet që vetë SOE do të mund të siguronte brenda vendit.⁷⁴ Kjo situatë vuri në dukje mospërputhjet ndërmjet politikave të hartuara në FO dhe planeve e veprimeve të SOE në terren që lindnin nga vendosmëria e FO për të modifikuar politikat e saj ndaj Shqipërisë kur ishte fjala për interesat greke. Rrjedhimisht, plani i SOE në Beograd për organizimin e kryengritjes në shkallë të gjerë në Veri dhe propozimi për sigurimin e furnizimeve ushtarake nga RAF u la përsëri mënjanë. Në vijim të kësaj sate, zyra e SOE në Londër i dërgoi një mesazh⁷⁵ zyrës së SOE në Beograd, ku i tërhiqte vëmendjen për rolin e saj në organizimin e revoltës duke theksuar se vendimi pro ose kundër një kryengritje në Shqipëri, duhet të merret nga autoritetet ushtarake në Kajro dhe Athinë. “Roli juaj është thjesht t’u shpjegoni situatën në detaj atyre e më pas të merrni udhëzime prej tyre” - citonte mesazhi. Po të marrim parasysh faktin që vetëm pak ditë më parë vetë Foreign Office e kishte pëlqyer dhe miratuar planin për kryengritje, tingëllon disi e çuditshme që SOE në Beograd të qortohej për këtë fakt. Rrethanat e këtyre zhvillimeve na lejojnë të mendojmë se këto ndodhin ngaqë politikëbërësit britanikë, nën influencën e Athinës zyrtare, u druhashin

⁷¹ Arben Puto, *Nëpër analet ...* vepër e përmendur, f. 37 - 38.

⁷² *Po aty*.

⁷³ Roderick Bailey, “*The Wildest Province ...* f. 30 - 31.

⁷⁴ Elisabeth Barker, *British Policy...*, f. 52.

⁷⁵ *Po aty*, f. 53. Më 26 dhjetor, Dixon raportoi se propozimi për momentin ishte abandonuar dhe po kështu më 28 dhjetor, Eden u shpreh: “SOE është nxituar pa u menduar gjatë”.

përgatitjeve për një kryengritje në shkallë të gjerë, pasi kjo i detyronte ata të ndërmerrnin detyrime politike. Por, SOE përsëri nuk hoqi dorë.

Në dimrin e vitit 1940 SOE hyri në kontakt në jug të Tiranës me Myslim Pezën, kryetarin e Zonës së Pezës të cilit i dha 500 pound në flori për t'u shkaktuar shqetësime italianëve.⁷⁶ Me këto para ai bleu armë, municione dhe ushqime për grupin e tij. Ai kishte afërsisht jo më shumë se 500 forca dhe prej tyre nuk përballonte të hidhte në terren më shumë se 150 të tillë. Me këto forca ai kreu gjatë dimrit 1940-1941 disa sulme në shkallë të vogël kundër forcave pushtuese.⁷⁷ Në fillim të vitit 1941, situata ushtarake po ndryshonte me shpejtësi, po binte tempa i rezistencës greke kundër italianëve, ndërsa po shfaqej gjithnjë e më qartë rreziku i ndërhyrjes gjermane kundër Greqisë e Jugosllavisë.⁷⁸ Gjatë kësaj periudhe, ndërsa përfaqësuesit e SOE në Beograd po përpunonin planet e tyre për një kryengritje në Shqipëri, ata u përpoqën të sillnin në skenë mbretin Zog. Por, përsëri këto përpjekje nuk gjetën mbështetje në nivelet përkatëse vendimmarrëse të politikës britanike. Foreign Office ishte kundër përdorimit të figurës së Zogut. Këtë e konfirmon më 17 shkurt 1941, Philip Nichols shef i Departamentit Jugor të Foreign Office kur shënon: “prej kohësh ka qenë një pikë kardinale e politikës sonë kundrejt Shqipërisë që të ecë në një hap me grekët”.⁷⁹ Por ky nuk ishte rasti për SOE, sidomos po të kujtojmë organizimin dhe funksionimin e saj të veçantë. Nga fundi i shkurtit, SOE dërgoi një propozim në Londër nga Komiteti Shqiptar në Stamboll sipas të cilit, me qëllim që të stimulohej rezistenca shqiptare kundër italianëve pushtues, të krijohej një qeveri kombëtare me ndihmën britanike dhe me premtimin e britanikëve për rivendosjen e shtetit shqiptar siç ishte para pushtimit italian. SOE sugjeroi që qeveria e propozuar duhej të përfshinte Gani Bej Kryeziun dhe një Ministër të mëparshëm shqiptar në Londër, Mehmet Bej Konica. Foreign Office nuk iu përgjigj fare këtij propozimi.⁸⁰ Po në këtë linjë vihet re se në rrethanat aktuale Britania ishte e preokupuar për situatën në Greqi, ndërkohë që nuk paraqiste asnjë interes në nxitjen e një kryengritjeje në Shqipëri. Kështu, në marsin e vitit 1941, Churchill autorizoi përforsimin e grekëve me trupa britanike, por nga ana tjetër asnjëherë nuk u dha

⁷⁶ Panorama, nr 2985, 20 Korrik 2008, f. 26 - 27.

⁷⁷ TNA, “SOE activities in Albania”, f. 2.

⁷⁸ Beqir Meta, *Tensioni ...* f. 338 - 339.

⁷⁹ Reginald Hibbert, *Fitorja...* vepër e përmendur, f. 58 - 60.

⁸⁰ Elisabeth Barker, *British Policy...*, f. 53.

ndonjë autorizim nga Wavell që SOE të avanconte me planet e saj për revoltën shqiptare. Për më tepër Britania bëri përpjekje të përfshinte jugosllavët duke i nxitur të sulmonin italianët në Shqipëri e duke grumbulluar kështu sasi të mëdha armësh të italianëve të cilat vetë britanikët nuk mund t'i siguronin. “Në këto rrethana - Churchill iu drejtua Roosveltit - veprimi i Jugosllavisë është kardinal. Nëse Jugosllavia do të sulmojë në prapavijën italiane në Shqipëri, nuk dihet se çfarë mund të ndodhë në pak javë. E tërë situata mund të ndryshojë”.⁸¹

Ndërkohë, diskutimet që RAF të shpërndante materiale të mjaftueshme për guerilasit në Shqipërinë Veriore nuk u konkretizuan. E gjithë kjo panoramë nxjerr në pah faktin se ajo që maksimalisht u aprovua ndonjëherë për Shqipërinë në rrethanat aktuale ishte plani i kufizuar për disa “trupa të parregullta”⁸² që do të hynin në Shqipërinë Veriore nga Kosova dhe do të kryenin disa veprime të vogla sabotazhi të tilla si prerja e linjave telefonike, sulmimi i postave policore, etj. Për më tepër në këtë periudhë ndikoi zbarkimi i Hitlerit në Ballkan. Nevoja e tij për të siguruar prapavijën në Ballkan, dështimi i sulmit italian kundër Greqisë dhe më së fundi përforcimi i Greqisë me trupa britanike (duke vënë nën kontroll Korfuzin) bëri që në prill 1941 Hitleri të drejtonte sytë nga Greqia dhe Jugosllavia.⁸³ Më 6 prill, forcat gjermane bombarduan dhe pushtuan Jugosllavinë.⁸⁴ Por, ata nuk u mjaftuan me kaq. Po në këtë datë forcat gjermane sulmuan në 5 drejtime Greqinë e cila më 12 prill 1941, filloi tërheqjen nga Shqipëria. Më 18 prill 1941 gjeneralët grekë të Epirit nënshkruan armëpushimin pa u këshilluar fare me drejtuesit politikë të shtetit të tyre.⁸⁵ Brenda kaq pak ditësh, dy shtetet e Ballkanit, Jugosllavia dhe Greqia, ranë pre e politikës pushtuese të Gjermanisë naziste. Në të vërtetë i gjithë plani i SOE për Shqipërinë në këtë periudhë u konkretizua me një operacion të vetëm në prill 1941 të kryesuar nga Oakley-Hill i cili së bashku me 200 shqiptarë, pa radio-komunikime, mbështetje ajrore dhe armë të mjaftueshme u

⁸¹ *Po aty*, f. 103.

⁸² Roderick Bailey, *The Wildest Province ...* f. 32.

⁸³ Barbara Jelavić, *Historia e Ballkanit, Vëllimi II*, New York: Cambridge University Press: 1983, f. 235 - 238.

⁸⁴ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912 - 2005*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë: 2006, f. 450.

⁸⁵ *Po aty*.

përpoqën për një kryengritje të përgjithshme, por që nuk pati sukses.⁸⁶ Kryengritja dështoi. Pse?

Një nga disavantazhet në realizimin e planit të kryengritjes ishte mungesa e furnizimit me material ushtarak. SOE në atë periudhë nuk ishte ende në një pozitë të tillë sa të tërhiqte material ushtarak. Hill kujton se për këtë organizata iu drejtua Kajros e cila dha pëlqimin për gjysmën e sasisë, disa qindra pushkë dhe mitralozë të lehtë. Kjo sasi armësh që mbushte pothuajse një kamion nuk mund të kalohej në Beograd dhe u planifikua të kalohej nëpërmjet Gjakovës. Por kamioni nuk arriti dot në Gjakovë pasi pikërisht ato ditë gjermanët do të bombardonin Beogradin.⁸⁷ Një tjetër disavantazh ishte se në atë kohë, ekzistonte një bindje e përgjithshme se nazistët e kishin të fituar luftën, gjë që kishte krijuar panik të përgjithshëm që nuk përjashtonte as atë pjesë të Shqipërisë. Pjesë e kësaj atmosfere ishte edhe përhapja e lajmit se “Jugosllavia kishte nënshkruar pakt me Forcat e Boshtit”.⁸⁸ Natyrisht kjo situatë nuk ofroi mbështetjen e duhur për agjentët britanikë. Nga ana tjetër në atë zonë të Shqipërisë kishte një prezencë trupash të rregullta jugosllave fakt i cili krijoi tek disa idenë se ndërlidhësit britanikë ishin vegla të jugosllavëve. Vetë Hill do të kujtonte më vonë: “Unë mendoj se dëmin më të madh na e bëri hyrja e jugosllavëve në Shqipëri. Tërë Veriu i largët kishte dijeni për praninë tonë dhe disa mendonin se ne ishim vegla të jugosllavëve. Ky qe grushti fatal”.⁸⁹ Duke gjykuar në një kontekst më të gjerë, mendojmë se me gjithë peshën e faktit, prania e trupave të rregullta jugosllave në kufirin shqiptar nuk përbënte grushtin fatal. Më shumë se kaq, ishte “fitorja rrufe e Vermahtit hitlerian ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë që i dha fund përfundimisht planit për një kryengritje në Shqipërinë e Veriut”.⁹⁰ Nëse gjermanët nuk do të kishin pushtuar Jugosllavinë, sigurisht do të ishte arritur më shumë sukses. Megjithatë, nisur nga rrjedha e zhvillimit të ngjarjeve, është me vend të pranohet se shkaku kryesor për dështimin e kryengritjes në Veri ishte vetë Britania e Madhe. Lidhur me këtë rast burimet arkivore dëshmojnë se me gjithë përpjekjet e bëra, kryengritja në Shqipëri dështoi pikërisht për faktin se Britania e Madhe ishte e ndjeshme ndaj pretendimeve greke kundër Shqipërisë.⁹¹ Në momentet e dhura ajo nuk mbështeti

⁸⁶ Bernd Fischer, *Resistance in Albania ...* f. 23.

⁸⁷ Oakley-Hill, *Një Anglez...* f. 134 - 136.

⁸⁸ Ruth Mitchell, *The Serbs ...* f. 1.

⁸⁹ Oakley-Hill, D. “Një Anglez...”, f. 149.

⁹⁰ Neuwirth, H. “Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri: 1939-1944”, f. 37.

⁹¹ AQSH, F. 1510/1, v. 1943, dos. 97, f. 1. Harry Hodgkinson collection: Shqipëria e

organizimin e kryengritjes në Shqipëri, nuk ofroi ndihma me ushqime, materiale ushtarake e të tjera të nevojshme për mundësimin e revoltës, hodhi poshtë në çdo rrethanë përdorimin e Zogut për këtë qëllim, kundërshtoi përpjekjet e degës së SOE që veproi në Shqipëri dhe të gjitha këto duke marrë për bazë dhe në përputhje të plotë me interesat greke. Nga ana tjetër vetë SOE u shpreh se nëse komandantët ushtarakë britanikë do të kishin sjellë më shumë mbështetje për Shqipërinë atë dimër, nëse do të furnizonin armë, ushqime dhe elemente të tjera thelbësore që revolta të mos dështonte, rezultati do të kishte qenë ndryshe.⁹² Në këto rrethana SOE nuk kishte më një bazë nga ku oficerët e SOE dhe furnizimet të kalonin për në Shqipëri. Për pasojë, bërthamat e seksioneve të SOE për Shqipërinë që vepronin në Beograd dhe Athinë u shpërndanë.⁹³ Do të kalonin dy vite që oficerët e SOE të angazhoheshin përsëri.⁹⁴ Megjithatë, ana pozitive e përpjekjeve të oficerëve britanikë për organizimin e saj në këtë periudhë ishte se ata kishin arritur të krijonin një “front të bashkuar”,⁹⁵ i cili do të vazhdonte të rritej akoma më shumë.

Jugut - Pretendimet Greke.

⁹² Xhelal Gjeçovi, “Shqipëria dhe Aleatët në vitet e Luftës së Dytë Botërore”, vepër e përmendur, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2004, f. 96.

⁹³ Hibbert, R. *Fitorja...*, f. 79; Për rrjedhojë veprimtaria e SOE lidhur me Shqipërinë ra mjaft poshtë për të rifilluar në pranverën e vitit 1943.

⁹⁴ TNA, “SOE activities in Albania”, f. 3 - 4.

⁹⁵ Bernd Fischer, *Resistance in Albania ...* f. 23.

Eva BABAMETO

SUMMARY

SOE IN ALBANIA: ATTEMPTS IN ORGANIZING A GENERAL UPRISING, 1940-1941

Great Britain was the center of diplomatic games played during the Second World War on a global level. The latter applied the appeasement policy and maintained a tolerant and indifferent stance in regards to the Italian invasion of Albania, aiming thus to prevent the situation from becoming even tenser on an international level. It continued maintaining that stance for a considerable amount of time after this invasion. In light of these policies, on the 31st of October 1939, Great Britain *de facto* recognized the 'new status' of Albania as an occupied territory of Italy, by appointing Laurence Grafftey Smith as a General Consul in Durrës. London began expressing its interest in Albania only in spring of 1940, when it became clear that Italy would enter the war and that the British needed the Albanian resistance as an object of experiment of guerrilla warfare in South-East Europe. This task was trusted to the Balkans office of the D section of SIS (Secret Intelligent Service). On the 10th of June 1940, Italy declared war to the Allies. Nonetheless, this event did not influence the political developments in favor of Albania. The British policy was to support the Albanian nationalists without bothering Italy. In July the task was passed on to the section SO-2, which was under the control of the Chancellor of Exchequer, Hugh Dalton, who led secret operations in the Balkans, in particular operations of sabotage and diversion, later known as SOE. Its existence was highly secret. The recruits' name remained unknown and the section operated outside the control of the Parliament. It was also funded from secret funds. The Foreign Office (FO) expressed interest in the increase of tensions between Italy and Greece in August of 1940, and as such it aimed to cause troubles for Italy in Albania. The Italian attack on Greece incited FO to reconsider some variants on future steps, but Athens was against any declaration of independence for Albania, which is why FO changed its stance.

KDU: 94(496.5)"1944"

327(496.5)"1944"

Marenglen KASMI

DIVIZIONI SS "SKANDERBEG" DHE KUSHTET E KRIJIMIT TË TIJ NË VITIN 1944

Ideja e krijimit të Divizionit SS "Skanderbeg" (21. *Waffen - Gebirgs - Division der SS "Skanderbeg" ose Albanische Nr. 1*), bazohej në prioritetin e qeverisë së Rexhep Mitrovicës (nëntor 1943-maj 1944) për krijimin e një force ushtarake shqiptare, e cila do të ruante qeverinë, do të luftonte lëvizjen komuniste dhe padyshim, do të lehtësonte edhe forcat e Wehrmacht-it gjatë kryerjes së detyrës së tyre luftarake në Shqipëri. Përgatitjet për krijimin e kësaj force, gjermanët dhe qeveria shqiptare i filluan menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë, por puna u ndërpre përkohësisht si pasojë e këmbënguljes së të dërguarit të plotfuqishëm të Ministrisë së Jashtme gjermane për Evropën Juglindore, Hermann Neubacher, i cili ishte përfaqësuesi më i lartë i politikës gjermane në Ballkan. Neubacher, jo vetëm që në fillimet e pushtimit ishte i interesuar për të ruajtur në dukje pavarësinë e Shqipërisë, duke shpresuar kështu në bashkëpunimin e ngushtë të shqiptarëve, por po ashtu ishte në dijeni të kontradiktave dhe përplasjeve të kompetencave që ekzistonin ndërmjet instancave ushtarake gjermane në Shqipëri. Kësisoj, në një letër që Kaltenbrunner (*Kaltenbrunner*), shefi i Policisë së Berlinit, i dërgonte Neubacher-it më 17 shtator 1943, ndër të tjera shkruante: "*Do të jetë me interes për ty të dish se, Reichsführer-i SS (Himmler - M.K), bazuar në propozimin tim, ka urdhëruar në mënyrë kategorike ndërprerjen e çdo rekrutimi vullnetarësh për njësitë e*

*Armës-SS në Shqipëri [...]'*¹. Në fillim të vitit 1944, pasi u pa qartë se qeveria shqiptare dështoi në ngritjen e katër regjimenteve të xhandarmërisë, trupa që për gjermanët dhe qeverinë shqiptare tashmë ishin tepër të nevojshme në luftën kundër partizanëve, Hitleri miratoi krijimin e Divizionit SS "Skanderbeg"².

Brigadenführer Fitzthum, (*Brigadenfyrrer, Gjeneralbrigade i Forcave - SS*) i cili në literaturën shqiptare të para viteve '90 shpesh paraqitet si prototipi i nazifashistit, simboli i së keqes dhe thuhet se sinonimi i figurës së Drakulës në filmat horror të Evropës Perëndimore³, ishte pikërisht ai që u ngarkua me ngritjen e kësaj force ushtarake. Një person tjetër kyç për ngritjen e këtij divizioni ishte edhe ministri i Brendshëm shqiptar, Xhaferr Deva. Madje, ai ishte aq i rëndësishëm në planet e gjermanëve, sa që funksioni i tij si ministër i Brendshëm lidhej drejtpërsëdrejti me suksesin e krijimit të këtij divizioni. Në krizën qeveritare të qershorit 1944, kur Mehdi Frashëri tentoi të largojë Devën nga qeveria, më 28 korrik 1944, Fitzthum i raportonte Himmler-it: "*Ministri Neubacher ka urdhëruar që Deva duhet të qëndrojë përsëri Ministër i Brendshëm edhe nëse ekziston rreziku që Mehdi Frashëri të japë dorëheqjen*"⁴. Këshillat për kujdesin që duhej të tregohej në mobilizimin e kësaj force, sigurisht që i jepte Neubacher, i cili besonte plotësisht në suksesin ushtarak dhe politik që do të kishte krijimi i këtij divizioni në luftën kundër bandave komuniste⁵. Sipas tij, ky sukses do të ishte ende më i madh, nëse marshimi i këtyre trupave në qytetet kryesore do të shoqërohej me një propagandë të sofistikuar. Gjatë fazës përgatitore për mobilizimin e këtij divizioni u mendua deri në detaje edhe për uniformën që duhej të vishnin ushtarët e këtij divizioni. Prandaj gjatë një takimi të mbajtur më 3 mars 1944, Vehbi Frashëri i propozonte palës gjermane që, një model i propozuar i festës së uniformës, e cila kishte ngjashmëri me festën turke, nuk duhej të

¹ PA/AA, Inland II g, 296, Waffen-SS, Albanien, Aufstellung von SS-Formationen 1943-1944. (PA/AA - Politisches Archiv des Auswärtigenamts/ Arkivi Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Berlin).

² PA/AA, Inland IIg, 296, 1943/44, H 298851.

³ KÜHMEL, Bernhard: Deutschland und Albanien, 1943-1944. Die Auswirkungen der Besetzung und die innenpolitische Entwicklung des Landes, Bochum 1981 (Inauguraldissertation zur Erlangung eines Doktors der Philosophie in der Abteilung für Geschichtswissenschaft der Ruhr-Universität Bochum), S. 296.

⁴ B Arch / NS 19/1488. (Bundesarchiv Berlin Lichterfelde/ Arkivi Federal Berlin Lichterfelde).

⁵ PA/AA, Inland IIg, 296, 1943/44, H 298816.

miratohej, sepse ajo i kujtonte shqiptarëve sundimin e gjatë osman. Më tej, Vehbi Frashëri argumentonte se, Shqipëria ishte e ndërtuar mbi bazë kombëtare dhe jo fetare. Kjo gjë vërtetohej edhe nga fakti që, të krishterë dhe myslimanë *"gëzojnë të njëjtat të drejta dhe jetojnë si shqiptarë në harmoni njëri me tjetrin. Ndonëse myslimanët në Shqipëri përbëjnë shumicën, të krishterët janë të përfaqësuar në qeveri thuajse në masën 50 për qind"*⁶.

Qeveria shqiptare mori përsipër nxjerrjen e një urdhri, sipas së cilit në Kosovë do të kryhej rekrutimi i burrave të lindur në vitet 1920-1924. Po ashtu, shqiptarët e Kosovës që ishin të burgosur duhej të liroheshin dhe të integroheshin në divizionin e ri. Myslimanët shqiptarë që ishin inkuadruar në Divizionin SS me numër 13 të vullnetarëve (*divizion me myslimanë boshnjakë-M.K.*), duhet të krijonin bazën e divizionit të ardhshëm SS shqiptar. Për rekrutimin e shqiptarëve ishte e interesuar edhe "Lidhja e Dytë e Prizrenit". Për këtë gjë, kryetari i Lidhjes Bedri Pejani, i cili më vonë do të zëvendësohej nga Xhaferr Deva, i shkroi më 29 mars 1944 një letër Hitlerit, ku ndër të tjera i kërkonte armatim për 120 000-150 000 vullnetarë shqiptarë për të luftuar kundër partizanëve serbë dhe malazezë⁷. Po ashtu, Pejani i kërkonte Hitlerit militarizimin e Kosovës nën drejtimin gjerman, sepse ai besonte se ky proces militarizimi, i kombinuar me luftën e shqiptarëve të armatosur me armë gjermane kundër partizanëve serbo-malazezë, ishte një garanci për Kosovën ndaj rrezikut shekullor serb. Ndër të tjera, Pejani i shkruante Hitlerit si më poshtë: *"[...] Militarizimi (i Kosovës-M.K.) ka për qëllim krijimin e një ushtrie vullnetarësh prej 120 000-150 000 luftëtarësh, të cilët janë të aftë të luftojnë gjatë gjithë luftës kundër partizanëve serbo-malazezë dhe të mbrojnë çështjen kombëtare të shqiptarëve në çdo situatë të vështirë dhe të rrezikshme që mund të krijohet pas lufte nëse plotësohen kushte te mëposhtme: 1. Sigurohet (nga gjermanët-M.K.) një armatim modern dhe pajisje të tjera moderne ushtarake te respektueshme. 2) Emërohet një numër oficerësh dhe nënoficerësh (gjermanë-M.K.) si organizatorë, instruktorë dhe komandantë për gjithë njësitë e kësaj ushtrie dhe 3) Për arsye strategjike, të bëhet ratifikimi i kufirit aktual me Malin e Zi dhe Serbinë"*⁸. Siç lexohet, ndër të tjera Pejani i kërkonte Hitlerit që

⁶ PA/AA, Inland IIg, 296, 1943/44, H 298885.

⁷ B Arch / NS 19-2071.

⁸ B Arch / NS 19-2071.

Gjermania të anulonte njohjen e kufijve të vitit 1941 sipas marrëveshjes italo-gjermane.

Gjithsesi, ky qëndrim separatist i Pejanit ndaj qeverisë së Tiranës nuk përkonte me planet gjermane. Prandaj më 9 maj 1944, Hermann Neubacher i udhëzonte vartësit e tij si më poshtë: “[...] Unë e kam konsideruar si jo serioze këtë letër dhe kam tërhequr vëmendjen se, Bedri Pejani nuk është në gjendje mendore normale. Dhënia e armëve tona një Lidhjeje të tillë nuk mund të merret prej nesh asnjëherë në konsideratë, sepse këto armë do të zhdukeshin në mënyrë të pakontrolluar në male. Unë e kam lutur njëherë Mehdi Bej Frashërin në mënyrë telegrafike nga Berlini, nëpërmjet djalit të tij Vehbi Frashërit, që ta largojë Bedri Pejanin nga skena politike dhe, po ashtu ju lutem edhe ju që, për këtë gjë të ushtroni në çdo rast ndikimin tuaj. Unë e konsideroj Bedri Pejanin të aftë në atë çmendurinë e tij, vetëm për të organizuar kundër serbëve të Kosovës një «Natë Shën Bartolomeu» ose si një Skënderbe i dytë të kalojë kufirin në krye të një dyzine të armatosur njerëzish [...]”⁹.

Edhe komandanti i Divizionit “Skanderbeg”, gjenerali Schmidhuber shkruante në raportin e tij përfundimtar për aktivitetin e divizionit shqiptar në lidhje me këtë kërkesë si më poshtë: “*Premtimet e Presidentit të atëhershëm të Komitetit Kombëtar Shqiptar të Prizrenit, Bedri Pejani, të cilat i ka bërë me shkrim edhe në një letër të drejtuar Reichsführer SS (Himlert-M.K.), nuk ishin asgjë tjetër sesa premtimet e mëdha të zakonshme të shqiptarëve. [...] Ngritja e Divizionit në këtë shifër të planëzuar, do të ishte ndoshta e mundur, vetëm nëse komandanti i Divizionit do të kishte ardhur me një thes me flori dhe do t’ua kishte shpërndarë bejlerëve më të rëndësishëm. Kështu ai do të kishte mundur të siguronte rekrutë, të cilët do të detyroheshin nga këta të fundit. Kush dëshiron të krijojë miqësi në Shqipëri, pyetet fillimisht: Sa flori do të më japësh? Ironia qëndron në faktin, që njerëz të caktuar kërkonin të bënin biznes me krijimin e Divizionit”*¹⁰. Siç shihet, Schmidhuber e përgënjeshtroi impenjimin e Lidhjes së Prizrenit dhe të kryetarëve të bashkive për të organizuar rekrutimin. Si pasojë, rekrutimi u krye me vështirësi dhe afatet e tij nuk u zbatuan. Në fakt, kjo gjë duket pak e ekgzagjruar nëse jemi të gatshëm të besojmë edhe deklaratat e Bedri Pejanit për krijimin e këtij divizioni. Sipas tij, prefekti i Prizrenit

⁹ PA/AA, Inland IIg, H299620, Nr. 902.

¹⁰ BA/MA, RS 3-21/1, S.3. (Bundesarchiv Militärarchiv/ Arkivi Federal Arkivi Ushtarak Freiburg).

Shaqir Curri, kishte njoftuar për marrjen e një urdhri sekret nga Ministria e Brendshme shqiptare, sipas të cilit në Kosovë duhej të formohej një divizion SS. Në këtë divizion, gjermanët do të mobilizonin të rinj shqiptarë dhe prefekturat duhej t'u jepnin gjermanëve gjithë ndihmën e nevojshme¹¹. Siç duket, këto trupa duhej të rekrutoheshin nën regjinë e gjermanëve, ndërsa "veglave muzikore" duhej t'u binin shqiptarët. *"Kur e dëgjova këtë nga prefekti Shaqir Curri - shkruante B. Pejani - unë parandjeva që ky divizion, nëse formohet nga gjermanët dhe prefektura, do të përbëhet nga njerëzit më të këqij dhe nga vagabondët dhe, për të mos ndodhur e njëjta gjë siç ndodhi me kazermën që u formua në Mitrovicën e Kosovës, unë mblodha Komitetin dhe vendosëm që ne të marrim përsipër formimin e atij divizioni"*¹².

Pasiviteti i prefektëve dhe kryetarëve të bashkive për rekrutimin e shqiptarëve nën Armën-SS, duhet konsideruar në njëfarë mënyre si një sinjal që ata i jepnin popullsisë që të mos e merrnin seriozisht këtë rekrutim, ta konsideronin atë si diçka të parëndësishme, madje edhe ta injoronin atë. Kjo gjë mund të shpjegohet me faktin se vetëm njerëz nga shtresa e varfër shfaqën interes për t'u rekrutuar, sepse ndoshta e shihnin veshjen e uniformës si një mundësi për të siguruar jetesën. Ndërkohë që djemtë e bejlerëve, agallarëve dhe tregtarëve të pasur u liruan nga detyrimi për rekrutim nëpërmjet njohjeve ose korrupsionit¹³. Duke ju referuar statistikave ushtarake gjermane të kohës për rekrutimin në radhët e Divizionit SS, deri më 25 shtator 1944 u paraqitën për rekrutim 11 398 shqiptarë, nga të cilët u konsideruan të aftë 9 275 burra. Prej tyre u inkadruan në divizion vetëm 6 491 shqiptarë¹⁴. Rekrutimet u bënë në zonat e Kosovës, Maqedonisë dhe Mitrovicës. Ekzistojnë disa të dhëna, pavarësisht se qeveria shqiptare nuk i konfirmonte, ku dëshmohet se, në këtë Divizion janë rekrutuar edhe shqiptarë nga Shqipëria, ndonëse numri i tyre ishte i vogël¹⁵. Kalimi i Turqisë në anën e aleatëve, pavarësisht se shqiptarët e Kosovës dëgjonin shumë Radio Ankaranë dhe si në Prizren ashtu edhe në Prishtinë flitej në masë gjuha turke, nuk pati ndonjë ndikim të madh te shqiptarët. Përkundrazi, ndikim të madh te kosovarët pati kapitullimi i Rumanisë e më pas i Bullgarisë, çka u ndie më tepër në propagandën që kryhej kundër

¹¹ Ethem Çeku, Shekulli i ilegales : proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë : dokumente, Brezi '81, Prishtinë 2004, f. 140.

¹² Po aty, f. 140.

¹³ BA/MA, RS 3-21/1.

¹⁴ BA/MA, RS 3-21/1.

¹⁵ BA/MA, XXII. A.K, 59643/4, (Raport i datës 02.05.1944).

divizionit. Parullat që hidheshin ishin “*Tërheqje në kohë nga bashkëpunimi me gjermanët*” dhe “*Jo luftë shqiptari kundër shqiptarit*”!

Shqiptarët kishin përjetuar fundin e Luftës së Parë Botërore, rënien e shpejtë të Jugosllavisë ndaj sulmit gjerman, si dhe dështimin e Italisë në luftë. Gjithashtu, ata shikonin edhe tërheqjen e afërt të gjermanëve nga Ballkani. Në këtë pikëpamje, ata qëndronin gati që, në rastin më të parë, pasi të dallonin shenjat e dobësimit të ushtrisë gjermane, të hidheshin në sulm për të përmirësuar armatimet dhe municionet e tyre, siç kishin bërë edhe në rastin e rrëzimit të Jugosllavisë dhe kapitullimit të Italisë. Në këtë kuadër, duhet vlerësuar edhe një sulm i organizuar i rreth 1 500 partizanëve kosovarë, më 11 shtator 1944, në Gjakovë. Forcat gjermane arritën ta thyejnë sulmin dhe të organizojnë një kundërsulm në rrethinat e Gjakovës. Në këtë betejë, si pasojë e mungesës së forcave, Shtabi i Divizionit luftoi si forcë e rregullt, gjë që ishte tepër vendimtare për fatin e kësaj beteje. Sipas burimeve gjermane, në këto luftime u vranë 10 ushtarë gjermanë. Nga pala tjetër humbën jetën 104 partizanë kosovarë¹⁶.

Nacionalistët kosovarë shpresonin që gjermanët do të zëvendësoheshin nga anglezët, para se komunistët të merrnin në dorë drejtimin e Shqipërisë. Pra, ardhja në pushtet e komunistëve do të thoshte për shqiptarët e Kosovës vazhdim i terrorit dhe sundimit serb, sepse komunizmi shihej nga popullsia në Kosovë si një formë e pansllavizmit dhe rrjedhimisht, kjo rrymë urrehej në mënyrë instiktive. Nga ana tjetër, bandat nacionaliste, sidomos në lindje të rajonit, fituan forcë morale, sepse në këto troje ekzistonte një nevojë e fortë për të organizuar mbrojtjen ndaj pretendimeve territoriale bullgare. Kësisoj, gjermanët, ndonëse pushtues, siguronin qoftë edhe përkohësisht mbajtjen larg të Serbisë nga Kosova dhe ndoshta pas tërheqjes së gjermanëve, do të ishin anglezët ata që do të ndërhyenin në Shqipëri. Për gjermanët paraqitej e rrezikshme edhe parulla “*jo luftë shqiptari kundër shqiptarit*”. Kjo parullë pengonte deri diku luftën ndaj komunistëve. Porë në këtë këndvështrim, propaganda gjermane arrinte njëfarë suksesi si pasojë e qëndrimit të partizanëve, të cilët luftonin me të njëjtin intensitet, si gjermanët ashtu edhe grupimet kundërshtarë nacionaliste që bashkëpunonin me gjermanët. Kjo gjë mundësoi bashkimin e tyre në luftë kundër komunistëve, por njëkohësisht i lidhte ata gjithmonë e më tepër me pushtuesit gjermanë. Në pikëpamje të sigurisë, largimi i forcave bullgare nga Maqedonia pas kapitullimit të Bullgarisë, bëri të

¹⁶ BA/MA, RS 3-21/1, S. 6.

mundur zgjerimin e kufijve të Shqipërisë deri në vijën Shkup-Kumanovë-Preshevë-Bujanovc. Sigurisht që, ky zhvillim ishte me interes për gjermanët. Parë thjesht nga pikëpamja gjeografike, ishte fituar një territor i cili ishte tepër i përshtatshëm për të organizuar mbrojtjen në rast të një sulmi nga Lindja. Po ashtu, bandat nacionaliste që vepronin në këto troje bënë një qëndresë të madhe kundër partizanëve. Duke pasur parasysh urrejtjen e madhe të shqiptarëve të këtyre trojeve ndaj bullgarëve, gjermanët mendonin se shqiptarët do të mbroheshin në vendosmëri nëse do të ishte e nevojshme.

Kriza politiko-ushtarake që mbizotëronte në Ballkan u pasua nga dezertime të mëdha në Divizionin “Skanderbeg”. Ky fenomen u kurorëzua nga dezertimi i thuajse gjithë regjimentit të këmbësorisë malore SS-1, i cili operonte në Tetovë dhe Gostivar. Dezertuesit merrnin me vete edhe gjithë armatimin dhe pajimet personale. Mosbesueshmëria e gjermanëve ndaj shqiptarëve u shfaq më tepër në Tetovë, ku dezertimi i ushtarëve shqiptarë u shoqërua edhe me parulla armiqësore ndaj Gjermanisë. Kjo gjë ishte tepër e rëndë për gjermanët. Sipas tyre, shqiptarët e rekrutuar në Tetovë u trajtuan nga eprorët e tyre në veçanti më mirë se gjithë pjesa tjetër e divizionit¹⁷. Deri më 1 tetor 1944, numri i dezertorëve shqiptarë nga radhët e Divizionit SS “Skanderbeg” arriti në 3 425 vetë¹⁸. Ndërkaq ndodhte që rojet, duke shkuar për të marrë shërbimin, largoheshin pa lënë asnjë gjurmë. Nga një lokal roje i vendosur në një urë, u larguan në mënyrë të organizuar 10 shqiptarë, duke braktisur të dy vendrojat e vendosura për ruajtjen e saj. Gjithashtu, 30 ushtarë shqiptarë që ndiqnin një kurs për instruktorë hipizmi, dezertuan dhe u larguan në mënyrë të organizuar. Një togë zbulimi, duke përfutur nga mungesa e efektivit gjerman në togë, u zhduk pa gjurmë e nuk u kthye më. Në Divizionin “Handschar” (*Handshar-hushta*) dezertoi i gjithë batalioni shqiptar i inkuadruar në këtë divizion, me një forcë luftarake prej 697 burrash. Kësisoj, më 1 tetor 1944, në Divizionin SS “Skanderbeg” ishin ende të inkuadruar rreth 3 994 shqiptarë¹⁹. Më konkretisht dezertimet dhe personeli i mbetur në Divizionin SS “Skanderbeg” deri më 1 tetor 1944 paraqiteshin si më poshtë²⁰:

¹⁷ BA/MA, RS 3-21/1, S. 7.

¹⁸ BA/MA, RS 3-21/1, S. 7.

¹⁹ BA/MA, RS 3-21/1.

²⁰ BA/MA, RS 3-21/1.

Njësia	Oficerë	Nënoficerë	Burra	Rekrutë	Dezertime	Lirime
<i>Shtabi i Divizionit</i>	17	41	69	51	1	-
<i>I./ SS – 2</i>	8	66	68	295	404	-
<i>II. / SS – 2</i>	6	42	16 7	284	123	22
<i>Bat. I i Regj. Art. Mal. 21</i>	6	18	8	539	450	-
<i>Njësia informac. SS 21</i>	5	27	67	299	14	45
<i>Trupat e zbulimit</i>	5	32	43	232	380	13 1
<i>Toga ndëshkimore</i>				112		
<i>Bat. Rez. fushor SS 21</i>	15	12 6	25 3	781	854	54
<i>Njësia e transp. të plagosurve SS 21</i>	6	37	53	168	-	-
<i>Komp. Veterinare SS 21</i>	1	6	13	166	34	-
<i>Komp. Sanitare SS 21</i>	5	15	11	128	42	-
<i>Togë (?) SS 21</i>	-	3	3	31	3	-
<i>Grup. luftarak MITROVICA</i>	1	9	50	-	-	-
<i>Grup. Luftarak NOVI PAZAR</i>	1	10	50	2	-	-
<i>Grupimi Hauser (shtabi ndërlidhës me çetat nacionaliste)</i>	2	5	5	-	105 5	-
<i>Grupimi Klingenberg (trupa komando të sigurimit të hekurudhës)</i>	2	7	13	2	-	-
SHUMA	86	46 7	88 7	350 4	342 5	37 3
Nga 467 nënoficerë, vetëm 38 prej tyre ishin shqiptarë. Ndërsa nga 887 burrat e divizionit (kështu quheshin ushtarët me përvojë), 499 prej tyre ishin shqiptarë.						

Vlerësuar në pikëpamje ushtarake dhe organizative, urdhri për krijimin e këtij divizioni ishte bazuar mbi kërkesa të gabuara. Shqiptarët nuk kishin qenë asnjëherë pjesë e një ushtrie të organizuar sipas

perceptimit gjerman për një forcë të rregullt ushtarake. Njësitë shqiptare të deriatëhershme, përfshirë edhe milicinë shqiptare të krijuar gjatë pushtimit italian, paraqisnin vetëm në dukje një krijesë ushtarake. Atyre u mungonte çdo strukturë e brendshme solide ushtarake. Mangësia e parë kryesore e këtyre trupave ishte mungesa e disiplinës, të cilën ushtarakët italianët jo vetëm që nuk u munduan ta përmirësojnë, por përkundrazi e kultivuan më tej atë.

Komandanti i divizionit, gjenerali Schmidhuber, shprehet në një raport për veprimtarinë e këtij divizioni si më poshtë, për sa i përket disiplinës së ushtarëve shqiptarë: *"Disiplinë do të thotë për shqiptarin një kufizim i lirisë së tij (...). Ai jeton në natyrë dhe bën atë që do. Shqiptari ka kohë. Ai nuk dëshiron të luftojë në formacion ushtarak, por në bandën e tij. Në bandë nuk ka disiplinë ligjore. Nëse bie shi, shqiptari largohet nga vendroja; nëse bie nata, ai po ashtu largohet nga pozicioni i tij fushor dhe shkon në fshat të pijë raki. Nëse ishte 12 ditë në terren, ai largohet 4-5 ditë për të shkuar në shtëpi pa e pyetur kryetarin e tij të bandës dhe pastaj kthehet përsëri, ose nuk kthehet fare."*²¹.

Si pasojë e këtyre mangësive të theksuara, gjermanët u ndodhën para problemeve të mëdha organizative. Për ta do të kishte qenë më e lehtë për t'i bërë sa më efikase në luftim këto trupa, nëse do të kishin përzgjedhur dhe arsimuar më parë oficerët dhe nënoficerët, e më pas të kishin bërë plotësimin e divizionit me ushtarë. Sigurisht që kjo gjë ishte e pamundur në situatë lufte dhe në nevojë emergjente për trupa të reja, sepse kontingjenti i shqiptarëve që u afruan për rekrutim ishte i dobët dhe i paarsimuar. Kryesisht ata ishin të motivuar më tepër se gjithçka tjetër nga rroga që do të merrnin apo nga ndonjë mundësi tjetër përfitimi. Kjo gjë konstatohet edhe në raportet ushtarake gjermane: *"Ai (ushtari shqiptar-M.K.) merr pjesë në sulm për aq kohë sa të gjejë diçka për të vjedhur apo bastisur. Nëse ai gjen një dhi, një plug apo një rrotë makine qepjeje, lufta për të ka mbaruar dhe ai në kokë të tij shkon në shtëpi"*²². Që në këtë divizion në pjesën më të madhe nuk u inkuadruan përfaqësuesit më të mirë të popullit kosovar është e qartë, por që të shikosh te ta vetëm njërën anë të medaljes nuk është e drejtë. Gjenerali Schmidhuber vlerëson në raportin e tij fenomenet e shfaqura te rekrutët shqiptarë, por ai harron, ose nuk arrin ta mendojë si ushtarak i mirëfilltë që ishte dhe si i huaj, se këta shqiptarë nuk kishin asnjë motiv të

²¹ BA/MA, RS 3-21/1.

²² BA/MA, RS 3-21/1.

luftonin kundër shqiptarëve të tjerë. Prandaj një pjesë e tyre, siç u theksua edhe më sipër, e shikonte këtë angazhim thjesht si një mundësi përfitimi!

Po kaq problematike konstatohet te ushtarët shqiptarë edhe përkujdesja ndaj uniformës. Madje Schmidhuber e krahasonte këtë aspekt të disiplinës te shqiptarët me zezakët e pamësuar me veshje. Ndër të tjera ai shkruante: *“Për sa i përket uniformës, personeli arsimues gjendej shpesh para vështirësive të njëjta si me zezakët. Shumica e rekrutëve vishnin për herë të parë këpucë në jetën e tyre. Prandaj ata ndiheshin tepër krenarë dhe nuk i hiqnin ato as natën. Në të kundërt me atë që duhet të bëjnë, ata i heqin këpucët kur marshojnë dhe i varin në qafë. Nëse atij i duhet të arratiset, e harron dashurinë e tij ndaj këpucëve dhe i hedh ato, sepse zbathur është në gjendje të vrapojë më shpejt. Mbajtja e rregullt e uniformës, atje ku arrihet, është një rezultat i jashtëzakonshëm me shqiptarët”*²³.

Formimi i këtij divizioni, padyshim që nuk kaloi pa rënë në sy të partizanëve që operonin në kufirin shqiptaro-maqedonas. Po ashtu, edhe gjermanët e dinin se ata nuk do të rrinin duarkryq, për më tepër kur në Kosovë ekzistonte një aktivitet i fuqishëm komunist. Pikërisht në këtë kohë, divizioni ndërmori dy aksione të shpejta, duke kryer arrestimin e 281 hebrenjve dhe të 210 komunistëve²⁴. Zbrazëtia e krijuar nga arrestimi i komunistëve dhe korrierëve të tyre u shfrytëzua nga gjermanët për të bërë stërvitjen bazë të rekrutëve shqiptarë. Gjatë luftimeve që kreu ky divizion kundër partizanëve jugosllavë, ra në sy përgatitja e lartë e partizanëve, si edhe armatimi dhe veshja e tyre. Në misionin e parë luftarak ndaj partizanëve, gjermanët vunë re, se luftonin kundër një trupe, e cila nuk kishte tashmë asgjë të përbashkët me banditët. Përkundrazi, ajo shfaqej si një trupë e mirëfilltë ushtarake, e rregullt, e disiplinuar, e veshur njësoj me uniforma angleze dhe që drejtohej nga oficerë me cilësi të larta ushtarake²⁵. Madje, si pasojë e mungesës së pajisjeve drejtuese në Divizionin “Skanderbeg”, Schmidhuber pranon, se *“trupat e tij kishin ndërruar rolet me banditët”*²⁶. Gjatë veprimeve luftarake të kryera, Divizioni “Skanderbeg” pësoi humbjet e mëposhtme²⁷: 166 të humbur, prej tyre

²³ BA/MA, RS 3-21/1.

²⁴ BA/MA, RS 3-21/1.

²⁵ BA/MA, RS 3-21/1.

²⁶ BA/MA, RS 3-21/1.

²⁷ BA/MA, RS 3-21/1.

14 gjermanë dhe 152 shqiptarë; 92 të plagosur, prej tyre 20 gjermanë dhe 72 shqiptarë; 56 të vvarë, prej tyre 8 gjermanë dhe 48 shqiptarë.

Si pasojë e dezertimeve në masë dhe nevojës për mbështetje të bandave nacionaliste nga gjermanët, Shtabi i Divizionit ndërmori disa masa organizative, duke shkruar disa njësi dhe duke i riformatuar trupat e divizionit. Nacionalistët shqiptarë ishin tepër të kënaqur, nëse në çetën e tyre kishin të paktën 10 ushtarë gjermanë që luftonin me ta! Pengimi i trupave anglo-amerikane para lumit Rin, e rriti disi besimin e shqiptarëve te Gjermania, ose të paktën mendohej, se humbja e Gjermanisë nuk do të ishte shumë e thellë. Duke pasur parasysh këtë fakt, por edhe si pasojë e disa sukseseve të vogla që arriti divizioni dhe pavarësisht nga problemet e shfaqura, në fund të muajit maj 1944, Fitzthum i propozonte Himmler krijimin e një divizioni të dytë SS në Shqipëri²⁸. Të krijohet përshtypja se kërkesa ishte e iniciuar nga qeveria shqiptare. Madje, Vehbi Frashëri u propozoi gjermanëve marrjen përsipër nga qeveria të një pjese të shpenzimeve që nevojiteshin për krijimin e kësaj force, nëse gjermanët premtonin se ky divizion nuk do të operonte jashtë “Shqipërisë së vjetër”²⁹. Është e vetëkuptueshme se sa i rëndësishëm ishte për qeverinë shqiptare ky projekt, sidomos tashmë kur mund të parashikohej tërheqja e gjermanëve nga Shqipëria dhe qeveria do të kishte në këtë mënyrë një forcë të armatosur në dispozicion, pavarësisht formatit të saj jo të plotë. Divizioni “Skanderbeg” veprroi kryesisht në rajonin kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ai po ashtu mori pjesë në disa operacione kundër partizanëve. Synimi i operacionit “*Endlich*” (Më në fund) ishte asgjësimi i forcave partizane në rajonin e Gjakovës. Gjatë këtij operacioni u shkatërrua një fushë aviacioni, e cila përdorej nga aleatët anglo-amerikanë për të furnizuar partizanët vendas. Në datat 11-27 qershor 1944, një batalion i përforcuar i Divizionit “Skanderbeg” mori pjesë në operacionin “*Falkenauge*” (Syri i skifterit). Në nëntor 1944, divizioni, tashmë i riformatuar në grupregjimentin “Skanderbeg” u transferua nga Prishtina në rajonin e Krajlevos. Më vonë, ai do të rigrupohej përsëri, por tashmë nën komandën e Divizionit të 7 malor SS “Prinz Eugen”.

²⁸ KÜHMEL, Bernhard: Deutschland und Albanien, 1943-1944. Die Auswirkungen der Besetzung und die innenpolitische Entwicklung des Landes, Bochum 1981 (Inauguraldissertation zur Erlangung eines Doktors der Philosophie in der Abteilung für Geschichtswissenschaft der Ruhr-Universität Bochum); f. 310.

²⁹ BA/MA, RS 3-21/1.

Përfundimisht vlen të theksohet se, krijimi i Divizionit SS “Skanderbeg” nuk përbënte ndonjë rast të veçantë apo tipar dallues të marrëdhënieve pushtuese, politike dhe ushtarake ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë. Kjo për shkak se gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, Gjermania rekrutoi nën Armën-SS shumë ushtarë apo njësi e reparte të tjera nga shtete të huaja në tërë hapësirën e paanë të pushtimit dhe jo vetëm në Ballkan, por thuajse në gjithë vendet që ajo pushtoi. Në këtë kuadër, edhe në Ballkan u rekrutuan forca të tilla, si në: Shqipëri, Bosnje, Kroaci, Bullgari etj. Krijimi i Divizionit “Skanderbeg” i shërbente më së shumti gjermanëve, por edhe qeverive kolaboracioniste shqiptare. Gjermanët i përdorën forcat e divizionit shqiptar në territore të largëta për qeverinë e Tiranës, kryesisht në Kosovë, dhe ata nuk mundën thuajse asnjëherë t’i shërbenin vërtet drejtpërdrejt qeverisë së Tiranës brenda Shqipërisë shtetërore. Kjo gjë tregon qartë, se këto forca më tepër duhej t’u shërbenin gjermanëve, sesa qëllimit të propaganduar gjatë procesit të rekrutimit.

Sipas propagandës gjermane, qeveria shqiptare do të kishte një Forcë të Armatosur, e cila do të luftonte kundër komunistëve dhe rrjedhimisht do të pengonte ardhjen e tyre në pushtet pas largimit të gjermanëve nga Shqipëria. Siç u tha më sipër, komunizmi lidhej në Kosovë me “*Pansllavizimin*”, gjë e cila e favorizonte krijimin e këtij divizioni. Kjo propagandë pati rezultat te shtresat e varfra dhe të paarsimuara të vendit, të cilët duke e besuar atë çka thuhej u paraqitën pranë zyrave të rekrutimit. Po ashtu, pati edhe të tjerë, të cilët pranuan të veshin uniformën SS të shtyrë vetëm nga nevoja ekonomike. Gjermanët arritën të krijonin te kjo shtresë besimin, se vetëm nën kujdesin e tyre mund të sigurohej Shqipëria e Madhe dhe Kosova të shpëtonte përfundimisht nga sundimi serb. Historiografia e huaj, përfshirë edhe atë serbe, e akuzon këtë divizion për kryerje të masakrave të mëdha ndaj popullsisë serbe në Kosovë. Shifrat e dhëna për viktimat janë të diskutueshme. Këto veprime të ndërmarra, të cilat në raste të caktuara morën edhe ngjyrimë kriminale, bazoheshin në urrejtjen e akumuluar dhe vuajtjet ndërshekullore të shqiptarëve nga vrasjet, plaçkitjet dhe politika shkombëtarizuese serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë. Pikërisht kjo urrejtje u përdor dhe u shfrytëzua mjeshtërisht nga politika gjermane në trevat shqiptare, këndeje dhe andej kufirit. Neubacher me të drejtë ishte shprehur që në fillim të pushtimit se në Kosovë ata do të gjenin përkrahjen më të madhe. Edhe pasi gjermanët ishin larguar nga Shqipëria, ata vazhdonin të kishin në Kosovë mbështetjen e popullsisë, pjesa më e madhe e së cilës luftonte me fanatizëm kundër ardhjes në

pushtet të komunistëve, sidomos të atyre sllavë. Përvoja historike do të tregonte se ata kishin të drejtë. Pas fitores së Titos dhe vendosjes së regjimit komunist në Jugosllavi, Kosovës jo vetëm që nuk ju dha e drejta e premtuar e vetëvendosjes, por populli shqiptar do të vuante edhe për disa dhjetëvjeçarë të tjerë. Së pari në vitet 1998-1999, populli shqiptar i Kosovës edhe me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, do ta hidhte përfundimisht tej, sundimin serb.

Marenglen KASMI

SUMMARY

THE SS SKANDERBEG DIVISION AND CIRCUMSTANCES SURROUNDING ITS FORMATION IN 1944

The formation of the SS 'Skanderbeg' Division does not necessarily represent an outcome of a political or military occupation of Albania by the Germans during the Second World War. The Third Reich recruited soldiers for the Waffen SS in numerous other countries forming thus foreign SS units. According to German propaganda, through the formation of this division the Albanian government would ultimately have armed forces under its command, which would serve to fight off communists and as a result prevent their advancement after the Germans would leave. This propaganda was successful, especially amongst the poorly educated and impoverished strata, who volunteered for recruitment. The Germans managed to implement the belief that through their support the Albanians would unify in one Albanian state, which would consequently prevent the Serbian reign in Kosova. There were also a number of volunteers who were forced to wear the uniform due to economical reasons. From a military and organizational standpoint, the order to form this division was based on false requests, and as such it resulted in a complete failure on behalf of the Germans and the Albanians who had shown interest in forming this division. The Albanians were not at any point a part of an organized army according to the German perception. The Albanian units that were active up until that point resembled an organized military structure only superficially. As was expected, the formation of the 'Skanderbeg' Division served mostly the Germans and significantly less so the collaborationist Albanian government in Tirana.

KDU: 94(496.51-3)(091)

323.282(496.51-3)

Mrika LIMANI

**NJË ANALIZË KUANTITATIVE E VIKTIMAVE TË
PRIZRENIT DHE RRETHINËS GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE, SIPAS LISTËS SË VIKTIMAVE TË LUFTËS,
LËSHUAR NGA KËSHILLI EKZEKUTIV FEDERAL I
JUGOSLLAVISË**

(Pjesa e parë)

Me gjithë faktin se lëvrimi i burimeve gjatë Luftës së Dytë Botërore ka arritur një shkallë të kënaqshme, duke qenë se është një tematikë me të cilën studiuesit merren tash e pesë dekada, problemi thelbësor qëndron në atë se të dhëna edhe aq të sakta për viktimat në Kosovë nuk ka. Si pasojë, na bie barra si studiues të mbledhim disa të dhëna, sa aty e këtu, në mënyrë që të shtyjme dhe një hap më tutje njohurinë tonë mbi viktimat e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Dy dekada pas përfundimit të LDB, në kohën kur Jugosllavia po zhvillohej si shtet i fuqishëm, madje me rëndësi faktoriale në Evropë, e pa të udhës që të organizojë një komision shtetëror për regjistrimin e viktimave të luftës si pasojë e refuzimit të Gjermanisë për shpagimin e dëmeve të luftës derisa të rezultojnë shifra të sakta mbi viktimat. Me aq pak të dhëna sa kishin mbetur nga katrahura që kishte ndodhur dy dekada para vitit 1964 - atëherë kur edhe u themelua ky komision - të dhënat përfundimisht u mblodhën dhe iu parashtruan Gjermanisë. Të dhënat e nxjerra nga sondazhi i përpiluar nga komisioni i veçantë për regjistrimin e viktimave (*Popis žrtava rata*, Survey), shërbejnë sadopak si bazë për të krijuar një ide të përgjithshme të viktimave të periudhës, e ç'është më me rëndësi, këto të dhëna shërbejnë për të krijuar një ide se cilat grupe

qoftë etnike qoftë politike ishin më të shënjestruarat. Në dritë të të dhënave kuantitative të cilat do t'i nënshtrohen analizës në rreshtat në vijim, kërkojmë të na bëhen të ditura disa çështje: Çfarë kombësie i përkisnin viktimat, në çfarë rrethana janë vrarë (në luftim, apo të shënjestruar si civilë) dhe çfarë treguesi janë ato për magnitudën e dhunës që kishte ngjarë në Prizren dhe rrethinë. Megjithëse burimet e referencuara na japin të dhëna mbi viktimat edhe në Kukës si regjion i përbashkët gjeografik me Prizrenin në raport me luftimet që kanë ngjarë në atë regjion, analiza është e kufizuar brenda territorit të Prizrenit dhe rrethinës.

Në sondazhin e përpiluar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë janë regjistruar 1.1 milion viktima në tërë ish-Jugosllavinë, 597 000 prej të cilëve janë të vdekur. Sondazhi përmban 11 kategori të viktimave, që variojnë nga viktimat e vrara në kampe, burgje, përgjatë deportimit, punë të dhunshme ose gjatë terrorit direkt (me ç'rast nënkuptohen masakrat ose dhuna me qëllim), deri të spektri i viktimave të cilët kanë rënë në luftime, përfshi dhe dy kategori "të tjera" dhe "të panjohur".¹ Në vijim, edhe vetë komisioni e ka pranuar se ka arritur të bëjë regjistrimin e vetëm 56%-59% të viktimave në përgjithësi², fakt ky që vetvetiu e gjymton tërësinë e analizës. Problemi tjetër që paraqitet te sondazhi është njëanshmëria e regjistrimit të viktimave. Kështu viktimat nga dhuna e partizanëve nuk janë regjistruar plotësisht, një kategori e viktimave që në përgjithësi përbën një tërësi për të cilët edhe sot shumë pak dihet. Më tutje, dorasi i dhunës nuk shënohet fare në sondazh, që e vështirëson procesin e identifikimit të magnitudës së dhunës edhe më tej. Megjithatë, duke i marrë parasysh disa parametra të tjera, si vendi i ndodhjes së vrasjes/luftimeve, si dhe viti e muaji, e duke u bazuar në studimet historike të periudhës, mund të përafrohet se midis të cilave palë mund të ketë ndodhur luftimi. Kjo metodë megjithatë nuk është gjithëherë shumë e sigurt, ndaj dhe përfundimet merren parasysh kryesisht si supozime. Analiza e paraqitur në këtë punim i qëndron besnike referencave gjeografike në bazë të organizimit administrativ të Prefekturës së Prizrenit ashtu siç ishte instaluar në gusht të vitit 1941. Prefektura e Prizrenit brenda territoreve nën administrim përfshinte 4 nënprefektura, me 38 komuna, me një sipërfaqe prej 3 090 km², ku

¹Tomislav Dulić, *Utopias of Nation: Local Mass Killing in Bosnia and Herzegovina, 1941-1942*, Acta Universitatis Upsaliensis, Studia Historica Upsaliensia, Uppsala, 2005, f. 47.

²Po aty.

banonin rreth 230 000 banorë. Nënprefekturat të cilat përfshiheshin brenda prefekturës së Prizrenit ishin ajo e Gjakovës, Suharekës, Rahovecit dhe e Dragashit.³

Pasi materiali parësor i cili është përdorur në këtë analizë janë vetë fletushkat e përpiluara nga komisioni i veçantë për regjistrimin e viktimave në komunën e Prizrenit, si i tillë materiali i përdorur në këtë punim është autentik dhe paraqet burimisht të dhënat e nxjerrura nga komisioni në fjalë. Si pasojë, burimet e tjera historike, qofshin ato memoare, studime historike si dhe burime e tjera arkivore mbi çështjen, megjithëse do të merren parasysh, për momentin, do të mbetën jashtë gamës së analizës parësore. Sa i përket seleksionimit të viktimave të cilat janë regjistruar në këtë analizë, në pjesën e parë të saj, që do të paraqitet në këtë artikull, janë regjistruar gjithsej 271 viktima nga 311, prej të cilës shifër 124 kanë qenë viktima që kanë vdekur gjatë luftës dhe në çfarëdo forme të ndërlidhur drejtpërsëdrejti me luftën. Në bazë të pjesës së parë të analizës do të nxjerrin disa përfundime parësore sa i përket këtij grupi të viktimave të regjistruara, përfundime të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë na japin të dhënat sa i përket natyrës së grupit të viktimave që janë vënë në shënjestër, pra qofshin ato etnike apo politike.

Të dhëna statistikore mbi viktimat

Përpunimi i materialit arkivor ka rezultuar se numri i viktimave në Prizren dhe rrethinë prej vitit 1941 deri më 1945 në grupin e parë të viktimave të regjistruara përfshihen gjithsej 124 viktima. Në këtë numër përfshihen të gjitha viktimat të cilat janë vrarë në luftime e sipër, viktima civile, si dhe viktima civile të cilët janë deportuar në kampe përqendrimi apo burgje, të cilët kanë ndërruar jetë ose janë vrarë aty.

Të dhëna statistikore në bazë të grupmoshave të viktimave

Sipas statistikave të nxjerra nga burimet, numri më i madh i viktimave është grupmosha që përfshin vitlindjet 1915-1930, që nënkupton se viktimat i përkasin moshës 15-35 vjeçare. Rrjedhimisht, sipas statistikave i bie që numri më i madh i viktimave kanë përfshirë grupmoshën e meshkujve të cilët kanë qenë në moshë të përshtatshme

³Muhamet Shatri, *Prizreni dhe rrethina në Lëvizjen Nacionalçlirimtare (1941-1945)*, tezë e doktoraturës, Prishtinë, 1981, f. 110-111.

për të luftuar. Njëkohësisht të dhënat tregojnë se numri më i madh i viktimave të kësaj grupmoshe kanë rënë gjatë luftimeve të drejtpërdrejta si partizanë ose janë shënjestruar si partizanë. Nga kjo grupmoshë numri më i madh i viktimave janë regjistruar nën grupin 5 dhe 9 në kategorinë e dhunës, gjegjësisht janë shënuar si viktima të dhunës si civilë dhe si pjesëtarë të LNÇ dhe formacioneve aleate. Disa nga viktimat e grupmoshës 1915-1930 janë shënuar si viktima “ushtar i ish-Jugosllavisë”, gjë që shkakton një grimë huti meqë nuk dihet saktësisht në çfarë rrethana janë vrarë apo në bazë të çfarë cilësie janë shënjestruar⁴. Rasti më i spikatur i viktimave të regjistruara në këtë grupmoshë është pikërisht viktima me emër Muradif Shabani, të cilit kategoria e kombësisë i është regjistruar e panjohur, por megjithatë nga emri (Muradif Husa Shabani) nënkuptohet që bëhet fjalë për shqiptar. Sipas fletës së regjistrimit, viktima në fjalë ka ndërruar jetë në Mynhen të Gjermanisë në 1942⁵. Të dhëna të tjera për viktimitën në fjalë nuk ka, por nga rrethanat nënkuptohet që viktima duhet të ketë ndërruar jetë gjatë internimit.

Karakteristikë tjetër e viktimave të kësaj grupmoshe përbëjnë viktimat që kanë rënë gjatë bombardimeve nga aleatët.⁶ Regjistrimi i kësaj kategorie të viktimave megjithatë rezulton i mangët, ngaqë nga të gjitha viktimat e bombardimeve vetëm dhjetë viktima që ndryshojnë nga të gjitha grupmoshat janë regjistruar në Prizren. Nga kjo grupmoshë vetëm një viktimitë është regjistruar si e rënë gjatë Luftës së Prillit në 1941⁷. Si viktima të rëna gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (kjo kategori në vete dhe e ndarë nga kategoria viktima të LNÇ dhe formacioneve tjera) nga kjo grupmoshë duket të ketë vetëm një.⁸ Të shënjestruar si civilë në këtë grupmoshë janë të përfshirë numër më i madh viktimash.⁹ Nga ky grup i viktimave të shënuar si civilë është karakteristike tri prej tyre duket të jenë vrarë gjatë periudhës së administrimit gjerman (1943-1944)¹⁰, përkundër

⁴Kështu qëndron konkretisht rasti me viktimat e regjistruara te *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIHP*), F. Regjistrimi i viktimave gjatë Luftës së Dytë Botërore, 1941-1945, M 34, M 17 dhe M 117.

⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 117, i regjistruar si Muradif Shabanoviq.

⁶Këtu bëhet fjala për të rënë në Gjakovë, Prizren dhe Ivanjiq Grad (Kroaci). Shih M 123, M 107, M 80 dhe M 47.

⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 46 (viktimë e cila është regjistruar si femër, mirëpo emri lë të kuptohet që bëhet fjalë për viktimitë të gjinisë mashkullore).

⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 108.

⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 118, M 111, M 102, M 94, M 93, M 84, M 83, M 32, M 23, M 20, M 18, M 9, M 8 dhe M 6.

¹⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 32, M 20 dhe M 6.

numrit tjetër të viktimave që rezultojnë të kenë rënë gjatë periudhës së administrimit italian (1941-1943).

Sa i përket viktimave të internimit në këtë grupmoshë rezulton të jetë vetëm një, ku sipas të dhënave bëhet fjalë për një hebre i cili duket të jetë internuar së bashku me familjen në Bergen Belsen. Këtu bëhet fjalë për familjen Bahar nga Prishtina, ndërkaq viktimë në fjalë e kësaj grupmoshe është Solomon Bahar¹¹. Të regjistruar si viktimë të burgosjes në këtë grupmoshë janë gjithsej gjashtë viktimë. Mes këtyre viktimave i regjistruar është edhe Sezai Surroi.¹² Grupmosha që përfshin vitlindjet 1900-1915 përbën grupmoshën e 31% të viktimave të luftës. Në këtë grupmoshë viktimë të internimit janë tre, ku njeri prej tyre, Xhevdet Doda, ishte internuar në Mathauzen¹³, dhe Zundija Solomon, hebreje nga Prishtina, e internuar në Bergen Belsen¹⁴. Ndërkaq, si viktimë të burgosjes janë të regjistruar vetëm tri.¹⁵ Si viktimë të punës së dhunshme, në anën tjetër, janë të regjistruara dy viktimë.¹⁶

Ngjashëm si me grupmoshën 1915-1930, edhe te grupmoshat 1900-1915, një përqindje të lartë e përbëjnë viktimat që janë shënuar si civilë. Këtu gjithsej janë të regjistruara dhjetë viktimë, të cilët kanë rënë në periudha të ndryshme, por kryesisht në rrethinën e Prizrenit.¹⁷ Për këtë grupmoshë është karakteristike numri më i madh i viktimave të cilët janë regjistruar si ish-ushtarë të Jugosllavisë. Në këtë grup bëjnë pjesë gjithsej gjashtë viktimë të tilla, të cilët kanë rënë gjithandej trojeve shqiptare, si: Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, madje njëri dhe në Vlorë.¹⁸ Në anën tjetër, në këtë kategori bëjnë pjesë edhe dy viktimë të cilët kanë ndërruar jetë në Gjermani.¹⁹ Të gjithë këta kanë vdekur në 1945. Ndërkaq, si luftëtar i LNÇ në këtë grupmoshë është regjistruar vetëm një viktimë.²⁰ Në Luftën e Prillit viktimat e kësaj grupmoshe rezultojnë të jenë tri.²¹ Ngjashëm si me grupmoshën 1915-1930, edhe te grupmosha 1900-1915, numri më i madh i viktimave rezulton të jetë

¹¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 87, M 89, M 90.

¹² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 54.

¹³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 33.

¹⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 89.

¹⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 82, M 25, M 3

¹⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 124, M 74,

¹⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 12, M 19, M 22, M 49, M 55, M 70, M 75, M 102, M 106.

¹⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 14, M 34, M 50, M 81.

¹⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 16, M 120.

²⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 109.

²¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 21, M 46, M 48.

ndër ata që kishin luftuar me LNÇ dhe formacionet aleate²².

Te grupmosha 1866-1899, në krahasim me grupmoshat tjera, paraqitet numri më i madh i viktimave të internuara. Gjegjesisht, në këtë grup bënë pjesë, pjesa dërmuese e familjes hebreje Bahar nga Prishtina. Sipas të dhënave e gjithë familja ishte internuar në kampin e shfarosjes Bergen Belsen²³. Te kjo grupmoshë sërish na paraqitet numri më i madh i viktimave të shënjestruar si civilë²⁴. Në këtë grupmoshë një numër pothuajse i barabartë i viktimave janë shënuar gjatë administrimit italian njëjtë sikurse gjatë atij gjerman. Në këtë grupmoshë vetëm një viktimitë është e regjistruar në kategorinë e ish-ushtarit të Jugosllavisë.²⁵ Në anën tjetër, në Luftën e Prillit rezultojnë të kenë rënë tri viktima nga kjo grupmoshë²⁶. Ndërkaq, nuk është e habitshme që duke marrë parasysh moshën që mund të kenë pasur viktimat nga kjo grupmoshë, vetëm një viktimitë është regjistruar si i rënë në luftë të LNÇ dhe formacioneve aleate²⁷. Viktima të tjera të kësaj grupmoshe nuk ka. Është karakteristike se përpos të gjitha këtyre viktimave janë të regjistruara edhe katër viktima që i përkasin grupmoshës 1930-1937, viktima këto që i bie të kenë qenë shumë të rinj në periudhën kur kanë vdekur. Nga këto viktima njëri ka vdekur gjatë bombardimeve nga aleatët në Gjakovë në maj të 1944²⁸, njëri si pjesëtar i LNÇ²⁹, dhe dy të tjerë të shënjestruar si civilë³⁰.

Të dhëna statistikore në bazë të kombësisë së viktimave

Regjistrimi i viktimave në sondazhin e përpiluar nga Këshilli Ekzekutiv i Jugosllavisë përmban në vete të dhëna të rëndësishme sa i përket kombësisë së të rënëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sa i përket të dhënave statistikore të nxjerra nga grupi i parë i viktimave që përfshihen në këtë analizë, këto të dhëna tregojnë se përqindja më e

²² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 40, M 41, M 42, M 44, M 53, M 58, M 65, M 69, M 73, M 91, M 113.

²³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 89, M 90 dhe M 88, por që nuk duket të ketë qenë pjesëtar i familjes Bahar.

²⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 2, M 5, M 7, M 10, M 27, M 29, M 86, M 95.

²⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 4.

²⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 45, M 52, M 121.

²⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 59.

²⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 80.

²⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 63.

³⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 8, M 9.

madhe e të rënëve gjatë luftës përbëhet nga viktimat e kombësisë serbe me një përqindje prej 45.9% nga shifra e përgjithshme e viktimave të regjistruara në këtë analizë. Numri i dytë më i madh i viktimave i përket kombësisë shqiptare me përqindje prej 38.70%, ndërkaq më pastaj vjen kombësia malazeze me 6.40%, turke 2.40% dhe hebreje me 1.60%.

Grupmoshat	Numri i viktimave	Përqindja e viktimave
1866-1900	24	19.30%
1900-1915	38	31%
1915-1930	58	47%
1930-1937	4	3.20%

Tabela 1. Përqindjet e viktimave në bazë të grupmoshave

Është e një rëndësie të veçantë të theksohet se duke pasur parasysh marginën e gabimeve që mund të kenë ndodhur gjatë procesit të regjistrimit të viktimave, një numër i viktimave rezulton të jetë regjistruar me kombësi të gabuar. Kjo mund të vërehet fare lehtë nëse krahasohet emri i viktimës me kombësi, ku ka shumë raste që emra që duken shqiptarë të jenë regjistruar si të kombit serb ose malazez apo dhe e kundërta. Kështu është konkretisht rasti me viktimën e quajtur Bari Romusoviq, i cili është regjistruar si serb.³¹ Megjithatë, duke gjykuar nga emri si dhe nga viktimat e familjes së njëjtë të regjistruara në vijim, na qartësohet se viktimat mund të ketë qenë shqiptar. Anëtarët tjerë të kësaj familje, që gjithashtu kanë rënë gjatë luftës, pra janë regjistruar si shqiptarë.³² Një rast i ngjashëm paraqitet edhe te viktimat e regjistruar si Adem (Bajram) Bajrami, që sipas sondazhit është regjistruar si turk.³³ Më i spikatur është rasti i regjistrimit të Sezai Surroit, i cili gjithashtu është i regjistruar gabimisht si turk.³⁴ Rast i ngjashëm duket të jetë edhe me viktimën e regjistruar si turk të quajtur Bajram (Jusuf) Kriz (?), prejardhja e tij dhe rrethanat e vdekjes të së cilit janë të panjohura.³⁵ Në anën tjetër rezultojnë edhe viktimat të cilët nga emri duket të kenë prejardhje sllave, por që janë regjistruar si shqiptarë, siç është rasti me

³¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 6.

³² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M8, M 9.

³³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 39.

³⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 54.

³⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 96.

Ilija (Jovan) Rajizoviq.³⁶ Te disa viktimat kombësia nuk është shënuar fare, mbase për shkak të pamundësisë për verifikimin e të dhënave, por në këso raste sërish emri i viktimës shërben për të dhënë një ide të përgjithshme se çfarë kombësie mund të ketë qenë viktimat. I tillë është rasti me viktimën Osman (Husa) (?), i cili gjykuar në bazë të emrit mund të ketë qenë shqiptar.³⁷ Ngjashëm ndodhë edhe me viktimat e sipërpërmendura Muradif (Husa) Shabanoviq dhe Fadil (Husa) Shabanoviq.³⁸

Përqendrimi gjeografik i dhunës në Prizren dhe rrethinë

Siç është dhe e pritur nga analiza, statistikat e viktimave të regjistruara në rrethinën e Prizrenit paraqesin edhe pikat më të mëdha të përqendrimit të dhunës në Prizren. Numri më i madh i viktimave brenda një periudhe të shkurtër janë viktimat e rëna në Luftën e Prillit, shumica e të cilëve kanë rënë në

Kombësia ³⁹	Numri i viktimave	Në përqindje
1	57	45.90%
2	0	
3	0	
4	0	
5	8	6.40%
6	0	
7	2	1.60%
8	3	2.40%
9	48	38.70%

Tabela 2. Përqindje të viktimave në bazë të kombësisë

vijën Prizren-Suharekë, ku dhe janë zhvilluar luftimet.⁴⁰ Dy viktimat tjera janë të regjistruara në periudhën e muajit maj të vitit 1941,⁴¹ ku

³⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 98.

³⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 102.

³⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 117, M 118.

³⁹ Kombësia 1: Serb, 2: Kroat, 3: Slloven, 5: Malazez, 7: Hebre, 8: Turk, 9: Shqiptar.

⁴⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 17, M 21, M 23, M 45, M 46, M 47, M 48, M 50, M 52, M 122.

vend i vdekjes së njëres viktimë nuk dihet, ndërkaq tjetri duket të ketë rënë në arrati në Karaxhorgjeviq. Një fluks të madh të viktimave rezulton të ketë në periudhën tetor-nëntor 1941, të dhëna këto që tregojnë për një intensitet më të madh të dhunës të ushtruar ndaj civilëve.⁴² Meqë numri dërmues i viktimave duket të kenë rënë në regionin Prizren-Mushtisht-Suharekë, mund të deduktohet se dorasit mund të kenë qenë italianët të cilët kishin nën kontroll ushtarak këtë region. Në anën tjetër, të dhënat tregojnë se dhuna ndaj civilëve ishte më e pakët në vitin 1942, në të cilin vit janë regjistruar pesë viktima gjithsej të cilët kanë rënë në periudhën shtator-dhjetor.⁴³

Përkundër vitit 1942, një fluks dukshëm më i madh viktimash është regjistruar në vitin 1943. Duke i pasur parasysh rrethanat politike dhe trazirat ushtarake është e arsyeshme të shihet një numër më i madh viktimash gjatë vitit 1943, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të këtij viti. Kështu si shembull një viktimë e regjistruar si Muja Sura (emri i plotë i palexueshëm), i lindur në 1892, është i regjistruar si i rënë më 10 shkurt 1943⁴⁴, ditë kjo që përputhet me dhunën e ashtuquajtur nazifashiste të ushtruar ndaj simpatizuesve të LNÇ.⁴⁵ Ngjashëm mund të supozohet se ka ndodhur me viktimën e quajtur Anton Fishiq (emri i plotë i palexueshëm), i cili gjithashtu ka rënë në shkurt të 1943.⁴⁶ Pas ndërrimit të administrimit nga ai italian në atë gjerman, grupet që quheshin kushtimisht diverzive jo vetëm që u forcuan në numër dhe armë, por edhe e intensifikuan aktivitetin e tyre. Si pasojë një numër i madh aktivistësh të Frontin nacionalçlirimtar u viktimizuan.⁴⁷ Periudha shtator-dhjetor e vitit 1943 duket të ketë qenë veçanërisht e dhunshme. Pjesa më e madhe e dhunës rezulton të ketë qenë e përhapur në regionin Prizren-Suharekë, gjatë së cilës është e ditur se aktiviteti i partizanëve ishte më i madh, posaçërisht në këtë region të Dukagjinit.⁴⁸

⁴¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 15, M 95.

⁴² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 2, M 5, M 8, M 9, M 10, M 12, M 14, M 16.

⁴³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 34, M 96, M 100, M 101, M 106.

⁴⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 29.

⁴⁵ Izber Hoti, *Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë, 1999, f. 48.

⁴⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave... M 93.

^{47,48} AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 3, M 13, M 18, M 25, M 29, M 32, M 49, M 70, M 71, M 83, M 84, M 88, M 92, M 94, M 112, M 115, M 116, M 118, M 121, M 123.

⁴⁸ Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 1998, f. 49.

Gjatë kësaj periudhe viktimat rezultojnë të kenë qenë si të kombësisë serbe, ashtu edhe shqiptare, emrat e të cilëve janë të njohur si pjesëtarë ose simpatizues të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.⁴⁹ Kjo periudhë përkon konkretisht me tentativat e ushtrisë gjermane për përhapjen e administrimit të tyre në tërë regjionin e Dukagjinit, nismë kjo që u has në kundërshtim me aradhët, sado të vogla partizane. Andaj, nuk është e habitshme që vendosja e administrimit gjerman në këtë territor përkon ngritjen e magnitudës së dhunës në këtë regjion si pasojë e një kundërpërgjigje të armatosur nga partizanët.⁵⁰

Në anën tjetër, të dhënat tregojnë se viti 1944 duket të ketë qenë më i dhunshmi gjatë luftës. Zmadhimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe intensifikimi i aksioneve kundërgjermane të partizanëve, detyrimisht pasoi me numër më të madh viktimash nga ana e partizanëve. Përballja me ushtrinë gjermane si dhe me vullnetarët shqiptarë ishte më e vështirë për partizanët, të cilët jo vetëm që ishin të pakët në numër, posaçërisht në Kosovë, por edhe kishin armatim modest. Si pasojë ky vit shënon rënien e numrit më të madh të viktimave partizane, pra që i bie se viktimat nuk u vranë në cilësinë e civilëve.⁵¹ Kjo dhunë paraqitet posaçërisht e intensifikuar gjatë vjeshtës së 1944, kur edhe u bë tërheqja përfundimtare e Grupit "E" të Armatës gjermane. Gjatë kësaj periudhe të fundit të 1944, numri më i madh i viktimave të Prizrenit duket të kenë rënë në regjionin Mitrovicë-Rudnik, aty ku kanë ndodhur luftimet frontale me trupat gjermane.⁵² Viti 1945 është tejet karakteristik me faktin që viktimat që kanë rënë gjatë këtij viti i përkasin kryesisht kombësisë shqiptare. Deduktuar nga të dhënat një gjë e tillë nuk është e habitshme nëse merret parasysh luftimi i partizanëve mes vullnetarëve shqiptarë, ose shqiptarëve që nuk ishin me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, të cilët zakonisht cilësohen si ballistë nga historiografia kosovare.⁵³

⁴⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 32, M 49, M 70, M 71, M 83, M 88, M 99, M 103, M 105, M 112, M 121.

⁵⁰ Për gjendjen e intensifikuar të dhunshme shih Hakif Bajrami, *Dokumente të institucioneve gjermane për historinë shqiptare 1941-1944*, Vatra, Prishtinë, 1998, f. 115-118.

⁵¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 6, M 7, M 20, M 27, M 28, M 31, M 33, M 38, M 39, M 54, M 55, M 58, M 59, M 60, M 73, M 74, M 75, M 77, M 78, M 80, M 85, M 86, M 91, M 98, M 107, M 109, M 110, M 113, M 114, M 124.

⁵² Izber Hoti, *Forcat e armatosura...*, f. 158.

⁵³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 24, M 26, M 35, M 36, M 37, M 40, M 41, M 42, M 43, M 44, M 51, M 56, M 61, M 62, M 63, M 64, M 65, M 66, M 67, M 69, M 76, M 81, M 82, M 87, M 89, M 90, M 120.

Numri i viktimave në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore të nxjerra nga kjo analizë na qartësojnë disa çështje parësore. Së pari, nga të dhënat është e qartë se numri më i madh i viktimave i përket kombësisë serbe dhe asaj shqiptare, të cilët gjatë periudhave të ndryshme gjatë luftës i janë nënshtruar dhunës kryesisht në cilësi politike, posaçërisht gjatë viteve 1941-1943. Megjithatë, numri dërmues i viktimave gjatë kësaj periudhe kanë rënë në cilësinë e civilëve, pavarësisht animeve politike. Të dhënat në vijim kanë dëftuar se gjatë periudhës 1944-1945 viktimat kanë rënë në cilësi politike, por kësaj radhe jo në cilësinë e civilëve, por në cilësinë e partizanëve të armatosur. Një intensitet i tillë i viktimave është posaçërisht evident në vitin 1944, kur ushtria gjermane po zhvillonte luftë frontale me partizanët. Në anën tjetër, viktimat që kanë rënë gjatë vitit 1945 kanë rënë në kombinim të cilësisë politike edhe asaj etnike. Megjithëse është e qartë se numri më i madh i viktimave të kësaj periudhe i përket kombësisë shqiptare, supozohet me të drejtë se ata janë vrarë në cilësinë e kundërshtarëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në aspektin politik.

Mrika LIMANI

SUMMARY

A QUANTITATIVE ANALYSIS OF THE VICTIMS PERTAINING TO THE SECOND WORLD WAR IN PRIZREN AND ITS VICINITY ACCORDING TO THE LIST OF WAR VICTIMS PUBLISHED BY THE FEDERAL EXECUTIVE COUNCIL IN YUGOSLAVIA

The Second World War had a grave impact on Kosova and resulted in significant number of victims. As a result of the nature of the war, a large number of victims were targeted as civilians, especially during the initial years into the war. The development of the National Liberation Movement resulted in an increase of victims who had fallen as Partisans during the war, which added another dimension to the war in Kosova. The expansion of violence in the region of Prizren as reflected by the previous analysis, informs us on what grounds the victims were targeted, be it of a political or ethnic nature. The intensification of the war and the increase of attacks conducted by both the Partisans and the Germans had ultimately caused an increase of victims in the region of Prizren, in particular during 1941. Alternatively, the year 1945 is characterized by a higher number of victims who were targeted by Partisans, where coincidentally the latter were predominantly targeted and fallen as victims in the initial years of the war. Ultimately, the analysis has proven that a larger flux of victims targeted as civilians was evident during the Italian reign, 1941-1943, whereas a larger flux of victims targeted as armed groups was apparent during the German reign, 1941-1943, whereas the largest flux of civilian victims targeted on ethnic grounds was most palpable during 1945.

KDU: 94(496.51)"1945/1999"
323.1(496.51)(091)

Sabile KEÇMEZI - BASHA

**LËVIZJA ILEGALE KOMBËTARE SHQIPTARE NË
KOSOVË (1945-1999)**

Okupimi i Kosovës dhe veprimtaria ilegale e shqiptarëve

Në Jugosllavinë e pasluftës u deklaruan se kriteri kombëtar do të vihej në themel të ndarjes territoriale dhe administrative të vendit. Në mbledhjen e dytë të KAÇKJ-së u deklarua kategorikisht se pakicat kombëtare do t'i kenë të gjitha të drejtat në Jugosllavinë e re dhe trumbetohej se këto do të jenë parimet themelore të shtetit socialist. Me vendimet e KAÇKAJ-së, e më vonë me Kushtetutën e vitit 1946 u "garantohej" liria kombëtare dhe barazia e plotë e kombësive në pikëpamje politike, ekonomike, kulturore dhe në çdo pikëpamje tjetër. Me nenin 21 të Kushtetutës, thuhej edhe kjo: "Të gjithë qytetarët e R.F.P.J-së janë të barabartë para ligjit, pa marrë parasysh përkatësin kombëtare, racën dhe fenë. Nuk pranohen kurrfarë privilegje, prej lindjes, pozitës, gjendjes materiale dhe ngritjes profesionale".¹ Ndërsa, Tito në fund të luftës më 1945, në bisedë me një grup të deleguar shqiptarësh nga Kosova, i kishte njoftuar me qëndrimet e partisë duke shtuar "se populli shqiptar duhet ta ketë të ditur se Jugosllavi po krijohet. Dhe në këtë bashkësi të re e cila na kushtoi aq shumë gjak të derdhur, do të jenë të barabartë dhe do të jenë të barabartë dhe do t'iu ofrohen të gjitha mundësit që të zhvillojnë dhe afirmojnë kulturën e tyre, do të kenë shkollat e veta, do të zhvillojnë bujqësinë. Populli

¹ Arhiv Centralnog Komiteta KPJ, F. CK.KPJ. 1948, IV Oblasna Konferencija KPS za Kosovu i Metohiju 1948, Raporti politik i Gjoka Pajkoviçit.

shqiptarë në Jugosllavi do të fitojë të gjitha ato të drejta që popullin e lirë e bëjnë popull”.² Por, pas përfundimit të luftës këto kritere për pushtetin jugosllav, nuk ekzistonin dhe si të tilla nuk u morën parasysh. Edhe pse viset shqiptare përbënin një tersi territoriale, ishin kompakt nga pikëpamja kombëtare, kishin një vijueshmëri e shtrirje të përcaktuar qartë nga pikëpamja gjeopolitike gjatë kufirit me trungun amtar dhe me republikat e tjera të Jugosllavisë, u ndanë midis njësive federale të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.³ Të gjitha këto ndikuan që në popullatën shqiptare të rritet pakënaqësia. Këtë më vonë e pranuan edhe vetë udhëheqësit jugosllavë. Jeta në sistemin e “ri e socialist” në Kosovë filloi me shumë vonesë në çdo pikëpamje, mirëpo edhe me hipoteka të ndryshme nga e kaluara. Kosova u konstituua si pjesë e Serbisë gjysmë viti pas “çlirimit” dhe tre muaj pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Gjendja e rëndë që pasoi në Kosovë pas përfundimit të luftës, ndikoi që pakënaqësia e rezistenca të forcat nacionaliste të marrin hov kundër shtypjes dhe kundër pushtuesit. Për organizimin e qëndresës popullore, për punimin e programit e të kërkesave të populli shqiptar në këto treva u formuan dhe u riaktivizuan grupe dhe organizata politike që ishin pjesë përbërëse e LNDSH-së, por që kishin programe me dallim nuancash në të shprehur, por qëllimi suprem i tyre ishte çlirimi i tokave shqiptare nga Jugosllavia e Titos dhe bashkimi i tyre në një Shqipëri Etnike. Nga ana tjetër, është e domosdoshme të nënvizohet se nacionalizmi shqiptar ka një dallim esencial nga nacionalizmat e tjerë ballkanik. Ai në veprimtarinë e vet nuk ishte ekstrem, nuk kishte parashtruar revizionizmin e dhunshëm territorial, nuk bazohej në fundamentalizëm fetar dhe në ekskluzivitetin etnik.⁴ Aneksimi i Kosovës me Serbinë ishte vetëm një pjesë e padrejtësisë që u bëhej shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste, sepse çështja e Kosovës nuk ishte krejt çështja shqiptare. Kosova jo vetëm që u shkëput nga trungu amë, por asaj iu shkoqën jo vetëm trevat e banuara kryekëput ose kryesisht me popullatën shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi, por edhe Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, në Serbinë Jugore, në të cilat shqiptarët ishin shumicë dërmuese.

Duke ecur në gjurmët e nacionalizmat shqiptare, mbledhja e Bujanit (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944), përcaktoi si synim

² Arkivi i Komitetit Krahinor të LKK, Fondi I LKK, dok. 711.

³ Lefter Nasi, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1990, f. 409.

⁴ Beqir Meta, Nacionalizmi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore, “E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike” - 2, Prizren, 2005. f. 10

madhor bashkimin e trojeve shqiptare. Këto vendime që u morën në këtë mbledhje, nuk ishin shfaqje e ndonjë nacionalizmi ekstrem, edhe pse më vonë nuk u përfillën vendimet e saja. Nuk u morë parasysh e drejta e vetëvendosjes së popullit shqiptarë për luftën e sakrificën që bënë. Periudha e mëvonshme provoi se ky copëtim ishte burim kryesor i pakënaqësive që ndodhën në popullatën shqiptare. Tradhtia që ndodhi më 8-10 korrik 1945, illegalen shqiptare e detyroi që të kërkonte përkrahjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin e forcave demokratike perëndimore. Ilegalja shqiptare duke e parë se tokat e saja po rrëshqitnin në prehrin sllav, filluan organizimet për t’iu kundërvënë qëllimeve gllabëruese jugosllave. Pas luftës (1945 e këndej) nacionalizmi shqiptar do të zhvillohej në emigracionin e detyruar, ndërsa ato forca apo elemente, që mbetën në trojet etnike shqiptare në ish- Jugosllavi do të ndesheshin në këto regjime në një betejë të pabarabartë, fundi i së cilës ishte tragjik për illegalen shqiptare.

Vendimi për aneksimin e Kosovës me vise të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe copëtimi i saj midis Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë

Në të vërtetë, më 9-12 nëntor 1944 në Beograd, në mbledhjen e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, para se Tito të priste një grup shqiptarësh nga Kosova që vinin për t’u interesuar për fatin e saj jetik⁵ u bë fjalë për Kosovën. Thënë më drejt, për Kosovën ishte bërë fjalë edhe më 2 shtator të vitit 1944, kur Shtabi Kryesor i UNÇ-së dhe AP-së të Kosovës, me urdhrin e Shtabit Suprem të UNÇ-së dhe APJ-së u vu nën komandën e Shtabit Kryesor të UNÇ-së dhe AP-së të Serbisë. Prej kësaj kohe, Shtabi Kryesor i UNÇ-së të Kosovës u bë Shtab Operativ i UNÇ-së dhe AP-së të Kosovës.⁶ Në shkurt të vitit 1945, në KQ të PKJ-së u organizua një mbledhje, ku veç debateve tjera u fol edhe për Kosovën dhe statusin e ardhshëm të saj. Nga e tërë kjo doli se zgjidhja më e mirë dhe më e drejtë ishte se “Kosova e Metohija t’i bashkohen Shqipërisë, kurse Shqipëria të hyjë në Federatën Jugosllave”, por meqenëse rrethanat ndërkombëtare nuk janë të favorshme për një hap të tillë - për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe hyrjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave, Kosova dhe Metohija

⁵ Shaban Braha, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990), Gjakovë, 1991, f. 472.

⁶ Hakif Bajrami, Kosova prej Bujanit në Kaçanik, Prishtinë 1997, f. 269.

si autonomi duhet t'i bashkohen Serbisë,⁷ por kishte edhe aso propozime që Kosova t'i takojë vetëm Malit të Zi, ngase kishin një histori të ngjashme dhe një mentalitet të përafërt me shqiptarët.

Në dokumentet e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, që u mbajt më 7-9 prill të vitit 1945 në Beograd, nga Kosova merrnin pjesë si mysafirë Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha, të cilët në seancë diskutuan dhe sipas dokumentit thuhej se shprehën dëshirën në emër të popullit të Kosovës që “Kosova të jetë nën Serbinë federale”.⁸ Në diskutimin e Dushan Mugoshës në mes tjerash vlen të veçojmë këtë kur ai në emër të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit përcjellë përsëritet dhe dëshirat se popujt e Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit t'i bashkohen Serbisë federale vëllazërore. Duke shprehur këtë vullnet të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar, shpreh dëshirën e popullit shqiptar, të popullit serb e malazias.⁹ Po në këtë frymë diskutoi edhe mysafiri tjetër nga Kosova, Mehmet Hoxha, i cili me diskutimin e tij vërtetoi fjalët e të mëparshmit duke thënë se “Dëshira, të cilën e shprehu shoku Mugosha, që Kosova e Rrafshi i Dukagjinit t'i bashkohen Serbisë Federale, nuk e frikëson popullin shqiptar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, por e forcon dhe i jep siguri se do të ketë po ato të drejta që i kanë edhe popujt e tjerë të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit¹⁰, dhe nga këto diskutime që u bënë në Beograd mund të konkludojmë se Kosova iu bashkua Serbisë në mënyrë arbitrar, në bazë të diskutimeve që u bënë nga dy mysafirë, e dihej mirë në bazë të dokumenteve historike se Kosova dhe populli i saj asnjëherë nuk diskutoi dhe votoi që ajo të ngeli në kuadrin e Serbisë federale. Për të qenë çdo gjë në rregull dhe e ligjshme, Serbisë dhe Jugosllavisë iu nevojitët edhe ana formale për të marrë verdiktin e popullit në një Kuvend sado formal që të jetë, por para opinionit të gjerë ta justifikojë tradhtinë e menduar me aq perfiditet.

Andaj, për të dal vendimet e ligjshme u thirr Kuvendi i Dytë i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit.

⁷ Branko Horvat, *Kosovsko pitanje*, Zagreb 1988, f. 62.

⁸ Rezoluta e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë lidhur me vendimin e KAÇK të Sanxhakut dhe deklaratat e delegatëve të KKNÇ të Vojvodinës dhe të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, *Gazeta “Borba”*, 9 prill 1945.

⁹ Diskutimi i Dushan Mugoshës në seancën e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë më 7-9 prill 1945.

¹⁰ Diskutimi i Mehmet Hoxhës, në seancën e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë më 7-9 prill 1945, Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit në Kaçanik*, f. 270.

Mbledhja e Kuvendit u mbajt më 8-10 korrik 1945, dhe i tërë ky tubim kaloi me presione nga më të ndryshmet ngase aty merrnin pjesë shumë atdhetarë e patriotë të shquar të cilët as me çmimin e jetës nuk pranonin që tokat shqiptare të ngelnin nën ish-Jugosllavi. Ata që e kundërshtuan një hap të tillë, më vonë u njëkën, u burgosën pa arsyetim, e disa edhe u likuiduan tinëzisht nga organet e OZN-së. Të tillët ishin mjaft, por po përmendim vetëm rastin e patriotit të shquar të Anamoravës, Ramiz Cërrnicën i cili në Kuvend doli haptas kundër qëndrimeve gllabëruese të Serbisë duke thënë se: “Ne jemi shqiptarë, kemi një gjuhë e një gjak me shqiptarët e Shqipërisë. Ku keni parë ju në historinë e njerëzimit që fëmija t’ia kthej shpinën nënës e ta përqafojë njerëkën? Kjo s’është as e logjikshme e as e pranueshme për ne shqiptarët”¹¹, por pas këtij diskutimi, në sallë u krijua një tollovi, disa nga udhëheqësit kërkuan që t’i ndërpritet fjala, disa kërkuan që të nxirret jashtë, dhe shumë propozime të tjera. Por, kaluari i Ramiz Cërrnicës nuk përfundoi me kaq, ai më vonë u ndjek dhe u arrestua nga organet e OZN-së, ku u dënua me 20 vjet burg të rëndë. Edhe pas daljes nga burgu, atë nuk e lanë të qetë, njëherit edhe anëtarët e tjerë u përcollën dhe disa nga ta kaluan vite të tëra nëpër burgjet jugosllave.

Pasi u përligj e drejta e vetëvendosjes dhe pas qëndrimit që në Kosovë të vihej administrimi ushtarak, forcat nacionaliste vëren me kohë se Kosovës po i përgatitej laku, andaj pakënaqësinë dhe revoltën e vetë e shprehen edhe më dendur nga fundi i nëntorit 1944 dhe fillimi i vitit 1945. Gjatë kësaj periudhe fillojnë kontaktet intensive në mes personaliteteve më të vendosura, më atdhetare dhe më besnike të çështjes kombëtare. Tërë këto padrejtësi me arsye krijuan tek shqiptarët pakënaqësi. Mu për këtë, një organizim më i shpejt dhe më i mirë pritej nga shqiptarë patriotë e intelektualë. Në këtë periudhë dhe nën këtë trysni të vazhdueshme lindën dhe vepruan forcat nacionaliste në mënyrë të organizuar nëpërmes të organizatave ilegale që qëllim parësor e suprem kishin: çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me shtetin amë - Shqipërinë. Edhe pse pushteti jugosllav i dinte qëllimet e nacionalizmës shqiptare, ajo propagandonte se, këto organizata ishin armiqësore, nacionaliste, separatiste, dhe veprojnë pa sukses, të nxitura nga shtetet perëndimore.

Në këto momente kritike të historisë, nacionalizmi shqiptar ende zotëronte një potencial njerëzor si në aspektin politik, ekonomik dhe në

¹¹ Afërdita Halimi-Cërrnica, Raif Halim Cërrnica (veteran i luftës dhe i demokracisë në Kosovë), Tiranë, 2000, f. 21.

atë ushtarak, i cili pas padrejtësive të shumta po vihej në veprim për ta ndryshuar situatën.

Organizimi i ilegales në Kosovë

Bërthamën e forcave nacionaliste për formimin e Ushtrisë Demokratike Shqiptare e gjejmë në marsin e vitit 1945.¹² Pas formimit të Komitetit Suprem të Kosovës të Adem Gllavicës më 1 dhjetor 1944, lindi ideja që në çdo pjesë të Kosovës, aty ku jetojnë shqiptarët, të formohen organizatat patriotike si dhe grupet e ilegales shqiptare. Në vazhdim të këtij aktiviteti të lëvizjes ilegale, u formuan shumë organizata patriotike shqiptare, me një distancë kohore të caktuar e që manifestohen sidomos pas vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945. Në këto vite, nga populli i okupuar formohen organizatat më të fuqishme nacionaliste siç ishin: Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH), Besa Kombëtare (BK), Organizata nr. 2¹³ dhe Këshilli i të Dymbëdhjetëve¹⁴, e disa të tjera më pak të njohura. Në këto grupime nacionaliste përfaqësoheshin gjerësisht inteligjencia e re nacionaliste shqiptare e cila aspironte për një Shqipëri të bashkuar dhe demokratike.

Periodizimi i Lëvizjes Ilegale në Kosovë

Hulumtimet e shumta kanë vërtetuar se periodizimi i Lëvizjes Ilegale shqiptare në Kosovë ka hasur në shumë dilema në kohën sa veproji në sistemin okupues ish-jugosllav. Lëvizja Ilegale brenda viteve të lartpërmendura (1945-1989), vazhdimisht ka për bazë përfundimin e

¹² Daut Bislimi, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997. f. 228.

¹³ Organizatën nr. 2, e formoi Ajet Gërguri në prill të vitit 1945. Prej janarit të vitit 1946, quhet edhe me një emër të ri “Shtabi i Zonës II-të LPLTSH. Gjatë tërë veprimtarisë së saj ishte e lidhur ngushtë me organizatën patriotike “Besa kombëtare”. Anëtarët e kësaj organizate ishin njerëz të shquar të lëvizjes shqiptare si në fushën politike, ashtu edhe në atë luftarake. Për këtë arsye, kjo organizatë mori për detyrë përgatitjen e Kongresit të Lipovicës të LNDSH, të mbajtur më 25 korrik 1946 në malet e Lipovicës.

¹⁴ Në Kuvendin e Dobërdolit, u zgjodhën udhëheqësit e sektorëve sipas parimit territorial. Duke mos lënë anash as udhëheqjen ushtarake e politike të sektorëve. Pasi se Kosova në këtë Kuvend u nda në 12 sektorë, andaj ishte krejt e natyrshme të caktohen komandantë dhe po aq komisarë politikë. Ky grup i përbërë prej 12 komandantëve e komisarëve politikë u quajt “Dymbëdhjetë Këshilltarët” apo “Këshilli i të Dymbëdhjetëve”.

Luftës Dytë Botërore (1945) dhe vitin 1989 kur në një mënyrë në ish-Jugosllavi fillon edhe sistemi pluralist i pandëshkuar. Ka mundësi dhe ka vend që ndarja në etapa të bëhej në mënyra të shumta, duke pasur për bazë shumë faktorë, si atë politiko-ideologjik; zhvillimet e situatës politike në Jugosllavi dhe në bazë të kërkesave të ilegales shqiptare.

Në baza politiko-ideologjike

Periodizimi i Lëvizja Ilegale në Kosovë, që bëhet në baza politiko-ideologjike, nuk mundet të jetë edhe aq strikte ngase brenda kufijve të Jugosllavisë ideologjia komuniste si në Shqipëri, po ashtu edhe në Jugosllavi ka qenë gati-gati e njëjtë dhe nuk ka pasur edhe aq mundësi për të manipuluar me vite e data të caktuara. Ta zëmë, menjëherë pas përfundimit të LDB, organizatat që u formuan në Kosovë kryesisht ishin me karakter djathtistë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në programet e tyre politike kërkonin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Kjo periudhë zgjatë deri me prishjen e marrëdhënieve të lagerit socialist me Jugosllavinë apo siç njihet ndryshe në shkencat e historisë edhe si koha e Informbyrosë. Marrëdhëniet edhe në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë prishen dhe gjatë kësaj kohe, organizatat ilegale që formohen në Kosovë në programet e tyre vërehej ngjyrimi ideologjik dhe në çdo parullë apo shkrim të tyre hasim kryesisht në përkrahjen e marksizëm-leninizmit, por në anën tjetër vërehej kërkesa e bashkimit kombëtar e që shprehej me të madhe nga përkrahja e Bashkimit Sovjetik dhe shteteve tjera socialiste. Nga e tërë kjo, duhet konkluduar se qëllimi i bashkimit kombëtar pa dallim të organizatave ishin djathtiste apo majtiste, kërkesa e tyre ishte dhe mbeti e njëjtë - atdheu i bashkuar. Kjo periudhë zgjat deri më 1966, kur edhe mbahet Plenumi i Brionëve¹⁵ dhe haptas në Jugosllavi dënohen forcat antishqiptare. Nga viti 1966 e këtej në Lëvizjen Ilegale atdhetare fillon një etapë e re e zhvillimit të tyre si në aspektin organizativ po ashtu edhe në aspektin konceptual, e që zgjatë deri më 1990. Organizatat ilegale, që u formuan pas këtyre viteve të rralla ishin ato që në programet e tyre kërkonin bashkimin kombëtar, por në mes rreshtave kuptohej që synimi i tyre ishte po ai. Duhet theksuar se në këtë etapë programet e organizatave vazhdojnë të jenë të majta, dhe kërkesat e tyre evoluojnë në kërkesën që Kosova të shpallej Republikë në kuadër të ish-Jugosllavisë. Siç dihej kjo kërkesë bëhej me qëllim ngase në

¹⁵ Mbledhja e IV e KQ të LKJ të Jugosllavisë, 1966.

Kushtetutën e Jugosllavisë të gjitha republikave iu garantonte shkëputjen dhe bashkimin e tyre me kë të donin. Kjo edhe ishte arsyeja pse ndryshoi qëndrimi i Lëvizjes Ilegale, ku kërkohej që Kosova të shpallej Republikë në kuadër të Jugosllavisë.

Në bazë të situatës politike në Jugosllavi

Tentohet që të bëhej edhe një ndarje në etapa të ndryshme që është një ndarje pak më e përshtatshme nga ndarja e mëparshme, ngase ndarja kryesisht bëhet në bazë të zhvillimeve politike në ish-Jugosllavi. Organizatat dhe veprimtaria e tyre, gjatë këtyre etapave herë vije më e vrullshme dhe herë më e ngadalshme, por vazhdimisht shumë e sigurt dhe rezistonte në kërkesat dhe qëllimet e saja. Duke u nisur nga këto oscilime veprimtarinë politike-kombëtare ilegale të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, që nga viti 1945-1990, do të dukej kështu:

Faza e parë, e cila përfshinë periudhën 1944-1948 dhe përkufizohet kryesisht me veprimtarinë e LNDSH-së. Si e tillë kjo lëvizje kishte karakter politiko-ushtarak, ajo ishte e përcaktuar për luftë të armatosur kundër robërisë së re jugosllave dhe formimit të një shteti shqiptar me territoret e veta, kishte një politikë nacionale e demokratike properëndimore, dhe kryesisht udhëhiqej nga patriotë dhe intelektualë të shquar, si: Ymer Berisha, Halim Spahiu, Selman Riza e shumë të tjerë. Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare, kishte dy komitete qendrore, njëri ishte me seli në Prizren e tjetri me seli në Shkup. Kjo ndarje në këtë organizatë ishte bërë për hir të funksionimit më të sigurt. Të dyja komitetet qendrore kishin të njëjtin betim dhe të njëjtin program, që i jepnin të gjithë anëtarët para se të aderonin në të, dhe i përmbaheshin të njëjtit program. Betimi i anëtarëve të NDSH-së fillonte kështu: *“Betohem në librin e shenjtë, në gjakun shqiptar, në flamur, se do të qëndroj dhe do të bëhem besnik, në organizatën nacionale për çlirimin e atdheut. Jetën do ta sakrifikojë nëse bie në duar të armikut. Për pjesëmarrësit e organizatës nuk do të deklarojë asgjë. Do të mbështetem në të gjitha ligjet, që i mbështet organizata. Me çmim të jetës do ta kryej çdo detyrë që ma parashtron organizata”*.¹⁶ Veç betimit që ishte akt solemn për të gjithë anëtarët e saj, po ashtu anëtarët i përmbaheshin edhe programit të LNDSH. Programi kishte njëmbëdhjetë pika, që përfshinin qëllimet dhe qëndrimet e saja. Si pikë e parë e programit ishte se: 1. “Për Shqipërinë Etnike dhe kufijtë e saj, për ekonominë dhe

¹⁶ Nga dosja e Hamdi Berishës, Gjykata e Qarkut, Gjiilan, 1947.

politikën demokratike...”¹⁷, ndërsa pikat tjera që paraqitën në program janë të dala nga kjo, ngase qëllim parësor ishte formimi i shtetit shqiptar në të gjitha trojet e veta, dhe kjo ishte qëllimi suprem i organizatës.

Faza e dytë, përfshinte vitet 1949-1958. Brenda këtyre viteve organizimet ilegale ishin të llojllojshme duke filluar nga vazhdimësia e LNDSH-së, e deri me formimin e organizatave të ndryshme ilegale që gjithashtu kishin karakter çlirimtar, por me koncepte të reja politike e kombëtare. Mbas krijimit të rrethanave të reja në Kosovë, mbas një stabilizimi kushtimisht relativ të pushtetit të ri në Kosovë, mbas përshtatjes së një pjese të shqiptarëve me këto rrethana të reja, këto grupe ilegale e kishin orientuar një pjesë të madhe të veprimtimit në bindjen e popullit se lufta kundër pushtetit jugosllav, megjithatë, ishte i vetmi mjet dhe e vetmja rrugë e lirisë.

Në këtë periudhë edhe pse ishte konsoliduar deri diku LNDSH-ja, më 1957 u formua dhe veproi organizata ilegale e atdhetarit Metush Krasniqi me emrin simbolik “Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë”. Në qershor të të njëjtit vit, Metush Krasniqi para anëtarëve të vetë në fshatin Rogan, paraqiti Programin e punës dhe projektin (skicën) e statutit të Partisë, ku pos angazhimeve të tjera, ai si kusht themelor e parimor kishte paraqitur rëndësinë e lirisë, por mbi të gjitha atë të bashkimit kombëtar me shtetin amë¹⁸, duke përdorur të gjitha mjetet dhe metodat. Në këtë drejtim kishte hartuar planin për propagandimin e idesë për bashkim me Shqipërinë.¹⁹ Ndërsa, më 1963 formohet një organizatë tjetër me emrin “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, e udhëhequr nga Adem Demaçi, i cili më vonë në bashkëpunim me inteligjencën kosovare hartuan Statutin dhe Programin e saj. Statuti i saj kishte përmbledhur në dhjetë nene të tërë objektivin dhe qëllimin e organizatës. “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve” për një kohë të shkurtër do të shtrihet pothuaj në tërë hapësirën shqiptare në Jugosllavi, si nga aspekti organizativ, ashtu edhe nga aspekti i ndikimit te popullsia shqiptare. Pas formimit të komiteteve të qyteteve të LRBSH në Prishtinë, në Mitrovicë, në Pejë, në Gjakovë, në Gjilan, në Shkup dhe në

¹⁷ Marrë nga Programi Politik i LNDSH, 1945.

¹⁸ Kadrush Sylejmani, Metush Krasniqi, simbol i qëndresës shqiptare, Prishtinë, 1999, 84.

¹⁹ Hetem Çeku, Mendimi politik i Lëvizjes Ilegale në Kosovë 1945-1981, Prishtinë, 2003, 143.

Stamboll, parashihej që të vazhdohej me formimin edhe të komiteteve të tjera.²⁰

Në nenin e parë të saj theksohej se: “*Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për Vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara në shumicë prej shqiptarëve që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë, domethënë qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht - Çlirimi i krahinave, të aneksueme prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet - Shqipërisë*”.²¹ Edhe pse më 1945, thuhej se kishte përfunduar lufta, megjithatë, me anën e këtyre neneve organizata e lartpërmendur iu bënte me dije se për shqiptarët e okupuar ende nuk kishte përfunduar lufta derisa të realizohen qëllimet supreme të shqiptarëve, të përcjellura amanet gjeneratë pas gjenerate derisa të realizohen qëllimet e tyre. Për qëllimet e qarta, politike dhe kombëtare të LRBSH, më së miri flet neni i katërt i Statutit, ku theksohet se Lëvizja nuk e drejton luftën dhe aktivitetin e vetë kundër Jugosllavisë dhe sistemit të saj, porse aktivitetet dhe lufta e saj do të vazhdojnë vetëm derisa t’i çlirojë dhe t’i ribashkojë me shtetin amë territoret e aneksuara nga Jugosllavia. Kjo dëshmon, përveç tjerash, se LRBSH ishte organizatë çlirimtare në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Veç këtyre në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi do të formohen dhe do të vepronin edhe disa grupime më të vogla ilegale-politike që për qëllim parësorë do të kenë bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare.

Nga viti 1959-1968, fillon **faza e tretë** e organizimeve ilegale, të cilat do të artikulojnë koncepte të reja politike e kombëtare. Ndërsa vitet 1969-1981, sjellin veprimtarinë e **fazës së katërt** ilegale në Kosovë, dhe mund të thuhet se ishte njëra nga fazat më të bujshme kur do të formohen grupe e organizata ilegale, me ngjyrimë të ndryshme ideologjike, të cilat i kishte ofruar koha. Ndërsa, sa i përket vlerësimit se të gjitha organizatat dhe grupet ilegale që vepronin në Kosovë në këtë periudhë kanë pasur orientime marksiste-leniniste, duhet të kihet parasysh rrethanat konkrete të kohës si dhe fakti se në Shqipëri sundonte një regjim i tillë. Andaj, këtyre organizatave në Kosovë u nevojitej një mbështetje e natyrshme në një aleat të qëndrueshëm e të

²⁰ Aktgjykimi, K. nr. 271/64.

²¹ Statuti i Organizatës “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, Arkivi i Kosovës, Fondi: Gjyqi i Qarkut, Prishtinë P. Nr. 14/59; Hakif Bajrami, Dosja Demaqi 1958-19.

pranueshëm.²² Sigurisht që po të mos kishin orientim majtist ato do të rrezikonin për të mbetur pa përkrahjen e Shqipërisë së asaj kohe.

Deri në vitin 1968, ndonëse të gjitha grupimet politike ilegale kishin si synim çlirimin e Kosovës me viset tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë, pa hequr dorë nga ky qëllim, do të angazhohen edhe për jetësimin e opsionit të Republikës, të përfshirë këtu në Kosovë dhe viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi²³ dhe kjo do të jetë shkalla e parë për realizimin e bashkimit kombëtar. Mbas demonstratave të vitit 1968, shumë atdhetarë e intelektualë ranë në burg. Por, gjatë viteve të '70-'80, ilegalja e Kosovës përsëri u këndell dhe mori veten. Gjatë kësaj periudhe u formuan organizata të reja që po ashtu angazhoheshin dhe luftonin për lirimin e tokave shqiptare nën ish-Jugosllavi. Në këtë kohë u organizua dhe veproi organizata ilegale "Grupi Revolucionar i Kosovës" që më vonë u shndërrua në "Organizatë Marksiste-Leniniste të Kosovës". Fillimisht Programi politik i GRK ishte ai i Lëvizjes tradicionale Kombëtare.

Duke pasur parasysh ndarjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga trugu i Shqipërisë, gjendjen e rëndë dhe të padurueshme të popullit shqiptar nën sundimin e huaj dhe të drejtën e ligjshme të vetëvendosjes e të bashkimit kombëtar, GRK programin e tij e ndërtonte mbi këtë bazë, që do të thoshte program politik i çlirimit kombëtar dhe i bashkimit të atdheut të copëtuar padrejtësisht. Ky përkufizim i programit përjashtonte çdo mundësi cilësimi të tij si ekstremist, majtist a reaksionar.²⁴ Më 1968, në Kosovë nga ilegalja shqiptare u organizuan edhe Demonstratat studentore që kërkuan forma të reja të organizimit ilegal, kërkuan unifikimin e organizatave dhe grupeve ilegale për të ndërtuar një platformë politike të veprimit, duke shtruar nevojën që programet politike të ilegales t'i përshtatën kohës dhe proceseve politike që u zhvilluan në rajon e më gjerë. Ndërsa, **faza e pestë** e Lëvizjes Ilegale në Kosovë fillon në vitet e kthesës më të madhe historike më 1981 dhe përfundon në fillim të viteve të '90, në kohën kur zë fill formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo edhe është faza më e rëndësishme e saj: është përmbyllje kulminante e një lëvizjeje të gjatë ilegale në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë.

²² Sabile Keçmezi-Basha, Organizatat dhe grupet Ilegale në Kosovë 1981-1989, Prishtinë 2005, 297.

²³ Sheradin Berisha, Veprimtaria politike e organizatave Ilegale në Kosovë , 1945-1999, 20.

²⁴ Mehmet Hajrizi, punim në dorëshkrim, nëntor 2007.

Demonstratat e vitit 1981 ishin një kushtim i madh për popullin shqiptar dhe opinionin ndërkombëtar.

Është karakteristikë e kësaj etape se në këtë kohë organizimi i ilegales kishte pësuar ndryshime të mëdha. Grupe të vogla që vepronin ilegalisht pas demonstratave studentore të '81 filluan të bashkohen dhe të formonin organizata më të mëdha po që kryesisht vepronin në interes të zhvillimit të Kosovës dhe të krijimit të kushteve të reja, qoftë në ngritjen e pozitës kushtetuese të saj, qoftë për përmbushjen e idealit të ilegales - bashkim kombëtar. Duhet përmendur me këtë rast grupet siç ishin: Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës; Fronti Popullor për Republikën e Kosovës; Lëvizja Studentore e vitit '81; Grupi i Intelektualëve të Kosovës; Fronti i Çlirimit Kombëtar; Partia Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi etj.

Në bazë të kërkesave të Lëvizjes Ilegale Shqiptare

Organizatave ilegale që vepruan në këtë periudhë, për të gjitha mund të thuhet se punonin në bazë të programeve politike dhe kishin statutet e tyre. Programet, platformat dhe synimet e tyre ishin thjesht të karakterit kombëtar dhe qëllimi suprem i të gjitha atyre ishte mëvetësia e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë. Duhet theksuar se edhe brenda organizatave politike të kohës kishte dallime rreth artikullimit programor, se cila ishte platforma më e mundshme dhe më e përshtatshme që duhej të përdorej për rrethanat e kohës, për të ardhur deri te një strategji e përbashkët e veprimit. Dallimet konsistonin në atë se si duhej t'i qaseshin zgjidhjes së çështjes kombëtare, ngase veprimtarët e ilegales asnjëherë në qëndrimet e tyre nuk kishin dogmat, por varësisht prej rrethanave kombëtare e ndërkombëtare, krijonin edhe qëndrimet e tyre. Këtë të dhënë më së miri e dëshmon evoluimi i qëndrimeve rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës në situata të caktuara, që do i paraqes, të përmbledhura në tre opsione si:

1. Bashkimi i të gjitha tokave shqiptare me Shqipërinë;
2. Bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare në një republikë brenda Jugosllavisë; dhe
3. Republika e Kosovës.²⁵

Që të tri këto opsione të shtruar nga veprimtarët e ilegales të Lëvizjes Kombëtare, në periudha të ndryshme kohore, kishin edhe

²⁵ Ethem Çeku, Kosova, në sfondin e diplomacisë jugosllave dhe të Shqipërisë 1945-1981, Prishtinë, 2009, 303.

bartësit e vetë ideor. **Opsionin e parë** për bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë në programin e saj e kishte paraparë LNDSh LRBSH, OMLK dhe LNÇ të Kosovës,²⁶ dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. **Opsion e dytë** e kishte paraparë organizata “Partia Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi”, e cila në programin e saj parashihte bashkimin e të gjitha trojeve ku shtriheshin shqiptarët në një republikë në kuadër të RSFJ. Megjithatë, veprimtaria dhe mendimi politik i shqiptarëve në Kosovë nuk u zhvillua lirshëm, si pasojë e statusit politik e juridik të popullit shqiptar në Jugosllavi; si pasojë e pengesave që vinin nga represioni i madh nga Republika e Serbisë dhe Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, e cila nuk pranonte alternativë tjetër të zhvillimit e të mendimit politik; si pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike, arsimore e kulturore dhe si pasojë e faktit se angazhimi politik për Pavarësinë e Kosovës zhvillohej nga veprimtarët që vepronin në ilegalitet.²⁷

Opsioni i tretë, apo zanafilla e idesë për Republikën e Kosovës ishte shpalosur fillimisht me Demonstratat e vitit 1968. Por, si më e sforcuar u paraqit në formë të plotë, në periudhën e demonstratave të vitit 1981 e 1989. Kjo kërkesë ishte shtrua madje edhe në diskutimet publike që u bënë menjëherë pas rënies së Rankoviqit. Këto biseda, sipas dokumenteve, dëshmojnë se janë zhvilluar edhe në mes të udhëheqësve të Kosovës me udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë.²⁸ Kosova Republikë, pas shumë bisedimeve në mes të veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare Ilegale, ishte kërkesë e të gjitha grupimeve ilegale pas vitit 1968, 1981, 1989, që më vonë do të bëhet kërkesë e gjithë popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera jugosllave të banuara me shqiptarë. Kërkesa për Republikë, për kohën ishte më e përshtatshmja ngase prapa kësaj qëndronte kërkesa për bashkim kombëtar me shtetin amë - Shqipërinë. Prandaj, këtu edhe qëndron çelësi i zgjidhjes së problemit të quajtur Kosovë. Latinët e vjetër thonë: “Nuk mund të qetësohet një popull në qoftë se nuk dëgjohet zëri i tij”, “Voks populi-voks dei”. Andaj, ngjarjet në vijim hapën një kaptinë të re brenda kombit shqiptar, hapën një proces të ri politik edhe për shtetin shqiptar.

²⁶ Procesi gjyqësor i Prizrenit, dos. Gj.nr. 17/45; Sabile Keçmezi-Basha, Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009.

²⁷ Po aty, f. 139.

²⁸ Selatin Novosella, Kosova ‘ 68, Prishtinë 1993. 26-31.

Angazhimi i mërgatës shqiptare për çështjen e Kosovës

Pas përfundimit të LDB-së (1945), në botën perëndimore po vazhdonte tradita patriotike e mërgatës shqiptare, sikurse që ishte vepruar edhe më herët nga shoqëritë shqiptare të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes, Selanikut e shumë të tjera. Veprimtaria e mërgatës shqiptare, sipas ecurive të saja pas Luftës së Dytë Botërore, është ndarë në dy etapa: etapa e parë fillon që nga viti 1945, për të përfunduar më 1966 (Plenumin e Brioneve). Kjo periudhë karakterizohet me një organizim më të madh, ngase në krye të saj ndodheshin intelektualë të shumtë, të cilët kishin emigruar e ikur menjëherë pas LDB-së, të cilët nuk ishin të kënaqur me sistemin e ri komunist në Shqipëri, por në këtë grupim bëjnë pjesë edhe atdhetarë të tjerë që ishin të zhgënjyer e të dëshpëruar me padrejtësitë e tradhtitë që iu bënë Kosovës, me aneksimin e saj nga Serbia e ish-Jugosllavia.

Duhet përmendur, se anëtarët e këtyre grupimeve, edhe pas largimit nga vendi, përsëri kishin vazhduar veprimtarinë e tyre atdhetare, duke formuar organizata të njëjta në mërgim. Ndërsa, etapa e dytë përfshin periudhën 1966-1990, në të cilën marrin pjesë mërgimtarë të cilët kishin emigruar në perëndim për arsye ekonomike, por që pas vitit 1981 ndryshon struktura e mërgimtarëve shqiptarë, tani kemi një kategori tjetër të tyre që janë kryesisht të rinj e studentë që në Kosovë kishin qenë anëtarë të organizatave ilegale, po ashtu shumica e tyre kishin marrë pjesë aktive në Demonstratat studentore të vitit 1981. Ata iknin nga terrori dhe dhuna serbe që ushtrohej në Kosovë duke kërkuar në shtetet perëndimore strehim politik. Nga kjo mërgatë u formuan organizatat atdhetare, si në: Gjermani, Austri, Zvicër, Francë, por nuk ngelën prapa as shqiptarët që ishin ngulitur në SHBA, si në Çikago, në Detroit, në Nju Jork, në Uashington, në Kanada, në Australi si dhe në Turqi, ku përmes organeve të tyre të informimit shprehnin pakënaqësinë dhe mllefin ndaj padrejtësive të shumta që iu bëheshin shqiptarëve si në Shqipëri po ashtu edhe në Kosovë.

Fillimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Me ngjarjet e viteve 1989 e këndeje që pasuan në ish-Jugosllavi, me një mënyrë filloi edhe dekompozimi i Federatës Jugosllave, ndërsa shqiptarët si andej e këndeje kufirit iu rikthyen qytetërimit të vet, pra bashkësisë së qytetërimit evropian.²⁹ Mirëpo, pas ndryshimeve të shumta politike që pasuan në mes viteve '89-'99 të shekullit të kaluar, veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që vepronin në ilegalitet, por edhe ata që vepronin në parti të ndryshme politike legale që u formuan gjatë kësaj periudhe, duke e parë dhe hetuar ndikimin e faktorit të brendshëm dhe të atij ndërkombëtarë, në qëndrimet e veta filluan të bënin korrigjime në qasje dhe në organizim.

Programet politike e kombëtare dhe mjetet e format e luftës me të cilat parashihej të arriheshin qëllimet e saja, në esencë kishin mbetur të pandryshueshme gjatë gjithë historisë së lëvizjes kombëtare. Por, forma më e lartë e rezistencës, lufta e armatosur, ndonëse ishte pjesë e programeve, por edhe e praktikës historike të lëvizjes kombëtare, arriti të zbatohej në tërë kuptimin dhe gjerësinë e saj, vetëm në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, atëherë kur u krijuan kushtet e brendshme dhe të jashtme për të, kur u poqën faktorët subjektivë dhe objektivë të lëvizjes. Brezat e mëparshëm të lëvizjes ilegale, nuk mund ta bënin këtë, në Jugosllavinë stabile e me prestigj ndërkombëtar dhe në rrethanat e luftës së ftohtë, që karakterizonte gjithë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, deri nga fundi i viteve të gjashtëdhjeta, por as gjatë të ashtuquajturës detantë, që e pasoi të parën. Megjithatë, lufta çlirimtare përgatitej dhe zhvillohej shkallë-shkallë përballë valëve të egra të dhunës që ushtronte pushtuesi. Ky besim dhe ky angazhim i pakursyer i ilegales dhe besimi i madh në popullin e vetë, ndikoi që të formohej edhe UÇK, ngase çdo organizatë ilegale në ish-Jugosllavi, në programet e tyre, përveç zgjidhjes paqësore të çështjes shqiptare ato parashihnin edhe zgjidhjen me luftë, andaj dalja në skenë e UÇK-së nuk ishte e rastësishme dhe se ishte krah më i natyrshëm i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë që nga viti 1945. Lufta e Kosovës nën udhëheqjen e UÇK-së dhe ndihma e madhe nga faktori ndërkombëtar që sollën lirinë që ne sot e gëzojmë, dëshmon dhe provon se ishte vepra më madhore e të gjithë atdhetarëve që u angazhuan për Pavarësinë e saj duke mos kursyer as jetën e tyre.

²⁹ Po aty, 317.

Ky organizim i ri dhe kjo qasje e re politike e ushtarake me kohë kishte kaluar barrierat ideologjike dhe nuk e shihte më veten pre të asnjë ideologjie. Bile, për hir të interesave më madhore kombëtare, gati të gjithë ish të burgosurit politikë në vitet e '89-'99, me daljen nga burgu kishin aderuar në radhët e LDK-së, e parti të tjera të formuara legalisht, vetëm e vetëm që të bënë unitetin kombëtar edhe më të fuqishëm, por ka ndodhur edhe kjo se më vonë kur po ata iu bashkonin radhëve të UÇK-së, paraprakisht deklarorin se nuk i takonin asnjë partie, se për ta ekzistonte vetëm UÇK-ja, si faktor politik e ushtarak i Kosovës. Në këtë luftë dhe në këtë angazhim të veprimtarëve ilegalë dhe të shqiptarëve në përgjithësi i kishte ndihmuar dhe mbajtur gjakimi shekullor i shumë gjeneratave që ishin flijuar për pavarësinë e tokave shqiptare.³⁰

Vetëm kur të studiohet mirë e shkencërisht kjo periudhë do të kuptohet më mirë e më drejt e tërë situata politike e ushtarake në të cilën kaloi Kosova. Edhe pse kjo situatë e rëndë me kalimin e viteve do të davaritej, në Kosovë do të ndihej rëndë pesha e represionit të egër serb, por edhe më tej tek populli shqiptarë do të rritej besimi te SHBA-të e Evropa, si kodi më i pathyeshëm për lirinë dhe sigurinë globale. Bashkësia ndërkombëtare shfaqet si forcë rrezatuese për zgjidhjen e problemit të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, ngase ata (shqiptarët) pa dashjen e tyre kishin ngelur larg saj. Angazhimi i madh që bënë forcat kombëtare për t'u kthyer aty, në Evropë nuk ishte i lehtë, ashtu siç ishte menduar në fillim të viteve '90-të. Ajo madje, shpesh acaroi edhe kancelaritë euro-perëndimore.³¹ Vitet 1991-1999, janë vitet më kulminante të lëvizjes politiko-ushtarake në Kosovë, dhe në historinë më të re të kombit tonë, me të drejtë duhet të cilësohej si periudha e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Në fillim të viteve të '90 përveç partive legale politike, si: LDK, PPK, PSHDK, PLK etj, vepronin edhe disa organizata politike-kombëtare ilegale, si: "Fronti Kombëtar" (1990-1991), "Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës" nga marsi 1993... dhe "Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës",³² dhe disa më të vogla. Bazamenti i UÇK-së ishte Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) e cila vepronte fuqishëm në Kosovë dhe në shtetet perëndimore. Kjo organizatë, në Mbledhjen e

³⁰ Ethem Çeku, Mendimi politik i Lëvizjes Ilegale në Kosovë 1945-1981, Prishtinë, 2003, 262.

³¹ Po aty, 13.

³² Sheradin Berisha, Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë, 27. 04. 2008. URL: http://pashtriku.beepworld.de/files/Histori/shpalime/levizjaksh_kosove_1945_1999_27.4.08.htm

vetë të katërt të Përgjithshme, që u mbajt më 28-29 korrik 1993, në “Kodër të Trimave”, në Prishtinë, u emërtua shkurt si: Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Në këtë mbledhje, në programin e LPK-së u aprovua njëzëri qëndrimi, se: lufta e armatosur do të jetë qëllimi kryesor për çlirimin e Kosovës me viset tjera etnike shqiptare (në ish-Jugosllavi) të mbetura padrejtësisht jashtë kufijve të Shqipërisë londineze. Epiqendra e UÇK-së do të bëhet grupi i armatosur në Drenicë në krye me komandantin legjendar të kësaj ushtrie të lavdishme, Adem Jashari.³³

Rëndësia e kësaj politike dhe e kësaj lufte më vonë kishte shënuar ngritje graduale pozitive, mund të thuhet që nga Rezoluta e Parlamentit Evropian (1989) e deri te përkrahja e Planit gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit. Zgjidhja e çështjes së Kosovës, e cila ishte edhe sfida e fundit e madhe që kishte mbetur në Ballkan pas shpërbërjes së Jugosllavisë, respektivisht bërja e pavarësisë së Kosovës mbi bazën e Planit të Ahtisarit, i cili përbën një zgjidhje kompromisi, është një sprovë përfundimtare për politikën e jashtme të Bashkimit Evropian, të SHBA-së dhe e Bashkësisë Ndërkombëtare në përgjithësi.

³³ Metush Zenuni, Lëvizja Popullore e Kosovës, Temë e masterit, Universiteti i Prishtinës, 2008. URL: <http://www.pashtriku.org/ngarkimet/dokumentet/Avdi-gjata-levizja-kombetare-llap.pdf>

Sabile KEÇMEZI-BASHA

SUMMARY

THE ILEGAL NATIONAL ALBANIAN MOVEMENT IN KOSOVA (1945-1999)

Ever since the Albanian League of Prizren (1878), there was a national program within the Albanian realm of activities that promoted the preservation of the entirety of the Albanian fatherland. They promoted National Unification on which basis many National Movements were created which continued to promote these requests represented through the existence of ilegal movements in the years to come. The Albanian League of Prizren had three main goals: The elimination of the Ottoman occupation, national independence and the unification of all Albanian lands within the borders of one state. As such, these became the main goals for the program of the Second League of Prizren (1943), as well as for other movements that emerged after the Second World War. The main goal remained achieving independence, but this time around it meant liberation from the Slavic occupation. Independence and national unification were quintessential for all ilegal movements. These aims resulted from the will to apply the right of being equal and free similar to all other nationalities. There is no other nationality in Europe that has been more maimed and done injustice towards than the Albanians.

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hamit KABA

Dokumenti i mëposhtëm është gjetur në Arkivat Kombëtare Britanike, gjatë kërkimeve tona të fundit në Londër. Ai është një studim i hartuar nga Sektori Historik i SOE [Special Operations Executive]¹, i cili hedh dritë mbi veprimtarinë e kësaj organizate në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe për marrëdhëniet e saj me forcat e rezistencës.

AKTIVITETET E SOE NË SHQIPËRI Shqipëria

*The National Archives [London],
HS 7/69, History 37A,
“Aktivitetet e SOE në Shqipëri” [pa
datë]*

SOE hyri me vonesë në skenën shqiptare, e megjithatë, në mënyrë paradoksale, Shqipëria ishte vendi i parë i cili do të ndeshej me sfidën e “Rendit të Ri”, nëpërmjet rezistencës guerilase nëpër male. Kur, në të Premten e Mirë të vitit 1939, Musolini dërgoi ushtrinë e tij për të rimarrë huadhënien që i kishte dhënë Mbretit Zog, fshatari shqiptar u tërhoq drejt maleve dhe përdori më së miri dhuntinë e tij për të penguar me qetësi dhe forcë, dhunti të cilën ai e kishte mësuar gjatë katërqind vjetëve të rezistencës sporadike ndaj sundimit turk, e cila kishte mbetur e gjallë dhe e freskët nga revolucionet kundër regjimit të

¹ SOE u krijua në vitin 1940 për të kryer operacione klandestine dhe për t’u koordinuar me lëvizjet e rezistencës në Europë dhe më vonë në Azinë Juglindore kundër Fuqive të Boshtit.

tij. Fshatari shqiptar fshihte të korrat, paguante taksat nëpërmjet dëftesave të borxhit dhe, nëse i bëhej shumë presion ose e kërcënoje me shërbim ushtarak, ai zhdukej me pushkën e tij në një vendstrehim më të thellë, ku tanket dhe këmbësoria italiane me arsye, parapëlqente të mos e ndiqte. Ashtu si gjermanët në Çekosllovakia edhe prania e italianëve në Shqipëri, ishte e pavend dhe e mjerueshme, por përgjatë dimrit të vitit 1939 dhe fillimit të verës së vitit 1940, Italia ishte akoma neutrale dhe Qeveria e Madhërisë së tij nuk mund të ndërhynte në mënyrë aktive. Gjithçka ndryshoi kur Musolini, pabesisht, i nguli thikën në shpinë Francës në qershorin e 1940-ës dhe në tetor vazhdoi me sulmin e paprovokuar ndaj Greqisë. Me këto veprime ai zbuloi shpinën e tij ndaj thikave të SOE-s, të planifikuara nga agjentët e saj në Beograd gjatë dimrit 1940-1941.

Në Jugosllavi jetonin dy shqiptarë, Abaz Kupi dhe Gani Kryeziu, të cilët parapëlqyen të jetonin në mërgim se sa nën regjimin fashist italian, por ata ruajtën kontrollin e trashëguar ndaj banorëve të qytezave ku ishin prijës të tipit feudal, pra të Gjakovës dhe të Krujës. Kupi dhe Kryeziu dërguan, nëpërmjet agjentëve dhe mbështetësve të tyre në rrethinat e këtyre qytezave (të dyja në pjesën veriore të Shqipërisë) para, të cilat ua kishte dhënë SOE. Ata nuk mund t'u dërgonin armë, të cilat ishin në fakt nevoja kryesore [e tyre]. Gjatë atij viti jugosllavët i qëndruan në mënyrë të dyshimtë neutralitetit të tyre. Rojet e tyre kufitare mund ta mbyllnin një sy netëve të errëta ndaj korrierëve që kalonin flori, por nuk mund kurrësi të rrezikonin të akuzoheshin për trafikim armësh kundër "Rendit të Ri". Në jug të Tiranës, SOE gjeti një aleat edhe më të fuqishëm tek Myslym Peza, prijësi patriarkal i krahinës së Pezës, e cila shtrihet mospërmas rrugës midis Tiranës dhe Elbasanit në drejtim të jugut. Ai përdori më së miri 500 £ [pounds-stërlina angleze] në ar, të cilat ia dërgoi SOE. Me to, ai bleu prej ushtarëve fitimtarë por të korruptuar italianë armë, municione dhe ushqim për njerëzit e tij. Këta, me shumë mundësi nuk qenë më shumë se 500 [vetë] dhe ai mund të përballonte të nxirrte në betejë, në çdo kohë, jo më shumë se 150 prej tyre; pjesa e mbetur duhej medoemos të ishte pranë fermave të tyre për të vazhduar luftën e pandërprerë për të përballuar jetesën. Me këto forca të vogla në numër, ai kreu gjatë dimrit 1940-1941 një seri sulmesh në shkallë të vogël ndaj forcave pushtuese: një roje i vrarë, një postë ushtarake e kapur në male, një autokolonë me furnizime që i ishte zënë prita gjatë rrugës së saj drejt frontit grek - çdo sulm shërbeu për pagesën e një pjese të armëve dhe

municioneve që nevojiteshin aq shumë, si dhe ndihmoi në uljen e mëtejshme të moralit në rënie të trupave italiane.

II

Duke punuar përgjatë kufirit të Jugosllavisë me neutralitet të paqëndrueshëm, oficerët e SOE-s deri në pranverën e vitit 1941 ishin bërë miq të besueshëm të Pezës, të simpatizuar nga Kupi dhe Gani Kryeziu në Tiranë e në Shkodër, si dhe nga prijësit e veçantë të krahinës së Dibrës në verilindje. SOE kishte vendosur se kishte ardhur koha që të dërgonte një emisar për të parë nga afër se çfarë ishte arritur. Më 6 prill 1941, një oficer i SOE-s kaloi kufirin me Kupin, Kryeziun dhe me varganin mbresëlënës të truprojave të tyre. Po në të njëjtën ditë trupat gjermane pushtuan Jugosllavinë nga veriu. Kjo rastësi solli një avantazh të çastit. Jugosllavët hoqën dorë nga qëndrimi neutral. Ata i dhanë ekspeditës [së drejtuar nga SOE] 1000 pushkë dhe dërguan një kolonë jugosllave të udhëtonte përmes Shqipërisë, me qëllim që t'u priste italianëve rrugën në jug. Grupi i SOE-s i bashkoi forcat me këtë kolonë dhe [së bashku] marshuan përmes shtigjeve të ashpra të maleve të Shqipërisë së Veriut.

Postat italiane që u hasën rrugës gjatë marshimit të tyre ishin ose pasive ose të pajeta, ndërsa flamuri shqiptar valëvitej sërish në fortesat e gurta antike, të cilat kacavirren shkëmbinjve të thepisur dhe duken si pjesë e pandashme [e tyre]. Kolona i afrohej Adriatikut. Fuqia e dukshme ishte pasaporta e saj: pamja e mushkave të ngarkuara me eksploziv dhe granata, me pushkë dhe mitralozë, solli mirëpritjen e prijësve luftëtarë dhe i shumëfishoi radhët e saj. Ishte një triumf jetëshkurtër. Më 22 prill, Jugosllavia kapitulloi ndaj Gjermanisë. Shqiptarët i kapi terrori. Italianët e dinin që ata [gjermanët] tek për tek qenë më të ligj se ata vetë; por egërsia e menjëhershme e gjermanëve, thënë e rithënë rreth zjarrit, i mbushi ata me lebeti. Kolona arriti në luginën perëndimore të Bogës, hezitoi dhe ndaloi. Jugosllavët ndërprejnë marshimin dhe u kthyen drejt lindjes, drejt vendit të tyre. Oficeri britanik bëri çdo përpjekje për t'u vendosur në kontakt me Beogradin, Kajron, Maltën ose Londrën. Thirrje të padëguara nga radioja e tij W/T për trupa, armë, para dhe ushqim për të mbështetur rezistencën në Shqipëri u dobësuan dhe dështuan tërësisht. Kupi dhe Kryeziu vazhduan drejt shtëpive të tyre malore. Oficeri britanik ndoqi shqiptarët e mbetur drejt lindjes në një rrugëtim zhgënjyes përgjatë shtigjeve me erë, mbi

5000 këmbë [1500 m] mbi luginë, përgjatë të cilave kishte marshuar në perëndim me shpresa të mëdha.

Nga ky mision i parë i SOE-s nuk erdhi asnjë e mirë e menjëhershme, megjithatë kishte qenë një zbulim i vlefshëm i terrenit. SOE tanimë e dinte se kishte miq në Shqipëri, edhe pse ata qenë të shpërndarë maleve. Dy vjet do të kalonin përpara se ata të mund të hynin në punë. Thirrje më urgjente për ndihmë erdhën nga vende të tjera të Ballkanit. Me Jugosllavinë në duart e gjermanëve, SOE nuk kishte një bazë nga e cila mund të dërgonte trupa dhe furnizime në Shqipëri. Deri në vitin 1943 nuk pati baza të reja, deri sa të tilla u siguruan në Greqi për të ripërtërirë përpjekjet.

III

Në prill të vitit 1943, tre oficerë britanik të udhëhequr nga majori (më vonë nënkolonel) Maclean, u parashutuan në Epir (në Greqinë e Veriut) me urdhra për të shkuar në Shqipëri. Gjatë udhëtimit të tyre për në veri nëpërmjet fshatrave greke ata u pritën dhe u shoqëruan shumë ngrohtësisht. Kjo nuk i ndihmoi ata të përgatiteshin për ftohtësinë relative me të cilën u përballën, pasi kaluan kufirin shqiptar në rajonin e Gjirokastrës. Që nga viti 1941, Shqipëria nuk kishte marrëveshje me Aleatët; dhe vendasit i shikonin oficerët britanikë me dyshim si agjentë të mundshëm të imperializmit grek. Ata u dërguan mesazhe prijësve shqiptarë, por korrierët i kthenin pas letrat, refuzuan të takoheshin me këta të fundit, dhe madje i këshillonin oficerët britanik të ktheheshin mbrapa në Greqi. Megjithatë, Maclean këmbënguli. Deri në mes të qershorit ai kishte arritur tek drejtuesit partizanë lokal. Deri në fund të gushtit ai dhe oficerët e tij kishin vështuar sulmet e partizanëve kundrejt qytezave të vogla, kishin parë kurthet ndaj autokolonave italiane, ishin ngatërruar për spiunë grekë dhe ishin kërcënuar me pushkatim, por ja kishin arritur të kalonin gjithë rreziqet dhe të fitonin besimin e shqiptarëve. Kishte pasur pengesa e vonesa, por oficerët britanik ja kishin arritur të kishin rezultate dhe jo vetëm premtime: më në fund, më 23 dhe 24 qershor avionë nga Afrika hodhën furnizime. Maclean u ftua në një takim të plotë me Këshillin Qendror Partizan në Labinot, një qytezë pranë Elbasanit. Ai udhëtoi atje i maskuar si civil dhe iu bashkua këshilltarëve në shtëpinë e prijësit të fshatit. Mbi ta, ndërsa ata ecnin, shtrihej masivi malor: nën ta, përgjatë rrugës, kalonin përditë autokolonat e koracuara italiane në rrugën e tyre drejt Greqisë, tunduese dhe një shtysë më shumë për të qëndruar të bashkuar.

Këtu, për herë të parë partizanët hapën sytë ndaj ndihmave që mund të sillte SOE. Zyra e parë Qendrore britanike u ngrit në një fshat malor, nën një minare të prishur të një xhamie të maskuar. Misioni i Maclean ishte që të niste punën menjëherë për trajnimin e të brigadës së parë partizane. Kishte nevoja të menjëhershme për armë dhe SOE kishte një numër të kufizuar avionësh nën komandën e saj. Gjatë gjashtë muajve të parë mund të dërgoheshin nga Afrika jo më shumë se: 128 pushkë me 537 000 fishekë, 177 mitralozë të lehtë ose të mesëm, 65 pushkë antitank dhe 349 automatik stens². Ata zbuluan se shqiptarët e mësonin shpejt përdorimin e armëve të reja dhe si gjithë guerilasit ata vlerësonin armën e tyre më shumë se gjithçka. Për ushqimin kishte vështirësi, çdo fshat kishte pak më shumë sesa nevojat e veta. Për sa i përket transportit, italianët kishin sekuestruar mushka e mëza kudo ku i gjenin, dhe këto mund të rimerreshin vetëm nëpërmjet forcës së armëve.

IV

Nevojat strategjike të italianëve dhe gjermanëve diktonin edhe operacionet taktike të shqiptarëve. Në Shqipëri, nuk gjendeshin burime të mjaftueshme për Fuqitë e Boshtit, përveç minierave të kromit, të cilat kishin nisur t'i shfrytëzonin. Qëllimi i Boshtit në Shqipëri ishte i dyfishtë: e para të mbronin bregun nga zbarkimet e Aleatëve, të cilat mund të kërcënonin rrugëkalimin e Gjermanisë midis Jugosllavisë dhe Greqisë. Andaj qëllimi i tyre ishte që të mbanin rrugën e furnizimeve të hapura, gjë që bënte objektiv të SOE ndërprerjen e këtyre rrugëve. Lufta në Shqipëri nisi ashtu siç do të vazhdonte deri në fund, si një luftë për rrugët. Këto rrugë, dhe sidomos rruga kryesore midis Korçës dhe Janinës e cila shtrihet përgjatë pjesës juglindore të Shqipërisë, ishin objektivi i tyre. Gjatë verës, vjeshtës dhe dimrit, u kryen disa sulme ngacmuese. Grupe me burra 50 deri 100 vetë kalonin nëpër gryka. Oficerët britanikë me ta tregoheshin të kujdesshëm për të mos pretenduar komandim. Ata i këshillonin ose i frymëzonin, si dhe ishin ekspertë për minat dhe shkatërrimet. Këto sulme, mbase të ndara një çdo javë që nga vera e vitit 1943 deri në pranverën e 1944, kishin krijuar një paradigmë të caktuar. Ditari i një oficeri ndërlidhës britanik e tregon këtë paradigmë më se qartë:

“12 Gusht. Gjithë ditën vështrova rrugën Ersekë-Leskovic me komandantët e nën-njësive dhe bëra

² Lloj automatiku britanik (Shën. i përkthyesit).

plane për pritën e ditës së nesërme. Gjatë natës vendosa minat në rrugë. . . mbarova rreth orës 5 të mëngjesit.

“13 gusht. Në orën 6 të mëngjesit, një kamion me ushtarë hunë³ i cili tërhoqte një top 88 mm u hodh në erë nga minat në krahun nga ana e Ersekës. Të gjithë gjermanët u vranë. 12 u vranë nga minat dhe zjarri i [topit] të kalibrit 20 mm, si dhe 6 u vranë në përpjekje për t’u arratisur. Mora letërnjoftimet. Gjysmë ore më vonë erdhi një kolonë nga Leskoviku. Kamioni i parë takoi në mina dhe 5 gjermanë u vranë. Më vonë erdhën shumë gjermanë, prandaj ne u kthyem në shtëpi. Të jep shumë kënaqësi të shikosh frytet e punës dhe minat që shpërthejnë. Pata shumë kënaqësi personale kur godita me topin 20 mm, drejtpërdrejt kamionin që transportonte trupa.”

Rrugët qenë shqetësimi kryesor i gjermanëve dhe puna jonë kryesore, por megjithatë minierat e kromit mbeteshin si objektiv me interes dytësor për të dyja palët. Një informacion i thatë dhe formal, nga një tjetër oficer ndërlidhës tregon për shkatërrimin e strukturave të minierave të kromit në Kam të rajonit të Kosovës në pjesën veriore të Shqipërisë:

“U mor informacion se 100 gjermanë dhe 400 punëtorë të tjerë do të rekrutoheshin në Kam më 31 janar. Vendosa të provoj të shkatërroj hangarin e makinerive . . . kjo ndërtesë ishte e vendosur në malin mbi Kam, rreth 400 yard⁴ nga kazermat . . . Grupi që do të nisej u projektua sa më i vogël i mundshëm dhe përbëhej nga rreshteri Brandrick, korporal Clifton, unë dhe dy shqiptarë si udhërrëfyes. Si mjet maskimi shërbyen pemët dhe shkurret, deri sa arritëm brenda 60 yard⁵ tek baza e kodrës. Kazermat ruheshin dhe kur rojet ishin në anën tjetër të ndërtesës, kjo distancë e hapur u

³ Emërtim përçmues ndaj gjermanëve i përdorur gjatë Luftës së Dytë Botërore (Shën. i përkthyesit).

⁴ 370 m (Shën. i përkthyesit).

⁵ 55m

kalua menjëherë. Ne ishim në pozicion në orën 17:10 dhe pastaj pritëm deri sa ra nata. Vazhduam më pas drejt objektivit . . . Clifton qëndroi jashtë për të bërë roje, ndërkohë që Brandrick dhe unë hymë në hangar. Pamë një sistem të komplikuar rrotullues, me një rrotull kablli të vendosur mënjanë. Eksplozivi u vendos në sistemin rrotullues, në rrotullën e kabllit dhe në motor . . . u vendos edhe 25 këmbë fitil në mënyrë që të kalonin gjermanët përpara se të ndodhte shpërthimi. Fitili u ndez në 17:45 dhe ne u tërhoqëm. Sapo kaluam kazermat dhe afërsisht 12 minuta më pas ndezëm fitilin dhe qielli u ndez nga shpërthimi, flakët arritën 20-30 këmbë lartësi. U ndezën dritat e alarmit dhe shpërthyen të shtënat por në atë kohë ne ishim larguar drejt strehimit tonë.”

Një agjent i cili u dërgua më vonë raportoi shkatërrimin e plotë të ndërtesës. Asnjë punëtor shtesë nuk arriti në 31 janar.

V

Armiku, si zakonisht, iu përgjigj sulmeve të tilla me shpejtësi dhe në mënyrë të pamëshirshme. Në pamundësi për të kapur autorët, të cilët u zhdukën në errësirë, ai iu drejtua, këtu, si dhe herë tjetër, reprezaljeve kundër fshatrave fqinjë. Djegia e shtëpive, shkatërrimi i të mbjellave, kapja dhe vrasja e pengjeve, janë akte barbare që të kujtojnë kohën e ashpër të Çezarit dhe Tacitit. Tani, si atëherë, këto masa qenë efektive. Ato konfirmuan në mendjet e shqiptarëve reputacionin e frikshëm të gjermanëve: gjatë vitit 1943 ata treguan një pakënaqësi të dallueshme për t’u ndeshur me trupat gjermane në afërsi, për t’i provokuar ata me sulme që i dëmtonin vërtetë, apo për kundërsulme serioze. Në vitin 1944, pasi erdhën më shumë armë dhe trupa, forcat guerilase u trimëruan dhe ata filluan të tregojnë qëndrueshmërinë dhe agresivitetin e forcave të disiplinuar. Gjithashtu, kishte çështje të komplikuar politike, të cilat tërhoqnin vëmendjen e shqiptarëve nga detyra e tyre parësore, që ishte çlirimi i vendit nga pushtimi i armikut. Ashtu si në Jugosllavi dhe Greqi, komunistët kishin marrë drejtimin, duke thirrur të gjithë udhëheqësit e rezistencës në një konferencë në Pezë, në shator 1942, dhe duke e lidhur veten me të gjithë elementët

aktivë. Nën drejtimin e tyre energjik u formua Fronti Nacional Çlirimtar (FNÇL). Kjo organizatë siguroi një bastion në Shqipërinë Jugore e Qendrore. Në veriun feudal e të prapambetur kishte pak mbështetje dhe ishte pikërisht këtu ku nacionalistët dhe krahu i djathtë, të alarmuar nga progresi i qëllimshëm i komunistëve, formuan organizatën e tyre rivale, atë të Ballit Kombëtar. Midis këtyre dy ekstremeve qëndronte Abaz Kupi dhe mbështetësit e Mbretit Zog, të cilët urrenin si gjermanët ashtu edhe komunistët, të cilët ishin objektiv i të dyjave. Edhe Kryeziu në verilindje të vendit refuzoi të bënte aleancë me komunistët dhe vazhdoi deri në fund pa aleanca. Copëtimi politik ishte shpërqendruar dhe irritues për misionet e SOE-s, të cilat i ishin bashkëngjitur secilit prej këtyre grupeve. Me kapitullimin e Italisë në vitin 1943, situata u përkeqësua. Shqiptarët panë me shpejtësi se një tërheqje gjermane ishte e pashmangshme, në mos shumë e afërt. Kishte ardhur koha që të kryenin lëvizjet e tyre për të marrë pushtetin kur kjo të ndodhte. Ajo çka që më përpara një grindje u kthye gradualisht në një luftë civile me Ballin Kombëtar, që kërkoi ndihmën e gjermanëve për t'i rezistuar cenimit nga FNÇL në territoret e tyre në veri.

VI

Gjermanët, të cilët i qëndronin politikës së Perandorisë Romake “Divide at Impera” [përça e sundo], u treguan të shkathët dhe përfituan nga situata e krijuar. Edhe pse më të paktë në numër, ata i çarmatosën menjëherë trupat italiane, armët e të cilëve mund të kishin rënë lehtësisht në duart e shqiptarëve. (Një oficer britanik, i cili i ishte bashkëngjitur Abaz Kupit, pa me admirim të ndrojtur se si katër ushtarë gjermanë në qytezën e Krujës iu vunë punës qetësisht për të çarmatosur gjithë divizionin e Firences - deri sa Abaz Kupi me mitralozin e tij i dha fund kësaj shfaqje). Katër muaj më vonë, ata filluan një sulm të gjerë drejt jugut për çlirimin e linjave të komunikimit, ku FNÇL, tanimë grupi rezistues i vetëm që merrte furnizime nga Kajro, ishte akoma një kërcënim aktiv. Dy nga të rënët e parë ishin oficerë të SOE-s. Brigadieri E.F. Davies, i dërguar në dhjetor [fundi i tetorit] të vitit 1943 për të pajtuar forcat politike të lëvizjeve së rezistencës shqiptare (ata qenë në mënyrë të trishtueshme përtej pajtimit) u kap në befasi. Gjatë muajve në vazhdim, në vendqëndrimin e tij kryesor, i cili gjendej vetëm një ditë marshim nga Tirana, ai u sulmua nga një përzierje forcash gjermane dhe të Ballit Kombëtar. Ai u qëllua në stomak dhe u çua në spitalin e Tiranës nga sulmuesit. Zëvendësi i tij [nënkoloneli Nichols] u arratis,

por gjatë marshimit katërditor nëpër male e zuri shumë keq morthi nga i cili edhe vdiq. Këto fatkeqësi personale konfirmuan besimin e SOE-s se e ardhmja e rezistencës shqiptare ndaj gjermanëve ishte në duart e FNÇL-s dhe vetëm të saj. Gjatë një periudhe, nën sulmet gjermane, të mbështetura nga tanket, avionët dhe mortajat dukej sikur edhe forcat partizane të FNÇL-s do të shpërbëheshin dhe do të shpartalloheshin. E megjithatë, edhe pse ato u shpërndanë (ashtu siç duhet të veprojnë normalisht guerilasit gjatë një sulmi) dhe qendrat e tyre të rezistencës në rajonet e jugut si Vlora, Gjirokastra dhe Korça u morën, trajnimi që kishin marrë dhe besimi që kishin fituar nga zotërimi i armëve moderne u dha atyre forcë për t'u rigrupuar dhe ripushtuar bazat e tyre të shkatërruara, pak përpara se pluhuri i lënë nga gjermanët në tërheqje të zinte vend.

VII

Lufta për rrugët rinisi. Më shumë avionë sollën më shumë furnizime. Në bregun e Adriatikut, në Borsh, u kapën rrethinat e një ure strategjike e cila mundësoi furnizime nga deti përveçse atyre nga ajri. Në qershor të vitit 1944, gjermanët rinisën edhe një herë sulmin në Gjirokastrë, Korçë dhe në jug të Vlorës, kësaj radhe me më shumë vendosmëri. Ata sollën divizionin e parë malor. 10 000 gjermanë, së bashku me 5 000 burra të Ballit Kombëtar lanë rrugët dhe u drejtuan nga lindja në përfundim përgjatë jugut të Shqipërisë, nga liqeni i Ohrit në Adriatik. Partizanët u shkrinë përballë tyre, por nuk humbën kohë dhe përsëri u rigrupuan sapo vala e tyre ishte tërhequr. Ata bënë më shumë. Sapo kishte nisur zbatica e gjermanëve në korrik 1944, partizanët kundërsulmuan. Ata marshuan drejt veriut përtej lumit të Shkumbinit ku një betejë e përgjakshme vazhdoi për një muaj, në dy qytezat e Dibrës dhe Peshkopisë. Partizanët sulmuan me divizionin e parë me 4 500 burra dhe një brigadë maqedonase me 750 vetë. Gjermanët u kundërvunë nga pozicione të mirëfortifikuara, me më shumë se 1 000 trupa, të ndihmuar nga 3 000 trupa kuislingë të qeverisë së Tiranës dhe nga ushtria kosovare pro-gjermane. Vetëm pas bombardimit të kazermave, të mbajtura fort nga gjermanët, nga avionët britanik, të thirrur nga SOE-s me radiomarrëset e tyre, qyteza e Dibrës kaloi kësaj radhe, për të fundit herë në duart e partizanëve. Gjatë gushtit, avancimi i partizanëve vazhdoi drejt veriut. Një sulm i komandove britanike, i mbështetur nga partizanët, siguroi rrethinat e një ure strategjike: një zgjatim prej 15 miljesh u siguroi për furnizimin e gjithë jugut.

Në shator të vitit 1944 panorama u bë e qartë. Gjermanët kishin për qëllim të mbanin Tiranën dhe rrugën drejt Shkodrës, me praparojë në Elbasan dhe një garnizon në Durrës. Trupat e tyre po tërhiqeshin nga Greqia dhe ndërkohë që partizanët i ndiqnin nga Vlora, Gjirokastra, Berati dhe Korça, ata mbanin linjat e tërheqjes dhe mund të luftonin përgjatë tyre nëse mblidhnin forcat dhe shtyheshin me forcë përpara. Në 5 nëntor, praparojat gjermane filluan tërheqjen nga Elbasani. Ky qe sinjali për një përpjekje madhore të partizanëve. Gjatë kohës që aviacioni britanik bombardonte dhe sulmonte kolonat nga ajri, partizanët i sulmonin nga krahët dhe i detyruan gjermanët të luftonin për çdo metër, gjatë 25 miljeve, të rrugës Elbasan-Tiranë dhe të paguanin një çmim të lartë (humbjet e tyre vlerësohen të kenë arritur deri në 1 000 vetë). Ata nuk mund ta mbanin Tiranën përtej datës 17 nëntor, kaq i fortë qe presioni i partizanëve, dhe faza finale nisi kur ata braktisën pozicionet e tyre këtu dhe në Durrës dhe u kthyen drejt Shkodrës. Kjo tërheqje nuk pati kundërshtim kaq rigoroz. Një brigadë partizane ishte vendosur në malin në lindje, por gjermanët, me kolonat e përforcuara nga garnizonet që tërhiqeshin arritën t'i mbanin nën fre. Ndërkohë që tërhiqeshin ata shkatërruan urat që linin pas. Më 28 nëntor, kolona e fundit gjermane u tërhoq nga dheu shqiptar.

VIII

Me zhdukjen e gjermanëve, FNÇL u bë fuqia më e madhe dhe e padiskutueshme në Shqipëri dhe voli përfitimet politike të luftimeve ngulmuese në terren. Forcat e saj të armatosura mbajtën pjesën më të madhe të armëve të cilat SOE kishte shpërndarë në Shqipëri - gjithsej 6 839 pushkë, 4 933 automatikë sten, 1 847 mitraloza, 3 040 topa kundërajrorë dhe kundërtank, 400 topa malor, 237 mortaja, 25 074 granata, 2 699 mina rrugësh dhe 22 radiomarrës, përtej eksplozivëve dhe qindra tonelata të tjera për nevoja të luftës guerile, ushqim, veshmbathje dhe furnizime mjekësore - dhe nuk kishte asnjë rival që ta trembte. Kupi shpërndaui burrat e tij në tetor të vitit 1944 dhe u arratis me varkë në Itali. Kryeziu besohet të jetë në Gjakovë në anën e kufirit malazez. Ai nuk është më një forcë ushtarake në vend, por gjeneral Hoxha, udhëheqësi i administratës së FNÇL-s (ende i panjohur nga qeveritë e aleatëve) mendohet se po përpiqet ta zgjeroj bazën e tij, duke përfshirë edhe Kryeziun. Deri tani Kryeziu ka qenë i shurdhët ndaj përpjekjeve të tyre. Balli Kombëtar, i diskredituar dhe copëtuar keq nga trupat e FNÇL-s gjatë shtytjes drejt veriut, u rrënua. Mbetjet e tyre në

Shkodër dhe Tiranë ruajtën kohezionin nën mbrojtjen e garnizoneve gjermane. Por, këto garnizone u tërhoqën dhe i lanë në fatin e tyre, të cilët, si bashkëpunëtorë e meritonin. Me siguri, disa u kanë mbijetuar spastrimeve të suksesshme që FNÇL ka ndërmarrë dhe presin mundësinë për t'u hakmarrë. Midis të mbijetuarve është një grup prej 100 prijësish të partisë, të cilët gjermanët, duke vlerësuar me mendjehollësi turpin që do të shkaktonin, i zbarkuan në bregun italian, në shpinë të linjave aleate.

RECENSIONE

Teuta SHALA - PELI

**VEPËR MONUMENTALE DHE UNIKALE PËR ARBËRORËT
DHE HISTORINË E TYRE**

**(Dr. sc. Gjon Berisha, ARBËRORËT NDËRMJET KISHËS
PERËNDIMORE DHE ASAJ LINDORE GJATË SHEKUJVE XI -
XV, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë 2015, f. 675)**

Studiuesi i historisë së mesjetës, Gjon Berisha kohë më parë e finalizoi një studim disavjeçar në një libër mjaft voluminoz me titull “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, një vepër e çmuar dhe e rrallë për këtë fushë të historisë. Botimi i librit në fjalë dëshmon qartë për një punë dhe angazhim mjaft serioze në fushën shkencore të studiuesit Gjon Berisha. Ky studim (libër), e që është i pesti në radhë i tij, është një kurorëzim i punës disavjeçare në tezen e doktoratës të cilën studiuesi Gjon Berisha e mbrojti me mjaft sukses, një vit më parë nën përkujdesjen e profesorit të nderuar, historianit dhe medievistit të mirënjohur prof. dr. Pëllumb Xhufi. Të arriturat shkencore që studiuesi Gjon Berisha na i ofron në këtë libër në thelb trajtojnë dhe nxjerrin në pah kontributin atdhetar të kishës dhe klerit gjatë shekujve XI - XV, kohë e cila përkon me ngjarje në të cilat arbërorët shpeshherë u gjenden përballë sfidave mjaft të vështira të cilat erdhën si rrjedhojë e shumë proceseve dhe ngjarjeve të

cilat i ofruan rrethanat kohore, jo vetëm tek shqiptarët e mesjetës, por edhe në vendet përreth tyre.

Periudha kohore e cila trajtohet në këtë libër e që kapë harkun kohor shek. XI - XV, nuk ishte një përcaktim i rastësishme nga ana e autorit të monografisë, ngase siç na shpjegon ai në hyrje të saj përcaktimi për të studiuar dhe ndriçuar këtë periudhë të historisë sonë, u bë duke marrë për bazë dy ngjarje të mëdha të asaj kohe për kishën në përgjithësi, dhe në veçanti për arbërorët. E para (shek. XI, 1054), lidhet me ndarjen e parë zyrtare kishtare në mes të Kostandinopojës dhe Romës, kurse e dyta (shek. XV) lidhet më rënien e këtyre trojeve përfundimisht nën sundimin osman. Në vazhden e këtyre të dhënave studiuesi Gjon Berisha monografinë e tij shkencore “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, e fillon duke trajtuar gjendjen kishtare tek iliro - arbërorët deri në shek. XI, duke u nisur nga fillimet e krishterimit dhe organizimit kishtar, për të vazhduar me gjendjen e kishës gjatë dyndjeve sllave, luftën kundër ikonave dhe manifestimeve të saj në trevat arbërore, për krishterimin dhe identitetin e arbërorëve gjatë mesjetës, për të përmbyllur këtë kapitull me komunitetin politik dhe fetar të arbërorëve gjatë mesjetës.

Në librin në fjalë studiuesi Gjon Berisha duke trajtuar problemin e arbërorëve ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV, i referohet edhe problemit të zonës Durrës - Arbër, ndërmjet kishës ortodokse dhe asaj katolike, duke sjellë argumente dhe duke sfiduar një pjesë të historiografisë së huaj ku dëshmon se pavarësisht rrethanave, arbërorët e këtyre viseve, arritën të mbijetojnë, të dalin si faktorë dhe në numër, kur rrethanat politike e mundësonin këtë gjë. Po ashtu, duke iu referuar dokumenteve mesjetare të shek. XIV - XV, përfshirë edhe ato serbe, studiuesi Berisha thekson se ato dëshmojnë se popullsia arbërore ishte në masë dhe mbizotëruese në këto treva. Në librin “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, autori i qaset edhe problemit të Argjipeshkvisë Diokle-Tivar gjatë shek. XI - XV, duke u përqendruar fillimisht tek kontinuiteti iliro-arbëror në Diokle/Zetë, për të vazhduar me elaborimin e shumë çështjeve të rëndësishme që lidhen e

Argjipeshkvinë e Tivarit gjatë shek. XI - XV, për të përfunduar me monumentet kishtare në Arbërinë Veriore dhe Zetë, duke vënë në dukje se numri i kishave në Arbërinë Veriore ishte i konsiderueshëm, dhe kjo tregon për rolin qendror që luante besimi në kuadër të jetës qytetare dhe ndikimi i saj në masat e gjera. Përveç kësaj, në kushtet e mesjetës, kisha përfaqësonte jo vetëm një forcë kishtare e shpirtërore, por në shumë raste edhe atë të pushtetit politiko-civil, ekonomik dhe në disa raste edhe atë gjyqësor - thekson ai.

Një çështje tjetër tejet e debatuar, që autori i qasët me mjaft përkushtim në këtë studim shkencor është edhe ajo e gjendjes kishtare në Kosovë gjatë shek. XI - XV, të cilën studiuesi Gjon Berisha me mjaft përkushtim i qaste në kapitullin e katërt “Gjendja kishtare në Kosovë gjatë shek. XI - XV”. Duke i shqyrtuar burimet historike që i referohen kësaj çështjeje ai potencon se burimet që i ka përdorur përkitazi me këtë çështje konkludojnë se në këto vise, kishte banorë shqiptarë katolikë të dëshmuar në dokumente gjithandej gjatë gjithë mesjetës, por të cilët gjatë periudhës së sundimit bizantin, bullgar e sidomos atij nemanjid, nën influencën e faktorëve politikë e fetarë iu nënshtruan një procesi të gjatë të ortodoksizmit, proces i cili vazhdoi më vonë njëkohësisht edhe me procesin e islamizimit, vënë në dukje ai.

Në kapitullin e pestë, përkatësisht në kapitullin e fundit të këtij libri, autori i qaset edhe rolit civil të kishës në jetën ekonomike, shoqërore, kulturore si dhe sjelljeve të klerikëve arbërorë, ku vë në pah rolin e kishës edhe në jetën sociale, politike, ekonomike, kulturore e arsimore, tek arbërorët gjatë mesjetës, duke potencuar se roli dhe kontributi i klerit në shoqërinë mesjetare arbërore del të jetë për faktin se kisha ishte promotore pothuajse e të gjitha segmenteve të jetës, qofshin ato të natyrës laike apo kishtare. Fare në fund, duhet shtuar se vlerë dhe rëndësi librit “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, i japin edhe aparatúra shkencore, ku veçojmë rezymenë në gjuhën angleze, fjalorin e emrave, burimet dhe literaturën, si dhe indeksin e emrave. Duke ju referuar librit “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, mund të konstatojmë se libri në fjalë për nga përmbajtja, mënyra

se si autori i është qasur problemeve të shumta duke filluar që nga shek. XI për të vazhduar deri në shek. XV, me një sërë problemesh që i karakterizonin trevat arbërore, qoftë në aspektin, politik, fetar, social, ekonomik, kulturor e arsimor në përgjithësi, paraqet interes të veçantë jo vetëm për opinionin shkencor, por edhe më gjerë, duke shërbye si burim i rëndësishëm dhe i pamohueshëm informacioni për arbërorët dhe vetë historinë e tyre gjatë periudhës kohore që trajtohet në libër. Për këtë fakt, librin “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI - XV”, me plotë të drejtë e kemi quajtur vepër monumentale dhe unike për arbërorët dhe historinë e tyre.

Hakif BAJRAMI

**ARGUMENTE QË E FORCOJNË NDËRGJEGJEN
KOMBËTARE PËR SHQIPËRINË ETNIKE**

**(Gjeneral G. F. Phillips dhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e
Kosovës, dokumente historike nga Arkivat Britanike 1913-1921
Përgatitur nga Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, Tiranë, Londër
2015, f. 483.)**

Autorët e këtij botimi i kanë prezantuar 128 dokumente me vlerë për plotësimin e shumë detajeve historike gjithëshqiptare. Në përzgjedhjen e dokumenteve, renditjen kronologjike dhe peshën domethënëse diplomatike, politike dhe etnografike-kulturore, kanë dëshmuar profesionalizëm të lartë shkencor. Dihet se heuristika merret me zbulimin e dokumenteve arkivore dhe të atyre që në esencë ruhen nga posedues me proveniencë të ndryshme. Këtë punë të mirëfilltë shkencore, autorët e kanë bërë me një profesionalizëm respektiv. Dokumentet nuk janë botuar në mënyrë kritike, sipas përmbajtjeve që ngërthejnë, por në bazë të hermeneutikës, kanë bërë përpjekje maksimale profesionale shkencore që të nxjerrin sa më shumë informacione për secilin dokument, duke ia ndajmath një argumenti, disa argumente dokumentare në vijim, që do të thotë se kanë zgjedhë një metodë origjinale për t'iu larguar citatomanisë së shumtë që kanë pasur mundësi të prezantojnë. Me këtë mënyrë të botimit, autorët kanë lënë hapësirë të kuptohet se do ta vazhdojnë serinë e hulumtimit dhe të botimit të dokumentacionit të kësaj proveniencie britanike.

E vërteta në titull, theksojnë se është fjala të observimet shqiptare nga gjenerali respektiv George Fraser Phillips, por përball tij sjellin edhe dokumente të tjera me vlerë të madhe për një periudhë tejet dramatike të kombit shqiptar, në shtetformim dhe kombëforcim. Autorët, tërë dokumentacionin e kanë renditë sipas viteve, nga viti 1913 kur po vendosej në Londër fati i Shqipërisë, e deri te Konferenca e Paqes në Versajë 1919-1921, duke vënë në qendër të prezantimit të fakteve ku rolin e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës e vlerësojnë objektivist, natyrisht me dokumente relevante. Ky përkthim i këtillë dëshmon se autorët jo vetëm që kanë treguar profesionalizëm të shkëlqyer, por njëherit edhe respekt dhe dashuri për kombin që i takojnë, pa ndonjë komentim të tyre subjektiv. E them këtë, sepse prezantimi i dokumenteve mbi krimet dhe masakrat serbo-malazeze, mbi një popull të pambrojtur, dëshmon se autorët jo vetëm që e njohin profesionin, por janë edhe pedagogë të mirëfilltë, sepse të rrallë janë ata autorë që duke i përshkruar barbaritë koloniale, nuk u nënshtrohen emocioneve dhe urrejtjes së dukshme. Me këtë, autorët kanë lënë hapësirë në shkallë hermeneutike, të kuptohet se lexuesi dhe studiuesi le të kuptojë në mes rreshtave çdo gjë që është prezantuar, por edhe çdo gjë që nuk është prezantua. E këta autorë nuk e kanë plasuar, por e dinë, se janë shumë të informuar, madje në detaje.

Dokumentet e botuara e nxjerrin në shesh edhe një aksiomë indikative. Brenga kryesore e politikës dhe diplomacisë angleze, del se ishte dhe mbetej që të themelohej një Shqipëri, madje e cunguar, mbi tokën e së cilës rriheshin dallgët e interesave gjeostrategjike të fuqive evropiane. Në këtë mënyrë del sheshazi se tokat shqiptare, nuk ishin objekt pazaresh në mes Fuqive dhe fqinjëve shqiptarë, se kush po grabitë më tepër e kush më pak, por le të kuptohet se ishte një fushatë infektive që kombi shqiptar të dënohej sa më egërsisht, sepse në “mesjetë” e kishte pranuar islamin si religjion. Ky kuptim del sheshazi nga filozofia e leximit dhe studimit të dokumenteve të prezantuara që krahas dëbimit të “Osmanlisë më 1912, të dëbohen edhe shqiptarët muslimanë n’Anadoll. Ishte fjala pra për një kryqëzatë klasike. Ndërsa ata shqiptarë që mbeteshin si të krishterë në trojet e veta, patjetër duhej që të konvertoheshin në “religjionin e origjinës”. E them këtë fakt, sepse nga viti 1913-1921, kohë kjo që autorët e përthekojnë me fakte arkivore, prezantohen të dhëna të pamohuara për barbaritë dhe mizoritë mbi popullsinë shqiptare, faktet e të cilave diplomacia angleze u ka kushtuar rëndësi të nivelit të lartë dhe objektiv, për t’i thënë asaj fushate një ditë STOP, sepse kishin fuqi dhe mjete të mjaftuara. Gjenerali Phillips, këtë

domethënie në veprimtarinë e tij në shërbim të shtetit të tij e dëshmon fillim e mbarim, kuptohet me një vakum të qartë, kur viset shqiptare u riokupauan nga pushtues të tjerë: austriak, italian, bullgar (1915-1918). Autorët më mirë se askund tjetër në publikim e kanë prezantuar, gjithnjë në bazë të dokumenteve objektive angleze hipokrizinë e parisë politike shqiptare, duke funksionalizuar tragjedinë edhe si pasojë e faktorit subjektiv përçarës. Ky argument del sheshazi në luftën që i bëhet “në ballë dhe pas shpine” orientimit të babait të pavarësisë Ismail Qemalit, me disa bashkëpunëtorë të pakët. Ky perfiditet finok aziatik “me jelekë” dhe evropian me “mustaqe”, nuk do të pushojë edhe pas largimit të Ismail Qemalit. Prandaj, autorët plasojnë dokumente rrëqethëse se si oscilojnë tradhtarët dhe finokët, mediokritet dhe bataçinjtë, bajraktarët dhe mercenarët, vrasësit dhe ngufatsit e shkollave të intrigave nga Stambolli, Athina, Roma, Beogradi, Cetina dhe Peterburgu, me disa premisa diversive edhe nga Parisi dhe Londra. I tillë është Raporti i G. F. Fillipsit nga 7 dhjetori 1915, që vajton fillim e mbarim fatin e ushtrisë serbe, pa e potencuar me asnjë fjalë krimin që i bënë oficerët dhe ushtarët serbo-malazezë popullsisë autoktone shqiptare nga Merdari e deri në Durrës në fund të vitit 1915.

Autorët për vitin 1918 japin një serë dokumente (20 dok.) duke prezantuar edhe një dokument propagandë, të cilin e përdorte oficeria okupuese austriake nëpër distrikte, për të “dëshmuar” se ja ne austriakët për “herë të dytë, po e shpallim pavarësinë shqiptare”, madje në Gjakovë! Kjo lloj shpalljeje nuk ndodhi vetëm në Gjakovë, por ishte dukuri gjatë vitit 1917 dhe vazhdoi edhe në vitin e fundit të okupimit austro-hungarez, të “ushtrohet” nëpër shumë qytete, si në: Shkodër, Lezhë, Elbasan që lë të kuptohet se ishte fjala për përdorim të njëkohshëm. Prania e historisë Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në shumë dokumente angleze nga 1 maji 1918 e deri më 1921 nuk do të thotë se Londra kishte qëndrim të drejtë ndaj çështjes shqiptare edhe pas Luftës së Parë Botërore. Letër njoftim për këtë qëndrim është qëndrimi i Sir E. Drymondit si ministër, e pastaj si kryetar i Shoqatës së Kombeve, i cili nuk bëri as më të voglin reagim ndaj mizorive të shtetit të Mbretërisë së SKS-së mbi shqiptarë. Me gjithë këtë duhet theksuar se F. O. e përcjell në Uashington, Letrën e KMKK-së, më 8 korrik 1919. Lidhur me këtë është me shumë interes prezantimi i një raporti nga gjenerali Fillips, shef i Misionit anglez në Shqipërinë e pas luftës (25 mars 1920), i cili zbulon detaje nga largimi i francezëve prej Shkodrës dhe raportet e shqiptarëve me Mbretërinë malazeze si kundërshtarë e Mbretërisë serbe. Në këto kombinime gjenerali Fillips i përzien me të

drejtë italianët, fakt ky që vërteton edhe dokumentet e proveniencave tjera arkivore. Vlen të theksohet se Ahmet Zogu dhe Hoxhë Kadri Prishtina (i pari nga Shqipëria bregdetare dhe i dyti nga Shqipëria kontinentale) ishin bërë faktorë të nderuar nga diplomacia e Londrës. Mu për këtë arsye Londra më 1921, nuk do të merret publikisht me statusin e Shqipërisë, aq më pak kur shteti shqiptar ishte pranuar në Shoqatën e Kombeve, por çështje e hapur mbeteshin kufijtë.

Për vitin 1921 Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, kanë prezantuar vetëm gjashtë dokumente. Emërues i përbashkët i tyre është se Londra, nuk ndryshon kursin e vjetër ndaj çështjes shqiptare. Në vijim çështja e kufijve nga Londra, do të pranohet të diskutohen dhe të vendosën definitivisht, por jo me ndryshime të mëdha në dëm të Tiranës. Në vijim autorët prezantojnë faksimile dokumentesh, duke pasuar me një aneks fotografish që jepen për herë të parë. Tronditës në këtë prezantim të fotove është rrahja publike e shqiptarëve nëpër sheshet e viseve shqiptare, dukuri kjo që zgjati nga viti 1913 e deri më 1923. Autorët në fund japin të kuptohet se do ta vazhdojnë serinë e botimit të dokumenteve të kësaj proveniencë, të cilën e përshëndesim nga zemra dhe me respekt profesional. Prezantimi i indeksit të emrave në fund dëshmon se kemi të bëjmë me një publikim serioz shkencor që lehtëson hulumtuesin gjatë gjurmimit të problemeve të caktuara.

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË PËR PERIUDHËN 2014-2015

Projektet shkencore

Tanimë që Kosova është shtet, me institucione respektive, flamur, himn e kushtetutë është e domosdoshme dhe jetike që sa më parë të ketë edhe historinë e shtetit. Në përpjekje për të hartuar një histori të nivelit shtetëror, të bazuar në burime dokumentare dhe në literaturën relevante, në kuadër të veprimtarisë së rregullt shkencore, Instituti i Historisë ka hartuar, përveç tjerash, projektin “Historia e Kosovës”. Projekti në fjalë është shkruar dhe përgatitur duke u specifikuar në detaje të gjitha periudhat historike që do të përfshihen, fazat e realizimit, parashikimet për hulumtime në arkiva dhe biblioteka dhe deri te planifikimet e përafërta buxhetore që kërkohen për të realizuar sa më me sukses një projekt të tillë të nivelit shtetëror.

Gjithnjë në të mirë të historisë kombëtare dhe shtetërore, Instituti ka marrë përsipër edhe hartimin e historisë më të re të Kosovës (shek. XX), për të cilën është shkruar më pak dhe në rrethana jo të favorshme politike e sociale. Në mënyrë të veçantë, e rëndësishme është zbardhja përmes fakteve e luftës së fundit në Kosovë, përkatësisht hartimi i një historie të përgjithshme, për të gjitha trevat dhe zonat e Kosovës, për Luftën Çlirimtare në Kosovë të viteve 1998-1999 dhe Gjenocidin serb mbi popullatën e Kosovës 1998-1999. Që kjo periudhë dhe këto ngjarje historike të gjejnë vendin e merituar në histori, Instituti ka hartuar projekte të veçanta për to, me shpresën se do të gjejë mbështetje edhe nga institucionet shtetërore të Kosovës: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga vetë Kryeministria e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të *projekteve të vogla kërkimore-shkencore* të sponsorizuara nga MASHT, Instituti ka fituar dy projekte: “Kosova

mesjetare sipas dokumenteve arkivore”, me bartës të projektit, dr. sc. Gjon Berisha, shef i Departamentit të Antikës dhe Mesjetës, i cili është në fazën përfundimtare të realizimit të tij. Në kuadër të këtij projekti tre studiues nga Instituti, kanë bërë kërkime intenzive shkencore (nga data 2-13 nëntor 2015), në *Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut* dhe atë të Tiranës, me ç’rast kanë sjellë një sasi të konsiderueshme të dokumenteve nga fusha e mesjetës të cilat janë në fazën e fundit të përpunimit të tyre; dhe projekti: *“Krimet e luftës dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë”*, me bartës prof. dr. Haki Kasumi - në fazën fillestare të realizimit.

Gjithashtu, punëtorët shkencorë në mënyrë individuale, gjatë këtij viti, kanë hulumtuar edhe nëpër arkiva tjera vendore si dhe ato jashtë vendit, materialet e të cilëve do të dorëzohen në Arkivin e Institutit. Një pjesë të këtyre rezultateve, gjatë vitit, i kanë prezantuar nëpër konferenca shkencore apo i kanë publikuar në revista shkencore e publicistike.

Aktivitetet shkencore

Vitet 2014-2015 karakterizohen si vite të suksesshme në realizimin e projekte, aktivitete dhe botime shkencore të fushës së historisë nga Instituti i Historisë. Kështu, gjatë këtyre viteve, Instituti organizoi disa konferenca shkencore të një rëndësie të veçantë për historiografinë shqiptare, atë të rajonit dhe më gjerë. Në kuadër të njëqindvjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore, më datë 15 tetor 2014, në Prishtinë u mbajt Konferenca Shkencore: *“Shqiptarët në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore 1914-1915”*, organizuar nga Instituti i Historisë në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës. Në këtë Konferencë morën pjesë studiues vendas dhe të huaj.

Gjatë Konferencës u prezantuan 26 kumtesa, në të cilat u trajtuan tematika të lidhura ngushtë me fatin historik të shqiptarëve përgjatë Luftës së Parë Botërore. Konferenca filloi me hapjen e fjalës nga prof. dr. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik, në të cilin fjalim ngërtheu pikat më të rëndësishme të ngjarjeve historike që krijuan rrethanat e vështira me të cilat u përballën shqiptarët në luftërat pararendëse të Luftës së Parë Botërore si dhe gjatë saj. Në këtë kontekst, u ritheksua vështirësia gjeostrategjike me të cilën përballeshin shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore, duke i pasur dy blloqe të luftës së hapur. Ndërkaq, fjalën përrshëndetëse e mbajti zëvendësministri i Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, z. Nehat Mustafa, ku mes të tjerave theksoi rëndësinë e mospolitizimit të historisë si dhe rëndësinë e Luftës së Parë Botërore që mban në kontekstin e situatës politike të shqiptarëve edhe në ditët e sotme.

Konferenca ishte e ndarë dy sesione. Studiuesit u paraqiten me këto kumtesa: Beqir Meta, *“Kontributi i “Vatrës” për çështjen shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore”*; Sabit Syla, *“Zona e pushtimit austro-hungarez në Kosovë”*; Proletar Hasani dhe Marenglen Kasmi, *“Formacionet ushtarake vendase nën ushtritë e huaja gjatë Luftës së Parë Botërore në teatrin shqiptar të luftës”*; Xheladin Shala, *“Shqipëria në kohën e Princ Vidit”*; Ledia Dushku, *“Përprjekjet e qeverisë shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore (mars-prill 1914)”*; Sabile Keçmezi-Basha, *“Programet politike të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918”*; Marenglen Verli, *“Aspekte rreth situatës në trevat shqiptare nën pushtimin austro-hungarez dhe bullgar (1916-1918)”*; Katarina Todoroska, *“How Chaulev regarded the Albanians and Albania”* (Si i pa Çaulevi shqiptarët dhe Shqipërinë); Pëllumb Xhufi, *“Masakrat greke në Shqipërinë e Jugut më 1914”*; Hamit Kaba, *“Shqipëria e Jugut në raportin e një gjenerali amerikan 1918”*; Fatmira Musaj, *“Roli i gruas shqiptare në vitet e Luftës së Parë Botërore”*; Lush Culaj, *“Kërkesat kryesore të Qeverisë së Durrësit drejtuar Konferencës së Parisit”*; Haki Kasumi, *“Gjendja dhe pozita e shqiptarëve në zonën okupuese bullgare”*; Ivanka Dodovska, *“The Treaty of London from 1915 and the involvement of secret diplomacy during the First World War”* (Traktati i Fshehtë i Londrës i vitit 1915 dhe përdorimi i instrumenteve të diplomacisë sekrete gjatë Luftës së Parë Botërore); Hakif Bajrami, *“Qëndrimet e Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore (sipas dokumenteve austriake)”*; Skënder Asani, *“Krahina e Shkupit gjatë pushtimit bullgar”*; Izber Hoti, *“Orientime dhe qëndrime në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore”*; Dalibor Jovanovski, *“Lyoubomir Miletich on the Albanians during the First World War”* (Lubomir Miletiqi për shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore); Liman Rushiti, *“Situata politike në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore”*; Ismet Dërmaku, *“Republika autonome e Korçës (10 dhjetor 1916-shkurt 1918) dhe Themistokli Gërmenji”*; Naser Ferri, *“Kontributi i pjesëtarëve të ushtrisë dhe i shkencëtarëve austro-hungarezë në arkeologji gjatë Luftës së Parë Botërore”*; Bernard Zotaj dhe Asllan Zemani, *“Çetat kryengritëse shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore (Sali Butka, Azem Bejta etj.)”*; Qerim Lita, *“Rrethanat politike e ushtarake në Lumë e Dibër gjatë vitit 1916”*; Memli Krasniqi,

“Rishpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në Gjakovë më 1918 (sipas dokumenteve arkivore britanike)”; Isa Bica, *“Përpyjekjet e Malit të Zi për pushtimin e Shkodrës më 1912-1913 dhe më 1915”*; Esilda Luku, *“Vështrim mbi Shqipërinë e projektuar në Traktatin e Fshehtë të Londrës”*.

Fjalën përmbyllëse e mbajti drejtori i Institutit të Historisë *“Ali Hadri”*-Prishtinë, prof. assoc. dr. Sabit Syla, ku theksoi rëndësinë e punimeve të Konferencës për historiografinë shqiptare. Në këtë fjalim, ndër të tjera i theksoi avantazhet e Konferencës në kontekstin e prurjeve të të dhënave të reja historike në aspekte analitike.

Më 5 qershor 2015, Instituti i Historisë *“Ali Hadri”*-Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Tiranë dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, nën patronazhin e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës organizuan Konferencën Shkencore: *“Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”*, e cila u mbajt në ambientet e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Organizimi i kësaj Konference, e cila u mbajt për nder të rivarrimit të eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletini në 99-vjetorin e rënies, qëllimi i të cilës ishte të ndriçojë jetën dhe veprën e atdhetarit Isa Boletini dhe bashkëluftëtarëve të tij. Në këtë Konferencë, morën pjesë 24 studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, të cilët kumtesat e tyre kushtuar veprimtarisë patriotike e atdhetare të Isa Boletinit i prezantuan në dy seanca.

Fjalën e hapjes së Konferencës Shkencore e mbajti Sabit Syla, drejtor i Institutit të Historisë. Në Konferencën Shkencore: *“Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”*, ishin të pranishëm edhe personalitete nga jeta politike, si kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli, ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi, të cilët mbajtën nga një fjalë përshëndetëse. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Kadri Veseli, në fjalën e tij përshëndetëse tha se heroi kombëtar Isa Boletini jetoi dhe veproi në një kohë të kthesave të mëdha historike. Sundimi shekullor osman po kalonte në vitet e fundit të tij dhe shqiptarët po përballeshin me një sfidë radikale, ose do të dilnin nga ky sundim si një komb i formuar dhe me aftësi shtetformuese ose rrezikonin një shpërbërje kolektive si etni dhe shpërbërje nga territori i tyre etnik. Rrugëtimi i gjatë i eshtrave të tij në një mënyrë pasqyron edhe sakrificën dhe udhëtimin e gjatë që pati populli ynë në luftën shekullore për liri dhe pavarësi - theksoi ai. Po ashtu edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Qemal

Minxhozi, në fjalën e tij përshëndetëse e çmoi lart figurën historike të heroit kombëtar Isa Boletini. Seancën e parë e drejtuan: Sabit Syla, Beqir Meta, Sabile Keçmezi-Basha, Marenglen Verli dhe Skënder Asani.

Studiuesit u paraqiten me këto kumtesa: Pajazit Nushi, *“Isa Boletini dhe tematizimi enciklopedik i jetës dhe veprimtarisë së tij”*; Sabile Keçmezi-Basha, *“Trajtimi i figurës së Isa Boletinit në historiografinë shqiptare”*; Proletar Hasani & Bernard Zotaj, *“Dimensioni ushtarak i Isa Boletinit”*; Bujar Dugolli & Jusuf Osmani, *“Roli i Isa Boletinit në pengimin e hapjes së Konsullatës ruse në Mitrovicë dhe vrasja e konsullit rus”*; Marenglen Verli, *“Isa Boletini në mbrojtje të Shqipërisë së Pavarur (në Vlorë, Londër, Durrës...)”*; Fatmira Musaj, *“Qëndrimi i Isa Boletinit ndaj elementit serb në Kosovë dhe politikës së Beogradit (1912-1916)”*; Ledia Dushku, *“Shoqëria “Shqipnia” dhe Isa Boletini”*; Sokol Gjërmeni, *“Isa Boletini dhe Kryengritja e vitit 1911”*; Nebi Dervishi, *“Veprimtaria atdhetare e Isa Boletinit në vitet 1912-1913”*; Qerim Lita, *“Kryengritja e Shtatorit më 1913 dhe roli i Isa Boletinit”*; Halim Purellku, *“Shteti shqiptar dhe roli i Isa Boletinit, më 1913-1915”*; Hakif Bajrami, *“Si u vra Isa Boletini, më 1916?”*; Lush Culaj, *“Bashkëpunimi i Isa Boletinit me Patër Engjëll Palaj”*; Fitim Rifati, *“Bashkëpunimi i Isa Boletinit me krerët e trevave lindore gjatë kryengritjeve të viteve 1910-1912”*; Gjet Ndoj, *“Isa Boletini në dritën e dokumenteve arkivore shqiptare”*; Dritan Egro, *“Kosova dhe Isa Boletini më 1910, sipas shtypit xhonturk”*; Frashër Demaj, *“Veprimtaria e Isa Boletinit sipas burimeve britanike, 1910-1912”*; Xheladin Shala, *“Isa Boletini në burimet serbe 1914-1916”*; Sylë Ukshini, *“Roli i Isa Boletinit në lëvizjen antixhonturke, sipas burimeve arkivore austro-hungareze”*; Isa Bicaj, *“Isa Boletini në dokumentet dhe shtypin malazez”*; Sevdail Demiri, *“Pasqyrimi i figurës së Isa Boletinit sipas burimeve dokumentare dhe shtypit bullgar, më 1912”*; Teki Kurti, *“Vështrim i shtypit të Shqipërisë mbi Isa Boletinin”*; Adem Zejnullahu, *“Isa Boletini sipas epikes historike dhe kujtesës së popullit”* dhe Asllan Murati, *“Sjellja e eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletinit nga Mali i Zi në Mitrovicë”*.

Fjalën e mbylljes së Konferencës Shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare ” e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë. Pasi bëri një rezymim të Konferencës në fjalë, ai theksoi se figura e Isa Boletinit është një figurë shumë e madhe.

Më 16 tetor 2015 u mbajt Konferenca Shkencore: “*Beteja e Dytë e Kosovës, 1448*”, gjatë së cilës Konferencë u paraqitën punime shkencore nga studiues vendas dhe të huaj, të ndara sipas fushave dhe specializimeve të veçanta: trajtesa historike dhe historiografike, krahasimtare në mes Betejës së Parë dhe asaj të Dytë të Kosovës, gjuhësore, nga tradita, eposi dhe folklori, aspekte letrare të trajtimit të temë etj. Punimet e Konferencës u hapën me fjalën e drejtorit të Institutit të Historisë, prof. assoc. dr. Sabit Syla, i cili foli për rëndësinë historike që mban Beteja e Dytë e Kosovës.

Në këtë Konferencë, studiuesit u paraqiten me këto kumtesa: Muhamet Mala, “*Aspekte krahasimtare në mes të Betejës së Parë dhe të Dytë të Kosovës*”; Iljaz Rexha, “*Lufta e Kosovës më 1448 sipas literaturës dhe kronikave osmane*”; Bedri Muhadri, “*Marrëdhëniet e Skënderbeut me Huniadin*”; Enver Rexhaj, “*Beteja e Dytë e Kosovës në historiografinë serbe*”; Mark Palnikaj, “*Beteja e Dytë e Kosovës më 1448 dhe ndikimi i saj në zhvendosjen dhe islamizimin e popullsisë së Kosovës dhe viseve të tjera bazuar në dokumentet e arkivave të Vatikanit*”; Virgjl Kule, “*Skënderbeu dhe Beteja e Dytë e Kosovës*”; Nikollë Loka, “*Arsimi shqiptar pas pushtimit osman*”; Mark Tirta, “*Pushtimi osman, shek. XV: ikje popullsie nga Kosova*”; Anna Di Lellio, “*Beteja e Parë e Kosovës dhe përkujtimi kolektiv në Kosovë*”; Zeqirja Neziri, “*Eposi heroik shqiptar përgjatë mesjetës*”; Zymer Neziri, “*Elemente të Eposit të Kreshnikëve*”. Konferenca u përmbyllë me diskutime interesante të natyrës historike.

Më 30 tetor të vitit 2015 u mbajt Konferenca Shkencore: “*Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)*”, e organizuar nga Instituti i Historisë, në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt dhe Komunën e Drenasit. Konferenca në fjalë u organizua me rastin e një ngjarje të rëndë për fatin e shqiptarëve në përfundim të Luftës së Dytë Botërore - 70 vjetorin e ripushtimit të Kosovës. Në Konferencë kumtesat e tyre në dy seanca i prezantuan 20 studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Hapjen e Konferencës e bëri drejtori i Institutit të Historisë prof. asoc. dr. Sabit Syla, i cili ndër të tjera theksoi rëndësinë historike të mbajtjes së kësaj konference, me rastin e 70-vjetorit të ripushtimit të Kosovës. Pas fjalës së hapjes punimet e Konferencës i përshëndetën: ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi dhe nënkryetari i Komunës së Skenderajt z. Fadil Nura, të cilët e përgëzuan Institutin e Historisë në Prishtinë për organizimin e kësaj Konference Shkencore.

Referuesit u paraqiten me këto kumtesa: Sabile Keçmezi-Basha, *"Kuvendi i Prizrenit, 8-10 korrik 1945"*; Beqir Meta, *"Ndikimi i situatës ndërkombëtare në ripushtimin e Kosovës (1944/1945)"*; Ibrahim Gashi, *"Shaban Polluzha drejtues i Luftës së Drenicës në dimrin e viteve 1944/1945"*; Marenglen Verli, *"Disa konsiderata për zhvillimet politiko-ushtarake në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore"*; Izber Hoti, *"Qëndrime dhe veprime të forcave politike dhe ushtarake të Kosovës (1944-1945) dhe Lufta e Drenicës"*; Hakif Bajrami, *"Si e riokupoi Jugosllavia Federative Kosovën (argumente) 1944-1945"*; Hamit Kaba, *"Rezistenca e shqiptareve në Kosovë e Maqedoni në vështirimin e britanikëve dhe amerikanëve"*; Proletar Hasani, *"Kontributi i Brigadave shqiptare në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore"*; Halim Purellku, *"Operacionet përfundimtare ushtarake të forcave komuniste partizane për trevat lindore shqiptare në gjysmën e dytë të vitit 1944"*; Sabit Syla, *"Qëndrimi i Qeverisë komuniste shqiptare ndaj ripushtimit të Kosovës"*, i cili paraqiti argumente shkencore rreth qëndrimit të qeverisë shqiptare ndaj çështjes së ripushtimit të Kosovës nga ana e Serbisë dhe Jugosllavisë më 1944-1945; Muhamet Shatri, *"Veprimtaria e forcave të armatosura jugosllave në Kosovë në fillim të vitit 1945"*; Muharrem Dezhgiu, *"Ballafaqimi midis njësive të UNÇSH-së dhe nacionalistëve shqiptarë në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore"*; Sulltane Ukaj, *"Pozita e nacionalistëve shqiptarë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore"*; Fehmi Rexhepi, *"Masakra e Tivarit në historiografinë shqiptare"*; Haki Kasumi, *"Masakra e Tivarit, shkaqet dhe pasojat"*; Qerim Lita, *"Rrethanat politike e ushtarake në trevat verilindore shqiptare, nëntor 1944-nëntor 1945"*; Marenglen Kasmi, *"Politika gjermane në Kosovë 1944-1945"*; Zeliye Shala, *"Organizimi i shqiptarëve për mbrojtjen e kufijve në vitin 1944-1945"*; Mrika Limani, *"Avancimi i forcave antifashiste krahas tërheqjes së trupave gjermane në territorin e Kosovës më 1944"* dhe Haxhi Ademi, *"Interpretimi i literaturës historiografike shqiptare, për ripushtimin jugosllav dhe Luftën e Drenicës më 1944/1945"*.

Fjalën përfundimtare të Konferencës: "Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944 -1945)" e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë, i cili pasi bëri një vlerësim të përmbledhur të tërë asaj që u kumtua në Konferencë - vlerësoi lart kumtesat dhe kontributin e studiuesve të cilët në mënyrë të veçantë i përgëzoi për gjuhën dhe fjalorin akademik që u përdor në këtë Konferencë.

Veprimtaria botuese

Në kuadër të veprimtarisë botuese të Institutit, në nëntor të vitit 2014, doli nga shtypi monografia “Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore” (përmbledhje studimesh). Ky botim është përmbledhje e materialeve të Konferencës Shkencore të organizuar në tetor të vitit 2013, në bashkorganizim të dy instituteve të historisë, atij të Prishtinës dhe Tiranës. Botimi në fjalë përmbledhë rezultate të reja historike të periudhës, që kanë vlerë të jashtëzakonshme për studiuesit. Pas një kohe relativisht të gjatë të mungesë së studimeve nga fusha e mesjetës, studiuesi Gjon Berisha, sjellë studimin tij monografik të titulluar “Organizimi kishtar në Kosovë gjatë Mesjetës”, botuar nga Instituti i Historisë në fillim të vitit 2014. Tematika e trajtimit në këtë libër, nga autori, është konceptuar si një sintezë e historisë së organizimit administrativ dhe juridiko-kishtar të kishës në këto treva që nga fillet e saj, por me një theks të veçantë gjatë shek. XI-XV. Vepër tjetër e një rëndësie të veçantë shkencore ishte vepra e studiuesit Isuf Ahmeti, “Qytetet e Kosovës gjatë shekujve XVI-XVIII”, e cila u botua në dhjetor të vitit 2014. E një rëndësie po aq të rëndësishme ishte dhe botimi i revistës shkencore vjetore “Kosova”, nr. 39 (2014), të Institutit të Historisë, botim ky i cili në vetvete përfshiu 19 punime shkencore që sollën të reja në fushën e historisë, tri punime të përbëra nga materialet dhe dokumentet, dhe dy recensione.

Viti 2015 gjithashtu u shënua qysh në janar me botime, konkretisht vepra e bashkautorëve Mehmet Hajrizi - Gani Sylja, e titulluar “Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës (dokumente dhe materiale)”, vepër kjo që u botua nga Instituti i Historisë në bashkëpunim me Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, dhe u promovua më 29 janar 2015 në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Gjate këtij viti u botuan edhe një sërë botimesh të veçanta nga autorët si: Gjon Berisha, “Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV”; Haki Kasumi, “Sadik Zeneli - Abria 1888-1945”; Shkodran Imeraj, “Masakrat në Lybeniq, 1998-1999”; Sabile Keçmezi-Basha, “Qëndresa shekullore e familjes - Tahir Meha” dhe përmbledhja dokumentare nga Qerim Lita, “Kushtrimi i Lirisë, Rafi Halili - dokumente. Fundi i vitit 2015, në fushën e botimeve përmbillet me botimin e materialeve të Konferencës Shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare” dhe vëllimi me dokumente: “Agjencia Shtetërore Informative “Kosovapress” - Arkivi i Luftës”, në katër vëllime e përgatitur nga Berat Luzha.

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË

KOSOVA

40 2015

Redaktore gjuhësore: Shqipe Doda

Rezimetë i përktheu: Mrika Limani

Arti grafik: Teuta Shala –Peli

Tirazhi: 500 copë